

INSTITUTI I STUDIMEVE MARKSISTE-LENINISTE
PRANË KQ TË PPSH

DOKUMENTA KRYESORE
TË PARTISË
SË PUNËS TË SHQIPËRISË

1949 - 1956

LOTËM I DËTË



TIRANË, 1972

PROLETARË TË TË GJITHË VENDEVE, BASHKOHUNI!

FRANË KQ TË PPSH

DOKUMENTA KRYESORE
TË PARTISË
SË PUNËS TË SHQIPËRISË

TIRANË, 1972

DOKUMENTA KRYESORE TË PPSH

VËLLIMI II

1949 - 1956

BOTIMI I DYTË

BIBLIOTEKA
E
SHKOLLËS SË PARTISË

SHKOLLËS SË PARTISË

PARATHËNJE

Vëllimi II i «Dokumentave Kryesore të PPSH» u botua në vitin 1961.

Në botimin e dytë të këtij vëllimi, përveç dokumentave të botimit të parë, përfshihen edhe dokumenta të tjera të rëndësishme të PPSH, një pjesë e të cilave botohet për herë të parë.

Në këtë vëllim përfshihen: raporte, vendime, rezolucione, udhëzime, letra e dokumenta të tjera të periudhës janar 1949-qershor 1956.

Dokumentat e kësaj periudhe pasqyrojnë: luftën për zbatimin e vendimeve historike të Kongresit I të Partisë, për të vënë në jetë kthesën që shënoi kongresi; luftën për zbatimin e vendimeve të Kongresit II të Partisë lidhur me ndërtimin e bazës ekonomike të socializmit.

Këto dokumenta flasin për përpjekjet e jashtzakonshme të Partisë e të popullit shqiptar për plotësimin e planit dyvjeçar e të planit të parë pesëvjeçar: për industrializimin socialist të vendit, për nxjerrjen e bujqësisë nga prapambetja dhe vënjen e saj në rrugën e transformimit socialist, që në fund të pesëvjeçarit të parë Shqipëria të shndërrohej nga një vend i prapambetur agrar në një vend agraro-industrial.

Në dokumentat e këtij vëllimi del në pah lufta e Partisë për zgjidhjen e problemeve të ndërtimit të bazës ekonomike të socializmit dhe të zhvillimit të forcave prodhuese, për kapërcimin e vështirësive të jashtzakonshme që dilnin përpara në rrugën e zgjidhjes së këtyre problemeve. Në këto kushte problem kyç paraqitej ruajtja dhe forcimi i aleancës së klasës punëtore me masat e fshatarësisë punonjëse. Për këtë qëllim ishte e domosdoshme të forcoheshin në radhë të parë lidhjet ekonomike midis fshatit dhe qytetit sidomos në lëmin e shkëmbimeve të mallrave. Këtij pikësynimi i shërbeu sistemi i ri i grumbullimit dhe i furnizimit që u përfundua dhe u vendos nga Partia fill pas Kongresit I të Partisë Komuniste Shqiptare.

Në këtë periudhë, pas tradhëtisë së udhëheqjes së PK të Jugosllavisë, Partisë sonë ju desh të kapërcejë jo vetëm vështirësi

të mëdha ekonomike, por edhe politike. U krijua një situatë e jashtme dhe e brendshme tepër e ndërlikuar. Si rrjedhim u ashpërsua lufta e klasave në shkallë ndërkombëtare e kombëtare. Imperialistët amerikanë e anglezë dhe shërbëtorët e tyre në kufitë e vendit tonë dendësuan veprimtarinë e tyre armiqësore. Këtë veprimtari e përkrahën klasat e përmbysura çifligaro-borgjeze dhe gjithë reaksionarët e vendit, të cilëve ju ngjallën shpresat për rivendosjen e rendit të vjetër.

Dokumentat e këtij vëllimi dëshmojnë për luftën heroike të Partisë e të popullit tonë kundër veprimtarisë agresive imperialisto-revizioniste dhe të armikut të klasës brenda vendit: u zbuluan dhe u asgjësuan bandat e dërguara prej tyre në Shqipëri, planet e komplotet e tyre për përmbysjen e pushtetit tonë popullor, u dërmuan forcat e armatosura monarko-fashiste në provokacionet e 2 gushtit 1949 dhe të gjitha përpjekjet e tyre kundër vendit tonë.

Presioni i luftës së klasës jashtë e brenda vendit u ndie edhe në gjirin e Partisë. Elementë të ndryshëm antiparti u gjuhëzuan përpara presionit të armiqve të jashtëm dhe të brendshëm të klasës si edhe përpara vështirësive të jashtzakonshme që kalonte vendi në atë kohë. Midis këtyre elementëve pati edhe ndonjë anëtar të KQ të PPSH.

Dokumentat e këtij vëllimi e veçanërisht materialet e Plenumit V të Shkurtit 1950, të Plenumit IX të Shkurtit 1951, të Kongresit II të PPSH, të Plenumit XIV të Qershorit 1955 dhe të Kongresit III të Partisë flasin për luftën e pandërprerë parimore të PPSH, me shokun Enver Hoxha në krye, kundër elementëve dhe pikëpamjeve antiparti dhe antimarksiste.

Kjo luftë ishte e domosdoshme për ruajtjen dhe forcimin e unitetit ideologjik e organizativ të saj, për forcimin e disiplinës proletare, për demokratizimin e mëtejshëm të jetës së brendshme, për rritjen e vigjilencës revolucionare.

Lufta kundër armiqve të klasës shërbeu drejtpërdrejt edhe për forcimin e diktaturës së proletariatit si arma kryesore në duart e klasës punëtore e të fshatarësisë punonjëse për ndërtimin e shoqërisë socialiste, si dhe për forcimin e modernizimin e mëtejshëm të forcave tona të armatosura, për fuqizimin e gjithanshëm të mbrojtjes së atdheut.

Në materialet e këtij vëllimi del qartë lufta parimore e konsekuente e Partisë, me shokun Enver Hoxha në krye, për ruajtjen dhe forcimin e unitetit të lëvizjes komuniste e punëtore ndërkombëtare e të kampit socialist, për mbrojtjen e ideve të marksizëm-leninizmit.

Të gjitha dokumentat që ribotohen dhe ato që botohen për herë të parë janë ballafaquar me origjinalin që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë. Ndërsa dokumentat që janë marrë nga veprat

e shokut Enver Hoxha botohen sipas veprave të tija pa asnjë ndryshim. Disa dokumenta që ishin me ndonjë shkurtim në botimin e parë, në këtë botim janë vënë më të plota, sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë. Disa materiale të botimit të parë nuk përfshihen në këtë vëllim.

Të gjitha dokumentat e reja në treguesin e lëndës janë shënuar me një yll para numrit rendor.

INSTITUTI I STUDIMEVE MARKSISTE-LENINISTE PRANË KQ TË PPSH

VENDIM

I KOMITETIT QENDROR TË PPSH «MBI SISTEMIN E RI TË GRUMBULLIMIT DHE TË FURNIZIMIT»

5 janar 1949

Komiteti Qendror i PPSH në vijim të vendimeve të Kongresit I të Partisë, për të goditur veprimtarinë trockiste të ushtruar në vendin tonë nga grupi nacionalist trockist i Titos dhe nga bashkëpunëtorët e tij Koçi Xoxe e Pandi Kristo, në lidhje me sistemin e gabuar të grumbullimit dhe të furnizimit që ka vështirësuar grumbullimin dhe furnizimin, ka favorizuar pasanikët në fshat dhe ka penguar zhvillimin e marrëdhënjeve të drejta ndërmjet fshatit dhe qytetit, dhe me qëllim që të sigurohet furnizimi i rregullt për masat punonjëse të qytetit dhe të fshatit dhe të goditet spekulli, tregu i zi, çrregullimet dhe anarkia,

Vendosi:

1. — Të anulohet ajo pjesë e sistemit të sotëm të grumbullimit të prodhimeve bujqësore e blegtorale, e cila pengon zhvillimin e drejtë të bujqësisë dhe të blegtorisë sonë, favorizon kapitalistët dhe spekulatorët në fshat dhe errëson perspektivën e masave punonjëse të fshatit për shtimin e prodhimit dhe për modernizimin e bujqësisë.

Të vendoset një sistem i drejtë grumbullimi që të ketë për qëllim të sigurojë fondin shtetëror të grumbullimit për furnizimin e masave punonjëse të qytetit dhe njëkohësisht të ndihmojë dhe të nxitë fshatarin e varfër dhe të mesëm që të shtojë, të përmirësojë prodhimin dhe të sigurojë burime të tjera prodhimi. Nga ana tjetër ky sistem i drejtë grumbullimi të krijojë kondita të favorshme për fshatarësinë që të disponojë lirisht tepricat.

2. — Të anulohet sistemi i sotëm i furnizimit që furnizon pa bërë dallim ndërmjet atyre që punojnë dhe prodhojnë për të mirën e përgjithshme dhe atyre që nuk prodhojnë, po rrojnë duke

spekuluar dhe duke ushtruar tregun e zi, në dëm të masave të gjera punonjëse, në kundërshtim me rregullat dhe dispozitat ekonomike të Republikës.

Të vendoset një sistem i drejtë furnizimi, i cili t'u sigurojë klasës punëtore edhe masave të tjera punonjëse, që nuk shfrytëzojnë krahët e tjetrit, kondita më të mira jetese. Nga ana tjetër, të forcojë aleancën e klasës punëtore me masat punonjëse të fshatit në mënyrë që shkëmbimet ndërmjet fshatit dhe qytetit të shtohen dhe të përmirësohen, të nxitet shfrytëzimi sa më i madh i të gjitha burimeve të prodhimit, të sigurohet fuqia punëtore e nevojshme për realizimin e planit të shtetit dhe të zhvillohet një luftë e ashpër kundër kulakut dhe spekulatorëve të ndryshëm.

3. — Për realizimin e sistemit të grumbullimit dhe të furnizimit është e domosdoshme të merren të gjitha masat për organizimin e shëndoshë të kooperativave të shitblerjes, të cilat të bëhen organizata masash në fshat për të organizuar tregëtinë kolektive dhe për të luftuar me sukses kapitalistët dhe spekulatorët e fshatit dhe të qytetit.

4. — Në bazë të këtyre drejtimeve mbi grumbullimin dhe furnizimin t'i propozohet Qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë që të merren masat e nevojshme.

KOMITETI QENDROR I PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË

Botohet sipas gazetës

«Zëri i Popullit», Nr. 10 (83),

12 janar 1949

INSTRUKSION I KQ TË PPSH MBI DETYRAT E ORGANIZATAVE TË PARTISË PËR SISTEMIN E RI TË GRUMBULLIMIT DHE TË FURNIZIMIT TË POPULLSISË

18 janar 1949

GJITHË KOMITETEVE TË PARTISË TË RRETHEVE E TË QYTETEVE

I

SISTEMI I RI I GRUMBULLIMIT DHE I FURNIZIMIT TË POPULLSISË

Qeveria e RPSH me propozimin e KQ të PPSH vendosi ndërrimin e sistemit të grumbullimit dhe të furnizimit të popullsisë duke caktuar një sistem të ri mbi baza më të drejta.

Sistemi i furnizimit dhe sistemet e grumbullimit nuk kanë qenë të drejta dhe kanë dëmtuar ekonominë e vendit tonë, kanë vështirësuar shumë jetën e masave punonjëse.

Sistemi i ri i grumbullimit dhe i furnizimit është i drejtë sepse ai mbështetet në mësimet e Leninit e të Stalinit dhe në eksperiencën e ndërtimit të socializmit në BS. Sistemi i ri i grumbullimit dhe i furnizimit do të ndihmojë ndërtimin e socializmit në vendin tonë, do të forcojë ekonominë e vendit tonë dhe do të përmirësojë jetën e masave punonjëse, do të jetë një mjet i rëndësishëm për shtimin e prodhimit e sigurimin e fuqisë punëtore, do të vërë në rrugë të drejtë e do të forcojë marrëdhënjet fshat-qytet, do të luftojë spekulimin e matrapazllëkun.

Sistemi i furnizimit të popullsisë

Sistemi i deritanishëm i furnizimit të popullsisë nuk ka qenë i drejtë. Politika armiqësore e klikës së Titos dhe e agjentëve të saj Koçi Xoxe etj. (mossjellja e mallrave etj.), si edhe ky sistem

i padrejtë furnizimi që na kanë huajtur, kanë shkaktuar mosfurnizimin në rregull të masave punonjëse, sidomos të qytetit.

Angazhimi që merrte shteti, në bazë të sistemit të furnizimit që kemi pasur deri sot, për të furnizuar me sendet e racionuara pa përjashtim të gjithë banorët, pa marrë parasysh shërbimin që i sillnin këta shoqërisë, ishte jo i drejtë dhe i dëmshëm:

a) Në këtë mënyrë kanë përfituar parazitët dhe matrapazët e qytetit, kanë përfituar kulakët dhe të pasurit e fshatit, të cilët, duke pasur të siguruar nga shteti me çmime të lira sendet e nevojës së parë, kanë nxjerrë në treg me çmime shumë të larta prodhimet e tyre bujqësore dhe blegtorale, kanë rjepur punonjësit e qyteteve dhe kanë grumbulluar sasi të mëdha të hollash, të cilat i mbajnë të vdekura duke dëmtuar kështu rëndë financat e shtetit.

b) Ky sistem furnizimi nuk ka favorizuar, por përkundrazi ka penguar aktivizimin në punë të të gjithë shtetasve, i ka dhënë shkas dembellëkut dhe ka vështirësuar sidomos sigurimin e fuqisë punëtore aq të domosdoshme për punët e mëdha që ka ndër marrë shteti.

c) Gjithashtu ka kufizuar inisiativën e fshatarëve dhe preokupacionin e tyre për të shfrytëzuar të gjitha burimet që mund të jepnin prodhime në treg.

ç) Në këto rrethana i është lënë vend zhvillimit të tendencave kapitaliste në radhët e fshatarësisë dhe për konsekuencë është krijuar një mendim i shtrembër ndër punonjësit e qytetit duke e parë fshatarin si spekulator dhe gjakpirës. Kjo ka penguar krijimin e lidhjeve të shëndosha ndërmjet fshatit dhe qytetit dhe ka dëmtuar aleancën luftarake të klasës punëtore me fshatarësinë punonjëse.

d) Ky sistem gjithashtu u ka humbur kuptimin kooperativave të shitblerjes në fshatra dhe i ka lënë ato krejt formale pse fshatari, duke qenë se i gjente në treg, të siguruara, me çmime fare të lira sendet e nevojës së parë, s'e ndjente nevojën të shiste në kooperativat e shitblerjes mallrat e tija kur ato mund t'i shiste në tregun e lirë dy ose tri herë më shtrenjtë. Ai s'kishte asnjë përfitim të shiste e të blente në kooperativat e shitblerjes, sepse kooperativat i merrnin prodhimet e tij shumë lirë dhe shpeshherë nuk furnizoheshin në rregull, kështu që fshatari nuk kishte mundësi të merrte as racionin që i takonte.

Sistemi i ri i furnizimit do të zhdukë pikërisht këto gabime dhe shtrembërime dhe do të krijojë mundësitë për zbatimin e parimit socialist «kush punon ha». Në praktikë ky sistem do të zërthehet në dy mënyra:

1. — Për furnizimin e qytetit: Në qytet shteti merr angazhim

të furnizojë rregullisht me artikuj të racionuar të gjithë punëtorët, nëpunësit dhe të gjithë ata punonjës të tjerë që me punën e tyre i shërbejnë shoqërisë, si zanatçinjtë që nuk shfrytëzojnë të tjerët (qofshin në kooperativa ose jo), punëtorët e shërbimeve të ndryshme (si berberë, hamej, kamerierë, elektrikistë, shërbyes, karrocierë, druvarë etj.). Gjithashtu e përfitojnë triskën dhe familjet e dëshmorëve e të invalidëve, familjet e ushtarëve, që nuk janë vetëm gra (kur këto familje nuk hyjnë në kategorinë e atyre, që, siç shpjegohet më poshtë, s'duhet të marrin triskën) etj.

Të tjerët që s'i japin asgjë shoqërisë, por përkundrazi e dëmtojnë dhe kërkojnë të pasurohen mbi kurrizin e masave punonjëse të qyteteve me anë të spekulimit dhe tregut të zi, si tregëtarët e mesëm e të vegjël, matrapazët, pronarët e restoranteve, mobiljeshitësit, pronarët që rrojnë me të ardhurat nga pronat e tyre, ata që rrojnë me flori si dhe ata që për asnjë arsye nuk punojnë, nuk përfitojnë triskën. Këta mund të furnizohen në tregun e lirë me çmime të larta.

2. — Për furnizimin e fshatarësisë: Pa përjashtim të gjithë fshatarëve u hiqet triska. Për fshatarësinë sistemi i ri i furnizimit mbështetet mbi sistemin e shkëmbimit reciprok, d.m.th. për të tërhequr artikuj industrialë dhe përgjithësisht mallra të racionuara, fshatari duhet të dorëzojë prodhime bujqësore ose blegtorale (drith, mish, vezë, bulmetra etj.). Shteti do të caktojë proporcionin e shkëmbimit të mallrave. Është e kuptueshme se dorëzimi i detyrimeve që fshatarët kanë ndaj shtetit si drithi, ulliri etj. nuk vlen për shkëmbim pse është si një taksë që i jep fshatari shtetit përkundrejt pagesës. Pra fshatari për të tërhequr mallrat e racionuara duhet të dorëzojë tepëricat (pasi të ketë kryer detyrimet ndaj shtetit) si edhe çdo prodhim tjetër që nuk e kap grumbullimi i detyruar si veza, qumshti, mjalti etj. Shteti sot për sot brenda mundësive që ka, do t'i furnizojë fshatarët e varfër (joprodhues) me një minimum sendesh të nevojës së parë. Por parimi është e mbetet ai që thamë më lart: shkëmbimi reciprok. Prandaj këta fshatarë duhet të përpiqen në fshat për të siguruar prodhime të ndryshme (lëkura gjahu, valanidh, lëndë druri etj.) dhe në pamundësi të këtyre të shkojnë punëtorë në fabrikat ku ata do të marrin triskën dhe familjet e tyre në fshat do të mund të furnizohen me bono. Ata duhet ta kenë të qartë se ky furnizim s'është i garantuar dhe shteti do të manevrojë sipas disponibilitetit të mallrave dhe sipas nevojës së fuqisë punëtore. Perspektiva është që në të ardhshmen ky furnizim edhe mund të pritët pse s'është e drejtë që këta fshatarë të rrojnë, si me thënë, gjysmë-parazitë e me lëmshën e shtetit.

Sistemi i ri i furnizimit i sjell përfitime të mëdha ekonomisë sonë dhe masave punonjëse:

a) Sistemi i ri i furnizimit, që mbështetet në shkëmbimin reciprok, siguron lidhje të shëndosha ndërmjet fshatit dhe qytetit duke forcuar kështu aleancën midis klasës punëtore dhe fshatarësisë punonjëse nën udhëheqjen e klasës punëtore.

Fshatari duhet ta ketë të qartë se, po nuk i dha punëtorit prodhimet e tij bujqësore e blegtorale, nuk mund të marrë prej tij prodhimet industriale (kripën, bezen, vajgurin etj.). Po kështu punëtori duhet të shtojë në maksimum prodhimet industriale pse vetëm kështu (me anën e shkëmbimit) fshatari do t'i japë prodhime bujqësore e blegtorale. Nuk mund të rrojë fshatari pa prodhimet e punëtorit ashtu dhe punëtori nuk mund të rrojë pa prodhimet e fshatarit dhe të dy së bashku nuk mund të rrojnë pa pushtetin e tyre popullor.

b) Ky sistem furnizimi u jep kooperativave të shitblerjes karakterin e tyre të vërtetë.

Për zbatimin e këtij sistemi kooperativat e shitblerjes do të luajnë një rol shumë të madh, mund të themi vendimtar. Ato duhet të jenë në gjendje që të përballojnë punën e madhe për të grumbulluar nga fshatarët tepricat dhe gjithë prodhimet e tjera dhe si shkëmbim t'u japin atyre mallra industriale për të cilat kanë nevojë.

c) Sistemi i ri i furnizimit do t'i japë hov shtimit të prodhimit, do të nxitë pjesëmarrjen e njerëzve në punë dhe do të bëjë që çdo njeri të mundohet t'i shërbejë sa më shumë shoqërisë.

Për të përfituar sa më shumë nga furnizimi i shtetit, fshatarët duhet të shtojnë prodhimet e tyre dhe të mundohen të shfrytëzojnë të gjitha burimet e mundshme që do t'u jepnin prodhime për treg, nga ana tjetër punëtorët duhet të prodhojnë sa më shumë që të mund të sigurojnë shkëmbimin e mallrave me fshatarët.

c) Ky sistem do të shërbejë për sigurimin e fuqisë punëtore.

Duke mos u dhënë triska të gjithë njerëzve në qytete që rri në punë ose merren me punë joprodhuese si dhe duke mos marrë angazhim për të furnizuar fshatarët joprodhues, është e natyrshme se shumica e tyre do të detyrohen të kërkojnë punë. Në këtë mënyrë gjen rrugën e drejtë të zgjidhjes një problem i madh që na ka preokupuar vazhdimisht dhe që në të ardhshmen (me zhvillimin e industrisë, të minierave etj.), do të bëhet akoma më i rëndësishëm.

d) Sistemi i ri i furnizimit do të shërbejë për të kufizuar elementin kapitalist në ekonomi dhe për të goditur e frenuar në maksimum spekulimin, shfrytëzimin dhe tregun e zi.

Vetë heqja e triskave për njerëzit e këtyre kategorive është

një masë kufizimi dhe goditjeje. Nga ana tjetër sistemi i furnizimit për fshatarësinë krijon nevojën e shkëmbimit reciprok midis saj dhe shtetit nëpërmjet kooperativave të shitblerjes. Kjo e kufizon kështu matrapazllëkun dhe për më tepër bën që shteti dhe kooperativat, duke siguruar edhe shumicën e prodhimeve bujqësore e blegtorale, të jenë në gjendje të konkurojnë ofertën e këtyre spekulatorëve me çmime të larta. Theksojmë se shteti me sistemin e ri të grumbullimit favorizon shumë kooperativat bujqësore, gjithashtu shteti do të caktojë masat (si për grumbullimin, për furnizimin etj.) për kufizimin e kulakëve. Për këtë do t'u dërgohen më vonë udhëzime të veçanta.

Anomalitë ose pakënaqësitë e para që mund të lindin, nga moskuptimi i mirë i këtij sistemi nuk duhet të na bëjnë dritë-shkurtër. Partia duhet ta ketë të qartë dhe t'ja bëjë të qartë edhe popullit perspektivën që ka ky sistem. Duke e parë kështu problemin duhen mobilizuar të gjitha forcat për vënjen me drejtësi dhe plotësisht në jetë të këtij sistemi.

Sistemi i grumbullimit

Sistemet e deritanishme të grumbullimit kanë pasur mjaft gabime dhe janë aplikuar me shumë gabime, prandaj s'janë grumbulluar kurrë sasitë e duhura. Ato kanë thyer vullnetin e fshatarit për të prodhuar sa më shumë dhe na kanë armiqësuar me të.

Sistemi i ri i grumbullimit ka për qëllim të ndreqë këto të meta:

a) Sistemi i ri ka si bazë stimulacionin për shtimin dhe përmirësimin e prodhimeve bujqësore e blegtorale, pse, për të plotësuar sasinë e detyrimeve ndaj shtetit, për të siguruar prodhime të bollshme për vete dhe për të nxjerrë sa më shumë teprica në treg, çdo fshatar do të përpiqet për ta shtuar e përmirësuar sa më shumë prodhimin e tij. Kjo do t'i japë shkas zhvillimit të përgjithshëm dhe përparimit të bujqësisë sonë të prapambetur e primitive.

b) Me sistemin e grumbullimit shteti siguron fondin shtetëror të drithërave e të prodhimeve të tjera bujqësore e blegtorale që është baza kryesore për furnizimin e masave punonjëse të qytetit, për furnizimin e industrisë sonë me lëndë të parë dhe për shtimin e eksportimeve.

1. — *Sistemi i grumbullimit të drithërave* (këtu hyjnë gruri, misri dhe thekra). Grumbullimi i drithërave ka qenë dhe ka për të qenë vazhdimisht një nga problemet më të rëndësishme të pushtetit tonë pse është i lidhur me sigurimin e bukës për punëtorët, nëpunësit dhe për Ushtrinë Kombëtare. Ky problem do të

bëhet gjithnjë e më i rëndësishëm për shkak të rritjes së fuqisë punëtore me zhvillimin e industrisë e të minierave në vendin tonë.

Deri sot nuk kemi pasur rezultate të kënaqshme në lidhje me grumbullimin e drithit:

a) Sistemi që u përdor pas çlirimit të Shqipërisë, ja merrte fshatarit të gjithë drithin, duke i lënë vetëm racionin e bukës, gjë që ishte jo e drejtë. Duke kërkuar të grumbullonim gjithshka që i tepronte fshatarit kemi rënë në konflikt me të, kemi rënë në burokratizëm, u kemi lënë vend hatëreve dhe akraballëqeve dhe së fundi nuk ka qenë kurrë e mundur të sigurohet fondi i grumbullimeve të shtetit. Por mbi të gjitha ky sistem grumbullimi ka thyer vullnetin e fshatarit për të prodhuar sa më shumë drithëra. Por me gjithë këto gabime, kjo urdhëresë në atë kohë ishte e nevojshme dhe solli shërbime.

b) Urdhëresa që nxori qeveria më 1948 përcaktonte drejt sistemin e grumbullimit të drithit në bazë të hektarëve. Por lëshimi në nenin 17 që i linte shteg shkeljes së kësaj urdhërese (siç ngjau në të vërtetë) duke u futur në llogari me fshatarët etj., bëri që kjo urdhëresë të mos shërbente siç duhej për realizimin e fondit të drithit të shtetit.

Korrigjimi i urdhëresës në bazë të principeve të drejta:

a) Do të sigurojë fondin shtetëror të drithit.

b) Do të shërbejë për shtimin e prodhimit.

Sistemi i grumbullimit të drithit nxit shtimin e prodhimit të tij. Në bazë të këtij sistemi shteti kërkon nga fshatarët sasinë që i takon sipas rregullit për sa hektar tokë ka dhe e lë të lirë fshatarin të shesë lirisht tepricat. Kështu nga një anë puna thjeshtohet, nuk hyhet në llogari, në ulje e në ngritje planesh që vënë gjithnjë në pikëpyetje realizimin e fondit të shtetit; nga ana tjetër fshatari e ka të qartë që përpara se sa kërkohet prej tij. Prandaj ai do të bëjë të gjitha përpjekjet që të shtojë prodhimin për të larë detyrimin dhe për të pasur sa më shumë të ardhura.

Ky sistem jo vetëm që nxit, por i deyron fshatarët për të shtuar sipërfaqet e mbjella, për të punuar sa më mirë, për të prodhuar sa më shumë, pse në bazë të këtij sistemi fshatari detyrohet t'i shesë shtetit drithin në bazë të hektarëve që ka, pa marrë parasysh nëse i punon ose jo të gjitha tokat, nëse i punon mirë apo keq etj. Është e ditur se fshatarët që nuk do të punojnë mirë tokën nuk do të kenë mundësi as t'i dorëzojnë shtetit detyrimet, as të sigurojnë bukën e tyre. Por shteti nuk do të hyjë në këto llogaritje. Shteti kërkon që të gjitha ekonomitë fshatare, pa përjashtim, t'i dorëzojnë sasinë e caktuar sipas hektarëve që disponojnë, cilësisë së tokës dhe koeficientit të caktuar.

Shteti përjashton nga grumbullimi i detyruar vetëm ekonomitë fshatare që kanë më pak se 0.8 hektar tokë. Gjithashtu shteti

zbret sasinë e detyrimeve kur prodhimi dëmtohet, jo nga pakujdesia ose puna e dobët e fshatarit, por nga shkaqe të jashtme si thatësira, krimbi, flama etj. Në këto raste do të merren masa nga organet kompetente për t'i vërtetuar në vend. Po dhe këtu nuk do të hyhet në kontrollin arë më arë pse kështu prapë do të dilnim nga karakteri i sistemit, por do të konstatohet si zonë, në ç'përqindje është dëmtuar prodhimi dhe si rrjedhim edhe detyrimi ndaj shtetit do të ulet në këto zona në aq përqind. Fakti që kontrolli i vërtetimit të dëmeve të shkaktuara do të bëhet menjëherë, ka për të qenë sigurisht nxitje për të shtuar dhe mbajtur gjithnjë ngritur kujdesin e vetë fshatarëve dhe të organeve kompetente të pushtetit për gjendjen e prodhimit, që të mund të merren kështu me kohë masat e nevojshme për të mos lejuar ose për të pakësuar dëmet.

Rruga që cakton sistemi i ri i grumbullimit për grumbullimin e drithërave është rruga më e drejtë dhe rruga që ka për të na çuar patjetër me sukses në realizimin e planeve.

2. — *Sistemi i grumbullimit të bimëve industriale* (këtu hyn dhe ulliri). Shteti do të grumbullojë bimët industriale me anë të sistemit të kontraktimeve. Korrigjimi i urdhëresës, që ka qenë deri sot në bazë të principeve të drejta, do të eliminojë të metat e konstatuara.

Ky sistem ka për qëllim që të nxitë fshatarin për të mbjellë sa më shumë bimë industriale, të cilat janë shumë të nevojshme si për furnizimin e industrisë sonë të lehtë e sidomos për zhvillimin e saj në të ardhshmen ashtu edhe për eksportimet. Për nxitjen e fshatarëve në këtë drejtim shërbejnë dhënja e mallrave industriale si stimulacion si edhe tatimi më i paktë për këto lloje bimësh sipas ligjit të tatimeve mbi të ardhurat bujqësore.

Gjithashtu ky sistem kërkon që fshatari të realizojë plotësisht angazhimet që merr në kontratë. Prandaj e shtyn atë bile e detyron, që t'u bëjë bimëve industriale një shërbim sa më të mirë në bazë të udhëzimeve të teknikëve.

Një e metë e rëndësishme në punën e deritanishme është mosrespektimi i kontratave nga të dy palët si nga fshatarët ashtu edhe nga shteti. Kjo nuk duhet të ngjasë më. Angazhimet me anën e kontratës marrin formën e detyrimeve për të dy palët, të cilat janë të detyruara t'i plotësojnë. Ndryshe ky sistem s'mund të japë rezultat.

3. — *Sistemi i grumbullimit të mishit*. Grumbullimi i mishit ka një rëndësi të madhe pse është ushqim i dorës së parë për masat punonjëse të qytetit. Sistemi i deritanishëm i grumbullimit të mishit në bazë të kokëve të bagëtisë jo vetëm që nuk ka mundur

të sigurojë grumbullimin e sasive të duhura për plotësimin e nevojave të popullit tonë, por, ç'është më keq, ka goditur zhvillimin e blegtorisë dhe e çonte atë drejt shkatërrimit të saj.

Sistemi i ri i grumbullimit të mishit për hektar dhe për kokë do të sigurojë grumbullimin e sasisë së nevojshme të mishit për plotësimin e nevojave të masave punonjëse të qytetit.

Sistemi i ri nxit fshatarët për shtimin e përmirësimit të blegtorisë dhe përmirësimit të racës:

a) Gjithë bujqit janë të detyruar të mbajnë bagëti pse sipas urdhërësës duhet t'i dorëzojnë shtetit 30 kg. mish të gjallë për çdo hektar tokë që disponojnë. Kur sasia e bagëtive kalon mesataren e caktuar nga shteti (40 kokë), atëhere veç detyrimit për hektar bujku detyrohet të dorëzojë edhe për kokë, me një përqindje progresive e cila rritet gjithnjë krahas rritjes së numrit të bagëtive. Blegtorët i dorëzojnë detyrimet në bazë të një përqindjeje të caktuar për kokë e cila është më e vogël nga ajo që dorëzojnë bujqit që kanë mbi 40 kokë.

b) Nga ana tjetër pranimi i çdo lloji mishi të ngrënshëm (si shpendë, derra etj) për shlyerjen e detyrimeve si edhe favorizimet për mishrat e majmura janë një nxitje e madhe për zhvillimin e rritjes së derrave, shpendëve, lepujve etj., si edhe për rritjen e mirë të gjësë së gjallë.

Është e nevojshme që organizatat e Partisë t'u shpjegojnë fshatarëve që s'kanë bagëti se shteti po i favorizon duke u lënë afat që detyrimet e sivjetme t'i dorëzojnë në tremujorin e katërt. Ndërsa ata që tani duhet të bëjnë të gjitha përpjekjet për të siguruar bagëtitë, derrat, shpendët etj.

Problemi i tepricave

Pasi fshatarët prodhues të kenë kryer plotësisht dhe brenda kohës së caktuar detyrimet ndaj shtetit, do të lihen të lirë t'i shesin ku të duan tepricat e prodhimeve të tyre (drith, mish apo çfarëdo qofshin ato). Kjo do të jetë një nxitje tjetër për fshatarët për të shtuar e përmirësuar prodhimet e tyre.

Detyra e Partisë është të bindë fshatarët që tepricat e të gjitha prodhimeve të tyre t'ja shesin shtetit dhe jo në tregun e lirë. Kjo nga një anë do të godasë matrapazllëkun dhe spekulimin që zhvillohet në tregun e lirë privat, dhe nga ana tjetër do të shërbejë për të bërë një ndarje racionale edhe të këtyre tepricave. Veç kësaj, detyra e Partisë është që të sigurojë grumbullimin e sa më shumë prodhimeve që s'i kap grumbullimi i detyruar.

II

DETYRAT E ORGANIZATAVE TË PARTISË PËR SISTEMIN E RI TË GRUMBULLIMIT DHE TË FURNIZIMIT TË POPULLSISË

Detyra e organizatave të Partisë është të mobilizohen dhe të marrin të gjitha masat që sistemi i ri i grumbullimit dhe i furnizimit të popullsisë të vihet plotësisht në jetë.

Për zbatimin me sukses të këtij sistemi organizatat e Partisë duhet të bëjnë një punë të madhe politike për sqarimin e masave të fshatit e të qytetit. Eksperienca e derisotme tregon se një nga të metat kryesore në punën e organizatave të Partisë sonë është mungesa e lidhjes së punës politike me detyrat ekonomike. P.sh. vitet e kaluara për problemin e grumbullimeve është mobilizuar pa përjashtim gjithë Partia, bile aq sa ka lënë pasdore gati të gjitha problemet e tjera, por megjithatë nuk janë arritur rezultatet e duhura sepse në sistemin e punës ka pasur të meta. Organizatat e Partisë në vend të punës politike për t'i sqaruar dhe për t'i bindur fshatarët kanë përdorur edhe arbitrarizmin..., i cili jo vetëm nuk mund të jepte rezultat, por përkundrazi, ka dëmtuar rëndë lidhjet e Partisë me masat. Organizatat e Partisë janë marrë më shumë me punë teknike, me kalkulime, me mbajtjen e statistikave etj., të cilat s'e kanë lejuar Partinë që të bëjë punë sqaruese politike dhe kanë shkaktuar që organizatat e Partisë të marrin përsipër punët që u ngarkohen organeve të pushtetit.

Prandaj organizatat e Partisë duhet të eliminojnë të gjitha të metat e konstatuara deri sot në punën politike. Ato duhet ta kuptojnë mirë rëndësinë e sqarimit politik të masave, sidomos të fshatarëve, pse pas leximit të urdhërësave, pas zhvillimit të konferencave etj., në kokën e fshatarit do të dalin me qindra pyetje, me qindra çështje të paqarta dhe Partia nuk duhet të lejojë që kulaku e tregëtari t'ja shpjegojnë atij sipas qejfit të tyre. Organizatat e Partisë, anëtarët, kandidatët, të rinjtë komunistë, agjitorët duhet vazhdimisht të jenë në kontakt me masat dhe me fjalë të thjeshta, me shembuj konkretë t'i sqarojnë për të gjitha çështjet e sistemit të ri të grumbullimit e të furnizimit duke u mbështetur në pjesën e parë të këtij instruksioni ku janë prekur problemet më kryesore. Që të mobilizohen masat me të gjitha forcat për zbatimin e këtij sistemi, organizatat e Partisë duhet t'u shpjegojnë atyre (sidomos fshatarëve) se ç'fitojnë ata nga ky sistem, d.m.th. t'i bindin se ky sistem do ta forcojë ekonominë e kështu do të përmirësohet jeta e mbarë popullit, do t'i shpëtojë nga spekulimi i matrapazëve e i tregëtarëve etj. Organizatat e Partisë duhet t'i matin sukseset e punës

politike me rezultatet ekonomike, d.m.th. jo vetëm t'i shpien këto udhëzime në popull, por t'i bindin masat, veçanërisht fshatarët që të kryejnë detyrimet ndaj shtetit.

Në pjesën e parë të këtij instruksioni, ku është shpjeguar sistemi i ri i grumbullimit dhe i furnizimit, kanë dalë përgjithësisht edhe detyrat e organizatave të Partisë. Tani shkurt po përmbledhim problemet kryesore për të cilat duhet të mobilizohen organizatat e Partisë:

1. — *Të sigurojnë realizimin e planit të grumbullimeve të shtetit e për t'ja arritur kësaj të punojnë për zbatimin e ligjit të shtetit dhe fshatarët të shtojnë sa më shumë prodhimet që përmbledh plani i grumbullimit të detyruar.*

a) Organizatat e Partisë duhet të luftojnë tendencën e gabuar që grumbullimet e detyrueshme të kuptohen si dhënje ndihme apo lëmoshe. Është e domosdoshme që fshatari ta ketë të qartë se dorëzimi i grumbullimit të detyruar është detyrë ndaj shtetit që përcaktohet me ligj dhe, kundër atyre që e shkelin këtë ligj duke mos i plotësuar detyrimet në sasinë dhe në kohën e caktuar, është e natyrshme që do të merren masa dhe sanksione që cakton ligji. Organizatat e Partisë duhet të luftojnë mendimin e gabuar të atyre fshatarëve që pretendojnë se nuk i kanë prodhimet e mira e si rrjedhim nuk mund të plotësojnë detyrimin që kanë ndaj shtetit dhe të mos bien në pozitat e tyre. Partia ka dënuar me rreptësinë më të madhe rastet kur në vitet e kaluara janë përdorur metoda policore dhe arbitrare. Por tani duhen luftuar po me atë forcë edhe sentimentalizmi e lëshimet në lidhje me plotësimin e detyrimeve nga ana e fshatarësisë. Detyra e organizatave të Partisë nuk është të humbasin kohën me lëshime e me keqardhje, por të mobilizohen që ky sistem i drejtë të zbatohet në jetë. Organizatat e Partisë e kanë detyrë të luftojnë që fshatari të kuptojë mirë detyrimin që ka ndaj shtetit duke i shpjeguar atij se pushteti popullor i ka dhënë fshatarit tokën e kreditin agrar, i garanton lirinë e pavarësinë, i siguron arësimin e shërbimin shëndetësor etj. Prandaj edhe fshatari duhet t'i japë pushtetit të tij, ta forcojë atë, pse sa më i fortë të jetë pushteti, aq më shumë të mira do të ketë fshatari: mallra industriale, shkolla, spitale etj.

b) Nga ana tjetër detyra e organizatave të Partisë është të nxitin fshatarët të prodhojnë sa më shumë. Organizatat e Partisë duhet t'i mësojnë fshatarët të punojnë të gjithë tokën që kanë dhe ta punojnë sipas udhëzimeve të teknikëve, ta plehërojnë atë, t'i mësojnë që të mbjellin sa më shumë bimë industriale e t'u bëjnë shërbimet, t'i këshillojnë që të mbajnë sa më shumë bagëti, derra, shpendë etj. Organizatat e Partisë duhet t'u shpjegojnë fshata-

rëve se, po s'punuan në këtë mënyrë, do të kenë pak prodhime, dhe kjo s'mund të jetë një justifikim për të mos i dorëzuar shtetit detyrimet. Shteti do t'i kërkojë detyrimet pa marrë parasysh nëse ata punojnë keq e s'prodhojnë as për vete. Si rrjedhim fshatarët duhet të kuptojnë se prodhimi i paktë do të shkaktojë që ata të mos jenë korrekt me shtetin dhe të mbeten vetë në gjendje të vështirë. Kështu Partia duhet ta shfrytëzojë sistemin e grumbullimit si një mjet të fuqishëm për të nxitur fshatarët që të shtojnë prodhimin dhe të luftojnë dembellëkun, parazitizmin e metodat primitive të punës etj.

Organizatat e Partisë duhet ta kenë parasysh problemin e grumbullimit që në kohën e mbjelljeve, ta ndjekin vazhdimisht me interesimin më të madh gjatë punës që bën fshatari për të plotësuar detyrat ndaj shtetit dhe të mos kujtohen vetëm në kohën e grumbullimeve.

2. — *Grumbullimi i sa më shumë tepricave dhe prodhimeve të tjera që s'i kap grumbullimi i detyruar është për organizatat e Partisë një detyrë shumë e rëndësishme, mund të themi sa ajo e grumbullimit të detyruar.*

Vetë sistemi i furnizimit reciprok kërkon nga fshatarët që të shtojnë prodhimin dhe i detyron ata që tepricat t'i shesin në kooperativat e shitblerjes ose në ndërmarrjet shtetërore, pse ndryshe nuk kanë si t'i sigurojnë mallrat industriale.

a) Organizatat e Partisë duhet t'u mësojnë fshatarëve, sidomos fshatarëve joprodhues, se si mund të sigurojnë sa më shumë prodhime, të grumbullojnë lende, valanidh, bimë medicinale, të zhvillojnë gjahun për mishin e lëkurat, të mbajnë bletë, shpendë, të zhvillojnë artizanatin e fshatit për të prodhuar: thika, lugë, avlëmende etj. Ato duhet gjithashtu të nxitin zhvillimin e artizanatit në qytet dhe t'u shpjegojnë zanatçinjtë se shteti i ka favorizuar duke u siguruar furnizimin me triskë prandaj edhe ata duhet të prodhojnë sa më shumë e të mos spekulojnë, pse ndryshe shteti do të detyrohet të marrë masa të tjera. Lidhur me këtë duhet punuar për grumbullimin e zanatçinjtë në kooperativat e artizanatit.

b) Organizatat e Partisë duhet të kenë parasysh se fshatari, për natyrën e tij, do të kërkojë rrugën që i jep fitime më të mëdha e të çastit, pa parë perspektivën dhe interesin e përgjithshëm. Në këtë rrugë do të na pengojnë dhe kulakët, të cilët, në bashkëpunim me tregëtarët ose matrapazët e qyteteve, do të kërkojnë të sabotojnë grumbullimet e shtetit për t'i lënë vend të lirë tregut të zi e spekulimit. Prandaj organizatat e Partisë duhet të sqarojnë e të bindin fshatarët që t'i shesin tepricat e tyre në kooperativat e shitblerjes ose në ndërmarrjet shtetërore, pse kështu do të mund të marrin mallra industriale me çmime të

lira dhe shteti do të mund të bëjë një ndarje racionale të tyre, gjë që do të shërbejë për luftimin e spekulimit, për normalizimin e tregut, për uljen e çmimeve, për ngritjen e fuqisë blerëse të punonjësve etj.

3. — *Duhet të sigurojmë fuqinë punëtore për industrinë, për minierat dhe përgjithësisht për realizimin e planit të shtetit.*

Vetë sistemi i ri i furnizimit do të japë shkas që mjaft njerëz të kërkojnë punë, por do pasur parasysh se edhe këtu do të ketë vështirësi, sepse fshatari ynë e ka shumë të zorshme të ndahet nga toka e tij në të cilën kanë rrojtur dhe gjyshërit e stërgjyshërit e tij. Prandaj t'u shpjegojmë fshatarëve, sidomos fshatarëve joprodhues të zonave joprodhuese, se si është jeta e punëtorëve të qytetit, ç'favore kanë ata nga Kodi i punës, nga sigurimet shoqërore, nga sistemi i ri i furnizimit etj. T'u shpjegohet fshatarëve rëndësia e madhe e ngritjes së industrisë: si kombinatat e sheqerit e të pëlhurës, zhvillimi i minierave e i naf-tës, ndërtimi i hekurudhave etj., të cilat do të përmirësojnë shumë jetën e punëtorit dhe të fshatarit. Me pak fjalë sistemi i ri ndihmon shumë për nxjerrjen e fuqisë punëtore, por organizatat e Partisë për të siguruar suksesin, duhet ta shoqërojnë këtë me një punë të madhe politike.

4. — *Duhet të forcojmë kooperativat e shitblerjes si organe kryesore që do të zhvillojnë shkëmbimin reciprok të mallrave dhe si forma më të ulëta dhe të domosdoshme për kolektivizimin e bujqësisë.*

Kooperativat e shitblerjes sot janë shumë të dobëta kështu që nuk mund t'u bëjnë ballë gjithë detyrave të rëndësishme që u ngarkohen. Prandaj në qoftë se organizatat e Partisë s'do të marrin masa të menjëhershme për forcimin e tyre, ato do të jenë pengesë në zbatimin e sistemit të ri të grumbullimit e të furnizimit.

Organizatat e Partisë duhet të punojnë që fshatarët të mos i quajnë kooperativat si organe tregëtare të huaja, por si organizata të tyre, prandaj duhet të mblidhen rregullisht këshillat administrative e asamblëtë dhe fshatarët të interesohen e të punojnë për mbarëvajtjen e tyre si p.sh. për transportimin e mallrave me kafshët e tyre etj. Organizatat e Partisë duhet të marrin masa për të vënë në krye të kooperativave shokë të zot e të mirë pse kuadrot e sotëm të kooperativave janë shumë të ulët. Ato duhet të agjitojnë në fshatarët edhe për ngritjen e kooperativave të reja, pse rrjeti i tanishëm është shumë i kufizuar.

5. — *Sistemi i ri i grumbullimit dhe i furnizimit kërkon iniciativë e operativitet, kërkon të luftohet burokratizmi dhe javashllëku.*

Inisiativa duhet të zhvillohet sa më shumë në njerëzit dhe në aparatet e pushtetit dhe sidomos në organet e tregëtisë për të zgjidhur me shpejtësi problemet që paraqiten. Ajo duhet të zhvillohet gjithashtu në punëtorët e agjitorët e Partisë, të cilët të gjenden kudo dhe kurdoherë ku ka vështirësi, keqkuptime etj. Inisiativa duhet të zhvillohet në vetë fshatarët dhe përgjithësisht në të gjithë punonjësit.

Organizatat e Partisë duhet të edukojnë me shpirtin e iniciativës, të operativitetit, të kritikës e të autokritikës, të luftës kundër burokratizmit të gjithë komunistët, t'i bëjnë ata shembull për edukimin e gjithë nëpunësve e punëtorëve me këtë stil pune.

. 1

KOMITETI QENDROR I PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË

*Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

1 Më poshtë bëhet fjalë për format e punës politike dhe organizative që do të përdorin organizatat e Partisë.

**LETËR E KQ TË PPSH DËRGUAR ORGANIZATAVE TË
PARTISË NË TERREN DHE NË USHTRI NË LIDHJE ME
DEMOKRACINË E BRENDSHME NË PARTI**

6 mars 1949

**TË GJITHA ORGANIZATAVE TË PPSH
NË TERREN DHE NË USHTRI,
TË GJITHË KOMUNISTËVE,**

Komiteti Qendror i PPSH konstaton se në mjaft organizata të Partisë dhe nga mjaft anëtarë të Partisë është kuptuar shtrembër demokracia e brendshme e Partisë dhe si rrjedhim nuk respektohet me rigozitet disiplina e Partisë, e cila buron prej saj.

Është e domosdoshme t'u jepet fund menjëherë dhe qysh tani në fillim të gjitha këtyre shfaqjeve të dëmshme, të cilat dobësojnë rëndë Partinë, dobësojnë unitetin dhe kompaktësinë luftarake të radhëve të saja, që të çojnë në një farë anarkie në punët e Partisë.

Partia jonë hedh poshtë kategorikisht atë kuptim të shtrembër mbi demokracinë në parti, që në të vërtetë i vë kazmën partisë, prish unitetin e mendimit dhe të veprimit në parti.

Lenini dhe Stalini na mësojnë se demokracinë e partisë duhet ta kuptojmë si një armë për të shtuar aftësinë luftarake, si një metodë për punën e brendshme të partisë, që shton aktivitetin dhe kompaktësinë e të gjithë anëtarëve të partisë, që fut të gjithë partinë në përpunimin e vendimeve të partisë dhe në luftë aktive për zbatimin e tyre të shpejtë dhe të përpiktë.

Shoku Stalin ka thënë:

«Demokracia e brendshme e partisë është shtimi i aktivitetit të masave të partisë dhe forcimi i unitetit të partisë, forcimi i disiplinës së ndërgjegjshme proletare në parti»¹.

¹ J. V. Stalin. Veprat, vëll. 8, f. 149.

Nga e gjithë Partia duhet të kuptohet mirë se disiplina e hekurt dhe rigoroze, që kërkon Partia nga anëtarët e saj, nuk çënon aspak demokracinë e shëndoshë të Partisë sonë. Përkundrazi disiplina e hekurt dhe e ndërgjegjshme, siç është disiplina e Partisë sonë, mund të zhvillohet vetëm në saje të demokracisë së brendshme të partisë.

Në Statutin e PPSH thuhet:

«Diskutimi i mirë dhe i shëndoshë mbi problemet e politikës së Partisë në organizatat e ndryshme ose në gjithë Partinë është për çdo anëtar partie një e drejtë e paprekshme që buron nga demokracia e brendshme e Partisë. Vetëm në bazë të demokracisë së brendshme të Partisë mund të zhvillohet kritika dhe autokritika e shëndoshë dhe të forcohet disiplina e Partisë e cila duhet të jetë konshiente dhe jomekanike»¹.

Kështu, forcimi i unitetit të brendshëm të Partisë, forcimi i disiplinës së Partisë konshiente dhe jomekanike, mund të mendohet vetëm në bazë të demokracisë së plotë të Partisë, sepse mbi këtë bazë ngrihet konshienca e komunistit, ngrihet niveli i tij politik e ideologjik.

Siç theksohet edhe në vendimet e Kongresit I të PKSH, ishte e natyrshme që dje, kur mungonte demokracia e brendshme e Partisë, kur në Parti si rezultat i punës armiqësore të Koçi Xoxes, të Pandi Kristos etj. ishin futur metoda ushtarake dhe policore, të mungonte disiplina e hekurt dhe konshiente e Partisë, të vihej disiplina mekanike, disiplina zyrtare mbi disiplinën e vërtetë të Partisë. Sot, kur të gjitha konditat për zhvillimin e plotë të demokracisë në Parti janë krijuar, çdo shtrembërim i demokracisë, çdo shkelje, sado e vogël qoftë e disiplinës së hekurt dhe të ndërgjegjshme të Partisë, është e palejueshme dhe e rrezikshme për Partinë.

Çfarë rastesh janë vënë re në Partinë tonë, që vërtetojnë se në mjaft organizata bazë dhe në shumë anëtarë partie është kuptuar keq demokracia e brendshme e Partisë dhe është shkelur disiplina e hekurt e Partisë?

a) Në shumë organizata bazë të Partisë, nuk respektohen mbledhjet e Partisë.

Është bërë pothuajse zakon në mjaft organizata bazë që mbledhjet të fillojnë me vonesë...

Gjithashtu ka anëtarë partie në shumë organizata bazë të

¹ «Dokumenta Kryesore të PPSH». Vëll. I, bot. i dytë, f. 527.

Partisë, që mungojnë pa asnjë arësye në mbledhjet e organizatës bazë...

Në Shkodër, për shembull, është bërë si rrugë që, kur i dhemb pak koka, ose sepse gjoja ka punë në zyrë, anëtari i Partisë nuk vete në mbledhjen e organizatës bazë.

Një gjendje e tillë duhet të goditet me të tërë forcën në Parti. Ky indiferentizëm për mbledhjet e Partisë tregon në fund të fundit dhe indiferentizmin e moskokëçarjen për zbatimin e vijës së Partisë, për realizimin e detyrave të Partisë. Ku, përveçse në mbledhjet e organizatës bazë, do të mund të njohë anëtari i Partisë vijën e Partisë, do të mund të vihet në dijeni të detyrave, që i shtron Partia, do të mund të ngarkohet me detyra për t'i kryer etj.?

Të mungosh nga mbledhjet e organizatës bazë të Partisë, do të thotë të shkëputesh nga jeta, nga fryma e Partisë dhe, më në fund, të punosh me kokën tënde, jo si të mëson dhe të udhëzon Partia. Ne duhet të kemi gjithnjë parasysh mësimet e Leninit të madh se çdo anëtar partie është përgjegjës për Partinë dhe Partia është përgjegjëse për çdo anëtar. Por, që Partia të mund të marrë përgjegjësi për çdo anëtar, është e domosdoshme të ketë siguruar kontrollin e vet mbi veprimtarinë dhe punën e çdo anëtari të saj.

Është për këtë arësye që pjesëmarrja në mbledhjet e Partisë është një nga konditat e para për anëtarësinë në Parti. Natyrisht, ndaj atyre që nuk plotësojnë këto detyra partie, duhen marrë dhe masat ndëshkimore që parashikon Statuti.

Mungesa në mbledhjet e Partisë nuk i jep mundësi anëtarit të Partisë të zhvillojë aktivitetet për Partinë, të punojë për të. Nga çdo komunist do kuptuar mirë se disiplina e Partisë sonë nuk presupozon një pajtim «me fjalë» me vijën e Partisë, por luftë konkrete dhe aktive për realizimin e kësaj vije me vepra, pikërisht në atë sektor, ku e ka vënë Partia anëtarin e saj.

Partia nuk lejon prishjen e disiplinës, as edhe në shkallën më të vogël; kjo është një nga karakteristikat e veçanta të disiplinës së Partisë sonë. Nuk lejohet në asnjë rast largimi nga programi dhe Statuti i Partisë. Ai komunist, që lë pasdore çfarëdo detyrë të Partisë, qoftë kjo pagesë e kuotizacionit, pjesëmarrja në mbledhjet e organizatës bazë, respektimi i orarit të mbledhjes, kryerja e ndonjë detyre të veçantë të Partisë ose zbatimi i vijës së Partisë, në atë organizatë ku anëtari i Partisë punon, ai ka shkelur disiplinën e Partisë.

b) Në shumë shokë janë paraqitur tendenca për moszbatimin e vendimeve dhe të detyrave të ngarkuara nga organizatat bazë, nga komitetet e rretheve e të qyteteve dhe deri nga Komiteti Qendror.

Ka pasur raste në mjaft organizata, që shokë të ngarkuar nga

Partia të kryejnë këtë ose atë punë, nuk janë bindur, nuk kanë dëgjuar të shkojnë atje, ku u thotë Partia, të kryejnë detyrën që u ngarkon Partia.

Në qytetin e Shkodrës komiteti i Partisë kishte urdhëruar organizatat bazë të lagjeve që të mobilizonin anëtarët e tyre për të grumbulluar popullin e lagjeve në disa konferenca që do të zhvilloheshin. Për këtë gjë u muar dhe vendim në organizatat bazë. Në këtë rast pati shokë në shumicën e lagjeve që, jo vetëm nuk punuan për grumbullimin e popullit në konferenca, por që nuk vajtën dhe vetë pa asnjë arësye...

Raste tipike të mospranimit dhe të diskutimit të urdhërave të dhëna nga komitetet e Partisë ka pasur sidomos në lidhje me vendosjen e kuadrit. Nën parullën e «demokracisë» shumë shokë kanë kundërshtuar vendimin e komitetit të Partisë për të shkuar në krye të detyrës. Në lidhje me këtë çështje janë vënë re dhe tendenca karrierizmi duke mos parë në radhë të parë nevojat dhe interesin e Partisë e të vendit, por duke shikuar për pozitën e gradën.

Gjithashtu në shumë shokë dhe në disa organizata bazë është zhvilluar një frymë e sëmure duke marrë në diskutim, në mënyrë jo të drejtë, vendimet e Partisë në vendosjen e kuadrit.

Në organizatën bazë të Ministrisë së Industrisë, disa anëtarë të Partisë nuk pranojnë vendimin e komitetit të qytetit, të aprovuar nga KQ i PPSH për caktimin provizorisht deri në zgjedhjet e reja të sekretarit dhe zëvendëssekretarit të organizatës bazë. Gjithashtu nga po këta shokë të kësaj organizate bazë diskutohet dhe konsiderohet i padrejtë vendimi i KQ të PPSH për vendosjen e disa kuadrove. Po kështu në organizatën bazë të Ministrisë së Tregëtisë, për katër orë rresht është diskutuar rreth vendosjes së kuadrove të ndryshëm nga ana e Drejtorisë së kuadrit të KQ.

Në analizë të fundit, ku të shpien këto pikëpamje të shtrembra, këto shtrembërime të demokracisë, këto raste tipike të thyerjes së disiplinës? Ato të shpien në dobësimin ose humbjen e besimit ndaj udhëheqjes. Moskryerja e urdhërave dhe e vendimeve të dhëna nga forumet më të larta do të sillte si rrjedhim që çdo anëtar partie, të vepronte si t'i donte qejfi, të shkonte ku t'i pëlqente, që do të thoshte më në fund të vinte në pikëpyetje vijën e Partisë.

Anëtari i Partisë duhet t'i përgjigjet çdo detyrë që i shtron Partia. Ai duhet të jetë gati të shkojë atje ku i thotë Partia, atje ku e gjen të nevojshme Partia. Për anëtarin e Partisë, nuk ka dy lloj interesash, interesi i Partisë dhe interesi personal. Për anëtarin e Partisë, Partia është mbi të gjitha. Kur interesi i Partisë e do që të shkohet edhe në fshatin më të largët, anëtari i Partisë duhet të jetë gati. Puna që duhet t'i pëlqejë më tepër anëtarit të

Partisë është të shkojë atje ku ka më shumë nevojë Partia, të shkojë atje ku e kërkon Partia.

Në qoftë se anëtarët e Partisë do të kërkonin të shkonin atje ku dëshironin ata, pa marrë parasysh nevojat e Partisë, kjo do të pengonte Partinë në shpërndarjen e drejtë të kuadrit, do t'i hiqte Partisë mundësinë të mbante fort nën kontrollin e saj të gjithë sektorët e ndryshëm të punës, të gjitha krahinat e vendit tonë.

Zbatimi i urdhërave dhe i vendimeve të Partisë është një ndër detyrat e para të anëtarit të Partisë. Statuti i PPSH parashikon për të gjithë ata që shkelin urdhërat e vendimet e Partisë një sërë masash dhe sanksionesh, që shkojnë deri në dënimin ekstrem: përjashtimin nga Partia.

«Vendimet e organeve qendrore të Partisë dhe të administratave të shtetit duhet të zbatohen shpejt dhe pikë për pikë» — thuhet në Statutin e PPSH dhe më poshtë vijon:

«Mosaplikimi i vendimeve të organeve më të larta dhe akte të tjera, të cilësuara si delikte nga opinioni publik i Partisë sjellin me vete: për organizatën, vërejtjen dhe shpërndarjen e saj; për anëtarët e Partisë, vërejtjen me shënim në biografi, ndalimin e përkohshëm për të pasur një vend drejtues në Parti dhe përjashtimin nga Partia»¹.

Përgjegjësit e punës, komitetet e Partisë, janë të ngarkuar gjithnjë të verifikojnë kryerjen e detyrave nga ana e organizatave, nga ana e çdo anëtari të Partisë. T'i mungosh këtij kontrolli, do të thotë t'i lësh rrugë të lirë thyerjes së disiplinës. Te ne sot, në mjaft shokë, ka tendenca që kërkojnë t'i kufizojnë të drejtat e kontrollit të Partisë, që kërkojnë t'i shpëtojnë kontrollit të përgjegjësve mbi ta. Nga mjaft shokë, kur u kërkon llogari për moskryerjen e detyrave, është dëgjuar të thuhet: «shok, ti je me frymën e Plenumit VIII² etj.». Këto janë pikëpamje të shtrembra, këto nuk janë pikëpamje partie. Partia jonë e ka ngritur dhe do ta ngrejë gjithnjë me forcë nevojën e verifikimit të kryerjes së detyrave, pa të cilën s'ka disiplinë partie, s'ka realizim të detyrave të Partisë.

c) Në mjaft organizata dhe nga mjaft shokë është shkelur konspiracioni i Partisë.

Duke dalë nga gjendja e një konspiracioni të ekzagjeruar, kur mbahej fshehtë dhe vetë vija dhe qëllimet e mëdha të Partisë, shumë shokë kanë kaluar në anën tjetër duke bërë biseda rrugëve

1 «Dokumenta Kryesore të PPSH». Vëll. I, bot. i dytë, f. 534.

2 Plenumi VIII i KQ të PKSH që u mbledh në shkurt 1948.

dhe kafeneve edhe ato gjëra që janë çështje të brendshme të Partisë.

Çështjet e brendshme të njëres organizatë (posaçërisht në dikastere), pa kaluar shumë kohë bëhen çështje bisede dhe për shumë organizata të tjera.

Por ka edhe raste gjithashtu që çështje të brendshme të Partisë janë bërë dhe biseda në popull. Në katundin Lekaj të rrethit të Kavajës, fjala vjen, bisedimet që janë bërë një natë më përpara në mbledhjen e organizatës bazë, janë marrë vesh të nesërmen nga mjaft persona në fshat dhe posaçërisht nga ata për të cilët ishte folur dhe ishin kritikuar në mbledhjen e organizatës. Në Koplik gjithashtu, disa anëtarë partie diskutojnë në klub se ku do të vendoset njëri dhe tjetri kuadër i Partisë. Këto biseda i dëgjojnë dhe njerëz jo anëtarë partie, njëri nga këta bile u thotë: «Mirë ju, që jeni anëtarë partie po e caktoni veten, po ne, ku do të na caktoni?».

Ka pasur raste gjithashtu që shokët, duke diskutuar me popullin (si në Pogon, rrethi i Gjirokastrës), të kenë dekonspiruar punën dhe format e punës së sigurimit.

Këto shkelje të disiplinës, që shfaqen në disa raste te disa shokë, duhen goditur me forcë nga ana e Partisë.

Veprime të tilla dobësojnë vigjilencën e anëtarëve të Partisë ndaj armikut, i japin mundësi armikut të na luftojë më kollaj, të dijë ku të na godasë.

c) Në disiplinën shtetërore janë vënë re gjithashtu shënja të mosrespektimit të urdhërave eprorë.

Ka pasur raste që shokë të ndryshëm në pushtet apo në ushtri, t'u shmangen urdhërave të eprorëve. Në Kombinatin vajguror Kuçovë-Patos, fjala vjen, në mjaft shokë që punojnë në prodhim është dukur tendenca e mosbindjes në urdhërat e drejtorisë, duke lënë kështu pa realizuar detyrat që u shtrohen.

...Në aparatit tonë të shtetit dhe posaçërisht në radhët e Ushtrisë sonë Kombëtare, nuk mund të lejohen në asnjë mënyrë shfaqje indisciplinimi që prishin rendin, që i hapin rrugën rrëmujës dhe anarkisë.

Urdhëri epror, posaçërisht në ushtri, është i padiskutueshëm. Ai kryhet pa hezitim. Në kondita luftime, kush kundërshton urdhërin, merr dënimin më të rëndë.

Fakti që është anëtar partie, nuk i jep asnjë privilegj këtij, siç mund të mendojë ndokush ndaj disiplinës shtetërore, ndaj ligjeve të shtetit. Disiplina shtetërore dhe ligjet e shtetit janë të pacënueshme. Shkelja e tyre qoftë edhe në masën më të vogël, është goditje direkte ndaj ndërtimit të vendit tonë. Prandaj ko-

munistët duhet të jenë të parët, që t'i zbatojnë dhe t'i respektojnë me rigorozitet këto. Jo vetëm ata që janë të ngarkuar nga Partia, që të luftojnë me të gjitha forcat e tyre për respektimin e kësaj disipline, por urdhërat dhe vendimet duhet të zbatohen nga e gjithë masa ku punon komunisti.

Shoku Stalin ka theksuar se të gjithë ata që shkelin ligjet e shtetit

«duhen shkarkuar pa ngurrim nga postet drejtuese, pa marrë parasysh meritat e tyre në të kaluarën. . . Kjo është e domosdoshme, në mënyrë që këtyre zotërinjve burokratë mendjemëdhën timer ulet hunda dhe t'u tregohet vendi. Kjo është e domosdoshme, në mënyrë që të forcohet disiplina e Partisë dhe e pushtetit në gjithë punën tonë»¹.

d) Janë vërtetuar raste të thyerjes së disiplinës në punë për realizimin e planit të shtetit.

Si rrjedhim i një fryme të tillë shthurjeje të disiplinës, në mjaft qendra pune e prodhimi janë vënë re shenja të demobilizimit në punë, që kanë sjellë si rrjedhim mosrealizimin e planeve.

Vlen të përmendet këtu shembulli i Kuçovës ku, për shkak të mungesës së disiplinës në punë nga ana e mjaft komunistëve dhe si rrjedhim dhe e mjaft punëtorëve, nga mungesa e shembullit personal të komunistit për të qenë në krye të punës, kurdoherë në sulm, ngjau që plani i prodhimit të muajit janar, megjithëse që plotësisht i mundshëm, të mos realizohet.

Kjo në asnjë mënyrë nuk u lejohet anëtarëve të Partisë. Partia u shtron atyre në radhën e detyrave të para, detyrën që të mobilizojnë të gjitha forcat e tyre në punën për realizimin e planit të shtetit. Dhe anëtari i Partisë jo vetëm që vetë duhet të punojë pa u lodhur dhe me abnegacion në punën që i ngarkohet, por njëkohësisht ai duhet të bëhet shembull i mirë në gjithë qendrën e punës për t'u ndjekur nga të gjithë punëtorët e tjerë.

Ku më mirë se në punën për realizimin e planit e tregon anëtari i Partisë sonë devocionin e tij për çështjen e Partisë, për ndërtimin e socializmit?

Statuti i Partisë sonë kërkon nga çdo komunist që të jetë shembull për respektimin e disiplinës në punë, pse nga ajo varet suksesi i ndërtimit socialist të vendit.

Sikundër e kam theksuar edhe në Kongresin e parë të kooperativave bujqësore:

1 J. V. Stalin. Veprat, vëll. 13, f. 356-357.

«Duhet mobilizimi i plotë i të gjithëve për kryerjen e planit, duhet të vazhdojmë të bëjmë sakrifica, pse pa punë dhe pa sakrifica nuk ndërtohet socializmi. Duhet të luftojmë me ashpërsi tendencat e mungesës së disiplinës në punë dhe në radhë të parë në njerëzit e pushtetit dhe në disa anëtarë të Partisë; duhet të hidhet tej dembellëku dhe pikëpamjet që nga zyrat mund të ndreqen gjërat dhe mund të mbarohen punët me dekrete dhe me kartëra. . . Një gjë e tillë do të marrë fund dhe do të ketë deziluzione të hidhura për cilindo qoftë, anëtar partie ose jo anëtar partie, nëpunës i thjeshtë ose i lartë, në rast se ai nuk kryen detyrën, nuk punon me ndërgjegje dhe nuk merr përgjegjësinë e plotë për punën që i ka ngarkuar Partia dhe qeveria dhe ta kryejë këtë punë»¹.

*
*

Përpara këtyre fakteve dhe të tjerave, që vërtetojnë se në mjaft organizata tona ka filluar të zhvillohet një frymë jo e shëndoshë dhe jo e Partisë, KQ i Partisë tërheq vëmendjen e të gjitha organizatave të PPSH, e të gjithë komunistëve që t'i japin fund menjëherë një situatë të tillë, të kuptojnë drejt dhe ta aplikojnë si duhet demokracinë e brendshme të Partisë dhe të respektojnë me rigorozitet disiplinën e hekurit të Partisë.

Në Partinë tonë nuk ka disiplinë qorre, bindje nga zori. Jo. Disiplina në Partinë tonë është e ndërgjegjshme, prandaj dhe është e fortë. Shoku Stalin ka thënë:

«... disiplina e hekurit nuk përjashton, por supozon një nënshtrim të ndërgjegjshëm dhe vullnetar, sepse vetëm një disiplinë e ndërgjegjshme mund të jetë disiplinë e hekurit»².

Të dobësosh sado pak disiplinën e Partisë, do të thotë të dobësosh Partinë, të rrezikosh Partinë. Respektimi rigoroz i disiplinës nga të gjithë anëtarët e Partisë merr një rëndësi të posaçme, sidomos sot, kur Partia është në fuqi. Lenini ka thënë:

«Kush e dobëson qoftë edhe pak disiplinën e hekurit të partisë së proletariatit (sidomos në kohën e diktaturës së

1 Enver Hoxha. Vepra, vëll. 6, f. 20-21.

2 J. V. Stalin. Veprat, vëll. 6, f. 186.

tij), ai në të vërtetë ndihmon borgjezinë kundër proleta-riatit»¹.

Të gjithë anëtarët e Partisë duhet t'i kenë gjithnjë parasysh këto fjalë të Leninit të madh.

Secili anëtar partie duhet t'i përmbahet pikë për pikë disiplinës në Parti e në punë, të punojë në mënyrë aktive dhe me vetëmohim për realizimin e Statutit të Partisë, për zbatimin e vijës dhe të detyrave të saja, duke siguruar unitetin e radhëve të Partisë.

Komiteti Qendror i Partisë i porositi të gjitha organizatat e Partisë, të gjithë komunistët që të luftojnë me të gjitha forcat e tyre për të kuptuar drejt dhe siç e shtron Partia, demokracinë e brendshme të Partisë e si rrjedhim për të vendosur në Parti e në punë një regjim disipline shembullore.

Për Komitetin Qendror të PPSH
Sekretari i Përgjithshëm

Enver Hoxha

Botohet sipas librit:
Enver Hoxha «Vepra, vëll. 6»

¹ V. I. Lenin. Veprat, vëll. 31, f. 33.

PLENUMI II I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Tiranë, 28-30 prill 1949

KOMUNIKATË

E PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Prej datës 28 deri më 30 prill 1949 zhvilloi punimet Plenumi i zgjeruar i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë.

Plenumi dëgjoi, shqyrtoi dhe aprovoi raportin e Byrosë Politike të mbajtur nga Sekretari i Përgjithshëm i Partisë, shoku Enver Hoxha, «Mbi masat e marrura për zbatimin e vendimeve të Kongresit I të PKSH dhe detyrat që i shtrohen përpara Partisë dhe popullit».

Plenumi i Komitetit Qendror analizoi situatën ndërkombëtare që karakterizohet, nga njëra anë, nga përpjekjet përherë e më të mëdha të nxitësve të luftës për të provokuar një luftë të re dhe për ta shpënë botën në një kasaphanë tjetër më të përgjakshme nga Lufta e dytë botërore dhe, nga ana tjetër, nga përpjekjet e shumëfishuara për mbrojtjen e paqes dhe të demokracisë, të forcave të kampit antiimperialist dhe demokratik që rriten vazhdimisht me në krye Bashkimin Sovjetik dhe shokun Stalin. Pasi shqyrtoi situatën e brendshme plenumi u përqëndrua veçanërisht në problemet ekonomike të vendit.

Plenumi konstatoi se pas shpëtimit të Partisë, të popullit dhe të atdheut nga rreziku që i kërcënohej prej klikës tradhëtare nacionaliste-trockiste të Titos dhe të agjentëve të saj në Shqipëri, është forcuar pavarësia e vendit dhe në saje të ndihmës së paqumeshme dhe të gjithanshme të BS, të Partisë Bolshevike dhe të mësuesit tonë të madh shokut Stalin dhe në saje të ndihmës së demokracive popullore, populli ynë me forca dhe me besim të shumëfishuar e, nën udhëheqjen e Partisë së Punës, vazhdon me vendosmëri ndërtimin e bazave të socializmit në vendin tonë.

Plenumi shtroi si detyrë që t'u kushtohet një kujdes i madh problemeve ekonomike të vendit. Partia duhet të mobilizohet e tëra dhe komunistët me shembullin e tyre personal duhet të udhë-

heqin masat e popullit tonë për një organizim më të mirë të punës, për një rendiment më të madh në prodhim, për një disiplinë më të madhe në punë, për një regjim kursimi rigoroz, për një administrim më të mirë të pasurisë së përbashkët të popullit, për një përdorim më racional e më të mirë të mjeteve të punës, për një emulacion më të shëndoshë me qëllim që të realizohet dhe të tejkalohet në sasi dhe në cilësi plani dyvjeçar i shtetit.

Dashuria për popull, për atdhe, për liri dhe për demokraci, duhet të bëhet një fuqi e madhe që të mobilizojë të gjitha forcat e shëndosha, përparimtare krijuese të vendit tonë, për të kapërcyer të gjitha vështirësitë që hasen në rrugën për ndërtimin e bazave të socializmit në vendin tonë, për forcimin e pushtetit popullor dhe të pavarësisë së vendit.

Plenumi shtroi detyrën që Partia të mobilizohet për të ruajtur pastërtinë e radhëve të saja, për të çelnikosur frymën luftarake dhe forcën e saj organizuese dhe mobilizuese në luftën për realizimin e detyrave të saja të rëndësishme, të rritë vigjilencën e masave punonjëse të qytetit dhe të fshatit, të të gjithë patriotëve për ruajtjen e pushtetit popullor, të pavarësisë, kundër armiqve të jashtëm dhe të brendshëm të popullit e të atdheut dhe për ndërtimin paqësor të vendit tonë.

Plenumi, gjithashtu, vendosi që me rastin e zgjedhjeve të këshillave popullore Partia e Punës e Shqipërisë të paraqitet me lista unike me Frontin Demokratik të Shqipërisë.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

VENDIM

I PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH «MBI DISA ÇËSHTJE TË PARTISË, TË QEVERISË DHE TË ORGANIZATAVE TË NDRYSHME»¹

30 prill 1949

I

ÇËSHTJE QË I PËRKASIN PARTISË:

1. — Të kalohet nga faza e konstatimeve në atë të vënjes para përgjegjësisë të shokëve që nuk kryejnë detyrën në kohë, nuk plotësojnë angazhimet dhe nuk arrijnë që të realizojnë planin në sektorin ku punojnë.

¹ Ky vendim botohet me disa shkurtime për të evituar përsëritjet.

3. — Për të përballuar gjendjen e vështirë ekonomike e financiare të praktikohet sa të jetë e mundur në një shkallë të gjerë puna vullnetare për realizimin e planit të shtetit duke i bërë thirrje patriotizmit të masave tona punonjëse.

4. — Shkrimtarët tanë të nxiten që, përveç shkrimeve për popullarizimin e Luftës nacional-çlirimtare, për të rritur dhe edukuar frymën e patriotizmit, të shkruajnë si nga jeta partizane, edhe çështje që kanë lidhje me përpjekjet që bën populli ynë sot për ndërtimin e socializmit.

5. — Në qytetin e Tiranës të bëhet një koordinim pune midis komitetit të Partisë të qytetit dhe aparateve të ndryshme të pushtetit qendror.

6. — Të luftohet në organizatat dhe në shokët, anëtarë partie, indiferentizmi dhe nënvleftësimi i punës armiqësore dhe ky të jetë një preokupacion i vazhdueshëm për të bërë që të luftohet që në fillim puna e armikut në tokën e Republikës sonë Popullore dhe për të shtuar sa më shumë urrejtjen kundër tij. Organizatat dhe anëtarët e Partisë të dallohen në masë për shpirt sakrifice dhe abnegacioni, për shpirt luftarak që të thyejnë çdo përpjekje që do të bëjë armiku për të na dëmtuar. Të luftohen pa mëshirë dhe në mënyrë të veçantë rastet e anëtarëve të Partisë që nuk janë të disiplinuar në punë, që prishin kot materialin e shtetit, që bëjnë vjedhje, shpërdorime etj. Të forcohet vigjilenca revolucionare në Parti, çështjet të mos shikohen me indiferentizëm, po të analizohen mirë dhe të çohen deri në fund për t'i zgjidhur.

7. — Të bëhet edukatë dhe jetë në Partinë tonë çështja e ruajtjes së sekreteve të shtetit dhe të Partisë dhe të luftohet pa mëshirë çdo neglizhencë në këtë drejtim.

8. — T'i kushtohet një kujdes i posaçëm dhe i vazhdueshëm zotërimit të teknikës në radhë të parë nga anëtarët e Partisë, pse kështu do të ketë mundësi të realizohen planet tona dhe të zbulohet më lehtë puna e armikut.

9. — Organizatat e Partisë t'i kushtojnë një kujdes sa më të madh çështjes së edukimit politik, në radhë të parë të anëtarëve të Partisë e pastaj të gjitha masave punonjëse dhe të tërhiqet vazhdimisht interesi e vëmendja e tyre për këto probleme, pse në këtë mënyrë do të bëhet e pamundur të zërë vend në masë puna e armikut dhe anëtari i Partisë do të jetë në gjendje të luftojë më me efikasitet në punën e tij. Është urgjente, pra, të zhvillohet ndërgjegjja politike e anëtarëve të Partisë për të qenë kudo të parët në çdo situatë dhe të luftohet me këtë rast tendenca e karrierizmit, e paqartësisë dhe e synimit drejt punëve të rehatshme duke bërë përpjekje për t'u larguar nga prodhimi. Të luftohen: plogështia, mungesa e disiplinës, e vigjilencës dhe shkelja e ligjeve,

të luftohet për ruajtjen e mirëmbajtjen e maqinerisë dhe të mjeteve të prodhimit etj. Të vihen kudo parulla ekonomike dhe t'i bëhet thirrje patriotizmit të masave për forcimin e ekonomisë popullore. Të forcohet në gjithë anëtarët e Partisë ndjenja e kuresimit dhe ruajtja e pasurisë shtetërore.

10. — T'i thuhet haptas popullit mbi vështirësitë që po kalojmë e do të kalojmë derisa të hedhim bazat e ekonomisë sonë popullore, që do të bëjë të mundshme arritjen e një jete më të mirë. Është detyra e organizatave të Partisë që të mbajnë lart moralin e popullit për të përballuar vështirësitë që kemi përpara dhe të edukohen ato që të mos bien në pozitat e armikut, po të mobilizojnë tërë forcat e tyre për ngritjen ekonomike të vendit.

11. — Organizatave të Partisë u vihet si një nga detyrat më me rëndësi dhe urgjente për realizimin e planit të shtetit, çështja e gjetjes së fuqisë punëtore, e parashikuar nga radhët e fshatarësisë joproduese ose gjysmëproduese. Në lidhje me këtë çështje të luftohen favorizimet për ata që rrinë kot në fshat duke mos u dhënë këtyre mallra konsumi të racionuara.

12. — Të studjohet dhe të dalë sa më parë kategorizimi më i drejtë për punëtorët duke u bazuar në parimin e madh socialist: shpërblim sipas punës, pse pagesat e drejta do të ndihmojnë për një rendiment më të mirë në punë.

13. — Është e domosdoshme që, për t'i dhënë një hov çështjes së shtimit të prodhimit, të caktohen normat në punë kudo ku ka mundësi dhe të aplikohen këto tërësisht atje ku janë vendosur.

14. — Të merret në studim çështja e forcimit me kuadro më të mirë në Kombinatin Kuçovë-Patos¹, sidomos përta u përket kuadrove që do të udhëheqin organizatat sindikale. Gjithashtu në krye të Ministrisë së Bujqësisë të vihet një shok më i zoti për të vënë punën në vijë, e cila tani nuk shkon aspak mirë.

15. — Të studjohet mirë çështja e zgjerimit dhe e shpërndarjes së kooperativave të shitblerjes në fshatra pse një pjesë e madhe prej tyre kanë dalë me deficite për mungesë xhiroje dhe personeli të tepërt që dëmton ekzistencën e këtyre organizatave.

16. — Për t'i dhënë një hov të madh shtimit të prodhimit dhe shkëmbimit të mallrave, të aktivizohen edhe elementët zanatçinj e borgjezë të vegjël patriotë që duan të punojnë në rrugën tonë. Këtu në radhë të parë duhet të kihet parasysh që të gjitha ndër-marrjet shtetërore të prodhojnë sa më shumë mallra konsumi.

¹ Presidiumi i Kuvendit Popullor me dekret Nr. 1200, dt. 19 dhjetor 1950 vendosi: qytetit të Kuçovës i jepet emri Qyteti «Stalin». (Gazeta Zyrtare Nr. 91, 29 dhjetor 1950).

17. — U vihet si detyrë gjithë organizatave të Partisë që të njohin mirë problemet financiare dhe në lidhje me situatën tonë ekonomike të dinë të japin për rrethin e tyre orientimin e drejtë për përpilimin e buxheteve dhe shpenzimet e fondeve në bazë të një disipline rigoroze financiare. Të kursehen të hollat nga shpenzimet e tepërta, të ulët kostoja e prodhimit, të shkurtohet kudo kuadri i tepërt, të luftohet tendenca e luksit etj., të cilat janë çështje që do të na lejojnë të forcojmë gjendjen financiare të shtetit tonë.

18. — Të bëhet një politikë më e drejtë me klerin e ulët dhe të nxitet që puna e tij të shkojë në favorin e pushtetit tonë, por këtu të mos harrohet puna e pjesës reaksionare të klerit që duhet luftuar si çdo armik tjetër për punën e tij armiqësore.

19. — T'i kushtohet më shumë kujdes nga ana e forumeve të Partisë, çështjes së forcimit të organizatave bazë të Partisë. Shokët e forumeve të venë sa më dendur poshtë dhe t'i ndihmojnë ato si të punojnë vetë dhe me popullin. Ky është një problem kyç, që do të bëjë të mundur aktivizimin e tërë forcave të Partisë dhe si konsekuencë të të tëra masave punonjëse të popullit tonë.

20. — Të shpejtohet krijimi i organizatës së re të rinisë¹ që të bëhet kjo një levë e fortë për të ndihmuar në zbatimin e vijës së Partisë në të gjitha ato probleme që i ngarkohen për t'i kryer. Të aktivizohen sa më tepër të gjitha organizatat e masave që në vijën e Partisë të ndihmojnë për realizimin e detyrave historike që na ngarkon situata.

21. — Shokët drejtues të Partisë e të pushtetit t'i kushtojnë kujdes mbajtjes së evidencave që të njohin në çdo kohë situatën e sektorit që drejtojnë dhe të kenë mundësi të ndjekin si duhet planin gjatë realizimit të tij.

22. — T'i kushtohet një kujdes i veçantë çështjes së buxhetit të organizatave të Partisë. Përpilimi i buxhetit dhe shpenzimi i fondeve t'u nënshtrohet të gjitha rregullave që ekzistojnë në shtetin tonë për çështjet financiare.

23. — Partia të mobilizohet për zbatimin e vendimeve të Plenumit II, pasi t'i jenë bërë asaj mirë të qarta e të kuptueshme të tëra problemet që u shtruan këtu.

24. — Të ndiqet një kriter i drejtë në çështjen e pranimeve në bazë të Statutit. Po ajo që duhet të preokupojë më shumë organizatat e Partisë është çështja e ngritjes ideologjike të anëta-

¹ Krijimi i organizatës së Bashkimit të Rinisë së Punës të Shqipërisë u bë në Kongresin e Unifikimit të Rinisë Komuniste Shqiptare dhe Rinisë Popullore të Shqipërisë, që u mbajt në Shkodër më 10 shtator 1949.

rëve që ka sot Partia e që janë mjaft të ulët dhe të shkullim nga mendja jonë konceptin e gabuar për masën e Partisë, se anëtari i Partisë sot në fshat po na bëhet pengesë për zbatimin e politikës sonë ekonomike me fshatin. Këtu njëkohësisht duhet parë me kujdes çështja e atyre elementëve të lëkundshëm, që pasi t'u kemi dhënë të gjithë ndihmën, të përjashtohen nga Partia.

25. — Të tregohet kujdes në diferencimin e njerëzve për punë armiqësore dhe të mos futim në një kallëp sabotatorin me teknikun e ri që për mungesë diturie dhe eksperience mund të shkaktojë edhe dëme; këta të fundit të vihen para përgjegjësisë po dhe të ndihmohen për ngritjen e tyre.

26. — Të ngrihet autoriteti i organeve shtetërore dhe të mos bjerë Partia në pozita që të kryejë punët e pushtetit, po ta drejtojë atë.

II

ÇËSHTJE QË I PËRKASIN QEVERISË:

5. — Të bëhen të tëra përpjekjet për të mbajtur angazhimet e marrura ndaj shteteve miq me të cilat kemi lidhur marrëveshje dhe të realizojmë plotësisht planin e eksportimeve tona.

A. KOMISIONI I PLANTIT:

1. — Të përfitohet sa më shumë nga eksperiencia sovjetike dhe në këtë drejtim të ndihmohen edhe poshtë organet e pushtetit për të hartuar plane sa më reale, të studjuara e të llogaritura mirë, pse kështu do të bëhet e mundur dhe vënja e njerëzve përpara përgjegjësisë.

B. INDUSTRIA:

1. — Për të forcuar punën në sektorin e industrisë duhet që ministria vetë të marrë në studim shkëputjen e një pjese të ndërmarrjeve të saja për t'i drejtuar direkt komitetet ekzekutive të

rretheve, në mënyrë që ministria të ketë mundësi t'u kushtohet më shumë problemeve të industrisë dhe të minierave, që janë sektorët më të rëndësishëm.

2. — Të luftohet në Ministrinë e Industrisë burokratizmi që ekziston në punë dhe të forcohet operativiteti në realizimin e detyrave që i ngarkohen.

3. — Për t'i dhënë një hov më të madh shtimit të prodhimit dhe shkëmbimit të mallrave, të bëhen përpjekje... që të tëra ndër-marrjet shtetërore të prodhojnë sa më shumë mallra konsumi.

C. BUJQËSIA:

1. — Organizatat e Partisë të zonave më prodhimtare në bimë industriale të kenë kujdes që t'u japin ndihmën e duhur atyre fshatarëve që kanë plotësuar ose tejkaluar planin e mbjelljeve me bimë të tilla që, kur të vijë koha e punimeve të mëdha, të ndihmohen nga ana e Partisë dhe e pushtetit për kryerjen e tyre. Kjo ka rëndësi pse në të ardhshmen do të nxiten edhe të tjerë që të mbjellin sa më shumë prej tyre.

Ç. TREGËTIA:

4. — Ngarkohet Ministria e Tregëtisë që, për të përmirësuar furnizimin e masave të qytetit me prodhime bujqësore, të marrë në studim dhe t'i paraqitë Komitetit Qendror se çfarë prodhimesh të tjera mund të futen në grupin e sendeve që përfshin tregëtia e detyrueshme, sidomos të mbahet parasysh çështja e grumbullimit të detyrueshëm të bulmetrave.

5. — Ministria e Tregëtisë të ushtrojë një kontroll më të fortë në ndërmarrjet nacionale të tregëtisë për çështjen e shpërndarjes së shpejtë dhe të drejtë të mallrave. Nga ana tjetër të bëhet një revizionim i tërë mallrave të blokuara në një rreth ku nuk shkojnë, për t'i dërguar atje ku shkojnë.

6. — Për të tërhequr shteti sa më shumë të holla dhe për të vënë sa më shumë nga masa e grave në punë, të mos lejohet të shiten ashtu si i importojmë të gjitha ato mallra që kanë mundësi të konfeksionohen.

7. — Një nga problemet më preokupante për ekonominë tonë është çështja e grumbullimit. Këtu duhet bërë një luftë e madhe nga organet e Partisë dhe të shtetit për të realizuar planin e grumbullimit të drithërave, me të cilat do të sigurohet buka e popullit, dhe planin e grumbullimit të bimëve industriale, medicinale etj. dhe çdo gjë tjetër që ka të bëjë me plotësimin e eksportimeve tona. Të luftohet mentaliteti i krijuar në fshatarësinë se shteti bën lëshime dhe tërheqje ashtu si në të vërtetë është vepruar në të kaluarën. T'i kushtohet një kujdes ngritjes së kuadrove të tregëtisë që të lidhen me profesionin e tyre dhe të jenë në gjendje të kryejnë sa më mirë detyrën ndaj shtetit dhe popullit.

D. KOMUNIKACIONI:

1. — Ministria e Komunikacionit të shtojë përpjekjet për shfrytëzimin sa më racional të mjeteve rrugore, detare dhe hekurudhore për mirëmbajtjen e tyre dhe për perfeksionimin teknik e të rritjes së ndërgjegjes së punëtorëve të komunikacionit. Për ngushticë të mjeteve të transportit, të mobilizohen edhe të gjitha mjetet primitive si kafshë, karroca, qerre etj. dhe të mos përdoren mjetet e motorizuara të transportit për distancat më pak se 40 km.

E. ARËSIMI:

2. — Organet shtetërore të arësimit dhe tërë Partia në çështjet e arësimit të mos synojnë tani në shtrirjen territoriale të arësimit pa krijuar më parë konditat, e pa siguruar kuadrot arësimore, por t'i kushtojnë kujdes ngritjes së kualitetit të punës në shkollat e të tëra tipeve. Të hiqet dorë nga përgatitja e kuadrove arësimore me anë kursesh dhe t'i kushtohet kujdes forcimit të shkollave pedagogjike. Nga ana tjetër të bëhet një politikë e drejtë me kuadrin arësimitar dhe të ruhet parimi pedagogjik i qëndrimit të arësimitarit për një kohë sa më të gjatë i lidhur me shkollën e tij. Të mbahet parasysh që në fshat të dërgohen sa më shumë mësues anëtarë partie për të ushtruar një influencë të madhe në zhvillimin e fshatit. Të forcohet gjithashtu puna në shkollat e natës dhe këto të ndiqen, në radhë të parë, nga anëtarët e Partisë. Shumë kujdes të tregohet nga organet e Partisë dhe për

luftën kundër analfabetizmit. Organizatat e Partisë të preokupoohen më shumë për problemet e arësimit.

III

ÇËSHTJE QË U PËRKASIN ORGANIZATAVE TË MASAVE:

.....

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

*Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

V E N D I M
I BYROSË POLITIKE TË KQ TË PPSH
MBI PUNËN E SINDIKATAVE

7 qershor 1949

Byroja Politike e KQ të PPSH, pasi mori në shqyrtim raportin e Kryesisë së Këshillit Qendror të Bashkimit të Përgjithshëm Sindikal mbi gjendjen në sindikata, konstatoi:

Nën udhëheqjen e Partisë sindikatat kanë arritur një sërë suksesesh në organizimin, mobilizimin dhe edukimin e klasës sonë punëtore për ndërtimin e bazave të socializmit në vendin tonë; ato janë rritur e forcuar duke grumbulluar në radhët e tyre shumicën dërmuese të punëtorëve e nëpunësve të vendit tonë; ato janë konsoliduar organizativisht dhe kanë rritur në gjirin e tyre një sërë kuadrosht të provuar në luftë e në punë.

Sukseset e arritura nga sindikatat janë bërë të mundshme në saje të udhëheqjes së drejtë të Partisë dhe kujdesit që ka treguar shteti ynë. Këto suksese në punë do të ishin akoma më të mëdha po të mos ishim dëmtuar nga veprimtaria armiqësore e Koçi Xoxes me shokë.

Veprimtaria armiqësore e klikës së Titos dhe e agjentëve të saj Koçi Xoxe e Pandi Kristo ka dëmtuar rëndë punën në sindikata. Plenumi IV i Këshillit Qendror të BPS që u zhvillua në frymën trockiste të Plenumit VIII të PKSH, ka pasur një influencë negative në tërë punën e sindikatave.

Nga kjo veprimtari armiqësore kanë rrjedhur një sërë të metash të rëndësishme që konstatohen sot në sindikatat, si tendenca për të shtrembëruar rolin dhe karakterin e sindikatave, për t'i degjeneruar ato në një aparat të thjeshtë burokratik. Po kështu është shkaktuar moskuptimi i drejtë i rolit të madh të sindikatave dhe mospasja e lidhjeve të shëndosha ndërmjet sindikatave e organeve shtetërore.

Janë arritur suksese të mëdha në lidhje me zgjerimin e forcimitin e sindikatave, megjithkëtë nga ana organizative sindikatat kanë mbetur të dobëta. Statuti dhe rregullorja e sindikatave nuk

janë respektuar dhe për situatën e sotme kanë mjaft mungesa. Është dëmtuar rëndë demokracia e brendshme dhe metoda e bindjes është zëvendësuar me metoda urdhëruese. Ka pasur konfuzion, burokraci e formalizëm në punë. Nga një punë e tillë është shkaktuar një disnivel i madh midis rolit të sindikatave dhe gjendjes së tyre organizative.

Sindikatat i kanë kushtuar një kujdes të veçantë mobilizimit të klasës punëtore për realizimin e planit të shtetit, duke nxitur emulacionin socialist në punë dhe duke organizuar garat socialiste në prodhim. Ato kanë ndihmuar Partinë në rritjen e ndërgjegjes së klasës punëtore. Por në punën e sindikatave për problemet e prodhimit konstatohen mjaft të meta të dukshme që janë rrjedhimi i një pune jo të shëndoshë edukative për luftën kundër shpërdorimeve, dëmtimeve, abuzimeve etj.

Klasa punëtore e organizuar në sindikata, nën udhëheqjen e Partisë, është edukuar me frymën e dashurisë për atdhe, për Bashkimin Sovjetik, Partinë Bolshevike dhe shokun Stalin. Të udhëhequra nga mësimet e marksizëm-leninizmit, sindikatat kanë edukuar klasën punëtore me frymën e internacionalizmit proletar dhe kanë mobilizuar punëtorët për të luftuar të gjitha tentativa e imperializmit dhe të armiqve të brendshëm të vendit tonë.

Sindikatat tona janë kujdesur për përmirësimin e konditave materiale e kulturele të punëtorëve e nëpunësve, për zbatimin e lidhjeve që caktojnë marrëdhënjet në punë. Por konstatohet se në këtë drejtim sindikatat në bashkëpunim me organet shtetërore duhet të kishin bërë më shumë. Gjithashtu legjislacioni i punës paraqitet me të meta e gabime, të cilat duhen korrigjuar.

Byroja Politike e KQ të PPSH, duke marrë parasysh rolin e sindikatave në përgjithësi dhe detyrat konkrete për realizimin e planit dyvjeçar, konsideron të domosdoshme që të merren masa për forcimin e sindikatave. Për këto arsye,

V e n d o s i :

I

MBI UDHËHEQJEN E PARTISË NË SINDIKATAT DHE
MARRËDHËNJET E SINDIKATAVE ME SHTETIN DHE
ME ORGANIZATAT E MASAVE

Për forcimin e vazhdueshëm të klasës sonë punëtore, e cila është mbështetja dhe forca kryesore e Partisë, baza e pushtetit tonë popullor dhe udhëheqja e masave punonjëse të vendit nën drejtimin e Partisë për ndërtimin e bazave të socializmit në vendin

tonë, është e domosdoshme të forcohet udhëheqja e Partisë në sindikatat, të shtohet kujdesi dhe ndihma e organizatave të Partisë për sindikatat.

1. — Organizatat e Partisë duhet t'i kushtojnë një kujdes të madh udhëheqjes së sindikatave dhe duhet të kenë të qarta detyrat e tyre për këtë problem. Forumet e Partisë në rrethe duhet të analizojnë thellësisht problemet sindikale, të udhëzojnë organizatat bazë të Partisë që të përdorin sindikatat si leva kryesore për punën e tyre.

Drejtorja e agjitacionit, e industrisë, e kuadrit dhe veçanërisht Drejtorja e organizimit të aparatit të Komitetit Qendror duhet të ndihmojnë konkretisht në punën e sindikatave.

2. — Është e domosdoshme që të vendosen marrëdhënje të ngushta në mes të sindikatave dhe organeve shtetërore si në qendër edhe në bazë. Të arrihet një bashkëpunim i ngushtë në mes tyre për të zgjidhur drejt të gjitha problemet që kanë të bëjnë me çështjet e prodhimit e të punëtorëve. Të bëhet rregull që të gjitha organet shtetërore të bashkëpunojnë me sindikatat për këto çështje.

Të luftohen të metat e deritanishme që kanë shkaktuar mosmarrëveshje e keqkuptime dhe të bëhen sindikatat një mbështetje e shëndoshë e shtetit në drejtimin e ekonomisë. T'i propozohet Këshillit të Ministrave dhe Këshillit Qendror të Sindikatave që të lëshojnë udhëzimet e nevojshme në lidhje me këtë problem.

3. — Marrëdhënjet midis sindikatave dhe organizatave të rinisë për çështje të prodhimit dhe të edukimit të brezit të ri punëtor duhet të forcohen. Sindikatat t'i kushtojnë një kujdes të veçantë këtij problemi dhe të koordinojnë në baza të drejta punën me organizatën e rinisë.

Gjithashtu sindikatat, në bashkëpunim me organizatat e gruas në mënyrë të veçantë, të kujdesen për edukimin e grave të sindikuara si edhe për edukimin e grave të punëtorëve dhe të fëmijëve të tyre.

II

MBI ÇËSHTJET ORGANIZATIVE

Me qëllim që të eliminohen të metat e konstatuara në çështjet organizative të sindikatave, për t'u forcuar këto organizativisht, që të bëhen të afta si duhet për mobilizimin me vrull të klasës punëtoresh për realizimin e planit dyvjeçar të shtetit, të merren këto masa:

1. — Pasi Statuti i BPS nuk u përshtatet më konditave të tanishme, Këshilli Qendror i Sindikatave të përgatitë brenda da-

tës 30 korrik të këtij viti projektstatutin e ri të sindikatave, i cili të përcaktojë qartë parimet, qëllimet dhe detyrat e sindikatave në situatën e tanishme.

2. — Me qëllim që të korrigjohen disa të meta që kanë ekzistuar në ndërtimin e organizatave sindikale, të merren këto masa të shpejta: Të organizohen grupet sindikale në organizatat bazë; këshillat sindikale të rretheve të mos formohen nga përgjegjësit e këtyre këshillave, por të zgjidhen dhe t'u përcaktohen detyrat si organe koordinuese, t'u përcaktohen mirë detyrat që të mos mbejnë formale.

Veç këtyre, Këshilli Qendror i Sindikatave, kur të përgatitë projektstatutin, të studjojë përcaktimin dhe ndryshimet e nevojshme në strukturën e organizatave sindikale.

3. — Duhet të punohet për të respektuar principet e centralizimit demokratik. Të luftohen metodat urdhëruese në udhëheqjen e punës sindikale. Të zhvillohet kritika dhe autokritika në baza të shëndosha të marksizëm-leninizmit dhe klasa punëtoresh e masat punonjëse të vendit tonë të edukohen në shembullin e në frymën e avangardës së tyre. Të rritet ndjenja e përgjegjësisë në anëtarët e sindikatës ndaj organeve drejtuese dhe këto të fundit të japin llogari periodikisht para masës së anëtarëve. Metoda e punës së sindikatave duhet të jetë metoda e bindjes, e edukimit dhe jo e imponimit.

Për këto arsye para Kongresit II të Sindikatave të zhvillohen zgjedhjet për organet drejtuese në sindikata.

4. — T'i kushtohet një kujdes i veçantë zgjerimit të radhëve të sindikatave dhe forcimit të tyre me anëtarë të rinj. Të punohet për të organizuar në sindikatë gjithë punëtorët e nëpunësit që deri tani kanë mbetur jashtë radhëve të sindikatave për shkak të sektarizmit dhe të punës së dobët që është bërë në këtë drejtim. Të shtohet influenca e organizatave sindikale në njerëzit e teknikës, të shkencës dhe të kulturës që të aktivizohen dhe të vënë të gjitha forcat për ndërtimin e bazave të socializmit.

5. — Të vendoset në organet drejtuese udhëheqja kolegjiale, të funksionojnë dhe të mblidhen rregullisht këshillat dhe kryesitë nga qendra deri në bazë. Të luftohet monopolizimi i punës në duart e disa elementëve.

6. — Të riorganizohet aparati pranë Këshillit Qendror të BPS, këshillave sindikale të rretheve, këshillave sindikale lokale dhe pranë organizatave bazë sipas skicës që i bashkëngjitet këtij vendimi.

Një kujdes i veçantë t'i kushtohet aktivizimit dhe futjes në punë të rrjetit të aktivistëve pa pagesë.

7. — Të merren masa për edukimin dhe lartësimin e kuadrit që punon në sindikatë, të vendosen në postet drejtuese quadro të

shëndoshë e me eksperiencë në punën sindikale dhe të vendoset kuadri i nevojshëm në vendet e paplotësuara.

8. — Të luftohet për të vendosur rregull në çështjet administrative dhe financiare të sindikatave. Të merren masa serioze për të zhdukur konfuzionin dhe burokracinë, për të vendosur evidenca të rregullta dhe të sakta dhe në administrimin e buxhetit të ketë një orientim më të drejtë, për të pasur sa më shumë të ardhura dhe sa më pak shpenzime të panevojshme.

III

MBI PUNËN EDUKATIVE

T'i jepet rëndësi e madhe edukimit politik e ideologjik të klasës punëtore, zhvillimit të saj kultural e artistik, të luftohen të gjitha të metat e trashëguara nga e kaluara dhe të çelënikoset klasa punëtore me cilësi të shëndosha që të bëhet e zonja për të kryer detyrat e mëdha që i ngarkohen.

Duhet të zhvillohet një punë e madhe për edukimin e klasës punëtore në bazë të teorisë marksiste-leniniste, për zhvillimin e patriotizmit, të dashurisë për atdheun, për Partinë dhe shokun Enver, për forcimin e dashurisë ndaj Bashkimit Sovjetik, Partisë Bolshevike dhe shokut Stalin, për zhvillimin e dashurisë për demokracinë popullore dhe të gjitha forcat përparimtare të botës, për shtimin e urrejtjes kundër imperialistëve dhe gjithë armiqtë të vendit tonë; të mobilizohet klasa punëtore për realizimin e planit të shtetit, t'i bëhet i qartë roli i saj pararojë në aleancën me fshatarësinë e varfër e të mesme për ndërtimin e bazave të socializmit në vendin tonë.

Sindikatat duhet të mobilizohen për të bërë një punë të madhe në këtë drejtim në bazë të vendimeve të veçanta që do të marrë Sekretariati i KQ të PPSH për këtë problem.

1. — Për edukimin ideo-politik të kadrove të sindikatave dhe të klasës punëtore në bazë të teorisë marksiste-leniniste duhet të bëhet një punë intensive duke u mbështetur në radhë të parë në kursin e shkurtër të «Historisë së Partisë Bolshevike».

Të merren masa për hapjen e kursit qendror të sindikatave dhe të seminareve brenda këtij viti.

2. — Këshilli Qendror i Sindikatave, duhet të marrë masa që kuadrot e sindikatave dhe gjithë klasa punëtore të njohin sa më shumë Bashkimin Sovjetik, sukseset e tij në realizimin e planit përveççar dhe në të gjitha lëmet e tjera të aktivitetit, të njohin sukseset e sindikatave e të klasës punëtore sovjetike.

Këshilli Qendror dhe organizatat sindikale gjithë punën e tyre duhet ta mbështetin në eksperiencën e sindikatave sovjetike, për këtë qëllim të bashkëpunojnë me Këshillin e përgjithshëm e degët e Lidhjes kulturele të Shqipërisë me BS.

3. — Tërë puna propagandistike dhe agjitative duhet të konsistojë në rritjen e ndërgjegjes së klasës, për realizimin e planit të shtetit, për zhvillimin e garave socialiste etj.

Me anën e agjitacionit dhe të propagandës duhet të merren të gjitha masat për të përhapur eksperiencën e punës, për të bërë të njohur metodat e reja, punëtorët e dalluar, novatorët etj. Gjithashtu të kritikohen publikisht e ashpër të metat.

Gjithë kuadrot dhe anëtarët e organizatave sindikale duhet t'i vënë vetes si detyrë kryesore dhe të rëndësishme njohjen e planit të shtetit, të problemeve ekonomike dhe të teknikës.

4. — Për edukimin kultural të punëtorëve, në radhë të parë, puna e sindikatave duhet të konsistojë në luftën kundër analfabetizmit: të organizohen kurset e reja kundër analfabetizmit, të riorganizohen ato që kanë ekzistuar deri tani, të vendoset ritmi i vazhdueshëm në këtë punë në bazë të një plani të përcaktuar. Veçanërisht në këtë drejtim duhet t'u kushtohet një kujdes i veçantë punëtorëve të minierave, të ndërtimit dhe të bujqësisë.

Gjithashtu sindikatat duhet të kujdesen që punëtorët të frekuentojnë shkollat e natës.

5. — Të zhvillohet një aktivitet më i gjerë kulturalo-artistik me punëtorët, të përmirësohet përmbajtja e punës kulturalo-artistike. Të organizohen sa më mirë rrethet artistike ku të marrin pjesë sa më shumë punëtorë dhe të shtohet aktiviteti i këtyre rretheve. Të organizohen mbi baza të drejta klubet dhe këndet e kuq me qëllim që të bëhen qendra të vërteta për edukimin dhe dëfrimin e punëtorëve. Këshilli Qendror i Sindikatave në marrëveshje me Komitetin e kulturës, të nxjerrë rregulloret për funksionimin e tyre.

6. — Me qëllim që gazeta «Puna» të luajë rolin e saj ashtu si duhet, Këshilli Qendror i BPS duhet të marrë masa për përmirësimin e përmbajtjes së saj. Redaksia të mbajë lidhje të ngushta me Këshillin Qendror të BPS, me organizatat sindikale, me dikasteret ekonomike dhe me qendrat e punës me qëllim që të ketë sa më tepër materiale mbi problemet që duhet të preokupojnë klasën punëtore dhe mbi eksperiencën e punës së sindikatave. Gjithashtu gazeta «Puna» të ketë sa më tepër materiale nga eksperiencia e punëtorëve dhe e sindikatave sovjetike, në radhë të parë, si edhe nga eksperiencia e sindikatave të demokracive popullore.

Të merren masa për forcimin e redaksisë dhe për të shtuar rrjetin e korrespondentëve në qendrat e punës. Të merren masa për shpërndarjen e gazetës «Puna» dhe për leximin e saj.

7. — Sindikatat të interesohen dhe të ndihmojnë për zhvillimin e fiskulturës në masat punëtore dhe për organizimin e shoqërive fiskulturale. Të nxiten masat punëtore në qendrat e punës dhe të prodhimit që të zhvillojnë sportin dhe fiskulturën në mënyrë që këto të bëhen të masave.

IV

MBI MOBILIZIMIN E SINDIKATAVE PËR ÇËSHTJET EKONOMIKE

Në qendër të vëmendjes së punës të sindikatave duhet të jenë problemet ekonomike dhe realizimi i planit dyvjeçar të shtetit. Për këtë duhet të merren masa që të zhvillohet emulacioni socialist, puna me gara etj.

1. — Në bashkëpunim me organet ekonomike, sindikatat duhet t'ua bëjnë të njohur punëtorëve ligjin e planit dyvjeçar dhe planet tremujore, të shtrohen këto në mbledhjet e punëtorëve sipas skuadrave, reparteve, turneve dhe në gjithë kolektivin punonjës, të diskutohen nga punëtorët dhe të dëgjohen me kujdes vërejtjet e propozimet e tyre dhe të merren masat e duhura.

2. — T'i propozohet qeverisë që të ngarkohet Komisioni i Planit të Shtetit, që brenda këtij viti, në bashkëpunim me dikasteret përkatëse dhe sindikatat, të përcaktojë e të vendosë normat në baza të drejta teknike në të gjithë sektorët që ka mundësi. Por sindikatat duhet të mobilizohen që tani për të vënë në jetë e për të realizuar normat që janë sot në fuqi. Kontrolli dhe ndjekja e punës me norma të jenë të vazhdueshme. Sindikatat të kujdesen veçanërisht për këto. Normat të kuptohen drejt nga punëtorët, të nxiten ata për të arritur e tejkaluar normën duke pasur parasysh shtimin e prodhimit, përmirësimin e cilësisë dhe uljen e kostos. Të mbahet evidencë e rregullt dhe të paguhen punëtorët në bazë të normave.

3. — Sindikatat duhet të luftojnë në të gjitha qendrat e punës e të prodhimit për të vendosur një regjim të fortë kursimi, faktor kryesor për uljen e kostos. Të luftohet kundër shpërdorimit të materialit, të lëndës së parë, kundër dëmtimeve të maqinerive, kundër tendencave që janë shfaqur për të kërkuar gjithnjë maqineri të reja dhe për të mos mbajtur mirë maqineritë ekzistuese.

Të forcohet vigjilenca revolucionare në punonjësit për ruajtjen e punës dhe të djersës së popullit, për të zbuluar sabotatorët, armiqtë, spiunët dhe për t'i luftuar ata pa mëshirë.

4. — Të vendoset një disiplinë e hekurt në punë; të punohet në këtë drejtim në mënyrë që asnjë punëtor të mos e lërë punën, të ketë sa më pak mungesa në punë nga ana e punëtorëve.

Organizatat sindikale duhet të zhvillojnë një fushatë të gjerë për t'u shpjeguar punëtorëve rëndësinë e kontratave të punës e të dispozitave të tjera ligjore dhe të mobilizohen për të ndihmuar organet shtetërore për shpërndarjen e librezave të punës dhe për zbatimin e dispozitave ligjore që ka nxjerrë e do të nxjerrë shteti.

5. — Sindikatat të mobilizojnë klasën punëtore për organizimin e garave socialiste të cilat duhet të kenë një ritëm të vazhdueshëm dhe të mbështeten në inisiativën e punëtorëve, të nxitin emulacionin socialist. Sindikatat duhet të bëjnë që në punën me gara të përfshihen masat e gjera të punëtorëve dhe të teknikëve.

Angazhimet për realizimin e planit si sasi, cilësi, kosto e të tjera të jenë konkrete dhe të studjuara, të përgatitura që më përpara, të ndiqet vazhdimisht realizimi i tyre dhe të ndihmojnë punëtorët. Garat duhet të mbikëqyren rregullisht, të jepen rezultatet duke u bërë dhe klasifikimi.

Lëvizja sulmuese duhet të bëhet masive, të ruhet kriteri i drejtë në shpalljen e sulmuesve. Të inkurajohen këta si edhe novatorët e racionalizatorët, të shpërblehen dhe të propagandohet puna e tyre duke u bërë këta shembull pune dhe heroizmi për punëtorët e tjerë.

6. — T'i jepet rëndësi shumë e madhe shpërndarjes së eksperiencës së punës.

Të përhapen eksperiencia dhe metodat e reja në punë të sulmuesve, novatorëve në të gjitha kolektivat punonjës. Të popullarizohen rezultatet e punës së ndërmarrjeve të përparuar dhe të bëhen këto nxitje për të gjitha kolektivat e tjera punonjës. Të kritikohen publikisht ndërmarrjet dhe punëtorët e prapambetur.

7. — Të kuptohet mirë rëndësia e kontratave kolektive si bazë e punës së sindikatave për realizimin e planit të shtetit dhe të gjitha detyrave të sindikatave. T'i propozohet Këshillit të Ministrave që të shqyrtojë propozimin e Këshillit Qendror të Sindikatave, të marrë vendim dhe të përcaktojë orientimin dhe mënyrën e lidhjes së kontratave kolektive ku të predominojë problemi i realizimit të planit të shtetit. Sindikatat të mobilizohen për t'i shtruar kontratat kolektive për diskutim të gjerë me punëtorët. Ato të ndihmojnë e të kontrollojnë për zbatimin e kontratave kolektive.

Kryesia e Këshillit Qendror të BPS t'i propozojë Këshillit të Ministrave që krahas me udhëzimet për kontratat kolektive të jepen udhëzime se kur e si mund të lidhen kontratat individuale.

8. — Sindikatat të ndihmojnë në organizimin e punës për ngritjen profesionale dhe përgatitjen e kuadrove të rinj, në bazë

të planit që ka shteti. Sindikatat në bashkëpunim me ndërmarrjet të ngrenë kudo kurse perfeksionimi. Të tregohet kujdes që këto kurse të funksionojnë në rregull, me programet dhe tekstet e nevojshme. Organizatat sindikale të nxitin punëtorët që t'i frekuentojnë rregullisht kurset dhe të mësojnë sa më shumë. Gjithashtu sindikatat të nxitin dhe të mobilizojnë teknikët, mjeshtrit dhe specialistët që të angazhohen për të mësuar punëtorët e ulët dhe të rinj në punë.

V

MBI PAGAT

Me qëllim që të rregullohet problemi i pagave dhe të bëhen këto nxitje për shtimin e prodhimit është e nevojshme që të merren këto masa:

1. — Për të korigjuar të metat që ekzistojnë sot dhe për të përcaktuar sa më drejt kategorizimin dhe sistemimin e pagave të punëtorëve e të nëpunësve, Kryesia e BPS duhet me anë të përfaqësuesve të saj, të ndihmojë dhe t'i japë gjithë materialin që disponon komisionit që ka ngarkuar qeveria për të përfunduar këtë problem deri më 30 korrik.

Gjithashtu sindikatat të ndihmojnë komisionin e lartpërmendur dhe organet shtetërore përkatëse për të përcaktuar rregulloret e veçanta për pagat e punëtorëve, teknikëve e nëpunësve të sektorëve të ndryshëm si dhe për studimin e korigjimit e urdhëresës për pagën e punëtorëve të mitur e praktikantë.

2. — Organizatat sindikale ngarkohen të merren me çështjen e pagave, të kontrollojnë llogaritë e mëditjeve dhe të pagesës sipas normave, të ndjekin rregullisht ngritjen e aftësive teknike të punëtorëve në punë, duke i ngritur këta në kategorizim. T'u shpjegojnë punëtorëve ligjin e urdhëresat mbi pagat dhe të bëhen këto nxitje për shtimin e prodhimit.

VI

MBI KODIN E PUNËS DHE INSPEKTIMIN E PUNËS

Për të vënë në rrugë të drejtë problemet e ndryshme mbi marrëdhënjet në punë, mbrojtjen e punës dhe funksionet e sindikatave për zbatimin e Kodit të punës, të merren këto masa:

1. — Organizatat sindikale të ndihmojnë organet përkatëse shtetërore në korigjimin e Kodit të punës në mënyrë që brenda muajit gusht të këtij viti, të shtohen dhe të rregullohen në kod funksionet e sindikatave për zbatimin e tij, marrëdhënjet e tyre me organet shtetërore, problemi i marrëdhënjeve në punë, ai i komisionit të konflikteve, i inspektimit të punës, i pagave mesatare, i lejeve të pushimit, i punëtorëve të mitur, i punës vullnetare, i punëtorëve të paraburgosur etj. Gjithashtu t'i propozohet Këshillit të Ministrave që të nxjerrë urdhëresa të veçanta për konkretizimin e zbatimin e neneve të ndryshme të Kodit të punës dhe për abrogimin e ligjit mbi inspektimin e punës sepse nuk është i drejtë.

2. — Organizatat sindikale dhe drejtoritë e ndërmarrjeve të njohin mirë legjislacionin e punës, detyrat që kanë ato për zbatimin e tyre dhe t'u bëjnë të njohur punëtorëve si të drejtat ashtu dhe detyrat që ata kanë.

3. — Në zbatimin e legjislacionit të punës, organizatat sindikale të kuptojnë drejt rolin e tyre dhe atë të ndërmarrjeve. Të mos mbeten në konstatime, por të ndihmojnë dhe të mobilizohen duke u bërë një mbështetje e fortë për zbatimin e ligjeve, për zgjidhjen e problemeve të ndryshme të punës e të punëtorëve dhe për përmirësimin e vazhdueshëm të konditave të punës e të jetesës së punëtorëve.

VII

MBI SIGURIMET SHOQËRORE

Pasi ligji mbi sigurimet shoqërore ka shumë të meta dhe me qëllim që legjislacioni i sigurimeve shoqërore të ngrihet mbi baza të drejta, të merren këto masa:

1. — T'i propozohet Këshillit të Ministrave që të abrogohet ligji i sigurimeve shoqërore dhe të nxirret ligji i ri brenda muajit gusht.

Organizatat sindikale të ndihmojnë organet shtetërore përkatëse për përgatitjen e ligjit të ri të sigurimeve shoqërore në bazë të një orientimi të drejtë, duke u mbështetur në eksperiencën sovjetike dhe në eksperiencën tonë. Ligji i sigurimeve shoqërore të udhëhiqet nga parimi që të përfshijë të gjitha kategoritë e punëtorëve, të përfshijë të gjitha llojet e sigurimeve shoqërore, të parashikojë përmirësimin e konditave materiale e kulture, të udhëhiqet në shpërblimet nga parimi socialist «secilit sipas punës», të

merret parasysh stazhi, meritat, rendimenti në punë. Gjithashtu sindikatat të ndihmojnë organet shtetërore për pregatitjen e urdhëresave të tjera mbi zbatimin e ligjit të sigurimeve shoqërore, mbi funksionet e organeve të tyre etj.

2. — Sindikatat, të cilat ngarkohen me zbatimin direkt të sigurimeve shoqërore, duhet t'i kushtojnë një kujdes të madh vënjes në jetë të ligjit të sigurimeve shoqërore, duke goditur shpërdorimet, konfuzionin, burokracinë, abuzimet etj.

3. — Drejtoria e kuadrit e KQ të PPSH të marrë masa për forcimin e aparatit të sigurimeve shoqërore me kuadrot e nevojshëm dhe Kryesia e BPS të marrë masa për ristudimin e këtyre kuadrove.

VIII

MBI FURNIZIMIN DHE BANESAT

Organizatrat sindikale t'i kushtojnë një kujdes të veçantë dhe të vazhdueshëm përmirësimit të konditave materiale të jetesës të punëtorëve në qendrat e punës dhe për këtë qëllim të mobilizohen:

1. — Për sigurimin e furnizimit të punëtorëve dhe të nëpunësve me sendet e nevojshme ushqimore, të shtohet rrjeti i mensave pranë qendrave të punës, të përmirësohet ushqimi, të ulen çmimet.

2. — Të shtohet sipërfaqja e tokave të kopshteve të zarzavateve pranë qendrave të punës dhe të kopshteve individuale të punëtorëve. Të organizohet punimi dhe mirëmbajtja e tyre në mënyrë kolektive dhe vullnetarisht nga punëtorët për të siguruar sa më shumë prodhime me çmime të ulëta. Të ngrihen ekonomitë e vogla ndihmëse me qëllim që të ndihmojnë në furnizimin e mensave të punëtorëve.

3. — Organizatat sindikale të mobilizojnë punëtorët për të ndihmuar në realizimin e planit të ndërtimit të banesave në qendrat e punës dhe të kujdesen për mirëmbajtjen e tyre.

4. — Këshilli Qendror i Sindikatave të marrë në studim dhe t'i propozojë Këshillit të Ministrave çështjen e organizimit të kontrollit të sindikatave mbi rrjetin e mensave, të dyqaneve dhe të ekonomive ndihmëse pranë qendrave të punës.

IX

MBI PUSHIMET E PUNËTORËVE

Sindikatat t'i kushtojnë një kujdes të veçantë organizimit të pushimit të punëtorëve në bazë të një plani që duhet të përcaktohet në bashkëpunim me ndërmarrjet para fillimit të çdo viti me qëllim që të gjithë punëtorët të marrin lejet e pushimeve vjetore pa u dëmtuar realizimi i planit të shtetit.

1. — Shtëpitë e pushimit të bëhen të përhershme në mënyrë që punëtorët të mos shkojnë vetëm gjatë verës, por gjatë gjithë vitit.

Të shtohen shtëpitë e pushimit dhe të caktohet një sistem i shtëpive dimërore, verore me klimë malore, detare etj.

Sindikatat të pregatitin një plan me afat të gjatë për ndërtimin dhe riparimin e shtëpive të përhershme të pushimit.

2. — Të vendoset një kriter i drejtë në dërgimin e punëtorëve në shtëpitë e pushimit në mënyrë që të shkojnë punëtorët më të mirë, sulmues, novatorë, racionalizatorë dhe ata që kanë më shumë nevojë nga ana shëndetësore.

3. — Të caktohen kategoritë e punëtorëve që meritojnë të kalojnë falas në shtëpitë e pushimit dhe të atyre që duhet të paguajnë pjesërisht shpenzimet.

4. — Të organizohet më mirë jeta, dëfrimi dhe çlodhja e punëtorëve në shtëpitë e pushimit sipas rregulloreve dhe programeve të përcaktuara.

X

MBI LIDHJET NDËRKOMBËTARE

Sindikatat të forcojnë në mënyrë të vazhdueshme lidhjet e tyre me sindikatat përparimtare të vendeve të tjera, të edukojnë klasën punëtore në frymën e internacionalizmit proletar dhe të rritin e të zhvillojnë urrejtjen kundër imperializmit, agjentëve të tij dhe tradhëtarëve të klasës punëtore.

1. — Të forcohen veçanërisht lidhjet me sindikatat sovjetike. Këshilli Qendror i Sindikatave duhet të marrë masa për forcimin e këtyre lidhjeve, për shkëmbimin e delegacioneve, të materialeve etj. Të popullarizojë në radhët e klasës sonë punëtore punën dhe rezultatet e klasës punëtore dhe të sindikatave sovjetike.

2. — Të mbahen lidhje të ngushta me FSB, të përkrahen akcionet dhe aktiviteti i saj, të vihen në jetë vendimet e saj dhe të popullarizohet ajo në radhët e punëtorëve tanë.

3. — Të forcohen lidhjet me sindikatat e vendeve të demokracisë popullore dhe me sindikatat e tjera përparimtare. T'u bëhen të njohura punëtorëve të vendit tonë, puna dhe rezultatet e tyre.

4. — Të merren masat e nevojshme me qëllim që të forcohet puna për popullarizimin e Republikës Popullore të Shqipërisë, të realizimeve të klasës sonë punëtoresh, të sindikatave dhe të gjithë aktivitetit të vendit tonë në vendet e tjera.

T'u dërgohet material punëtorëve shqiptarë në mërgim të cilët interesohen për t'u informuar mbi sukseset që arrin Shqipëria e re.

XI

Me qëllim që t'i jepet një drejtim i ri tërë punës në sindikata, të përcaktohen dhe të vihen në rrugë të drejtë veçanërisht çështjet organizative, me qëllim që sindikatat të mobilizojnë më me vrull klasën punëtoresh për realizimin e planit dyvjeçar të shtetit dhe për shkak se sipas statutit u kanë kaluar afatet e mbledhjeve:

1. — I rekomandohet Këshillit Qendror të Sindikatave të thërrisë Plenumin V të tij brenda muajit qershor të këtij viti.

2. — Rekomandohet të thirret Kongresi II i Sindikatave brenda muajit shtator të këtij viti.

Byroja Politike e KQ të PPSH kërkon nga të gjitha organizatat e Partisë, nga organizatat sindikale dhe nga organet ekonomiko-shtetërore që të kuptojnë mirë rolin dhe detyrat e mëdha të sindikatave. Të mobilizojnë të gjitha forcat për zbatimin e këtyre vendimeve, që kanë rëndësi të madhe për të bërë një ndryshim rrënjësor në tërë punën e sindikatave, në mënyrë që organizatat sindikale të bëhen një mbështetje e fuqishme e Partisë dhe e shtetit për ndërtimin e socializmit në vendin tonë.

BYROJA POLITIKE E KQ TË PPSH

Botohet sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

REZOLUTË

E KOMITETIT QENDROR TË PPSH PËR PUNËN ME RININË

9 qershor 1949

1. — Në situatën që kalon vendi ynë, kur përpara Partisë paraqitet më se i domosdoshëm problemi i grumbullimit dhe i aktivizimit të masave të gjera popullore të udhëhequra nga klasa punëtoresh dhe pararoja e saj, Partia e Punës e Shqipërisë, në luftë për ndërtimin e bazave të socializmit, çështja e rinisë, e organizimit dhe e mobilizimit të saj është një çështje mjaft e rëndësishme për Partinë.

2. — E kaluara ka qenë e rëndë për rininë e vendit tonë ashtu si edhe për gjithë popullin. Por kurdoherë, që nga kohët më të lashta dhe deri tani, në rininë tonë janë ruajtur gjallë patriotizmi i kulluar, dashuria për popull dhe atdhe. Rinia e Shqipërisë ka qenë kurdoherë në ballë të përpjekjeve të lavdishme të popullit tonë për pavarësinë dhe lirinë e tij. Gjatë regjimit gjakatar të Zogut dhe më vonë, gjatë okupacionit fashist italian rinia shqiptare shumëzoi përpjekjet e saja dhe zhvilloi patriotizmin e dashurinë për popullin. Jehona e Revolucionit të Tetorit dhe idetë e Leninit e të Stalinit që pak nga pak filluan të përhapen në vendin tonë, ekzistenca e Bashkimit Sovjetik, lëvizja revolucionare ndërkombëtare, si lufta e popullit spanjoll kundër regjimit fashist të Frankos etj., puna e madhe dhe jeta e komsomolit të Lenin-Stalinit influencuan shumë në rininë tonë për forcimin e patriotizmit të saj, për organizimin e luftës kundër regjimit të Zogut. Për këtë një ndihmë të madhe kanë dhënë grupet e para komuniste të vendit tonë.

Megjithëse pa një organizatë të sajën, e cila do ta organizonte më mirë luftën e rinisë, rinia shqiptare goftë gjatë regjimit të Zogut, goftë edhe gjatë okupacionit fashist italian u rezistoi dhe bëri të dështojnë të gjitha tentativat që bëjnë regjimi i Zogut dhe ai i okupacionit për korrupsionin e rinisë dhe për shkëputjen e saj nga lufta e popullit.

Nga rezistenca heroike e rinisë sonë falimentuan njëra pas tjetrës organizatat fashiste, «Djelmënia Shqiptare», organizatat e krijuara nga fashizmi italian etj. Urrejtja e rinisë për okupatorët

dhe tradhëtarët ishte e madhe. Të paharrueshme do të mbeten demonstratat e rinisë më 5,6 dhe 7 prill 1939 kur rinia protestoi kundër okupacionit dhe regjimit tradhëtar të Zogut. Po aq të lavdishme janë edhe demonstratat e mëvonshme të mijëra të rinjve në Shkodër, Tiranë, Vlorë, Korçë, Gjirokastër, Durrës, Elbasan etj., më 28 Nëntor dhe në festat e tjera me anën e të cilave rinia jonë tregonte patriotizmin e saj, dashurinë e madhe për popullin dhe atdheun e robëruar.

Megjithkëtë përpjekjet e rinisë nuk ishin të organizuara. Por edhe kjo ditë erdhi. Lufta heroike e popujve sovjetikë kundër Gjermanisë fashiste agresore i dha zemër dhe shpresë gjithë popullit tonë trim. Në këto kondita u krijua në vendin tonë Partia Komuniste Shqiptare, e cila i doli zot popullit tonë dhe u vu në krye të luftës së tij për lirinë dhe pavarësinë. Rinia e Shqipërisë, në gjakun e së cilës ziente atdhedashuria dhe urrejtja për okupatorët agresivë, shumë shpejt u grumbullua për luftën rreth Partisë Komuniste Shqiptare.

3. — Partia Komuniste Shqiptare është organizatorja e rinisë sonë. Me iniciativën e saj më 23 nëntor të vitit 1941 me qëllim që të grumbulloheshin, të organizoheshin dhe të hidheshin në luftë masat e rinisë për çlirimin e popullit, u krijua organizata e Rinisë Komuniste Shqiptare. Qysh në fillim Partia është kujdesur për edukimin dhe organizimin e rinisë. Në Rezolucionin e Konferencës I të Partisë në nëntor të vitit 1941 thuhet:

«Organizatat e Partisë dhe forumet e larta detyrohen t'i japin ndihmën e tyre rinisë komuniste shqiptare në zhvillimin e saj dhe në mobilizimin e të gjithë rinisë së ndershme shqiptare»¹.

Partia e organizoi Rininë Komuniste sipas shembullit të komsomolit leninist-stalinian, si ndihmëse besnike të saj. Ajo që në ditët e para këshillonte:

«Të vihet në dijeni rinia jonë mbi jetën e lumtur dhe kulture dhe mbi luftën heroike të rinisë së URSS-it, e cila na jep shembull se si i shërbehet popullit të vet»².

E udhëhequr nga Partia, organizata e Rinisë Komuniste shpejt u bë një organizatë e fortë luftarake. Në radhët e saja ajo grumbulloi të rinjtë më të mirë të vendit, të rinjtë më të vendosur për kauzën e popullit, të rinjtë më të devotshëm. Detyrat e Rinisë Komuniste përmbledheshin në mobilizimin dhe aktivizimin e masave të rinisë shqiptare në luftë për çlirimin e vendit për zbatimin e vijës së Partisë, në zhvillimin dhe forcimin e patriotizmit të masat

1 «Dokumenta Kryesore të PPSH». Vëll. 1, bot. i dytë, f. 25.

2 Po aty, f. 141.

e rinisë sonë, në edukimin e rinisë me mësimet e marksizëm-leninizmit.

Rinia Komuniste ka qenë organizata e vetme e rinisë, e cila nën udhëheqjen direkte të Partisë, mbajti lart traditat luftarake të rinisë sonë, u bëri ballë armiqve, okupatorëve dhe tradhëtarëve të vendit, luftoi në ilegalitet në qytete e fshatra dhe me armë në dorë në çetat partizane për lirinë, pavarësinë dhe për një jetë më të mirë për popullin tonë. Gjatë Luftës nacional-çlirimtare Rinia Komuniste shkroi faqe të lavdishme në historinë e popullit tonë; shembujt e heroizmit të të rinjve komunistë janë të panumërt. Ata të edukuar dhe të udhëhequr nga Partia, nga mësimet e shokut Enver Hoxha, si bij besnikë të saj, shkuan në aksion me ballë hapët, syptrembur dhe përpara sakrificës supreme thërritnin për lavdinë e Partisë sonë, të popullit tonë heroik, të Bashkimit Sovjetik e të Stalinit të madh. Nga radhët e Rinisë Komuniste kanë dalë luftëtarë të shquar si Heroi i Popullit Qemal Stafa, Sekretar i parë i KQ të Rinisë Komuniste, Heroi i Popullit Misto Mame, anëtar i KQ të Rinisë Komuniste, dëshmorët: Margarita Tutulani, Manush Alimani, Shyqyri Ishmi, Lef Sallata, Myzafer Asqeriu, Ajet Xhindolli, Midhi Kostani, Sul Myzyri, Janaq Kilica, Teli Ndini e qindra e qindra të tjerë të rinj, të cilët me heroizmat e tyre, me luftën e tyre të shkëlqyer i treguan rrugën e lavdishme dhe të nderit rinisë sonë, e mësuan atë si luftohet për lirinë, pavarësinë dhe demokracinë.

Rinia Komuniste e Shqipërisë luftoi me besim të patundur në fitoren, me besim në udhëheqjen e Partisë, me besim në Bashkimin Sovjetik dhe Stalinin e madh, prandaj edhe fitoi. Ajo ka kontribuar në një masë të konsiderueshme për ngritjen e patriotizmit të masave, të entuziazmit të tyre, për ngjalljen e besimit në forcat tona, në Partinë dhe në çështjen e lëvizjes nacional-çlirimtare. Rinia Komuniste Shqiptare ka qenë një agjitore e shquar, ndihmëse e Partisë për ngritjen e masave të gjera të popullit dhe veçanërisht të rinisë në luftë kundër okupatorit.

4. — Rinia Komuniste ka punuar për të bashkuar të gjithë rininë shqiptare në luftë për çlirimin e vendit tonë. Qysh në Konferencën e Pezës rreth Rinisë Komuniste ishte grumbulluar një pjesë e madhe e rinisë shqiptare. Si rezultat i këtij mobilizimi të rinisë, Komiteti Qendror i Partisë në vitin 1943 vendosi organizimin e Bashkimit të Rinisë Antifashiste Shqiptare, që do të punonte, e drejtuar nga Rinia Komuniste, nën udhëheqjen e Partisë. Duke zbatuar këtë vendim të Partisë, Rinia Komuniste Shqiptare që nga shtatori i vitit 1943 u bë organizatorja dhe inisiatorja e krijimit të Bashkimit të Rinisë Antifashiste Shqiptare, organizatës së masave të rinisë së ndershme të Shqipërisë.

Në radhët e BRASH u grumbulluan të rinjtë dhe të rejat e

qytetit dhe të fshatit, që ndihmonin dhe luftonin për çlirimin e vendit kundër okupatorëve dhe tradhëtarëve, për një Shqipëri të lirë, për realizimin e aspiratave të popullit e të rinisë sonë dhe për krijimin e të ardhshmes së saj të lumtur. Komiteti Qendror i PPSH konstaton se ajo ka mobilizuar masat e gjera të rinisë, i grumbulloi këto rreth Partisë dhe i hodhi në luftë për çlirimin e popullit duke bërë që të dështonjë tentativat e armiqve të jashtëm dhe të tradhëtarëve të brendshëm, që kishin për qëllim të korrupcionit rininë dhe ta largonin atë nga lufta. Kontributi që ka dhënë Rinia Antifashiste gjatë Luftës nacional-çlirimtare me në krye Rininë Komuniste, ka qenë faktor i rëndësishëm për suksesin e lëvizjes sonë të çlirimit. Nga radhët e saja dolën me mijëra dhe mijëra partizanë dhe ranë shumë dëshmorë nga më heroikët e popullit dhe të Ushtrisë sonë Nacional-Çlirimtare.

«Rinia e vendit tonë, krenaria e popullit shqiptar, u hodh me mish e me shpirt në luftën e përgjakshme, ajo dha dëshmorët e parë heroikë dhe tregoi që në fillimin e robërisë së, me gjithë terrorin e tmerrshëm fashist dhe pa pasur ende armët në dorë, ajo ishte e vendosur të luftonte, ajo dinte përse luftonte dhe se në hovin e saj ngadhënjimtar s'kish fuqi që ta ndalonte»¹.

Me punën e palodhur të Rinisë Komuniste dhe nën udhëheqjen e organizatave të Partisë, organizata e Rinisë Antifashiste shumë shpejt u bë një organizatë masive që u shtri në gjithë vendin tonë.

Këshillat e Rinisë Antifashiste u krijuan në të gjithë vendin.

Në gushtin e vitit 1944 zhvilloi punimet e tij Kongresi i parë i Rinisë, i cili shënon një etapë të rëndësishme në lëvizjen e rinisë sonë. Atje mori formë organizata e Bashkimit të Rinisë Antifashiste, u zgjodh udhëheqja e saj dhe u konsakrua platforma me të cilën kishte luftuar organizata e rinisë; atje u caktuan detyrat në lidhje me edukimin e rinisë dhe mobilizimin e saj për forcimin e pushtetit demokratik dhe të ekonomisë sonë popullore.

5. — Pas çlirimit të vendit rinia e Shqipërisë, e organizuar në Bashkimin e Rinisë Antifashiste, më vonë, në Rininë Popullore, nën udhëheqjen e Rinisë Komuniste vazhdoi të jetë gjithnjë ndihmëse besnike e Partisë, në kryerjen e detyrave të reja që dolën përpara vendit. Në radhët e Rinisë Popullore, në krye të së cilës kanë qenë dhe janë të rinjtë komunistë, u aktivizuan masat e gjera të rinisë së vendit tonë. Me inisiativën e saj, entuziazmin dhe dinamizmin që e karakterizon, rinia e Shqipërisë u bë një luftëtare e shquar e ndërtimit të vendit. Të pavdekshme do të

¹ Enver Hoxha. Vepra, vëll. 2, f. 309.

mbeten në historinë e popullit tonë veprat e ndërtuara me mundin dhe djersën e rinisë sonë heroike, siç janë rruga Peshkopi-Bicaç, hekurudhat Durrës-Peqin, Durrës-Tiranë dhe shumë vepra të tjera më të vogla, ku mijëra dhe dhjetëra mijëra të rinj, besnikë të popullit dhe të Partisë së tyre, patriotë të shquar të vendit tonë, treguan po aq heroizëm, po aq besim në fitore, po aq dashuri për popullin dhe Partinë sa edhe në Luftën nacional-çlirimtare të popullit tonë.

Të organizuar në Rininë Popullore dhe në Rininë Komuniste, mijëra dhe dhjetëra mijëra të rinj dhe të reja kanë qenë dhe janë luftëtarë besnikë të ndërtimit të bazave të socializmit dhe roje vigjilente në radhët e Ushtrisë sonë Kombëtare. Me heroizëm ata luftojnë dhe përpiqen për plotësimin e planit të shtetit, me abnegacion dhe entuziazëm ata punojnë për lulëzimin e atdheut tonë. Në këtë mënyrë ata tregojnë se ecin me vendosmëri në rrugën që u dëfton Partia, në rrugën ku e kanë udhëhequr drejtuesit e saj të shquar si Qemal Stafa, Nako Spiru, Misto Mame, Alqi Kondi.

«Në flamujt tuaj të rinisë nuk numërohen fitoret; ato janë të rëndësishme si njëra-tjetra. Në të gjitha punët e rëndësishme të vendit tonë është vula juaj dhe këtu është siguria në pavdekshmërinë e këtyre veprave»¹.

Rinia Popullore nën drejtimin e Rinisë Komuniste gjatë gjithë kësaj kohe e deri sot e ka ndihmuar aktivisht Partinë për edukimin ideo-politik dhe kultural të rinisë, për mobilizimin e saj në vijën e Partisë. Sukseset që ka arritur rinia i dedikohen faktit se ajo ka pasur ndihmën dhe kujdesin e Partisë e të Sekretarit të Përgjithshëm të Partisë, shokut Enver Hoxha dhe sepse në punën e saj ajo udhëhoqej nga shembulli dhe eksperiencia e rinisë sovjetike, nga komsomoli heroik i Lenin-Stalinit.

6. — Gjendja që ekzistonte në vetë Partinë tonë, e shkaktuar nga puna armiqësore trockiste e klikës së Titos dhe e agjentëve të saj të kryesuar nga Koçi Xoxe si dhe influenca e puna armiqësore e trockistëve kundër rinisë sonë, kanë sjellë si rezultat mbajtjen në gjysmlegalitet të organizatës së Rinisë Komuniste. Komiteti Qendror i Partisë e konsideron të gabuar një veprim të tillë sidomos pas çlirimit të vendit. Kjo ka sjellë si rezultat që, përpara masave të rinisë, të mos dilte roli drejtues i Rinisë Komuniste, i kësaj organizate të fortë, që ruante traditat më të mira luftarake, që kishte përshkuar një rrugë të lavdishme e fitimtare, në pararojë të të gjithë rinisë shqiptare.

Komiteti Qendror i Partisë konstatoi gjithashtu se

a) Në Rininë Komuniste nga mungesa e statutit të organiza-

¹ Enver Hoxha. Vepra, vëll. 4, f. 47.

tës nuk janë respektuar parimet e centralizmit demokratik dhe ka munguar demokracia e brendshme. Nuk janë bërë zgjedhjet. Nuk është aplikuar dhënja llogari e forumeve para zgjedhësve dhe ka munguar kritika e autokritika. Organizata e Rinisë Komuniste nuk është rritur në proporcion me sukseset e mëdha të saja. Nga kjo pikëpamje vihet re një sektarizëm i theksuar.

b) Në Rininë Popullore, megjithëse ekzistonte statuti, si refleksi i gjendjes që ekzistonte në Parti dhe në Rininë Komuniste, ka munguar demokracia e brendshme në organizatë. Në Rininë Popullore ekziston një shturje, ka hyrje e dalje të vazhdueshme anëtarësh, gjë që ka shkaktuar edhe shturjen e disiplinës. Një gjendje e tillë u krijonte mundësi armiqve të depërtonin në radhët e organizatës.

c) Trockistët jugosllavë dhe agjentët e tyre të kryesuar nga Koçi Xoxe, duke e ditur se rinia jonë ishte revolucionare dhe besnike e Partisë, synonin ta goditnin atë. Ata janë munduar ta orientonin shtrembër rininë tonë, të mbytnin entuziazmin dhe dinamizmin e saj. Kjo vijë armiqësore u konkretizua në rini në Plenumin VII të organizatës së Rinisë Popullore si rrjedhim i Plenumit VIII të Partisë.

7. — Komiteti Qendror i Partisë konsideron si pengesë për mobilizimin e gjerë të masave të rinisë në vijën e Partisë, ekzistencën e dy organizatave të rinisë. Në periudhën e luftës dhe në kohët e para të çlirimit grumbullimi i rinisë në dy organizata, në atë të Rinisë Komuniste dhe në atë të BRASH, ishte i nevojshëm sepse në këtë mënyrë u arrit më lehtë mobilizimi i rinisë. Por në periudhën e ndërtimit të vendit tonë, kur Partia, duke plotësuar detyrat e reja historike, drejton luftën për ndërtimin e bazave të socializmit, kur lufta e klasave vazhdon të zhvillohet e ashpër, kur për Partinë shtrohet si problem i dorës së parë grumbullimi i masave të gjera punonjëse të vendit tonë, duhet të ekzistojë vetëm një organizatë e rinisë, e cila të grumbullojë në radhët e saja të rinjtë dhe të rejat punonjëse të vendit tonë. Vetë eksperiencia e deritanishme ka provuar në praktikë se dy organizata të rinisë kanë penguar mobilizimin e gjerë të saj dhe se në to ka ekzistuar një formalizëm i theksuar. Duhet theksuar se trockistët e klikës së Titos dhe agjenti i tyre Koçi Xoxe qysh shumë kohë më parë janë treguar kundër unifikimit të dy organizatave të rinisë. Ata kërkonin shkrirjen e Rinisë Komuniste, likuidimin e saj të plotë dhe, nga ana tjetër, ekzistencën e një organizate amorge të rinisë. Një gjë e tillë në fakt do të thoshte të mos kishte një organizatë të rinisë, të mos grumbullohej dhe të aktivizohej rinia jonë heroike, të mos krijoheshin mundësi për edukimin e saj. Kjo do të thoshte, nga ana tjetër, t'i shkëputje Partisë, rininë, gjakun e saj të ri, burimin e kuadrove të saj të rinj.

Demaskimi i klikës së Titos, zbulimi i punës tradhëtare të Koçi Xoxes me shokë brenda Partisë sonë, i dha mundësi Partisë sonë që të vendosë për unifikimin e dy organizatave të rinisë sonë drejt e në bazë të mësimëve të marksizëm-leninizmit.

Partia jonë i ka parasysh mirë mësimet e klasikëve të marksizëm-leninizmit për rëndësinë e madhe që ka puna me rininë. Lenini ka thënë:

«Ne jemi partia e së ardhshmes, dhe e ardhshmeja i takon rinisë. Ne jemi partia e novatorëve, dhe rinia shkon kurdoherë më me qejf pas novatorëve. Ne jemi partia e luftës plot vetëmohim kundër kalbësirës së vjetër, dhe rinia hidhet kurdoherë e para në luftën plot vetëmohim»¹.

Duke çmuar rëndësinë e këtij problemi, Kongresi I i Partisë sonë mori vendimin që

«Rinia Komuniste dhe Rinia Popullore të shkrihen në një organizatë të vetme të rinisë, e cila do të jetë nën drejtimin direkt të Partisë së Punës dhe do të ndihmojë Partinë për edukimin e rinisë në frymën e socializmit, do të jetë rezervë dhe ndihmësja e Partisë»².

Konditat nëpër të cilat kalon vendi ynë, lufta për ndërtimin e bazave të socializmit vënë përpara Partisë si imediate detyrën e krijimit të një organizate të vetme të rinisë. Entuziazmi i rinisë, inisiativa e saj krijuese, dinamizmi dhe vullneti që ajo ka e bëjnë rininë një faktor shumë të rëndësishëm të luftës për socializmin, e bëjnë atë një ndihmëse të vërtetë të Partisë për mobilizimin e masave të gjera të rinisë dhe për mobilizimin moralo-politik dhe kultural të masave punonjëse të vendit rreth Partisë sonë të Punës. Një organizatë unike e rinisë do të thotë një koncentrim i të gjitha forcave të rinisë për një qëllim të vetëm, do të thotë një organizim më i shëndoshë i rinisë dhe një mobilizim shumë më i gjerë i saj. Një organizatë unike revolucionare e rinisë do të ketë kujdesin e vazhdueshëm të Partisë, ajo do të edukohet nga Partia, anëtarët e saj do të përgatiten si bij besnikë dhe të denjë të popullit dhe të Partisë sonë.

8. — Duke marrë parasysh sa më sipër Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë mendon se duhet të procedohet sa më parë për unifikimin e organizatave të Rinisë Komuniste dhe të Rinisë Popullore. KQ i PPSH mendon se organizata unike e

1 V. I. Lenin. Veprat, vëll. 11, f. 409.

2 «Dokumenta Kryesore të PPSH». Vëll. 1, bot. i dytë, f. 567.

rinisë, që do të krijohet në fabrika, në fshatra, në shkolla dhe në Ushtrinë Kombëtare, do të sjellë si rezultat një mobilizim më të gjerë të forcave të rinisë, nën udhëheqjen e Partisë, për kryerjen e detyrave të rëndësishme që ka përpara.

9. — Organizata unike e rinisë do të jetë organizata revolucionare masive e të rinjve punonjës të qytetit dhe të fshatit, ajo do të përfshijë në radhët e saja të gjithë ata të rinj dhe të reja që kanë dhënë dhe japin prova se duan të luftojnë sinqerisht për ndërtimin e socializmit. E bazuar mbi principin e luftës së klasave, e udhëhequr nga Partia e Punës e Shqipërisë, organizata unike e rinisë do të edukohet sipas mësimëve të Marksit-Engelsit-Leninist dhe Stalinit.

Organizata unike e rinisë do të jetë një ndihmëse besnike e Partisë. Ajo do të punojë për të përhapur influencën e Partisë në të gjitha masat e rinisë sonë si dhe në ato të popullit tonë. Ajo do të ketë kurdoherë parasysh mësimet e të madhit Stalin kur flet për bashkimin e rinisë:

«Ajo është një organizatë masash e rinisë punëtore dhe fshatare, një organizatë jo partie, por që qëndron pranë partisë. Ajo ka për detyrë të ndihmojë partinë në veprën e edukimit të brezit të ri me frymën e socializmit. Ajo jep rezervë të reja për të gjitha organizatat e tjera të masave të proletariatit në të gjitha fushat e administrimit»¹.

Organizata unike e rinisë do të ketë statutin dhe programin e saj të veçantë, i cili do të bazohet në parimet marksiste-leniniste dhe do të mbështetet në eksperiencën e madhe dhe në shembullin e komsomolit të Lenin-Stalinit. . .

Organizata e rinisë do të ngrihet mbi principin e centralizmit demokratik. Do të bëhen zgjedhjet demokratike dhe do të respektohet demokracia e brendshme në organizatë. Pranimi në organizatë do të bëhet individualisht.

Organizata unike e rinisë do të jetë solidare me lëvizjen demokratike të rinisë botërore; ajo do të jetë anëtare efektive e FBRD, në radhët e së cilës, së bashku me të gjitha rinitë përparimtare të botës, me në krye rinitë heroike të Bashkimit Sovjetik, do të luftojë për paqen, demokracinë dhe një të ardhshme më të mirë.

10. — Organizata unike e rinisë do të ketë si detyrë kryesore edukimin e masave të gjera të rinisë dhe mobilizimin e tyre në luftën që zhvillojnë masat punonjëse të vendit tonë nën udhëheqjen e Partisë, për forcimin dhe konsolidimin e demokracisë

1 J. V. Stalin. Veprat, vëll. 8, f. 34.

sonë popullore dhe për ndërtimin e bazave të socializmit në vendin tonë.

Për këtë organizata unike e rinisë duhet:

a) Të edukojë rinitë sipas traditave të saja revolucionare të formuara gjatë Luftës nacional-çlirimtare nën drejtimin e Partisë dhe të organizatorëve të saj Qemal Stafa, Nako Spiru, Misto Mame, Alqi Kondi. Të edukojë rinitë me dashuri të pakufi për kauzën e popullit punonjës, për Partinë e tij të lavdishme, organizatoren dhe udhëheqësen e të gjitha fitoreve të popullit tonë, për shokun Enver Hoxha, mësuesin dhe mikun e saj më të dashur.

b) Të zhvillojë në rini një dashuri të pakufishme për Bashkimin Sovjetik dhe për shokun Stalin, udhëheqësin e gjithë njerëzimit përparimtar, mbrojtësin dhe mikun e shtrenjtë të popullit tonë. Nëpërmjet të dashurisë për Bashkimin Sovjetik dhe për rinitë e tij heroike, për komsomolin e Lenin-Stalinit, duhet të zhvillohet dhe të forcohet fryma patriotike dhe internacionaliste në masat e rinisë sonë.

c) Rinia jonë duhet t'i ruajë të gjalla dhe t'i zhvillojë traditat e saja të internacionalizmit proletar. Ajo duhet të edukohet vazhdimisht me dashurinë për të gjithë popujt, për të gjithë rinitë e vendeve të ndryshme që luftojnë për paqen dhe demokracinë në botë, për të gjithë ata që luftojnë për liri dhe pavarësi kundër imperialistëve kolonizatorë dhe veglave të tyre. Të shtohet edhe më shumë urrejtja për armiqët e paqes dhe të socializmit, për luftëdashësit imperialistë amerikano-anglezë dhe satelitët e tyre, për grupin trockist të Titos, armiq të kampit unik të socializmit.

ç) Në rinitë tonë duhet shtuar përditë e më tepër vigjilencë revolucionare për të mbrojtur atdheun tonë, lirinë dhe të ardhshmen tonë nga çdo armik. Ajo duhet të shtojë urrejtjen dhe të luftojë kundër armiqve të brendshëm, kundër agjentëve imperialistë dhe trockistë, kundër kulakëve dhe borgjezisë reaksionare, armiq të betuar të popullit punonjës, të së ardhshmes së rinisë sonë dhe të ndërtimit të socializmit në vendin tonë.

d) Të tregohet një kujdes më i madh për edukimin ideopolitik të rinisë me parimet e marksizëm-leninizmit. Kjo do të thotë të orientohet rinia drejt njohjes së realitetit politik të vendit tonë, drejt konditave në të cilat zhvillohet lufta për ndërtimin e socializmit, t'i sqarohen perspektivat e zhvillimit të vendit tonë dhe të pajiset krahas kësaj pune politike, me armën e shëndoshë të ideologjisë marksiste-leniniste.

dh) Të organizohet një punë e gjerë për edukimin kultural të rinisë dhe për të luftuar paragjykimet, bestytnitë dhe zakonet prapanike. Prapambetja kulturele, paragjykimet e ndryshme dhe analfabetizmi në rini, të trashëguar nga e kaluara, pengojnë për-

parimin e rinisë, nuk e lejojnë këtë që të kryejë më së miri detyrat e saja. Lenini i madh ka thënë:

«...se në një vend analfabetësh nuk mund të ndërtohet shoqëria komuniste»¹.

e) Duke marrë parasysh se për edukimin e rinisë një rol të dorës së parë luajnë shkollat, t'i jepet rëndësi organizimit të punës në shkollat e mesme e fillore në mënyrë që të nxiten nxënësit për të mësuar sa më mirë dhe për të përvetësuar mësimet, të jenë të disiplinuar dhe të pregatitur nga ana kulturale e politike, të aftë për t'i shërbyer sa më mirë popullit. Të bëhet një punë e madhe me fëmijët, sidomos në fshat me qëllim që të realizohet plotësisht ligji i detyrimit shkollor. Duhet t'i jepet rëndësi e madhe organizimit dhe frekuentimit të shkollave të natës për rininë punëtore dhe fshatare.

f) Të marrë pjesë aktive në zgjidhjen e detyrave të rëndësishme që i dalin Partisë, shtetit dhe sindikatave në lidhje me edukimin politik, kultural, profesional dhe teknik të rinisë dhe të masave punonjëse të vendit tonë. Detyrat e mëdha të ndërtimit të vendit vënë përpara nevojën e kuadrove të mësuar, teknike që t'i zgjidhin këto detyra. Shoku Stalin duke i folur komsomolit në Kongresin VIII të tij këshillon:

«Të zotërojmë shkencën, të farkëtojmë kuadro të reja bolshevikësh specialistë në të gjitha degët e dijes, të mësojmë, të mësojmë, të mësojmë me këmbënguljen më të madhe, — kjo është sot detyra jonë.

Rinia revolucionare të marshojë në masë drejt shkencës, — ja çfarë na duhet sot shokë»².

Krahas me këtë punë t'i kushtohet një kujdes i veçantë edukimit fizik të rinisë dhe dëfrimit të saj. Rinia duhet të pregatitet e fortë fizikisht e moralisht për ndërtimin e Shqipërisë dhe mbrojtjen e pavarësisë e të lirisë së popullit tonë.

11. — Për plotësimin e detyrave në lidhje me konsolidimin e demokracisë popullore dhe ndërtimin e bazave të socializmit, organizata unike e rinisë duhet të mobilizojë gjithë rininë e Shqipërisë për realizimin dhe tejkalimin e planit të shtetit, duke e inkurajuar dhe nxitur atë për shtimin sa më të madh të prodhimit, për ngritjen e cilësisë në prodhim, duke qëndruar në ballë të përpjekjeve për ruajtjen e pasurisë shtetërore dhe të pronës kolek-

1 V. I. Lenin. Veprat, vëll. 31, f. 331.

2 J. V. Stalin. Veprat, vëll. 11, f. 77.

tive, duke luftuar për uljen e kostos së prodhimit, duke e aktivizuar në aksione të ndryshme vullnetare dhe duke zhvilluar garat dhe emulacionin socialist në punë.

Pushteti i popullit i ka siguruar rinisë të drejta të barabarta dhe me ligj i janë siguruar asaj kondita të përshtatshme pune dhe jete. Rinia duhet të jetë në ballë të luftës për realizimin e planit të shtetit, sepse kështu do të ndërtojë të ardhshmen e saj, sepse kështu përmirëson jetën e saj. Lëvizja sulmuese, zhvillimi i së cilës duhet inkurajuar sa më shumë, duhet të gjejë shprehjen e saj të plotë në masat e rinisë punëtore. Lenini duke i folur komsomolit në Kongresin III të tij ka thënë:

«Bashkimi i Rinisë Komuniste duhet të jetë një grup sulmues i cili në çdo punë jep ndihmën e vet, tregon iniciativën dhe vrullin e vet»¹.

Organizata unike e rinisë duhet të bëhet shkollë e ndërtuesve të rinj të socializmit. Ajo duhet të edukojë të riun punëtor, të riun e fshatit dhe atë të shkollës që ta dojë punën dhe pronën kolektive. Duhet të edukojë punëtorët e rinj që të jenë të disiplinuar dhe të ndërgjegjshëm në punë. Në prodhim, në punë e sipër, në këtë luftë të madhe për realizimin e planit duhet të dalin dhe të provohen kuadrot e rinisë. Anëtarët më të mirë të organizatës, patriotët më të vendosur të jenë ata që prodhojnë më shumë e më mirë, që mësojnë më mirë, që kryejnë me ndërgjegje e ndershmërisht detyrat e tyre kudo që jetojnë dhe punojnë në qendra pune, në fshat, në shkollë, në zyra e në Ushtrinë Kombëtare.

Të punohet me rininë punëtore të vendit tonë për të ngritur entuziazmin e saj, për ta bërë atë inisiatoren e lëvizjes sulmuese në çdo qendër pune. Organizata unike e rinisë duhet të kujdeset për respektimin e ligjeve të shtetit, që i sigurojnë rinisë sonë punëtore një sërë të drejtash dhe, nga ana tjetër, t'i propozojë Partisë e organeve shtetërore masat konkrete që duhen marrë në lidhje me jetën dhe mësimin e saj.

Rinia fshatare të mobilizohet për të realizuar prodhime sa më të larta për përmirësimin e punës në fshat, për futjen e metodave të reja agroteknike në bujqësi. Rinia në fshat duhet të bëhet mbështetje e shëndoshë për këshillat popullore dhe të jetë organizatore e shquar dhe ndihmëse besnike e Partisë për ngritjen kulturele dhe politike të masave fshatare.

12. — Organizata unike e rinisë në Ushtrinë Kombëtare duhet të jetë ndihmëse aktive e Partisë dhe e komandave në reparte. Ajo duhet të punojë për edukimin e patriotëve të rinj në repart,

1 V. I. Lenin. Veprat, vëll. 31, f. 332.

për përgatitjen e ushtarëve trima dhe besnikë të popullit e të Republikës sonë dhe për ngritjen e cilësive të tyre luftarake. Anëtarët e organizatës së rinisë duhet të jenë shembull për të gjithë ushtarët në stërvitje dhe në përvetësimin e ar'it ushtarak, në disiplinë dhe në rregull. Ata duhet të nxitin të gjithë masën duke dhënë të parët shembullin për kryerjen e urdhërave dhe të udhëzimeve të komandave dhe të rregulloreve ushtarake. Të rinjtë në ushtri të jenë në krye të jetës kulturele, fiskulturale dhe artistike në reparte.

13. — Organizata unike e rinisë duhet t'i kushtojë një kujdes të veçantë punës me të rejat. Duhet të punohet në mënyrë që të rejat dhe sidomos ato të fshatit të tërhiqen më shumë në punët e organizatës dhe në prodhim.

14. — Organizata unike e rinisë duhet t'i kushtojë kujdes të veçantë organizimit më të mirë të punës me pionierët dhe sidomos edukimit të tyre. T'i kushtohet kujdes caktimit të kuadrove më të mirë për punën me pionierët dhe të krijohen konditat materiale për edukimin dhe dëfrimin e fëmijëve. Organizata e rinisë të ketë parasysh që t'i edukojë pionierët sipas parimeve shkencore të ideologjisë e të pedagogjisë marksiste.

15. — Organizata unike e rinisë duhet të ketë shtypin e saj të veçantë. Duhet të punohet edhe më shumë që të përmirësohet përmbajtja ideo-politike dhe kulturele e shtypit. Nga ana tjetër shtypi duhet të lidhet më mirë me problemet e organizatës dhe me vetë jetën e rinisë.

16. — Komiteti Qendror i Partisë konsideron se është e nevojshme të zhvillohet një punë e gjerë politike në radhët e rinisë për të realizuar me sukses unifikimin e të dy organizatave dhe krijimin e organizatës unike të rinisë.

Organizatata e Partisë duhet të tregojnë gjithë kujdesin e tyre për kryerjen sa më mirë të këtij aksioni kaq të rëndësishëm në jetën e rinisë dhe të vendit tonë, për forcimin e organizatës unike të rinisë dhe për mobilizimin e të gjitha masave të rinisë në kryerjen me sukses të detyrave që u cakton Partia.

Komiteti Qendror i PPSH porositi që kjo rezolutë të punohet në të gjitha organizatat e Partisë dhe të rinisë në mënyrë që këto të jenë të qarta mbi problemin e rinisë dhe të mundin kështu të ndihmojnë aktivisht në krijimin e organizatës së vetme të rinisë.

KOMITETI QENDROR I PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË

Botohet sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 139 (211), 11 qershor 1949

LETËR E BYROSË POLITIKE TË KQ TË PPSH DËRGUAR ORGANIZATAVE TË PARTISË NË LIDHJE ME GABIMET E VËRTETUARA NË ORGANIZATËN E PARTISË TË RRETHIT TË LUSHNJËS

23 korrik 1949

MBI PUNËN E SËMURË NË ORGANIZATËN E LUSHNJËS

Organizata e Lushnjës është një organizatë me kuadro të rinj dhe të ulët ideologjikisht. Një pjesë e mirë e anëtarëve të kësaj organizate janë pranuar në Parti gjatë viteve 1945-1949. Një tjetër karakteristikë është se organizata e Partisë në qytet dominon organizatën e fshatit. Numri i anëtarëve të organizatës është gati i ndarë si vijon: 50 për qind e anëtarëve bëjnë pjesë në organizatën e qytetit dhe gjysma tjetër janë në fshat. Lushnja dhe rrethi i saj, sikundër dihet, është një vend bujqësor dhe i mungon krejt industria, goftë kjo e përfaqësuar nga ndonjë fabrikë e vogël. Artizanati është shumë pak i zhvilluar. Prandaj duke marrë parasysh këtë fakt, ka qenë gabim që janë pranuar në fillim më shumë nga qyteti dhe nuk është bërë shpërndarja e drejtë e forcave të Partisë duke lënë, siç thamë, 50 për qind të komunistëve në qytet dhe 50 për qind në fshat. Organizata e Partisë, në një periudhë relativisht të shkurtër, është zgjeruar jashtëzakonisht shumë; proporcioni midis kandidatëve dhe anëtarëve nuk është i drejtë, ka më shumë kandidatë se sa anëtarë. Pranimi në Parti s'është bërë i studjuar dhe në baza të shëndosha. Organizata, sidomos ajo e qytetit, është zgjeruar mjaft me elementë jo të shëndoshë. Janë futur në Parti elementë me qëndrim jo të shëndoshë gjatë luftës, me origjinë agai e kulaku, intelektualë të sëmurë, ambiciozë dhe kritizerë, elementë pretenciozë, që dëshirojnë të përfitojnë duke ekzagjeruar meritat e tyre të luftës, me qëllim që të nxjerrin këtej nga një anë përfitime personale dhe nga ana tjetër të mbytin elementin e ri dhe të shëndoshë të Partisë, që po ngrihet dhe po rritet në luftë për ndërtimin e vendit tonë. Të tillë elementë me origjinë borgjeze dhe mikroborgjeze, të futur në or-

për përgatitjen e ushtarëve trima dhe besnikë të popullit e të Republikës sonë dhe për ngritjen e cilësive të tyre luftarake. Anëtarët e organizatës së rinisë duhet të jenë shembull për të gjithë ushtarët në stërvitje dhe në përvetësimin e ar'it ushtarak, në disiplinë dhe në rregull. Ata duhet të nxitin të gjithë masën duke dhënë të parët shembullin për kryerjen e urdhërave dhe të udhëzimeve të komandave dhe të rregulloreve ushtarake. Të rinjtë në ushtri të jenë në krye të jetës kulturele, fiskulturale dhe artistike në reparte.

13. — Organizata unike e rinisë duhet t'i kushtojë një kujdes të veçantë punës me të rejat. Duhet të punohet në mënyrë që të rejat dhe sidomos ato të fshatit të tërhiqen më shumë në punët e organizatës dhe në prodhim.

14. — Organizata unike e rinisë duhet t'i kushtojë kujdes të veçantë organizimit më të mirë të punës me pionierët dhe sidomos edukimit të tyre. T'i kushtohet kujdes caktimit të kuadrove më të mirë për punën me pionierët dhe të krijohen konditat materiale për edukimin dhe dëfrimin e fëmijëve. Organizata e rinisë të ketë parasysh që t'i edukojë pionierët sipas parimeve shkencore të ideologjisë e të pedagogjisë marksiste.

15. — Organizata unike e rinisë duhet të ketë shtypin e saj të veçantë. Duhet të punohet edhe më shumë që të përmirësohet përmbajtja ideo-politike dhe kulturele e shtypit. Nga ana tjetër shtypi duhet të lidhet më mirë me problemet e organizatës dhe me vetë jetën e rinisë.

16. — Komiteti Qendror i Partisë konsideron se është e nevojshme të zhvillohet një punë e gjerë politike në radhët e rinisë për të realizuar me sukses unifikimin e të dy organizatave dhe krijimin e organizatës unike të rinisë.

Organizatave të Partisë duhet të tregojnë gjithë kujdesin e tyre për kryerjen sa më mirë të këtij aksioni kaq të rëndësishëm në jetën e rinisë dhe të vendit tonë, për forcimin e organizatës unike të rinisë dhe për mobilizimin e të gjitha masave të rinisë në kryerjen me sukses të detyrave që u cakton Partia.

Komiteti Qendror i PPSH porositi që kjo rezolutë të punohet në të gjitha organizatat e Partisë dhe të rinisë në mënyrë që këto të jenë të qarta mbi problemin e rinisë dhe të mundin kështu të ndihmojnë aktivisht në krijimin e organizatës së vetme të rinisë.

KOMITETI QENDROR I PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË

Botohet sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 139 (211), 11 qershor 1949

LETËR E BYROSË POLITIKE TË KQ TË PPSH DËRGUAR ORGANIZATAVE TË PARTISË NË LIDHJE ME GABIMET E VËRTETUARA NË ORGANIZATËN E PARTISË TË RRETHIT TË LUSHNJËS

23 korrik 1949

MBI PUNËN E SËMURË NË ORGANIZATËN E LUSHNJËS

Organizata e Lushnjës është një organizatë me kuadro të rinj dhe të ulët ideologjikisht. Një pjesë e mirë e anëtarëve të kësaj organizate janë pranuar në Parti gjatë viteve 1945-1949. Një tjetër karakteristikë është se organizata e Partisë në qytet dominon organizatën e fshatit. Numri i anëtarëve të organizatës është gati i ndarë si vijon: 50 për qind e anëtarëve bëjnë pjesë në organizatën e qytetit dhe gjysma tjetër janë në fshat. Lushnja dhe rrethi i saj, sikundër dihet, është një vend bujqësor dhe i mungon krejt industria, qoftë kjo e përfaqësuar nga ndonjë fabrikë e vogël. Artizanati është shumë pak i zhvilluar. Prandaj duke marrë parasysh këtë fakt, ka qenë gabim që janë pranuar në fillim më shumë nga qyteti dhe nuk është bërë shpërndarja e drejtë e forcave të Partisë duke lënë, siç thamë, 50 për qind të komunistëve në qytet dhe 50 për qind në fshat. Organizata e Partisë, në një periudhë relativisht të shkurtër, është zgjeruar jashtëzakonisht shumë; proporcioni midis kandidatëve dhe anëtarëve nuk është i drejtë, ka më shumë kandidatë se sa anëtarë. Pranimi në Parti s'është bërë i studjuar dhe në baza të shëndosha. Organizata, sidomos ajo e qytetit, është zgjeruar mjaft me elementë jo të shëndoshë. Janë futur në Parti elementë me qëndrim jo të shëndoshë gjatë luftës, me origjinë agai e kulaku, intelektualë të sëmurë, ambiciozë dhe kritizerë, elementë pretenciozë, që dëshirojnë të përfitojnë duke ekzagjeruar meritat e tyre të luftës, me qëllim që të nxjerrin këtej nga një anë përfitime personale dhe nga ana tjetër të mbytin elementin e ri dhe të shëndoshë të Partisë, që po ngrihet dhe po rritet në luftë për ndërtimin e vendit tonë. Të tillë elementë me origjinë borgjeze dhe mikroborgjeze, të futur në or-

ganizatën e qytetit të Lushnjës dhe sidomos në atë të pushtetit, janë bërë një pengesë në zhvillimin normal të Partisë, në zbatimin e drejtë të vijës, në zhvillimin e drejtë të punës së Partisë dhe të pushtetit në fshat.

Lushnja është një rreth bujqësor; duke qenë kështu, Partia duhej të mbështetej fuqimisht në elementin fshatar të varfër dhe të mesëm, i cili, në bazë të fitores së pushtetit popullor dhe të reformës agrare, u çlirua dhe mori tokën. Kjo nuk është bërë si duhet dhe këtë e provon shtrirja e dobët e organizatës së Partisë në fshat si dhe kompozicioni i udhëheqjes në këtë organizatë. Këtë ka rrjedhur që nuk është zhvilluar një punë organizative e shëndoshë dhe një punë politike e zgjeruar. Në këto drejtime kanë gabuar një pjesë e udhëheqësve të ndryshëm të kësaj organizate dhe njëkohësisht KQ nuk ka pasur kontrollin e duhur mbi zhvillimin e kësaj organizate. Drejtuesit e ndryshëm kryesorë të kësaj organizate, me të meta dhe me gabime, që rrjedhin nga mbeturinat mikroborgjeze, nga mungesa e një lufte nga ana e tyre për zhdukjen e këtyre të metave me anën e kritikës dhe të autokritikës, nga niveli i ulët ideologjik i tyre, nga ambiciet e sëmura, s'kanë pasur perspektiva të qarta, kanë bërë gabime, të cilat s'i kanë njohur dhe s'i kanë korrigjuar, kanë ecur në rrugë të gabuar, kanë qenë të lëkundur e të influencuar shumë herë nga njerëz me interesa të kundërt me ato të Partisë dhe kanë neglizhuar luftën e klasave. Praktikisht, në të gjitha këto situata të vështira nga ku ka kaluar Partia, borgjezia nuk ka fjetur dhe ka përfutur nga shkujdesia e udhëheqjes së organizatës.

Presioni i borgjezisë ka qenë i vazhdueshëm mbi disa elementë në udhëheqje, të cilët e kanë pranuar këtë dhe kanë punuar nën këtë presion dëmprurës. Kjo situatë do të mund të luftohej në rast se këta elementë nuk do të fshihnin gabimet e tyre, në rast se do të zhvisheshin nga mbeturinat e moralit borgjez dhe në rast se do të mbështeteshin në vijën e drejtë të Partisë dhe në elementin e shëndoshë të fshatarësisë së varfër e të mesme. Organizata e Lushnjës është drejtuar nga këta shokë me frymë tarafi e jo nga shokë me frymë revolucionare dhe në vijën e drejtë të Partisë. Kjo punë tarafi, që ekzistonte në kryet e organizatës, kishte molepsur dhe një sërë shokësh, sidomos në organizatën e qytetit dhe të pushtetit. Disa shokë të sëmurë çështjen e Partisë e lidhnin me disa persona në udhëheqje. Kjo rridhte, pse këta njerëz të sëmurë dhe karrieristë, e shikonin Partinë si një grup, që mund të fshihte të metat dhe gabimet e tyre, që do t'u kënaqtë ambiciet e tyre dhe do t'i lejonte të manevronin duke e thyer vijën politike dhe organizative të Partisë. Rruga që ndiqnin këta njerëz, do t'i çonte në armiqësi me Partinë.

Armiku i klasës dhe i Partisë, duke bërë presion direkt ose

indirekt në këta elementë të sëmurë, ishte mjaft i interesuar që kjo sëmundje në udhëheqjen e organizatës së Lushnjës, të thellohej dhe të forconte kështu pozitat e tija në këtë rreth, brenda në Parti dhe në radhë të parë në udhëheqje.

Qëllimi i borgjezisë është reflektuar në këta drejtues të organizatës së Lushnjës në çështjen: kush të ketë pushtetin në dorë. Borgjezia e këtij rrethi, si e gjithë borgjezia armike e vendit, jo në gjendje të organizuar, ka për qëllim rrëzimin e pushtetit dhe shndërrimin e Partisë në një parti mbrojtëse të borgjezisë e të kulakëve. Por ajo e sheh se marrja e pushtetit në duart e veta është krejtësisht e pamundur, por me pasë njerëzit e saj në pushtet dhe në Parti për t'i minuar këto nga brenda, kjo i është e mundur, në rast se Partia vihet në gjumë. Elementi i sëmurë në udhëheqjen e kësaj organizate ka shikuar kurdoherë në objektivin e marrjes së postit kryesor në udhëheqjen e Partisë dhe që andej të kishte nën kontrollin e vet Partinë dhe pushtetin. Partia dhe pushteti kësajsoj të shndërroheshin në një detachment partizan, nën drejtimin e disa ambiciozëve, që me siguri do të kalonin në rrugën antiparti.

Pra, në gjirin e organizatës së Lushnjës prej një kohe ekzistonte një antagonizëm në udhëheqje, zhvillohej një punë personale e tarafi dhe me veprime antiparti; në këtë organizatë, ku influenza e borgjezisë ka qenë e paevitueshme, u formuan dy tarafe shokësh. Shokët që s'ndjekin vijën e Partisë, që nuk i shohin çështjet në prizmin dhe në interesin e Partisë, që nuk e mbrojnë Partinë, që nuk e mbështetin dhe nuk e fuqizojnë Partinë me elementin e shëndoshë punëtor, fshatar dhe intelektual të ndershëm, patriot e pa njolla, ata, pa asnjë dyshim, bien në pozitat e borgjezisë dhe pranojnë ligjin e saj.

Klasa armike ka menduar se duhej të përkrahte një prej këtyre tarafeve, të krijuara në gjirin e organizatës dhe do të përkrahte atë anë, që tregojë liberale dhe oportuniste ndaj saj.

Në organizatën e Lushnjës ka pasur një punë tarafi shumë të theksuar dhe të dëmshme, që po të mos ishte diktuar me kohë nga Komiteti Qendror, mund të degjeneronte në forma më të rrezikshme për Partinë.

Një nga këto tarafe ka pasur si figurë në krye Hasan Ginën dhe ishte tarafi më i rrezikshëm. Prapa Hasan Ginës ka një sërë shokësh të pakënaqur, disa të goditur padrejtësisht nga puna armiqësore e trockistëve, por që pas Plenumit XI nuk e shikuan kthesën në rrugën dhe në vijën e Partisë. Me metoda jo të drejta dhe me pikëpamje politike jo të qarta, ata kujtuan se «rruga e drejtë» ishte hakmarrja, mbivlerësimi i meritave të tyre jashtë çdo mase dhe shumë herë i falsifikuar. Ky shikim i çështjeve nën këtë prizëm nga këta shokë ishte i rrezikshëm dhe do të bënte

që këta të gabonin më vonë. Në këtë grup ka pasur shokë ambiciozë, arrivistë, njerëz me të kaluar jo të pastër dhe me origjinë jo të shtresës.

Në mes të këtij grupi shokësh të sëmurë, ai më i sëmuri, i cili ka vepruar vazhdimisht (me gjithë këshillimet e KQ) për keqësimin e situatës, ka qenë Halit Ahmeti.

Tarafi i dytë, i cili nuk ka pasur një figurë në krye, por që përpiquej të krijonte një të tillë (prandaj u përpoq të fshihej pas ish-sekretarit të parë të organizatës, i cili nuk del i implikuar në këtë grup), formohej prej shokësh që kishin bërë gabime para Plenumit XI, që ishin goditur për gabimet e tyre dhe që ishin lidhur me njëri-tjetrin me familjaritet të sëmurë dhe si të solidarizuar në «fatkeqësinë» që u ngjau. Ky ishte në opozicion me tarafin e Hasan Ginës, në rrugë jo të drejtë dhe shumë herë të paprincipitë e jo në baza të shëndosha.

Me këto metoda të sëmura luftonin midis tyre këto dy palë tarafe: tarafi i parë, i Hasan Ginës, për t'i eliminuar krejtësisht këta shokë dhe për të pasur vetë në duar drejtimin e Partisë dhe të pushtetit dhe tarafi i dytë për t'u mbrojtur.

Sekretari i parë i Partisë së rrethit nga ana e tij, megjithëse nuk ka qenë i implikuar në këtë luftë të paprincipitë në mes këtyre shokëve, ai s'ka ditur të diktojë këtë punë të dëmshme që ekzistonte dhe s'ka vënë në dijeni KQ për këtë çështje. Ai, si sekretar politik i kësaj organizate, nuk ka ditur ta frenojë dhe ta shërojë këtë situatë.

Tarafi i Hasan Ginës ka pasur për qëllim të vinte në udhëheqje ose të qëndronte në udhëheqje me çdo kusht dhe me mënyra dhe metoda të gabuara dhe të dënueshme nga parimet e Partisë, në kundërshtim me urdhërat dhe qarkoret e KQ dhe me forma e me metoda që binin erë frymë borgjeze. Lufta e këtij tarafi zhvillohej gjoja në format e sipërme kundër sekretarit të parë të Partisë për Lushnjën kur ky ishte emëruar tok me një byro provizore nga KQ deri në zgjedhjet e reja, gjoja pse ky kishte gabuar në të kaluarën, sikur gabimet e Hasan Ginës dhe të shokëve të tjerë të këtij grupi nuk ishin po ato të sekretarit të parë për mos me thënë më të rënda.

Shoku Hasan Gina ka rënë në këtë terren të kalbur dhe ka gabuar. Njëkohësisht shumë elementë të sëmurë kanë influencuar te ai dhe kanë vepruar në dëm të Partisë duke u fshehur dhe duke u mbështetur nga shoku Hasan Gina. Këta kanë ditur të përfitojnë nga fryma e ambicies që ekziston te Hasan Gina, nga një shikim jo i shëndoshë i kapaciteteve të tij, nga liberalizmi dhe butësia e tij dhe e kanë nxjerrë përpara Hasan Ginën. Këta elementë, direkt ose indirekt, i kanë sjellë Hasan Ginës pikëpamjet dhe frymën e borgjezisë për veprim dhe ky ka vepruar,

disa herë me ndërgegjeje, disa herë në mënyrë inkoshiente në rrugë të gabuar. Një nga elementët më të dëmshëm, që ka influencuar Hasan Ginën, ka qenë Halit Ahmeti.

Shoku Hasan Gina, i shtyrë nga ambicia personale, nga miqësitë e sëmura, nga gjykimet jo të shëndosha dhe të thella mbi situatat e krijuara dhe mbi shokët, ka humbur rrugën, ka harruar rregullat dhe vijën e Partisë, ka harruar luftën që zhvillon Partia kundër kulakëve dhe borgjezisë armike të qytetit dhe të fshatit.

Një punë e tillë e sëmurë në organizatën e Lushnjës e ka burimin që para Plenumit XI. Duke marrë parasysh përbërjen sociale të gjithë rrethit të Lushnjës, borgjezia armike do të përpiquej që aksionet e saj të mbështeteshin nga elementi i lëkundshëm dhe i butë i Partisë e i pushtetit dhe, natyrisht, nga elementët e tillë të qytetit, të cilët, përveç të metave të klasës, që ekzistojnë në ta, nuk kishin kaluar në fazat e ashpra të luftës dhe tamam në këto faza ata s'kishin mundur të rezistonin, kush më shumë dhe kush më pak. Një gjë e tillë shkaktoi mungesë vigjilence dhe mosvazhdimësi në konsolidimin e Partisë dhe të pushtetit. Këta u treguan liberalë dhe të influencuar nga rrethe të ndryshme mikroborgjeze, pranonin lehtësisht influencën direkte ose indirekte të shtresave të larta, të goditura nga lufta dhe nga reformat e pushtetit. Lufta e klasës, pra, nuk u ashpërsua. Në ndarjen e tokës fshatarëve të varfër dhe të mesëm, u bënë gabime në dëmin e këtyre; fshatarët që morën tokën u kërcënuan prej kulakëve, bejlerëve dhe tregëtarëve fajdexhinj. Disa elementë, që influenconin udhëheqjen e Partisë dhe të pushtetit në rreth, nën flamurin e Frontit, përhapnin moskënaqësira dhe kërcënime të mbuluara dhe të tërthorta. Ekzistonin dhe përkraheshin në një situatë të tillë hatëret, favorizimet, nxiteshin intrigat e fshatit dhe politika në fshat bëhej në plan dhe në pozitë e këtyre thashethemeve dhe intrigave të vogla.

Nga ana tjetër fryma e sëmurë që ekzistonte në Parti, puna armiqësore e trockistëve jugosllavë dhe e Koçi Xoxës, reflektohej dhe vepronte edhe në këtë rreth duke favorizuar një mentalitet të tillë në udhëheqje. Veprime jo të drejta, të papeshuara mirë e arbitrare janë bërë nga disa udhëheqës të Partisë dhe të sigurimit. Një politikë e gabuar kuadri është zhvilluar dhe në këtë organizatë, ashtu si edhe në të tjerat. Njerëz të luftës janë përkrahur, pastaj janë goditur, janë favorizuar pastaj janë lënë pasdore. Kjo varej nga një informatë, nga një përshtypje, nga një mëri personale, nga intrigat që bënte njëri ose tjetri. Veprime të tilla që lindnin nga një situatë e tillë e sëmurë, përfundonin në vendime jo të drejta për kuadrin.

Pas Plenumit XI dhe pas Kongresit I u bënë të qarta veprimet e gabuara në vijë, u bë e qartë puna armiqësore e trockistëve

dhe konsekuencat e saja, gjithashtu u bë e qartë vija dhe taktika e Partisë për ndreqjen e këtyre gjërave. Por disa udhëheqës të organizatës së Lushnjës ishin larg nga kuptimi i drejtë i vijës së kongresit dhe taktikës që duhej ndjekur dhe zbatuar. Elementët e pakënaqur, që ndaj tyre ishin mbajtur qëndrime jo të drejta nga ana e drejtuesve të Partisë dhe të sigurimit, në këto momente spastrimi dhe shërimi të përgjithshëm, duke mos i njohur të metat e veta që ekzistonin dhe ekzistojnë akoma në ta e që s'bënë autokritikën e shëndoshë të punës së tyre, në mënyrë që të visheshin gështjet një herë e mirë në vendin e duhur, pse kështu do të dilnin edhe gabimet e të tjerëve, këta elementë vepruan në mënyrë jo të drejtë dhe jo në rrugë të Partisë. Ata menduan se kishte ardhur koha të hakmerreshin kundër elementit që kishte gabuar para Plenumit XI. Kjo kategori shokësh, ku bën pjesë Hasan Gina dhe Halit Ahmeti dolën si të persekutuar nga puna trockiste, morën bajrakun e luftës për «ndreqjen e gabimeve», që ishin vërtetuar, por ky bajrak nuk ishte në duar të shëndosha dhe sikundër u provua dhe më vonë, ky grup nuk ndoqi rrugën e caktuar nga kongresi, por u përpoq të vepronte në frymë tarafi, ambicie etj., që i dënon Partia.

Është e vërtetë se disa shokë drejtues të organizatës së Lushnjës dhe të sigurimit të atjeshëm kanë gabuar dhe duhej përpara masës së Partisë të bënin autokritikë të shëndoshë, pse kjo është e vetmja rrugë e shërimit të tyre. Këta shokë kanë marrë dënimin që kanë merituar, por këtyre duhej medoemos t'u jepej dora të ngriheshin dhe të ndihmoheshin. Gabimet e këtyre shokëve në tërësi nuk ishin krime të shëmtuara. Gabimet e tyre duhej të mateshin në masën e gabimeve të të gjithë asaj pune të gabuar që ishte vërtetuar para kongresit dhe të korrigjoheshin në bazë të orientimeve të drejta të kongresit. Kjo nuk u bë në organizatën e Lushnjës, bile u bë e kundërta. Kritika dhe autokritika ka qenë e dobët nga të gjithë. Njerëzit, që kishin gabuar, u goditën ashpërsisht, u diskredituan, saqë çdo njeri mund të mendonte «si mbahen në Parti këta njerëz që kanë bërë gjithë këto gjëra të paljueshme». Por u shkua edhe më tej. Nga pikëpamje të tilla të sëmura dhe sektare ndaj kuadrit, dalin dhe pikëpamjet oportuniste ndaj elementit të dobët dhe armikut të klasës. Këto janë si motër e vëlla.

Janë shtyrë direkt ose indirekt elementë të borgjezisë armike të kërkojnë hedhjen në gjyq të shokëve të sigurimit, pse ata i kishin konfiskuar çiften ndonjë beu, sipas urdhërit që kishin nga lart, ose të çonin në gjyq shokë komunistë, që kishin rrëzuar portat e bejlerëve etj. gjëra të tilla. U është bërë një luftë e shndershme dhe antiparti shokëve komunistë, që kishin bërë disa gabime, por që i kishin kuptuar këto gabime dhe që punonin me

të gjitha forcat për t'ja larë Partisë. Këta ishin hedhur në punë, zhvillonin aktivitet, por pikëpamja mbi këta shokë, që rehabilitoheshin, qëndronte po ajo e vjetra dhe si rezultat, vazhdohej të diskreditoheshin këta shokë.

Tarafi i Hasan Ginës, i Halit Ahmetit me shokë, duke dashur të djegë, duke i futur krejtësisht në rrugë jo të drejtë dhe aspak të shëndoshë shokët e rinj, që kishin bërë gabime, theu rregullat e Partisë, nuk ruajtë inspiracionin. Çdo gjë që zhvillohej në organizatat bazë, bëhej shkas muhabeti në popull dhe në konferenca. Nga njerëz të dyshimtë dhe armiq po mbaheshin nëpër gojë shokë komunistë për çka thuhej dhe vendosej për ta në celula e në komitete. Reaksioni po krijonte opinione për të ngritur në qiell një palë dhe për të futur në varr palën tjetër. Tarafi i Hasan Ginës ka pasur tendencë dhe ka vepruar, duke thyer çdo rregull organizativ, t'i sjellë shokët e organizatave bazë të ndryshme të gjykohen, të kritikohen në organizatën bazë të pushtetit të qytetit, ku ata kishin mbështetjen dhe që kjo organizatë paraqitej dhe paraqitet më e sëmura, pse ishte e përbërë në përgjithësi me elementë jo të shëndoshë dhe me plot të meta.

Tarafi i Hasan Ginës dhe i Halit Ahmetit me shokë gjatë gjithë kësaj periudhe kanë adoptuar një qëndrim oportunist ndaj borgjezisë së qytetit dhe të fshatit. Kjo u është ofruar shokëve të këtij grupi dhe është pritur jo keq prej tyre. Këta shokë kanë dëgjuar me kujdes ankimet e këtyre «shqerave të persekutuar nga komunistët», ju kanë dhënë shumë herë të drejtë, ju kanë dhënë të shpresojnë dhe të atakojnë njerëzit e Partisë. Shokë nga të këtij grupi kanë shkuar si pa të keq të përgëzojnë njerëz, që kishin dalë nga burgu, pse u ishte falur dënimi, pa gjykuar pak se këtyre elementëve armiq të dënuar u ishte falur me të vërtetë një pjesë e dënimit, por ata kanë qenë fajtorë. Një sërë veprimesh të tilla të gabuara, orientonin borgjezinë të shikonte në këtë grup një mbështetje për veprime më të guximshme kundër popullit, prandaj borgjezia e mbështeste me parulla e me propagandë veprimin e këtyre shokëve. Elementi i huaj i Partisë po merrte pjesë në këtë situatë, që zhvillohej dhe influenconte brenda në njerëzit e Partisë, pra, në veprimet e saj.

Në veprimtarinë e tarafit të Hasan Ginës dhe të Halit Ahmetit me shokë filloi të dukej dhe një tendencë e rrezikshme dhe karakteristike e luftës që zhvillon borgjezia kundër pushtetit tonë: gështja e dallimeve fetare. Karakteristike është se shumica e shokëve të sëmurë të këtij grupi janë me origjinë muslimane dhe presioni i borgjezisë, që bëhej në këtë grup, vinte nga elementi musliman i goditur. Një rigrupim i tillë, ndofta inkoshient, shikohet edhe në grupin tjetër në opozicion me grupin e Hasan Ginës e të Halit Ahmetit me shokë. Në këtë grup antagonist janë shokë me

origjinë të krishtere. Tendenca të tilla, që vërtetojnë metodat e luftës së borgjezisë, u shfaqën në këtë punë të sëmure, që po zhvillohej në Lushnjë dhe kështu në forma indirekte shfaqej dhe organizohej fillimi i një përçarjeje në rrugë fetare.

Tarafi në opozicion me tarafin e Hasan Ginës e të Halit Ahmetit me shokë përbëhet kryesisht me elementë, që kanë gabuar para Plenumit XI dhe që edhe këta jo në rrugën e drejtë të Partisë kërkojnë të thyejnë tarafin e Hasanit, të forcojnë pozitën e tyre personale, të punojnë po me ato metoda të gabuara që lufton tarafi i Hasan Ginës.

Fill pas punimeve të kongresit, Komiteti Qendror emëroi Hasan Ginën sekretar të parë provizor të organizatës. Hasan Gina në funksionet e sekretarit zhvilloi një aktivitet të sëmure sikundër u analizua më lart dhe nuk e mbante drejt në korrent Komitetin Qendror.

Më vonë Komiteti Qendror, në interesin e Partisë mori masa duke emëruar byrotë dhe sekretarët provizorë në rrethe, për të shëndoshur punën në organizatat, derisa të bëheshin zgjedhjet e reja. Një vendim i tillë u muar dhe për Lushnjën. Para se t'i komunikojë organizatës së Lushnjës ky vendim, Hasan Gina dhe Halit Ahmeti me shokë, alarmohen nga thashethemet pa përgjegjësi të një shoku dhe i drejtojnë një letër alarmante Komitetit Qendror. Këta shokë alarmohen, pse kanë frikë se hiqen nga pozitën që kanë zënë dhe natyrisht ambicia e tyre i mundon. Këta shokë kanë pasur një botëkuptim të sëmure mbi Partinë dhe me pikëpamjet e tyre të ngushta e konsideronin Komitetin Qendror si një forum, ku lehtë mund të intrigojë ndonjëri për të emëruar ose pushuar një funksionar qoftë edhe të vogël të Partisë.

Pas emërimit të byrosë provizore dhe të sekretarëve në Lushnjë, ku Hasan Gina nuk figuronte si sekretar i parë, ky dhe shokët e tij i drejtuan Komitetit Qendror edhe një letër tjetër më alarmante akoma për situatën e organizatës së Lushnjës dhe tarafi i tyre filloi pëshpëritjet për ta vështirësuar edhe më tepër gjendjen që kishin krijuar në organizatë, për të diskredituar vendimet e Komitetit Qendror, me të cilat vendime, Hasan Gina, Halit Ahmeti dhe shokët e tyre nuk ishin dakord.

Megjithëse Hasan Gina dhe Halit Ahmeti u thirrën para Sekretariatit të Komitetit Qendror dhe ikën gjoja të sqaruar, ata jo vetëm që nuk u bindën, por puna e tyre e mëvonshme e tregoi se vazhdonin në rrugën e gabuar.

Përpara zgjedhjeve të Partisë ata filluan aktivitetin e tyre në forma të gabuara dhe të dënueshme nga rregullat e Partisë.

Në kohën e zgjedhjeve të Partisë çështja mori forma të acaruara dhe u duk qartë gjithë kjo punë e sëmure. Në konferencën e Partisë në Lushnjë, me gjithë orientimin që u jepej nga i deleguari i Komitetit Qendror, tarafi i Hasan Ginës filloi kritikën jo-

parimore, të pabazuara e të ekzagjeruara. Tarafi tjetër filloi dhe ai mbrojtjen e tij dhe kritikën e tija po të kësaj natyre, pra, zgjedhjet u zhvilluan në platforma tarafi të paprincipita në një atmosferë shumë të sëmure, ku dukej një kritikë dhe autokritikë shumë e sëmure, ku dominonte ambicia, intriga etj. e këtyre njerëzve të sëmure të ndarë në tarafe. Një mision kaq të rëndësishëm, që u kishte ngarkuar organizata, këta e përdorën për të plotësuar ambiciet e tyre personale dhe qëllimet e sëmura të tyre. Duke orientuar keq zgjedhjet u arrit në rezultatin që të dy tarafet të mos votojnë për njëri-tjetrin dhe të kenë vota më pak se të gjithë të tjerët duke u ndodhur kështu në fund të listës. Duken qartë, pra, qëllimet që u synuan në atë konferencë. Kjo punë e tillë pati dhe një konsekuencë tjetër të rëndë, se në Komitetin e Partisë u zgjodhën shumë shokë jo të përshtatshëm për udhëheqje dhe që s'mund të ishte ndryshe, pse nga kjo punë e tillë e sëmure tarafi dhe ambicie, do të dilnin të tillë elementë në udhëheqje.

1. — Duke pasur kurdoherë bindjen e plotë se në organizatën e Lushnjës ekziston një numër i madh shokësh të shëndoshë, besnikë, të pastër dhe të klasës punëtore, Komiteti Qendror u rekomandon këtyre që të vënë të gjitha forcat për spastrimin e këtyre sëmundeve dhe të metave që ekzistojnë në organizatën e tyre, ta forcojnë këtë, ta bëjnë luftëtare revolucionare për realizimin e plotë të programit të Partisë, ta bëjnë të pamëshirshme kundër armikut të klasës dhe të zhvillojnë me sukses luftën e klasave.

Komiteti Qendror i rekomandon organizatës së Lushnjës, të thellohet sa më shumë në direktivat dhe në vijën e Partisë, t'i bëjë këto mish dhe gjak të saj dhe me gjak të ri, të hidhet në punë dhe në luftë.

Komiteti Qendror është i bindur se të metat dhe gabimet, që janë vërtetuar në disa njerëz të kësaj organizate, do të spastrohen sa më parë, duke përdorur fuqimisht dhe drejt armët e fuqishme të Partisë, kritikën dhe autokritikën.

Kritika dhe autokritika janë kondita të domosdoshme për një aktivitet militant të drejtë, domethënë, vetëm me anën e këtyre mund të nxjerrim mësim, mund të nxjerrim gabimet dhe dobësitë që nga rrënja, me qëllim që t'i korrigjojmë.

Duhet me punue mirë dhe çdo njeri duhet të punojë mirë, por dhe kritika e autokritika janë mjete që të bëjnë të punosh mirë. Kritika dhe autokritika, të kuptuara mirë për rolin e tyre të madh, e bëjnë militantin që i përdor këto në mënyrë të ndërgjegjshme, t'i mbajë këmbët në tokë, e bëjnë të kuptojë dhe të luftojë influencën e ideologjisë borgjeze në konshiençën e punonjëseve.

5. — Kjo letër të punohet në organizatat e Partisë për rrethin e Lushnjës dhe në të gjitha organizatat e Partisë të rretheve të tjera dhe të shërbejë si mësim për gjithë Partinë për të luftuar me ashpërsi të tilla shfaqje të huaja për Partinë tonë, gjithashtu të armatohet Partia nga kjo eksperiencë, duke u ruajtur dhe duke luftuar presionin e borgjezisë dhe metodat e saja armiqësore.

Për Byronë Politike të KQ të PPSH

Enver Hoxha

Botohet sipas librit:

Enver Hoxha «Vepra, vëll. 6»

LETËR E KQ TË PPSH MBI SHITIMIN E VIGJILENCËS DHE FORCIMIN E PROPAGANDËS

19 gusht 1949

GJITHË KOMITETEVE TË PARTISË

Kohët e fundit monarko-fashistët kanë bërë në kufirin tonë të Jugut një sërë provokacionesh në stil të gjerë dhe me karakter agresiv. Krahas këtyre provokacioneve të armatosura, drejtuesit e qeverisë monarko-fashiste të Greqisë, radio Athina dhe gjithë shtypi reaksionar po zhvillojnë kundër atdheut tonë një fushatë shpifjesh të poshtra. Me këto provokacione dhe shpifje bashkohen edhe titistët jugosllavë, agjentë të imperialistëve, armiq të Bashkimit Sovjetik, të vendeve të demokracisë popullore dhe të kampit unik të socializmit.

Të gjitha këto provokacione dhe shpifje janë në planin e imperialistëve amerikanë, përgatitës dhe nxitës të një lufte të re, këto kanë karakter armiqësor kundrejt atdheut tonë. Këto provokacione dhe shpifje bëhen me qëllim të caktuar: 1) Aktet agresive të fundit kishin për qëllim ta përdornin tokën tonë për t'u dalë pas shpine forcave të Ushtrisë demokratike greke. 2) Monarko-fashistët, me nxitjen e imperialistëve amerikanë llogaritin që, me anë të këtyre provokacioneve dhe shpifjeve, të venë në sesionin e afërm të OKB-së me argumenta për të vërtetuar se «ndërmjet Shqipërisë dhe Greqisë ekziston një gjendje lufte» dhe se «Shqipëria është shkaktare për këtë gjendje». Ata përpiqen ta paraqitin çështjen se në kufirin greko-shqiptar është krijuar një «gjendje e padurueshme» se «Shqipëria ndihmon direkt demokratët grekë duke u dhënë baza për artileri» etj. 3) Këto provokacione bëhen me qëllim që të krijojnë në vendin tonë një psikozë pasigurie në qendrushmërinë e situatës — një psikozë lufte — në mënyrë që të pengojnë popullin tonë në punën e tij paqësore, të dobësojnë besimin e popullit tonë në forcat e tija, në forcën e pushtetit të tij, në udhëheqjen e Partisë së tij. Me anë të këtyre provokacioneve

imperialistët kanë për qëllim që të inkurajojnë elementin armik në vendin tonë për shtimin e veprimtarisë së tij armiqësore, të krijojnë konfuzion në punën tonë ndërtimore dhe paqësore, të sabotojnë punën tonë për realizimin e planit të shtetit etj.

Në lidhje me këtë gjendje, para organizatave të Partisë dhe në radhë të parë para komiteteve të Partisë dalin detyra të reja që kërkojnë veprim të shpejtë, të zgjuar dhe të matur.

Komiteti Qendror konstaton se komitetet e Partisë nuk e kanë çmuar si duhet situatën aktuale dhe si rrjedhim nuk kanë mundur që të orientojnë edhe organizatat e Partisë. Në organizatat tona ka injorim të madh në lidhje me zhvillimin e ngjarjeve dhe nënvlefësim të punës së armikut. Në punën tonë ekziston një shkëputje në mes të punës politike për zgjidhjen e problemeve ekonomike dhe të zhvillimit të situatës politike të brendshme e ndërkombëtare. Kjo e metë e madhe që vihet re në mungesën e lidhjes së punës politike me problemet ekonomike përbën një rrezik për Partinë tonë, sepse nga një anë dobëson vigjilencën revolucionare dhe luftën kundër armiqve, nga ana tjetër dobëson mobilizimin e masave punonjëse për realizimin e planit.

Komiteti Qendror u tërheq vëmendjen komiteteve të Partisë se kanë kaluar dy javë nga dita e fillimit të provokacioneve në kufirin e Jugut dhe Komiteti Qendror nuk ka marrë asnjë letër nga komitetet e Partisë, ku të tregohet se ç'masa kanë marrë ato për orientimin e organizatave të Partisë, për sqarimin e popullit, me ç'parulla ka dalë armiku etj.

Porsa të merrni këtë letër, të thirrni menjëherë mbledhjen e seminarit të agjitorëve. Në këtë mbledhje të shtrohet konkretisht situata jonë aktuale e lidhur kjo me provokacionet e fundit në kufirin tonë të Jugut dhe detyrat e organizatave të Partisë e të agjitorëve tanë në këtë situatë.

Përsa u përket detyrave, kryesisht do të theksohen këto:

1. — Në radhë të parë është e domosdoshme që organizatat tona, agjitorët e Partisë ta njohin mirë situatën. Kësaj do t'ja arrijmë pikësepari, me anën e leximit të rregullt të shtypit. Shtypi kohët e fundit ka pasur mjaft material, por pak po lexohet dhe shpërndarja e tij është akoma shumë e dobët. Po nuk u njohim zhvillimi i ngjarjeve dhe qëndrimi zyrtar i Partisë dhe i qeverisë, organizatat tona, komunistët, nuk mund të jenë në asnjë mënyrë në krye të situatës, nuk mund të jenë në asnjë mënyrë të zotët që ta forcojnë punën e tyre politike për sqarimin e masave. Të shpjegohet se mungesa e njohjes së situatës e dobëson vigjilencën revolucionare në Parti dhe në masat e popullit dhe si konsekuencë dobëson edhe luftën kundër armiqve të brendshëm dhe të jashtëm.

Organizata e Partisë të sqarohet mirë mbi situatën në mënyrë që të mos ketë keqinterpretime dhe muhabetë që krijojnë pastaj psikoza të ndryshme të gabuara në Parti dhe në popull. Nuk është çështja as për t'u alarmuar, as për t'u vënë në gjumë, por për të vlerësuar drejt situatën, për të forcuar vigjilencën në Parti dhe në masat dhe për të ashpërsuar gjithnjë e më shumë luftën kundër armiqve. Në këtë situatë nuk lejohet në radhët e Partisë as edhe lëkundja më e vogël; çdo shfaqje e dobët e komunistëve duhet të goditet menjëherë. Të shërbejë kjo gjendje për të provuar besnikërinë dhe vendosmërinë e çdo komunisti e sidomos të elementit të ri ndaj çështjes së Partisë.

2. — Të ngrihet më mirë në Parti dhe në masat e popullit lidhja e situatës aktuale të provokacioneve me problemet ekonomike të ditës si me realizimin e planit të shtetit në qendrat e prodhimit, me grumbullimin, me nxjerrjen e fuqisë punëtore, me mbjelljet e vjeshtës etj. Bile organizatat e Partisë të orientoohen që këtë situatë ta marrin në dorë mirë dhe ta shfrytëzojnë për të ngjallur më shumë patriotizmin në masat tona punonjëse, patriotizëm ky që do të shfaqet në mobilizimin më të madh për realizimin e planit të shtetit në qendrat e prodhimit, në grumbullim, në nxjerrjen e fuqisë punëtore. P.sh. për grumbullimin të mos lejohet të ketë efekt parulla e armikut «mos dorëzoni bereqetin se do plasë lufta dhe do ngelim pa bukë»; por duke u shpjeguar masave fshatare situatën pse bëhen, kush i bën dhe ç'qëllim kanë provokacionet, të shpejtojmë dorëzimin e bereqetit dhe duke e shpjeguar këtë si një detyrë të shenjtë patriotike ta realizojmë qind për qind planin. Organizatat e Partisë dhe përgjegjësit e sektorëve ekonomikë sot më shumë se kurrë duhet të mobilizohen për të kaluar çdo vështirësi në realizimin e planit. Ngjarjet e fundit nuk duhet të ulin ritmin në realizimin e planit të grumbullimit, përkundrazi ta shpejtojnë dhe nuk duhet të pengojnë sigurimin e fuqisë punëtore, por të nxitin plotësimin qind për qind të saj.

3. — Në punën tonë me masat për sqarimin e gjendjes, një vend të rëndësishëm do të zërë agjitacioni individual. Agjitacioni individual marrë parasysh këtë situatë, duhet të jetë jashtëzakonisht i shpejtë dhe luftarak që të luftojë në vend çdo përpjekje dhe parullë të armikut për të krijuar alarme në popull. Armë në duart e agjitorëve për këtë qëllim është shtypi, prandaj të merren masat dhe të ushtrohet kontroll i përditshëm dhe rigoroz direkt nga byrotë e organizatave bazë për shpërndarjen dhe përdorimin e tij. Të porositen agjitorët që të shfrytëzojnë çdo rast për t'u futur thellë në masat e popullit, për të zhvilluar një punë intensive dhe

të gjerë në qytete e fshatra me të gjitha format që bën fjalë vendimi i Komitetit Qendror «mbi agjitacionin». Për këtë kolektivitet e agjitorëve duhet të bëjnë një ndarje pune në bazë të një plani dhe për të gjithë aktivitetin e agjitorëve të mbajnë vazhdimisht në korrent byrotë e komiteteve të Partisë që të mos ngjasë siç ngjet sot, që byrotë e komiteteve të Partisë nuk dinë se ç'flitet në masa dhe ç'parulla hedh armiku.

4. — Të ngremë me forcë të madhe çështjen e vigjilencës revolucionare në Parti dhe në popull. Të shpjegohet se kjo situatë pasqyron ashpërsimin gjithnjë e më të madh të luftës së klasave qoftë brenda vendit tonë, qoftë në planin ndërkombëtar. Kjo situatë kërkon nga çdo komunist dhe qytetar që të bëjë roje për atdheun, roje të zgjuar për të kuptuar çdo gjë armiqësore dhe për ta goditur në vend. Të orientohen konkretisht organizatat e Partisë dhe aktivistët rreth Partisë se ku duhet ta shikojnë punën e armikut. Veprimtarinë kryesore me anë parullash armiku sot po e bën në lidhje me situatën e jashtme: «Jemi të rrethuar nga të katër anët dhe në rast lufte do të jemi vetëm», «anglo-amerikanët nuk e durojnë këtë gjendje në Shqipëri», «do të kemi luftë së shpejti, anglo-amerikanët do të zbarkojnë, po përgatitet ushtri në Greqi dhe Jugosllavi për invadim», «ka lëvizje të madhe të ushtrisë, duket se do të pëlçasë shpejt luftë» etj.; të gjitha këto kanë për qëllim që të krijohet psikoza e luftës së afërt, psikoza e pasigurisë dhe të pengohet mobilizimi në punë. Armiku përpiket me të gjitha forcat për të penguar dhe për të sabotuar realizimin e problemeve ekonomike dhe këtë e bën me akte sabotazhi duke prishur maqinerinë, duke bërë riparim të dobët, duke zgjatur kohën në riparim, me anë parullash: «mos e dorëzoni bereqetin, se lufta është më të plasur dhe do të mbetemi pa bukë», «mos e dorëzoni grurin se s'dihet si do të dalë misri», «kemi kaq plane të qeverisë për të larë dhe nuk mund të shkojmë punëtorë»; armiku bën edhe vrasje, si vrasja e fundit e sekretarit të parë në Rrëshen, shokut Bardhok Biba dhe e një shoku të sigurimit ditët e fundit në Krujë. Veçanërisht organizatat e Partisë dhe masat e popullit rreth kufirit të kenë parasysh se spiunë të huaj monarko-fashistë grekë dhe të UDB-së jugosllave mund të kapërcejnë kufirin. Të na shërbejë për vigjilencë këtu shembulli i kufitarëve sovjetikë; agjitorit i Partisë t'i hapë sytë e t'i bëjë katër, kështu të mësohet edhe çdo qytetar e fshatar, bari dhe druvar kur shikon njeri të huaj që lëviz në fshat.

Duke forcuar dashurinë për atdheun, duke ngjallur ndjenjat e patriotizmit në masat tona punonjëse, duke rritur aktivitetin e

tyre për ndërtimin socialist të atdheut tonë, të forcojmë vigjilencën revolucionare në Parti dhe në popull. Të zbulojmë në kohë çdo aktivitet dhe parullë të armikut dhe ta godasim në vend dhe ashpër ashtu siç veprohej gjatë Luftës nacional-çlirimtare.

Të ngrihet gjithashtu me urgjencë para organizatave të Partisë nevoja e forcimit të konspiracionit për çështjet e Partisë, të ushtrisë etj. dhe të mësohen në këtë frymë të gjithë qytetarët e Republikës.

5. — Të rritet në organizatat e Partisë dhe në masat e popullit dashuria dhe besimi për Ushtrinë tonë Popullore. Të ngjallet në popull krenaria për ushtrinë tonë trime. Agjitorët me lexime dhe biseda të vënë në dijeni masat e popullit për aktet heroike të ushtarëve tanë trima në kufi. Mirë kanë bërë minatorët e Minierës Mborje-Drenovë që kanë theksuar në letren e angazhimeve drejtuar shokut Enver se do të punojnë për realizimin e planit të shtetit, ashtu siç luftojnë vëllezërit tanë në kufi. Këtë shembull ta ndjekin edhe të tjerët; t'u shkruajnë punëtorët, fshatarët dhe veçanërisht gratë, nënat dhe motrat njerëzve të tyre në ushtri. Të shfrytëzohen kujtimet e Luftës nacional-çlirimtare dhe heroizmat e partizanëve dhe të popullit tonë. Punës me gruan, sqarimit e mobilizimit të saj në lidhje me këtë situatë si dhe mobilizimit të rinisë, t'u vihet rëndësi e veçantë.

6. — Me punën tonë me masat, të bëjmë që të njihen sa më shumë Bashkimi Sovjetik, vendet e demokracisë popullore, luftërat e armatosura të popujve të Kinës e të Indonezisë, rritja e rezistencës në Francë, Itali etj. Të forcohet në masat tona dashuria për frontin unik të socializmit. Të forcohet në masat tona besimi te fuqia e madhe, që vete çdo ditë duke u rritur, e kampit demokratik, antiimperialist me në krye Bashkimin e madh Sovjetik.

7. — Të demaskohen me të gjitha forcat përpjekjet e imperialistëve për të përgatitur dhe nxitur një luftë të re. Të demaskohen qëllimet që ndjekin imperialistët amerikanë në nxitjen dhe përgatitjen e provokacioneve dhe të shpifjeve nga ana e monarko-fashistëve grekë kundër vendit tonë.

Në përgjithësi këto janë çështjet që duhen ngritur para organizatave të Partisë, para organizatave të masave dhe që duhet të shtrohen në seminaret e agjitorëve.

Sipas udhëzimeve të Komitetit Qendror, në qendrat e rrethëve do të organizohen mitingje proteste kundër provokacioneve. Vetë mitingu është një aksion i rëndësishëm politik dhe ta shfrytëzoni këtë për një mobilizim më të madh për realizimin e planit të shtetit.

Presim që të dërgoni sa më parë një relacion mbi gjendjen politike në rrethin tuaj.

Pastaj, për zhvillimin e situatës, veçanërisht në lidhje me provokacionet në kufirin e Jugut, të na informoni vazhdimisht.

KOMITETI QENDROR I PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË

*Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

PLENUMI III I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Tiranë, 11-13 tetor 1949

Prej datës 11-13 tetor 1949 zhvilloi punimet e tij Plenumi III i KQ të PPSH, i cili pasi dëgjoji dhe aprovoi raportin e mbajtur nga shoku Spiro Koleka «Mbi çështjet ekonomike» dhe raportin e mbajtur nga shoku Mehmet Shehu «Mbi gjendjen politike të Shqipërisë», mori masa shumë të rëndësishme lidhur me realizimin e planit të shtetit, me përmirësimin e jetesës së punëtorëve në qendrat industriale, me forcimin e vigjilencës revolucionare në anëtarët e Partisë dhe në gjithë masat punonjëse, sidomos në sektorët e ekonomisë, me forcimin e patriotizmit dhe të gatishmërisë për të mbrojtur atdheun dhe fitoret e revolucionit popullor.

RAPORT

I BYROSË POLITIKE TË KQ TË PPSH «MBI GJENDJEN POLITIKE TË SHQIPËRISË»

12 tetor 1949

Gjendja politike e brendshme dhe e jashtme e Republikës Popullore të Shqipërisë, që nga kthesa e Partisë dhe deri sot, karakterizohet nga ashpërsimi i luftës së klasave, nga intensifikimi i veprimtarisë armiqësore të reaksionit të brendshëm, nga rritja e vazhdueshme e veprimtarisë armiqësore të imperializmit në përgjithësi dhe e fqinjëve tanë në veçanti kundër vendit tonë, nga rigrupimi dhe riorganizimi i reaksionit shqiptar në emigracion prej amerikanëve, anglezëve dhe fqinjëve tanë, nga goditjet e rënda që ne i kemi dhënë armikut dhe nga falimentimi i planeve të deritanishme të armikut, si rezultat i vigjilencës revolucionare dhe i goditjeve tona kundër tij.

1. — Ashpërsimi i luftës së klasave në vendin tonë

Në vendin tonë lufta e klasave këto vitet e fundit, pas çlirimit, ka ardhur duke u ashpërsuar. Si shpjegohet ky ashpërsim i luftës së klasave në Republikën tonë Popullore? Kjo shpjegohet nga fakti që ekonomia jonë është duke u zhvilluar në rrugën drejt socializmit në interes të masave të gjera punonjëse dhe në dëm të ish-klasave sunduese, të cilat e kanë humbur pushtetin dhe tani populli është në fuqi; shpjegohet nga rritja e gjithanshme e forcës së Republikës sonë, si rezultat i zhvillimit të gjithanshëm të jetës sonë në rrugën e ndërtimit të socializmit¹. Marrëveshjet eko-

¹ Ky ashpërsim i luftës së klasave në atë kohë kishte lidhje drejtpërdrejt me ashpërsimin e luftës së klasave në shkallë ndërkombëtare e sidomos me sulmin frontal që ndërmerën kundër RPSH imperialistët amerikanë,

nomike me Bashkimin Sovjetik dhe demokracitë popullore që ne bëmë nga fillimi i këtij viti, sukseset në realizimin e planit ekonomik të shtetit (me të gjitha mungesat që janë vërtetuar në realizimin e këtij plani), vënja në zbatim e sistemit të ri të grumbullimit dhe të furnizimit, që është sistemi më i drejtë në kohën e sotme, realizimi me sukses i huas së shtetit, të korrurat e kënaqshme dhe realizimi i grumbullimit të grurit, zhvillimi i arësimit, i artit e i kulturës në interes të masave punonjëse, forcimi i gjithanshëm i marrëdhënjëve me Bashkimin Sovjetik dhe demokracitë popullore, spastrimi i vendit nga agjentura titiste dhe goditjet e ashpra që i kemi dhënë vazhdimisht punës armiqësore të reaksionit të brendshëm dhe të jashtëm në vendin tonë — të gjitha këto fakte dëshmojnë për rritjen e potencialit ekonomik të shtetit tonë, dëshmojnë për forcimin dhe zhvillimin e gjithanshëm të Republikës sonë Popullore dhe dobësimin e armiqve tanë të klasës.

Zhvillimi i ekonomisë sonë popullore nuk mund të kryhet pa hasur pengesa e rezistencë në elementët kapitalistë të qytetit e të fshatit, në ata elementë që në të kaluarën ishin pronarë të mëdhenj e që bashkëpunonin me okupatorët dhe sot janë prekur nga pushteti ynë, në ata që dje ishin agallarë, që shfrytëzonin forcën e kraut të të tjerëve, që ishin kryetarë të «Ballit» e të «Legalitetit» ose funksionarë të okupatorit, të cilët vajtojnë të kaluarën e tyre të privilegjuar, urrejnë të tashmen dhe e luftojnë atë, sepse tmërohen nga e ardhshmeja jonë e lumtur. Ky zhvillim bëhet nëpërmjet një lufte të ashpër me elementët dhe klasat që janë goditur nga reformat tona, të cilët kanë interesa të kundërta me masat punonjëse që kanë pushtetin në dorë.

Elementët kapitalistë dhe armiq të klasës nuk tërhiqen vullnetarisht para rulosë së zhvillimit të ekonomisë e të pushtetit tonë. Çdo hap i ynë përpara has patjetër në rezistencën e gjithanshme të armikut të klasës. Shoku Stalin na mëson se

«Nuk ka pasur deri më sot raste të tilla në histori që borjezia në agoni të mos i ketë vënë në provë të gjitha mbeturinat e forcave të saj për të mbrojtur ekzistencën e vet. Sido që të jetë aparati i ynë shtetëror lokal, i mirë ose i keq, përparimi i ynë, ofensiva e jonë do t'i godasë elementët

anglezë tok me fashistët italianë, monarko-fashistët grekë dhe titistët jugosllavë, me qëllim që të asgjësonin fitoret e revolucionit tonë popullor.

Ky sulm nxiti shpresat te ish-klasat sunduese në vendin tonë dhe bëri që edhe ato të gjallëroheshin në mënyrë të veçantë kundër rendit popullor në Shqipëri.

kapitalistë dhe do t'i eliminojë ata, kurse klasat në agoni do të rezistojnë me çdo kusht»¹.

Duhet theksuar gjithashtu se në rezistencën që bëjnë elementët kapitalistë e armiqtë e vjetër bashkohen edhe elementë të rinj, kapitalistë të rinj që lindin nga borgjezia e vogël e fshatit dhe e qytetit, sepse

«Borgjezia e vogël, borgjezia e qytetit dhe e fshatit, nxjerr nga gjiri i saj, sikurse ka thënë Lenini, çdo ditë dhe çdo orë kapitalistë të mëdhenj dhe të vegjël, dhe këta elementë kapitalistë marrin të gjitha masat e duhura për të mbrojtur ekzistencën e tyre»².

Kështu shpjegohet fakti që elementi kulak në fshat reziston dhe saboton grumbullimin e bereqetit të shtetit, duke mos e dorëzuar bereqetin, duke e dorëzuar të përzier me rërë ose të prishur, ose duke e dorëzuar vetë në rregull dhe nga ana tjetër duke shtytur fshatarët e varfër që të mos e dorëzojnë «sepse shteti nuk i godet ata pasi janë shtresë e varfër» etj.

Kështu shpjegohet fakti që elementi tregëtar i tatuar e fsheh floririn nën tokë për të mos ja dorëzuar shtetit. Kështu shpjegohet fakti që në fshat lindin kulakë si këpurdat pas shiut. Shumë herë kulaku shtiret që vetë të jetë korrekt karshi detyrimeve të shtetit, por nga ana tjetër ai shtyn të tjerët për t'i rezistuar zhvillimit tonë ekonomik d.m.th. luan rolin e hipokritit. Kështu ka ndodhur, p.sh. në një fshat të rrethit të Fierit, ku kulaku vetë e dorëzoi detyrimin e drithit, por nga ana tjetër, në mënyrë ilegale, u mundua të organizonte rezistencën kolektive të shumë fshatarëve të varfër për të kërkuar nga pushteti uljen e detyrimeve; ose në një rast tjetër kur kulaku e mësonte fshatarin e varfër se si mund «t'ja hidhte» ndërmarrjes së grumbullimit në larjen e detyrimit të mishit. Raste të tilla, që janë rezultat i punës armiqësore të elementit kapitalist të fshatit e të qytetit, hasen çdo ditë te ne në forma të ndryshme.

Por mos vallë rezistenca që bëjnë elementët kapitalistë dhe armiq në çdo hap që ne hedhim përpara, tregon se ata bëhen më të fortë se ne? Kjo, në asnjë mënyrë, nuk tregon një gjë të tillë. Kjo tregon të kundërtën, tregon se elementët kapitalistë dhe armiq, duke parë në sukseset tona disfatën e tyre, duke parë se çdo hap i ynë përpara është një tërheqje për ata drejt vdekjes,

1 J. V. Stalin. Veprat, vëll. 12, f. 37.

2 Cituar sipas J. V. Stalinit. Veprat, vëll. 12, f. 37.

rezistojnë «me thonj e me dhëmbë», për të mbrojtur ekzistencën e tyre si klasë dhe këtë rezistencë do ta bëjnë vazhdimisht deri në buzën e varrit.

«Klasat e vjetra rezistojnë, thotë shoku Stalin, jo sepse janë bërë më të forta se ne, por sepse socializmi rritet më shpejt se ato, dhe ato bëhen më të dobëta se ne. Dhe pikërisht sepse ato po bëhen më të dobëta, ato e ndjejnë se po afrohen ditët e fundit të jetës së tyre dhe janë të shtërnguara të rezistojnë me të gjitha forcat, me të gjitha mjetet»¹.

Nuk duhet harruar se zhvillimi dhe ashpërsimi i luftës së klasave në vendin tonë në kohën e sotme bëhet edhe brenda kuadrin të përgjithshëm të zhvillimit dhe të ashpërsimit të kontradiktave midis kampit demokratik dhe kampit imperialist. Si shpjegohet ashpërsimi i kontradiktave midis kampit demokratik e kampit imperialist? Ky shpjegohet me faktin e forcimit të gjithanshëm të kampit demokratik dhe të dobësimit të gjithanshëm të kampit imperialist. Sukseset e mëdha në lëmin ekonomik, kultural e politik të Bashkimit Sovjetik dhe të demokracive popullore; triumfi i revolucionit popullor në Kinë, i cili ka një rëndësi të madhe ndërkombëtare, që është një grusht shumë i rëndë për kampin imperialist dhe që ka bërë që raporti i forcave të rrokulliset me shpejtësi në favor të kampit demokratik e në dëm të kampit imperialist; Kongresi Botëror i Partizanëve të Paqes; demaskimi i klikës së Titos si një klikë tradhëtarësh në shërbim të imperializmit; demaskimi dhe goditja e agjenturave të trockizmit e të imperializmit në demokracitë popullore (Shqipëri, Bullgari, Hungari); asgjësimi i «gogolit atomik» të imperializmit; ashpërsimi i mëtejshëm i krizës së përgjithshme të sistemit kapitalist; thellimi i kontradiktave të brendshme të këtij sistemi — të gjithë këta faktorë çojnë në forcimin e kampit demokratik dhe në dobësimin e kampit imperialist. Kampi imperialist ka vënë në përdorim të gjitha mjetet dhe forcat e tija për të përgatitur luftën e re botërore, sepse mendon që me anën e luftës do të mund të zgjidhë krizën e tij të përgjithshme dhe do të shkatërrojë armiqtë e vet, d.m.th. kampin demokratik.

Republika Popullore e Shqipërisë është një pikëmbështetje e fortë, me një rëndësi të madhe politike dhe ushtarako-strategjike në prapavijat e forcave të avancuara të kampit imperialist. Shqipëria është një pengesë të cilën kampi i imperializmit kërkon ta zhdukë për të përgatitur më mirë kryeurën e tij në Ballkan kundër

1 J. V. Stalin. Veprat, vëll. 12, f. 38.

Bashkimit Sovjetik dhe demokracive popullore. Prandaj imperia-
lizmi amerikan dhe anglez, jo vetëm që solidarizohet me forcat
reaktionare të brendshme të Shqipërisë, por edhe u ndihmon drejt-
përsëdrejti këtyre forcave, me qëllim që t'i përdorë ato për rrëzim
me forcë të pushtetit tonë popullor. Prandaj rezistenca që
bën reaksioni në vendin tonë, duhet konsideruar si një armë në
duart e reaksionit ndërkombëtar, të kampit imperialist, që për-
doret jo vetëm kundër Republikës Popullore të Shqipërisë, por
edhe kundër gjithë kampit demokratik. Prandaj nuk është e mun-
dur që ta ndash punën armiqësore të reaksionit të brendshëm nga
veprimtaria armiqësore e imperializmit kundër vendit tonë dhe
kampit demokratik. Imperializmi amerikano-anglez, në veprimtarinë
e tij kundër vendit tonë është duke përdorur të gjitha bazat
që disponon përreth Shqipërisë: Jugosllavinë, Greqinë dhe Italinë.
Në këtë mënyrë, Republika Popullore e Shqipërisë është bërë
objekti i kryqëzimit të shigjetave armiqësore të të gjithë fqinjëve
të saj, shigjeta të cilat burimin e fijeve drejtuese të tyre e kanë
që të gjitha në një vend të vetëm: në Departamentin e Shtetit
të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

2. — Presioni i borgjezisë dhe falimentimi i orvatjeve të deritanishme të reaksionit

Pas Plenumit XI të Komitetit Qendror të Partisë sonë reaksioni
i brendshëm u mundua të përfitonte nga demaskimi dhe goditja
që i bënte Partia jonë agjenturës së Titos në vendin tonë
(Koçi Xoxe e kompani), për ta paraqitur veten (ai, reaksioni) si
të persekutuar nga Koçi Xoxe, për të dobësuar vigjilencën tonë,
për të ulur tensionin e luftës së klasave në dëm të popullit dhe në
interes të borgjezisë. Kjo ishte taktika e «peshkimit në ujë të tur-
bullt» që përdori reaksioni gjatë valës së kthesës sonë. Kjo ishte
metodë lufte e elementit armik kundër Partisë, pushtetit dhe po-
pullit tonë. Këtu armiku mundi të përfitonte deri diku, duke spe-
kuluar në nivelin e ulët politik e ideologjik të Partisë sonë. Të
gjithë e mbajmë mend se si pas Plenumit XI të Komitetit Qendror,
elementë kriminelë lufte dhe spiunë të burgosur e të dënuar,
ose kulakë e feudalë, tregëtarë të tatuuar, elementë antiparti, i
gjithë reaksioni, të ngrinte zërin hysterik mbi «padrejtësitë» që
kishte pësuar «nën Koçi Xoxen» etj. Në këtë mënyrë borgjezia
ushtroi presion të fortë mbi Partinë tonë gjatë kthesës së saj his-
torike. Dhe ky presion, i ushtruar nga borgjezia mbi ne, në një
moment oportun për të, në mënyrë të gjithanshme e me metoda të
rafinuara, pati efektin e vet negativ në disa anëtarë të Partisë
sonë: pati keqinterpretime në zbatimin e demokracisë së brendshme

të Partisë, shtrembërime të parimit të kritikës dhe të autokritikës,
shturje të disiplinës së Partisë, të përgjegjësisë personale, të dhën-
jes llogari për zbatimin e detyrave dhe shfaqjen e tendencës së
oportunizmit. Elementët e Partisë, në të cilët u shfaqën këto do-
bësi si rrjedhim i presionit dhe i influencës së borgjezisë, me gjit-
thë paralajmërimet në kohën e duhur nga ana e Partisë mbi këto
rreziqe, ishin në radhë të parë elementë të origjinës shoqërore jo
të shëndoshë, të ulët politikisht dhe ideologjikisht, me kulturë
borgjeze.

Oportunizmi u bë i dëmshëm për Partinë dhe shtetin, sepse
u shfaq dhe u praktikua me të dyja duart nga të gjitha organet e
prokurorive dhe të gjykatave tona. Këto organe të drejtësisë fil-
lluan të bënin lëshime të mëdha pas Plenumit XI të Komitetit
Qendror të Partisë dhe oportunizmi u bë vijë e tyre në zbatimin e
ligjeve të shtetit, duke u treguar të butë në dhënjen e dënimeve
kundrejt armiqve të popullit, të mëshirshëm dhe «zemërgjerë»
ndaj spiunëve, vrasësve, hajdutëve dhe keqbërësve. Komiteti Qen-
dror e analizoi në kohën e duhur këtë çështje dhe konstatoi se
burimi i të gjitha këtyre shfaqjeve oportuniste ka qenë në Proku-
rorinë e Përgjithshme të Shtetit dhe në Gjykatën e Lartë Ush-
tara. Komiteti Qendror i dënoi rreptë pikëpamjet e gabuara dhe
jomarksiste të shfaqura në gjykatat e prokuroritë sipas të cilave
gjykatat dhe prokuroritë duhet të veprojnë në mënyrë «independente»
nga lufta e klasave dhe interesat e klasës. Ky koncept i
gabuar u bë vijë dhe platformë pune për gjykatat dhe prokuroritë
tona. Kjo ndodhi për arsye se në gjykatat tona sot ka akoma
shumë elementë me kulturë borgjeze dhe në prokuroritë tona ka
elementë të pangritur politikisht e ideologjikisht, të cilët në rre-
thanat e presionit të borgjezisë, ranë në oportunizëm. Byroja Po-
litike e Komitetit Qendror i ka dënuar këto shfaqje si të rrezik-
shme dhe është duke i vënë në rrugën e duhur prokuroritë dhe
gjykatat tona.

Në ditët e para të kthesës sonë, me gjithë ndërhyrjet e Kom-
itetit Qendror, në të shumtat e rasteve, u bë e zakonshme që në
mbledhjet e organizatave bazë të Partisë, sa edhe në mbledhjet
publike të popullit, çështjet e Sigurimit të Shtetit të bëheshin
objekt sulmi të padrejtë dhe të rrezikshëm. Ka pasur raste kur
anëtarë partie padrejtësisht kanë akuzuar publikisht funksionarët
e sigurimit dhe aparatin e sigurimit duke detyruar njerëzit e si-
gurimit që të dekonspironin sekretet e shtetit. Ka pasur raste, kur
anëtarë partie kanë kërkuar të hidhnin në gjyq njerëzit e si-
gurimit për «padrejtësitë» që gjoja atyre u paskëshin qenë bërë nga
organet e sigurimit në kohën e Koçi Xoxes. Ka pasur funksionarë
të lartë të gjykatave tona që kanë menduar se të gjithë funksio-
narët e sigurimit duhej të çoheshin në gjyqin e popullit si armiq,
si Koçi Xoxe.

Në këtë mënyrë u konfondua Arma e Sigurimit të Shtetit me personin që e drejtonte këtë, me Koçi Xoxen. Shfaqje të këtilla kanë qenë të dëmshme për Partinë, për popullin dhe në interes të borgjezisë. Nga kritika e ashpër dhe e drejtë që Byroja Politike u bëri organeve të drejtësisë mbi këto shfaqje jo të drejta dhe të dëmshme, këto organe tani janë duke u vënë në rrugën e drejtë të Partisë, sikurse edhe të gjithë elementët që gabuan në interpretimin e kritikës dhe të autokritikës nga niveli i ulët i tyre dhe nga influenca e presionit të borgjezisë reaksionare. Porse shfaqje të tilla na kanë dëmtuar mjaft.

Arma e Sigurimit të Shtetit, pas Plenumit XI të Komitetit Qendror u gjend midis «dy zjarreve»: nga një anë sigurimi sulmohej nga elementët reaksionarë e armiq, që mundoheshin ta paraqitnin atë si armë personale të Koçi Xoxes dhe të dëmshme për «popullin» e, nga ana tjetër, sigurimi sulmohej edhe nga disa anëtarë partie të ulët politikisht e ideologjikisht. Kjo solli si rrjedhim demoralizimin e shumë kadrove të sigurimit, duke i dhënë kështu, mundësi armikut, për një kohë, që «të peshkonte në ujë të turbullt». Në këtë mënyrë, aparati i sigurimit u trondit rëndë dhe ra në pasivitet. Ky ishte rezultat i kundërgoditjes që na bënte reaksioni i brendshëm në një moment të vështirë për ne.

Këto ishin momente kur Sigurimi i Shtetit paraqitej si një repart i lodhur e i raskapitur, që tërhiqet jo në rregull përpara një armiku të inkurajuar nga rrethanat. Por Partia mori masa efektive të rastit, goditi ashpër të gjitha shfaqjet oportuniste në radhët e saja, e mëkëmbi Sigurimin e Shtetit dhe dërmoi të gjitha orvatjet e armikut.

Sigurimit të Shtetit ju desh të riorganizohej, të ndryshonte taktikën dhe metodën e punës, të korrigjonte të gjitha gabimet e mëdha të së kaluarës dhe e gjithë kjo u bë gjatë procesit të kundërgoditjes së armikut e duke u hedhur kështu në sulm mbi armikun. Këtë detyrë me shumë rëndësi Sigurimi i Shtetit është duke e kryer me sukses në saje të udhëheqjes së drejtë të Partisë.

Gjatë kthesës sonë, armiqtë u përpoqën të spostonin luftën tonë kundër tyre, në drejtim të luftës së Partisë kundër agjenturës titiste (Koçi Xoxes etj) dhe të na vinin në gjumë përsa i përket luftës së pandërprerë dhe të ashpër që duhej të bënim kundër borgjezisë reaksionare. Duke u nisur nga kjo platformë, reaksioni i brendshëm, i ndihmuar dhe i drejtuar efektivisht nga imperia-lizmi, bëri të gjitha orvatjet gjatë dimrit të kaluar, për të rigrupuar forcat e veta, për t'i riorganizuar ato dhe, në pranverën e në verën e këtij viti, t'i hidhte në sulm kundër nesh me qëllim që të rrëzonte me forcë pushtetin tonë popullor. Në këtë drejtim armiku u mobilizua dhe përdori të gjitha metodat: luftën e nervave me anën e parullave alarmuese, sabotazhin ekonomik, diversio-

nin, terrorin, propagandën. Plani i armiqve tanë të brendshëm dhe të jashtëm gjatë vitit 1948-1949 nuk u realizua, me gjithë situatën e vështirë që ishte për ne menjëherë pas kthesës së Partisë. Ky plan falimentoi më parë se të fillonte të realizohej, siç do ta shohim më poshtë.

3. — Intensifikimi i veprimtarisë armiqësore të armiqve tanë të jashtëm

Viti 1949 karakterizohet nga rritja e vazhdueshme e veprimtarisë armiqësore të imperialistëve amerikano-anglezë dhe të sate-litëve të tyre fqinjë të Shqipërisë, me qëllim që të përmbysej pushteti popullor në Shqipëri dhe të vendosej regjimi reaksionar. Në këtë luftë të ashpër e të gjithanshme që na kanë bërë dhe na bëjnë armiqtë e jashtëm, klika e Titos është duke konkuruar me monarko-fashistët grekë e me reaksionarët italianë dhe, nga të gjitha të dhënat, duket sikur padronët e kësaj klike trockiste, imperialistët amerikanë dhe anglezë, ja kanë dhënë asaj bajrakun e zi kundër Republikës Popullore të Shqipërisë. Në se konsiston veprimtaria armiqësore e klikës së Beogradit kundër nesh? Ajo konsiston në përpjekjet e gjithanshme të agjenturës së Rankoviçit për të organizuar sa më shumë arratisje nga Shqipëria për në Jugosllavi, në propagandën legale dhe ilegale të shfrenuar kundër vendit tonë, në armatosjen dhe drejtimin e reaksionit shqiptar në Jugosllavi kundër vendit tonë, në organizimin e provokacioneve të armatosura kundër integritetit tonë tokësor, në hedhjen e grupepe diversante ilegale në Shqipëri, në organizimin e punës agjenturale të terrorit dhe të sabotazhit, në ustrimin e presioneve dhe të shantazheve, në luftën «diplomatike» dhe në drejtimin e atyre pak kriminelëve ballistë dhe zogistë që qarkullojnë akoma në vendin tonë. Të gjitha këto forma të luftës që udhëheqja e Jugosllavisë i bën Republikës sonë Popullore, kanë një qëllim të caktuar: përmbysjen e pushtetit popullor ekzistues në Shqipëri, kthimin e Shqipërisë në një koloni jugosllave dhe zhdukjen e kësaj pikëmbështetjeje të avancuar të kampit të socializmit që është Shqipëria, për të mundur që të formohet uniteti gjeografik, ekonomik, politik e ushtarak i kryeurës së imperializmit në Ballkan kundër kampit demokratik, duke përfshirë edhe Shqipërinë në këtë kryeurë bashkë me Jugosllavinë e Greqinë.

Për t'ja arritur këtij qëllimi, qeveria e Beogradit është duke bashkëpunuar ngushtësisht në të gjitha drejtimet me imperialistët amerikanë dhe anglezë, me reaksionarët italianë, me monarko-fashistët grekë dhe me pjesën më të zezë të reaksionit shqiptar si brenda ashtu dhe jashtë kufive tanë. Rankoviçi i ka përshkuar të

gjitha rrugët makiaveliste¹ për t'ja arritur qëllimit të tij si agjent i imperializmit. Ai është duke bashkëpunuar me agjentët e shërbimit të informacionit ushtarak italian, si me Nikoll Mëlyshin dhe Ndue Pjetër Gjon Markaj, të cilët, pasi kryen një kurs spiunazhi në Itali, u hodhën nga italianët me parashuta në malet e Mirditës, organizuan dhe kryen vrasjen e sekretarit politik të Komitetit të Partisë të rrethit të Mirditës, shokut Bardhok Biba dhe sot ndodhen të lirë e të armatosur në Jugosllavi, pasi në Shqipëri nuk mund të qëndronin dot nga ndjekja e forcave tona (Ndue Pjetër Gjon Markaj këto kohët e fundit është «zgjedhur» anëtar i komitetit drejtues të organizatës «Blok i Indipendent» në të cilin janë grupuar të gjithë fashistët shqiptarë më të vendosur në emigracion, si Ernest Koliqi etj.). Rankoviçi është duke strehuar dhe duke drejtuar në luftë kundër nesh qindra kriminelë luftime si Cen Elezin, Dan Kaloshin, Nik Sokolin, Tahir Hoxhën etj., të cilët i kanë duart e tyre të lypa me gjakun e popullit shqiptar dhe sot zhvillojnë një aktivitet armiqësor kundër vendit tonë duke u nisur që nga toka jugosllave.

Në Jugosllavi është formuar një komitet antishqiptar me kriminelë luftime dhe me agjentin e Inteligens Servis-it, Gani Kryeziun në krye. Ky komitet fashistësh ka edhe shtabin e vet ushtarak në Kosovë (Jugosllavi) që drejtohet nga njerëzit e UDB-së. Qëllimi i Gani Kryeziut dhe i Rankoviçit është po ai i Mithat Frashërit dhe i amerikanëve. Gani Beg Kryeziu ka të vëllanë e tij Seit Beg Kryeziun në Komitetin «Shqipëria e Lirë» të formuar këto kohët e fundit nga amerikanët në Paris. Gani Kryeziu dhe i deleguari i Titos kanë marrë pjesë në mbledhjen e fshehtë që është mbajtur në këta muajt e fundit në Trieste, bashkë me Abaz Ermenin, me përfaqësuesit e «Ballit Kombëtar» e të «Legalitetit», me oficerin anglez Mak Lin² dhe me oficerë amerikanë, në të cilën mbledhje u morën vendime në lidhje me luftën që ata do t'i bëjnë vendit tonë. Më parë, më 1946 Mosha Pijade ka pasur një takim të fshehtë me Caldarisin, ku kanë biseduar për copëtimin e Shqipërisë midis Greqisë dhe Jugosllavisë. Në këtë mënyrë, udhëheqja e Beogradit është duke bashkëpunuar me të gjitha agjenturat imperialiste dhe fashiste që veprojnë në Shqipëri dhe jashtë Shqipërisë e me gjithë reaksionin e brendshëm e të jashtëm, me qëllim që të përmbysë pushtetin tonë popullor dhe vendi ynë të

1 Nga emri Makiaveli (1469—1527), personalitet politik dhe shkrimtar i Republikës së Firencës, i cili për realizimin e një qëllimi predikonte një politikë të tillë që nuk ndalej para asnjë mjeti mizor luftime, duke përdorur gënjeshtëri, hipokrizinë, tradhëtinë, pabesinë, vrasjen etj.

2 Mak Lin — oficer anglez, agjent i Inteligens Servis-it, kryetar i misionit ushtarak anglez pranë kriminelit Abaz Kupi.

copëtohet midis Jugosllavisë, Greqisë e Italisë, sipas planit të amerikanëve dhe anglezëve.

Që nga fillimi i këtij viti dhe deri në fund të shtatorit forcat e armatosura jugosllave kanë bërë më se 110 provokacione tokësore, ajrore dhe detare kundër integritetit tonë tokësor. Është interesant të shënohet se në muajin prill, numri i këtyre provokacioneve filloi të rritej, sepse atëhere Rankoviçi, shpresonte që me anën e provokacioneve në kufi, të inkurajonte kriminelët e diversantët që ndodheshin në Shqipëri, sepse atëhere ishte momenti kur «çelte gjethi» e kështu do të bëheshin të mundshme aksionet e të arratisurve. Gjatë verës së këtij viti jugosllavët kanë bërë një sërë operacionesh ushtarake për spastrimin e zonave kufitare me Shqipërinë nga elementët antititistë dhe internacionalistë. Këto operacione në stil të gjerë gjatë kufirit tonë kanë pasur për qëllim terrorizimin e popullsisë maqedonase, shqiptare dhe malazeze që banon në ato zona dhe për të frikësuar popullin tonë me zhurmën e armëve të jeniçerëve titistë.

Agjentura e Rankoviçit, e cila ka hedhur rrënjët e saja qysh gjatë luftës në vendin tonë, pas Rezolutës së Byrosë Informativë «Mbi gjendjen në Partinë Komuniste Jugosllave», u aktivizua për të zgjeruar radhët e saja në vendin tonë, për të shkaktuar dizorganizim, konfuzion, panik, sabotazh dhe terror. Sabotimet në stil të gjerë në transportin hekurudhor, vrasja e kryetarit të Komitetit ekzekutiv të lokalitetit të Hajmelit, vrasja e shokut Bardhok Biba, vrasja e sekretarit të organizatës bazë të Partisë të Kalasë së Dodës, vrasja e punëtorit operativ të Sigurimit të Shtetit në lokalitetin e Milotit, tentativa për «rrëmbimin» e Koçi Xoxes, tentativa për diversion në Minierën e Krrabës, organizimi i arratisjeve — të gjitha këto akte janë rezultati i punës së agjenturës së Rankoviçit në Shqipëri. Qeveria e Titos ka sabotuar dhe saboton sistematikisht lidhjet tona me botën e jashtme.

Paralel me veprimtarinë armiqësore të klikës së Titos, është duke u zhvilluar kundër nesh edhe veprimtaria armiqësore e monarko-fashistëve grekë dhe e reaksionarëve italianë. Metodatat e punës së qeverisë së Athinës kundër nesh, kanë qenë po ato të Beogradit. Që nga fillimi i këtij viti dhe deri në fund të shtatorit monarko-fashistët grekë kanë kryer më se 540 provokacione të armatosura tokësore, ajrore dhe detare kundër integritetit tonë tokësor. Pas muajit prill këto provokacione kanë ardhur duke u shtuar, sikurse edhe provokacionet e Rankoviçit, dhe kjo shpjegohet nga fakti që midis Beogradit dhe Athinës ka pasur një plan të përbashkët veprimi kundër Shqipërisë. Dihet se gjatë muajit gusht provokacionet monarko-fashiste morën karakterin e agresionit kundër integritetit tokësor të Republikës sonë, sepse toka jonë u sulmua nga njësi operative të rregullta të ushtrisë mo-

narko-fashiste, të përkrahura nga të gjitha llojet e armëve. Agresioni monarko-fashist kundër tokës sonë nuk kishte për qëllim vetëm marrjen e krahëve të Ushtrisë demokratike greke, që luftonte në Vici dhe në Gramos, por kishte për qëllim edhe zbulimin ushtarak në stil të gjerë, për të parë forcën e ushtrisë sonë, qëndrueshmërinë e mbrojtjes sonë. Me anën e provokacioneve të përbashkëta dhe me punën agjenturale e kundërrevolucionare të tyre në vendin tonë, jugosllavët e grekët menduan ta tronditnin pushtetin tonë, të krijonin një situatë të turbullt në Shqipëri, të inkurajonin reaksionin e brendshëm për t'u hedhur në sulm kundër pushtetit popullor dhe më vonë ndoshta edhe për të ndërhyrë ushtarakisht me forcat e tyre të rregullta për copëtimin e Shqipërisë. Ne disponojmë fakte që tregojnë se grupe elementësh reaksionarë në vendin tonë, të organizuar bashkërisht nga agjencura greke dhe jugosllave, ishin përgatitur të dilnin në mal në muajin gusht duke u armatosur nga Rankoviçi. Kjo koïncidonte me sulmin e ushtrisë monarko-fashiste greke kundër kufive tanë dhe me lëvizjen e trupave jugosllave në kufitë tanë veriorë. Por këto grupe reaksionare, të përbëra nga ballistë, zogistë dhe armiq të vjetër të popullit, u likuiduan në bërthamë nga organet tona të sigurimit dhe nga policia popullore, para se të kryenin «revoltën» e tyre kriminale. Gjithashtu forcat ushtarake greke që sulmuan tokën tonë në rajonin e Devollit, (brigadat 41 e 42 të Divizionit IX, si edhe repartet e tjera të ushtrisë greke), u mbytën në gjak në tokën tonë, ku lanë qindra të vrarë e të plagosur dhe pjesa tjetër u tërhoq e shpartalluar në tokën greke e ndjekur këmba-këmbës deri në kufi, nga ushtarët tanë trima. Të gjitha orvatjet e vazhdueshme të monarko-fashistëve grekë u asgjësuan plotësisht nga ushtria jonë në tokën tonë. Kështu, pra, plani greko-jugosllav gjatë këtij viti nuk mundi të realizohej, sepse Ushtria jonë Popullore e asgjësoi që në fillim agresionin monarko-fashist, sepse rojet tona të kufirit ishin vigjilente kundër qëllimeve të Titos, sepse reaksioni i brendshëm u mbërthye mirë nga darët e Sigurimit të Shtetit.

Në radhë të parë ky plan nuk u realizua sepse Partia jonë u tregua në lartësinë e detyrës së saj, e vendosur, e gatshme dhe e aftë për drejtimin e mbrojtjes së atdheut, sepse populli u tregua si kurdoherë i gatshëm për mbrojtjen e independencës dhe patriotizmi i masave u bë arma kryesore për mbrojtjen e atdheut. Fshatra të tëra, të rinj e pleq, me nisativën e tyre kërkonin të shkonin vullnetarisht në front për të mbrojtur kufitë, kur gjëmonte topi dhe mitralozi në luginën e Devollit. Është për t'u admiruar qëndrimi shembullor i katundarit të varfër mirditas, të cilit ju vra djali në piramidën Nr. 33 në luftimet e gushtit me monarko-fashistët grekë. Kur katundari mirditas shkoi të shihte varrin e djalit që ishte 500 metra afër kufirit, ai u interesua se

ku ishte vrarë ekzaktësisht djali i tij; dhe kur e pa se i biri ishte vrarë nga plumbat monarko-fashiste 50 metra nga piramida e kufirit, atëhere ai, duke ju drejtuar varrit të të birit, tha: «Të lumtë hej biri im se ke nderue vëdin, mue edhe vatanin, ke krye detyrën si të pata porositun kur të nisa për ushtri! Jam i kënaqun dhe jo i hidhnuem që re për vatanin!» Në këto ditë pleqtë patriotë të Shkodrës, ata që kishin luftuar kundër Turqisë dhe kundër të gjithë okupatorëve, i mësonin të rinjtë me fjalën e tyre patriotike të qëmtohmë: «Kur është puna për atdheun, flaka asht ma e ambël se mjalti!»

Plani armiqësor i qeverive të Beogradit e Athinës kundër Shqipërisë nuk u realizua, sepse Shqipëria nuk është vetëm, sepse ajo është pjesë integrale e kampit demokratik me Bashkimin Sovjetik në krye, se për armiq të jugosllavë e grekë u bë e qartë që çështja e Shqipërisë ishte çështje e kampit demokratik.

Qeveria e Romës edhe ajo ka luajtur rolin e saj në këtë lodër gjarpërinjsh rreth atdheut tonë. Ajo ka furnizuar Jugosllavinë e Greqinë me kuadro të spiunazhit e të diversionit që janë përgatitur në Itali për t'i hedhur ilegalisht në Shqipëri. Italia e De Gasperit sot është transformuar në një kazermë të të gjithë reaksionarëve që janë arratisur nga vendet e demokracisë popullore dhe në një laborator komplotesh kundërrevolucionare, kundër vendeve të demokracisë popullore. Natyrisht «komandantët» e këtyre kazermave dhe «doktorët» e këtyre laboratorëve janë amerikanët dhe anglezët. Vetëvetiu kuptohet se midis Beogradit, Athinës e Romës duhet të ketë një marrëveshje sekrete kundër Shqipërisë të diktuar nga amerikanët.

4. — Organizimi dhe aktivizimi i reaksionit shqiptar në emigracion nga amerikanët, anglezët dhe fqinjët tanë

Më 1947 shoku Zhdanov ka thënë se qëllimi kryesor i kampit imperialist është forcimi i imperializmit, përgatitja e një lufte të re imperialiste, lufta kundër socializmit e demokracisë dhe mbështetja e gjithanshme e regjimeve dhe e lëvizjeve reaksionare antidemokratike dhe profashiste. Në zbatimin e këtyre detyrave kampi imperialist është i gatshëm që të mbështetet në forcat reaksionare dhe antidemokratike në të gjitha vendet dhe të mbështetet kriminelët e djeshëm të luftës kundër aleatëve të tyre të luftës.

Pikërisht këtë gjë janë duke bërë imperialistët edhe në drejtim të Shqipërisë. Ata janë duke përkrahur moralisht e materialisht reaksionin e brendshëm të cili mbështetet për qëllimet e tyre kundër vendit tonë. Ata përkrahin në të gjitha pikëpamjet kriminelët e luftës që mundën të arratiseshin nga Shqipëria nga

fundi i Luftës sonë nacional-çlirimtare dhe që janë grumbulluar në Itali, Greqi e Jugosllavi, ku organizohen, armatosen dhe stërviten nga imperialistët për t'u përdorur kundër Republikës sonë Popullore. Këta muajt e fundit, pas përpjekjesh të gjata për të shehshuar kontradiktat e brendshme midis grupeve të ndryshme të emigracionit shqiptar («Balli Kombëtar», «Legaliteti», «Bloku Independent», «Partia Agrare»), amerikanët mundën të formonin Komitetin «Shqipëria e Lirë»¹ me elementët më reaksionarë të emigracionit shqiptar me Mithat Frashërin në krye. Duhet shënuar se Komiteti «Shqipëria e Lirë» u formua pikërisht atëhere kur dështoi plani i parë greko-jugosllav, d.m.th. pas luftimeve të gushtit 1949 në kufirin greko-shqiptar. Kuptohet vetëvetiu se me anën e Komitetit «Shqipëria e Lirë» dhe të komitetit të Gani Kryeziut, imperialistët amerikanë dhe ata anglezë, të përkrahur nga qeveritë e Beogradit, Athinës e Romës, do të përpiqen të organizojnë reaksionin shqiptar kundër pushtetit tonë popullor.

Ne jemi përgatitur kundër çfarëdo tentative të armiqve tanë dhe jemi plotësisht të sigurtë në dështimin e çfarëdo plani të armikut, për arësyen e thjeshtë se jemi të fortë dhe kemi miq shumë më të fortë se sa i gjithë kampi imperialist. Por imperializmi shpresat e tija nuk i humbet deri në varr dhe është i detyruar të tërhiqet para forcës së kampit demokratik duke rezistuar «me thonj e me dhëmbë» për të mbrojtur ekzistencën e tij, dhe kjo rezistencë nuk është shenjë e forcës së tij, por është shenjë e dobësisë së tij.

Dëshira e imperialistëve është likuidimi i independencës sonë kombëtare. Por midis dëshirës e realizimit ka një distancë shumë të madhe. Shumë plane janë bërë deri më sot kundër Republikës sonë, por asnjë nga këto plane nuk ka dalë me sukses. Janë të panumërta planet dhe stërplanet që ka pasë bërë imperializmi kundër Bashkimit Sovjetik, porse asnjë nga këto nuk ka dalë me sukses deri më sot. Shqipëria sot nuk është më ajo e 1919-s², dhe

¹ Pas dështimit të planit të parë të imperialistëve kundër vendit tonë në provokacionet e gushtit 1949 në kufirin greko-shqiptar, u formua, me ndihmën e amerikanëve, Komiteti «Shqipëria e Lirë». Komiteti kishte për qëllim të shuante kontradiktat e brendshme që ekzistonin midis grupeve të ndryshme të emigracionit reaksionar shqiptar («Balli Kombëtar», «Legaliteti», «Bloku Independent», «Partia Agrare» etj.). Në Komitetin «Shqipëria e Lirë» bënin pjesë elementët më reaksionarë të emigracionit shqiptar me në krye Mithat Frashërin. Pas vdekjes së Mithat Frashërit kryesinë e këtij komiteti e mori tradhëtari Hasan Dosti. Edhe pas formimit të këtij komiteti kontradiktat që ekzistonin në gjirin e emigracionit reaksionar vazhduan.

² Më 18 janar 1919 u hap Konferenca e Paqes në Paris e organizuar nga 5 fuqitë fituese të Luftës së parë botërore: SHBA-ja, Anglia, Franca,

as ajo e 1939-s. Plani i armiqve tanë do të dështojë patjetër. Cilët janë faktorët që përcaktojnë pamundësinë e realizimit të qëllimeve të armikut kundër vendit tonë? Këta faktorë janë:

a) *Forca e shtetit tonë popullor, vitaliteti i popullit tonë dhe forca drejtuese e Partisë sonë.* Sot ne jemi më të fortë se kurrë në të gjitha pikëpamjet. Kthesa e Partisë është realizuar me sukses dhe Partia jonë sot paraqitet monolite, vigjilente, e vendosur, e gatshme dhe e fortë, ajo ka qenë dhe është kurdoherë në krye të situatës si forca drejtuese e shtetit dhe e popullit tonë, në rrugën e drejtë të marksizëm-leninizmit. Momentet më kritike ne i kemi kaluar me sukses dhe kemi dalë triumfues. Këto momente të vështira për ne ishin sot e një vit më parë kur ekonomia jonë ishte përtokë, kur na mungonte buka dhe artikujt e konsumit të gjerë, si konsekuencë e tradhëtisë së Titos, kur reaksionit i paraqitej një farë situatë e favorshme «për të peshkuar në ujë të turbullt», kur kthesa jonë porsa kishte filluar të realizohej, kur Sigurimi i Shtetit ishte në fazën e riorganizimit që duhej kryer nën presionin e reaksionit. Sot ekonomia jonë është shumë më përpara se atëhere. Bukën e kemi të siguruar, artikujt e konsumit të gjerë nuk na mungojnë si atëhere, forca ekonomike e shtetit tonë është rritur dhe po rritet çdo ditë e më tepër, çmimet janë duke zbritur, tregu ka filluar të gjallërohet.

Ajo që ka rëndësi më tepër se çdo gjë tjetër është uniteti i udhëheqjes së Partisë, i cili është i siguruar sepse udhëheqja është spastruar nga armiqët më të rrezikshëm, nga agjentët e Titos qysh në Plenumin XI dhe sot Partia e pushteti janë në duar të forta dhe të sigurta. Sot ushtria jonë është më e fortë se kurrë. Sigurimi i Shtetit është bërë armë e fortë në duart e shtetit dhe të Partisë. Patriotizmi i popullit, i shprehur në zgjedhjet e fundit ku më se 98 për qind të votuesve votuan për Frontin Demokratik, në huan e shtetit ku plani u tejkalua me lehtësi të madhe, në grumbullimin e bereqetit ku plani po realizohet në mënyrë të kënaqshme, në mbështetjen efektive që u japin masat e gjera punonjëse urdhëresave të qeverisë, në gatishmërinë e popullit për të mbrojtur atdheun dhe në punën e përditshme për realizimin e planit të shtetit — ky patriotizëm i masave tona punonjëse është një faktor me shumë rëndësi për ne. Pushteti ynë është duke u forcuar. Rinia jonë qëndron si kurdoherë në ballë të luftës për ndërtimin e socializmit në vendin tonë. Pra, faktorët Parti-popull-pushtet-ushtri-rini janë garanci për falimentimin e planit të armikut.

Italia dhe Japonia. Qëllimi ishte të ndanin botën sipas interesave të tyre.

Konferenca diskutoi dhe çështjen shqiptare dhe e trajtoi atë siç e kërkoi interesat e fuqive të mëdha imperialiste. Ndërsa Italia, Greqia, Jugosllavia qëndronin dhe luftonin që të ruanin pretendimet e tyre për copëtimin e Shqipërisë.

b) *Forca e kampit demokratik.* Gënjejhen rëndë ata që mendojnë se Shqipëria është vetëm dhe mund të gëlltitet kollaj. Çështja e independencës së Shqipërisë, sot, nuk është vetëm çështja e popullit shqiptar, por është çështje e kampit demokratik që është shumë më i fortë se sa kampi imperialist. Çështja jonë është e drejtë, është në rrugën që na mëson Marks, Engelsi, Lenini dhe Stalini. Prandaj ne jemi të fortë.

c) *Kontradiktat e brendshme të armiqve tanë.* Reaksionit i mungon uniteti ideologjik, politik dhe organizativ, të cilat ai nuk mund t'i ketë kurrë. Kontradiktat në gjirin e reaksionit shqiptar janë shumë të mëdha dhe të pakapërcyeshme, sepse të gjithë krejtë e reaksionit duan të bëhen kryetarë dhe komandantë, që nga Zogu, te Abaz Kupi, Gjon Marka Gjoni, Abaz Ermeni, Xhafer Deva, Gani Kryeziu, Muharrem Bajraktari, Hysni Dema etj. Gjithashtu kontradiktat midis fqinjëve tanë dhe reaksionit shqiptar janë të mëdha. Komiteti «Shqipëria e Lirë» rivendikon Kosovën, Greqia rivendikon Korçën e Gjirokastrën. Titua Kosovën nuk e jep sepse kërkon që e gjithë Shqipëria të bashkohet me Kosovën në kuadrin e RFJ sado që është gati t'i japë mercenarë Komitetit «Shqipëria e Lirë» për të luftuar kundër nesh ashtu sikundër kralj Aleksandri i dha Zogut ushtrinë kundërrevolucionare të Vrangelit më 1924 për të ardhur në fuqi. Kështu që armiqtë tanë paraqiten, siç tha shoku Enver në Shkodër, si «një stan çakejsh dhe lepujsh». Ne kemi besim të plotë se Kosova nuk do të lejojë që të bëhet rezervë e imperializmit kundër atdheut të vet, Shqipërisë. Hesapet mbi kokën e popullit të Kosovës nga armiqtë tanë janë bërë «pa hanxhinë» dhe hanxhiu në këtë rast është populli i Kosovës.

Këta janë, pra, faktorët që determinojnë pamundësinë e realizimit të planeve të armiqve tanë kundër Republikës sonë. Ne kemi besim të plotë në forcat tona dhe në sukseset që do të korrim edhe në të ardhshmen në ndërtimin e socializmit në vendin tonë, në ruajtjen e independencës sonë dhe në ruajtjen e interesave të përgjithshme të kampit demokratik, këtu në prapavijat e armikut.

5. — Detyrat tona

Ç'detyra na dalin në lidhje me këtë situatë? Çfarë duhet bërë nga ana jonë në mënyrë që armiku të diktohet me kohë dhe të goditet e të asgjësohet? Në lidhje me këtë situatë, Partisë sonë i dalin detyra me shumë rëndësi:

a) Në radhë të parë ne duhet të mobilizohemi totalisht për realizimin e planit të shtetit. Kjo ka qenë caktuar si detyrë kryesore për ne nga Kongresi I i Partisë dhe kështu mbetet edhe tani. Realizimi i planit ekonomik të shtetit është konditë e domosdoshme

për ndërtimin e socializmit. Puna e armikut mund të zërë vend atëhere kur gjendja jonë ekonomike është e vështirë dhe puna jonë politike e dobët. Çdo komunist dhe patriot i ndershëm duhet ta ketë të qartë se plotësimi i detyrave që u ngarkon Partia në lidhje me realizimin e planit është detyrë patriotike numër një. Patriot i mirë dhe komunist i mirë është ai që plotëson detyrën kundrejt shtetit. Ai që nuk e kryen detyrën, ai që nuk e realizon planin, ai nuk ka ndihmuar popullin, por, me dashje ose pa dashje, ka ndihmuar armikun, sepse mosrealizimi i planit të shtetit nuk është veçse në favorin e armikut dhe në dëm të tonë. Armiku e di mirë rëndësinë që ka për ne realizimi i planit të shtetit. Prandaj në radhë të parë ai mundohet që të na goditë në këtë sektor. Armiku e di mirë që, në rast se nuk bëhet buka ose nuk prodhohet veshmbathja dhe populli nuk furnizohet në rregull, fjala e armikut zë vend kollaj. Prandaj vlera e njerëzve duhet të matet me rendimentin që ata japin në punën që u ka ngarkuar Partia dhe shteti.

b) Paralel me mobilizimin për realizimin e planit të shtetit, duhet të mobilizohemi për të forcuar vigjilencën revolucionare. Sa më të ngritur politikisht e ideologjikisht të jemi, aq më lehtë do të jetë për ne që të jemi vigjilentë kundrejt punës së armikut. Armiku punon në forma të ndryshme, me metoda të ndryshme, të cilat ne duhet t'i zbulojmë e t'i luftojmë.

Ku duhet kërkuar armiku? Si ta zbulojmë armikun? Në radhë të parë duhet të dimë se armiku përdor si metodë kryesore pune propagandën që ka për qëllim popullarizimin e mbivlerësimit e forcës së imperialistëve dhe nënvleftësimin e forcës sonë dhe të gjithë kampit demokratik, mbjelljen e panikut dhe krijimin e mosbesimit në forcat tona. Prandaj armiku hedh parulla në këtë drejtim. Është konstatuar se anëtarët e Partisë nuk kanë qenë kurdoherë në lartësinë e detyrës së tyre për të luftuar parullat e armikut. Po të kishin qenë të vërteta parullat e armikut, Shqipëria do të ishte invaduar nga armiqtë e saj të jashtëm. . . Anëtarët e Partisë e kanë për detyrë që të gjitha parullat e armikut t'i luftojnë dhe përhapësit e këtyre parullave t'i gjurmojnë, t'i zbulojnë dhe t'i demaskojnë menjëherë në vend, pa asnjë hezitim. Për të mos zënë vend puna e armikut dhe për ta luftuar këtë efektivisht, Partisë i bie si detyrë forcimi i punës ideo-politike me anëtarët e Partisë dhe sqarimi i popullit.

Sabotazhi ekonomik është edhe ky një nga metodat kryesore të punës së armikut. Ne duhet të dimë se atje ku nuk zbatohet plani i prodhimit, diçka duhet të ketë: ose ka arësye konkrete që justifikojnë drejt moszbatimin e planit të prodhimit, ose ka punë armiqësore. E vërteta do të dalë në shesh vetëm në bazë të një analize konkrete të shkaqeve që përcaktojnë mosrealizimin e planit. Atje ku digjet motori, ose përzihet sheqeri me kripë, ose kur dër-

gohen këpucë me thundra të gjata në vend që të dërgohet pëlhurë etj. si këto raste, duhet parë mirë se përse ka ndodhur kështu. Atje ku motorit i hidhet vaj i përzier me rërë ose ku maqina shirëse digjet gjoja nga pakujdesia, ose lokomotiva digjet «për mungesë uji», ose kur patatet kalben gjoja për mungesë transporti etj. duhet parë mirë përse ka ndodhur kështu, ka ndodhur me të vërtetë për arsye objektive apo është akt diversioni i armikut. Format e sabotazhit dhe të diversionit janë të shumëllojta dhe vetëm vigjilenca revolucionare e komunistëve mund t'i zbulojë elementët armiq. Prandaj vigjilenca revolucionare është një detyrë me rëndësi të madhe për çdo anëtar partie dhe të mos harrojmë fjalën e Leninit sipas së cilës «çdo komunist i mirë është dhe një çekist i mirë» d.m.th. që çdo komunist i mirë është njëkohësisht edhe një punëtor i mirë i sigurimit. Duhet theksuar se lufta kundër armikut nuk bëhet vetëm nga organet e Sigurimit të Shtetit, por bëhet nga e gjithë Partia, nga të gjitha masat punonjëse.

c) Anëtarët e Partisë duhet të jenë kurdoherë të gatshëm për të mbrojtur me çdo mënyrë që të jetë e nevojshme Partinë dhe popullin. Masave punonjëse u duhet sqaruar mirë puna e armikut, qëllimet dhe rrezikshmëria e tij. Të gjithë anëtarët e Partisë dhe të gjitha masat punonjëse duhet ta kuptojnë dhe të bëhen të ndërgjegjshme se socializmi nuk importohet, por ndërtohet në vend dhe nuk ndërtohet pa sakrifica, se rruga jonë është plot me vështirësi dhe duhet të mësohemi si të jetojmë me vështirësitë dhe si t'i kapërcejmë këto vështirësi. Duhet të mësojmë shumë në këtë drejtim nga eksperiencia e popujve sovjetikë, që po luftojnë prej më se 31 vjetësh jo vetëm për veten e tyre, por për të gjithë botën përparimtare, për të gjithë popujt, edhe për popullin tonë, që në rrugën e tyre të lavdishme të ndërtimit të socializmit kanë hasur dhe kanë kapërcyer pengesa dhe vështirësi shumë të mëdha, që u është dashur të dërmonin kundërrevolucionin, të thyenin intervencionin ushtarak të imperialistëve, të ndërtonin socializmin të vetëm e nën rrethimin e kapitalizmit dhe të luftonin e të fitonin kundër fashizmit. Kushdo që ankohet nga vështirësitë që has përpara, le të kujtojë fjalët e shokut Stalin në kongresin e kolkozianëve më 1933. Atëhere shoku Stalin ka thënë:

«Po a e dini ju se sa u kanë kushtuar punëtorëve të Leninogradit dhe të Moskës këto suksese, se ç'kanë hequr ata derisa, më në fund, i kanë arritur këto suksese? Unë mund t'ju tregoj disa fakte nga jeta e punëtorëve më 1918, kur me javë të tëra punëtorëve nuk u jepej asnjë copë bukë, pa le pastaj mish dhe sende të tjera ushqimore. Ditët më të mira në atë kohë ishin ato ditë, kur punëtorët e Leninogradit dhe të Moskës merrnin nga 50 gram bukë thekre,

edhe kjo e përzier përgjysmë me krunde. Kjo vazhdoi jo një muaj e as gjashtë, por plot dy vjet. Mirëpo, punëtorët duruan dhe nuk e humbën besimin, sepse ata e dinin se do të vinin kohë më të mira dhe do të korrnin suksese vendimtare. Dhe, siç e shihni, punëtorët nuk u gabuan»¹.

Në këto kondita e kanë ndërtuar socializmin punëtorët sovjetikë. Po të kemi parasysh se ç'kanë hequr popujt e Bashkimit Sovjetik për të ndërtuar socializmin dhe çfarë jete të lumtur bëjnë ata sot, të cilën e kanë ndërtuar me duart e tyre, do të marrim kurajë dhe hov të ri për të kapërcyer vështirësitë që hasim në rrugën tonë.

c) Sigurimi i Shtetit duhet të perfeksionojë organizimin dhe metodat e punës, të vazhdojë rrugën që i ka caktuar Partia dhe që e ka ndjekur me sukses, të jetë i pamëshirshëm për armiqtë e popullit dhe i dashur me popullin. Organet e drejtësisë duhet të bëjnë përpjekje për t'u spastruar nga konceptet oportuniste në të cilat kanë rënë, nga influenca e presionit të borgjezisë dhe të jenë të rreptë, të drejtë dhe të pamëshirshëm kundrejt armiqve dhe keqbërësve. Ushtria Popullore duhet të qëndrojë siç ka qëndruar kurdoherë — roje vigjilente e pavarësisë së atdheut tonë.

Në këtë mënyrë, duke mobilizuar Partinë, pushtetin dhe masat punonjëse në këto drejtime, do të mund të korrim suksese të reja në rrugën tonë dhe ta çojmë flamurin tonë të fitores lart e më lart.

*Botohet sipas broshurës:
Raport i Byrosë Politike të KQ
të PPSH «Mbi gjendjen politike të Shqipërisë» mbajtur
nga shoku Mehmet Shehu*

¹ J. V. Stalin. Veprat, vëll. 13, f. 235.

REZOLUCION

I PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH MBI ÇËSHTJET EKONOMIKE DHE GJENDJEN POLITIKE TË SHQIPËRISË

13 tetor 1949

Prej 11 deri më 13 tetor 1949 u mbajt mbledhja e Plenumit III të Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë. Pasi dëgjoi, shqyrtoi dhe aprovoi raportin e shokut Spiro Koleka «Mbi çështjet ekonomike» dhe raportin e shokut Mehmet Shehu «Mbi gjendjen politike të Shqipërisë», plenumi mbërriti në këto konkluzione:

1. — Marrëveshjet ekonomike me Bashkimin Sovjetik dhe me demokracitë popullore që ne bëmë në fillim të këtij viti, sukseset në realizimin e planit të shtetit (me gjithë mungesat që janë vërtetuar në realizimin e këtij plani), vënja në zbatim e sistemit të ri të grumbullimit e të furnizimit, realizimi me sukses i huas së shtetit, të korrurat e kënaqshme dhe realizimi i grumbullimit të grurit, zhvillimi i arësimit, i artit e i kulturës në interes të masave punonjëse, forcimi i gjithanshëm i marrëdhënjeve me Bashkimin Sovjetik dhe demokracitë popullore, pastrimi i vendit nga agjentura titiste dhe goditjet e ashpra që i kemi dhënë vazhdimisht punës armiqësore të reaksionit të jashtëm dhe të brendshëm në vendin tonë, të gjitha këto fakte dëshmojnë zhvillimin dhe forcimin e gjithanshëm të Republikës sonë Popullore.

2. — Në gjashtëmujorin e parë, plani ekonomik i shtetit nuk ka qenë realizuar në mënyrë të kënaqshme, për shkak të mungesës së një preokupacioni të mjaftueshëm nga ana e organeve të Partisë dhe të pushtetit për të kapërcyer vështirësitë e mëdha që na dolën përpara si rrjedhim i punës armiqësore të klikës së Titos kundër vendit tonë dhe për shkak të mungesës së operativitetit, të organizimit dhe të kontrollit në punë.

3. — Në tremujorin e tretë konstatohet një përmirësim i dukshëm në realizimin e planit ekonomik të shtetit. Ky përmirësim u arrit nga masat energjike që mori Komiteti Qendror i Partisë dhe qeveria, për të luftuar të metat e konstatuara gjatë gjashtëmujorit të parë, nga një mobilizim më i madh i kuadrove dhe i

masës së Partisë dhe të pushtetit dhe sidomos i klasës punëtore. Megjithatë, realizimi i planit të shtetit në disa sektorë kryesorë të ekonomisë sonë, si në industri dhe në bujqësi, është jo i kënaqshëm. Kjo ka ndodhur në radhë të parë për shkak se njerëzve drejtues të këtyre sektorëve u ka munguar kapaciteti drejtues dhe nuk kanë mundur ta organizojnë në mënyrë të kënaqshme punën e tyre. Në këta dy sektorë, më tepër se kudo gjatë, konstatohet kujdes i paktë për organizimin e jetesës së punëtorëve, mungesa e kontrollit të rreptë në zbatimin e vendimeve dhe e kërkesës së llogarisë mbi plotësimin e detyrave dhe mungesa e organizimit të mirë të emulacionit socialist në punë.

4. — Lufta e klasave në vendin tonë po vete duke u ashpërsuar çdo ditë e më tepër e kjo shpjegohet nga fakti se ekonomia jonë është duke u zhvilluar në rrugën drejt socializmit, nga rritja e gjithanshme e forcës së Republikës sonë, si rezultat i zhvillimit të gjithanshëm të jetesës sonë në rrugën e ndërtimit të socializmit. Zhvillimi i ekonomisë sonë popullore kryhet nëpërmjet luftës së ashpër me elementin kapitalist të qytetit e të fshatit që bën rezistencë. Kjo rezistencë e elementëve armiq të klasës nuk tregon forcën, por dobësinë e tyre.

5. — Gjatë kthesës që bëri Partia jonë, presioni i borgjezisë u ushtrua i fortë dhe i gjithanshëm mbi Partinë dhe pushtetin tonë dhe ky presion pati efektin e vet negativ në disa anëtarë të Partisë sonë, si shfaqje keqinterpretimesh të demokracisë së brendshme të Partisë, shtrembërime të kritikës dhe të autokritikës, shturje të disiplinës e të përgjegjësisë personale dhe shfaqje të oportunizmit. Oportunizmi u shfaq dhe filloi të bëhet një vijë e tërë në organet e prokurorive dhe të gjykatave tona, që filluan të vepronin në rrugë të gabuar duke e konsideruar veten si institucione që veprojnë «jashtë» luftës së klasave dhe sollën si konsekuencë zbutjen e masave dhe të dënimeve kundër elementit armik. Të gjitha këto shfaqje të gabuara dhe antimarksiste janë goditur nga Komiteti Qendror i Partisë dhe prokuroritë e qytetit janë duke u vënë në rrugën e drejtë.

6. — Imperializmi anglo-amerikan, i përkrahur nga Greqia monarko-fashiste, nga klika trockiste e Titos dhe nga reaksioni italian është munduar të organizojë forcat e reaksionit shqiptar kundër pushtetit tonë. Koha që nga dalja e Rezolucionit të Informbyrosë «Mbi gjendjen në Partinë Komuniste Jugosllave» dhe deri sot karakterizohet nga intensifikimi i veprimtarisë armiqësore të klikës së Titos, të monarko-fashistëve grekë dhe të imperializmit anglo-amerikan me qëllim që të përmbysin pushtetin tonë popullor dhe ta copëtojnë Shqipërinë. Këto tentativa deri sot kanë falimentuar në saje të patriotizmit, të unitetit dhe të vitalitetit të popullit tonë, të aftësisë drejtuese të Partisë sonë, të forcës së push-

tetit tonë e të kampit demokratik me Bashkimin Sovjetik në krye. Me gjithë disfatat e deritanishme që ka pasur reaksioni i brendshëm dhe i jashtëm në punën e vet kundër Republikës sonë, armiqtë tanë të jashtëm dhe të brendshëm do të mundohen që të na luftojnë vazhdimisht. Prandaj anglo-amerikanët të ndihmuar nga klika e Titos janë duke rigrupuar dhe riorganizuar reaksionin shqiptar në emigracion. Por të gjitha planet e armiqve tanë do të falimentojnë siç kanë falimentuar, sepse populli ynë, krahas me popujt e vendeve të demokracisë popullore dhe forcat e tjera përparimtare në botë, me në krye Bashkimin Sovjetik, luftojnë për paqen, sepse forca jonë dhe e miqve tanë të kampit demokratik është e pathyeshme dhe shumë më superiore se forca e armiqve tanë.

Duke marrë parasysh konkluzionet e mësipërme, Plenumi III i Komitetit Qendror

Vendosi:

1. — Të mobilizohen të gjitha organizatat e Partisë dhe masat punonjëse për realizimin e planit të shtetit. Realizimi i planit të shtetit të konsiderohet si detyrë patriotike me shumë rëndësi për çdo nënshtetas të Republikës sonë. Të vendoset një regjim i rreptë në kontrollin e zbatimit të vendimeve dhe në dhënjen llogari për plotësimin e detyrave të ngarkuara. Të merren masa të rrepta ndaj neglizhuesve e shpërdoruesve të pasurisë shtetërore dhe të organizohet më mirë ndihma dhe kontrolli nga lart-poshtë. Atje ku nuk realizohet plani i shtetit, organizata e Partisë duhet të analizojë dhe të gjejë shkaqet e vërteta të mosrealizimit, të mobilizohet për kapërcimin e vështirësive dhe për zhdukjen e të metave.

2. — Të merren masa urgjente për përmirësimin e jetesës së punëtorëve dhe në radhë të parë në Minierën e Krrabës, në Sharrat e Pukës dhe në Patos. Të gjithë komunistët dhe punëtorët e Kombinativit vajguror Kuçovë-Patos dhe sidomos ata të Patosit duhet të mobilizohen që në tremujorin e katërt të mund të mbulojnë sa më shumë deficitin e deritanishëm të prodhimit dhe të krijojnë konditat organizative dhe materiale që gjatë vitit 1950 të realizohet plotësisht plani i prodhimit dhe të mbulohet edhe deficitin e vitit 1949. Komunikacioni duhet të realizojë me çdo kusht transportimin e kromit në portet tona për eksportin dhe të plotësojë planin e vitit deri në fund të tremujorit të katërt. Gjithashtu në lidhje me transportimin e kromit, ai të mundohet të mbulojë sa më shumë deficitin e transportit në sektorët e tjerë.

Bujqësia të marrë masa të menjëhershme për organizimin më të mirë të punës në fermat e shtetit, në SMT-të, në ndërmarrjet blegtorale, të organizojë dhe të kryejë matjen e tokave dhe plotësimin e planit të mbjelljeve të vjeshtës.

Tregëtia duhet të përpiqet që të shkurtojë sa më shumë deficitin e eksportit dhe të kryejë brenda tremujorit të katërt inventarizimin e rezervave të shtetit në mënyrë që të mund të shkurtojë planin e importit të këtij viti për ato materiale që mund të gjenden këtu në vend.

3. — Brenda tremujorit të katërt të bëhet kategorizimi i ri i punëtorëve dhe i nëpunësve, i cili të bazohet në parimin «secilit sipas punës». Të merren masa organizative dhe praktike për të forcur emulacionin në punë në të gjitha qendrat e punës. Të vendosen normat në punë kudo ku ka mundësi. Dita e përvjetorit të pestë të çlirimit të Shqipërisë, 29 Nëntori, të shërbejë për një mobilizim më të madh të të gjitha masave punonjëse për realizimin e planit të shtetit.

4. — Të forcohet vigjilenca revolucionare e anëtarëve të Partisë dhe e të gjitha masave punonjëse, sidomos në sektorin ekonomik, ku armiku do të mundohet të sabotojë realizimin e planit të shtetit. Anëtarët e Partisë duhet të jenë të parët që të zbulojnë parullat dhe punën armiqësore, ta demaskojnë armikun dhe ta luftojnë pa mëshirë. T'u shpjegohet masave punonjëse gjendja politike dhe të mobilizohen këto për të luftuar të gjitha vështirësitë që hasim. Përforcimi i punës ideo-politike dhe sqarimi i anëtarëve të Partisë dhe masave punonjëse mbi zhvillimin e ngjarjeve të rëndësishme ndërkombëtare do të ndihmojë në forcimin e vigjilencës revolucionare.

5. — Anëtarët e Partisë dhe të gjithë patriotët e ndershëm duhet të jenë kurdoherë të gatshëm për të mbrojtur Partinë dhe popullin. Prandaj të punohet për forcimin e ndjenjës patriotike, për mbrojtjen e pavarësisë, të interesave të popullit tonë dhe të kampit demokratik. Në këtë drejtim duhet të zhvillohet puna politike e pandërprerë me masat punonjëse për të vënë në dukje forcën e pathyeshme të kampit demokratik me Bashkimin Sovjetik në krye, forcën dhe vitalitetin e popullit tonë si dhe dobësimin e përditshëm të forcave të imperializmit.

6. — Organizatat e Partisë të tregojnë më tepër kujdes për sindikatat, për rininë dhe për gruan. Të punohet për forcimin organizativ të Partisë duke edukuar pa ndërprerje të gjithë anëtarët e Partisë dhe duke spastruar radhët e saja nga elementët që janë të pavlefshëm dhe që janë bërë pengesë për Partinë. Anëtarët e Partisë duhet ta ndjejnë si detyrë kryesore perfeksionimin e tyre për të zotëruar teknikën.

7. — Organet e drejtësisë duhet të luftojnë për t'u spastruar nga influenca e ideologjisë borgjeze që është shfaqur në këto organe gjatë këtij viti. Organet e Sigurimit të Shtetit duhet të forcojnë vigjilencën e tyre dhe të godasin armikun pa mëshirë.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë

PLENUMI IV I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Tiranë, 27 dhjetor 1949

KOMUNIKATË

E PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Më 27 të këtij muaji u mbledh Plenumi IV i zgjeruar i Komitetit Qendror të PPSH, nën kryesinë e Sekretarit të Përgjithshëm të Partisë, shokut Enver Hoxha, për të diskutuar rezultatet e mbledhjes së Byrosë Informative që u zhvillua në Hungari në 15-ditëshin e fundit të muajit nëntor.

Plenumi dëgjoi dhe diskutoi raportin «Mbi mbrojtjen e paqes dhe luftën kundër nxitësve të luftës», raportin «Mbi unitetin e klasës punëtore dhe detyrat e partive komuniste dhe punëtore» dhe raportin «Partia Komuniste Jugosllave në duart e vrasësve dhe të spiunëve».

Plenumi u solidarizua plotësisht me rezolutat e Byrosë Informative dhe nxori detyrat që i dalin përpara Partisë dhe popullit tonë në dritën e këtyre rezolutave.

Plenumi mori vendime për organizimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të aktivitetit për mbrojtjen e paqes, për forcimin e Republikës sonë Popullore, për realizimin e planit ekonomik të shtetit dhe për forcimin e miqësisë me popujt sovjetikë dhe të lidhjeve me Bashkimin Sovjetik, i cili, i udhëhequr nga Stalini i madh, qëndron në ballë të luftës për paqen, lirinë, demokracinë dhe demaskon planet kriminale të nxitësve të një lufte të re.

Plenumi aprovoi vendimin e Byrosë Politike që rezolutat e Byrosë Informative si dhe vendimet e plenumit në fjalë të punohen në mbledhjet e aktiveve të Partisë në rrethe, në organizatat bazë të Partisë dhe në masat e gjera të popullit.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

VENDIM

I PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH «MBI DETYRAT E PARTISË SONË NË DRITËN E REZOLUCIONIT TË BYROSË INFORMATIVE»

27 dhjetor 1949

Më 27 të këtij muaji u mbledh Plenumi IV i zgjeruar i Komitetit Qendror të PPSH nën kryesinë e Sekretarit të Përgjithshëm të Partisë, shokut Enver Hoxha, për të diskutuar rezolucionin e mbledhjes së Byrosë Informative që u zhvillua në Hungari në 15-ditëshin e fundit të muajit nëntor.

Plenumi dëgjoi dhe diskutoi raportin «Mbi mbrojtjen e paqes dhe luftën kundër nxitësve të luftës», raportin «Mbi unitetin e klasës punëtore dhe detyrat e partive komuniste dhe punëtore» dhe raportin «Partia Komuniste Jugosllave në duart e vrasësve dhe të spiunëve.»

Plenumi u solidarizua plotësisht me rezolutat e Byrosë Informative dhe nxori detyrat e mëposhtme që i vihen përpara Partisë dhe masave punonjëse të vendit tonë, në dritën e këtyre rezolutave:

1. — Partia dhe populli ynë janë për paqen, demokracinë dhe socializmin në mënyrë aktive, ashtu siç janë komunistët dhe gjithë forcat e kampit demokratik antiimperialist me Bashkimin Sovjetik në krye, sepse lufta për mbrojtjen e paqes, është luftë për pavarësinë kombëtare, luftë për ndërtimin e socializmit e të komunizmit. Por ne nuk e lypim paqen, ne e ndërtojmë atë dhe luftojmë për mbrojtjen e saj. Këtë del detyra që të mobilizojmë të gjitha forcat e popullit tonë, pa dallim feje dhe bindje politike, të gjithë njerëzit e ndershëm, patriotë e paqedashës, në luftën për mbrojtjen e paqes, kundër nxitësve të një lufte të re. Partia jonë, qeveria dhe masat e gjera punonjëse të vendit tonë kanë dhënë, deri sot, shumë prova në luftën e përgjithshme për mbrojtjen e paqes. Anëtarët e Partisë dhe masat e popullit duhet të kuptojnë drejt situatën, të njohin fitoret e mëdha të kampit të demokracisë, rritjen dhe konsolidimin e forcave të paqes të udhëhequra nga Bashkimi i lavdishëm Sovjetik, ata duhet të shohin njëkohësisht dobësimin e mëtejshëm të kampit imperialist, thellimin e kontradiktave të tija të brendshme që vijnë dita-ditës duke u ashpërsuar dhe që përgatitin varrin e tij; por anëtarët e Partisë dhe masat e popullit tonë duhet ta vlerësojnë mirë situatën. Ata nuk duhet të nënvleftësojnë për asnjë çast rrezikun e një lufte të re, të cilën imperialistët amerikanë-anglezë dhe satelitët e tyre janë duke e përgatitur me një ritëm të pandalur. Duhet të kuptohet mirë fakti se sa më shumë rriten e forcohen forcat e paqes e të demokracisë aq më të egër e më të rrezikshëm bëhen imperialistët, nxitës të një lufte të re. Prandaj

Partia jonë duhet të punojë me një vullnet akoma më të madh që lëvizja ndërkombëtare e partizanëve të paqes, e udhëhequr nga Stalini i madh, të përshkojë sa më thellë masat tona punonjëse, shtresën e intelektualëve, gjithë patriotët e vendit tonë, të shkundë dhe të mobilizojë indiferentët duke bërë që të gjithë këta të shohin në këtë lëvizje interesat jetike të atdheut të tyre, të popullit dhe të familjeve të tyre. Organizatat e masave dhe shtypi duhet të intensifikojnë propagandën e tyre në favor të paqes, t'u bëjnë një demaskim të gjithanshëm të gjitha përgatitjeve për luftë të kampit imperialist me në krye amerikanët dhe anglezët, të demaskojnë përherë me fuqi klikën e Titos, agjenturë e rrezikshme e imperializmit. Paralelisht me këtë, lëvizja e partizanëve të paqes në vendin tonë duhet të marrë forma organizative të përshtatshme dhe të përfitohet nga ato forma të përdorura me dobi në vendet e tjera. Gjithë lëvizja për paqe, demokraci dhe socializëm duhet të ngrihet dhe të zhvillohet me besim të patundur se është e mundur t'u hidhen në erë planet e luftës pasardhësve të Hitlerit dhe të Musolinit, amerikanë-anglezëve. Çdo organizatë, çdo kolektiv punonjësish, çdo individ në punën e tij për paqen duhet të ketë parasysh se vepron i inkuadruar në forcat e partizanëve të paqes që janë qysh tani shumë më të mëdha nga ato të reaksionit dhe që zhvillohen përherë më tepër në të gjithë botën dhe brenda vetë shteteve kapitaliste.

2. — Detyrë e rëndësishme për Partinë e popullin tonë, sikundër për gjithë Partitë komuniste e popujt e botës, në luftën për paqe, demokraci dhe socializëm është të shtojmë sa më shumë dashurinë për Bashkimin Sovjetik që është mbrojtësi i paqes, pavarësisë dhe sovranitetit të popujve. Në këtë çështje të rëndësishme, Partia jonë ka pasur suksese të mëdha. Por ne nuk duhet të kënaqemi me kaq, duhet të forcojmë në popullin tonë dashurinë për Bashkimin Sovjetik. . . Këtë çështje duhet ta shohim në mënyrë marksiste-leniniste pse Bashkimi Sovjetik përfaqëson shtetin e fuqishëm të proletariatit dhe të fshatarëve të varfër që këputen përgjithmonë zinxhirët e imperializmit. . . Ky është internacionalizmi proletar me të cilin duhet të pajisen të gjitha masat tona punonjëse. Për të konkretizuar dashurinë për Bashkimin Sovjetik, Partia jonë duhet të bëjë që çdo komunist dhe patriot i ndershëm të mësojë sa më shumë e më mirë mësimet e Leninit dhe të Stalinit, të mësojë «Historinë e Partisë Komuniste (b) të Bashkimit Sovjetik»... Ne duhet t'i vëmë në dukje popullit tonë të gjitha ndihmat që na jep Bashkimi Sovjetik, ndihma që nuk mund të llogariten me kreditë që na jepen, por me ngrohtësinë dhe me dashurinë e madhe që popujt sovjetikë ushqejnë për popullin dhe Partinë tonë që nga udhëheqësi më i madh i popujve sovjetikë shoku Stalin dhe deri te njeriu më i thjeshtë sovjetik. Një çështje e madhe që Partia jonë

duhet të kuptojë sa më mirë dhe t'ua bëjë të qartë masave të gjera të popullit është ndihma që BS i jep popullit tonë në lëmin ndërkombëtar në mënyrë të vendosur dhe konsekuente saqë imperia- lizmi amerikan-anglez nuk do të guxojë të atakojë popullin tonë dhe t'i shkelë atij independencën dhe sovranitetin e tij... Duke pasur si bazë forcimin gjithnjë më të madh të miqësisë dhe të lidhjeve të popullit tonë me BS, Partia jonë duhet të punojë në të njëjtën kohë për zhvillimin e mëtejshëm të lidhjeve politike, eko- nomike dhe kulturele me demokracitë popullore, për njohjen sa më të thellë e sa më të gjerë të këtyre popujve që ecin në rrugën e lavdishme të çarë nga popujt sovjetikë për ndërtimin e socializmit në vendet e tyre. Partia jonë duhet të punojë për të forcuar lidhjet e organizatave tona shoqërore, e organizatave të masave, e orga- nizatave kulturele me ato të Bashkimit Sovjetik, të demokracive popullore dhe me organizatat demokratike të të gjithë botës si dhe ato ndërkombëtare. Partia jonë duhet të rrënjosë thellë në popullin tonë shpirtin e internacionalizmit proletar...

3. — Partia e Punës e Shqipërisë me Komitetin e saj Qendror të udhëhequr nga mësuesi ynë i dashur, shoku Enver Hoxha, është e vetmja forcë, e vetmja udhëheqje, që me vijën e saj marksiste- leniniste udhëheq përpjekjet e popullit tonë në mbrojtjen e paqes e të demokracisë, në luftën kundër nxitësve të një lufte të re, që siguron dhe forcon mbrojtjen dhe pavarësinë e vendit tonë, që i si- guron vendit tonë një zhvillim paqësor dhe fëmijëve tanë një të ardhshme të begatshme dhe plot lumturi. Partia jonë e ka radhitur popullin tonë përkrah Bashkimit Sovjetik, përkrah popujve të vendeve të demokracisë popullore, përkrah njerëzimit përparimtar. Ajo rrit çdo ditë e më tepër rolin e popullit tonë në lëmin ndërkombëtar si një popull liridashës dhe paqedashës. Prandaj, detyra jonë kryesore për kryerjen e të gjitha detyrave të tjera është forci- mi i gjithanshëm i Partisë sonë. Duke pasur një Parti të fortë, ne do të jemi në gjendje t'u bëjmë ballë dhe t'i dërmojmë tentativat e imperializmit dhe të reaksionit të brendshëm, të forcojmë Repu- blikën tonë Popullore, të ndërtojmë jetën tonë të re e të lumtur. Detyra kryesore e anëtarëve të Partisë në lidhje me forcimin e Partisë është mprehja e vigjilencës për ruajtjen e pastërtisë së vijës dhe të radhëve të Partisë. Në Rezolucionin e Byrosë Informative thuhet:

«Për partitë komuniste dhe punëtoare ka një rëndësi të jashtëzakonshme që ato t'i denoncojnë, në terrenin ideolo- gjik dhe t'i luftojnë pa mëshirë manifestimet e çdo lloj opor- tunizmi, sektarizmi dhe nacionalizmi borgjez, si dhe depër- timin e agjentëve të armikut në gjirin e partisë.

Mësimet që rrjedhin nga denoncimi i klikës së spiunë- ve Tito-Rankoviç u ngarkojnë partive komuniste dhe punë-

tore detyrën imperative që të ngrejë në maksimum vigji- lencën revolucionare»¹.

Cila duhet të jetë metoda jonë kryesore për të forcuar vigji- lencën revolucionare? Eksperiencia e Partisë Bolshevike që është eksperiencia më e mirë na tregon se metoda më efikase, më e mirë dhe më e thjeshtë për të përforcuar vigjilencën është metoda e përcaktimit të përgjegjësive personale dhe kontrolli në zbatimin e urdhërave dhe të direktivave. Atje ku ka konfuzion, ku nuk ka rregull, ku të gjithë janë përgjegjës në teori dhe «asnjëri» nuk është përgjegjës në praktikë, atje është vështirë të zbulohet puna e armikut. Përkundrazi, atje ku ka organizim, rregull, kontroll, atje ku vlerësohet drejt puna e njërit dhe e tjetrit, atje armikut i hiqet maska dhe nuk lejohet që ai të fshehë veprimtarinë e tij armiçësore nën maskën e «përgjegjësive kolektive», të mungesave «objektive» etj. Pra një nga detyrat kryesore dhe imediate për të gjithë Partinë tonë, që ka një rëndësi të madhe për forcimin e vigjilencës revolu- cionare, është përcaktimi i përgjegjësive personale dhe kontrolli sistematik e i pandërprerë për zbatimin e urdhërave, direktivave dhe vendimeve. Por vigjilencia revolucionare duhet të orientohet jo vetëm në ruajtjen e Partisë nga puna e armikut jashtë radhëve të saja, por duhet që kjo të orientohet edhe në ruajtjen e Partisë nga puna e armikut brenda radhëve të saja.

Vigjilencia revolucionare dhe forcimi i mëtejshëm i Partisë du- het të zhvillohen e të forcohen në organizatën bazë, në organet drej- tuese, në qendrën e punës, në terren dhe kudo. Elementët e lë- kundur, oportunistët dhe sektarët, anarkistët, arrivistët etj., që rasti i solli në Parti, por që nuk janë me vijën e Partisë, me ideologjinë e rrugën e saj, janë ana negative që pengojnë forcimin e Partisë. Ata janë të gatshëm për të përqaftuar ideologjinë borgjeze dhe punën e armikut ashtu siç e ka provuar eksperiencia e Partisë sonë, prandaj në terrenin konkret, në procesin e punës së përditshme, të shikohet, të studjohet dhe të provohet mirë puna e tyre dhe jo llafet e tyre dhe kush është për t'u ndihmuar dhe për t'u këshilluar, të ndihmohet dhe të këshillohet, dhe kush është për t'u spastruar nga radhët e Partisë të spastrohet, sepse kështu forcohet Partia. Në të njëjtën kohë duhet të tregohet kujdes dhe vëmendje më e madhe në pranimin e elementëve të rinj, të cilët duhet ta duan me gjithë shpirt Partinë e popullin dhe të mos kursejnë asgjë për kauzën e socializmit. Respektimi i rregullit, i disiplinës, respektimi i nor- mave e i parimeve të Partisë, kritika dhe autokritika janë kondita të domosdoshme për forcimin e ruajtjen e Partisë. Prandaj në orga- nizatën bazë anëtarët e Partisë duhet të luftojnë për rregullin dhe disiplinën, të ndjekin dhe të godasin me kujdes të gjitha shfaqjet

¹ Gazeta «Për një paqe të qëndrueshme, për një demokraci popullore». Nr. 28 (55), 29 nëntor 1949.

e shkeljes së rregullit dhe të disiplinës, ardhjen vonë në mbledhje, mungesën pa arsye, mosmarrjen pjesë në diskutimin e çështjes, moszbatimin e direktivave të Komitetit Qendror dhe të komitetit të Partisë të rrethit ose vendimet e organizatës bazë, shkeljen e moralit proletar, kritikën e shtrembër ndaj shokëve, mungesën e autokritikës dhe mospranimin ndershmërisht të kritikës së drejtë të shokëve, kritikë jashtë organizatës bazë, vënjen në diskutim e dyshim të direktivave e të vijës së Partisë, marrjen në gojë të udhëheqjes së Partisë, thyerjen e konspiracionit, bisedimin e çështjeve të Partisë me farefisnin, mbajtjen e rezervave ndaj Partisë. Të gjitha këto shfaqje janë të huaja dhe të rrezikshme për Partinë, ato çojnë në devijime, në grupazhe dhe në fraksione. Por që anëtarët e Partisë t'i kuptojnë mirë këto shfaqje në praktikë, si ngjasin dhe kur ngjasin, është shumë e nevojshme dhe e domosdoshme që çdo anëtar partie të shtojë përpjekjet e tija për të mësuar më shumë marksizëm-leninizmin, për t'u ngritur ideologjikisht e politikisht dhe për të lexuar sa më shumë shtypin tonë.

Partia jonë do të jetë e fortë dhe do të mund të plotësojë detyrat e saja në qoftë se levat e saja: pushteti, Fronti, organizatat e bashkimeve profesionale, rinia, gruaja, Lidhja e Shkrimtarëve, Komiteti i intelektualëve për mbrojtjen e paqes, Bashkimi i Gazetarëve, etj., janë të forta. Prandaj anëtarët e Partisë duhet të punojnë më tepër për forcimin e këtyre organizatave në mënyrë që ato të përfshijnë gjithë popullin tonë dhe të luajnë rolin e tyre në luftën për paqe, demokraci dhe socializëm.

4. — Lufta për forcimin ekonomik të vendit është sot një nga format kryesore të luftës për ndërtimin e socializmit, e luftës për mbrojtjen e paqes dhe kundër nxitësve të luftës. Prandaj, realizimi i planit të shtetit, siç përcaktohet në Rezolucionin e Kongresit I të Partisë, është një nga detyrat kryesore jo vetëm të çdo komunisti, por edhe të çdo nënshtetasi. Përpjekjet e Partisë dhe të masave punonjëse për realizimin e planit të këtij viti kanë ardhur duke u shtuar dhe duke u organizuar më mirë. Mobilizimi ynë për realizimin e planit është rritur sidomos pas analizës së përbashkët të Byrosë Politike dhe qeverisë. Por megjithkëtë në punën për realizimin e planit ka akoma shumë të meta dhe dobësi që pengojnë arritjen e rezultateve të dëshiruara. Këtej del detyra për anëtarët e Partisë dhe për gjithë punonjësit e vendit tonë që të luftojnë më shumë e më mirë për të vendosur organizim të shëndoshë, rregull, përgjegjësi e disiplinë në punë. Shoku Stalin na mëson se imperializmi nuk mund ta lërë të qetë zhvillimin e ekonomisë socialiste, ai do të përpiqet me çdo mënyrë ta pengojë atë. Prandaj, anëtarët e Partisë, çdo punëtor ose patriot të rritin vigjilencën revolucionare që të mos lejojnë armikun të punojë lirisht përpara hundës së tyre, të shkatërrojë ose të dëmtojë pasurinë e përbash-

kët. Gjithashtu anëtarët e Partisë në terren duhet të jenë vigjilentë për punën dhe dredhitë e kulakut në fshat, kur ai i gënjen fshatarët e varfër e të mesëm dhe i shtyn kundër detyrimeve dhe urdhëresave të qeverisë, ndërsa ai vetë i paguan detyrimet pa bërë fjalë. Në ndërmarrjet dhe në kantieret, atje ku punohet dhe prodhohet, në organizatat ekonomike të masave, si në kooperativat e prodhimit, të konsumit dhe të shitblerjes, në fermat e shtetit e kudo duhet të forcohet organizimi dhe drejtimi i punës, të shtohet dhe të forcohet mobilizimi i masave për realizimin e planit, për shtimin e prodhimit dhe për uljen e kostos së tij. Në ndërmarrjet e shtetit, bashkëpunimi i drejtë i drejtorit të ndërmarrjes me përgjegjësin e organizatës bazë të Partisë, përgjegjësin e sindikatës dhe të rinisë, është konditë e domosdoshme për mbarrëvajtjen e punës në realizimin e planit. Nuk mund të lejohet në ndërmarrje që drejtori të interesohet vetëm për prodhimin dhe të mos dijë e të mos interesohet se si rron dhe çfarë bën kolektivi punonjës i ndërmarrjes së tij. Drejtori duhet të dijë se çdo gjë, në ndërmarrjen që ai drejton, është e lidhur ngushtë me prodhimin, prandaj ai duhet të interesohet për të gjitha, për prodhimin, për normat, për planin, për cilësinë e punës, për disiplinën, për kursimet, njësoj si për mensën, për klubin, për kurset, për programin e mësimit, për pushimet e punëtorëve, për shpërblymimet, për shëndetin e punëtorëve etj. Organizatat e Partisë dhe organizatat e masave në ndërmarrje duhet të ndihmojnë në mbarrëvajtjen e punës, të mobilizojnë kolektivin punonjës në realizimin e planit, në shtimin e prodhimit dhe në forcimin e rregullit e të disiplinës. Ato duhet të kujdesen për përmirësimin e jetës së punëtorëve nga çdo pikëpamje.

Çështja e normave është një nga detyrat kryesore të ndërmarrjeve tona ekonomike. Puna me norma është baza e emulacionit socialist. Prandaj, anëtarët e Partisë që punojnë në ndërmarrjet tona ekonomike duhet të bëjnë përpjekje më të mëdha që normat të vendosen kudo, të arrihen dhe të tejkalohen. Eksperienca e këtyre muajve të fundit ka treguar se në vendin tonë janë konditat për zhvillimin e emulacionit dhe të garave socialiste në realizimin e planit. Prandaj duhet të bëjmë që në vitin 1950 ato të zhvillohen e të organizohen më mirë, të përfshijnë masa të gjera punonjësishe dhe të bëhen një metodë pune për realizimin e planit.

Në degët e ekonomisë duhet të forcohen kooperativat e prodhimit, të konsumit dhe të shitblerjes, të vihet një rregull e një disiplinë më e fortë në këta sektorë dhe të tregohet një kujdes më i madh për prodhimin dhe për qarkullimin e mallrave. Kooperativat e prodhimit në fshat dhe ato të artizanatit të shtojnë përpjekjet e tyre, të rritin inisiativën, të ndihmohen dhe të forcohen dhe të bëhen një mbështetje e fuqishme e sektorit ekono-

miko-shtetëror. Kooperativat e konsumit dhe të shitblerjes si organizata masash, të ngrihen në lartësinë e misionit të tyre e të zhdukin çrregullimet dhe abuzimet, të forcojnë besimin e dashurinë e masave dhe t'i shërbejnë me ndërgegje popullit. Furnizimi i popullit të merret seriozisht nga dikasteret ekonomike e komitetet e Partisë të kujdesen dhe të japin ndihmën e tyre që të sigurohet furnizimi i popullit me mallrat që kemi e që do të kemi. Ekonomitë individuale në fshat të ndihmohen dhe të udhëzohen më shumë, që të shtojnë prodhimin dhe të orientohen sa më shumë në mbjelljen e kulturave sipas planit të shtetit. Në aparatet administrativ ekonomik të shtetit të forcohet puna organizative dhe të luftohet burokratizmi.

5. — Forcimi i Partisë sonë është i lidhur ngushtë me forcimin gjithnjë e më shumë të unitetit të klasës sonë punëtore si bazë e bashkimit dhe e unitetit të masave tona punonjëse në Frontin Demokratik. Prandaj Partia jonë duhet të preokupohet më shumë për përbërjen shoqërore të klasës punëtore dhe të bëjë përpjekje më të mëdha për të zhvilluar industrinë sepse kështu do të forcojmë përbërjen shoqërore të klasës punëtore, do të shtojmë më tepër radhët e saja dhe do të kemi një unitet më të shëndoshë jo vetëm të klasës punëtore, por të gjithë popullit tonë punonjës. Partia jonë duhet të synojë që me punën e saj bindëse të tërheqë sa më shumë fshatarë joprodhues nga fshati në qendrat tona të prodhimit, në ndërtimet etj. Nëpërmjet procesit të zhvillimit të industrisë në vendin tonë, klasa jonë punëtore do të sigurojë më shumë dhe më mirë rolin e saj udhëheqës nën drejtimin e Partisë.

Krahas me zhvillimin dhe forcimin e klasës punëtore Partia duhet të kujdeset më shumë për edukimin politik e ideologjik dhe për zhvillimin kultural të saj. Niveli i ulët i punëtorëve të rinj të ardhur nga fshati dhe nga malësitë e bën shumë të nevojshme, të domosdoshme dhe urgjente nevojën e edukimit politik dhe të ngritjes ideologjike të klasës punëtore. Bashkimet profesionale duhet të aktivizohen më shumë në këtë drejtim. Veçanërisht përpara Partisë shtrohet detyra për përmirësimin e konditave materiale të klasës punëtore. Për këtë detyrë të madhe që shpeshherë është neglizhuar duhet të kujdesen më shumë edhe bashkimet profesionale, administratat e ndërmarrjeve dhe dikasteret ekonomike. Nuk është me vend dhe as i drejtë, në konditat tona, mendimi që ka ekzistuar në ndërmarrjet e në dikasteret tona dhe veçanërisht në Komisionin e Planit që të investohet vetëm në objektet ekonomike prodhuese dhe të neglizhohen konditat materiale të jetës së punëtorëve. Gjithashtu Partia duhet të kujdeset që organet e prokurorisë të evitojnë gabime të tilla siç është çështja e procedimit të punëtorëve; këto gabime na kushtojnë shumë. Nga

organet e prokurorisë dhe përgjithësisht të drejtësisë duhet të kuptohet mirë fryma e ligjeve të pushtetit tonë popullor. Ne duhet të luftojmë për disiplinën dhe për rregullin në punë nga ana e punonjësve, se me procedime nuk zgjidhim gjë, përkundrazi e devijojmë problemin. Ne duhet t'i kushtojmë kujdes edukimit të punëtorëve.

6. — Forcimi i situatës së brendshme të vendit është një çështje me shumë rëndësi për Partinë. Kjo ka të bëjë me mbrojtjen e paqes, ruajtjen e pavarësisë dhe të lirisë së popullit tonë, me konsolidimin dhe përparimin e Republikës sonë Popullore. Imperializmi amerikano-anglez dhe satelitët e tij e kanë halë në sy Republikën tonë dhe përpiqen që në Shqipëri të ndërrojë situatën, të kthehet e kaluara dhe vendi ynë të bëhet, siç ka qenë në të kaluarën, një çiflig i tyre. Por imperialistët nuk guxojnë të sulmojnë direkt Republikën tonë, sepse populli ynë konsiderohet në botë si një popull që ka luftuar kundër fashizmit dhe ka kontribuar për fitoren e përbashkët, sepse vendi ynë përkrahet në mënyrë të vendosur dhe konsekuente nga Bashkimi i fuqishëm Sovjetik. Prandaj, përpjekjet e tyre më të mëdha kundër Republikës sonë, imperialistët amerikano-anglezë i kanë përqëndruar në nxitjen dhe organizimin e ndonjë lëvizjeje nga brenda nga ana e elementëve reaksionarë, armiq të popullit, për të përmbysur qeverinë dhe Partinë tonë. Imperializmi me anë të klikës së Titos, të monarko-fashistëve të Athinës dhe të neofashistëve italianë përpriqet të dërgojë dhe të organizojë në vendin tonë agjentë, diversantë e kriminelë, të cilët me anën e terrorit e të propagandës së tyre, të ngjallin frikë në popull, ta shkëputin këtë nga Partia dhe pushteti dhe të sabotojnë punën e madhe të ndërtimit të socializmit. Përpara këtyre qëllimeve dhe përpjekjeve të imperializmit Partia dhe populli ynë duhet të jenë vigjilentë në maksimum. Kjo do të thotë që çdo komunist dhe patriot i vendit tonë të hapë më tepër sytë dhe veshët, për të parë dhe për të dëgjuar armikun më mirë, për ta diktuar atë me kohë dhe për ta goditur pa mëshirë.

Ne duhet të jemi më shumë vigjilentë kundrejt klikës së Titos, ta demaskojmë atë pa mëshirë dhe të dërmojmë çdo tentativë që ajo ka në plan kundër Republikës sonë Popullore.

Partia jonë duhet t'i mprehë dhe t'i mobilizojë mirë të gjitha armët e saja në luftën kundër armikut. Për këtë qëllim në radhë të parë duhet që t'i kushtohet kujdes i madh forcimit të Partisë dhe të pushtetit. Pushteti ynë është forcuar mjaft, por duhet të forcohet edhe më shumë. Sëmundja që Partia akoma përqëndron në duart e saja të gjitha kompetencat që i takojnë pushtetit, është një pengesë për forcimin e pushtetit dhe një gabim që duhet ndrequr. Komitetet e Partisë nuk duhet të marrin të gjitha punët mbi

vete dhe të mos u lënë kompetencë të tjerëve. Partia duhet të jetë motori drejtues në çdo sektor, ajo duhet të këshillojë dhe të drejtojë, por njerëzit e pushtetit duhet të kryejnë detyrat e tyre dhe të jenë përgjegjës për punën e tyre. Kryetari, sekretari dhe këshilltari i pushtetit duhet të jenë njerëzit që të drejtojnë me të vërtetë gjithë jetën shtetërore të një rrethi, lokaliteti ose fshati dhe të zgjidhin të gjitha problemet shtetërore të popullit. Kështu pushteti ynë do të forcohet, ekonomia jonë do të përparojë dhe armiku do të gjejë vështirësi të mëdha në organizimin e luftës së tij kundër pushtetit tonë. Partia jonë duhet të forcojë edhe më tepër Armën e Sigurimit të Shtetit, Ushtrinë Kombëtare, rojet e kufirit, të cilët janë në përpjekje të vazhdueshme me armikun, me diversantët, sabotatorët dhe bandat e armikut. Partia duhet të sqarojë pikëpamjet e padrejta për njerëzit dhe punën e Sigurimit të Shtetit që ekzistojnë akoma në mendjen e disa anëtarëve të Partisë dhe të forcojë konsideratën për këtë sektor kaq të rëndësishëm për Partinë dhe shtetin tonë dhe duhet t'u japë të gjithë ndihmën e saj organeve të Sigurimit të Shtetit dhe kjo ndihmë të jetë sa më konkrete.

Të shtohet dashuria për ushtrinë tonë të lavdishme, të ndihmohet ushtria me çdo mënyrë, të shtohet dhe të forcohet pjesëmarrja aktive e masave në organizatën e SHNUM-it. Ushtarët dhe oficerët tanë të bëjnë përpjekje më shumë për të forcuar disiplinën, për të përvetësuar artin ushtarak stalinian, për të rritur njohuritë e tyre duke u pajisur me eksperiencën e Ushtrisë Sovjetike dhe traditat luftarake të Luftës nacional-çlirimtare të popullit tonë. Ushtria jonë të jetë kurdoherë e gatshme dhe me vigjilencë të mbrojtë kufitë e atdheut tonë dhe si kurdoherë roje e pafjetur dhe tmerr për armiqtë, të ruajë fitoret e popullit dhe punën paqësore ndërtimtare të tij.

Të forcohet patriotizmi i popullit tonë. Në shkollat e institucioneve, në ndërmarrje, në konferenca politike etj. të flitet për patriotizmin e popullit, për sakrificat e tija në luftën për liri dhe në punën për ndërtimin e jetës së tij të re e më të mirë. Të flitet gjithashtu për sakrificat dhe përpjekjet e të parëve tanë për të mbajtur të pacënueshme lirinë, kombësinë, gjuhën dhe zakonet e mira të vendit tonë.

Partia jonë duhet të luftojë për të zbatuar sa më drejt politikën e saj, veçanërisht në fshat. Ne duhet të përpiqemi të mobilizojmë sa më shumë masat punonjëse të fshatit në zgjidhjen e problemeve që u sigurojnë atyre një jetë më të mirë. Po të ishte punuar më mirë ne do të kishim evituar mjaft gabime që janë bërë në këtë drejtim. Partia jonë duhet të bënte më shumë përpjekje që pas reformës agrare fshatarët të ndihmoheshin me kredi nga ana e shtetit. Kreditë e akorduara nga shteti nuk u janë dhënë

fshatarëve dhe si rrjedhim sot ka një numër të madh fshatarësh që, me gjithë përmirësimet e tyre të dukshme në krahasim me të kaluarën, nuk janë në gjendje të mirë ekonomike. Duke marrë parasysh se propaganda jonë në fshat është akoma e dobët, Partia duhet të intensifikojë punën e saj politike në fshat duke bërë një propagandë të shëndoshë si nga ana bujqësore ashtu dhe nga ana politike. Në lidhje me këtë gjë duhet të rregullohet një herë e mirë shpërndarja e shtypit në fshat.

Partia jonë duhet të kujdeset sa më shumë për përmirësimin e jetës së popullit. Organizatat e Partisë nuk duhet vetëm të kërkojnë nga populli, por të kujdesen në të njëjtën shkallë për t'i dhënë popullit atë që i takon. Popullsisë, edhe në zonat më të thella duhet t'i dërgohet në rregull vaj e kripë që i kemi në vend dhe sendet e tjera. Veçanërisht duhet treguar kujdes për përmirësimin e konditave materiale të punëtorëve. Për të gjitha këto gështje duhen marrë masa serioze, duhen dënuar neglizhuesit dhe duhet parë me sy kritik puna jonë.

Të gjitha këto detyra janë të lidhura me fuqinë mbrojtëse të vendit tonë. Kështu vendi ynë do të forcohet edhe më shumë dhe shpresat e armiqve të brendshëm, të nxitur dhe të ndihmuar nga imperialistët për të rivendosur pushtetin e pronarëve dhe të çifligarëve, do të zhduken bashkë me ëndrrat e armiqve të jashtëm që do të dëshironin të rrëmbenin ndonjë copë të vendit tonë duke kujtuar se jemi vetëm, të pafuqishëm dhe të izoluar.

Partia jonë do të mobilizohet me të gjitha forcat e saja për realizimin e detyrave që na dalin në dritën e rezolutave të Byrosë Informative.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

*Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

V E N D I M

I BYROSË POLITIKE TË KQ TË PPSH «MBI VËRTETIMIN DHE NDËRRIMIN E DOKUMENTAVE TË PARTISË»

21 janar 1950

Byroja Politike e KQ të PPSH në mbledhjen e saj më 21 janar 1950, pasi mori në studim çështjen e ndërrimit të dokumentave të Partisë, e konsideron të domosdoshme vërtetimin dhe ndërrimin e dokumentave të anëtarëve dhe të kandidatëve të PPSH dhe konstaton:

1. — Si rrjedhim i punës armiqësore të Koçi Xoxes, në çështjet e administrimit të brendshëm të Partisë ka ekzistuar një konfuzion i madh. Posaçërisht në regjistrimin e komunistëve, ku duhet të kishte rregull shembullor dhe precizion të madh, ka pasur shumë të meta.

a) Nuk kanë qenë të pajisur me dokumentat e Partisë të gjithë anëtarët e kandidatët e PPSH. Kjo ka ardhur se nuk ka qenë kudo rregull që çdo anëtar ose kandidat i ri të plotësonte dokumentat e tij bazë para se të futej në Parti, nuk janë ruajtur vendimet e organizatës përkatëse e dokumentat e tjera që vërtetonin qenjen anëtar ose kandidat partie, nuk janë pajisur të gjithë anëtarët me taserën e Partisë, kurse kandidatët s'kanë pasur fare kartë kandidati dhe ka munguar rregulli i duhur për transferimin e komunistëve.

b) Në plotësimin e dokumentave të anëtarëve dhe të kandidatëve të Partisë ka pasur gjithashtu të meta të mëdha. Përmbajtja e tyre nuk kontrollohet e nuk vërtetohet me dokumenta, kështu ka pasur raste që në to të kishte dhe gjëra të padrejta, bile dhe gënjeshtra me qëllim. Për shembull ka pasur raste që komunisti nga paqartësia s'e ka shkruar drejt origjinën e gjendjen e tij shoqërore, por ka edhe raste kur ai e ka fshehur me qëllim origjinën e tij shoqërore dhe ka disa komunistë që s'i kanë treguar Partisë qëndrimin e keq politik që kanë pasur në të kaluarën dhe gabimet që kanë bërë etj. Gjithashtu s'ka pasur rregulla të caktuara për të shënuar në dokumentat e komunistëve ndryshimet që u ndodhin atyre pas hyrjes në Parti e në këtë mënyrë në dokumentat e ko-

munistëve s'janë vënë ndryshimet që u kanë ndodhur ose janë vënë gjëra të pavërtetuara (shpifje) që i ngarkojnë disa komunistë me njolla që s'i kanë. Kështu ne sot s'kemi të dhëna ekzakte ashtu siç duhet për çdo komunist.

c) Një pakujdesi e theksuar ka ekzistuar edhe në lidhje me ruajtjen dhe sigurimin e dokumentave të Partisë. Komitetet e Partisë të rretheve nuk kanë marrë masat e nevojshme për sigurimin e të gjitha dokumentave të Partisë dhe disa komunistë nuk kanë treguar preokupacionin e domosdoshëm për ta ruajtur taserën e Partisë.

Të gjitha këto çrregullime dhe neglizhenca të vërtetuara në çështjet e administrimit të Partisë tregojnë se në Parti ka munguar vigjilenca e shëndoshë revolucionare për ruajtjen e pastërtisë së radhëve të Partisë nga elementët armiq, të cilët mundohen të depërtojnë në radhët e saja me qëllim që, në mënyrë të fshehtë, prapa taserës së Partisë, të mund ta luftojnë më kollaj dhe më rëndë Partinë tonë. Kuptohet vetëvetiu se në një situatë të tillë kur në çështjet e administrimit të Partisë ekziston një konfuzion i madh, elementi armik ka mundësi të depërtojë më lehtë.

2. — Për përmirësimin e kësaj gjendjeje në çështjet e brendshme të Partisë një rol me rëndësi duhet të luajë vërtetimi dhe ndërrimi i dokumentave të anëtarëve dhe të kandidatëve të Partisë.

a) Vërtetimi dhe ndërrimi i dokumentave të Partisë duhet të zhdukë kaosin që ekziston në çështjet e regjistrimit të komunistëve dhe të vendosë rregullin bolshevik brenda në Parti. Të vendoset sistemi unik në gjithë Partinë në lidhje me regjistrimin e komunistëve. Të plotësohen të gjithë anëtarët dhe kandidatët e PPSH me dokumentat bazë dhe të pajisen të gjithë komunistët me taserën e Partisë apo kartën e kandidatit.

b) Vërtetimi dhe ndërrimi i dokumentave të Partisë duhet të shërbejë për të njohur më mirë përbërjen e Partisë sonë. Kjo do të vlejë që të merren masat e nevojshme për të forcuar Partinë, që të merren masat e duhura edukative dhe disiplinore për të korigjuar të metat që ekzistojnë në disa komunistë si dhe që të lihen jashtë Partisë elementët armiq, që mund të kenë hyrë kontrabandë në Parti duke falsifikuar dokumentat ose duke përfutuar nga mungesa e vigjilencës së shëndoshë në organizatat e Partisë.

c) Vërtetimi dhe ndërrimi i dokumentave duhet të sigurojë për organizatat e Partisë një eksperiencë të gjerë në lidhje me çështjet organizative të Partisë: mbi kriterin që duhet të ndiqet për pranimet në Parti, mbi shëndoshjen e jetës së brendshme të organizatave bazë të Partisë, mbi përmirësimin e punës në aparatet pranë komiteteve të Partisë të rretheve etj.

Duke marrë parasysh këto dhe në bazë të vendimit të Byrosë Politike të dhjetorit 1949 Byroja Politike e KQ të PPSH

Vendosi:

I. — Para ndërrimit të dokumentave, të bëhet në gjithë Partinë vërtetimi një për një i dokumentave të anëtarëve dhe të kandidatëve të PPSH deri më 31 tetor 1950.

a) Vërtetimi i dokumentave duhet të bëhet me kujdesin dhe imtësinë më të madhe me qëllim që të sigurohen të dhënat sa më ekzakte për çdo anëtar dhe kandidat partie, të sqarohen të gjitha çështjet e dyshimta dhe të zbulohen të gjitha gjërat që mund t'i jenë fshehur Partisë.

Për këtë çdo anëtar dhe kandidat partie duhet të plotësojë fletanketën e re dhe autobiografinë. Komitetet e Partisë të rretheve duhet të kërkojnë nga çdo komunist, që të vërtetojë me dokumenta të gjitha informatat e rëndësishme që ka dhënë rreth personit të tij. Shokët e ngarkuar për vërtetimin e dokumentave duhet të bisedojnë me komunistin, të cilit po i vërtetohen dokumentat, për çdo gjë që kanë nevojë ta sqarojnë me gojë dhe detyra e çdo komunisti është t'i flasë haptas Partisë për çdo gjë, pa mbajtur asnjë rezervë. Ata që gënjejnë Partinë s'mund të jenë anëtarë të saj. Gjithashtu, për të vërtetuar të thënat e komunistëve në dokumentat e tyre, është e domosdoshme të pyeten edhe anëtarë e kandidatë partie të tjerë, të cilët i njohin këta dhe detyra e gjithë anëtarëve dhe e kandidatëve është t'i thonë haptas Partisë çdo gjë që dinë rreth komunistëve, të luftojnë dobësitë e «miqve» të tyre duke i fshehur të vërtetën Partisë. Kur shihet e nevojshme dhe posaçërisht në rastet kur informatat e marrura nga i interesuari ose nga anëtarët dhe kandidatët e tjerë të Partisë nuk janë të mjafta, atëhere mund të merren në pyetje dhe elementë pa parti nga radhët e punëtorëve dhe të fshatarëve të varfër, që e njohin mirë komunistin, dokumentat e të cilit kontrollohen.

Byrotë e komiteteve të Partisë të rretheve duhet të kenë parasysh se elementi armik do të mundohet me këtë rast të pengojë punën për vërtetimin e dokumentave të Partisë duke u përpjekur të fshehë mirë veten e tij dhe nga ana tjetër të shpifë e të intrigojë kundër elementit të shëndoshë të Partisë. Prandaj është e domosdoshme që komitetet e Partisë të rretheve dhe gjithë komunistët të jenë shumë vigjilentë për ruajtjen e Partisë, për të zbuluar armiqtë e fshehur të saj, për të nxjerrë në dritë çdo gjë që i ishte fshehur Partisë. Nga ana tjetër komitetet e Partisë të rretheve duhet të jenë shumë të matura në gjykimin e komunistëve, të vërtetojnë me drejtësinë më të madhe çdo informatë ose akuzë që i bëhet një komunisti për të parë sa i përgjigjet realitetit, pse, siç

na mëson eksperiencia e Partisë Bolshevike, armiku shpif për të goditur elementët e shëndoshë të Partisë dhe për të forcuar pozitat e tija duke u hequr si njeri që gjoja lufton për pastërtinë e Partisë.

Duhet pasur kujdes gjithashtu që për të gjitha çështjet që do të dalin gjatë vërtetimit të dokumentave rreth anëtarëve dhe kandidatëve të PPSH, të mbahet konspiracioni më i madh.

b) Punën për vërtetimin e dokumentave të Partisë duhet ta drejtojnë direkt byrotë e komiteteve të Partisë të rretheve të cilat janë përgjegjëse për mbarëvajtjen e kësaj pune para KQ të PPSH. Përgjegjësi të veçantë kanë sekretarët e parë dhe të dytë të komiteteve të rretheve.

Për vërtetimin e dokumentave të anëtarëve dhe të kandidatëve të Partisë, në radhë të parë, byrotë e komiteteve të Partisë të rretheve duhet të caktojnë anëtarët e kandidatët e komitetit të rrethit si edhe instruktorët që punojnë në aparatin e komitetit të rrethit.

Dokumentat e vërtetuara nga shokët e ngarkuar duhet të shqyrtohen një për një nga sekretarët e komitetit të Partisë të rrethit. Në rrethet e mëdha ose në rrethet ku mungon sekretari i dytë dokumentat mund të shqyrtohen edhe nga 1-2 anëtarë të byrosë por vetëm me aprovimin e Sekretariatit të Komitetit Qendror.

Sekretarët e komiteteve të Partisë të rretheve (ose anëtarët e autorizuar të byrosë) duhet të shtrojnë në byrotë e komiteteve të Partisë të rretheve rezultatet e vërtetimit të dokumentave për çdo komunist dhe kjo pastaj do të vendosë për lëshimin ose jo të dokumentit të ri të Partisë.

Rezultatet e vërtetimit të dokumentave të të gjithë komunistëve të organizatës së rrethit duhet të shtrohen në mbledhjen e komitetit të Partisë të rrethit.

II. — Vërtetimi i dokumentave të anëtarëve dhe të kandidatëve të Partisë duhet të shfrytëzohet për të njohur sa më mirë përbërjen e Partisë sonë (për të pasur një pasqyrë sa më të qartë për përbërjen e saj reale) dhe kjo gjë do të shërbejë që ne të marrim masat e duhura për forcimin e Partisë.

a) Gjatë vërtetimit të dokumentave do të njihen dhe do të zbulohen të gjitha të metat dhe dobësitë që ekzistojnë në disa komunistë; komitetet e Partisë të rretheve duhet të marrin shënim për të gjitha këto dhe të analizojnë thellë të metat e tyre. Komitetet e Partisë të rretheve duhet të përcaktojnë masat e nevojshme edukative e disiplinore që duhen marrë për luftimin e dobësive, për edukimin e korigjimin e këtyre komunistëve dhe për forcimin e mëtejshëm të Partisë.

b) Gjatë vërtetimit të dokumentave do të zbulohen gjithashtu armiqtë e fshehur të Partisë, të cilët mund të kenë hyrë kontra-

bandë në gjirin e saj. Komitetet e Partisë duhet t'i studjojnë im-tësisht këto raste dhe t'i bëjnë Komitetit Qendror propozime për t'i lënë jashtë radhëve të Partisë. Tesera e re e Partisë dhe karta e kandidatit nuk duhet në asnjë mënyrë t'i jepet në dorë armikut.

Për të mos u lëshuar taserën e re të Partisë apo kartën e kandidatit duhet të propozohen kryesisht:

1. — Elementët, të cilët gjatë vërtetimit të dokumentave do të rezultojnë se kanë falsifikuar dokumentat ose kanë hyrë ilegalisht në Parti.

2. — Elementët armiq, të cilët në mënyra të ndryshme kanë mundur ta fshehin fytyrën e tyre të vërtetë para Partisë.

3. — Elementët me qëndrim të keq në të kaluarën (posaçërisht gjatë Luftës nacional-çlirimtare) si ata që kanë luftuar me armë kundër forcave partizane, ata që kanë bërë pjesë në formacionet e spiunazhit armik, dezertorët, ata që kanë kallëzuar para armikut etj.

4. — Elementët të cilët kanë gënjyer Partinë në dokumentat e tyre (ata që me qëllim e kanë fshehur të vërtetën) si dhe elementët që kanë vjedhur dhe abuzuar.

Komitetet e Partisë të rretheve duhet të jenë shumë të matur në marrjen e vendimeve për moslëshimin e dokumentave të Partisë një anëtar dhe kandidati; ato duhet ta shqyrtojnë çështjen thellësisht dhe ta peshojnë nga të gjitha anët me drejtësinë më të madhe.

Komitetet e Partisë në rrethe duhet të kenë parasysh se në këtë drejtim nuk mund të ketë disa kritere standard, por çdo rast duhet të studjohet veçanërisht duke marrë parasysh individin, rrethanat, krahinat etj. Duhet pasur parasysh që të mos gjykohej njerëzit nga dukja e jashtme, nga fjalët, por nga veprat e tyre. Gjithashtu duhet pasur parasysh që të mos konsiderohet armik një shok vetëm për faktin se i ati ose farefisi i tij kanë qenë me armikun, pa marrë parasysh qëndrimin e punën e vetë këtij shoku. Element armik duhet të konsiderohet ai që ka kryer ose kryen vepra armiqësore ndaj Partisë dhe popullit.

Vendimet e byrove të komiteteve të Partisë të rretheve, për moslëshimin e taserës së re të Partisë ose të kartës së kandidatit ndonjë anëtar dhe kandidati të Partisë duhet të aprovohen nga Sekretariati i KQ të PPSH. Kjo është një garanci për të mos lejuar që të goditet me këtë rast ndonjë element i pafajshëm.

III. — Ndërrimi i dokumentave të anëtarëve dhe të kandidatëve të Partisë do të fillojë pasi KQ i PPSH të ketë shqyrtuar raportet e byrove të komiteteve të Partisë të rretheve mbi përfundimet e nxjerra nga vërtetimi i dokumentave.

Më vonë do të lëshohen nga ana e KQ të PPSH udhëzime të

posaçme mbi mënyrën se si do të procedohet për ndërrimin e dokumentave.

IV. — Gjatë kohës që do të vazhdojë vërtetimi dhe ndërrimi i dokumentave të Partisë pezullohet pranimi në Parti i anëtarëve dhe i kandidatëve të rinj. Hapja rishtas e pranimeve në Parti të anëtarëve dhe të kandidatëve të rinj do të bëhet me vendim të Byrosë Politike të KQ të PPSH.

V. — Ngarkohet Drejtorja e organizimit dhe e inspektimit të përgatitë udhëzime më të hollësishme për zbatimin e këtij vendimi.

BYROJA POLITIKE E KOMITETIT QENDROR TË PPSH

*Botohet sipas origjinalit që
gjetet në Arkivin Qendror
të Partisë*

PLENUMI V I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Tiranë, 20—22 shkurt dhe 6 mars 1950

KOMUNIKATË

E PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Në mbledhjen e tij më datë 20-22 shkurt dhe 6 mars 1950, Komiteti Qendror vendosi përjashtimin nga radhët e tija të anëtarëve të Komitetit Qendror, Abedin Shehu, të Niazi Islamit, i cili u përjashtua edhe nga Partia dhe të kandidatit të Komitetit Qendror, Shyqri Këllezi, për aktivitet antiparti dhe trockist në dëm të intereseve të Partisë, të popullit dhe të Republikës Popullore.

Gjithashtu vendosi edhe përjashtimin e Nexhip Vinçanit nga radhët e Komitetit Qendror për gabime dhe faje të rënda në funksionet e tij shtetërore dhe të Partisë.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

REZOLUCION

I PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH MBI AKTIVITETIN GRUPAZH TË GRUPIT ANTIPARTI TË KRYESUAR NGA ABEDIN SHEHU, NIAZI ISLAMI DHE SHYQRI KËLLEZI

6 mars 1950

Më datën 20-22 shkurt dhe 6 mars zhvilloi punimet e tij Plenumi V i Komitetit Qendror të PPSH nën kryesinë e Sekretarit të Përgjithshëm të Partisë, shokut Enver Hoxha.

Plenumi i Komitetit Qendror dëgjoi raportin e Sekretarit të Përgjithshëm të Partisë, shokut Enver Hoxha, mbi ekzistencën e

një grupi antiparti dhe të një aktiviteti grupazhi në Parti, në të cilin bënin pjesë anëtarët e Komitetit Qendror, Abedin Shehu, Niazi Islami dhe kandidati i Komitetit Qendror Shyqri Këllezi dhe disa elementë të tjerë joanëtarë të Plenumit të Komitetit Qendror. Pasi dëgjoi edhe autokritikën e shokëve të lartpërmendur dhe analizoi punën e këtij grupi antiparti Plenumi i Komitetit Qendror konstatoi se ka ekzistuar një grup dhe një aktivitet grupazhi në Parti në të cilin bënin pjesë shokët Abedin Shehu, Niazi Islami, anëtarë të Komitetit Qendror, shoku Shyqri Këllezi kandidat i Komitetit Qendror dhe Isuf Keçi e Hamit Keçi. Ky grup që zhvillonte një aktivitet të rrezikshëm për Partinë dhe të dënueshëm prej saj, do të shkonte në fraksion dhe do të përfundonte në tradhëti të hapët në qoftë se Komiteti Qendror dhe Partia nuk do të ishin treguar vigjilentë dhe nuk do ta kishin zbuluar me kohë. Eksperienca tregon se elementi grupash dhe antiparti përfundon në tradhëti dhe në prehrin e imperializmit.

Në vijim të letrave të Partisë Bolshevike Partia jonë zbuloi grupin trockist të kryesuar nga Koçi Xoxe, grup që ishte i organizuar, i ndihmuar dhe i mbështetur nga Tito-Rankoviç etj. . .

Grupi trockist i tradhëtarit Koçi Xoxe, ashtu si klika e Beogradit, synonte të degjeneronte Partinë dhe ta transformonte atë në parti trockiste në duart e tyre, të degjeneronte Republikën Popullore në një republikë borgjeze, ta shkëputte vendin dhe popullin tonë nga kampi i socializmit që i jep mundësi ndërtimit të socializmit në vëndin tonë, ta futte vëndin tonë në prehrin e imperializmit, për realizimin e aspiratave të tyre imperialiste e kolonialiste.

Në dritën e letrave të Partisë Bolshevike u godit grupi trockist i Koçi Xoxes dhe veprimtaria e tij. U rivendosën në Parti parimet marksiste-leniniste, centralizmi demokratik, disiplina e ndërgjegjshme dhe e çelnihtë, kritika dhe autokritika, demokracia e brendshme dhe vigjilenca revolucionare.

Pas zbulimit të bandës trockiste të Koçi Xoxes, Komiteti Qendror dhe Partia duhej të forconin vigjilencën për të ruajtur Partinë nga çdo aktivitet trockist dhe armiqësor i mëvonshëm, të ruanin radhët e Partisë dhe t'i spastronin këto. Kjo do të bëhej në luftë të vazhdueshme e të përditshme për ruajtjen e parimeve marksiste-leniniste, për ruajtjen e rregullave organizative të Partisë, për forcimin e disiplinës, të kritikës dhe të autokritikës, të demokracisë së brendshme në Parti, në luftë kundër influencës së veprimtarisë trockiste dhe të çdo shfaqjeje që dëmton Partinë dhe vijën e saj politike, ekonomike dhe organizative.

Këtë orientim të drejtë i dha Kongresi I i Partisë Komitetit Qendror dhe Partisë sonë. Eksperienca e Partisë Bolshevike ishte

një mbështetje e fuqishme për një orientim të drejtë të punës dhe të vigjilencës për ruajtjen dhe forcimin e radhëve të Partisë, dhe bashkë me këtë Partia jonë kishte dhe një eksperiencë të sajën në luftë kundër grupazheve dhe fraksioneve, siç ishte ai i tradhëtarëve Sadik Premte dhe Anastas Lula, krerë të grupit të «Të Rinjve».

Partia jonë lindi nga grupet komuniste. Elementi i grupit të «Të Rinjve», si elementi i të gjitha grupeve të tjera, u fut në radhët e Partisë. Krerët e grupit të «Të Rinjve», tradhëtarët Sadik Premte dhe Anastas Lula, ishin kundër formimit të Partisë dhe vijës së saj politike dhe organizative.

Këta krerë trockistë kishin krijuar një grup me koncepte anti-parti dhe antimarksisteleniniste. Duke mos pasur besim në masat e popullit, në klasën punëtore dhe në rolin e saj avangardë, nuk kishin asnjë lidhje me to, nuk i përfillnin dhe rrinin larg tyre. Puna e tyre ishte një punë trockiste e fashiste e mbuluar me parulla të majta. Ata i orientonin anëtarët drejt krimeve. Koncepti i tyre mbi moralin ishte në kundërshtim me moralin proletar. Trockistët Anastas Lula dhe Sadik Premte e edukonin grupin me një konspiracion të kalbur dhe me një formë organizimi antiparti duke përdorur rrethe të ngushta të njohurish, miqsh e farefisi, që janë rezultat direkt i mosbesimit ndaj masave.

Pas formimit të Partisë, trockistët dhe fashistët Anastas Lula dhe Sadik Premte u hodhën në luftë të hapët kundër Partisë. Partia i dërmoi këta tradhëtarë. Me punën e kujdesshme të Partisë, pjesa më e madhe, e shëndoshë e elementit të këtij grupi u edukua nga Partia dhe u bë besnike e saj. Një pjesë tjetër e këtij grupi, që ishte më shumë nën influencën e krerëve, të ideologjisë dhe të konceptioneve antiparti të grupit, i ruajti dhe i zhvilloi konceptionet morale, shoqërore, organizative dhe ideo-politike të grupit. Kjo pjesë jo e shëndoshë e këtij grupi ka qenë vazhdimisht në kundërshtim me Partinë dhe me vijën e saj, ka bërë zigzage të rëndësishme në punë, por nuk ka mundur të dalë hapur në luftë kundër Partisë, për arsye të sukseseve dhe të vrullit revolucionar të Partisë.

Kjo pjesë e grupit të «Të Rinjve», në të cilën bënë pjesë Abedin Shehu, Shyqri Këllezi, Isuf Keçi dhe Hamit Keçi dhe me të cilën u bashkua edhe Niazi Islami që kishte të njëjtat koncepte antiparti, ishte gjithmonë në pritje të evenimenteve dhe të krizave në Parti për të përfitur nga situatat. Plenumi VIII ishte një nga këto evenimente. Ata u solidarizuan me platformën e Rezolucionit të Plenumit VIII jo nga pozitat e Partisë, por nga pozitat e tyre antiparti; dolën si të persekutuar dhe në të njëjtën kohë u bënë persekutues. Ata jo vetëm që nuk u goditën nga kryetrockisti Koçi Xoxe, por do të puqeshin me të në luftë kundër Partisë në qoftë se nuk zbuloheshin grupi trockist i Koçi Xoxes.

Plenumi XI ishte një eveniment tjetër në Parti për qëllimet antiparti të Abedin Shehut, Niazi Islamit, Shyqri Këllezit, Isuf Keçit dhe Hamit Keçit.

Plenumi XI ishte një kthesë e rëndësishme që bëhej në Partinë tonë në dritën e letrave shpëtimtare të Partisë Bolshevike drejtuar udhëheqjes së Partisë Komuniste Jugosllave. Gjithë puna e Partisë dhe e njerëzve u rishikua në frymën e një kritike dhe auto-kritike të shëndoshë. Vetëm trockistët, «rrethi» ku bënë pjesë Abedin Shehu, Niazi Islami, Shyqri Këllezi, Isuf Keçi, Hamit Keçi dhe elementi tjetër i dobët nuk e bënë këtë. Ky «rreth shokësh» as këtë herë nuk i folën haptas Partisë, nuk rishikuan gabimet dhe pikëpamjet e shtrembra të tyre ndaj Partisë. Ata mbetën në pozitat e tyre antiparti dhe e gënjyen Partinë në një kohë kur ajo, me plot të drejtë, rishikonte gabimet e bëra dhe dënimet e dhëna në vijën trockiste, kur ajo po ndryshonte pikëpamjet e veta ndaj kuadrit për të siguruar, në këtë mënyrë, shkatërrimin definitiv të efektit të aktivitetit trockist mbi politikën e kuadrit dhe mbi kuadrin.

Në prakun e këtyre evenimenteve dhe në Kongresin I të Partisë dhe gjatë kongresit, ata i vunë vetes si objektiv të zënë pozita në Parti duke përfitur nga situata. Për këtë ata u përgatitën dhe bënë plan: në organizatat bazë, në konferencat për zgjedhjen e delegatëve për në kongres dhe në kongres ata kanë fshehur jo vetëm pikëpamjet e tyre antiparti dhe gabimet e tyre, por edhe ato të njëri-tjetrit, duke u hequr si të persekutuar largonin çdo dyshim kundrejt tyre; reklamonin njëri-tjetrin, kritikonin ata që sipas pikëpamjes së tyre nuk duhej të ishin në udhëheqjen e re dhe, në kundërshtim flagrant me rregulloren e aprovuar nga kongresi, bënë lista të kandidatëve për udhëheqje, jashtë komisionit të zgjedhjeve të caktuar nga kongresi. Abedin Shehu, i cili ishte anëtar i këtij komisioni, dekonspironte në shokët e tij të grupit diskutimet e komisionit të zgjedhjeve.

Kongresi u bë për këta shokë një kthesë në drejtim dhe me qëllim të kundërt me atë të Partisë. Ata zunë pozita në Parti dhe në shtet dhe filluan të rigrupohen e të zhvillojnë një punë konkrete grupazhi dhe të kalojnë nga lidhjet «e lira shoqërore» në lidhje organizative grupi.

Kështu nga lidhjet «miqësore» të ruajtura nga grupi i «Të Rinjve», ata përfunduan në krijimin e një grupi antiparti në radhët e Partisë me tipare organizative, politike dhe morale të grupit të vjetër të «Të Rinjve». Në këtë mënyrë, duke pasur pikëpamje grupazhi mbi Partinë, duke mos pasur besim te Partia dhe duke qenë në kundërshtim me të dhe me vijën e saj, ata kaluan në një fazë më të organizuar të luftës së tyre kundër Partisë dhe pikërisht në një kohë kur ata forcuan pozitat e tyre në udhëheqje të Partisë dhe të shtetit.

Ky «rreth shokësh» dhe puna e tyre i ka të gjitha karakteristikat e grupit antiparti dhe të punës grupazh.

1. — Grupi mbledhje gati rregullisht. Mbledhjet bëheshin përgjithësisht me po ata persona: Abedin Shehu, Niazi Islami, Shyqri Këllezi, Isuf Keçi, Hamit Keçi që ishin «shokët» kryesorë.

2. — Në këto mbledhje bisedonin çështjet që kishin frikë dhe që nuk donin t'i bisedonin në Parti dhe në organet e tjera të shtetit, dhe bënin kritika mbi çdo gjë dhe kundër cilitdo, jashtë rregullave të Partisë.

3. — Në këto mbledhje bisedoheshin probleme politike, ekonomike, shoqërore, ushtarake, organizative e kuadri sikur të ishte një forum partie (siç e kanë pohuar ata vetë) ose një qeveri tjetër.

4. — Diskutimet mbi problemet politike, ekonomike, shoqërore, ushtarake, organizative e kuadri, bëheshin në baza antiparti, antisocialiste dhe antipopullore. Ata nënvleftësonin historinë e popullit tonë, forcat revolucionare të popullit, klasën punëtore dhe Luftën nacional-çlirimtare. Për ata Skënderbeu nuk ishte Heroi i Kombit tonë që përballoi për 24 vjet sulmet e përsëritura të otomanëve duke siguruar pavarësinë e popullit tonë, por një «hiç gjë» dhe historia e Shqipërisë për ta është një «përrallë»; popullin tonë që fitoi admirimin e gjithë botës me rezistencën e tij kundër fashizmit që në ditët e para të prillit dhe me Luftën e tij nacional-çlirimtare, ata e akuzonin si popull «mistrec». Sipas pikëpamjeve të këtij grupi, në Shqipëri nuk ka një klasë punëtore. Punëtorët tanë «nuk e meritojnë» këtë emër. . .

Sipas pikëpamjeve të gabuara dhe antiparti të këtij grupi politika ekonomike e Partisë dhe e qeverisë sonë nuk ishte e drejtë. Sipas tyre tregu i lirë i shtetit nuk ishte në interes të shtetit dhe të masave punonjëse, por «në interes të të pasurve»¹. Për ata planet ekonomike të shtetit ishin «të parealizueshme». Duke u nisur nga mosbesimi në forcat ndërtimore të popullit tonë, duke qenë në kundërshtim me vijën e Partisë dhe duke dashur sabotimin e realizimit të planit ekonomik të shtetit, ata shfaqnin mosbesim në realizimin e planit të grumbullimeve dhe të sektorëve të tjerë ekonomikë dhe pritin dështimin e këtyre planeve për të goditur Partinë dhe shtetin.

Ata shqetësoheshin për luftën që u bëhej kulakëve në fshat

¹ Është fjala për vendimet e Partisë e të qeverisë mbi sistemin e ri të grumbullimit dhe të furnizimit.

dhe u qanin hallin atyre për goditjet që pësonin nga pushteti popullor.

Urdhërat ushtarakë për ata ishin të diskutueshëm. Ata pretendonin se zbatimi i detyrueshëm i urdhërave ushtarakë nuk është i drejtë. «Inferiori, — thoshin ata, — duhet t'i vlerësojë dhe t'i diskutojë ata, dhe, në qoftë se nuk i mbushet mendja për saktësinë e tyre, të mos i zbatojë». Ata s'kishin besim në aftësinë mbrojtëse të vendit tonë dhe në gatishmërinë luftarake të Ushtrisë Popullore. Ata informoheshin për aftësinë mbrojtëse të vendit tonë, për gatishmërinë luftarake të ushtrisë dhe për sekrete të tjera të rëndësishme ushtarake. Ata i përfundonin diskutimet e tyre të bindur se mbrojtja e vendit tonë është e dobët dhe gatishmëria e ushtrisë nuk është e mjaftë.

Ata bisedonin probleme organizative e kuadri, si krijim dikasteresh të reja, ndryshime ministrash, sekretarë të parë rrethesh etj.

5. — Në këto mbledhje arrihej në konkluzione dhe në bazë të këtyre konkluzioneve, nga pozita grupi, mbahej qëndrim në punë partie dhe shtetërore. Në raste të ndryshme ata kanë bërë propozime, vërejtje dhe kanë mbajtur qëndrim mbi çështje politike, ekonomike dhe organizative në qeveri, në komisione etj., për të cilat më parë kanë biseduar dhe kanë rënë dakord midis tyre. Kështu pas bisedimeve të bëra në grup ata kanë bërë vërejtje se politika e tregut të lirë shtetëror nuk është e drejtë, se planet nuk mund të realizohen në qoftë se «nuk janë gati dhe nuk janë plotësuar në mënyrë «perfekte» materiali, transporti, fuqia punëtore etj.», se planet janë ireale etj. Ndërsa kur është marrë vendim për këto çështje nga Komiteti Qendror dhe nga qeveria, ata nuk kanë bërë vërejtje të këtilla. Nga pozitat e grupit ata kanë dalë me propozime për krijimin e dikasterëve të reja dhe e kanë sabotuar organizimin e organeve administrative, në bazë të vendimeve të marrura dhe në bazë të eksperiencës sovjetike.

6. — Kjo punë grupazhi refleктоhej në punën e anëtarëve jashtë grupit. Në punën e tyre jashtë grupit është parë mosbindja, kundërshtimi i urdhërave dhe thyerja e vendimeve. Kanë refuzuar, si ushtarakë, t'u binden urdhërave të Komandës, të thyejnë në mënyrën më flagrante nënrendimin ushtarak dhe të akuzojnë për tradhëti komandën e lojës gjatë një loje ushtarake; kanë refuzuar t'u binden urdhërave të qeverisë për të bashkëpunuar me ministra për zgjidhjen e problemeve shtetërore; kanë thyer vendimet e marrura në udhëheqje për pregatitje organikash të organeve shtetërore dhe kanë dalë me projekte në kundërshtim me këto vendime.

Nuk kanë respektuar ligjet e shtetit. Në kundërshtim me vendimin e qeverisë kanë mbajtur në fuqi dhe kanë zbatuar urdhëresat të abroguara.

Në punën e tyre jashtë grupit është parë përhapja e frymës

demobilizuese në realizimin e planit dhe sabotimi i tij, disfatizmi dhe çorganizimi, moskokëçarja, mungesa absolute e vigjilencës kundrejt punës së armiqve dhe sabotimeve, thyerja e disiplinës dhe e hierarkisë shtetërore dhe e Partisë dhe janë lavdëruar dhe dekoruar sabotatorët, agjentë dhe spiunë të jugosllavëve. Me gjithë vërejtjet e bëra herë pas here nga udhëheqja e Partisë dhe e shtetit mbi punën armiqësore që zhvillohej në sektorët e tyre, ata kanë vazhduar t'i bëhen mbrojtës kësaj pune duke i shkaktuar dëme të mëdha shtetit qoftë me sabotimet qoftë me mosrealizimin e planit të shtetit si p.sh. në komunikacion, në Kuçovë etj.

Megalomania dhe ambicia që ushqehet në grupin e tyre shfaqet në përcmimin e punëve të sektorëve të tjerë, në përcmimin e udhëheqësve të sektorëve të tjerë, në reklamimin e vetes dhe të punës së tyre. Mosbesimi i grupit në klasën punëtore dhe degjenerimi i ndërgjegjes punëtore brenda radhëve të tyre shfaqet në keqpërdorimin që i bënin punëtorisë, si në Patos e gjetkë. Për shkak të anti-sovjetizmit të tyre ata nuk bashkëpunonin me këshilltarët sovjetikë, nuk dëgjonin këshillat e tyre të çmueshme për një organizim më të mirë të punës, për aplikimin e metodave të reja për shtimin e prodhimit, për realizimin e planeve etj.

Ata përpiqeshin t'i largoheshin kontrollit dhe drejtimit të Partisë. Për ata komitetet e Partisë nuk duhet të kishin të drejtë të bënin politikën e kuadrit në qendrat e punës, të shihnin projektplanet dhe realizimin e planeve, të shfaqnin mendimin e tyre dhe të ndihmonin. Ata donin një drejtim diktatorial (sipas shprehjes së tyre), një drejtim personal të sektorëve të punës që kryesonin ata.

7. — Secili anëtar direkt ose indirekt dekonspironte në grup të gjitha sekretet shtetërore, për të cilat kishte dijeni. Janë dekonspiruar këtu sekrete të rëndësishme të shtetit në lidhje me marrëdhënjet tona të jashtme; sekrete të ekonomisë, si shifra, projektstudime të paparaqitura akoma në qeveri etj., sekrete ushtarake të sigurimit dhe të mbrojtjes së vendit tonë etj. Anëtarët e Plenumit të Komitetit Qendror, Abedin Shehu, Niazi Islami dhe Shyqri Këllezi jo vetëm që nuk mbanin qëndrim, por dekonspironin edhe këta vetë sekretet shtetërore dhe të Partisë e detyronin edhe të tjerët të dekonspironin duke u kërkuar informata.

8. — Kishte filluar të krijohet një qëndër në të cilën dallohej autoriteti i disave dhe sidomos i Abedin Shehut. Këtyre u shtroheshin çështjet, bisedohej me ta, kërkohej mendimi i tyre për çështje shtetërore dhe partie. Shtypi i Partisë dhe i organizatave nuk lexohej dhe situata politike e brendshme dhe e jashtme merrej nga grupi.

9. — Ishte zhvilluar konspiracioni i grupit. Asnjëri nuk e informonte Partinë dhe qeverinë dhe i ruheshin vigjilencës revo-

lucionare të Partisë. Partia nuk është vënë kurrë në korrent as për mbledhje as për dekonspirimin e sekreteve shtetërore dhe as për pikëpamjet e gabuara dhe kundërshtimet me vijën e Partisë, që shfaqeshin brenda grupit.

10. — Mbronin e mburrnin njëri-tjetrin dhe fshihnin përpara Partisë gabimet dhe fajet e tyre dhe të shokëve të grupit.

11. — Punonin për zgjerimin e rrethit të tyre me shokë që ishin me pozita në Parti dhe në shtet dhe përdornin për këtë metodën e provokacionit dhe të komprometimit ndaj elementit që ata kujtonin se mund të kishte arësye për të qenë i pakënaqur ose që donin t'i ngjallnin pakënaqësi.

TAKTIKA E GRUPIT

Këta shokë përfituan nga eksperiencia dhe nga metodat e grupit trockist për të zhvilluar punën e tyre prej grupazhi. Ata synonin:

1. — Të thyej centralizmi demokratik, të thyej konspiracioni e disiplina e Partisë dhe e shtetit, të shuhej vigjilenca, të shkeleshin rregullat dhe parimet organizative të Partisë dhe të shtetit, të shuhej kritika dhe autokritika si armë të fuqishme të zhvillimit të Partisë dhe të shoqërisë sonë, për të degjeneruar Partinë dhe Republikën tonë.

2. — Të ngjallej mosbesimi në punën e planit dhe të zhvillohej disfatizmi, çorganizimi, mosbindja, arbitrariteti dhe indisciplinimi. Të goditej ekonomia e vendit tonë, të dobësohej kjo si bazë e pushtetit popullor dhe të vështirësohej gjendja e brendshme e vendit. . .

4. — Të minonin udhëheqjen e Partisë dhe të shtetit duke minuar më parë pozitat e shokëve udhëheqës të Partisë dhe të shtetit që ata kujtonin se mund të goditeshin më lehtë ose duke i provokuar ose duke u përpjekur për t'i komprometuar.

5. — Të përfitonin nga çdo situatë për të forcuar dhe zgjeruar pozitat e tyre në pritje që të ndodhnin evenimente të tjera dhe situata të vështira për Partinë, që të mund të realizonin qëllimet e tyre.

Edhe pas zbulimit të aktivitetit të grupit, të lartpërmendurit mbajtën një qëndrim trockist dhe përdorën po atë taktikë që përdori grupi trockist i Koçi Xoxes.

E para, ata i prenë mbledhjet e përbashkëta duke mbajtur takime individuale sipas rastit.

E dyta, të frikësuar, ata, për sy e faqe, u desolidarizuan me pjesëtarët e grupit që ishin më të komprometuar dhe më në sy kundrejt Partisë duke u bërë atyre deri diku edhe një farë kritike që nuk ngrinte peshë në krahasim me fajet që kishin.

E treta, pranuan se kanë bërë bisedime kurdoherë me njëri-tjetrin, por pretenduan se këto bisedime me ata që ishin më shumë të komprometuar kanë qenë «në formë të përgjithshme» dhe «jokorrekte». Duke e ditur mirë se nuk janë të dënueshme dhe as të ndaluara nga Partia mbledhjet dhe bisedimet shoqërore të shëndosha, bisedimet ndërmjet anëtarëve të qeverisë për çështje qeveritare dhe bisedimet ndërmjet anëtarëve të Komitetit Qendror për çështje partie dhe pushteti, ata u përpoqën që t'i paraqitnin këto në fillim si «mbledhje të thjeshta shoqërore» dhe si bisedime «ndërmjet ministrash» ose «anëtarësh të Plenumit të Komitetit Qendror». Por ndërkohë ata linin në heshtje çështjen kryesore: a) bisedimet e tyre me shokë që nuk ishin anëtarë të Komitetit Qendror dhe anëtarë të qeverisë, b) për probleme që nuk u përkitnin atyre, dhe c) bisedimet që zhvilloheshin në kundërshtim me vijën e Partisë dhe të shtetit dhe në frymë antimarksisteleniniste, antisocialiste, antipopullore.

E katërta, fshihnin gjërat komprometuese dhe të rrezikshme dhe, kur kishin mundësi, binin dakord për qëndrimin që duhej të mbanin për çështje të caktuara, me qëllim që të fshihnin çka të ishte e mundur, të mbronin kë të ishte e mundur dhe të digjnin vetëm ata që nuk ishte oportune të mbroheshin më.

E pesta, pohuan vetëm kur u gjendën përpara fakteve dhe vetëm aq sa kishte mundur të zbulonte Komiteti Qendror.

E gjashta, herë pas here kur ata gjendeshin përpara fakteve premtorin, në të njëjtën mënyrë si trockisti Koçi Xoxe dhe shokët e tij, se do të bënin radhën tjetër autokritikë, pa arritur ta bëjnë këtë autokritikë as edhe përpara Komitetit Qendror.

Ky grup antiparti punonte për dobësimin e Partisë, të shtetit, të ekonomisë së vendit tonë, për forcimin e pozitave të tija në Parti dhe në shtet. Minonte pozitën e udhëheqjes së Partisë dhe priste, si dhe herë të tjera, një moment të përshtatshëm për qëllimet e tij antiparti, priste «kur të pëlciste në Parti».

Këta shokë që kurrë nuk kanë qenë përsekutuar siç kanë pretenduar, që nuk janë keqpërdorur kurrë, që Partia u dha dorën në Kongresin I të saj duke i zgjedhur anëtarë të Plenumit të Komitetit Qendror dhe që u dha pozita të rëndësishme në qeveri, në ushtri dhe në organe të tjera të pushtetit, që u dha besim se do të punonin për të mirën e atdheut, të pushtetit popullor dhe të Republikës,

e shpërdoruan pozitën e tyre dhe besimin e Partisë, të pushtetit popullor për qëllimet e tyre antiparti, antipopullore.

ANËTARËT E GRUPIT ZHVILLONIN ME NDËRGJEGJE NJË PUNË GRUPAZHI E ANTIPARTI

Shokët e lartpërmendur zhvillonin me ndërgjegje një punë grupazhi dhe antiparti, prandaj punonin në mënyrë konspirative dhe nuk e vinin për asgjë në korrent Partinë dhe qeverinë. Ata e dinin se puna që bënin ishte në kundërshtim me vijën e Partisë, me rregullat e saja organizative, me disiplinën e saj, porse ata nuk hiqnin dorë nga kjo pse e çmonin të nevojshme një veprimtari të tillë grupazhi për qëllimet e tyre antiparti. Ata pohuan se nuk do t'ja tregonin kurrë Partisë ekzistencën dhe punën e grupazhit pse ishin të ndërgjegjshëm për punën që bënin dhe, sikur mos ta kishte zbuluar Partia, grupi do të vazhonte rrugën për realizimin e qëllimeve të tij antiparti.

Kurdoherë që ka pasur nga ana e tyre shfaqje të një qëndrimi jokorrekt, dekonspirimi, shfaqje pikëpamjesh antisocialiste e antisovjetike, shfaqje indisciplinimi, thyerje vendimesh, urdhërash, pikëpamje të shtrembra vije, shenja çorganizimi në punë, mungesë vigjilence. Komiteti Qendror ua ka vënë në dukje këto dobësi dhe i ka këshilluar që t'i ndreqin, por ata, duke qenë të ndërgjegjshëm për punë grupazhi që zhvillonin prapa shpinës së Partisë, nuk i kanë treguar asgjë Partisë, nuk kanë dashur të korrigjohen dhe kanë vazhduar në punën e tyre antiparti.

Por Komiteti Qendror dhe Partia përpara shfaqjeve të tilla e shtonin dhe e mprehnin vigjilencën. Shfaqje të tilla nuk mund të ishin të rastit dhe të shkëputura aq më tepër kur këto shfaqje jo-normale në jetën e komunistëve dhe të Partisë, përsëriteshin nga i njëjti person ose kishin analogji me shfaqje të pjesëtarëve të tjerë të këtij grupi. Me një shtim më të madh të vigjilencës u arrit të zbulohet ky grup antiparti.

Qëndrimi armiqtësor i të lartpërmendurve pas zbulimit të grupit tregon edhe një herë se sa të ndërgjegjshëm ishin në këtë punë antiparti. Byroja Politike i pyeti me anën e të deleguarve të saj, i thirri përpara Byrosë, u paraqitën në mbledhjen e Komitetit Qendror ku u shtrua puna dhe aktiviteti i këtij grupi antiparti. Ata në çdo përgjegje të pyetjeve që u bëheshin dhe në autokritikën e tyre janë përpjekur të fshehin punën e qëllimin e tyre, të ruajnë «shokët e grupit» duke mos përfillur aspak interesat e Partisë dhe të shtetit. Duke qenë të ndërgjegjshëm në punën e tyre prej grupazhi, ata kanë pranuar fakte të pakundërshtueshme që u ka vënë

përpara Komiteti Qendror, pa bërë nga ana e tyre autokritikë të hapur e të plotë dhe pa ndihmuar Partinë.

Duke qenë të ndërgjegjshëm në punën e tyre antiparti, në kundërshtim me porosinë e Byrosë Politike që t'i shkëputnin menjëherë lidhjet e grupit, ata kanë vazhduar t'i mbajnë këto lidhje dhe të organizojnë mbrojtjen.

Me gjithë ndihmën e madhe që ju dha këtyre shokëve nga të deleguarit e Byrosë Politike, nga Byroja Politike dhe nga Komiteti Qendror, ata me ndërgjegje vazhduan të mbeten në pozita armiqësore kundrejt Partisë.

Komiteti Qendror, me qëllim që t'i ndihmojë këta shokë, t'i shpëtojë, t'i nxjerrë nga pozitat armiqësore kundrejt Partisë në të cilat kanë rënë, t'i bëjë që të punojnë për të mirën e Partisë dhe të popullit, i këshillon që të thellohen mirë mbi fajet e tyre, t'i analizojnë shkaqet e thella që i çuan në këtë rrugë, të nxjerrin konkluzione dhe të zbulojnë të gjithë punën e tyre prej grupazhi, se vetëm kështu do të kenë shpresë të shërohen dhe do të mundin të kthehen drejt rrugës së Partisë për të mirën e Partisë e të popullit dhe për të mirën e tyre. Ndryshe nuk do të jenë të denjë të jenë anëtarë partie.

Plenumi i Komitetit Qendror u vë në dukje shokëve, që kanë rënë në këtë llum, të dalin nga pozitat armiqësore që janë sot, pse ato janë të rrezikshme dhe do t'i futin më thellë në rrugën e tradhëtisë në qoftë se nuk kthehen me vendosmëri në rrugën e Partisë. Autokritika e shëndoshë, e hapur, pa hezitime dhe e guximshme, është i vetmi mjet i komunistëve që gabojnë për të filluar kthesën drejt rrugës së Partisë. Që të mundin ta bëjnë këtë, shokët e lartpërmendur duhet të krijojnë besimin e fortë dhe të shëndoshë te Partia, të ndejnë dashurinë e saj. Kjo, nga ana tjetër, do t'i ruajë nga provokacionet e nga rreziqet që patjetër do të gjejnë në rrugën e tyre. Është gabim i madh të mendohet se nuk është oportune ose se është turp të bëhet një analizë e thellë e gabimeve dhe e fajeve dhe një autokritikë e plotë sot për arsye se nuk u bë dje. Kështu mund të mendojnë dhe të arsyetojnë vetëm mikroborgjezët.

KONKLUZIONE

Plenumi i Komitetit Qendror konkludon se Partia jonë, e ngritur mbi principet marksiste-leniniste, e udhëhequr nga mësimet

e Leninit dhe të Stalinit, duke ndjekur shembullin dhe eksperiencën e Partisë Bolshevike, është dhe do të jetë si shkëmb graniti ku kanë thyer dhe do të thyejnë kokën armiqtë e brendshëm dhe të jashtëm dhe elementi grupash e fraksionist. Ajo ka një eksperiencë të madhe në luftë me armiqtë e brendshëm dhe të jashtëm. Ajo i ka dërmuar gjithmonë këta, ka dalë triumfuese dhe ka forcuar dhe çelnikosur përherë e më shumë radhët e saja, unitetin e saj, rolin e saj si udhëheqëse pararojë.

Klika trockiste e Beogradit, bashkëpunëtore e imperializmit, është armike e Bashkimit Sovjetik, e Republikës sonë Popullore dhe e Partisë sonë. Kjo klikë ka punuar dhe do të punojë kundër Republikës sonë Popullore, Partisë dhe popullit tonë... Ajo përpiqet të inkurajojë, të grumbullojë, të organizojë, brenda dhe jashtë Partisë elementin antiparti, armiqtë e kiasës dhe çdo mbeturinë të reaksionit në vendin tonë kundër Partisë sonë dhe pushtetit popullor. Përveç kësaj, kjo klikë grumbullon dhe organizon armiqtë e popullit dhe tradhëtarët e vendit tonë në tokën e saj dhe hedh spiunë, provokatorë dhe diversantë brenda kufive të vendit tonë. Të gjitha këto i bën për një qëllim të vetëm: të pengojë ndërtimin e socializmit në vendin tonë, ta shkëputë vendin tonë nga Bashkimi Sovjetik dhe ta futë në prehrin e imperializmit.

Në veprimtarinë e grupit, në të cilin bënin pjesë elementët kryesorë Abedin Shehu, Niazi Islami, Shyqri Këllezi etj., ka pasur shenja që tregojnë se ka gisht në të edhe klika trockiste e Beogradit. Puna antiparti dhe antishtetërore e këtij grupi me format dhe me taktikën tipike të trockistëve, pohimi direkt i Niazi Islamit se ka bërë punë trockiste, frika e shfaqur prej tij se mos konsiderohej protitist, mospranimi i sugjerimeve të këshilltarëve sovjetikë për organizimin më të mirë të punës dhe mospranimi dhe hedhja poshtë e eksperiencës sovjetike prej tyre, sabotimet në shkallë të gjerë dhe të hapët nga agjentët titistë sidomos në hekurudhë, mosmarrja e masave nga Niazi Islami për t'i dhënë fund këtij sabotimi, mbrojtja që u bënte ai sabotatorëve dhe inkurajimi i tyre me lavdërime e dekorime, vetëvraska e Niazi Islamit më 25 shkurt, pa i dhënë llogari Partisë për të gjitha fajet e tij dhe të grupit dhe pa zbuluar të gjithë aktivitetin armiqësor, vërtetojnë këtë aktivitet antiparti dhe antishtetëror të këtij grupi.

Zbulimi i këtij grupi është një sukses tjetër i rëndësishëm në rrugën e forcimit të unitetit të Partisë, të udhëheqjes dhe të forcimit të radhëve të Partisë, në mobilizimin revolucionar të Partisë dhe të masave punonjëse për realizimin e vijës së Partisë, për forcimin e marrëdhënjeve tona e të miqësisë me BS, të dashurisë për popujt e Bashkimit Sovjetik, për Partinë Bolshevike dhe Stalinin e madh dhe për forcimin e lidhjeve tona me popujt e çliruar të demokracisë popullore që qëndrojnë të bashkuar rreth Bashkimit të lavdishëm Sovjetik.

Por për t'u bërë plotësisht kështu duhet:

1. — Të zhvillohet gjithnjë më e fuqishme lufta kundër klikës trockiste të Titos që është bashkëpunëtore e reaksionit imperialist dhe armike e Bashkimit Sovjetik, e demokracive popullore, e socializmit dhe e partive komuniste dhe punëtore. Të intensifikohet lufta në shkallë më të gjerë kundër aktivitetit të tyre dhe ideologjisë së tyre trockiste e pseudosocialiste. Të intensifikohet puna për demaskimin e gjithanshëm të tyre. Të vigjilohet dhe të goditet çdo shfaqje e pikëpamjeve dhe e veprimtarisë trockiste në Parti dhe jashtë Partisë. Partia të jetë vazhdimisht e mobilizuar kundër çdo shfaqjeje dhe veprimtarie armiqësore të kësaj klike.

2. — Të zhvillohet edhe më shumë kritika dhe autokritika e shëndoshë bolshevike dhe të forcohet demokracia e brendshme në Parti. Të rritet kombativiteti në organizatat e Partisë për pastërtinë e radhëve të Partisë, për pastërtinë e vijës së saj, për edukimin komunist të shokëve. Të çmohet kritika dhe autokritika si i vetmi ligj i zhvillimit të Partisë dhe të Republikës sonë, pa të cilin rrezikohet ekzistenca e Partisë dhe ndërtimi i socializmit në vendin tonë. Atje ku nuk përdoret kritika dhe autokritika e shëndoshë bolshevike, zënë vend miqësitë e sëmura, rezervat, paragjykimet, mëritë personale, hatëret e mbetura, dizarmonia që çojnë dalëngadalë dhe në mënyrë sistematike në rrugë antiparti dhe në shkatërrimin e organizatës së Partisë. Atje ku nuk zhvillohet kritika dhe autokritika nuk mund të spastrohen shokët nga të metat dhe nga mbeturinat mikroborgjeze që sillen në Parti, nuk mund të ruhen ata nga presioni i borgjezisë, nuk mund të ndihmohen njerëzit të përmirësohen dhe të përmirësojnë edhe punën e tyre. Partia duhet ta bëjë kritikën dhe autokritikën gjithnjë e më shumë një armë të fuqishme për veten e saj, për organet e pushtetit dhe për popullit.

3. — Të zhvillohet vigjilenca revolucionare që është e domosdoshme për ruajtjen e Partisë nga armiqtë që futen në të kontrabandë dhe për spastrimin e saj, që është e domosdoshme për të parë dobësitë, të metat dhe lëshimet në punën e Partisë dhe të pushtetit, për të dalluar shkaqet dhe arësyet e tyre të thella dhe për të marrë masat me kohë. Të mbahet parasysh se armiku synon të futet në Parti dhe kur është brenda synon drejt udhëheqjes. Këtë na e tregon eksperiencia e Partisë Bolshevike dhe eksperiencia e Partisë sonë. Ai synon të dobësojë Partinë në çdo mënyrë dhe përpjekjet e tija bëhen aq më të mëdha dhe metodat aq më të stërholluara, sa më tepër armiku dobësohet dhe goditet. Prandaj edhe më me forcë shtrohet përpara Partisë detyra që të zhvillojë vazhdimisht vigjilencën revolucionare dhe ta zhvillojë këtë vigjilencë edhe në masat punonjëse të vendit tonë, në të gjithë patriotët që të ruhet pushteti ynë nga armiqtë dhe të sigurohet mbrojtja e vendit tonë nga ana e vetë masave.

4. — Të forcohet disiplina e ndërgjegjshme dhe e çelniktë në Parti. Të ruhet dhe të mbrohet principi i centralizmit demokratik dhe rregullat organizative të Partisë kundër të cilave zhvillojnë luftën të gjithë armiqtë e Partisë. Respektimi dhe zbatimi me përpikmërinë më të madhe i rregullave të Statutit është detyra e parë dhe kryesore e çdo anëtarit të Partisë.

5. — Të intensifikohen përpjekjet nga ana e forumeve dhe nga anëtarët e Partisë për ngritjen ideo-politike të anëtarëve të Partisë. T'i jepet rëndësi më e madhe ndjekjes së kurseve të Partisë dhe të gjitha formave të tjera të edukimit, si shkollave politike, rretheve të studimit, studimit individual, leximit të shtypit, leximeve kolektive, luftës kundër analfabetizmit në radhët e Partisë, që anëtarët e Partisë të armatosen me armën e fuqishme të teorisë marksiste-leniniste për të qenë luftëtarë të denjë të pararojës.

6. — Të shtohen përpjekjet për realizimin e planit ekonomik të shtetit dhe lufta kundër neglizhencave, lëshimeve, pakujdesive, çorganizimit, demobilizimit, disfatizmit në realizimin e planit. Armiku e di se me realizimin e planeve është e lidhur mirëqënjja e popullit tonë, prandaj ai i drejton goditjet e tija kundër planit ekonomik të shtetit. Të luftohet me ashpërsinë më të madhe kundër çdo shpërdorimi dhe kundër çdo sabotimi të planit ekonomik të shtetit.

7. — Të punohet pa pushim dhe gjithnjë e më shumë për forcimin e lidhjeve të miqësisë dhe të dashurisë me Bashkimin Sovjetik që është ndihmësi dhe mbrojtësi i vendit dhe i popullit tonë, që është mbështetja e madhe e mbrojtjes së pavarësisë së vendit tonë dhe të ndërtimit të socializmit në vendin tonë. Të shtohet gjithnjë e më shumë dashuria dhe mirënjohja ndaj Partisë Bolshevike dhe Stalinit të madh, udhëheqës i gjithë njerëzimit përparimtar dhe mbrojtës i paqes, i demokracisë dhe i socializmit. Të forcohen dhe të shtrëngohen gjithnjë e më shumë radhët e popullit tonë me ato të popujve të vendeve të demokracisë popullore përreth Bashkimit Sovjetik dhe me gjithë forcat përparimtare të botës, në lëvizjen e madhe të partizanëve të paqes që udhëhiqet nga Stalini i madh.

8. — Në dritën e eksperiencës së zbulimit të aktivitetit të grupit antiparti, organizatat e Partisë të analizojnë punën e tyre, të godasin dhe të ndreqin gabimet, të metat dhe lëshimet.

Duke marrë parasysh sa u thanë më lart, Plenumi i Komitetit Qendror

V e n d o s i :

1. — Të përjashtohen nga radhët e Komitetit Qendror anëtarët e Komitetit Qendror Abedin Shehu¹, Niazi Islami dhe kandidati i KQ Shyqri Këllezi², të cilët në kundërshtim me rregullat më ele-

mentare të Partisë kanë zhvilluar një aktivitet grupazhi antiparti me të cilin kanë dëmtuar Partinë, nuk kanë ruajtur vijën e Partisë dhe interesat e saj dhe kanë punuar në kundërshtim me vijën e Partisë, nuk kanë bërë autokritikë përpara Komitetit Qendror.

Duke marrë parasysh se pas përjashtimit nga Komiteti Qendror Niazi Islami vrau veten, akt ky që është në vetëvete i dënueshëm nga Partia, duke marrë parasysh që Niazi Islami i ka fshehur Partisë aktivitetin e tij armiqësor, duke marrë parasysh se vetëvrasja e tij është një tjetër akt armiqësor kundrejt Partisë për të mbuluar tradhëtinë që i ka bërë Partisë dhe shtetit, Komiteti Qendror vendosi përjashtimin e tij nga Partia pas vdekjes.

2. — Komiteti Qendror përjashtoi nga radhët e Partisë Hamit Keçin dhe Isuf Keçin dhe aprovoi arrestimin e tyre për faje kundër popullit dhe shtetit.

3. — Të mblidhen aktivet e Partisë për të punuar këtë rezolucion dhe mbas aktiveve rezolucioni të punohet në të gjitha organizatat bazë të Partisë.

4. — Të shërbejë punimi i këtij rezolucioni si një armë e fuqishme për forcimin e Partisë, të unitetit të saj, të rregullave organizative të Partisë dhe të vigjilencës revolucionare. Të shërbejë punimi i këtij rezolucioni për realizimin e planit ekonomik të shtetit dhe për një zhvillim të madh të kritikës dhe të autokritikës në mënyrë që elementët, që eventualisht mund të kenë rezerva, që mund të kenë gabuar dhe që janë drojtur të flasin hapur, që janë gjendur padashur të komprometuar nga metodat e ndryshme që përdor armiku i klasës, të flasin hapur, pa frikë e pa hezitime, për veten e tyre dhe për të tjerët. Partia këtyre do t'u japë dorën, do t'i ndihmojë të dalin nga pozitat që janë të rrezikshme për Partinë dhe për veten e tyre, të dalin nga ato pozita që i bëjnë ata të jenë gjithnjë preja e armikut. Vetëm në këtë mënyrë këta elementë do të ringjallen dhe do të ecin kryelartë, me zemër të pastër prej revolucionari, në rrugën e Partisë.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

*Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

REZOLUCION

I PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH MBI GABIMET DHE FAJET E NEXHIP VINÇANIT

6 mars 1950

Më datën 20-22 shkurt dhe 6 mars 1950 zhvilloi punimet e tij Plenumi V i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë nën kryesinë e Sekretarit të Përgjithshëm të Partisë, shokut Enver Hoxha.

Plenumi i Komitetit Qendror dëgjoi raportin e Sekretarit të Përgjithshëm të Partisë, shokut Enver Hoxha mbi gabimet dhe fajet e Nexhip Vinçanit. Pasi dëgjoi edhe autokritikën e shokut Nexhip Vinçani dhe analizoi punën e tij, Plenumi i Komitetit Qendror, konstatoi se shoku Nexhip Vinçani:

1. — Nuk ka pasur besim te Partia dhe te udhëheqja e saj.

2. — Duke qenë megaloman dhe karrierist, duke mbiçmuar veten e tij dhe duke qenë i pakënaqur për pozitën që i kishte besuar Partia në ushtri, ai filloi të diskreditojë superiorët e tij, në Komandë, me qëllim që të minonte pozitën e tyre dhe t'u zinte vendin për qëllime të ulëta karrierizmi dhe në rrugë antiparti.

3. — Ka thyer disiplinën dhe hierarkinë ushtarake, disiplinën dhe rregullat organizative të Partisë, është treguar i pakujdesshëm në punë dhe i ka munguar konspiracioni në detyrë.

4. — Në jetën e tij private ka pasur mungesa të mëdha serioziteti që dëmtojnë interesat e Partisë dhe të shtetit.

5. — Ka fshehur gabimet dhe fajet e tij. Me gjithë përpjekjet që ka bërë Komiteti Qendror për ta ndihmuar, ai është përpjekur vazhdimisht të fshehë gabimet dhe fajet e tij të rënda dhe t'i mohojë. Duke mos pasur besim te Partia, ai nuk ka bërë autokritikë.

Ruajtja dhe zhvillimi i mbeturinave mikroborgjeze si megalomania, karrierizmi, ambicia, amorpropi borgjez etj., thyerja e disiplinës, e konspiracionit dhe mosruajtja e sekreteve në Parti dhe në ushtri, thyerja e rregullave organizative të Partisë dhe e hierar-

kisë ushtarake janë të dëmshme për Partinë dhe për ushtrinë. Këto janë të papajtueshme me edukatën komuniste, me vijën e Partisë dhe me rregulloret dhe karakterin popullor të ushtrisë sonë.

Duke marrë parasysh sa u tha më lart, Plenumi i Komitetit Qendror të PPSH

V e n d o s i :

1. — Të përjashtohet nga Komiteti Qendror kandidati i Komitetit Qendror, shoku Nexhip Vinçani, i cili ka dëmtuar udhëheqjen e Komandës, ka thyer hierarkinë, ka dëmtuar Partinë dhe nuk ka bërë autokritikë duke u treguar se është i padenjë dhe i paaftë për të bërë pjesë në radhët e Komitetit Qendror.

2. — Komiteti Qendror porosit veçanërisht aparatit politik të komisarëve dhe të punëtorëve politikë dhe gjithë Partinë në ushtri, të nxjerrin mësim nga ky rezolucion dhe të mbajnë parasysh këto detyra:

a) Të forcohet disiplina në ushtri, të mos lejohen në asnjë rast lëshime dhe të goditen ashpër e drejt të gjithë ata që shkelin disiplinën në ushtri. Partia në ushtri të punojë pareshtur për forcimin e disiplinës së ndërgjegjshme dhe të çelniktë dhe të zhvillojë në ndërgjegjen e çdo ushtaraku ndjenjën e lartë të detyrës ushtarake, të shërbimit ndaj popullit dhe atdheut, të zbatimit me përpikmëri të urdhërave dhe të rregulloreve të ushtrisë, të cilat janë ligj për mbarëvajtjen e Ushtrisë sonë Popullore.

b) Të luftohet kundër çdo shfaqjeje dekonspirimi dhe pakujdesie në ruajtjen e sekreteve ushtarake dhe të punohet pareshtur për vendosjen e konspiracionit të fortë, për forcimin e vigjilencës në radhët e ushtrisë, për ruajtjen e sekreteve ushtarake dhe të materialit ushtarak e shtetëror. Të zbulohen dhe të goditen me forcë dhe menjëherë shkeljet e rregulloreve dhe lëshimet në punë që janë të dëmshme për ushtrinë dhe për Partinë.

c) T'i kushtohet vëmendje e veçantë ngritjes politike dhe ideologjike në ushtri, të rritet roli avangard i anëtarëve të Partisë dhe i anëtarëve të BRPSH në ushtri, të kuptohet mirë zhvillimi i luftës së klasave në vendin tonë, e cila reflektohet dhe në radhët e ushtrisë dhe të luftohen pikëpamjet e mbeturinat mikroborgjeze, morali borgjez dhe çdo shfaqje që është në kundërshtim me edukatën komuniste dhe me moralin proletar.

ç) Të rritet edhe më tepër dashuria për Partinë në ushtri dhe kjo dashuri të pasqyrohet në zbatimin e përpiktë të detyrave të rëndësishme dhe delikate që i ka ngarkuar Partia dhe populli ushtrisë, në forcimin dhe ruajtjen e disiplinës, në bindjen dhe në zbatimin e plotë të urdhërave, në forcimin e vigjilencës dhe të

konspiracionit, në ruajtjen e sekreteve shtetërore dhe ushtarake, në gatishmërinë ushtarake në çdo moment, në mbrojtjen e vijës së Partisë dhe në ruajtjen e pastërtisë së radhëve të saja.

3. — Ky rezolucion të punohet në aktivet e Partisë dhe në të gjitha organizatat bazë dhe të shërbejë për të goditur dhe për të ndrequr gabimet dhe dobësitë në punën e organizatave, për forcimin e kritikës dhe të autokritikës, për një forcim të mëtejshëm të punës së Partisë dhe të ushtrisë dhe për një forcim edhe më të madh të radhëve të tyre.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

*Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

V E N D I M

I PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH PËR THIRRJEN E KONFERENCËS II NACIONALE TË PARTISË

6 mars 1950

Plenumi V i Komitetit Qendror të PPSH në mbledhjen e tij të datës 20-22 shkurt dhe 6 mars 1950, duke u mbështetur në Statutin e Partisë, i cili thotë se të paktën një herë në çdo vit duhet të mblidhen përfaqësuesit e organizatave lokale në një konferencë të Partisë me qëllim që të merren vendime për çështje me rëndësi dhe aktuale të politikës së Partisë, dhe duke marrë parasysh se tani para nesh shtrohen disa probleme të rëndësishme,

V e n d o s i :

1. — Më 10 prill 1950 të thirret Konferenca II Nacionale e Partisë.

2. — Në konferencë të shtrohen këto çështje:

a) Raport «Mbi situatën politike, problemet ekonomike dhe disa çështje të Partisë» nga Sekretari i Përgjithshëm i Partisë, shoku Enver Hoxha.

b) Raport «Mbi çështjet organizative të Partisë».

3. — Në konferencë të marrin pjesë afro 360 delegatë: 243 delegatë me votë deliberative duke zgjedhur për çdo 125 anëtarë partie 1 delegat, dhe 117 delegatë me të drejtë vote konsultative duke zgjedhur mbi 150 kandidatë partie 1 delegat. Sipas Statutit të Partisë delegatët do të zgjidhen me votë të fshehtë në mbledhjet plenare të komiteteve të Partisë të rretheve. Sekretariati i Komitetit Qendror do të lëshojë udhëzime më të hollësishme për zgjedhjen e delegatëve.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

*Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

KONFERENCA II NACIONALE E PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË

Tiranë, 10-14 prill 1950

Prej datës 10 deri më 14 prill 1950 zhvilloi në Tiranë punimet e saj Konferenca II Nacionale e PPSH.

Në konferencë morën pjesë 248 delegatë me të drejtë vote deliberative dhe 121 me të drejtë vote konsultative.

Konferenca dëgjoi, shqyrtoi dhe aprovoi unanimisht raportin e Sekretarit të Përgjithshëm të Partisë, shokut Enver Hoxha, «Mbi situatën politike, problemet ekonomike dhe disa çështje të Partisë» si dhe raportin «Mbi çështjet organizative të Partisë».

Konferenca analizoi veprimtarinë e Partisë që nga Kongresi I i PKSH dhe deri në ditët e hapjes së saj, konstatoi sukseset që ishin arritur nga Partia pas kthesës historike që bëri Kongresi I dhe goditi rëndë të metat dhe gabimet që ishin vërtetuar në Parti dhe në organet e shtetit. Konferenca aprovoi vendimet e Plenumit V të KQ të PPSH të Shkurtit 1950, i cili zbuloi dhe dënoi rëndë veprimtarinë armiqësore të grupit antiparti, të Abedin Shehut, Niazi Islamit etj.

Konferenca mori vendime të rëndësishme lidhur me situatën e brendshme dhe të jashtme, me forcimin organizativ të Partisë dhe me detyrat ekonomike për realizimin e planit të shtetit të vitit 1950.

Për të plotësuar vendet vakante në Komitetin Qendror, konferenca zgjodhi dy anëtarë nga radhët e kandidatëve të Komitetit Qendror dhe katër kandidatë të rinj për anëtarë në KQ të PPSH.

REZOLUCION

I KONFERENCËS II NACIONALE TË PPSH «MBI SITUATËN POLITIKE, PROBLEMET EKONOMIKE DHE ÇËSHTJET ORGANIZATIVE TË PARTISË»

14 prill 1950

Prej datës 10 deri më 14 prill 1950, zhvilloi në Tiranë punimet e saj Konferenca II Nacionale e PPSH.

Në konferencë morën pjesë 248 delegatë me të drejtë vote deliberative dhe 121 me të drejtë vote konsultative, të zgjedhur në bazë të dispozitave të Statutit të Partisë së Punës të Shqipërisë.

Konferenca dëgjoi, shqyrtoi dhe aprovoi unanimisht raportin e Sekretarit të Përgjithshëm të Partisë, shokut Enver Hoxha, «Mbi situatën politike, problemet ekonomike dhe disa çështje të Partisë» si dhe raportin «Mbi çështjet organizative të Partisë».

Të gjitha punimet e konferencës u zhvilluan në frymën e kritikës dhe të autokritikës bolshevike. Konferenca analizoi veprimtarinë e Partisë që nga Kongresi I i Partisë Komuniste Shqiptare e deri sot, sukseset e mëdha që janë arritur nga Partia në realizimin e kthesës së madhe që përcaktoi Plenumi XI e Kongresi I i Partisë nën dritën e letrave të KQ të PK (b) të BS drejtuar KQ të PK Jugosllave si dhe të metat, dobësitë dhe gabimet në punën e Partisë dhe të organeve të shtetit. Konferenca II Nacionale, ashtu sikurse Kongresi I i Partisë, shprehu unitetin e Partisë dhe besimin në Komitetin Qendror me Sekretarin e Përgjithshëm të Partisë, shokun Enver Hoxha në krye, shprehu dashurinë e pakufishme dhe besnikërinë e madhe për Bashkimin Sovjetik, Partinë e madhe Bolshevike dhe mësuesin gjeneral të proletariatit dhe të gjithë njerëzimit përparimtar, shokun Stalin.

Gjatë analizës që bëri veprimtarisë së Partisë, sukseseve dhe të metave në punën e saj që nga Kongresi I i PKSH e deri sot, konferenca arriti në këto konkluzione:

I

MBI GJENDJEN POLITIKE NDËRKOMBËTARE DHE TË BRENDSHME

1. — Qysh prej Kongresit I të Partisë dhe deri sot gjendja politike ndërkombëtare ka vajtur gjithnjë duke u ashpëruar. Imperialistët amerikanë, anglezë dhe shërbëtorët e tyre, pasi shkelën paturpësisht marrëveshjet e Jaltës¹ dhe të Potsdamit², mbi të cilat duhej të ndërtohej paqja e vërtetë në Evropë dhe në botë, kanë treguar edhe më haptazi politikën e tyre agresive dhe grabitqare, kanë bërë për vete politikën e fashizmit hitlerian, politikën e çmendur antisovjetike dhe të sundimit të botës.

Imperialistët amerikanë dhe anglezë për të shpëtuar nga kriza, që çdo ditë i shpie drejt shkatërrimit dhe për të realizuar planet e tyre grabitqare, kanë shtuar përpjekjet për përgatitjen e një lufte të re, janë vënë në një garë armatimesh dhe përgatitjesh ushtarake, kanë lidhur marrëveshje dhe aleanca agresive.

Ata po ringjallin klikat naziste gjermane dhe po bëjnë ç'është e mundur që ta kthejnë Gjermaninë Perëndimore në bazë agresioni dhe arsenal lufte kundër Bashkimit Sovjetik dhe demokracive popullore. Në këtë mënyrë ata po veprojnë edhe në Japoni ku po mëkëmbin militaristët japonezë dhe po i organizojnë për agresion kundër Bashkimit Sovjetik dhe Republikës Popullore të Kinës. Imperialistët amerikanë me anë të veglave të tyre po bëjnë ç'është e mundur që të shuajnë luftën e popujve liridashës të Indonezisë, të Vietnamit dhe të Greqisë dhe të shumë vendeve të tjera të va-

1 Konferenca e Jaltës zhvilloi punimet e saj nga 4—11 shkurt 1945 në Jaltë të Krimesë (BRSS) me pjesëmarrjen e kryetarëve të qeverive të tri shteteve aleate, të Bashkimit Sovjetik, të SHBA-së e të Britanisë së Madhe si dhe të ministrave të punëve të jashtme dhe të shefave të shtatmadhorive të këtyre vendeve. Pjesëmarrësit e konferencës ranë dakord dhe përcaktuan planet për mbarimin e Luftës së dytë botërore dhe për shkatërrimin e Gjermanisë hitleriane dhe përcaktuan në të njëjtën kohë parimet themelore të politikës së përbashkët të aleatëve lidhur me sigurimin e një paqeje të qëndrueshme dhe me organizimin e një sistemi të sigurimit ndërkombëtar.

2 Konferenca e Potsdamit zhvilloi punimet e saj nga 17 korrik deri më 2 gusht 1945 në qytetin e Potsdamit të Gjermanisë me pjesëmarrjen e kryetarëve të qeverive të Bashkimit Sovjetik, të SHBA-së dhe të Britanisë së Madhe. Konferenca vendosi të merreshin një varg masash për çmilitarizimin, denazifikimin dhe ndërtimin mbi baza demokratike të Gjermanisë së mundur në Luftën e dytë botërore 1939 — 1945. Por këto masa nuk janë zbatuar për shkak të shkeljes së vendimeve nga ana e SHBA-së dhe e fuqive të tjera perëndimore; gjithashtu edhe për shkak të tradhëtisë së revizionistëve sovjetikë.

rura dhe koloniale, duke synuar njëkohësisht që t'i bëjnë këto vende baza luftarake. Nga ana tjetër ata po zhvillojnë pareshtur një veprimtari armiqësore kundër Bashkimit Sovjetik dhe vendeve të demokracisë popullore duke organizuar akte spiunazhi, diversioni dhe sabotimi si dhe një fushatë të vazhdueshme shpifjesh dhe gënjeshtresh. Një rol kryesor në këtë drejtim imperializmi amerikan ja ka ngarkuar klikës së Titos.

Në këtë mënyrë imperialistët amerikanë, anglezë dhe shërbëtorët e tyre janë bërë sot, më tepër se kurrë, armiq të betuar të mbarë njerëzimit, kërcënuesit e rrezikshëm të paqes dhe të sigurimit ndërkombëtar, nxitësit dhe organizatorët e një lufte të re.

2. — Kundër politikës grabitqare dhe luftëdashëse të imperializmit amerikan, qëndron shteti i fuqishëm socialist, Bashkimi Sovjetik. Bashkimi Sovjetik ka luftuar dhe lufton me vendosmëri kundër tentativave të imperialistëve amerikanë dhe anglezë për shpërthimin e një lufte të re, ka demaskuar synimet e tyre grabitqare dhe ndërhyrjet e tyre në çështjet e brendshme të popujve dhe ka mbrojtur me vendosmëri të drejtat dhe lirinë e tyre. Bashkimi Sovjetik me politikën staliniane bëri të mundshme krijimin e lëvizjes së përbotshme të partizanëve të paqes dhe e udhëheq këtë lëvizje për sigurimin e paqes, të demokracisë dhe të socializmit kundër nxitësve të një lufte të re. Bashkimi Sovjetik ka bërë gjithmonë të dështojnë manevrat dhe intrigat e imperialistëve amerikanë dhe të shërbëtorëve të tyre. Bashkimi Sovjetik që është koka e kampit demokratik e antiimperialist, ka zhvilluar më tej ekonominë e kulturën socialiste dhe ka shtuar fuqinë mbrojtëse të atdheut sovjetik. Fitoret e njëpasnjëshme në ndërtimin e komunizmit kanë treguar edhe më tepër epërsinë e sistemit sovjetik mbi atë kapitalist. Ndërsa gjatë vitit 1949 në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe në vendet e marshallizuara¹ prodhimi ka shkuar gjithmonë duke u ulur, në Bashkimin Sovjetik prodhimi industrial dhe bujqësor ka arritur dhe tejkaluar nivelin e paraluftës.

Zgjedhjet e fundit për Sovjetin Suprem treguan edhe një herë forcën e pathyeshme të demokracisë së vërtetë sovjetike, unitetin e

¹ Është fjala për vendet që ju nënshtruan planit Marshall, i cili u parastrua në vitin 1947 nga Sekretari i Departamentit të Shtetit të SHBA-së Xhorxh Marshall (emrin e të cilit ai mban) dhe në vitin 1948 u aprovua nga Kongresi i SHBA-së. Ky plan përfaqësonte në vetëvete një pjesë përbërëse të politikës agresive të imperializmit amerikan me qëllim që të vendoste hegjemoninë botërore të SHBA-së dhe të përgatiste luftën kundër Bashkimit Sovjetik dhe vendeve të demokracisë popullore. Me anën e këtij plani imperialistët amerikanë kishin për qëllim t'i kthenin vendet që pranonin këtë plan në baza strategjike luftarake të agresionit amerikan. Planit Marshall përgatiti terrenin për krijimin e blokut agresiv të Atlantikut Verior.

çelniktë të popujve sovjetikë dhe besnikërinë e tyre të pakufishme ndaj Partisë Bolshevike dhe Stalinit të madh.

Në demokracitë popullore masat punonjëse kanë përforcuar pozitën e tyre në pushtet, është realizuar uniteti i klasës punëtore dhe janë arritur suksese të mëdha në luftën për ndërtimin e themeleve të socializmit. Populli i madh kinez u çlirua nga robëria shekullore e feudalëve dhe e imperialistëve të huaj, u krijua Republika Popullore e Kinës, e cila u bë një mburojë e fuqishme për paqen në Azi dhe në botë. Nënshkrimi i aleancës sovjetiko-kineze ka qenë një fitore e madhe historike e politikës staliniane të Bashkimit Sovjetik dhe një faktor me rëndësi për mbrojtjen e paqes në botë. Krijimi i Republikës Demokratike Gjermane shënoi një kthesë në historinë e Evropës dhe është bërë një faktor me rëndësi për dështimin e planeve të imperialistëve. Fitoret e Republikës Demokratike të Vietnamit, të RDP të Koresë dhe forcimi i lëvizjes dhe i luftës së popujve të shtypur e kolonialë kanë qenë gjithashtu fitore të rëndësishme të kampit socialist dhe disfata të pariparueshme të kampit imperialist.

Sot kampi i paqes, i demokracisë dhe i socializmit me Bashkimin Sovjetik në krye numëron një forcë të madhe prej më se 800 milion njerëz.

3. — Mbrojtja e paqes kundër nxitësve të luftës së re është bërë sot kauza e të gjithë popujve. Qindra miliona njerëz të thjeshtë, që janë mobilizuar në lëvizjen e madhe popullore të partizanëve të paqes, luftojnë në të katër anët e botës, për të evituar rrezikun e një lufte të re që përgatitin imperialistët amerikanë dhe shërbëtorët e tyre. Lëvizja e partizanëve të paqes, që përfaqëson vullnetin dhe forcën e bashkuar të njerëzimit për mbrojtjen e paqes, po merr dita-ditës përpjesëtime më të mëdha dhe kjo po trondit dhe po prish planet e nxitësve të luftës. Por kjo nuk do të thotë se rreziku i luftës është pakësuar. Nënvlëftësimi i rrezikut të luftës dhe dobësimi i vigjilencës dhe i aksioneve për të mbrojtur paqen, do të ishin një gabim i madh që do t'i sillte dëm kauzës së sigurimit të paqes.

Vendimet e Kongresit Botëror të Partizanëve të Paqes¹ u pri-

¹ Kongresi i parë Botëror i Partizanëve të Paqes duhej të mbledhej në Paris, por qeveria e Francës u refuzoi vizat përfaqësuesve të Kinës, Polonisë, Bullgarisë, Rumanisë, Shqipërisë dhe të disa vendeve të tjera dhe në mënyrë arbitrare kufizoi numrin e vizave për përfaqësuesit e BRSS. Si rezultat i kësaj Kongresi i parë Botëror i Partizanëve të Paqes i zhvilloi punimet e tij në të njëjtën kohë edhe në Paris edhe në Pragë nga data 20-25 prill 1949. Në të morën pjesë 2 065 delegatë nga 72 vende që përfaqësonin 600 milion luftëtarë të organizuar të paqes. Kongresi u zhvillua nën parullën «Mbrojtja e paqes është çështja e gjithë popujve të botës». Ai diskutoi çështjet mbi demaskimin e garës së armatimeve, mbi rolin e Organizatës së Kom-

tën me entuziazëm nga masat punonjëse të vendit tonë dhe u bënë një program lufte për mbrojtjen e paqes. Duke shprehur vullnetin dhe interesat e mbarë popullit tonë, Kuvendi Popullor i Republikës Popullore të Shqipërisë aprovoi solemnisht thirrjen e Komitetit të Përhershëm të Partizanëve të Paqes. Aprovimi i kësaj thirrjeje dhe Kongresi Kombëtar i Partizanëve të Paqes¹ kanë qenë manifestime të fuqishme të vullnetit të të gjithë punonjësve të vendit tonë për mbrojtjen e paqes kundër nxitësve të luftës.

Populli ynë është i bindur se lufta nuk është e paevitueshme dhe se paqja mund t'u imponohet nxitësve të një lufte të re.

4. — Prej Kongresit I të Partisë e deri sot imperializmi dhe shërbëtorët e tij përreth kufive tanë kanë bërë sulme të reja kundër Republikës sonë Popullore. Këto sulme kanë qenë të organizuara në bazë të një plani të koordinuar dhe të udhëhequra prej imperialistëve amerikano-anglezë. Për realizimin e këtij plani janë vënë në lëvizje titistët e Beogradit, monarko-fashistët grekë dhe neofashistët italianë.

Klika e Titos ka treguar haptas se është agjentura e rrezikshme e imperializmit në Ballkan. Beogradi është bërë çerdhe e spiunazhit amerikan, ku kurdisen plane të reja kriminale kundër kampit të socializmit dhe të paqes.

Imperializmi amerikan dhe anglez i ka besuar klikës së Titos rolin kryesor për të dëmtuar Republikën Popullore të Shqipërisë. Gjyqi kundër Koçi Xoxes dhe gjyqet e tjera në vendet e demokracisë popullore kanë vërtetuar plotësisht këtë veprimtari armiqësore të klikës Tito-Rankoviç.

Veprimtaria armiqësore e shërbëtorëve të imperializmit amerikan kundër vendit tonë është përqëndruar në provokacione dhe shantazhe, në një veprimtari spiunazhi e diversioni, në organizimin e kompleteve për përmbysjen e pushtetit popullor dhe sabotimin e ndërtimit ekonomik të vendit.

Në planin e kësaj veprimtarie armiqësore kundër Republikës Popullore të Shqipërisë bën pjesë edhe ngritja e të ashtuquajturit Komitet «Shqipëria e Lirë» i përbërë prej kriminelëve të luftës të arratisur, anëtarë të «Ballit Kombëtar», të «Legalitetit» dhe të qeverisë kuislinge si dhe fushata e tërbuar e shpifjeve dhe e gënjeshtreve kundër vendit tonë.

beve të Bashkuara në mbrojtjen e paqes, mbi demaskimin e propagandës së luftës, mbi respektimin e sovranitetit dhe të pavarësisë së popujve, mbi marrëdhënjet ekonomike midis kombeve, mbi pjesëmarrjen e gruas dhe të rinisë në lëvizjen për paqe dhe mbi bashkimin e forcave të paqes. Manifesti i kongresit u bënte thirrje popujve, që të ishin vigjilentë, aktivë dhe të bashkuar në luftën për paqe kundër nxitësve të luftës së re. Kongresi zgjodhi Komitetin e Përhershëm të përbërë nga përfaqësuesit e 72 vendeve.

¹ Ky kongres i zhvilloi punimet e tij në Tiranë më 5 dhe 6 mars 1950.

NË LIDHJE ME ZHVILLIMIN E GJENDJES POLITIKE NDËRKOMBËTARE DHE TË BRENDSHME KONFERENCA II NACIONALE E PPSH SHTRON KËTO DETYRA:

1. — Të forcohet lufta e popullit tonë për mbrojtjen e paqes, se lufta për paqen është lufta për mbrojtjen e pavarësisë, të lirisë dhe të fitoreve të demokracisë popullore. Organizatat e Partisë dhe ato të masave të shtojnë aktivitetin për të zgjeruar dhe për të forcur organizativisht në vendin tonë lëvizjen për mbrojtjen e paqes dhe të tërhiqen në këtë lëvizje të gjithë njerëzit e ndershëm që duan të punojnë dhe të luftojnë për paqen. Të forcohet çdo ditë solidariteti me luftën e partizanëve të paqes në botë dhe të organizohet një fushatë e madhe dhe e vazhdueshme për të mbështetur vendimet dhe thirrjen e Kongresit Botëror të Partizanëve të Paqes për ndalimin e bombës atomike, si armë kriminale e shfarosjes së njerëzve në masë.

Të demaskohen pareshtur dhe me forcën më të madhe planet agresive e grabitqare të imperialistëve amerikanë dhe anglezë si dhe rrjedhimet e sistemit imperialist.

Të demaskohet titizmi si agjentura më e rrezikshme e imperializmit amerikan kundër Bashkimit Sovjetik dhe demokracive popullore dhe veçanërisht kundër vendit tonë.

2. — Të forcohet edhe më tepër dashuria dhe besnikëria ndaj Bashkimit Sovjetik, Partisë Bolshevike dhe shokut të madh Stalin, të çelnikoset miqësia e përjetshme midis popullit tonë e popullit të lavdishëm sovjetik. Partia jonë duhet të zbulojë dhe të luftojë me ashpërsinë më të madhe çdo shfaqje antisovjetike. Të organizohet puna nga ana e Partisë dhe e institucioneve shtetërore e shoqërore e sidomos e shoqërisë për Lidhje kulturele e miqësore me Bashkimin Sovjetik, për përvetësimin dhe aplikimin sa më të gjerë të eksperiencës sovjetike nga punonjësit e vendit tonë në të gjithë sektorët e jetës ekonomike, kulturele e shkencore. Të përhapet sa më shumë literatura sovjetike dhe të nxirren më shumë përfitime nga ajo.

Të punohet më shumë për forcimin e miqësisë së popullit tonë me popujt e demokracive popullore motra. Të zhvillohet një punë e gjerë propagandistike me qëllim që masat punonjëse të vendit tonë të njohin sa më mirë jetën, punën dhe përparimin e popujve vëllezër të demokracive popullore dhe ndihmën që këto vende i japin vendit tonë.

Partia jonë gjithashtu të mbajë gjithmonë të gjallë dhe të forcojë në masat e gjera të popullit tonë ndjenjën e solidaritetit ndërkombëtar me të gjitha forcat demokratike përparimtare të botës, me popujt e shtypur të kolonive që nën udhëheqjen e partive komuniste dhe punëtoresh luftojnë për paqen, lirinë dhe pavarësinë

kombëtare. Masat e popullit tonë duhet të vihen gjerësisht në korrant të luftës që bëjnë këta popuj kundër imperializmit.

3. — Të përmirësohet dhe të forcohet vazhdimisht gjendja e brendshme politike e vendit tonë në një luftë të ashpër kundër armiqve të klasës dhe të popullit tonë. Të organizohet një punë e gjerë politike e shëndoshë dhe e pareshtur për forcimin e mëtejshëm të patriotizmit në masat e gjera të popullit tonë, për shtimin gjithnjë e më të madh të dashurisë e të besnikërisë së tyre ndaj Partisë së Punës të Shqipërisë.

Partia jonë duhet të luftojë për konsolidimin e mëtejshëm të bashkimit moral e politik të popullit tonë në radhët e Frontit Demokratik të udhëhequr nga Partia jonë. Organizatat e Partisë duhet të punojnë vazhdimisht për grumbullimin dhe aktivizimin në radhët e Frontit të të gjithë njerëzve që duan atdheun, popullin dhe Partinë tonë. Fushata e zgjedhjeve të Kuvendit Popullor të bëhet manifestimi më i fuqishëm i këtij bashkimi moral e politik të popullit tonë në luftë të ashpër kundër armiqve të jashtëm dhe të brendshëm të Republikës Popullore të Shqipërisë.

Partia jonë duhet të punojë edhe më tepër për konsolidimin e pushtetit popullor. Të punojë për forcimin e Ushtrisë Popullore, të Sigurimit të Shtetit, të forcave të kufirit dhe të policisë, armë me të cilat populli ynë mbron vazhdimisht atdheun e tij dhe Republikën Popullore. Organizatat e Partisë duhet të punojnë më shumë për forcimin e mëtejshëm të lidhjeve të masave me pushtetin dhe me Ushtrinë Popullore, për mobilizimin e tyre në zgjidhjen e problemeve të pushtetit dhe veçanërisht në kontrollin e veprimtarisë së tij.

Të forcohet vigjilenca revolucionare kundër të gjithë elementëve spiunë, diversantë dhe sabotatorë; të zbulohen dhe të goditen këta me forcë dhe pa mëshirë.

II

MBI ÇËSHTJET EKONOMIKE

1. — Hovi revolucionar dhe puna e palodhur e Partisë dhe e popullit tonë si dhe ndihma e madhe e Bashkimit Sovjetik në radhë të parë dhe e demokracive popullore, kanë bërë të arrihen suksese në luftën për realizimin e planit, në përmirësimin e mirëqenjes së popullit dhe të kapërcehen vështirësitë dhe pengesat e mëdha.

Nga puna armiqësore e klikës trockiste të Titos në Shqipëri dhe e agjentëve të saj Koçi Xoxe me shokë, nga puna antiparti e

grupit të Abedin Shehut dhe nga disa të meta në punën organizative të Partisë dhe të organeve të shtetit, nuk ka mundur të realizohet plani i shtetit në disa sektorë të ekonomisë. Këto të meta sidomos në industri, në miniera e në bujqësi kanë shkaktuar një ulje si tërësi në planin tonë dyvjeçar dhe veç sektorit të prodhimit kanë dëmtuar edhe atë të eksportimeve, duke shkaktuar mosrealizimin e angazhimeve të shtetit tonë. Të metat dhe dobësitë në punë kanë rrjedhur nga mungesa e një kontrolli rigoroz, nga një burokraci e theksuar dhe mungesë operativiteti nga ana e organeve të shtetit.

2. — Në sektorin e industrisë dhe të minierave në saje të mobilizimit të punëtorëve tanë me komunistët në krye, ne kemi pasur rezultate të kënaqshme sidomos në krom e në bitumin e Selenicës ku plani është tejkaluar. Po ashtu kemi pasur rezultate të kënaqshme dhe në industrinë e lehtë. Kurse në industrinë vajguore dhe sidomos në Patos realizimi i planit gjatë vitit 1949 nuk ka qenë aspak i kënaqshëm. Pas vendimeve të përbashkëta të Byrosë Politike të Komitetit Qendror dhe të qeverisë, në lidhje me realizimin e planit në gjashtëmujorin e parë të vitit 1949, në të gjithë sektorët e industrisë e të minierave, me përjashtim të prodhimeve vajguore, realizimi i planit ka shënuar ngritje të kënaqshme, ndërsa nafta qëndron në vend. Kjo për arsye të punës armiqësore të trockistëve jugosllavë në të kaluarën, të punës armiqësore të grupit antiparti të kryesuar nga Abedin Shehu me shokë si dhe nga shkak i një burokracie të theksuar, i një fryme lëshimesh e demobilizimi, çorganizimi dhe mungese të kontrollit të shëndoshë në vetë udhëheqjen e Ministrisë së Industrisë e në atë të Kombinatit vajguror Kuçovë-Patos. Realizimi i planit në tremujorin e parë të vitit 1950 paraqitej i kënaqshëm; gati në të gjithë sektorët ekonomikë është realizuar e në shumë ndërmarrje është tejkaluar, përveç Kombinatit vajguror Kuçovë-Patos ku me përpjekjet dhe mobilizimin e punëtorëve të kombinatit ka disa përmirësime, por plani nuk është realizuar.

3. — Në sektorin e bujqësisë, në saje të përpjekjeve të mëdha nga ana e Partisë dhe e fshatarësisë punonjëse, janë korrur një sërë suksesesh në realizimin e planit të mbjelljeve, të grumbullimit në fermat e në SMT-të si dhe në kooperativat bujqësore. Por nga moszbatimi sa duhet i vendimeve të Komitetit Qendror kanë mbetur pa u kryer një sërë detyrash që i ngarkonte bujqësisë plani dyvjeçar i shtetit. Nuk është ndjekur me seriozitetin e duhur çështja e ndarjes dhe e klasifikimit të tokave. Është nënvlehtësuar përdorimi i eksperiencës së kaluar për një përmirësim të kadastrës, ka akoma tokë të pashpërndarë dhe gjendja e evidencave statistikore në bujqësi është shumë e dobët. Nuk i është vënë kujdesi i duhur problemit të rendimenteve dhe përcaktimit ekzakt të koeficienteve për çdo

kulturë; nuk i është dhënë rëndësia e duhur çështjes së rajonizimit të tokave për planifikimin sa më të mirë të kulturave në përshatje me kushtet klimaterike. Nga mosorganizimi mirë i punës e për arsye të thatësirës plani në bimët industriale është realizuar në një përqindje shumë të ulët.

Në sektorin shtetëror të bujqësisë, në fermat e sidomos në ndërmarrjet blegtorale, ka pasur mungesa të ndieshme organizimi që kanë shkaktuar mosrealizimin e planit në disa kultura dhe humbje financiare. Në SMT-të, me gjithë përmirësimet në krahasim me të kaluarën, ka çaluar puna politike dhe kulturele si dhe ruajtja e shfrytëzimi i maqinerisë. Në kooperativat bujqësore ka pasur përmirësime, por ka akoma mungesa të ndieshme në organizimin e punës.

4. — Në sektorin e grumbullimeve janë bërë ndryshime rrënjësore si nga ana e përmbajtjes, ashtu dhe nga ana organizative. Sistemi i ri i grumbullimit dhe i furnizimit ka dhënë rezultate të kënaqshme në rritjen e fondit të grumbullimeve dhe në sigurimin e burimeve të reja prodhimi, ka përmirësuar mjaft gjendjen e tregut në qytete dhe ka siguruar një furnizim më të mirë të masave punonjëse; ka forcuar marrëdhënjet qytet-fshat dhe konkretisht rolin e madh të kooperativave të shitblerjes në zhvillimin e tregëtisë kolektive në fshat.

5. — Në ndërtimet ka çaluar organizimi, racionalizimi i mirë i forcave dhe aplikimi i normave në punë. Në sektorin e ndërtimeve janë arritur edhe suksese të mira si në Kombinatin e tekstileve «Stalin», në atë të sheqerit e në Hidrocentralin e Selitës. Në komunikacion, në transportin hekurudhor, automobilistik dhe detar kemi pasur dëme dhe sabotime nga trockistët jugosllavë dhe nga sabotatorët armiq të Partisë, Niazi Islami me shokë, që për një kohë gjatë vitit 1949 drejtonte këtë sektor. Me masat që mori Partia më vonë gjendja e transportit është përmirësuar.

6. — Emulacioni socialist në punë ka shkuar duke u përmirësuar dhe veçanërisht në gjashtëmujorin e dytë të vitit 1949 dhe në tremujorin e parë të vitit 1950, por ka akoma shumë të meta në lidhje me cilësinë e punës e të prodhimit, nuk ka shumë përpjekje për uljen e kostos në prodhim dhe për aplikimin e normave të punës në të gjithë sektorët.

7. — Nga mosinteresimi sa duhet i komiteteve ekzekutive dhe i komiteteve të Partisë, si dhe nga pakujdesia e vetë ndërmarrjeve, sidomos në gjashtëmujorin e parë të vitit 1949, plani i fuqisë punëtore nuk është realizuar. Nuk është treguar një kujdes i vazhdueshëm për përmirësimin e konditave materiale të punonjësve në qendrat e punës. Për përgatitjen tekniko-profesionale të punëtorëve nuk është bërë sa duhet dhe ritmi i kësaj përpjekjeje nuk i është përgjegjur plotësisht ritmit të zhvillimit të ekonomisë sonë.

Nuk i është dhënë rëndësia e duhur pjesëmarrjes së gruas në prodhim dhe në kurset tekniko-profesionale.

8. — Pasuria shtetërore dhe kooperativiste në shumë raste është dëmtuar nga mosorganizimi i punës, në radhë të parë nga vetë drejtuesit e dikasterëve, nga mungesa e ndërgjegjes në punë ndaj pasurisë shtetërore dhe kooperativiste, nga mospërcaktimi i përgjegjësisë personale. Këto dëmtime i kanë shkaktuar shtetit dhe sektorit kooperativist humbje të konsiderueshme dhe i kanë lënë mundësi elementit armik të punojë dhe të sabotojë më lirisht.

9. — Kontrolli i shtetit për zbatimin e ligjeve, për mbrojtjen e pasurisë shtetërore dhe kooperativiste, për zbatimin e vendimeve të qeverisë, dhe lufta kundër burokratizmit dhe lëshimeve në punë, nuk kanë qenë në lartësinë e duhur gjatë vitit 1949 dhe sidomos në gjashtëmujorin e parë. Kohët e fundit vërehen përmirësime, por këto janë akoma të pamjaftueshme.

PËR ELIMINIMIN E KËTYRE TË METAVE E DOBËSIVE DHE PËR TË KORRUR SUKSESE MË TË MËDHA NË FORCIMIN E SEKTORIT EKONOMIK, KONFERENCA II NACIONALE E PPSH U NGARKON ORGANIZATAVE TË PARTISË DHE GJITHË ORGANEVE TË PUSHTETIT KËTO DETYRA:

1. — Të tejkalohet plani ekonomik i vitit 1950 në gjithë sektorët dhe të merren masa për mbulimin e deficiteve të vitit 1949 e të bëhen të gjitha përpjekjet që në fund të vitit 1950 të arrihet realizimi i planit dyvjeçar aty ku janë mundësitë. Të ndiqet realizimi i planit me rigorozitetin më të madh nga dikasteret përkatëse, nga Komisioni i Planit të Shtetit, komitetet ekzekutive të rretheve, drejtoritë e ndërmarrjeve dhe nga organet e tjera të ngarkuara me këtë funksion. Të mbahet qëndrim i menjëhershëm atje ku realizimi i planit mbetet prapa dhe ku puna nuk shkon mirë. Të realizohet me çdo kusht dhe para afatit plani i eksportimeve tona dhe të mbuloen deficitet. Për këtë të zhvillohet një luftë sistematike e përditshme kundër burokratizmit dhe javashllëkut në punë dhe të forcohet çdo ditë e më tepër kontrolli i zbatimit të vendimeve të marrura. Të forcohet përgjegjësia personale në punë duke filluar që nga drejtuesit e dikasterëve, të sektorëve të ndryshëm dhe deri te punonjësit më të thjeshtë. Ndiurma e organeve më të larta për organet vartëse të jetë më e madhe dhe më sistematike. Të forcohet vigjilenca revolucionare në punë në çdo sektor dhe të ashpërsohet çdo ditë e më tepër lufta kundër armiqve të Partisë dhe të popullit.

Të zhvillohet dhe të organizohet më mirë emulacioni socialist në të gjithë sektorët e ekonomisë si mjet i domosdoshëm për realizimin e tejkalimit të planit të shtetit.

2. — Të merren të gjitha masat e nevojshme për sigurimin me kohë të fuqisë punëtore. T'i jepet veçanërisht një rëndësi e madhe hedhjes së gruas në punë e në prodhim, jo vetëm në sektorët administrativë, po edhe në ata të industrisë, të tregëtisë e të ndërtimit. Të merren masa të menjëhershme për një trajtim më të mirë të punëtorëve në qendrat e punës. Nga organet furnizuese të tregëtisë dhe nga kooperativat të merren masa për një furnizim më të rregullt të punëtorëve për përmirësimin e gjendjes së tyre materiale. Të punohet më tepër nga ana e ndërmarrjeve dhe e dikastereve për përfeksionimin e punëtorëve në punë dhe të forcohen shkollat dhe kurset profesionale për shtimin dhe kualifikimin e kadrove të nevojshëm për ekonominë tonë.

3. — Në ndërmarrjet shtetërore ekonomike e sidomos në sektorin e industrisë e të minierave të luftohet për një organizim e kontroll më të shëndoshë. Të merren masa për aplikimin sa më të gjerë të normave në punë dhe për përmirësimin e cilësisë. Të bëhet kursimi një çështje nderi dhe të bëhen përpjekje të vazhdueshme për uljen e kostos. Të luftohet për përdorimin sa më racional e më të frutshëm të materialeve e të maqinerisë ekzistuese dhe atyre që na vijnë nga BS e demokracitë popullore. Të merren masa për zhvillimin e mëtejshëm të industrisë lokale dhe të artizanatit dhe udhëheqja e Ministrisë së Industrisë t'i ndihmojë më tepër këta sektorë.

4. — Në bujqësi të zhvillohet lufta për të prodhuar sa më shumë drithëra dhe në radhë të parë grurë; të luftohet për rajonizimin e kulturave duke e drejtuar fshatarin që të mbjellë ato kultura që ka nevojë më tepër ekonomia jonë. Të merren masa për ndjekjen dhe disiplinimin e gjendjes së kadastrës, të rregullohet shpërndarja e tokave disponibël dhe të vihet në vijë shpejt sistemi i evidencave statistikore në bujqësi. T'i jepet një rëndësi e veçantë mbjelljes dhe zhvillimit të kulturave industriale dhe veçanërisht realizimit e tejkallimit të rendimenteve të parashikuara në plan.

Të bëhet kultura e pambukut dhe e panxharit një kulturë nacionale dhe të tregohet kujdes për rritjen dhe zhvillimin e ullirit në vendin tonë. Të përmirësohet puna politike dhe kulturele si dhe disiplina në punonjësit e SMT-së, të tregohet kujdes më i madh për forcimin organizativ të fermave e të ndërmarrjeve blegtorale. Ngritja e kooperativave bujqësore të mos shpejtohet po edhe të mos harrohet. Të tregohet kujdes i veçantë për forcimin e kooperativave bujqësore në mënyrë që këto të bëhen shembull dhe nxitje për ngritjen e kooperativave të reja në zonat tona fushore. Të tregohet kujdes për shpërndarjen e kreditit agrar.

5. — Organizatat e Partisë dhe organet e pushtetit të bëjnë të gjitha përpjekjet që plani i grumbullimit të realizohet e të tejkallohet, duke grumbulluar sa më tepër teprica. Punonjësit e grumbullimi

mit të organizojnë më mirë punën e tyre dhe të ndjekin më me kujdes dhe me sistem zhvillimin e grumbullimeve në fshat. Të organizohet më mirë furnizimi i masave punonjëse të qytetit e të fshatit, të zgjerohet rrjeti i tregëtisë shtetërore e kooperativiste e të përmirësohet puna e organeve të tregëtisë.

6. — Organizatat e Partisë dhe organet e pushtetit të përmirësojnë sa më shumë metodën e kontrollit, të zbatimit të urdhëresave e të vendimeve. Të forcohet operativiteti nga organet e kontrollit të shtetit. Kontrolli duhet të jetë i shpejtë, i vazhdueshëm, rigoroz e të godasë pa mëshirë e me kohë çdo shkelje të ligjeve të pushtetit, të urdhëresave e të vendimeve qeveritare. Të goditet ashpër çdo shpërdorim i pasurisë shtetërore dhe kooperativiste.

III

MBI PARTINË

1. — Konferenca konstaton se në punën organizative të Partisë është realizuar me sukses kthesa që përcaktoi Plenumi XI dhe Kongresi I i Partisë Komuniste Shqiptare.

Masat e rëndësishme që ka marrë Komiteti Qendror i PPSH për të vënë në jetë vijën e Kongresit I kanë sjellë si rezultat likuidimin e punës armiqësore të trockistëve jugosllavë dhe të agjentëve të tyre Koçi Xoxe etj. dhe forcimin politik e organizativ të Partisë sonë. Është vënë në jetë Statuti i Partisë dhe janë respektuar rregullat e brendshme të Partisë, është forcuar puna ideologjike dhe politike e Partisë, janë vendosur parimet e drejta leninist-staliniane në politikën e kuadrit, është forcuar vigjilenca dhe lufta kundër mbeturinave trockiste e elementëve të huaj dhe është riorganizuar në baza të drejta puna në gjithë sektorët.

Mësimet e nxjerra nga letrat e PK (b) të BS drejtuar KQ të PKJ ndihmuan Partinë tonë të zbulojë planet që kishte klika trockiste e Titos dhe agjentët e saj, Koçi Xoxe me shokë për likuidimin e Partisë e kolonizimin e vendit tonë. Plenumi V i KQ të PPSH zbuloi dhe goditi me kohë grupin antiparti të formuar nga Abedin Shehu me shokë, grup që zhvillonte një aktivitet armiqësor dhe antiparti, antipopullor dhe antisovjetik duke thyer të gjitha rregullat organizative, vijën politike dhe ekonomike të Partisë, duke thyer ligjet dhe vendimet e qeverisë dhe duke sabotuar planin ekonomik të shtetit. Vigjilenca e Komitetit Qendror dhe e Partisë zbuloi në kohë dhe goditi edhe veprimtarinë armiqësore e antipar-

ti të Nexhip Vinçanit dhe të Gjin Markut që minonte pozitat e udhëheqjes në ushtri.

2. — Pas Kongresit I janë arritur shumë suksese për forcimin organizativ të Partisë, suksese këto që dëshmojnë se Partia jonë po ecën me vendosmëri në rrugën e fitoreve të reja drejt forcimit dhe bolshevizimit të saj.

Zbatimi i parimeve të Statutit ka shtuar forcat e Partisë, ka forcuar demokracinë e brendshme, disiplinën e ndërgjegjshme e të hekurt, kritikën dhe autokritikën, jetën e brendshme të Partisë. Por megjithkëtë ka raste që anëtarë partie, organizata bazë dhe forume nuk e njohin mirë dhe nuk e respektojnë rigorozisht Statutin e PPSH.

Vihet re se ka akoma formalizëm në jetën e brendshme të Partisë. Nuk marrin pjesë gjallërisht që të gjithë anëtarët e Partisë në diskutimet që zhvillohen dhe nuk goditen me ashpërsinë më të madhe që të gjitha dobësitë, neglizhencat dhe pikëpamjet e shtrembra që shfaqen në organizatën bazë. Nuk zhvillohet një kritikë e shëndoshë nga masat e Partisë kundrejt shokëve me përgjegjësi që gabojnë. Gjithashtu autokritika në Parti akoma paraqitet e dobët.

3. — Përcaktimi i sistemit të edukimit të Partisë dhe vendosja e programeve të reja në të gjitha format e edukimit marksist-leninist, kanë dhënë rezultate të kënaqshme. Por megjithkëtë niveli ideo-politik i masës së Partisë është mjaft i ulët. Akoma shumë komunistë, bile dhe shokë me përgjegjësi, e lënë pasdore çështjen e studimit. Ka në Parti anëtarë dhe kandidatë partie që janë anal-fabetë dhe nuk bëjnë përpjekje për të mësuar. Ka një pakujdesi të theksuar për shpërndarjen dhe për studimin e shtypit.

4. — Puna me kuadrin që nga Kongresi I i PKSH ka pasur mjaft përmirësime. Kuadri është vendosur kolegjisht nga organet kompetente sipas nomenklaturës së aprovuar nga Komiteti Qendror. Por me gjithë përmirësimet që janë bërë në punën me kuadrin akoma ka mjaft të meta e dobësi që pengojnë gjithë punën. Ka pasur shumë lëvizje kuadri dhe jo në vijë vertikale, nuk është ndjekur si duhet kuadri në punë. Nga mungesa e vigjilencës në disa sektorë kanë mundur të depërtojnë elementë jo të mirë, nuk është punuar seriozisht për përgatitjen e kuadrit dhe për të krijuar rezervën e kuadrit.

Në punën e kuadrit ka ekzistuar një frymë sektarizmi. Është menduar për ngritjen dhe lëvizjen vetëm të një numri të kufizuar kuadrosh të ngritur dhe të përgatitur dhe nuk është punuar për të ngritur elementë të rinj nga masa e Partisë, nga radhët e punëtorëve, të rinisë, të gruas e të fshatarësisë punonjëse.

5. — Pas Kongresit I të PKSH janë arritur suksese të dukshme

në forcimin e Bashkimeve Profesionale të Shqipërisë, të Bashkimit të Rinisë së Punës të Shqipërisë, të Bashkimit të Grave të Shqipërisë, të Frontit Demokratik, të këshillave popullore si dhe në forcimin e udhëheqjes së Partisë në organizatat e masave. Nën drejtimin e Partisë, organizatat e masave janë aktivizuar dhe kanë ndihmuar Partinë në realizimin e detyrave politike dhe ekonomike. Forcimi i organizatave të masave ka shërbyer për forcimin e lidhjeve të Partisë me masat.

Por, në punën e Partisë me organizatat e masave, konstatohen akoma të meta të rëndësishme. Organizatat e Partisë shpesh nuk i aktivizojnë si duhet këto organizata, por i zëvendësojnë dhe i eliminojnë, duke humbur në këtë mënyrë rolin e tyre drejtues.

Gjithashtu në punën e Partisë me masat konstatohen raste të një qëndrimi të padrejtë për komunistët, sjellje arbitrare, arrogante, mospërfillje të zërit të masave, s'punohet si duhet për aktivizimin e njerëzve pa parti dhe ka ngurrim për t'i ngritur në vende me përgjegjësi. Sidomos ka sektarizëm për të futur në punë e për të ngritur në përgjegjësi gratë dhe të rejat.

NË LIDHJE ME KËTO KONSTATIME DHE PËR FORCIMIN E MËTEJSHËM TË PARTISË KONFERENCA II NACIONALE E PARTISË SHTRON KËTO DETYRA:

1. — Një nga detyrat më të rëndësishme që i shtrohet Partisë për të ardhshmen është njohja dhe respektimi me rigorozitet i Statutit të PPSH. Të luftojmë më shumë që rregullat e Statutit të njihen thellë e të respektohen nga të gjithë anëtarët e kandidatët dhe nga vetë forumet e Partisë.

Të forcohet jeta e brendshme e Partisë, kombativiteti e hovi revolucionar, centralizmi demokratik, disiplina e ndërgjegjshme dhe e hekurt, demokracia e brendshme, vigjilenca revolucionare, konspiracioni. Të forcohet kritika dhe autokritika dhe të çmohen këto si i vetmi ligj i zhvillimit të Partisë, pa të cilat rrezikohen ekzistenca e Partisë dhe ndërtimi i socializmit në vendin tonë. Të zhvillohet në shkallë të gjerë inisiativa e komunistëve dhe pjesëmarrja e gjerë e tyre në diskutimin e çështjeve të Partisë. Kjo të shërbejë për të shtuar aktivitetin e komunistëve në lidhje me kryerjen e detyrave që u ngarkon Partia dhe për të luftuar me ashpërsinë më të madhe të gjithë armiqtë e Partisë dhe të gjitha pikëpamjet e huaja e shfaqjet armiqësore që vijnë në Parti nga presioni i borgjezisë.

Të luftohet për të forcuar përbërjen e Partisë duke zbatuar vendimet e Komitetit Qendror për pranimet në Parti dhe duke punuar për edukimin e komunistëve të rinj. Vërtetimi dhe ndërrimi i dokumentave të Partisë të konsiderohet si një aksion shumë i rëndësishëm për forcimin e Partisë dhe për pastrimin e radhëve të saja.

2. — Të forcohet dhe të përmirësohet puna për edukimin marksist-leninist dhe për ngritjen politike dhe ideologjike të masës së Partisë. Të forcohet ndihma dhe kontrolli në Parti për zbatimin e vendimeve që ka marrë Komiteti Qendror për këtë sektor dhe të ngrihet puna e edukimit ideologjik të Partisë në një nivel më të lartë. Të përmirësohen programet, lënda, tekstet e leksionet e ndryshme dhe t'i kushtohet një kujdes i veçantë përgatitjes së propagandistëve. T'i kushtohet më shumë kujdes ngritjes ideo-politike të masave, luftës kundër analfabetizmit. Të tregohet më shumë kujdes për problemet e arësimit e të kulturës.

3. — Të zhvillohet një punë më operative dhe më shkencore në lidhje me lëvizjen, avancimin dhe edukimin e kuadrove. Të luftohet sektarizmi në këtë drejtim dhe të ngrihen me guxim kuadrot e rinj, besnikë të Partisë. Çështja e kuadrit të bëhet një çështje e gjithë Partisë.

4. — Të punohet sistematikisht për forcimin e lidhjeve të Partisë me masat, të forcohet udhëheqja e Partisë në organizatat e masave, të aktivizohen dhe të mobilizohen drejt këto organizata për problemet e Partisë e të shtetit.

Partia të kujdeset veçanërisht për aktivizimin e Frontit Demokratik dhe për forcimin e këshillave popullore.

5. — Të përmirësohet më shumë metoda e punës dhe udhëheqja kolegjiale në Parti; të luftohet burokratizmi, të forcohet kontrolli mbi organizatat lokale dhe lidhjet me bazën; të aktivizohen sa më shumë që të gjitha organizmat dhe aparatet e Partisë.

6. — Të mobilizohet gjithnjë e më shumë Partia për problemet ekonomike dhe shtetërore. Në këtë drejtim të kihet kujdes që Partia të mos zëvendësojë organet ekonomike dhe shtetërore, por t'i drejtojë dhe t'i kontrollojë ato.

Të forcohet akoma më shumë lidhja e punës politike me çështjet ekonomike dhe në asnjë mënyrë të mos ndodhë që, për shkak të punëve të vogla e praktike, të lihet mënjanë puna politike sqaruese me masat.

7. — Të forcohet vigjilenca revolucionare e gjithë anëtarëve të Partisë për të ruajtur pastërtinë e vijës dhe të radhëve të Partisë nga të gjitha influencat e ideologjisë borgjeze si edhe

nga elementët armiq, që mundohen ta godasin Partinë nga brenda. Të tregohet kujdes në mënyrë të veçantë për ta ruajtur Partinë nga rreziku titist, që sot paraqitet agjenturë e imperializmit.

Ky rezolucion duhet të punohet në të gjitha organizatat e Partisë.

Botohet sipas broshurës:
«Konferenca II Nacionale e
PPSH», Tiranë, 1950

Botuar për herë të parë në
gazetën «Zëri i Popullit»,
Nr. 98 (487), 23 prill 1950

PLENUMI VI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Tiranë, 22 prill 1950

V E N D I M

I PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH MBI APROVIMIN E VENDIMEVE TË KONFERENCËS II NACIONALE

22 prill 1950

Plenumi VI i Komitetit Qendror të PPSH, i mbledhur në Tiranë më 22 prill 1950 për të shqyrtuar vendimet që ka marrë Konferenca II Nacionale e Partisë së Punës të Shqipërisë,

V e n d o s i :

Të aprovojë plotësisht vendimet e kësaj konference.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

*Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

V E N D I M

I BYROSË POLITIKE TË KQ TË PPSH PËR PUNËN ME GRUAN

10 gusht 1950

Byroja Politike e Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, pasi shqyrtoi punën e Partisë me masat e grave dhe punën e Bashkimit të Grave të Shqipërisë, konstatoi:

1. — Si rezultat i vetë zhvillimit të vendit tonë dhe nga puna që ka bërë organizata e Bashkimit të Grave të Shqipërisë, nën kujdesin e afërt të Partisë, në gjendjen e masave të grave është bërë një ndryshim rrënjësor në krahasim me të kaluarën.

E kaluara ka qenë e zezë për gruan shqiptare. Ajo s'kishte asnjë të drejtë të merrte pjesë në jetën politike dhe shoqërore të vendit. Ajo konsiderohej dhe përdorej si një qenje e ulët nga shoqëria feudoborgjeze dhe nga regjimet shtypëse.

Vetëm me krijimin e Partisë Komuniste Shqiptare problemi i gruas u shtrua me tërë seriozitetin e vet. Partia Komuniste Shqiptare duke pasur parasysh se

«Nuk është e mundur të bëhet revolucioni socialist, po nuk mori pjesë në një masë të konsiderueshme shumica dërmuese e grave punonjëse»¹,

që me themelimin e saj u bëri thirrje masave të grave që të bashkonin forcat e tyre me ato të të gjithë popullit në luftën e çlirimit për vendosjen e pushtetit popullor, pse vetëm kështu ato do të fitonin dhe të drejtat e tyre politike, shoqërore dhe ekonomike. Masat e grave në vendin tonë ju përgjegjën gjerësisht thirrjes së Partisë. Ato dhanë kontributin e tyre shumë të çmuar në revolucionin tonë popullor. Dhe revolucioni popullor, pushteti popullor, të udhëhequr nga Partia u dhanë atyre të drejtë të marrin pjesë

¹ V. I. Lenin. Veprat, vëll. 28, f. 194.

aktivisht në jetën shoqërore, politike dhe ekonomike të vendit. Gruaja në Republikën tonë Popullore gëzon të drejta të barabarta me burrin.

2. — Pas çlirimit nën udhëheqjen e Partisë, janë arritur suksese të rëndësishme për futjen e gruas në prodhim dhe për aktivizimin e saj në gjithë jetën e vendit. Me punën e organizatës së Bashkimit të Grave të Shqipërisë dhe në saje të ligjeve dhe masave të marrura nga pushteti, gruaja në Republikën tonë është bërë një luftëtare aktive për ndërtimin e bazave të socializmit.

3. — Organizata e Bashkimit të Grave të Shqipërisë, e udhëhequr nga Partia, ka zhvilluar një punë të gjerë me masat e grave për edukimin e tyre politik. Ajo ka punuar mjaft mirë për mobilizimin e masave të grave për mbrojtjen e paqes, për zbatimin e programit të Federatës Demokratike Ndërkombëtare të Grave dhe për forcimin e solidaritetit me gratë e Bashkimit Sovjetik e të demokracive popullore e me të gjitha gratë përparimtare të botës. Bashkimi i Grave të Shqipërisë ka punuar aktivisht për forcimin e miqësisë dhe të dashurisë për Bashkimin Sovjetik dhe shokun Stalin dhe ka përfituar nga eksperiencia e grave të lavdishme të Bashkimit Sovjetik.

Gratë e vendit tonë janë mobilizuar për të luftuar armiqtë e për të mbrojtur atdheun.

4. — Nën kujdesin e Partisë, nga puna që ka zhvilluar Bashkimi i Grave të Shqipërisë dhe nga masat e marrura prej pushtetit popullor, janë arritur suksese dhe në punën e edukimit të nënave për rritjen e fëmijëve dhe për problemet sociale të gruas.

Por këto suksese do të ishin akoma më të mëdha po të mos ishin influenca trockiste e klikës së Titos dhe puna armiqtësore e Koçi Xoxes me shokë, të cilët u përpoqën të errësonin rolin udhëheqës të Partisë në Bashkimin e Grave të Shqipërisë dhe nënvleftësuan rëndësinë e kësaj organizate.

Byroja Politike i konsideron këto suksese të rëndësishme, por duke pasur parasysh mundësitë që janë krijuar në vendin tonë për një aktivitet shumë më të gjerë të grave konstaton dhe këto të meta në punën e Partisë me gratë dhe në Bashkimin e Grave të Shqipërisë.

1. — Akoma nuk është kuptuar sa duhet nga organizatat e Partisë dhe nga organizatat e masave rëndësia e punës me gratë dhe ka shfaqje indiferentizmi, nënvleftësimi e sektarizmi. Bashkimi i Grave të Shqipërisë i ka parë problemet e gruas ngushtë si problemet e organizatës dhe nuk ka ditur të ngrejë para organizatave të Partisë, organeve të pushtetit e të organizatave të masave problemet e gruas dhe të sigurojë bashkëpunimin e tyre.

2. — Futja e grave në prodhim dhe në gjithë sektorët e ak-

tivitetit të vendit duhet dhe mund të ishte shumë më e madhe. Bashkimi i Grave të Shqipërisë nuk e ka vlerësuar sa duhet këtë problem si detyrën e vet kryesore, dhe s'e ka parë këtë në tërë gjerësinë e tij. Organizatat e Partisë, organet e pushtetit dhe organizatat e masave s'janë kujdesur sa duhet për këtë problem dhe ka pasur shfaqje sektarizmi sidomos në lidhje me ngritjen e grave në vende me përgjegjësi.

3. — Puna edukative me gratë nuk ka qenë e mjaftueshme sidomos për demaskimin e imperialistëve luftëdashës, të titistëve, të monarko-fashistëve dhe të armiqtë të brendshëm dhe sidomos në disa zona ku prapambetja politike e shoqërore e grave është më e madhe.

4. — Problemit të nënës e të fëmijës, organet e Bashkimit të Grave të Shqipërisë në rrethe s'i kanë dhënë rëndësinë e duhur. Në aktivitetin e zhvilluar për këtë problem s'janë përfshirë të gjitha masat sidomos të fshatit, nuk është bashkëpunuar sa duhet me organet e shëndetësisë dhe sidomos me ato të arësimit.

5. — Në Bashkimin e Grave të Shqipërisë ka pasur shfaqje sektarizmi dhe nuk është punuar për edukimin dhe ngritjen në përgjegjësi të grave aktive, por është mbështetur puna vetëm në një numër të kufizuar grash.

6. — Organet udhëheqëse të Bashkimit të Grave të Shqipërisë e kanë kryer me shumë të meta detyrën kryesore të tyre, kontrollin për zbatimin e vendimeve. Prandaj dhe vendimet e tyre nuk janë realizuar plotësisht. Nga ana e Kryesisë dhe e Sekretariatit të Këshillit të Përgjithshëm të Bashkimit të Grave të Shqipërisë organizatat lokale janë ndihmuar pak.

Byroja Politike e Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, duke marrë parasysh ndryshimet e thella që janë bërë në vendin tonë në përgjithësi dhe veçanërisht në jetën e grave, duke pasur gjithashtu parasysh se janë krijuar të gjitha konditat për një pjesëmarrje më aktive dhe më të gjerë të grave në punën për ndërtimin e bazave të socializmit në gjithë sektorët e aktivitetit të vendit tonë dhe duke u udhëhequr nga mësimet e themeluesve të socializmit e të komunizmit,

Vendosi:

I

Organizatat e Partisë, organet e pushtetit dhe gjithë organizatat e masave punën për ngritjen e gruas në shkallën e një qytetareje aktive për ndërtimin e bazave të socializmit duhet ta konsiderojnë si një nga detyrat e tyre të rëndësishme.

1. — Gjithë Partia, pushteti dhe organizatat e masave duhet të shtojnë përpjekjet për tërheqjen e gruas në shkallë të gjerë në prodhim dhe ta quajnë këtë si qëllim kryesor të punës me masat e grave. Për Bashkimin e Grave të Shqipërisë hedhja e grave në prodhim të jetë detyrë e saj e parë, metri me të cilin do të maten rezultatet e punës edukative që ajo do të zhvillojë me gratë.

2. — T'i propozohet Këshillit të Ministrave të marrë masa të nevojshme për futjen e grave në prodhim. Për këtë të krijohet një komision, i cili të caktojë sektorët e përshtatshëm ku mund të punojë gruaja. Organet shtetërore të kenë parasysh që në planet e fuqisë punëtore të caktojnë numrin e grave që duhen futur në punë. Bashkimi i Grave të Shqipërisë të punojë për plotësimin e planit të caktuar si forca me pagesë ose vullnetare.

3. — Bashkimi i Grave të Shqipërisë të punojë për t'i futur akoma dhe më shumë gratë fshatare në prodhim, sepse kështu ndihmohet edhe për nxjerrjen e fuqisë punëtore nga fshati. Të punohet që gratë të njohin agrominimumin dhe të përvetësojnë metodat e reja sovjetike në bujqësi për të siguruar prodhime sa më të larta. Të mobilizohen gratë veçanërisht për mbjelljen e bimëve industriale të pambukut e të panxharit të sheqerit, për mbjelljen e kopshteve, të pemëve frutore, për shtimin e shpendëve e të blegtorisë etj. Të mobilizohen gratë për shlyerjen e detyrimeve ndaj shtetit dhe sidomos për produktet që gruaja mund të interesohet më shumë.

4. — Të punohet që gratë e familjeve të kooperativave bujqësore të marrin pjesë gjerësisht në prodhim dhe Bashkimi i Grave të Shqipërisë të propagandojë në masat e grave mbi përfitimet që kanë ato nga kooperativat në mënyrë që, atje ku janë konditat, gratë të jenë për ngritjen e kooperativave.

5. — Bashkimi i Grave të Shqipërisë në bashkëpunim me Bashkimin e Kooperativave të Artizanatit të kujdeset për futjen e grave në kooperativat e artizanatit dhe për ngritjen e të tilla kooperativave atje ku paraqitet nevoja e ku janë mundësitë.

6. — Të luftohet sektarizmi dhe mentaliteti antimarksist i mosbesimit në forcat krijuese të gruas, të mësohen, të ndihmohen dhe të ngrihen ato me kurajë në vende me përgjegjësi në pushtet, në organet e Partisë, në organet e Bashkimeve Profesionale të Shqipërisë, në BRPSH, në Frontin Demokratik etj.

7. — Për pjesëmarrjen e gruas në prodhim dhe në gjithë sektorët e aktivitetit politik-shoqëror të vendit është e domosdoshme të punohet shumë për arësimin dhe përgatitjen profesionale të grave dhe të të rejave. T'i propozohet Këshillit të Ministrave që në planin e shtetit të parashikohet futja e më shumë femrave në shkollat e kurset dhe dhënja e më shumë bursave që të favorizohet pjesëmarrja e tyre edhe në punë drejtuese. Bashkimet pro-

fesionale të punojnë që sa më shumë gra punëtore të marrin pjesë në kurset e kualifikimit. Bashkimi i Grave të Shqipërisë në bashkëpunim me BRPSH të punojë për të siguruar numrin e vajzave të parashikuara në plan për shkolla, kurse e bursa.

8. — T'i propozohet Këshillit të Ministrave që të vendosë masat që duhen marrë për krijimin e konditave lehtësuese të domosdoshme për futjen e gruas në prodhim, si ngritja e çerdheve, kopshteve të fëmijëve, të shesheve verore, të mensave, të lavanderive etj. Gjithashtu në planet e shtetit të ndërmarrjeve shtetërore, kooperativiste etj. të caktohen fondet që do të përdoren për ngritjen e tyre.

· · · · ·

III

Bashkimi i Grave të Shqipërisë duhet të kujdeset shumë më tepër se deri sot për problemet e nënës e të fëmijës dhe për problemet e tjera sociale të grave.

1. — Bashkimi i Grave të Shqipërisë dhe Bashkimet Profesionale të Shqipërisë të ndihmojnë me sugjerime dhe punë vullnetare në ngritjen dhe mirëmbajtjen e institucioneve të nënës e të fëmijës. Bashkimi i Grave të Shqipërisë të organizojë në shkallë të gjerë marrjen në patronazh të këtyre institucioneve dhe të institucioneve të tjera shoqërore si spitale etj. Gjithashtu të kujdeset për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e shtëpive që janë pasuri shtetërore dhe të ndihmojë organet shtetërore në problemin e strehimit në qytet.

2. — Bashkimi i Grave të Shqipërisë duhet të punojë për edukimin e nënave me qëllim që ato t'i edukojnë fëmijët e tyre me të gjitha vetitë e larta që duhet të ketë qytetari i ri i Republikës sonë Popullore, t'i rritin patriotë të vërtetë, besnikë të Partisë, të atdheut e të popullit, me dashuri për punën e për diturinë. Për këtë Bashkimi i Grave të Shqipërisë duhet të bashkëpunojë ngushtë me Ministrinë e Arësimit e Bashkimin e Rinisë së Punës të Shqipërisë dhe të përpiqet të forcojë lidhjen shkollë-familje. Bashkimi i Grave të Shqipërisë duhet të luftojë kundër moskujdesisë së prindërve që i lënë fëmijët e tyre të marrin rrugën e veseve dhe të vagabondazhit.

3. — Bashkimi i Grave të Shqipërisë të edukojë nënat për të rritur fëmijë të fortë dhe në bashkëpunim me organet e shëndetësisë të luftojë kundër mortalitetit të fëmijëve, t'i edukojë nënat që të çmojnë rëndësinë e institucioneve të nënës e të fëmijës dhe t'i frekuentojnë ato sa më shumë.

4. — Bashkimi i Grave të Shqipërisë të zhvillojë në gratë

ndjenjën e pastërtisë e të rregullit, të higjienës në përgjithësi, sidomos në fshat, me qëllim që të përmirësohen konditat e jetesës së familjes e të rritjes së fëmijëve.

5. — Organizatat e Partisë, organet shtetërore, organizatat e masave dhe veçanërisht Bashkimi i Grave të Shqipërisë duhet të luftojnë kundër sjelljeve të padrejta ndaj gruas e familjes, gjë që sjell konsekuenca të dëmshme për shoqërinë tonë dhe për edukimin e fëmijëve. Të dënohen rreptë shkeljet e ligjeve në këtë drejtim, njëkohësisht të bëhet punë edukative për të luftuar këto shfaqje të dëmshme.

IV

Bashkimi i Grave të Shqipërisë duhet të forcojë punën për edukimin e masave të grave me qëllim që t'i bëjë ato ndërtuese aktive e të ndërgjegjshme për ndërtimin e socializmit, për mbrojtjen e pavarësisë dhe të paqes.

1. — Për edukimin e grave Bashkimi i Grave të Shqipërisë të kujdeset që të botohen më shumë materiale me përmbajtje të përshtatshme për nivelin e grave dhe nevojat e tyre. Revista «Shqiptarja e Re» të dalë dy herë në muaj dhe të ketë më shumë material nga jeta e organizatës dhe e masave të grave. Organizata të mobilizohet për shpërndarjen dhe shfrytëzimin e shtypit dhe të materialit tjetër edukativ.

2. — Bashkimi i Grave të Shqipërisë, nën udhëheqjen e ndihmën e organizatave të Partisë, të luftojë kundër fanatizmit, zakoneve të dëmshme dhe prapambetjes që janë pengesa serioze për mobilizimin e grave për ndërtimin e socializmit. Lidhur me këtë Bashkimi i Grave të Shqipërisë duhet t'i japë një rëndësi shumë të madhe luftës kundër analfabetizmit.

Organizatat e Partisë duhet të kenë parasysh se edukimi i grave nuk është detyrë që i takon vetëm organizatës së Bashkimit të Grave të Shqipërisë, por është një problem që i intereson direkt Partisë, prandaj ato duhet të udhëheqin me kujdes tërë punën edukativo-politike me masat e grave.

V

1. — Bashkimi i Grave të Shqipërisë duhet të paraqitë në kongresin e vet projektstatutin e Bashkimit të Grave të Shqipërisë dhe të punojë për forcimin e organizatës dhe për aktivizimin e të gjitha anëtareve të saja.

2. — Bashkimi i Grave të Shqipërisë të luftojë sektarizmin

që ekziston në radhët e veta dhe të shtojë numrin e aktivisteve sidomos me elementë pa parti, të ngrejë me guxim në udhëheqje të organizatës së Bashkimit të Grave të Shqipërisë gra të thjeshta e aktive dhe të marrë masa për edukimin e kuadrit duke organizuar kurse të shkurtëra e seminare në qendër, në rrethe e në lokalitete. Bashkimi i Grave të Shqipërisë duhet të arrijë që organizatat bazë të drejtohen nga vetë këshillat e bazës. Për zonat ku organizata paraqitet më e dobët, të merren masa të posaçme për përgatitjen e kuadrit vendës për të drejtuar organizatat.

3. — Byroja Politike e konsideron të nevojshme t'u theksojë anëtareve të forumeve të Bashkimit të Grave të Shqipërisë dhe gjithë aktivisteve që ta konsiderojnë nder të madh detyrën që u ka besuar masa e grave duke i zgjedhur udhëheqëse dhe të kuptojnë mirë përgjegjësinë që kanë ndaj këtyre masave.

Në organet e Bashkimit të Grave të Shqipërisë në qendër e në rrethe të luftohet për të përmirësuar metodën e punës, për të forcuar disiplinën, kontrollin për zbatimin e vendimeve dhe të shtohet operativiteti për të forcuar lidhjet me bazën dhe me masat e grave.

VI

Organizatat e Partisë të kenë kurdoherë parasysh rolin e madh të gruas në shoqëri e rëndësinë që ka puna me gruan dhe të luftojnë shfaqjet e nënvleftësismit, të indiferentizmit e të sektarizmit ndaj gruas si dhe të gjitha shfaqjet e tjera të shtrembra.

1. — Organet e Partisë të shtojnë kujdesin për Bashkimin e Grave të Shqipërisë. Kujdes të veçantë të tregojnë organizatat bazë të Partisë për ta ndihmuar organizatën e gruas në bazë, sidomos në fshat, ku ajo paraqitet më e dobët. Gjithë komunistët kanë detyrë të ndihmojnë Bashkimin e Grave të Shqipërisë dhe veçanërisht shoqet komuniste duhet të marrin pjesë aktivisht në punën me gruan. Ato duhet të kuptojnë se, si gra pararoje, u takon një detyrë e madhe në punën për ngritjen e gruas në përgjithësi. Të goditen shfaqjet e nënvleftësismit dhe të mospërfilljes së punës me gruan që janë dukur në disa shoqe komuniste.

Të tregohet kujdes që si rezultat i një pune më të shëndoshë në Bashkimin e Grave të Shqipërisë elementët më të mirë të përgatiten për t'u pranuar në Parti dhe të luftohet sektarizmi që ka ekzistuar në këtë drejtim.

2. — Të forcohet bashkëpunimi i organizatave të pushtetit dhe i të gjitha organizatave të masave me Bashkimin e Grave të Shqipërisë dhe Bashkimi i Grave të Shqipërisë të ngrejë përpara këtyre organeve të gjitha problemet që i dalin. Organizatat e ma-

save ta konsiderojnë punën me gruan si një problem të tyre. Veçanërisht të shtohet kujdesi i Bashkimeve Profesionale të Shqipërisë për gratë punëtore dhe i Bashkimit të Rinisë së Punës të Shqipërisë për të rejtat.

Byroja Politike e Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë i rekomandon Bashkimit të Grave të Shqipërisë që ta ketë parasysh këtë vendim për përgatitjen e Kongresit të tretë të Bashkimit të Grave të Shqipërisë që do të bëhet më 1 tetor dhe porositi organizatat e Partisë që t'i japin Bashkimit të Grave të Shqipërisë gjithë ndihmën e nevojshme për përgatitjen sa më të mirë të këtij kongresi që ka rëndësi jo vetëm për masën e grave, por për gjithë popullin tonë.

Byroja Politike e Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë porositi që ky vendim të punohet në të gjitha organizatat e Partisë dhe të Bashkimit të Grave të Shqipërisë.

BYROJA POLITIKE E KOMITETIT QENDROR TË PPSH

*Botohet sipas origjinalit që
gjetet në Arkivin Qendror
të Partisë*

*Botuar për herë të parë në
gazetën «Zëri i Popullit»,
Nr. 216 (605), 6 shtator 1950*

V E N D I M

I BYROSË POLITIKE TË KQ TË PPSH «MBI DISA PROBLEME AKTUALE TË FSHATARËSISË»

16 shkurt 1951

Byroja Politike e Komitetit Qendror të PPSH, e mbledhur më 16 shkurt 1951 për të shqyrtuar problemin me rëndësi të fshatarësisë në gjendjen aktuale, në të cilën ajo ndodhet sot, pasi dëgjoi, shqyrtoi dhe aprovoi raportin e shokut Mehmet Shehu mbi këtë problem,

V e n d o s i :

1. — Për të lehtësuar fshatarësinë e varfër dhe të mesme nga detyrimet e rënda në tatimin në natyrë të merren këto masa:

a) Për drithërat e bukës të planit të grumbullimit të vitit 1950 që nuk janë realizuar akoma, të ndalohet grumbullimi i tyre dhe t'i lejohet fshatarësisë që të na e dorëzojë në prodhimin e ardhshëm;

b) Ngarkohen ministri i grumbullimeve, ministri i bujqësisë dhe presidenti i Komisionit të Planit të kalkulojnë masën e uljes së koeficienteve të tatimit në natyrë dhe t'i paraqitin propozime konkrete Këshillit të Ministrave jo më vonë se 1 mars 1951;

c) Fletëdetyrimet për prodhimet bujqësore të vitit 1951 të mos shpërndahen derisa të vendosë Këshilli i Ministrave mbi uljen e koeficienteve të tatimit. Por fletëdetyrimet duhet t'u shpërndahen fshatarëve jo më vonë se 15 prill 1951;

ç) Ministria e Bujqësisë të marrë masa për shpejtimin operativ të korrigjimit të kadastrës në mënyrë që të gjitha këto veprime të marrin fund për të gjithë Republikën brenda vitit 1952. Klasifikimi i ri t'u shpallet fshatarëve menjëherë, papritur fletëdetyrimet.

2. — Për të forcuar lidhjet midis qytetit dhe fshatit, për të forcuar aleancën e klasës punëtore me fshatarësinë, të merren këto masa:

a) Të ulen çmimet e prodhimeve industriale në mënyrë të tillë që fshatarësia të tërhiqet më tepër nga tregu reciprok se sa nga tregu i lirë, në mënyrë që shteti të mund të grumbullojë tepër nga fshatarësia nëpërmjet tregut reciprok dhe fshatarësia të mund të furnizohet më mirë me prodhime industriale. Për këtë ngarkohet nënministri i tregëtisë, ministri i financave dhe presidenti i Komisionit të Planit ta studjojnë çështjen dhe t'i paraqitin propozime konkrete në këtë drejtim Këshillit të Ministrave jo më vonë se më 15 mars 1951. Për vitin 1951 t'i japim fshatarësisë, me anën e tregut reciprok, një vëllim mallrash industriale që të jetë baras me ekuivalentin e 100 000 kv. drithëra buke që duhet të grumbullojmë nga fshatarësia me anën e tregut reciprok. Njëkohësisht stimulacionet dhe tregu reciprok i shtetit duhet të furnizojnë fshatarësinë gjatë vitit 1951 me një sasi drithi prej 180 000 kv. për bimët industriale dhe prodhime të tjera që do të grumbullohen nga fshatarësia (këto shifra të jenë orientative për komisionet përkatëse);

b) Në mënyrë që të ndalohet zvogëlimi absolut i inventarit zooteknik të fshatarësisë, të ulet tatimi në natyrë për grumbullimin e mishit. Për këtë, të ngarkohet ministri i grumbullimeve, ministri i bujqësisë, presidenti i Komisionit të Planit dhe nënministri i industrisë që ta studjojnë çështjen në tërësi dhe t'i paraqitin propozimet konkrete Këshillit të Ministrave jo më vonë se 15 mars 1951;

c) Ministria e Bujqësisë të marrë të gjitha masat në mënyrë që fermat bujqësore dhe blegtorale të shtetit të përmirësojnë gjendjen e tyre, të bëhen me të vërtetë shembull i socializmit në fshat dhe të ndihmojnë më konkretisht dhe efektivisht kooperativat bujqësore dhe fshatarësinë e varfër e të mesme përreth me mekanikë bujqësore, farëra të seleksionuara, kafshë race, fidana frutorë, këshilla teknike etj.;

ç) Ministria e Bujqësisë të marrë të gjitha masat në mënyrë që SMT-të të ndihmojnë më mirë kooperativat bujqësore dhe sidomos fshatarësinë e varfër dhe të mesme. Të respektohen rigorozisht kontratat e SMT-ve me kooperativat dhe fshatarët individualë. SMT-të të bëhen një mjet i fortë lidhjeje materiale dhe propagandistike midis shtetit dhe fshatarësisë, duke e ndihmuar fshatarësinë konkretisht dhe duke e tërhequr atë në kolektivizimin e bujqësisë;

d) Ministria e Bujqësisë të marrë masat për të ndihmuar më tepër kooperativat ekzistuese dhe të bëjë përgatitje të gjithanshme për t'u ardhur në ndihmë kooperativave që mund të formohen

në të ardhshmen (rreth 50 kooperativa gjatë këtij viti). Këto përgatitje duhet të konsistojnë në ndihmën efektive (organizative, teknike, materiale) në përgatitjen e kuadrit rezervë, në ngritjen profesionale të kuadrit ekzistues, në farë, kafshë race, mekanikë bujqësore etj.;

dh) Në përpilimin e planit të vitit 1951, Ministria e Bujqësisë, Komisioni i Planit dhe Banka e Shtetit të kenë parasysh shtimin e kreditit agrar dhe bankar për fshatarësinë individuale dhe kooperativiste, në masën që e lejojnë mundësitë ekonomike të shtetit dhe që të bëjë efektin e duhur në gjendjen ekonomike të kooperativave dhe të fshatarëve të varfër, sidomos të atyre që janë më të pafuqishëm ekonomikisht:

e) Në përpilimin e planit ekonomik të vitit 1951 dhe të planit pesëvjeçar të mbahet parasysh prodhimi në seri i plugjeve në vend, prodhimi në masë nga industria dhe artizanati i veglave bujqësore (shata, lopata, kazma etj.), gjithashtu edhe importimi sa më i gjerë i veglave të tjera bujqësore që nuk prodhohen në vendin tonë dhe i plehrave kimike. Ministria e Bujqësisë duhet të rezervojë të paktën 20 000 kv. farë misri për fshatarësinë e varfër dhe të mesme për mbjelljet e pranverës. Ministria e Bujqësisë duhet të marrë masa që brenda pesëvjeçarit të furnizojë fshatarësinë kooperativiste dhe individuale me farëra të seleksionuara në mënyrë të tillë që në fund të pesëvjeçarit, e gjithë fara e grurit të paseleksionuar të jetë zëvendësuar plotësisht me farë të seleksionuar;

ë) Për vitin 1951 dhe për pesëvjeçarin të shtohen investimet në bonifikime dhe në çelje kanalesh ujitëse në një masë më të gjerrë se sa është bërë deri sot;

f) Ministria e Bujqësisë të marrë masa që të shtojë ndihmën agronomike për kooperativat dhe fshatarësinë individuale. Gjatë vitit 1952 Ministria e Bujqësisë duhet të sigurojë një kuadër teknik të mesëm për bimët industriale për çdo 500 ha. pambuk të mbjellë nga fshatarësia kooperativiste dhe individuale;

g) Të fillohet për të vënë në jetë formën kolektive bujqësore jo vetëm në tokat fushore, por dhe në tokat malore, në bazë të statutit që ka propozuar Ministria e Bujqësisë dhe që ka aprovuar Byroja Politike.

gj) Për të kompensuar uljen e çmimeve të prodhimeve industriale në tregun reciprok, duhet të mobilizohet e gjithë Partia për uljen e kostos së prodhimit në sektorin industrial dhe për të bërë kursime sa më të mëdha në administratë dhe kudo gjetkë;

h) Të zgjerohet dhe të forcohet rrjeti i kooperativave të shitblerjes në fshat, duke e lidhur më tepër ekonomikisht fshatarin me kooperativën. Për këtë, Ministria e Tregëtisë dhe Bashkimi Qendror i Kooperativave duhet t'i paraqitin Këshillit të Mi-

nistrave një relacion të hollësishëm me propozimet përkatëse jo më vonë se 15 mars 1951.

3. — Për zhvillimin e luftës së klasave në fshat, është e nevojshme që organet e Partisë:

a) të shpejtojnë dhe të intensifikojnë punën për identifikimin e masës së kulakut;

b) të intensifikojnë punën agjitative dhe propagandistike në fshat për të bërë që të tërhiqen në luftën për kufizimin e kulakut masat e fshatarësisë së varfër dhe të mesme. Të intensifikojnë punën për të zbuluar dhe demaskuar të gjitha metodat dhe format e punës së kulakut kundër pushtetit. Komitetet e Partisë në rrethe të ndihmohen më tepër nga aparati i Komitetit Qendror, në mënyrë që të evitohen shmangjet nga vija e Partisë në lidhje me luftën e klasave në fshat...

4. — Në mënyrë që të sigurohet më mirë buka, Ministria e Grumbullimeve duhet të marrë masa për vendosjen e një discipline rigoroze në ruajtjen e drithërave të bukës, në manipulimin dhe konsumin e tyre. Ministria e Grumbullimeve duhet t'i paraqitë Këshillit të Ministrave bilancin e bukës të vitit 1951 jo më vonë se 1 mars 1951. Anëtarëve të Byrosë Politike duhet t'u vijnë statistikat përkatëse për gjendjen e depove dhe konsumin e bukës për çdo tremujor.

5. — Për të konkretizuar më mirë perspektivën e zhvillimit të kolektivizimit të bujqësisë, Ministria e Bujqësisë duhet ta studjojë mirë çështjen dhe t'i paraqitë Byrosë Politike raportin përkatës dhe propozimet jo më vonë se 10 mars 1951.

6. — Pasi të shqyrtohet në Byronë Politike përmbajtja e këtij raporti... çështja e fshatarësisë të shtrohet në një plenum të jashtëzakonshëm të Komitetit Qendror. Në këtë plenum të analizohet çështja e fshatarësisë në bazë të përmbajtjes së këtij raporti, të analizohet gjerësisht edhe puna e Partisë në fshat në të gjitha aspektet e saj brenda muajit mars.

Për Byronë Politike të Komitetit Qendror të PPSH

Sekretari i Përgjithshëm

Enver Hoxha

Botohet sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

PLENUMI IX I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Tiranë, 19—23 shkurt 1951

Nga data 19—23 shkurt 1951 zhvilloi punimet e tij Plenumi IX i KQ të PPSH i cili dëgjoji, shqyrtoi dhe aprovoi:

1. — Raportin «Mbi gjendjen politike dhe punën e Partisë», mbajtur nga shoku Enver Hoxha.

2. — Raportin «Mbi disa anëtarë të KQ të PPSH që kanë vepruar në kundërshtim me vijën e Partisë», mbajtur nga shoku Enver Hoxha.

3. — Raportin «Mbi realizimin e planit dyvjeçar të shtetit».

Vendimet e plenumit shërbyen për përparimin e mëtejshëm të ekonomisë sonë popullore, për forcimin e Republikës Popullore të Shqipërisë, për forcimin e radhëve të Partisë dhe të unitetit të saj.

Rezolucionet përkatëse të këtij plenumi botohen në këtë vëllim, me përjashtim të rezolucionit mbi realizimin e planit dyvjeçar të shtetit.

REZOLUCION

I PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH «MBI GJENDJEN POLITIKE DHE PUNËN E PARTISË»

23 shkurt 1951

Komiteti Qendror i PPSH, i mbledhur prej datës 19 shkurt 1951 deri më datën 23 shkurt 1951, pasi dëgjoi dhe aprovoi raportin e Sekretarit të Përgjithshëm të Partisë, shokut Enver Hoxha, «Mbi gjendjen politike dhe punën e Partisë», konstatoi:

I

Situata ndërkombëtare karakterizohet nga njëra anë nga forcimi dhe zgjerimi gjithnjë e më i madh i kampit të paqes dhe të socializmit, nga zgjerimi i lëvizjes së fuqishme të partizanëve të paqes, që tani përfshin në gjirin e vet popujt e mbarë botës; nga suksese përditë e më të mëdha të Bashkimit Sovjetik, që po ndërton shoqërinë komuniste dhe që udhëheq lëvizjen e madhe të popujve për paqe e demokraci; nga suksese të reja të demokracive popullore, të Republikës së madhe Popullore të Kinës dhe të Republikës Demokratike Gjermane; nga zgjerimi i vrullshëm i përpjekjeve e i luftërave çlirimtare të popujve kolonialë e të shtypur. Nga ana tjetër situata ndërkombëtare karakterizohet nga një kalbëzim i kampit imperialist që brehet prej aspirimit të kontradiktave të brendshme dhe të jashtme dhe nga përgatitjet e imperialistëve më në krye ata amerikanë për të shpërthyer një luftë të re botërore. Ata tashmë me agresionin e tyre në Kore kanë kaluar, nga faza e përgatitjeve, në luftë të hapët.

Republika jonë Popullore ka qenë dhe është një objekt goditjeje dhe sulmi nga ana e imperialistëve luftënxitës dhe e agjentëve të tyre të Beogradit, të Athinës e të Romës, të cilët, të mbështetur edhe në shërbëtorët e tyre të brendshëm, janë përpjekur dhe po

përpiqen të skllavërojnë popullin tonë. Të gjitha tentativat e tyre janë dërmuar nën grushtin e fortë të Armës së Sigurimit të Shtetit dhe të vigjilencës e të patriotizmit të popullit tonë të udhëhequr nga Partia.

Si rezultat i këtyre sukseseve si dhe i sukseseve të arritura në forcimin e ekonomisë popullore, në saje të ndihmës së madhe të Bashkimit Sovjetik dhe të shokut Stalin, si dhe të demokracive popullore, situata e brendshme është forcuar, është konsoliduar Republika jonë Popullore.

Por rreziku i një lufte të re kërcënon botën dhe vendin tonë. Armiqtë e paqes e të demokracisë, imperialistët, titistët, monarko-fashistët dhe neofashistët intensifikojnë përpjekjet e tyre për të përmbytur pushtetin tonë popullor dhe për t'i rrëmbyer popullit lirinë.

Situata ndërkombëtare vë përpara Partisë detyrën që të përforcohen sa më shumë lidhjet e saja me masat. Duke pasur parasysh fjalët e shokut Stalin se

«Paqja do të ruhet dhe do të forcohet në qoftë se popujt do ta marrin në duart e veta çështjen e ruajtjes së paqes dhe do ta mbrojnë atë deri në fund»¹,

kjo detyrë bëhet për Partinë tonë shumë e rëndësishme dhe imperative. Ne duhet të forcojmë punën politike me masat, të demaskojmë sa më shumë imperializmin me të gjitha të këqiat që ka me vete ai sistem, të bëjmë që çdo qytetar i Republikës sonë Popullore të njohë mirë qëllimet luftënxitëse të imperializmit dhe konsekuencat e luftës, të demaskohen sa më shumë agjentët e tij të Beogradit, të Athinës e të Romës dhe qëllimet e tyre kundër Republikës sonë Popullore; të shtohet sa më shumë urrejtja e masave kundër imperializmit dhe shërbëtorëve të tij që janë në kufi të atdheut tonë, të shtohet sa më shumë urrejtja kundër klikës tradhëtare të Beogradit, të luftohen pa mëshirë armiqtë e brendshëm, të arrihet gatishmëria e popullit për ruajtjen e paqes me të gjitha mjetet. Për një punë të tillë duhet të aktivizohen dhe të mos mbeten formale edhe komitetet për mbrojtjen e paqes. Ngarkohet Byroja Politike që të shqyrtojë dhe të përcaktojë masat që duhen marrë për forcimin e punës politike me masat.

Partia të punojë që populli ynë të njohë sa më mirë rolin e madh dhe vendimtar që luan Bashkimi Sovjetik në mbrojtjen e paqes në botë, sukseset e mëdha që po arrihen në ndërtimin e komunizmit, ndihmën e madhe që na jep për ndërtimin e socializmit në

¹ J. V. Stalin. Bisedë me korrespondentin e gazetës «Pravda». «Pravda», Nr. 48 (11885), 17 shkurt 1951.

vendin tonë dhe të bëjë që të shtohen dhe të forcohen gjithnjë e më shumë dashuria dhe devocioni i popullit tonë ndaj Bashkimit Sovjetik dhe të madhit Stalin.

II

Partia jonë gjatë planit dyvjeçar dhe veçanërisht gjatë vitit 1950 ka kryer më mirë rolin e saj në drejtimin e jetës ekonomike të vendit dhe kjo për arsye se gjatë kësaj kohe ajo është forcuar organizativisht, është shtuar kombativiteti në radhët e Partisë, është përmirësuar demokracia e brendshme në Parti dhe është përmirësuar metoda e punës së organeve dhe organizatave të Partisë.

Por me gjithë këto suksese që janë arritur, plani i shtetit nuk është realizuar në të gjithë sektorët dhe në mjaft lëme të aktivitetit konstatohen të meta në punë. Këto kanë rrjedhur në radhë të parë nga dobësitë që janë vërtetuar në punën drejtuese të Partisë.

Komiteti Qendror konstaton se të metat kryesore janë:

1. — Dobësitë në drejtimin e punës nga organet udhëheqëse të Partisë.

a) Komiteti Qendror i Partisë, si organi më i lartë pas kongresit, nuk ka kryer plotësisht rolin që i është besuar; nuk është vlerësuar sa duhet roli i Komitetit Qendror dhe në këtë mënyrë nuk është respektuar si duhet parimi i udhëheqjes kolegjiale në Parti.

Komiteti Qendror i Partisë nuk është mbledhur rregullisht, dhe, edhe atëhere kur është mbledhur, janë bërë zakonisht mbledhje të zgjeruara të tija, gjë që ka penguar zhvillimin e kritikës dhe të autokritikës. Çështjet më të rëndësishme të Partisë dhe të shtetit nuk janë shtruar sa duhet nga Byroja Politike para Komitetit Qendror. Komiteti Qendror nuk është informuar rregullisht mbi realizimin e vendimeve të Kongresit I të Partisë, të Konferencës II Nacionale të Partisë dhe të plenumeve të Komitetit Qendror, as mbi vendimet e marrura nga Byroja Politike e Komitetit Qendror. Në këtë mënyrë ai nuk ka mundur të ushtrojë si duhet drejtimin dhe kontrollin mbi gjithë sektorët e jetës së vendit.

Një sistem i tillë pune ka penguar ngritjen e anëtarëve të Komitetit Qendror si udhëheqës të vendit, ka shkaktuar që ata të mos ndjejnë sa duhet përgjegjësinë e madhe që kanë para Partisë dhe popullit, ka bërë që ata të mos kujdesen sa duhet për problemet e Partisë dhe të pushtetit jashtë sektorit që ata drejtojnë direkt dhe të mos përpiqen si duhet që t'i njohin, të thellohen në to dhe të ndihmojnë në zgjidhjen e tyre. Anëtarët e Komitetit Qendror nuk janë aktivizuar sa duhet.

Nga mungesa e zgjidhjes së problemeve të Partisë e të shtetit kolektivisht nga ana e Komitetit Qendror vjen rreziku i dobësimit të kritikës dhe të autokritikës në gjirin e Komitetit Qendror dhe të gjithë Partisë, pengohet lufta kundër metodave të komandimit në Parti, pengohet zhvillimi i demokracisë së brendshme të Partisë.

b) Përgjegjësia për mosfunksionimin e Komitetit Qendror të Partisë dhe për moskryerjen si duhet të rolit që i takon atij, bie mbi Byronë Politike, si organ ekzekutiv më i lartë i Komitetit Qendror e ngarkuar me përgatitjen e problemeve që duhet t'i paraqiteshin për shqyrtim Komitetit Qendror, me kontrollin e zbatimit të vendimeve të kongresit, të konferencës dhe të plenumeve si dhe me drejtimin e gjithë jetës së vendit midis plenumeve të Komitetit Qendror. Kjo ka ardhur për arsye se vetë Byroja Politike nuk ka zotëruar si duhet gjithë problemet që i takojnë.

Byroja Politike e Komitetit Qendror nuk ka qenë e informuar sa duhet mbi çështjet e jetës dhe të aktivitetit të organizatave të Partisë dhe kështu ajo nuk ka qenë në gjendje sa duhet që të merrte masat e duhura për zgjidhjen e mjaft çështjeve dhe problemeve që kanë të bëjnë me punën e Partisë. Kjo ka ardhur se Sekretariati i Komitetit Qendror nuk ka udhëhequr operativisht si duhet aparatën e Komitetit Qendror, nuk ka ndjekur si duhet operativisht zbatimin e vendimeve të Komitetit Qendror, nuk ka përgatitur si duhet çështjet që duhet të shtroheshin në Byronë Politike të Komitetit Qendror. Përgjegjësia për këtë bie sidomos mbi dy sekretarët¹ e Komitetit Qendror që kanë qenë në drejtim të punës së përditshme në aparatën e Komitetit Qendror.

Byroja Politike gjithashtu nuk ka qenë e informuar sa duhet mbi problemet ekonomike të vendit, sidomos mbi realizimin e planit dhe mbi të gjitha çështjet e tjera shtetërore. Këshilli i Ministrave, përpara krijimit të Kryesisë, nuk ka qenë në gjendje të ngrejë si duhet problemet ekonomike dhe shtetërore përpara Byrosë, sepse dhe ai vetë nuk i ka zotëruar këto, nuk ka kontrolluar dhe nuk ka drejtuar si duhet ministrinë dhe organet shtetërore lokale.

Disa anëtarë të Byrosë Politike nuk i kanë njohur mirë problemet e ndryshme të Partisë dhe të shtetit dhe sidomos problemet ekonomike. Jo të gjithë anëtarët e Byrosë Politike kanë marrë pjesë aktivisht në studimin e çështjeve në Byronë Politike dhe anëtarët e Byrosë që s'kanë qenë sekretarë të Komitetit Qendror nuk janë interesuar sa duhet për problemet e ndryshme, por janë interesuar më shumë për sektorët e tyre të punës, nuk e kanë ndjerrë sa duhet përgjegjësinë kolektive.

c) Kjo metodë pune ka ekzistuar edhe në komitetet e Partisë

¹ Tuk Jakova e Bedri Spahiu.

të rretheve, ku byrotë nuk kanë përgatitur rregullisht çështjet që duhet të shtroheshin në plenumë dhe ku anëtarët e komiteteve nuk janë aktivizuar sa duhet e s'e kanë ndjerë përgjegjësinë kolektive për gjithë problemet e rrethit.

2. — Kritika dhe autokritika ka qenë jo në lartësinë e duhur si në Byronë Politike e në Komitetin Qendror, ashtu dhe në gjithë Partinë. Ka ekzistuar një frymë familjariteti dhe një farë liberalizmi ndaj njëri-tjetrit; kërkimi i llogarisë në kryerjen e detyrave ka qenë i dobët. Nuk është kuptuar mirë se kritika dhe autokritika janë ligj për zhvillimin e shoqërisë socialiste dhe janë armë të mprehta për eliminimin e të metave në punë, për të luftuar tendencën e të kënaqurit me pak, shfaqjet e mendjemadhësisë etj. Nuk është kuptuar si duhet se për partitë në fuqi kritika dhe autokritika përbëjnë forcën lëvizëse të zhvillimit politik, ekonomik dhe kultural të vendit.

Byroja Politike nuk ka dhënë llogari rregullisht për veprimtarinë e saj para Komitetit Qendror dhe kjo ka shkaktuar që Byroja Politike dhe anëtarët e s.j të viheshin në pozita të privilegjuara në Komitetin Qendror dhe prandaj të mos kritikoheshin për të metat e tyre në punë. Përveç kësaj ka influencuar negativisht në zhvillimin e kritikës dhe të autokritikës dhe mosdhënja llogari përpara plenumit nga ana e anëtarëve të Komitetit Qendror. Gjithashtu edhe në Byronë Politike nuk ka qenë zhvilluar si duhet kritika dhe autokritika dhe ka ekzistuar një farë tolerance, liberalizmi dhe frymë familjariteti dhe kjo ka shkaktuar që të mos luftohen gabimet dhe të metat e shokëve në punë si p.sh. të mos analizohen me kohë gabimet e shokut Tuk Jakova. Metoda e punës së deritanishme ka sjellë si konsekuencë që Sekretariati të jetë në pozita të privilegjuara në Byro dhe të krijohet mendimi i gabuar sikur ai është një organ më i lartë nga Byroja Politike e Komitetit Qendror.

Këto gjëra janë vërtetuar edhe në komitetet e Partisë në rrethe edhe në organizatat bazë, ku kritika është zhvilluar më shumë nga lart-poshtë dhe autokritika ka qenë e dobët e sidomos nga përgjegjësit. Byrotë e komiteteve të Partisë të rretheve nuk kanë dhënë llogari rregullisht para plenumëve dhe nuk është zhvilluar kritika e autokritika si duhet në komitete. Anëtarët e plenumëve të komiteteve të Partisë nuk kanë kritikuar sa duhet anëtarët e byrosë e sidomos sekretarët. Gjithashtu në byro nuk ka pasur kudo kritikë dhe autokritikë të shëndoshë. Nuk janë praktikuar në rregull mbledhjet e aktiveve të Partisë.

Mungesa e kritikës dhe e autokritikës së shëndoshë ka lejuar që gabimet në metodën e drejtimit të punëve të Partisë të kenë vazhduar deri tani dhe të mos merreshin me kohë masat për përmirësimin e punës. Mungesa e kritikës dhe e autokritikës së shëndoshë në udhëheqje të Partisë dhe në gjithë Partinë dobëson kon-

trollin e kritikën nga ana e masës së Partisë mbi organet drejtuese të Partisë që ajo ka zgjedhur, dobëson kritikën e masave të popullit mbi Partinë. Në këtë mënyrë dobësohet demokracia në Parti dhe krijohet rrethi i «të pakritikueshmëve». Mungesa e kritikës dhe e autokritikës të shëndoshë në Parti, mungesa e luftës së rreptë për të zbuluar dhe për të goditur të metat, dobëson vigjilencën revolucionare në Parti dhe lehtëson punën e armikut.

3. — a) Vigjilenca ndaj armikut të klasës s'ka qenë në lartësinë e duhur, lufta kundër armikut të klasës si në fshat dhe në qytet nuk ka qenë e ashpër sa duhet.

Lufta kundër armikut të klasës në fshat, kulakut, që nga Plenumi VIII i Komitetit Qendror¹ dhe deri në muajin tetor është shtruar në forma shumë të përgjithshme dhe nuk është konkretizuar. Komiteti Qendror nuk i ka ndihmuar si duhet organet e Partisë në rrethe në këtë drejtim dhe kjo është bërë një pengesë për realizimin e plotë të detyrës që ka vënë para nesh Kongresi I i Partisë mbi zhvillimin e luftës së klasës në fshat e në qytet. Urrej-tja kundër armikut të klasës nuk ka qenë e fortë sa duhet.

Janë manifestuar shfaqje liberalizmi, zemërgjerësie, butësie, oportunizmi kundrejt armikut të klasës.

b) Shfaqje të oportunizmit janë vërtetuar sidomos në organet e drejtësisë dhe të Prokurorisë së Përgjithshme në lidhje me politikën e goditjeve.

c) Mungesa e vigjilencës dhe e luftës kundër armikut të klasës është shfaqur edhe në kujdesin e pamjaftueshëm për vendosjen në punë të kuadrove me qëndrim të keq politik, të cilëve u janë dhënë në disa raste vende ku ata mund të dëmtojnë ose në vendosjen në vende kyçe të kuadrove jo sa duhet revolucionarë. Tipik ka qenë rasti i caktimit të kuadrove gjyqësorë. Edhe në këto raste ka influencuar puna oportuniste e shokut Tuk Jakova i cili ka drejtuar këtë sektor.

4. — Një dobësi e madhe që ka influencuar në moszbulimin me kohë të të metave dhe ka lejuar vazhdimin për një kohë të tillë të mungesës së duhur të vigjilencës revolucionare, të gabimeve në realizimin e vijës së Partisë në lidhje me luftën kundër armikut të klasës etj., ka qenë niveli i ulët ideologjik i Partisë, duke filluar që nga anëtarët e Komitetit Qendror dhe deri në bazë. Por përgjegjësia për këtë gjendje për anëtarët e Komitetit Qendror dhe për kuadrot kryesorë të Partisë bie mbi vetë ata, për arsye se nuk kanë bërë përpjekje për ngritjen e tyre, duke mos zbatuar kështu një nga detyrat kryesore që u caktua nga Kongresi I i Partisë. Nga ky nivel ideologjik ka ardhur që problemet e ndry-

¹ Është fjala për Plenumin VIII të KQ të PPSH, gusht 1950.

shme që janë shqyrtuar në udhëheqje të Partisë nuk janë studjuar dhe nuk janë përpunuar si duhet në mënyrë marksiste-leniniste.

Puna për ngritjen ideologjike të masës së Partisë, me gjithë përmirësimet që janë vërtetuar këto kohët e fundit, paraqit mjaft të meta, sidomos përsa i përket lidhjes së teorisë me praktikën. Anëtarët e komiteteve të Partisë në rrethe nuk i kanë kushtuar kujdesin e duhur ngritjes së tyre ideologjike dhe mjaft komitete rrethesh nuk e kanë drejtuar si duhet problemin e propagandës.

5. — Verifikimi i zbatimit të vendimeve dhe i kryerjes së detyrave ka qenë mjaft i dobët si nga ana e Byrosë Politike, e Sekretariatit të Komitetit Qendror dhe nga aparati i Komitetit Qendror. Nuk është pasur parasysh sa duhet mësimi i shokut Stalin, sipas të cilit verifikimi i kryerjes së detyrave përbën stilin bolshevik në punë. Aparati i Komitetit Qendror nuk ka ndjekur zbatimin e vendimeve të Byrosë Politike dhe të Komitetit Qendror dhe nuk ka ndihmuar komitetet e rretheve dhe organizatat bazë. Drejtoria e propagandës dhe ajo e organizimit, me gjithë përmirësimet që kanë bërë, nuk kanë ndjekur si duhet çështjet organizative dhe politike, Drejtoria e bujqësisë s'i ka kryer si duhet detyrat e saja, por sidomos drejtoritë e industrisë dhe të tregëtisë nuk e kanë luajtur rolin e tyre. Anëtarët e Byrosë Politike dhe anëtarët e Komitetit Qendror, që punojnë në aparatin e Komitetit Qendror, nuk kanë ndihmuar në vend organizatat e Partisë. Gjithashtu nuk është praktikuar dërgimi i anëtarëve të Komitetit Qendror për të ndihmuar organizatat e rretheve.

Të metat në verifikimin e zbatimit të vendimeve dhe të kryerjes së detyrave kanë ekzistuar edhe në komitetet e Partisë në rrethe deri edhe në organizatat bazë të Partisë. Anëtarët e komiteteve të rretheve nuk kanë shkuar sa duhet për të ndihmuar organizatat bazë në vend.

Gjithashtu në udhëheqjet e organizatave të masave e në organet shtetërore ka pasur të meta të theksuara në lidhje me verifikimin e zbatimit të vendimeve e të detyrave.

Si konsekuencë e këtyre dobësive ka pasur javashllëk në punë, është krijuar një atmosferë lëshimesh, është dobësuar disiplina e ndërgjegjshme dhe përgjegjësia personale në punë.

Duke marrë parasysh situatën ndërkombëtare dhe gjendjen e vendit tonë, duke marrë parasysh përgjegjësinë e madhe të Partisë para popullit për ndërtimin e socializmit në vendin tonë dhe për të kryer me sukses detyrat e mëdha që kemi përpara për realizimin e

plotë të planit perspektiv pesëvjeçar, është e domosdoshme të eliminohen të metat në punën e Partisë.

Për këtë Plenumi IX i Komitetit Qendror të Partisë

V e n d o s i :

I

TË PËRMIRËSOHET METODA E DREJTIMIT NGA ANA E ORGANEVE UDHËHEQËSE TË PARTISË

Në radhë të parë është e domosdoshme që të sigurohet në Komitetin Qendror zgjidhja e të gjitha çështjeve të rëndësishme, të vendoset fryma bolshevike në punë, në mënyrë që të forcohet roli i Komitetit Qendror në Parti, si organi më i lartë drejtues kolektiv unik, si shtabi drejtues i gjithë jetës së vendit tonë. Të luftohen me ashpërsi të gjitha mbeturinat e metodës së komandimit në Parti.

1. — Duke marrë parasysh këtë rol të madh që ka Komiteti Qendror është e nevojshme që të gjitha çështjet më të rëndësishme për vendin tonë të shtrohen në mbledhjet e Komitetit Qendror dhe të zgjidhen kolektivisht.

Anëtarët e Komitetit Qendror të kuptojnë përgjegjësinë që bie mbi ta si anëtarë të forumit më të lartë për të gjitha problemet e Partisë dhe të shtetit, prandaj ata duhet të interesohen për çdo gjë dhe të mos kufizohen vetëm në çështjet që ata drejtojnë direkt.

Për këtë është e nevojshme që të gjithë anëtarët e Komitetit Qendror të interesohen që t'i njohin problemet e vendit, t'i studjojnë ato, të thellohen mbi to, në mënyrë që të jenë në gjendje të ndihmojnë në zgjidhjen e drejtë të tyre.

2. — Byroja Politike si organ ekzekutiv i Komitetit Qendror duhet të ketë parasysh që çështjet më të rëndësishme të Partisë dhe të shtetit, planet ekonomike, problemet e fshatit, problemi ideologjik në Parti, çështjet e forcimit organizativ të Partisë, të forcimit të organeve të drejtësisë sonë popullore, problemi i punës me kuadrin etj. të shtrohen për shqyrtim dhe aprovim para Komitetit Qendror të Partisë. Të gjitha këto çështje duhet të studjohen dhe të përpunohen në mënyrë marksiste-leniniste, duke u mbështetur në eksperiencën e madhe të Partisë Bolshevike dhe në eksperiencën e Partisë sonë.

Byroja Politike e Komitetit Qendror duhet të kujdeset që të

mbajë në dorë mirë të gjitha çështjet e rëndësishme të Partisë e të shtetit.

Sekretariati i Komitetit Qendror duhet të forcojë drejtimin operativ në zgjidhjen e çështjeve të përditshme të Partisë e në ndjekjen e zbatimit të vendimeve të Komitetit Qendror e të Byrosë Politike dhe të ngrejë vazhdimisht para Byrosë Politike problemet që dalin. Prandaj të forcohet Sekretariati i Komitetit Qendror, duke u shtuar, përveç Sekretarit të Përgjithshëm të Partisë, numri i sekretarëve në 5 vetë. Sekretariati i Komitetit Qendror duhet të tregojë më shumë kujdes për forcimin e udhëheqjes së Partisë në organizatat e masave dhe për aktivizimin më të madh të këtyre organizatave.

Byroja Politike duhet të tregojë kujdes të veçantë për problemet ekonomike të vendit dhe të thellohet mirë në këto probleme. Këshilli i Ministrave kolektivisht t'i ndjekë më mirë çështjet ekonomike, të thellohet më shumë në to dhe problemet më të rëndësishme t'i ngrejë vazhdimisht para Byrosë Politike.

3. — Duhet të forcohet udhëheqja kolektive në komitetet e Partisë të rretheve duke u shtruar atje nga ana e byrove të gjitha problemet më të rëndësishme të rrethit dhe duhet të aktivizohen të gjithë anëtarët e komiteteve për zgjidhjen me sukses të të gjitha detyrave që ka komiteti.

II

TË FORCOHET PARTIA NGA PIKËPAMJA ORGANIZATIVE, TË ZHVILLOHET MË SHUMË DEMOKRACIA E BRENDSHME NË PARTI, TË FORCOHET KRITIKA DHE AUTOKRITIKA NË PARTI

Detyrat e mëdha që kemi përpara kërkojnë patjetër forcimin më të madh të vetë Partisë, në mënyrë që organizatat e Partisë të luajnë rolin e tyre të pararojës në gjithë sektorët e punës.

Për forcimin e Partisë duhet të zhvillohet më tej demokracia e brendshme në Parti, të shtohet kombativiteti i anëtarëve të Partisë për kryerjen e detyrave, të krijohet një atmosferë intransigjente kundër gabimeve dhe të metave të njëri-tjetrit, duke pasur parasysh që të ruhen parimet e Partisë, të luftohen familjariteti dhe liberalizmi, të forcohen kritika dhe autokritika në Parti, të luftohet tendenca e të kënaqurit me pak dhe e mendjemadhësisë.

Organet udhëheqëse të Partisë të tregojnë kujdes të veçantë për forcimin organizativ të Partisë, për jetën e brendshme të Partisë, për zbatimin e plotë të parimit kryesor mbi të cilin ndërtohet

Partia — centralizmi demokratik — të luftohet për bolshevizimin e Partisë. Drejtoria e organizimit pranë Komitetit Qendror dhe seksionet e organizimit të komiteteve të Partisë të rretheve, t'u kushtojnë kujdes të madh këtyre çështjeve që kanë të bëjnë me problemin jetik të forcimit të brendshëm të Partisë.

1. — Të forcohet kritika dhe autokritika në gjirin e Byrosë Politike dhe të Komitetit Qendror, sepse pa kritikë dhe autokritikë të shëndoshë parimore, nuk mund të ketë unitet të vërtetë mendimi e veprimi. Byroja Politike si dhe anëtarët e Komitetit Qendror, të japin llogari për punën e tyre para Komitetit Qendror, sepse kjo është konditë e domosdoshme për zhvillimin e kritikës nga poshtë. Kritika duhet të jetë parimore, e ashpër dhe e drejtuar kundër kujtdo qoftë pa marrë parasysh meritat e së kaluarës dhe përgjegjësitë që ai ka dhe pa u drojtur se mos atij i prishet qejfi ose i preket autoriteti. Në Komitetin Qendror dhe në Byronë Politike duhet të mos lejohen në asnjë mënyrë toleranca dhe lëshimet ndaj gabimeve të njëri-tjetrit, të luftohet familjariteti dhe të goditen me ashpërsi të gjitha të metat dhe gabimet në punë, shfaqjet jo të drejta, neglizhenat. Anëtarët e Komitetit Qendror të jenë intransigjentë për luftimin e këtyre shfaqjeve.

2. — Të forcohet kritika dhe autokritika në komitetet e Partisë të rretheve dhe në organizatat bazë duke pasur parasysh ato që thuhën për Komitetin Qendror. Byrotë e rretheve të japin llogari rregullisht për veprimtarinë e tyre para komiteteve dhe të zhvillohet kritika e shëndoshë ndaj të metave të njëri-tjetrit si edhe ndaj të metave të byrosë; të thirren një herë në 3 muaj aktivet e Partisë dhe të inkurajohet kritika e autokritika; në organizatat bazë të zhvillohet kritika dhe autokritika e rreptë e anëtarët e thjeshtë të mos druhen të kritikojnë këdo qoftë — sekretarin ose përgjegjësën kryesor të punës.

3. — Të zhvillohet më tej demokracia e brendshme në Parti, prandaj të inkurajohet pjesëmarrja aktive e masës së Partisë në zgjidhjen e çështjeve të Partisë, duke mbajtur parasysh mësimin e Partisë Bolshevike sipas të cilit demokracia nuk qëndron vetëm në zgjedhjet demokratike. . . Demokracia e vërtetë qëndron në faktin që në organizatën e partisë të veprojnë masa e partisë, që masa e partisë të zgjidhë si çështjet e partisë, ashtu edhe çështjet e përgjithshme praktike. Kjo duhet të bëjë që të shtohet përgjegjësia e gjithë anëtarëve të Partisë për zgjidhjen e problemeve të Partisë. Për këtë është e nevojshme që rregullisht në organizatat bazë, në aktive e në konferenca të rretheve të jepet llogari nga organet e zgjedhura dhe të shtrohen çështjet më me rëndësi për t'u gjykuar nga masa e Partisë.

4. — Duke marrë parasysh rëndësinë e madhe që kanë për forcimin e Partisë zhvillimi i kritikës nga poshtë dhe i demokracisë së

brendshme në Parti, të goditen me ashpërsi të gjitha shfaqjet dhe të gjithë ata që pengojnë zhvillimin e kritikës nga poshtë në çdo formë qoftë.

5. — Të inkurajohet jo vetëm kritika nga masat e Partisë mbi organet e zgjedhura, por edhe kritika e masave punonjëse mbi Partinë.

Shtypi i Partisë të forcojë më tepër kritikën. Forcimi i kritikës dhe i autokritikës është konditë e domosdoshme për edukimin dhe kalitjen bolshevike të kuadrove, për forcimin e vigjilencës revolucionare, për zbulimin e armiqve dhe të elementëve të dyshimtë, për të luftuar dhe likuiduar të metat dhe gabimet që pengojnë ecjen përpara dhe zhvillimin e punës së madhe që ka Partia. Forcimi i kritikës dhe i autokritikës është i domosdoshëm për luftimin e të gjitha shfaqjeve të huaja dhe për bolshevizimin e Partisë.

Kritika dhe autokritika është konditë e domosdoshme dhe ligj për zhvillimin dhe konsolidimin e demokracisë sonë popullore dhe për shkuarjen në socializëm.

III

TË FORCOHET LUFTA KUNDËR ARMIQVE TË KLASËS DHE ÇDO SHFAQJEJE TË HUAJ NË PARTI, TË FORCOHET VIGJILENCA REVOLUCIONARE E PARTISË

Të mbahet parasysh nga e gjithë Partia se fitoret tona nuk e zbutin luftën e klasave, por e ashpërsojnë atë. Armiku para suksesive tona, i dëshpëruar nga humbjet që pëson, egërsohet dhe intensifikon përpjekjet e tija për restaurim, duke përdorur forma të ndryshme e gjithnjë më të reja. Prandaj gjithnjë e më shumë duhet shtuar vigjilencia revolucionare e Partisë për zbulimin e armiqve dhe duhet të forcohet lufta e Partisë për zhdukjen e tyre.

1. — Të forcohet lufta kundër armikut të klasës në fshat, kundër kulakut. Partia të shpejtojë identifikimin e kulakëve, të marrë masa për kufizimin ekonomik dhe të luftojë për izolimin politik të tyre duke demaskuar veprimtarinë e tyre armiqësore dhe duke tërhequr në këtë luftë fshatarësinë e varfër në radhë të parë dhe fshatarësinë e mesme.

Për këtë organet drejtuese të Partisë në rrethe dhe organizatat bazë të Partisë në fshat të zbatojnë udhëzimet e Komitetit Qendror dhe të mos lejojnë shfaqje oportuniste në zbatimin e vijës së Partisë në fshat.

Byroja Politike, Sekretariati dhe aparati i Komitetit Qendror

të kontrollojnë zbatimin e këtyre vendimeve dhe të ndihmojnë organizatat e Partisë në rrethe.

Organet shtetërore dhe ekonomike që kanë lidhje me problemet e fshatit të zhvillojnë gjithë punën e tyre, duke u mbështetur në udhëzimet e Komitetit Qendror mbi zhvillimin e luftës së klasave në fshat.

2. — Të forcohet vigjilencia revolucionare për zbulimin e aktivitetit armiqësor në ndërmarrjet ekonomike, në administrata dhe veçanërisht në tregëti. Mosrealizimi i planit, shpërdorimet dhe dëmtimet e pasurisë së shtetit, vjedhjet dhe abuzimet, sjelljet arrogante dhe të shkujdesshme ndaj kërkesave dhe lutjeve të popullit, burokratizmi dhe konfuzioni, janë shfaqje të punës armiqësore, prandaj prapa këtyre duhet kërkuar armiku. Për zbulimin e punës së armikut është e nevojshme të forcohet kontrolli në punë dhe të përcaktohet mirë përgjegjësia personale.

3. — Të goditen më rreptë armiku i klasës, sabotatorët, dëmtesit e pasurisë së shtetit, shkelësit e ligjeve. Në radhë të parë është e nevojshme të goditet oportunizmi në organet gjyqësore dhe të prokurorisë dhe të merren masa efikase për përmirësimin e punës në to.

4. — Të mbahet parasysh se armiku përpiqet me të gjitha mënyrat të depërtojë në radhët e Partisë, me qëllim që, duke u fshehur prapa tesarës së Partisë, të na luftojë më lehtë. Këtë ai e përdor sot si një nga metodat kryesore të tija. Prandaj vigjilencia revolucionare duhet të forcohet brenda radhëve të Partisë. Një punë e madhe për spastrimin dhe forcimin e Partisë duhet bërë me verifikimin e dokumentave të Partisë, për të cilin duhet të tregohet një kujdes i madh nga e gjithë Partia.

Duhet të tregohet një kujdes i madh për zbulimin e armiqve brenda radhëve të Partisë, sepse ai me shumë mjeshtëri i fsheh mendimet, pikëpamjet dhe aktivitetin e tij armiqësor, duke u sjellë me hipokrizi dhe servilizëm. Për këtë arsye është e domosdoshme të luftohet me ashpërsi çdo shfaqje dhe pikëpamje e shtrembër në kundërshtim me vijën e Partisë, duke luftuar liberalizmin, oportunizmin, zemërgjerësinë, butësinë, mbeturinat mikroborgjeze, gabimet e përsëritura në punë, pse kështu i hiqet mundësia armikut që, duke u maskuar, të zhvillojë aktivitetin e tij armiqësor. Të luftohet pa mëshirë kundër çdo shfaqjeje disfatizmi të papajtueshëm me Partinë tonë luftarake dhe revolucionare.

Lufta kundër këtyre shfaqjeve duhet të forcohet jo vetëm në Parti, por edhe në organet shtetërore, në organizatat e masave dhe kudo.

Të jetë e qartë se burimi i forcës së Partisë qëndron në atë që ajo është e papajtueshme me oportunizmin dhe me çdo shfaqje armiqësore.

5. — Organet udhëheqëse të Partisë të tregojnë kujdes të madh për forcimin e punës politike të Partisë me masat, lidhur kjo me situatën ndërkombëtare e të brendshme, me ashpërsimin e luftës së klasave. Partia duhet të mobilizojë dhe të aktivizojë në këtë drejtim shumë më tepër organizatat e masave.

Drejtoria e propagandës pranë Komitetit Qendror dhe seksionet e propagandës të komiteteve të Partisë në rrethe kanë detyrë të shtojnë shumë më tepër kujdesin për këtë problem me rëndësi shumë të madhe për Partinë tonë dhe të fuqizojnë rolin e shtypit e të mjeteve të tjera të agjitacionit e të propagandës.

Forcimi i vigjilencës revolucionare është i lidhur me mbrojtjen e pavarësisë së vendit tonë, prandaj Partia duhet të edukojë gjithë masat e popullit për të qenë vigjilente dhe të gatshme për mbrojtjen e atdheut, të shtojë në to dashurinë për organet e Ministrisë së Punëve të Brendshme, për Ushtrinë tonë Popullore dhe të bëjë që çdo komunist në radhë të parë dhe çdo qytetar i Republikës sonë të bëhet një «çekist». Të forcohen gjithnjë e më shumë organet e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Ushtria jonë Popullore që janë garancia e lirisë dhe e të gjitha fitoreve të popullit tonë.

IV

TË LUFTOHET ME KËMBËNGULJE PËR NGRITJEN E NIVELIT IDEOLOGJIK NË PARTI, PËR PËRVETËSIMIN E MËSIMEVE TË MARKSIT, ENGELSIT, LENINIT DHE STALINIT

Për të drejtuar si duhet, për të vlerësuar drejt situatën, për të studjuar problemet në baza marksiste-leniniste, është e domosdoshme ngritja e nivelit ideologjik të Partisë sonë si Parti në fuqi, që ka përgjegjësi të mobilizojë dhe të drejtojë popullin tonë në socializëm.

1. — Në radhë të parë gjithë anëtarët e Komitetit Qendror duhet të punojnë vazhdimisht dhe me këmbëngulje për ngritjen e tyre ideologjike, të përpiqen për të mësuar pareshtur mësimet e Marksit, Engelsit, Leninit e Stalinit, të mësojnë nga eksperiencia e Partisë Bolshevike, të mësojnë nga jeta dhe eksperiencia e punës së Partisë sonë, të mësojnë nga populli, përndryshe nuk do të jenë në gjendje të kryejnë rolin që u është besuar dhe do të mbeten prapa.

Byroja Politike ngarkohet të konkretizojë mënyrën dhe format për ngritjen ideologjike të anëtarëve të Komitetit Qendror dhe për kontrollin e përpjekjeve që ata do të bëjnë në këtë drejtim.

2. — Gjithë kuadrot e Partisë në vende drejtuese të Partisë, të organizatave të masave dhe të organeve shtetërore duhet të shumëfishojnë përpjekjet për ngritjen e tyre ideologjike, sepse pa teorinë marksiste-leniniste ata nuk do të jenë në gjendje të kryejnë si duhet detyrën e tyre. Një kujdes të veçantë duhet të tregojnë në këtë drejtim kuadrot që punojnë në arësim, kulturë, art, letërsi, shkencë, drejtësi dhe në sektorë të tjerë që kanë të bëjnë direkt me problemet ideologjike. Përpjekje të mëdha për ngritjen e tyre ideologjike duhet të bëjnë anëtarët e Partisë që punojnë në sektorin e propagandës së Partisë.

3. — Drejtoria e propagandës pranë Komitetit Qendror, komitetet e Partisë në rrethe dhe organizatat bazë duhet të punojnë për zbatimin e përpiktë të vendimit të Byrosë Politike «Mbi arësimin në Parti»¹ dhe t'i kushtojnë kujdes të veçantë përmbajtjes së punës ideologjike, të përpiqen që të zbatohet drejt lidhja e teorisë me praktikën.

Puna ideologjike me masën e Partisë duhet të shërbejë për edukimin komunist të anëtarëve të Partisë dhe t'i bëjë ata që të vënë interesat e Partisë mbi çdo gjë, të shërbejë për zhdukjen e mbeturinave mikroborgjeze dhe të paragjykimeve që ekzistojnë sidomos në komunistët e fshatit për t'i bërë ata luftëtarë për zbatimin e vijës dhe të detyrave të Partisë duke dhënë shembullin personal në punë.

Ngritja ideologjike në Parti do të forcojë vigjilencën revolucionare dhe do të shërbejë për shtimin e kombativitetit në Parti.

V

VERIFIKIMI I ZBATIMIT TË VENDIMEVE DHE TË DETYRAVE TË KONSIDEROHET SI NJË DETYRË KRYESORE NGA E GJITHË PARTIA, DUKE FILLUAR QË NGA BYROJA POLITIKE E KOMITETIT QENDROR DERI NË ORGANIZATËN BAZË TË PARTISË, SEPSE TË UDHËHEQËSH DO TË THOTË TË VERIFIKOSH ZBATIMIN E VENDIMEVE

1. — Në radhë të parë Byroja Politike duhet të ushtrojë kontroll mbi zbatimin e vendimeve të Kongresit I dhe të Konferencës II Nacionale të Partisë, të plenumeve të Komitetit Qendror dhe të vetë Byrosë, duke dëgjuar vazhdimisht raporte mbi probleme të ndryshme të Partisë e të shtetit, mbi aktivitetin e përgjithshëm të organizatave të Partisë në rrethe etj.

¹ Është fjala për vendimin e Byrosë Politike Nr. 119/2, dt. 10.V.1949 «Mbi format e instruksionit të marksizëm-leninizmit në Parti».

2. — Sekretariati i Komitetit Qendror duhet të marrë masa efikase për përmirësimin e punës në aparatet e Komitetit Qendror në mënyrë që ky aparat të kryejë siç duhet detyrën e tij kryesore, që është verifikimi i zbatimit të vendimeve.

3. — Të ndihmohen më shumë organizatat e Partisë në rrethe nga anëtarët e Komitetit Qendror e të Byrosë Politike, nga sekretarët e Komitetit Qendror dhe nga aparatet e Komitetit Qendror. Të praktikohet dërgimi i anëtarëve të Komitetit Qendror në rrethe, sepse kjo do të shërbejë jo vetëm për të ndihmuar bazën, por edhe për njohjen më mirë të problemeve të Partisë nga anëtarët e Komitetit Qendror dhe do t'i bëjë ata që të jenë më në gjendje të ndihmojnë në zgjidhjen e drejtë të çështjeve.

4. — Komitetet e Partisë në rrethe, udhëheqjet e organizatave të masave dhe organet shtetërore duhet gjithashtu të përmirësojnë rrënjësisht verifikimin e zbatimit të vendimeve. Komitetet e Partisë në rrethe duhet t'i kushtojnë një kujdes të veçantë ndjekjes së jetës së organizatave bazë dhe t'i ndihmojnë ato sa më shumë në vend.

5. — Të vendoset një regjim i fortë kontrolli në punë, në mënyrë të atillë që asnjëri të mos mund t'i shpëtojë përgjegjësisë personale të mbetet pa u përgjegjur dhe pa dhënë llogari për moskryerjen e detyrave. Kontrolli në punë të shoqërohet me masa efikase për përmirësimin e gjendjes dhe për të dënuar neglizhuesit në punë.

6. — Të luftohet burokratizmi, javashllëku dhe lëshimet dhe të forcohet operativiteti.

Vetëm duke u forcuar në këtë mënyrë kontrolli për zbatimin e vendimeve, udhëheqja do të njohë më mirë situatën, do të jetë në korrent të jetës dhe të problemeve që dalin dhe kështu do të mund të marrë në kohën e duhur masat e nevojshme. Vetëm kështu udhëheqja do të mund jo vetëm të ndihmojë në zbatimin e vendimeve, por do të vërtetojë në jetë saktësinë e vendimeve të marrura.

VI

PARTIA DUHET TË TREGOJË MË SHUMË KUJDES PËR KUADROT, SEPSE BESIMI POLITIK DHE AFTËSIA E TYRE LUAJNË NJË ROL VENDIMTAR PËR MBARËVAJTJEN E GJITHË PUNËVE DHE SEPSE ARMIKU PËRPIQET QË ME TË GJITHA MËNYRAT TË INFILTROHET NË VENDET MË ME RËNDËSI

1. — Duke pasur parasysh se Drejtoria e kuadrit pranë Komitetit Qendror dhe seksionet e kuadrit në rrethe u suprimuan dhe meqenëse në punën me kuadrin janë vërtetuar të meta, del nevoja

e një kujdesi më të madh në zgjedhjen, vendosjen dhe përgatitjen e kuadrit dhe sidomos për ngritjen me kurajë të elementit punëtor.

2. — Të shpejtohet puna për zbatimin e vendimeve të Komitetit Qendror të Partisë në lidhje me spastrimin e aparateve shtetërore nga elementët armiq që janë futur kontrabandë.

3. — Të merren masa për forcimin e aparateve të Partisë dhe veçanërisht në rrethe, duke i zgjedhur kuadrot me një aftësi më të madhe se sa i kemi dhe duke pasur parasysh që në aparatet e Partisë të zgjidhen kuadro me garanci.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

*Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

REZOLUCION

I PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH «MBI DISA ANËTARË TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH QË KANË VEPRUAR NË KUNDËRSHTIM ME VIJËN E PARTISË»

23 shkurt 1951

I

MBI VEPRIMTARINË OPORTUNISTE TË SHOKUT TUK JAKOVA

Nga analiza që i bëri Plenumi IX i Komitetit Qendror të PPSH të gjithë veprimtarisë së shokut Tuk Jakova, anëtar i Byrosë Politike dhe sekretar i Komitetit Qendror, u konstatua se veprimtaria e shokut Tuk Jakova si udhëheqës dhe si komunist, që nga viti 1943 dhe deri sot, karakterizohet nga një oportunizëm i thellë, liberalizëm i patolerueshëm, mungesë urrejtje në masën e duhur kundrejt armikut të klasës, mungesë të vigjilencës revolucionare, mungesë përpjekjesh për ngritjen ideologjike personale dhe neglizhenca serioze në kryerjen e detyrave që i ka pasë ngarkuar Partia.

Të gjitha këto të meta serioze në personin e shokut Tuk Jakova e kanë origjinën në vetë jetën dhe edukatën e shokut Tuk, në ambientin mikroborgjez në të cilin ai është rritur, në influencën e frymën fetare katolike në edukatën e tij, në presionin e borgjezisë reaksionare kundrejt Partisë sonë në përgjithësi dhe kundrejt shokut Tuk veçanërisht.

1. — Nga ish-grupi komunist i Shkodrës, si anëtar i këtij grupi, shoku Tuk ka trashëguar frymën e familjaritetit të sëmurë, frymën e kënaqësisë në vetëvete, të nënvleftësimit të armikut, të zemërgjerësisë mikroborgjeze, të mungesës së vigjilencës. Këto karakteristika janë manifestuar te shoku Tuk gjatë gjithë punës së tij që nga formimi i Partisë dhe deri sot. Ai ka qenë kritikuar

vazhdimisht nga udhëheqja e Partisë për këto të meta serioze, por autokritikat e tija në drejtim të këtyre të metave nuk kanë qenë të thella dhe të plota dhe nuk janë vënë në jetë prej tij.

2. — Shoku Tuk Jakova praktikisht ka menduar dhe ka vepruar në kundërshtim me vijën politike të Partisë. Kapitullimin e Ymer Dishnicës në Mukje, në kundërshtim me të gjithë Partinë që e kuptoi dhe e dënoi kategorikisht këtë veper armiqësore të Ymer Dishnicës, shoku Tuk Jakova e ka kuptuar shumë vonë. Për një kohë të gjatë pas Mukjes, shoku Tuk ka ruajtur në kokën e tij idenë e nënvleftësimit të rrezikut që i vinte Partisë dhe popullit nga kapitullimi i Ymer Dishnicës në Mukje. Dhe ajo që është më e keqe, shoku Tuk Jakova këtë gjë nuk ja ka pasë deklaruar Partisë asnjëherë deri në Plenumin IX të Komitetit Qendror, shkurt 1951.

Në Plenumin V të Komitetit Qendror, më 1946 shoku Tuk Jakova, si anëtar i Komitetit Qendror, nuk ka mbajtur qëndrim të prerë kundrejt vijës oportuniste dhe liberalo-borgjeze të Sejfulla Malëshovës, e cila u dënua në këtë plenum. Edhe në këtë rast shoku Tuk Jakova e ka kuptuar me vonesë të madhe rrezikun që i vinte Partisë dhe popullit nga oportunizmi dhe liberalizmi borgjez i Sejfulla Malëshovës. Dhe këtë fakt, të kuptuarit me vonesë të këtij rreziku dhe nënvleftësimin e tij për një kohë, shoku Tuk nuk ja ka thënë Partisë asnjëherë deri në Plenumin IX të Komitetit Qendror, shkurt 1951.

Veprimtarinë armiqësore të grupit antiparti të kryesuar nga Abedin Shehu, shoku Tuk Jakova nuk e ka kuptuar si duhet; ai ka vazhduar deri sot ta nënvleftësojë në mënyrë të patolerueshme rrezikun titist për Partinë tonë. Ndërsa e gjithë Partia dhe i gjithë populli e kanë pasë konsideruar dhe e konsiderojnë vetëvrasjen e armikut, Niazi Islami, si një akt i kryer nga një armik kundër Partisë dhe popullit, shoku Tuk Jakova ka vazhduar deri këto ditët e fundit që ta konsideronte vetëvrasjen e armikut, Niazi Islami, si një akt të kryer jo nga një armik, por nga një «kokëfortë». Shoku Tuk, në kundërshtim me Partinë, e ka konsideruar Niazi Islamin jo armik, por «kokëfortë» dhe megaloman.

Në kundërshtim me vijën politike të Partisë dhe të shtetit në drejtim të klerit katolik, shoku Tuk Jakova ka vepruar haptas kundër kësaj vije deri këto ditët e fundit. Ai praktikisht nuk ka qenë dakord me vijën e Partisë dhe të shtetit në drejtim të klerit katolik. Ka nënvleftësuar veprimtarinë armiqësore të hierarkëve të klerit katolik e marrëdhënjet personale që ai ka mbajtur me disa nga këta hierarkë kanë qenë të atilla që e kanë dëmtuar rëndë Partinë. Shoku Tuk u ka lënë atyre përshtypjen se do të ishte përkrahësi i pikëpamjeve të tyre për aprovimin e statutit të tyre nga qeveria, statut i cili është në kundërshtim me ligjet e shtetit tonë, i ka

prité dhe përcjellë priftërinjtë katolikë reaksionarë në shtëpinë e tij me një përzemërsi borgjeze dhe të patolerueshme, bile dikujt prej tyre i ka dhënë edhe ndihmë ekonomike në të holla. Në qoftë se hierarkët reaksionarë të klerit katolik kanë përhapur fjalën kudo se «statuti i tyre do të aprovohet medoemos nga qeveria», kjo ka rrjedhur nga shpresa e madhe që ata kanë pasur në shokun Tuk Jakova si udhëheqës në Parti dhe në shtet për t'u dhënë atyre mbështetjen e duhur.

Në kundërshtim me vijën e Partisë, e cila është për zhvillimin e luftës së klasave dhe për forcimin e urrejtjes kundër armikut të klasës nga ana jonë, shoku Tuk Jakova jo vetëm që nuk e ka forcuar këtë urrejtje, por në të kundërtën ai e ka zbutur atë shumë. Në shtëpinë e shokut Tuk Jakova, sidomos gjatë vitit 1950, janë pritë dhe përcjellë prej tij çfarëdo elementësh të pakontrolluar, midis tyre edhe elementë kundërshtarë të pushtetit tonë. Shoku Tuk është treguar një mikpritës shumë i mirë me këta elementë kundërshtarë ashtu sikurse me miqtë e pushtetit. Ai nuk ka bërë dallimin midis miqve dhe armiqve. Për atë, lufta e klasave duhej të shkonte drejt shuarjes. Të gjithë këta elementë antipushtet dhe armiq kanë shkuar me qëllim të shoku Tuk dhe te ai kanë gjetur edhe përkrahjen, e cila është shprehur me ndërhyrjet e vazhdueshme të shokut Tuk pranë organeve të pushtetit për t'u bërë atyre favore. Kështu ka ndodhur p.sh. që me ndërhyrjen e shokut Tuk u lirua nga burgu një armik, i cili, porsa doli nga burgu, u arratis në mal etj.

Të gjitha këto tregojnë se shoku Tuk Jakova praktikisht ka qenë në opozitë me vijën politike të Partisë.

3. — Shoku Tuk Jakova, në kundërshtim me politikën ekonomike të Partisë dhe të shtetit, ka ruajtur në kokën e tij gjatë vitit 1949, idenë se plani ekonomik i shtetit në disa sektorë, e sidomos në atë të naftës, ka qenë gjoja joreal. I inspiruar nga ideja krejtësisht e gabuar se gjoja plani në këta sektorë nuk ka qenë real, shoku Tuk nuk i ka mobilizuar organizatat e Partisë dhe të masave në rrugën e drejtë për realizimin e planit. Ai vetë ka qenë pesimist për realizimin e planit në këta sektorë dhe prandaj nuk mund të luftonte efektivisht që organizatat e Partisë dhe të masave të kishin besim në realizimin e planit.

4. — Si sekretar i Komitetit Qendror për kuadrot, shoku Tuk Jakova nuk e ka kryer detyrën dhe ka bërë gabime e lëshime serioze. Ai nuk ka zbatuar vendimet e Kongresit I në drejtim të politikës së kuadrit. E ka gjykuar kuadrin vetëm në mënyrë burokratike, që nga zyra, nuk ka ndjekur zhvillimin e kuadrit në punë. Ai nuk ka ngritur në masën e duhur kuadrin e ri dhe me perspektivë dhe, nga ana tjetër, nuk ka pastruar aparatet e shtetit nga elementët e padëshirueshëm dhe armiq.

5. — Si sekretar i Komitetit Qendror për organizatat e Partisë dhe të masave, shoku Tuk Jakova nuk e ka kryer detyrën. Ai e ka drejtuar këtë sektor jetik për Partinë në mënyrë krejt burokratike, vetëm nëpërmjet shkresave nga zyra. Që nga Plenumi XI i Komitetit Qendror¹ dhe deri këto kohët e fundit ai nuk ka vajtur asnjëherë personalisht në organizatat e Partisë dhe të masave në terren për të parë në praktikë si zbatohet vija e Partisë. Duke qenë i frymëzuar për veten e tij nga nënvleftësimi i punës armiqësore, nga nënvleftësimi i luftës së klasave, nga të kënaqurit në vetëvete me pak, nga mungesa e vigjilencës dhe nga neglizhenca në detyrë, shoku Tuk jo vetëm që nuk ka punuar si duhet për të forcuar demokracinë e brendshme në Parti, për të forcuar kritikën dhe autokritikën në organizatat e Partisë, por, në të kundërtën, ai ka lejuar që kritika dhe autokritika në Parti dhe në organizatat e masave të nënvleftësohet, të neglizhohet, të dobësohet, gjë e cila i ka sjellë dëme serioze Partisë. Shoku Tuk Jakova, si udhëheqës kryesor në Parti duhej të luftonte për forcimin e demokracisë së brendshme të Partisë. Por ai vetë, me shembullin dhe me punën e tij e ka dobësuar kritikën dhe autokritikën, e ka dobësuar demokracinë e brendshme, luftën e klasave, vigjilencën në Parti.

Në vend që të ishte i pari që të luftonte për forcimin organizativ dhe politik të Partisë, si sekretar i Komitetit Qendror, shoku Tuk ka qenë i pari që i ka thyer rregullat organizative të Partisë. Ai ka shkelur për një kohë të gjatë rregullin organizativ për rifutjen në Parti të elementëve të përjashtuar nga Partia, duke i futur këta jashtë kontrollit të Byrosë Politike dhe të Sekretariatit si edhe pa asnjë konsultim me organizatat bazë të interesuara. Dhe në këtë mënyrë ai ka bërë që të futeshin në Parti një sërë elementësh të padëshirueshëm vetëm me iniciativën e kolegjiut² pranë Komitetit Qendror dhe me aprovimin personal të tij. Ai ka qenë përkrahësi kryesor i idesë së gabuar për procedurën e verifikimit të dokumentave të Partisë, sipas së cilës këto dokumenta duhej të verifikoheshin jashtë kontrollit të masës së Partisë, jashtë mbledhjeve të organizatave bazë të Partisë. Këto shkelje të vijës organizative të Partisë nga Tuk Jakova u ndreqën nga udhëheqja e Partisë, por me vonesë dhe, edhe kjo punë e shokut Tuk, i ka shkakuar dëme Partisë.

1 Është fjala për Plenumin XI të KQ të PKSH, shtator 1948.

2 Pas Plenumit XI të KQ të PKSH (shtator 1948) u krijua kolegjiut pranë KQ të PPSH që merrej me shqyrtimin e ankesave dhe të letrave të komunistëve. Ky kolegjiut ekzistoi deri në Kongresin III të PPSH (maj 1956), i cili në vend të tij zgjodhi Komitetin e Kontrollit pranë KQ të PPSH. Ndërsa me ndryshimet në Statutin e PPSH nga Kongresi V i PPSH (nëntor 1966) u krijua Komisioni Qendror i Kontrollit dhe i Revizionimit.

Shoku Tuk Jakova nuk është kujdesur pothuajse aspak për forcimin e organizatave të masave. Ai gjithashtu nuk e ka kryer detyrën në lidhje me drejtimin e drejtorive të aparatit të Komitetit Qendror për sektorin ekonomik, të cilat kanë qenë nën vartësinë e tij. Roli i këtyre drejtorive dhe drejtimi i tyre nga ana e shokut Tuk kanë qenë pothuajse hiç; dhe kjo gjë, d.m.th. mosfunksionimi i drejtorive ekonomike kryesore të Komitetit Qendror, e ka dëmtuar Partinë në masë të konsiderueshme.

6. — Shoku Tuk Jakova, në vend që të jepte shembullin e mirë dhe të studjonte për të ngritur nivelin e tij politik dhe ideologjik, ka dhënë shembullin e keq. Ai nuk ka studjuar marksizëm-leninizmin pothuajse fare gjatë kohës që është sekretar i Komitetit Qendror. Ai nuk ka vënë në praktikë akoma eksperiencën e Partisë Bolshevike të sjellë në vendin tonë nga delegacioni i Partisë gjashtë muaj më parë dhe bile akoma edhe sot ai as nuk ka lexuar materialin që ka prurë ky delegacion në lidhje me çështjet e brendshme të Partisë. Kjo nuk është vetëm një neglizhencë skandaloze nga ana e shokut Tuk, por është, njëkohësisht, dhe një moskonsiderim i patolerueshëm dhe shumë i dëmshëm ndaj eksperiencës së Partisë Bolshevike dhe Bashkimit Sovjetik. Që shoku Tuk ka pasur një moskonsiderim të tillë për eksperiencën e Partisë Bolshevike dhe Bashkimit Sovjetik, kjo duket edhe nga fakti se ai gjatë këtyre dy viteve të fundit ka pasur fare pak takime me shokët sovjetikë në Shqipëri për të biseduar me ta dhe për të përfutur nga eksperiencia e tyre. Të gjitha sa u thanë më lart tregojnë qartë se shoku Tuk Jakova ka qenë për një kohë të gjatë në opozicion praktik me vijën e Partisë, sado që këtë opozicion të tij ai nuk e ka pasë deklaruar kurrë. Kjo veprimtari dëmprurëse e shokut Tuk për Partinë e ka rrënjën në pikëpamjet thellësisht oportuniste dhe liberalo-borgjeze të tija. Këto pikëpamje të dëmshme janë kristalizuar në një vijë të tërë oportuniste në praktikë të shoku Tuk Jakova. Në rast se Partia do të ishte vënë në rrugën oportuniste të shokut Tuk Jakova, kjo patjetër do të çonte në likuidimin e Partisë dhe të pushtetit tonë popullor. Kjo punë oportuniste e shokut Tuk Jakova nuk ka qenë dënuar më parë siç dënohet sot, jo vetëm për faktin se sot kjo punë e dëmshme e shokut Tuk është bërë shumë e qartë prej vetë fakteve konkrete, por nga shkak se në Byronë Politike ka munguar kritika dhe autokritika bolshevike. Vendosja e kritikës dhe e autokritikës bolshevike në Byronë Politike bëri që këto veprime të dëmshme të shokut Tuk Jakova të sqaroheshin, të dënoheshin dhe t'i paraqiteshin Plenumit të Komitetit Qendror, i cili i aprovoi plotësisht dhe i zhvilloi edhe më tej konkluzionet e Byrosë Politike mbi veprimtarinë e shokut Tuk Jakova.

Në Plenumin IX të Komitetit Qendror ku u shtrua çështja e

shokut Tuk Jakova, predominoi fryma e kritikës dhe e autokritikës së shëndoshë. Shoku Tuk bëri autokritikën e tij para plenumit. Kjo autokritikë konsiderohet e kënaqshme. Por shoku Tuk Jakova, në të ardhshmen, duhet të thellohet edhe më tej në autokritikën e tij, të analizojë më gjerë dhe më thellë shkaqet e gabimeve dhe të fajeve të tij.

II

MBI QËNDRIMIN KAPITULLUES TË SHOKËVE THEODHOR HEBA DHE MANOL KONOMI.

Shokët Theodor Heba dhe Manol Konomi, që të dy anëtarë të Komitetit Qendror të zgjedhur nga Kongresi I i Partisë, të influencuar plotësisht nga presioni i borgjezisë reaksionare të brendshme dhe nga imperializmi në përgjithësi, janë treguar frikacakë dhe kapitullantë përpara vështirësive dhe përpara detyrave që u ka pasë besuar Partia. Shoku Theodor Heba jo vetëm që ka një përgjegjësi shumë të madhe për gabimet e rënda që janë vërtetuar në zbatimin e politikës së kuadrove si drejtor i Drejtorisë së kuadrove pranë Komitetit Qendror, por ai vetë ka pohuar se këto gabime kanë qenë refleksi i presionit të borgjezisë mbi të që nga viti 1945 e deri sot, se e ndjen veten jo të aftë për detyrat që i janë ngarkuar etj. Ai ka pohuar përpara Plenumit të Komitetit Qendror se deri sot nuk ka lexuar as «Historinë e Partisë Bolshevike», gjë e cila është e turpshme dhe e palejueshme edhe për një anëtar të thjeshtë partie dhe jo më për një anëtar të Komitetit Qendror. Autokritika e shokut Theodor Heba para Plenumit të Komitetit Qendror ka qenë fare përtokë, i gjithë plenumi ka mbetur fare i paqartë rreth qëndrimit të shokut Theodor Heba. Ai vetë deklaroi përpara plenumit se ka jetuar thellësisht nën presionin e armiqve të brendshëm dhe të jashtëm dhe se duke u nisur nga kjo ka arritur ta konsiderojë veten e tij si krejtësisht të pazotin. Por plenumi nuk është i qartë mbi mënyrën dhe masën se si presioni i armikut ka influencuar te shoku Theodor Heba dhe nga ana tjetër nuk beson në asnjë mënyrë që shoku Theodor të jetë «pa asnjë aftësi» siç ka deklaruar ai vetë. Prandaj plenumi e konsideron qëndrimin e shokut Theodor Heba si kapitullues, e konsideron shokun Theodor Heba si dezertor nga fronti i luftës së Partisë dhe të padenjë që të bëjë pjesë në Komitetin Qendror të Partisë.

Shoku Manol Konomi deklaroi vetë se zgjedhjen e tij nga Kongresi I si anëtar të Komitetit Qendror nuk e ka pritur me qejf,

gjoja se i mungojnë aftësitë. Ai gjithashtu ka kërkuar disa herë rresht që të shkarkohej nga detyra si ministër i drejtësisë, gjoja për paaftësi. Gjatë kohës si ministër i drejtësisë ai nuk është treguar në lartësinë e duhur dhe ka përkrahur elementin borgjez dhe reaksionar që ka penetruar në organet e drejtësisë, është treguar thëllësisht oportunist në zbatimin e ligjshmërisë së shtetit tonë dhe është treguar frikacak nga ashpërsimi i luftës së klasave. Plenumi i Komitetit Qendror nuk mbeti aspak i kënaqur nga autokritika e shokut Manol Konomi. Plenumi nuk mund të besojë se shokut Manol i mungojnë aftësitë praktike dhe është i bindur se të gjitha këto shfaqje të shoku Manol janë shprehja e presionit të armiqve të brendshëm dhe të jashtëm mbi atë dhe në këtë mënyrë e konsideron shokun Manol si kapitullues përpara vështirësive, si dezertor nga fronti i luftës së Partisë dhe të padenjë që të bëjë pjesë në Komitetin Qendror të Partisë.

Duke analizuar veprimtarinë oportuniste të shokut Tuk Jakova, si dhe qëndrimin kapitullues të shokëve Theodor Heba dhe Manol Konomi, Plenumi IX i Komitetit Qendror,

V e n d o s i :

1. — Shoku Tuk Jakova të shkarkohet nga përgjegjësia si anëtar i Byrosë Politike dhe sekretar i Komitetit Qendror. Ai të mbetet anëtar i Komitetit Qendror, duke marrë parasysh luftën që ai ka bërë dhe meritat e tjera të tija e me shpresë se ai do të bëjë një kthesë rrënjësore në veten e tij duke u vënë definitivisht në rrugën e Partisë.

2. — Shokët Theodor Heba dhe Manol Konomi të përjashtohen nga Komiteti Qendror. T'i rekomandohet qeverisë që të rishqyrtojë çështjen e postit të shokut Manol Konomi si ministër i drejtësisë, duke e hequr këtë nga ky post.

*
* * *

Të gjitha organizatat e Partisë duhet të mësojnë sa më shumë nga gabimet dhe fajet e shokëve Tuk Jakova, Theodor Heba dhe Manol Konomi. Duhet që çdo komunist t'i bëjë një analizë të thëllë veprimtarisë së tij, të gjejë gabimet dhe të metat në personin e tij dhe t'i luftojë këto me vendosmëri. E gjithë Partia, në mënyrë të vazhdueshme duhet të jetë e mobilizuar në këto drejtime.

a) Të kuptohet nga çdo komunist se këto gabime të rënda shfaqen atëhere kur nuk është e qartë lufta e klasave, atëhere kur

njeriu dehet nga sukseset, kur lind te ai mendjemadhësia, kur duken shfaqje të të kënaqurit me pak.

b) Të luftohet pa asnjë hezitim çfarëdo shfaqje oportuniste, mbeturinat borgjeze e mikroborgjeze të komunistëve siç janë: fanatizmi, hatëri, fodullëku, shpirtbutësia kundrejt armikut, hezitimi përpara vështirësive, mungesa e shpirtit të sakrificës etj.

c) Të forcohen vigjilencat revolucionare dhe disiplina e çel-niktë bolshevike. Këto mund të bëhen vetëm nëpërmjet forcimit të kritikës dhe të autokritikës në Parti, nëpërmjet forcimit të demokracisë së brendshme.

ç) Të zhvillohet lufta e klasave, duke forcuar urrejtjen kundër armikut të klasës dhe duke forcuar luftën e organizuar kundër presionit të armiqve të brendshëm dhe të jashtëm.

d) Të ngrihet niveli politik dhe ideologjik i çdo komunisti si dhe i atyre pa parti. Çdo komunist, nga koha në kohë, bile çdo ditë, duhet t'i bëjë pyetjen vetes: «sa kam mësuar unë sot, sa jam ngritur politikisht dhe sa kam punuar për të ndihmuar edhe të tjerët që s'janë në Parti për t'u ngritur politikisht dhe ideologjikisht».

dh) Të forcohet dashuria kundrejt Bashkimit Sovjetik, Partisë Bolshevike dhe shokut Stalin dhe kjo dashuri duhet të shprehet jo vetëm me fjalë e në forma sentimentale, por konkretisht në punë, me vepra, me zbatimin e detyrave që na ka ngarkuar Partia dhe populli, me mbrojtjen e vijës së Partisë.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Botohet sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

PROKLAMATË

E KOMITETIT QENDROR TË PPSH ME RASTIN E 10-VJETORIT TË THEMELIMIT TË PARTISË

10 prill 1951

Popull shqiptar,

Dhjetë vjet më parë, më 8 Nëntor 1941, u themelua Partia Komuniste, sot Partia e Punës e Shqipërisë.

Partia u ngrit mbi parimet organizative të Partisë ngadhënjimtare Bolshevike dhe e bëri të sajën teorinë pararojë revolucionare, marksizëm-leninizmin. Ajo u bë parti e një tipi të ri, përfaqësuese e interesave të klasës punëtore dhe të masave punonjëse të vendit tonë dhe luftëtare e vendosur dhe konsekuente për mbrojtjen e të drejtave të tyre.

Themelimi i Partisë është një ngjarje me rëndësi të madhe historike për popullin tonë. Me organizimin e Partisë u krijua për herë të parë në Shqipëri një udhëheqje politike popullore, e organizuar dhe e aftë për të drejtuar popullin në luftë për çlirimin e atdheut dhe për realizimin e aspiratave të tija shekullore. Feudoborgjezia me regjimin e saj të Zogut shfrytëzoi tmerrësisht masat punonjëse, i pregatiti terrenin fashizmit, e ndihmoi këtë në okupimin e vendit, në shtypjen dhe në shfrytëzimin e popullit tonë. Me themelimin e Partisë masat punonjëse, me klasën punëtore në krye, vepruan me vendosmëri në arenën politike të vendit, me perspektiva të qarta e besim të patundur në çlirimin e atdheut e në realizimin e aspiratave të tyre.

Nën drejtimin e Partisë populli ynë bëri një kthesë në historinë e tij. I udhëhequr dhe i edukuar nga Partia, populli u mobilizua në Frontin Nacional-Çlirimtar, në luftë kundër okupatorëve dhe tradhëtarëve, luftoi me heroizëm të papërshkrueshëm kundër armiqve shumë herë më të mëdhenj dhe të armatosur me armët më moderne, çliroi vendin dhe u bë zot i fateve të tij.

Populli shqiptar, i udhëhequr nga Partia, organizoi dhe ngriti në luftë e sipër, shtetin dhe ushtrinë e tij popullore, si armë të fuqishme për çlirimin e atdheut, për vendosjen e demokracisë

popullore, për ndërtimin e socializmit dhe për mbrojtjen e vendit.

Aparati i shtetit fashist dhe i feudoborgjezisë si dhe forcat e armatosura të tyre u shkatërruan fund e krye. I gjithë pushteti kaloi në duart e masave punonjëse të vendit. Roli udhëheqës i Partisë në drejtimin e shtetit, lidhjet e tija me masat dhe përbërja e tij popullore i sigurojnë atij karakterin popullor dhe demokratik.

Ushtria Popullore e lindur dhe e rritur në luftë kundër okupatorëve dhe tradhëtarëve u forcua dhe u modernizua. Ajo është një mbrojtëse e vendosur e paqes, roje besnike e kufive të atdheut dhe e fitoreve të popullit tonë.

Nën drejtimin e Komitetit Qendror me mësuesin dhe udhëheqësin tonë të dashur, shokun Enver Hoxha në krye, Partia e çoi popullin tonë në fitoren e revolucionit popullor.

Dhjetë vjet jetë të Partisë së Punës të Shqipërisë janë epoka më e ndritur dhe më revolucionare e gjithë historisë së popullit tonë. Në këto dhjetë vjet jetë Shqipërisë i ndërroi faqja. Vetëm masat punonjëse me klasën punëtore në krye, të udhëhequra nga një parti marksiste-leniniste, parti e tipit të ri, mund të bëjnë ndryshime të tilla revolucionare dhe mund të realizojnë vepra si këto që janë bërë në Republikën tonë Demokratike dhe Popullore.

U zhduk shfrytëzimi i masave punonjëse. Klasa punëtore erdhi në fuqi dhe fitoi të drejtat e plota politike, ekonomike dhe shoqërore. E drejta e punës dhe e organizimit, e drejta e mjekimit dhe e arësimit falas, sigurimi i pleqërisë dhe i pushimit të paguar, tetorëshi dhe pagimi i punës së tepërt, janë disa nga fitoret e klasës sonë punëtore. Gruaja fitoi të drejta të barabarta me burrin dhe para saj u hapën rrugët për të marrë pjesë në gjithë aktivitetet e vendit tonë.

Fshatarësia jonë, e zonja e tokës që punon, e gjësë së gjallë dhe e prodhimit, ka gjetur në klasën punëtore aleatin udhëheqës në luftën e saj për ndërtimin e jetës së re.

U likuidua prona feudale dhe kapitaliste, u shpronësuan tokat dhe kopetë e feudalëve dhe të pronarëve të mëdhenj. Toka ju dha atyre që e punojnë.

U shtetëzuan industria, mjetet e tjera të fuqishme të prodhimit dhe çdo gjë tjetër që ishte ngritur me gjakun dhe me djersën e popullit dhe përdorej për shfrytëzimin e tij. U shtetëzua tregëtia e jashtme dhe ajo grosiste e brendshme. U shtetëzuan bankat, u anuluan koncesionet dhe privilegjet që u kishte dhënë regjimi shtypës i Zogut fashistëve italianë dhe imperialistëve anglezë e amerikanë. Kapitalit monopolist të imperialistëve ju pre rruga.

U krijua prona e përbashkët e popullit dhe prona kooperativiste. Ekonomia e vendit tonë u fut në rrugën e planifikimit. Me likuidimin e pronës feudale dhe kapitaliste u zhdukën anarkia në prodhim, krizat dhe papunësia.

Bujqësia e prapambetur u fut në rrugën e modernizimit. Pro-na kooperativiste i çel fshatarësisë perspektiva të së ardhshmes së lumtur. Fermat e shtetit dhe kooperativat janë për fshatarësinë tonë shembull për një bujqësi të përparuar. Traktorë, maqina korreë dhe shirëse, kombajna dhe mjete të tjera moderne bujqësore, të ardhura nga Bashkimi Sovjetik, përmbysën metodat e vjetra të punës në fushat e vendit tonë dhe i hapën fshatarësisë perspektiva të shkëlqyera të zhvillimit të mëtejshëm të bujqësisë. Kanale ujitëse dhe kulluese përmirësojnë me mijëra hektarë tokë, duke forcuar besimin në fshatarësinë punonjëse se nën drejtimin e Partisë dhe të pushtetit popullor, ajo nuk do të jetë në mëshirën e kushteve atmosferike. Në fushat tona mbillen bimë industriale që do të furnizojnë industrinë e vendit tonë. Shteti ndihmon fshatarësinë e varfër dhe të mesme me teknikë, me plehra kimike, me mjete bujqësore, me farëra të seleksionuara, me kafshë race, me kredite agrare dhe me mjete të tjera, për të modernizuar bujqësinë e vendit tonë.

Vendi ynë është futur në rrugën e industrializimit. U përmbysën normat e vjetra të prodhimit artizanal. Me shpejtësi të madhe po ngrihen fabrika të reja dhe ndërmarrje të reja industriale si Kombinati i tekstileve «Stalin», Hidrocentrali «Lenin», Kombinati i sheqerit e të tjera. Një shfrytëzim i panjohur më parë u bëhet sot pasurive të nëntokës. Nafta, bitumi, kromi, qymyr guri, shfrytëzohen në shkallë përherë më të gjerë në dobi të masave punonjëse të vendit.

Kurrë ndonjëherë nuk janë bërë në vendin tonë kaq ndërtime si këto të gjashtë vjetëve të fundit. Nën drejtimin e Partisë, në një kohë rekord, masat punonjëse të vendit tonë rindërtuan industrinë, minierat e shkatërruara, urat e hedhura në erë dhe çdo gjë që kishte shkatërruar armiku, ndërtuan hekurudhën Tiranë-Durrës-Elbasan, çanë rrugë të reja si Kukës-Peshkopi, Shëmbri-Kolgecaj, Gramsh-Korçë, ngritën ofiçina dhe kantiere, çanë kanale ujitëse si ai i Jubës, «Naum Panxhi», etj. etj. dhe thanë me mijëra e mijëra hektarë tokë si në Maliq e gjetkë; ngritën pallate e baneza për punëtorë, shkolla e spitale, shtëpi kulture, klube, parqe etj. Karakteri socialist i regjimit popullor siguron zhvillimin e pandërprerë industrial të vendit tonë në dobi të masave punonjëse të qytetit dhe të fshatit.

Me shtetëzimin e tregëtisë së jashtme dhe të tregëtisë së brendshme grosiste u likuiduan tregëtarët që shfrytëzonin masat punonjëse të vendit tonë. Tregëtia shtetërore dhe kooperativiste po zgjerohet përditë e më shumë duke vënë në kontakt direkt prodhuesin me konsumatorin. Shteti ynë u bë furnizuesi më i madh, administratori dhe rregulluesi i marrëdhënjeve të tregut. Me politikën e tij të grumbullimit e të furnizimit shteti ka bërë të mundur

që të furnizohen masat e qytetit dhe të fshatit pa ndërmjetësinë e spekulatorëve, në dobi të masave punonjëse. Duke shtuar vazhdimisht prodhimin në bujqësi, duke rritur rendimentin dhe duke ulur koston, duke përmirësuar cilësinë dhe duke realizuar e tejkaluar planin, duke forcuar përherë e më shumë rrjetin tregëtar dhe kooperativist, duke organizuar më mirë dhe duke shpejtuar shpërndarjen e mallrave do të përmirësohet edhe më shumë e do të ngrihet vazhdimisht standardi i jetesës dhe mirëqenja e popullit tonë.

Klasat sunduese të vendit tonë ishin bërë pengesë e zhvillimit dhe e përparimit. Ato e mbanin vendin në prapambetjen më të zezë. Prapambetja dhe injoranca ishin në duart e tyre mjete për të shtypur dhe për të mbajtur të nënshtruara masat punonjëse të vendit tonë. Revolucioni popullor i hapi popullit tonë rrugën e arësimit dhe të kulturës. Në shembullin e shkollës sovjetike, shkolla në vendin tonë është bërë e popullit. Rritja e numrit të shkollave fillore, 7-vjeçare e të mesme, lufta kundër analfabetizimit, kushtet e reja të punës të krijuara për punonjësit, sigurimi falas i arësimit, e kanë bërë arësimin një armë në duart e popullit në luftën e tij për ndërtimin e bazave të socializmit.

Kultura dhe arti zhvillohen pa ndërprerje në vendin tonë. Me qindra studentë kanë mbaruar ose janë duke mbaruar jashtë shtetit shkollat e larta dhe inteligjencia e re po rritet në luftën e madhe për ndërtimin e bazave të socializmit. Emulacioni socialist po përfshin përherë e më shumë masat punonjëse të vendit tonë. Lëvizja sulmuese po i shton përherë e më shumë radhët e saja me punonjësit më të mirë të vendit tonë dhe në shembullin e këtyre njerëzve të rinj që krijoi revolucioni popullor, në shembullin e punonjëseve sovjetikë, punëtorët tanë edukohen dhe luftojnë për ndërtimin e jetës së re.

Imperialistët anglo-amerikanë u përpoqën të sabotonin Luftën nacional-çlirimtare pse e shihnin se ajo ishte rruga e çlirimit të popullit tonë. Pas çlirimit ata u përpoqën me të gjitha mjetet të përmbysnin pushtetin popullor dhe të sabotonin ndërtimin paqësor të vendit tonë. Ata luftuan me egërsinë më të madhe kundër të drejtave ndërkombëtare të popullit tonë. Por të gjitha përpjekjet e tyre kundër vendit e popullit tonë dështuan dhe do të dështojnë vazhdimisht.

Ndërhyrja e imperialistëve me anën e agjentëve të tyre të Beogradit për të marrë nga brenda Partinë tonë, për të transformuar Republikën tonë në një republikë borgjeze, për të kolonizuar vendin tonë dhe për të skllavëruar popullin tonë dështuan plotësisht. Provokacionet e vazhdueshme të kurdisura në Beograd, në Athinë dhe në Romë kundër Shqipërisë, me qëllim që të ndërpritej puna ndërtimore paqësore në vendin tonë dhe të inkurajoheshin armiqtë e brendshëm, kanë dështuar dhe do të dështojnë si ngahera.

Pregatitjet për luftë të imperialistëve amerikanë dhe anglezë dhe të këlyshëve të tyre të Beogradit, të Romës e të Athinës, hasin kundërshtimin përherë e më të madh të popujve dhe të gjithë partizanëve të paqes.



Partia e Punës është organizatorja e të gjitha fitoreve të popullit tonë. Ajo e udhëhoqi dhe e udhëheq drejt popullin tonë pse është e ndritur nga mësimet e Marksit, Engelsit, Leninit e Stalinit; pse i orientoi masat nga vendi çlirimtar i Sovjetëve; pse masat e popullit tonë u bindën në eksperiencën e tyre të përditshme se Partia ishte e tyre dhe i udhëhiqte në luftë për realizimin e aspiratave të tyre; pse masat panë në luftën e madhe çlirimtare dhe patriotike të Ushtrisë së lavdishme Sovjetike mbështetjen e sigurtë për çlirimin e atdheut dhe u frymëzuan nga heroizmat e saj; pse ato panë në Bashkimin Sovjetik mbrojtësin e madh të të drejtave të tyre dhe ndihmësin e pakursyer për ndërtimin e jetës së tyre të re.

Ushtria e lavdishme Sovjetike goditi për vdekje forcat e armatosura të fashizmit dhe i dërmoi në strofkën e tyre duke i dhënë në këtë mënyrë mundësinë popullit tonë që të çlirojnë atdheun. Vendosmëria e Partisë dhe e popullit tonë si dhe karakteri çlirimtar i luftës së popujve të lavdishëm sovjetikë, politika paqësore staliniane, ua bënë të pamundur imperialistëve anglo-amerikanë që ta bënin Shqipërinë edhe një herë koloni të tyre dhe asgjësuan të gjitha përpjekjet e tyre në këtë drejtim.

Politika paqësore staliniane ka krijuar në gjithë botën një lëvizje të madhe të popujve për mbrojtjen e paqes në luftë kundër nxitësve të një lufte të re, imperialistëve amerikanë dhe anglezë e satelitëve të tyre. Me politikën e saj të drejtë Partia i siguroi popullit tonë një vend nderi në kampin e socializmit dhe e rreshtoi atë në lëvizjen e madhe të partizanëve të paqes duke e bërë kështu një luftëtar të vendosur për paqe që është kauza e gjithë njerëzimit përparimtar.

Ndihma e çmueshme dhe bujare e popujve të Bashkimit Sovjetik, kujdesi dhe dashuria e Stalinit dhe e Partisë Bolshevike për popullin tonë, e ndihmuan Partinë dhe popullin shqiptar të shpëtonte nga rreziku i madh që i kishin pregatitur imperialistët amerikanë dhe titistët e Beogradit.

Ndihma e çmueshme e Bashkimit Sovjetik dhe e demokracive popullore bënë që populli ynë të evitojë në ndërtimin e socializmit shumë nga sakrificat e mëdha që kanë bërë popujt sovjetikë

në ndërtimin e socializmit në kushtet e rrethimit kapitalist, pa ndihmën e kurrkujt dhe në luftë me imperialistët. Populli ynë do t'i jetë mirënjohës përjetë Stalinit të madh dhe Partisë Bolshevike dhe do të jetë mik besnik i popujve sovjetikë brez pas brezi.

Ndihma bujare dhe e vazhdueshme materiale dhe morale e Bashkimit Sovjetik i kanë krijuar popullit tonë kushtet e nevojshme dhe të domosdoshme për forcimin e pushtetit popullor, për ndërtimin e bazave të socializmit, për mbrojtjen e pavarësisë dhe të paqes.

10-vjetori i Partisë së Punës të Shqipërisë, 10-vjetori i fitoreve më të mëdha dhe më të shkëlqyera në të gjithë historinë e popullit tonë, do të kremtohet si një festë e madhe popullore në të gjithë vendin.

Sukseset e arritura nga masat punonjëse nën drejtimin e Partisë gjatë këtyre dhjetë vjetëve, i mbushin ato me besim të patundur në të ardhshmen e tyre të lumtur.

Le t'u shërbejë krentimi i 10-vjetorit të themelimit të Partisë masave punonjëse të vendit tonë, për të luftuar më me guxim dhe më me vendosmëri kundër vështirësive që hasin në këtë epokë të kalimit nga kapitalizmi në socializëm, për të korrur suksese edhe më të mëdha në të ardhshmen!

Të jenë si gjithmonë komunistët në ballë të luftës për suksese të reja! Ta mbajnë ata si kurdoherë lart flamurin e Partisë!

Të shërbejë krentimi i 10-vjetorit të themelimit të Partisë që klasa jonë heroike punëtoresh, në krye të masave punonjëse, në shembullin e punonjësve sovjetikë, të shtojë përpjekjet e saja për shtimin e rendimenteve, për tejkalimin e normave, për uljen e kostos, për të prodhuar me cilësi më të mirë, për kursime, për ruajtjen e pasurisë shtetërore, për përvetësimin e eksperiencës së punëtorëve më të mirë të vendit tonë dhe të punonjësve sovjetikë, për kualifikimin në punë dhe për përvetësimin e teknikës!

Fshatarësia punonjëse, në aleancë të pathyeshme me klasën punëtoresh, të shtojë përpjekjet e saja për aplikimin e rregullave agrotëknike, për sigurimin e rendimenteve më të larta dhe për prodhime të bollshme; të ecë dhe të punojë ajo në shembullin e kolkozianëve sovjetikë.

Për 10-vjetorin e Partisë së tyre, punëtorët dhe fshatarët, të rinjtë dhe gratë, në qendra pune, në qytet dhe në fshat, të hidhen në sulm me entuziazmin e njerëzve të lirë, për realizimin e tejkalimit e planit të shtetit. Të mbajnë parasysh se çdo realizim dhe tejkalim i planit ndihmon drejtpërsëdrejti për përmirësimin e kushteve të jetesës së masave punonjëse, ndihmon për forcimin e ekonomisë dhe për mbrojtjen e atdheut e të paqes. Të kenë parasysh që lufta për realizimin e planit është një detyrë e madhe patriotike.

Le të shërbejë bilanci i shkëlqyer i sukseseve të këtij 10-vjetori të Partisë që popullit tonë t'i shtohet edhe më shumë dashuria dhe mirënjohja ndaj Bashkimit Sovjetik, Partisë Bolshevike dhe Stalinit të madh, që përherë e më shumë të forcohen këto lidhje miqësie ndërmjet popullit tonë dhe popujve sovjetikë, në mënyrë që të ecë gjithmonë përpara ndërtimi i socializmit në vendin tonë, që të jetë e sigurtë jeta dhe e ardhshmja e popullit tonë.

Populli ynë të mos dehet nga fitoret; të jetë syhapët ndaj armiqve të brendshëm dhe të jashtëm. Të forcojë përherë e më shumë luftën e tij për paqen kundër nxitësve të luftës. Të zbulojë dhe të goditë si përherë me ashpërsi armiqtë e brendshëm. Të dërmojë si gjithmonë provokacionet e titistëve, të monarko-fashistëve grekë dhe të neofashistëve italianë. Të forcojë radhët e tija në lëvizjen e madhe për paqen që udhëhiqet nga politika paqësore e Bashkimit të lavdishëm Sovjetik.

Të rrojë dhe të forcohet miqësia, bashkëpunimi dhe solidariteti i popullit tonë me popujt e lavdishëm të Bashkimit Sovjetik, të demokracisë popullore dhe me të gjitha forcat e kampit të paqtheshëm të paqes që me Bashkimin e madh Sovjetik në krye luftojnë për paqen dhe socializmin në botë!

Rroftë Partia jonë e Punës me në krye Komitetin Qendror e shokun Enver Hoxha, që e udhëhoqën popullin në Luftën nacional-çlirimtare dhe që e udhëheqin sot në luftën për paqe, demokraci dhe socializëm!

KOMITETI QENDROR I PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË

*Botohet sipas gazetës
«Zëri i Popullit», Nr. 150 (855),
24 qershor 1951*

PLENUMI X (i korrigjuar) I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Tiranë, 14 maj 1951

K O M U N I K A T Ë

E PLENUMIT TË JASHTËZAKONSHËM TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Më datën 14 maj 1951 u mbledh Plenumi i Jashtëzakonshëm i Komitetit Qendror të PPSH nën drejtimin e Sekretarit të Përgjithshëm të Partisë, shokut Enver Hoxha. Plenumi mori në shqyrtim edhe një herë çështjen e kolektivizimit të bujqësisë dhe konstatoi se orientimi i dhënë nga Plenumi X i Komitetit Qendror, mbajtur në muajin prill të këtij viti «mbi zgjerimin e kolektivizimit në bujqësi» nuk është i drejtë, se detyra jonë kryesore sot nuk është zgjerimi i numrit të kooperativave bujqësore, por është forcimi i kooperativave bujqësore ekzistuese. Në lidhje me këtë, Plenumi i Jashtëzakonshëm i Komitetit Qendror i bëri korrigjimet e nevojshme Rezolucionit të Plenumit X të Komitetit Qendror, duke dhënë këtë orientim: «Perspektiva e bujqësisë sonë është pa dyshim kolektivizimi, sepse vetëm me anë të kolektivizimit mund të ndërtohet socializmi në fshat. Por në lidhje me kolektivizimin në fshat ne nuk duhet të shpejtohemi në asnjë mënyrë, por të ecim me kujdes të madh dhe me hapa të sigurtë, në bazë të vendimeve të Konferencës II Nacionale të Partisë që «në kolektivizimin e bujqësisë as të mos shpejtojmë dhe as të ndalemi në vend». Prandaj si detyrë imediate dhe urgjente na vihet jo rritja e numrit të kooperativave bujqësore të prodhimit, por forcimi i gjithanshëm i kooperativave ekzistuese, në mënyrë që këto të bëhen shembull i shkëlqyer për fshatarët e varfër dhe të mesëm, për t'u tërhequr këta në rrugën e kolektivizimit pa asnjë presion, por vullnetarisht dhe në bazë të shembullit praktik të kooperativave ekzistuese. Çfarëdo shpejtimi i pamatur në kolektivizimin e bujqësisë në konditat e sotme do të çonte në gabime të rënda që do ta dëmtonin rëndë vetë çështjen e kolektivizimit të bujqësisë».

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

REZOLUCION

I PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH «MBI DISA KORRIGJIME QË JU BËNË REZOLUCIONIT TË PLENUMIT X TË KQ TË PPSH»

14 maj 1951

Më datën 14 maj 1951 u mbledh Plenumi i Jashtëzakonshëm i Komitetit Qendror të PPSH nën drejtimin e Sekretarit të Përgjithshëm të Partisë, shokut Enver Hoxha. Ky plenum mori në shqyrtim edhe një herë çështjen e kolektivizimit të bujqësisë dhe konstatoi se orientimi i dhënë nga Plenumi X i Komitetit Qendror, i mbajtur në muajin prill të këtij viti mbi zgjerimin e kolektivizimit në bujqësi nuk është i drejtë, se detyra jonë kryesore sot nuk është zgjerimi i numrit të kooperativave bujqësore, por është forcimi i kooperativave bujqësore ekzistuese. Në lidhje me këtë, Plenumi i Jashtëzakonshëm i Komitetit Qendror i bëri korrigjimet e nevojshme Rezolucionit të Plenumit X të Komitetit Qendror si më poshtë:

I

MBI GJENDJEN AKTUALE TË BUJQËSISË DHE PERSPEKTIVAT E ZHVILLIMIT TË SAJ

1. — Fitorja e madhe e popullit tonë në Luftën nacional-çlirimtare kundër okupatorëve italo-gjermanë dhe shërbëtorëve të tyre vendës u arrit në saje të luftës heroike të popujve të lavdishëm sovjetikë kundër fashizmit, të udhëheqjes së drejtë të masave të gjera të popullit tonë nga ana e Partisë, të patriotizmit të shkëlqyer të popullit tonë. Vendosja e pushtetit popullor mbi gjermadhat e pushtetit të vjetër, pushtetit të shfrytëzuesve dhe të gjakpirësve, bëri të mundur që të krijohen të gjitha konditat e favorshme për zhvi-

llimin ekonomik të vendit në interes të masave punonjëse. Nacionalizimi i bankave, i industrisë, i minierave, i tregëtisë, i transportit, i ndërtimeve, shpronësimi i plotë pa shpërblim i çifligarëve dhe i pasanikëve të fshatit dhe zbatimi i plotë i reformës agrare, kanë bërë që të ndryshojnë rrënjësisht marrëdhënjet e vjetra në prodhim. Pushteti popullor, që është pushteti i masave punonjëse me klasën punëtore në krye dhe që, në fazën e sotme, kryen funksionet e diktaturës së proletariatit i ka ndryshuar rrënjësisht konditat e zhvillimit të bujqësisë, duke krijuar për fshatin marrëdhënje prodhimi krejt të ndryshme nga ato që ekzistonin në regjimet e mëparshme shtypëse dhe shfrytëzuese, duke krijuar marrëdhënje krejt të reja midis qytetit dhe fshatit.

2. — Me zbatimin e reformës agrare, fshatarësia punonjëse e rriti në mënyrë të konsiderueshme tokën nën zotërimin e saj dhe inventarin bujqësor, duke marrë 320 000 ha. tokë, 500 000 rrënjë ullinj, mijëra kafshë pune etj., pa asnjë shpërblim nga çifligjet dhe inventari i bejlerëve dhe i agallarëve, që u shpronësuan totalisht nga pushteti popullor, si edhe nga çifligjet e shtetit. Toka është e atij që e punon dhe shteti e ndalon shitjen dhe blerjen e saj, për të mos lejuar koncentrimin e tokës në duart e pasanikëve dhe varfërimin e masave të fshatarësisë. Sipërfaqet e mbjella e tejkaluan nivelin e paraluftës qysh më 1945 dhe prodhimi i drithërave e kaloi këtë nivel në vitin 1946. Në vitin 1950 sipërfaqet e mbjella u realizuan 149,5 për qind dhe prodhimi i përgjithshëm i drithërave, i orizit dhe i patates, me gjithë thatësinë e këtij viti, ka qenë 133,8 për qind në krahasim me vitin 1938.

3. — Me rritjen e vëllimit të prodhimeve bujqësore është rritur edhe niveli i jetesës së fshatarësisë, është furnizuar industria shtetërore me lëndë të parë, është shtuar fondi i bukës së shtetit, janë shtuar eksportimet. Por megjithatë, nuk është arritur akoma që të prodhohet në vend e gjithë buka e nevojshme për tërë Republikën. Rritja e rendimenteve të prodhimit në bujqësi nuk është e kënaqshme. Zhvillimi i sektorit blegtoral nuk është i kënaqshëm. Sado që në zhvillimin e bujqësisë sonë janë bërë përparime të mëdha, megjithatë, plenumi konstaton se ritmi i zhvillimit të bujqësisë është akoma i ngadalshëm, bujqësia nuk u përgjigjet plotësisht nevojave që lindin nga zhvillimi i shpejtë dhe i domosdoshëm i ekonomisë sonë në përgjithësi dhe i industrisë veçanërisht. Vendi ynë është një vend agrar, bujqësia në ekonominë tonë zë vendin e parë dhe nga zhvillimi i mëtejshëm i ekonomisë sonë bujqësore varet direkt edhe zhvillimi i sektorit industrial të ekonomisë sonë. Prandaj është e nevojshme që t'i kushtohet kujdes i veçantë zhvillimit të ekonomisë bujqësore, kujdes, i cili deri sot nuk ka qenë në lartësinë e duhur.

4. — Ritmi jo i kënaqshëm i zhvillimit të bujqësisë sonë shpjegohet me faktin e prapambetjes së madhe dhe të përbërjes së saj. Bujqësia jonë karakterizohet nga një prapambetje e madhe në metodat e prodhimit, niveli kultural dhe teknik i fshatarësisë sonë është i ulët, ekonomia bujqësore është jashtëzakonisht e copëtuara dhe primitive e që në pjesën dërmuese ndodhet në duart e privatëve, nuk mund të gëzojë lehtësitë e një ekonomie të bashkuar sikurse fermat shtetërore dhe kooperativat bujqësore. Ajo i nënshtrohet përgjithësisht elementit spontan të prodhimit, nuk mund të drejtohet me plan në të njëjtën masë sikurse sektori shtetëror dhe socialist i ekonomisë, përmban në gjirin e vet farën e shfrytëzimit, lind nga gjiri i vet elementë kapitalistë, kulakë, «çdo ditë, çdo orë», siç ka thënë Lenini.

5. — Gjatë Luftës nacional-çlirimtare, aleanca e klasës punëtore me fshatarësinë mbështetej në dëshirën, vullnetin, shpresën dhe besimin e plotë të fshatarësisë për fitoren definitive të luftës, d.m.th. për lirinë, pushtetin popullor dhe tokën. Gjatë zbatimit të reformës agrare, aleanca e klasës punëtore me fshatarësinë punonjëse bazohej në arritjen e frutit të luftës, d.m.th. në marrjen e tokës nga ana e fshatarësisë. Mbas zbatimit të reformës agrare, lidhjet midis klasës punëtore dhe fshatarësisë marrin forma të reja. Këto forma të reja shprehen në përkrahjen dhe ndihmën që i jep shteti fshatarësisë për të forcuar ekonominë e vet, nëpërmjet hallkave të aleancës siç janë:

a) *Ndërmarrjet shtetërore bujqësore dhe blegtorale.* Misioni i këtyre është që të shërbejnë si pikëmbështetje të socializmit në fshat, si shembull i shkëlqyer për fshatarësinë kooperativiste dhe individuale, për t'i treguar asaj me shembullin praktik se çfarë rezultati pozitiv jep ekonomia e madhe e planifikuar, e mekanizuar dhe e përparuar në krahasim me ekonominë e vogël individuale të fshatarit. Njëkohësisht ato kanë për detyrë që të ndihmojnë materialisht dhe ekonomikisht fshatarët kooperativistë dhe individualë përreth. Në përgjithësi ndërmarrjet tona shtetërore bujqësore dhe blegtorale e kryejnë këtë detyrë, e luajnë rolin e tyre si hallkë lidhjeje midis shtetit dhe fshatarësisë, sado që ato kanë shumë të meta, siç janë kostoja e lartë e prodhimit, moszbatimi i plotë i rregullave agroteknike, mosorganizimi i mirë i emulacionit socialist etj.

b) *Stacionet e makinave dhe të traktorëve.* Këto janë krijuar nga shteti me qëllim që t'u vijnë në ndihmë fshatarëve kooperativistë dhe individualë, duke u kryer këtyre punimet bujqësore në bazë të akordit të përbashkët dhe të kontraktimit. Për vitin 1951 SMT-të do të kryejnë rreth 50 për qind të të gjitha punimeve

kryesore të kooperativave bujqësore ekzistuese dhe pjesën tjetër të kapacitetit të tyre do ta përdorin për të plotësuar deficitet në fuqi motorike të fermave shtetërore dhe për të kryer punime në tokat e fshatarëve individualë të varfër dhe të mesëm. Vendi ynë nuk ka pasur kurrë ndonjëherë më parë kaq traktorë dhe maqina bujqësore sa ka sot dhe fuqia motorike e SMT-ve do të rritet vazhdimisht. Kostoja e lartë e punës, mungesa në mirëmbajtjen e maqinorisë, mosshfrytëzimi racional i të gjithë kapacitetit efektiv janë të metat kryesore në SMT-të.

c) *Kooperativat bujqësore të prodhimit.* Këto vlejnë si një hallkë lidhjeje me fshatarësinë individuale, sepse me shembullin e tyre konkret, me ndihmën që i japin fshatarësisë individuale punonjëse dhe me ndihmën që u jep atyre shteti, inkurajojnë fshatarësinë e varfër dhe të mesme që të vihen në rrugën e kolektivizimit. Kooperativat bujqësore ekzistuese në përgjithësi shkojnë mirë, fshatarët kooperativistë do të kenë të ardhura më të mëdha se fshatarët individualë, metodat e kultivimit janë më të përparuara se në sektorin privat. Por kooperativat bujqësore ekzistuese nuk kanë arritur akoma shkallën e duhur të zhvillimit të tyre për të bërë që, me shembullin e tyre praktik, të tërheqin vullnetarisht në rrugën e kolektivizimit fshatarësinë e varfër e të mesme. Prandaj detyra jonë kryesore në këtë drejtim është forcimi i kooperativave bujqësore ekzistuese, në mënyrë që ato të bëhen me të vërtetë shembull praktik për tërheqjen e masave të fshatarësisë së varfër dhe të mesme në rrugën e kolektivizimit, e cila është rruga e vetme për të ndërtuar socializmin në fshat.

c) *Kooperativat e shitblerjes.* Këto shërbejnë si një mjet i fuqishëm për të forcuar lidhjet midis fshatit e qytetit, nëpërmjet të cilave fshatari furnizohet me prodhime industriale në shkëmbim të prodhimeve bujqësore. Ato përfshijnë sot rreth 60 për qind të të gjitha ekonomive individuale në fshat. Por kooperativat e shitblerjes në fshat janë akoma shumë të dobëta nga pikëpamja organizative si edhe nga fuqia e tyre ekonomike. Forcimi i tyre organizativ dhe ekonomik është detyra jonë kryesore në këtë drejtim.

d) *Krediti agrar.* Shteti e ndihmon fshatarësinë me anën e kreditit agrar për të blerë vegla bujqësore, kafshë pune, kafshë race, farëra etj. Gjatë dy viteve të fundit, shteti i ka dhënë më tepër se 73 milion lekë fshatarësisë në formë të kreditit agrar. Gjatë dy viteve të fundit shteti i ka shpërndarë fshatarësisë së varfër dhe të mesme mbi 30 mijë kuintalë farëra drithërash, mbi 17 mijë kuintalë farëra bimësh industriale, mbi 23 mijë kuintalë farëra të tjera, me mijëra plugje, pompa spërkatëse, dhjetëra mijëra kuintalë plehra kimike etj. Por kjo ndihmë në drejtim të fshatarë-

sisë me anën e kreditit agrar nuk mund të konsiderohet e mjaftueshme dhe në të ardhshmen ajo duhet të shtohet në mënyrë të konsiderueshme. Krediti agrar do të vlejë si një mjet i rëndësishëm për të forcuar aleancën midis klasës punëtore dhe fshatarësisë punonjëse.

dh) *Bonifikimet dhe kanalet ujitëse.* Veprat e bonifikimeve dhe çelja e kanaleve ujitëse që ndërmerr shteti janë një mjet i rëndësishëm për të forcuar lidhjet me fshatarësinë, e cila në to sheh praktikisht ndihmën që i jep shteti për përmirësimin e ekonomisë fshatare. Gjatë dy viteve të fundit shteti ka investuar mbi 400 milion lekë për bonifikime të ndryshme dhe rreth 120 milion lekë për çeljen e kanaleve ujitëse. Nga këto investime janë hapur rreth 3 000 hektarë tokë e re, janë përmirësuar edhe 21 000 hektarë tokë, janë vënë nën ujë mbi 10 000 hektarë dhe janë përmirësuar kanalet e tjera ujitëse me një sipërfaqe prej më tepër se 6 000 hektarë. Në të ardhshmen ne duhet të rritim në mënyrë të konsiderueshme investimet tona për bonifikime të rëndësishme dhe për çelje kanalesh për ujitje. Me anën e kreditit agrar shteti duhet të inkurajojë më tepër fshatarësinë për çeljen e kanaleve të bonifikimit dhe të ujitjes përveç veprave nacionale të bonifikimit dhe të ujitjes që do të bëjë vetë shteti.

e) *Ndihma agroteknike.* Kjo ndihmë nga ana e shtetit është shumë e vlefshme për fshatarësinë tonë të prapambetur. Ajo i është dhënë fshatarësisë, por jo në masën e duhur. Shumë agronomë janë bërë njerëz të zyrave dhe nuk kujdesen sa duhet për t'i ardhur në ndihmë fshatarësisë, për të përmirësuar metodat e punës e të prodhimit. Forcimi i ndihmës agroteknike në drejtim të fshatarësisë është një detyrë e rëndësishme që do të vlejë për përmirësimin e metodave të punës në bujqësi, për rritjen e rendimenteve të prodhimit dhe për forcimin e aleancës midis klasës punëtore dhe fshatarësisë punonjëse.

ë) *Rritja e prodhimit industrial dhe zgjerimi i furnizimit të fshatarësisë me prodhime industriale të një kostoje dhe çmimi më të ulët.* Për të forcuar lidhjet midis qytetit dhe fshatit, për të forcuar aleancën midis klasës punëtore dhe fshatarësisë, një mjet i fuqishëm është edhe furnizimi i fshatarësisë me prodhime industriale kurdoherë sa më shumë dhe me çmime të arësyeshme. Për ta bërë këtë, është e nevojshme që të bëhen të gjitha përpjekjet në sektorin industrial për të shtuar vëllimin e prodhimeve si edhe për të ulur koston e prodhimit. Lufta për shtimin e vëllimit të prodhimeve dhe për uljen e koston së prodhimit në sektorin e industrisë është faktor i rëndësishëm për të forcuar aleancën midis klasës punëtore dhe fshatarësisë.

6. — Vendi ynë si nga pikëpamja e klimës, ashtu dhe nga pikëpamja e tokës është shumë i përshtatshëm për një bujqësi të përparuar. Ne i kemi të gjitha mundësitë për zhvillimin e cerealeve (në radhë të parë për zhvillimin e kulturës së misrit dhe të grurit që janë buka e popullit), për zhvillimin e bimëve industriale (në radhë të parë për zhvillimin e pambukut, të panxharit të sheqerit dhe të duhanit që janë baza e lëndëve të para të industrisë sonë), për zhvillimin e zooteknikës (në radhë të parë për përhapjen e racës së deles rudë dhe për përmirësimin e racave ekzistuese të gjedheve dhe të kuajve) etj. Duke forcuar në mënyrë të gjithanshme kooperativat bujqësorë ekzistues, duke forcuar hallkat ekonomike që lidhin qytetin me fshatin, duke forcuar ndihmën e shtetit në drejtim të fshatarësisë kooperativiste dhe individuale, duke bërë të gjitha përpjekjet për rritjen e rendimenteve të prodhimit në bujqësi, duke zhvilluar luftën e klasave në fshat, duke treguar një kujdes më të madh nga ana e Partisë dhe e shtetit në drejtim të bujqësisë, ne do të bëjmë që të zhvillohet bujqësia jonë, që të rriten prodhimet bujqësorë, që të ngrihet niveli i jetesës së fshatarësisë, që të sigurohet buka e popullit në vend si dhe të gjitha lëndët e para bujqësore për industrinë tonë, që të zvogëlohet disproporcioni midis qytetit dhe fshatit.

7. — Në fshatarësinë tonë po zhvillohet diferencimi i shtresave të ndryshme të fshatarësisë. Ndërsa në regjimin kapitalist shtresa e fshatarësisë së mesme dobësohej ekonomikisht, zvogëlohej dita-ditës dhe shtoheshin të dy ekstremet, shtresa e fshatarësisë së varfër nga një anë dhe kulakët nga ana tjetër, në regjimin tonë popullor në shtresat e ndryshme të fshatarësisë karakteristikë kryesore është forcimi i fshatarësisë së mesme ekonomikisht dhe numerikisht. Shtresa e kulakëve është duke u kufizuar ekonomikisht me anën e masave që merr shteti kundrejt saj; kulakët si individë ose grupe kulakësh të veçuar, të cilët kundërshtojnë ligjet e shtetit për kufizimin e tyre, likuidohen dhe në radhët e kësaj shtrese futen vazhdimisht disa kulakë të rinj, që lindin nga fshatarësia e mesme duke u pasuruar me anën e shfrytëzimit dhe të spekulimit.

Fshatari i mesëm është figura qendrore në fshat. Shtresa e fshatarëve të varfër lëviz në dy drejtime: një pjesë, e cila ka mundur të përmirësojë gjendjen e saj ekonomike, ka kaluar ose është duke kaluar në radhët e fshatarëve të mesëm, ndërsa një pjesë që është e pafuqishme ekonomikisht dhe që nuk mund të përballojë dot nevojat e jetesës në fshat me atë pasuri që disponon, ka filluar të lërë fshatin dhe të zbresë në qendrat e punës, duke u futur në radhët e klasës punëtore. Ajo pjesë e fshatarësisë së varfër e cila nuk ka mundur të shtojë shumë pasurinë e vet, por as nuk e ndjen nevojën të largohet nga fshati për në qendrat e punës, mbetet

atje ku është derisa të krijohen për të rrethanat ekonomike për ta vënë atë në lëvizje në një drejtim ose në tjetrin. Ky është procesi i diferencimit që po kryhet në fshatin tonë. Ky proces është i logjikshëm, krejt i kundërt nga procesi i diferencimit të fshatarësisë në regjimin kapitalist. Ky diferencim që po bëhet sot në fshat është karakteristikë e regjimit popullor, e regjimit socialist, ku në fuqi nuk është klasa kapitaliste, por klasa punëtore. Por ky diferencim nuk është veçse në fazën fillestare të tij.

8. — Përpara popullit tonë shtrihet një perspektivë pune dhe lumturie e pafund... Së shpejti do të shpallet plani i parë pesëvjeçar i ndërtimit të ekonomisë sonë. Me realizimin e planit pesëvjeçar gjendja ekonomike e popullit tonë do të përmirësohet shumë nga të gjitha pikëpamjet, niveli kultural e politik i popullit do të ngrihet, fuqia mbrojtëse do të forcohet. Plani i parë pesëvjeçar për sektorin e bujqësisë ka për të pasur si objektiv rritjen e prodhimit bujqësor në një shkallë të atillë që të mund të prodhojmë bukën e popullit në vend, që të prodhojmë lëndë të parë të mjaftueshme për nevojat e industrisë sonë, që të shtojmë eksportimet tona.

Detyrat tona në lidhje me zhvillimin e mëtejshëm të bujqësisë

Duke marrë parasysh se, nga një anë, ritmi i zhvillimit të bujqësisë sonë është i ngadalshëm dhe, nga ana tjetër, se me rritjen e ekonomisë sonë në përgjithësi dhe me rritjen e industrisë në veçanti shtohen në mënyrë progresive nevojat për prodhime bujqësore; duke marrë parasysh nevojën e rritjes së rendimenteve të prodhimit dhe të rritjes së ritmit të zhvillimit të bujqësisë në përgjithësi, detyra jonë kryesore në lëmin e bujqësisë është: të shpejtojmë ritmin e zhvillimit të bujqësisë, duke forcuar kooperativat bujqësore ekzistuese dhe duke forcuar ndihmën e shtetit në drejtim të fshatarësisë punonjëse individuale, duke forcuar format e reja të lidhjeve midis qytetit dhe fshatit, të aleancës midis klasës punëtore dhe fshatarësisë, duke zhvilluar çdo ditë e më tepër luftën e klasave në fshat. Për këtë është e nevojshme të plotësojmë këto detyra konkrete:

1. — Të marrim të gjitha masat për likuidimin e të gjitha të metave në ndërmarrjet bujqësore dhe blegtorale të shtetit. Këto masa duhet të bëjnë që këto ndërmarrje të bëhen me të vërtetë pikëmbështetje të socializmit në fshat, të bëhen shembull i mirë pune dhe prodhimi për të gjithë fshatarësinë dhe ta ndihmojnë këtë efektivisht. Këto masa duhet të konsistojnë në organizimin e mirë të punës, në zhdukjen dhe dënimin e pamëshirshëm të qëndrimit të pandërgjegjshëm të disa punonjësve të bujqësisë kundrejt pasu-

risë shtetërore, në organizimin e plotë të emulacionit socialist për rritjen e prodhimit dhe uljen e kostos, në zbatimin e detyrueshëm të rregullores agroteknike në prodhim, në futjen e të gjitha fermave në sistemin e qarkullimit bujqësor brenda këtij viti, në zhdukjen e humbjeve të kota në ndërmarrjet blegtorale, në përmirësimin e racave të kafshëve. Fermat shtetërore dhe blegtorale duhet të bëhen bazë kryesore për prodhimin e farërave të seleksionuara dhe të kafshëve të racës. Ato duhet të udhëhiqen nga eksperiencia e sovkozeve sovjetike në të gjitha drejtimet e aktivitetit të tyre. Brenda muajit korrik të këtij viti Byroja Politike të marrë në shqyrtim gjendjen aktuale të ndërmarrjeve bujqësore e blegtorale shtetërore dhe të marrë masat e nevojshme konkrete për forcimin e tyre të mëtejshëm.

2. — Të forcohen SMT-të duke marrë një sërë masash të cilat të synojnë: në organizimin e mirë të punës, në rritjen e normave mesatare progresive, në uljen e kostos, në uljen e konsumit të karburantit, në mirëmbajtjen e maqinerisë, në përmirësimin e cilësisë së punës. Gjatë këtij viti SMT-të të kryejnë deri 50 për qind të punimeve bujqësore në kooperativat bujqësore ekzistuese. Të shtohet vazhdimisht parku i SMT-ve në mënyrë që në vitin 1955 ai të ketë një kapacitet të mjaftueshëm për të kryer punimet në masën jo më pak se 50 për qind të të gjitha kooperativave bujqësore e t'u ndihmojë fshatarëve individualë. Zgjerimi i mekanizimit në bujqësi duhet të konsiderohet si konditë e domosdoshme për zhvillimin e mëtejshëm të bujqësisë. Ministria e Bujqësisë duhet të marrë të gjitha masat për të përgatitur kuadrot e nevojshëm për drejtimin e maqinave dhe të traktorëve.

3. — Të merren të gjitha masat praktike për të forcuar kooperativat bujqësore ekzistuese duke i ndihmuar ato me kredit bankar, me farëra të seleksionuara, kafshë pune dhe kafshë race, SMT-të me kuadro etj.

4. — Deri në fund të vitit 1955 të gjitha farërat ekzistuese dhe jo të mira të zëvendësohen me farëra të seleksionuara në të gjithë Republikën. Këto farëra do të prodhohen nga fermat shtetërore dhe nga kooperativat më të mira. Brenda vitit 1952 duhet që e gjithë fara e jonxhës të prodhohet në vend, kryesisht nga fermat shtetërore.

5. — Brenda këtij viti të merren të gjitha masat e duhura për forcimin e gjithanshëm të kooperativave të shitblerjes në fshat në mënyrë që ato të bëhen organizata të fuqishme masash për ta lidhur më fort politikisht dhe ekonomikisht fshatin me qytetin dhe për të futur në fshatarësinë frymën e kolektivizimit. Brenda muajit qershor të këtij viti Byroja Politike të shqyrtojë gjendjen e kooperativave të shitblerjes dhe të marrë masa konkrete për forcimin e tyre të gjithanshëm. Kooperativat e shitblerjes duhet t'i shesin fshatarit jo vetëm me çmimet e tregut reciprok, por edhe

me çmimet e tregut komercial, sidomos vegla bujqësore si kazma, lopata etj.

6. — Industria dhe artizanati të prodhojnë plugje fushore dhe kodrinore për qetë dhe kuajt e vendit, duke u përpjekur që të ulet vazhdimisht kostoja e prodhimit të tyre. Deri në fund të vitit 1955 plugu i hekurt të jetë përhapur kudo për të zëvendësuar parmendën e drurit. Këto plugje të prodhohen sa më shumë në vend, ndërsa pjesa tjetër, që nuk mund të prodhohet në vend, duhet të importohet. Industria dhe artizanati duhet të prodhojnë me shumicë vegla të tjera bujqësore si kazma, lopata, sëpata etj., me kosto të ulët dhe këto t'u shiten fshatarëve në kooperativat e shitblerjes në fshat. Kooperativat e shitblerjes duhet të përdorin sistemin e kontraktimit me fshatra të tëra për t'i furnizuar ato me vegla bujqësore në shkëmbim të prodhimeve bujqësore ose me të holla. Deri në fund të vitit 1952, në çdo lokalitet duhet të ketë të paktën nga një kovaç, një samarpunues, një zdruckthtar dhe një nallban, qofshin këta të kooperuar ose privatë.

7. — Të merren masa për të përmirësuar kulturën e misrit dhe të grurit, duke përhapur gjerësisht metodat sovjetike, duke seleksionuar farën e vendit dhe duke futur në kultivim farëra të reja më shumë prodhuese që mund të importohen nga Bashkimi Sovjetik. Përhapja e mbjelljes së misrit me fole katrore, përgatitja e tokës që do të mbillet misër qysh në vjeshtë për të konservuar sa më shumë vlagë, përdorimi sa më i gjerë i veglave bujqësore moderne, kanalizimet sa më të shumta për të ruajtur të lashtat nga lagështia, zgjerimi sa më i madh i kanaleve kulluese e ujitëse do të bëjnë që të shtohen rendimentet në prodhimin e cerealeve dhe veçanërisht në prodhimin e misrit dhe të grurit.

8. — Të tregohet më tepër kujdes për zhvillimin e kulturave industriale, në radhë të parë për kulturën e pambukut, të panxharit të sheqerit e të duhanit. Bimët industriale duhet të mbillen në tokat më të mira dhe më të përshtatshme për to, t'u bëhen të gjitha shërbimet e nevojshme agroteknike, të përdoret gjerësisht plehu natyral dhe plehu kimik për ushqimin e tyre. Uji i kanaleve ujitëse duhet të rezervohet në radhë të parë për pambukun, të inkurajohet më tepër prodhimi i pambukut, i panxharit të sheqerit, i duhanit dhe i bimëve oleoze. Puna e SMT-ve duhet të drejtohet kryesisht nga bimët industriale. Rritjes së rendimenteve të prodhimit për hektarë duhet t'i kushtohet rëndësi e veçantë. Brenda vitit 1953 Ministria e Bujqësisë duhet të ketë përgatitur kuadro të ulët dhe të mesëm të mjaftë në mënyrë që të caktohet një kuadrë për çdo 500 ha. tokë të mbjellë me bimë industriale. Këta kuadro do të jenë përgjegjës për kultivimin e bimëve industriale në sipërfaqen që do t'u caktohet, qoftë kjo në sektorin kooperativist ose në atë privat.

9. — Të inkurajohet mbjellja e patates, e groshës dhe e perimeve në një shkallë më të gjerë se sa deri sot.

10. — Duke e konsideruar kulturën e ullirit dhe atë të agrumeve (portokalle, mandarina, limona etj.) si kryesore në sektorin e frutikulturës, duhet të bëhen të gjitha përpjekjet për përmirësimin e këtyre kulturave. Ullinjve dhe agrumeve ekzistuese duhet t'u bëhen sa më mirë shërbimet agroteknike në mënyrë që të sigurohet prodhimi i vazhdueshëm dhe joperiodik i ullinjve si dhe prodhimi i cilësisë së mirë e me shumicë i agrumeve. Të zgjerohen fidanishtet ekzistuese për të rritur fidanet e nevojshme për zgjerimin e frutikulturës. Nga ana e Ministrisë së Industrisë duhet të merren të gjitha masat për të siguruar përpunimin industrial të frutave të vendit tonë, siç është punimi i ullirit, konservimi i frutave të ndryshme etj. Ministria e Bujqësisë duhet të përgatitë kuadrot e nevojshëm që të përdoren si teknikë të frutikulturës në terren e sidomos për kulturën e ullirit, të agrumeve, të vreshtave.

11. — Për të përmirësuar pasurinë zooteknike, të zgjerohen stacionet e ndërzimit në mënyrë që brenda vitit 1955 të kemi mesatarisht një stacion ndërzimi për çdo lokalitet. Të përgjithësohet brenda vitit 1952 ndërzimi i deleve të sektorit shtetëror me desh të racës rudë. Njëkohësisht të merren masa që raca rudë të përgjithësohet në të gjithë Republikën brenda pesëvjeçarit edhe për fshatarët privatë. Të forcohet kontrolli shtetëror në therjen e qeve të punës, të mëshqerrave, të viçave meshkuj dhe të deshëve e të qingjave meshkuj të racës rudë. Të ulet tatimi i mishit në masën që do ta shohë të arësyeshme Këshilli i Ministrave. Të shtohet prodhimi i peshkut për të zëvendësuar mishin; brenda pesëvjeçarit të paktën 1/3 e konsumit të mishit duhet të zëvendësohet me peshk. Komitetet e Partisë të zonave të peshkimit: i Sarandës, i Vlorës, i Durrësit, i Lezhës, i Shkodrës dhe i Pogradecit duhet të tregojnë kujdes të veçantë për realizimin e planit të peshkimit. Të merren masa nga ana e shtetit për të inkurajuar shtimin e kuajve dhe të gjedheve. Të merren masa nga industria në mënyrë që brenda këtij viti të fillojë prodhimi në vend i koncentreve me melasin e sheqerit, bërsitë e ullirit, të lules së diellit e të pambukut, për të përmirësuar bazën ushqimore të kafshëve. Të inkurajohet mbjellja e jonxhës në shkallë të gjerë. Të përgatiten kuadro të rinj në veterinari në mënyrë që brenda pesëvjeçarit të kemi të paktën një infermier veteriner për çdo lokalitet, përveç qendrave kryesore blegtorale. Të aprovohet sa më parë plani për përmirësimin dhe zhvillimin e blegtorisë. Orientimi kryesor në zooteknikë të jetë: përmirësimi i racave ekzistuese, duke përmirësuar bazën ushqimore të kafshëve dhe duke praktikuar kryqëzimin në masë.

12. — Gjatë pesëvjeçarit të bëhen investime të rëndësishme për të kryer bonifikime dhe çelje kanalesh për ujitje në shkallë të gjerë, sidomos në fushën e Myzeqesë. Komitetet e Partisë dhe komitetet ekzekutive të rretheve duhet të tregojnë një kujdes të veçantë për zgjerimin e bonifikimeve dhe të kanaleve ujitëse lokale. Ministria e Bujqësisë të marrë të gjitha masat për të forcuar organizimin e administrimit të kanaleve ujitëse. Hapja e kanaleve kulluese dhe e atyre ujitëse nuk duhet të bëhet vetëm nga ana e shtetit, por dhe nga ana e fshatarëve në bazë të punës vullnetare e kolektive ose me ndihmën e shtetit në formë të kreditit agrar.

13. — Brenda gjashtëmuorit të dytë të vitit 1952 duhet të ketë marrë fund korigjimi i kadastrës me mjete primitive në të gjithë Republikën dhe pastaj të vazhdojë verifikimi i këtij korigjimi me mjete gjeodedike të precizionit.

14. — Emulacioni socialist, brenda këtij viti, duhet të përfshijë jo më pak se 75 për qind të të gjithë punonjësve të sektorit të bujqësisë, të jetë përhapur në të gjitha kooperativat bujqësore ekzistuese dhe të organizohet më mirë në rrethe, lokalitete dhe fshatra. Brenda këtij viti të ngrihet sistemi i saktë i evidencës së bujqësisë deri në fshat. Të aprovohet nga qeveria dhe nga Presidiumi i Kuvendit Popullor dekreti për dhënjen e dekoratave të gjithë punonjësve të përparuar të bujqësisë të sektorit shtetëror, kooperativist dhe privat. Dekoratat të fillojnë të jepen brenda këtij viti. Të popullarizohet dhe të përhapet eksperiencia e kolkozianëve sovjetikë si dhe eksperiencia e bujqëve tanë të përparuar me anën e shtypit, të konferencave, të panairëve dhe të ekspozitave bujqësore. Të caktohen me dekret të Presidiumit të Kuvendit Popullor çmimet për rendimente të larta në bujqësi dhe të jepen këto çdo vit.

15. — Të popullarizohet plani pesëvjeçar i pyjeve dhe të organizohet puna në mënyrë që qysh sivjet, në baza vullnetare, të tejkalohet plani i pyllëzimeve dhe i përmirësimeve pyjore në mënyrë të konsiderueshme.

16. — Për të përgatitur kuadrot e nevojshëm për bujqësinë të merren këto masa të menjëhershme. Të planifikohet përgatitja e kuadrove për të gjithë pesëvjeçarin, të zgjerohen qysh sivjet bazat e kurseve për kuadrot e kooperativave bujqësore dhe të SMT-ve, të zgjerohen bazat e teknikumit bujqësor dhe të hidhen bazat e shëndosha për krijimin e Institutit të lartë shtetëror të bujqësisë, në rangun e Universitetit. Në vitin shkollor 1951-1952 të fillojë mësimet kursi i parë i agronomisë i këtij instituti me 50 studentë që të kenë mbaruar shkollën e mesme. Në vitin shkollor 1952-1953 të jenë ngritur tri katedra të institutit: katedra e agronomisë, e zooteknikës dhe ajo e bimëve industriale. Kapaciteti i institutit të jetë për jo më pak se 300 studentë.

17. — I gjithë aktiviteti ynë në sektorin e bujqësisë duhet të mbështetet në eksperiencën e bujqësisë sovjetike. Të luftohet pa mëshirë çfarëdo shfaqje e influencës borgjeze reaksionare në bujqësinë tonë. Teknikët tanë bujqësorë duhet të vënë të gjitha forcat e tyre për realizimin e detyrave të mëdha që u vihen përpara.

Të gjitha konditat për plotësimin e këtyre detyrave të rëndësishme ne i kemi. Për kryerjen e këtyre detyrave ne bazohemi në udhëheqjen e drejtë të Partisë, në udhëheqjen e drejtë të masave tona punonjëse nga klasa punëtore me Partinë në krye, në vullnetin dhe në kapacitetin e punonjësve të bujqësisë sonë, në patriotizmin e masave të fshatarësisë sonë punonjëse dhe në ndihmën e çmueshme të Bashkimit Sovjetik. Me zbatimin e këtyre detyrave, bujqësia jonë do të zhvillohet më tej, do të rriten rendimentet e prodhimit, do të rritet vëllimi i prodhimeve bujqësore, do të sigurohet në vend buka e popullit dhe të gjitha lëndët e para bujqësore për industrinë, do të rritet niveli i jetesës së fshatarësisë punonjëse.

II

MBI POLITIKËN E TATIMEVE DHE TË ÇMIMEVE NË DREJTIM TË FSHATARËSISË

1. — Për jetën ekonomike të fshatit, periudha që nga çlirimi dhe deri sot ndahet në dy faza: faza e parë është ajo që ka vazhduar deri në fillim të vitit 1949, kur sistemi i tatimit të fshatarësisë bazohej në grumbullimin e detyrueshëm nga ana e shtetit të të gjitha tepricave të prodhimeve kryesore bujqësore; faza e dytë është kjo në të cilën jemi sot, kur po aplikojmë sistemin e tatimit në natyrë për grumbullimin e prodhimeve bujqësore nga ana e shtetit si dhe tatimin financiar progresiv mbi ekonominë bujqësore. Grumbullimi i detyrueshëm i të gjitha tepricave të fshatarësisë ishte i nevojshëm për shtetin në fazën e parë, për arsye se ne dolëm të shkatërruar ekonomikisht nga lufta dhe nuk kishte rrugëdalje tjetër për të përballuar nevojat e shtetit dhe të qendrave të punës për bukë. Sistemi i tatimit në natyrë, që është në fuqi, është i drejtë, sepse e nxit fshatarësinë që të prodhojë sa më shumë, i siguron shtetit një fond të kënaqshëm prodhimesh bujqësore dhe i lë fshatarësinë teprica, me të cilat fshatarësia mund të manevrojë për t'i shitur sipas nevojës dhe dëshirës në tregun reciprok ose në tregun e lirë. Gjithashtu sistemi i tatimit financiar i ekonomisë bujqësore është i drejtë, sepse zbatohet në mënyrë

progresive në bazë të parimit që kush fiton më shumë, paguan më shumë. Por dispozitat ligjore në fuqi për tatimin financiar të ekonomisë bujqësore kanë të metën që nuk parashikojnë tatimin financiar individual të ekonomisë së kulakut. Nga tatimi financiar i ekonomisë bujqësore janë përjashtuar të gjithë fshatarët e varfër që kanë të ardhura më pak se 10 000 lekë në vit.

2. — Gabimet e shumta që ka pasur kadastra (regjistrimi i tokave) dhe të metat e klasifikimit të vjetër të tokave e kanë rënduar në një farë mase fshatarësinë. Prandaj qeveria është duke shpejtuar korrigjimin e kadastrës, ka bërë korrigjimin e klasifikimit të tokave dhe ka ulur koeficientët e tatimit të drithërave në masën mesatare 25 për qind. Shteti u ka kthyer me mijëra quintalë drithëra fshatarëve për efekt të thatësirës së madhe të vitit të kaluar dhe, këto kohët e fundit, u ka shpërndarë bukë në sasi të mjaftë deri në korrjet e reja, në formë huaje, rreth 25 mijë familjeve fshatare të varfëra. Të gjitha këto masa lehtësuese të shtetit ndaj fshatarësisë e kanë bazën në kujdesin e madh të Partisë dhe të qeverisë për aleaten e klasës punëtore, për fshatarësinë punonjëse, e kanë burimin në rritjen e fuqisë ekonomike të vendit tonë dhe në ndihmën e Bashkimit Sovjetik dhe të vendeve të demokracisë popullore.

Raporti ekzistues midis çmimeve të prodhimeve industriale dhe atyre të prodhimeve bujqësore është i atillë që nuk e inkurajon fshatarësinë që të tërhiqet më tepër nga tregu reciprok se sa nga tregu i lirë. Në këtë mënyrë shteti nuk mund të grumbullojë nga fshatarësia teprica të shumta me anën e tregut reciprok dhe tendenca e fshatarësisë për t'u tërhequr më tepër nga tregu i lirë shkakton ngritjen e çmimeve të prodhimeve bujqësore në tregun e lirë. Rruga më e drejtë për të zhdukur disproporcionin midis çmimeve të prodhimeve industriale dhe çmimeve të prodhimeve bujqësore është rruga e shtimit të vazhdueshëm të vëllimit të prodhimeve industriale dhe e përpjekjeve për uljen e kostos së tyre, rruga e përpjekjeve për uljen e shpenzimeve tregëtare dhe për rritjen e rendimenteve të prodhimit në bujqësi.

Detyrat tona në lidhje me politikën e tatimeve dhe të çmimeve në drejtim të fshatarësisë

Duke u nisur nga parimet kryesore të politikës së Partisë mbi tatimet dhe çmimet në drejtim të fshatarësisë, parime të cilat kanë për qëllim lehtësimin e fshatarëve të varfër e në radhë të parë të atyre më të pafuqishmëve ekonomikisht nga një anë dhe nga ana tjetër kufizimin ekonomik të kulakëve; duke marrë parasysh se si interesi i shtetit ashtu edhe ai i fshatarësisë punonjëse

është që fshatarësia të tërhiqet më tepër nga tregu reciprok se sa nga tregu i lirë; duke marrë parasysh se rruga më e drejtë për të zhdukur disproporcionin midis çmimeve të prodhimeve industriale dhe çmimeve të prodhimeve bujqësore, është rruga e zhvillimit të mëtejshëm të industrisë dhe e uljes së kostos së prodhimeve industriale, e shtimit të rendimenteve në bujqësi e blegtori, e shtimit të grumbullimeve të prodhimeve bujqësore në duart e shtetit dhe të organizatave ekonomike; më në fund duke marrë parasysh mundësitë praktike që janë krijuar për shtetin tonë nga forcimi i përgjithshëm i ekonomisë së vendit; duke marrë parasysh pra të gjitha këto, na dalin këto detyra konkrete:

1. — Organet e tregëtisë të organizojnë punën në mënyrë që të furnizojnë fshatarësinë gjatë këtij viti me një sasi prodhimesh industriale me anën e tregut reciprok, me ekuivalentët që do të caktojë qeveria dhe, duke i shkëmbyer këto prodhime industriale me prodhime bujqësore, të mund të grumbullojnë gjatë këtij viti jo më pak se 100 000 kv. drithëra buke në këtë treg. Të parashikohet që në vitet e ardhshme tregu reciprok i fshatarësisë të furnizohet në një masë kurdoherë më të madhe dhe grumbullimi i drithërave të bukës me anën e këtij tregu nga shteti të rritet çdo vit në një masë të madhe.

2. — Komitetet e Partisë, komitetet ekzekutive të rretheve dhe organet e grumbullimit të marrin të gjitha masat për identifikimin e kulakut në mënyrë që gjatë këtij viti nga tatimi individual i kulakut shteti të sigurojë një fond buke.

3. — Të intensifikohet propaganda e Partisë në masat e fshatarësisë për grumbullimin e tepricave të drithit. Grumbullimi i tepricave të drithit duhet të konsiderohet si një detyrë e rëndësishme për çdo komunist dhe funksionar të shtetit që punon në fshat.

4. — Organizatat e Partisë dhe organet e pushtetit ta organizojnë fushatën e grumbullimit në mënyrë që kjo fushatë të kryhet në afatet më të shkurtëra: për të lashtat të kryhet brenda gushtit dhe për të vonat brenda dhjetorit për të gjithë Republikën. Parulla e Partisë «lëmin e parë shtetit» duhet të bëhet realitet. Të kuptohet nga të gjithë se lufta për realizimin e planit të grumbullimit është lufta për sigurimin e bukës, për mbrojtjen e paqes, për ndërtimin e socializmit, për mbrojtjen e pavarësisë. Gjatë fushatave të grumbullimit, aktivistët më të mirë të Partisë dhe të pushtetit nga qendra dhe nga rrethet, duhet të angazhohen në punë intensive për realizimin e planit të grumbullimit.

Për të lehtësuar fshatarësinë, brenda tremujorit të dytë të këtij viti, Ministria e Grumbullimit të zgjerojë rrjetin e depove për grumbullimin e drithërave, duke ju afruar kështu më tepër bazës së grumbullimit, fshatit.

5. — Qeveria të studjojë dhe të vendosë uljen e koeficientit të tatimit të mishit dhe ta shpallë këtë sa më parë. Qendrat e punës të sigurojnë nga ekonomitë ndihmëse një përqindje të furnizimit të tyre me mish.

6. — Masat që ka marrë dhe do të marrë Partia dhe qeveria për lehtësimin e fshatarësisë, për forcimin ekonomik të fshatarëve të varfër dhe të mesëm, duhet të vlejë si një flamur lufte, si një armë e fortë në duart e organizatave të Partisë për ta lidhur edhe më tepër fshatarësinë punonjëse me pushtetin, me klasën punëtore, me Partinë... Në këtë drejtim duhet të punojnë agjitorët dhe propagandistët tanë.

7. — Qeveria të marrë në shqyrtim dhe të vendosë për përjashtimin nga tatimi financiar i ekonomisë bujqësore fshatarët e varfër në një masë më të madhe nga ajo e deritanishmja.

8. — Të gjithë komunistët dhe punonjësit pa parti që punojnë në sektorin shtetëror të ekonomisë sonë, në industri, në miniera, e kudo gjetkë duhet të mobilizohen plotësisht dhe seriozisht në luftën e përditshme për uljen e kostos së prodhimit. Lufta për uljen e kostos së prodhimit të kuptohet nga të gjithë si luftë për forcimin e aleancës midis klasës punëtore dhe fshatarësisë, për forcimin e fuqisë mbrojtëse të vendit, për ndërtimin e socializmit në vendin tonë. Ulja e kostos së prodhimit duhet të planifikohet në të gjitha ndërmarrjet e shtetit dhe brenda këtij viti kostoja e prodhimit duhet të ulet në masën mesatare jo më pak se 10 për qind në krahasim me vitin 1950 për të gjithë sektorin shtetëror të ekonomisë. Tejkalimi i normave të punës, kursimi i shpenzimeve administrative, shfrytëzimi sa më i plotë i mbeturinave të materialeve nga procesi i prodhimit, mirëmbajtja e maqinerive dhe shfrytëzimi maksimal i të gjitha burimeve të vendit për prodhim, të gjithë këta faktorë duhet të vlerësohen seriozisht për uljen e kostos së prodhimit.

III

MBI LUFTËN E KLASAVE NË FSHAT

1. — Lufta e klasave në fshat karakterizohet nga ashpërsimi i saj i vazhdueshëm. Nga njëra anë shtresa e kulakëve kufizohet ekonomikisht dhe izolohet politikisht nga Partia dhe masat e fshatarësisë punonjëse çdo ditë e në një masë më të madhe, nga ana tjetër kulakët intensifikojnë përpjekjet e tyre për të sabotuar ligjet dhe urdhëresat e qeverisë, për t'i rezistuar kufizimit ekonomik

dhe izolimit politik. Ata nuk kanë mundur që të organizohen në luftën e tyre kundër pushtetit në saje të vigjilencës së Partisë, të masave të fshatarësisë dhe të punës së palodhur të organeve të Sigurimit të Shtetit, por ata sabotojnë në njëmijë mënyra duke përdorur kryesisht taktikën «hidh gurin dhe fshih dorën». Këto kohët e fundit kulakët e fshatit të Zëmlakut kanë arritur që të kryejnë akte terroriste duke djegur kooperativën¹ e fshatit.

2. — Direktivat e Komitetit Qendror në lidhje me luftën e klasave në fshat nuk janë vënë në jetë si duhet. Deri sot një pjesë fare e vogël e kulakëve është identifikuar. Nga njëra anë vihet re një neglizhencë e pajustificuar në organizatat e Partisë dhe në organet shtetërore për identifikimin e kulakut, ndërsa nga ana tjetër konstatohen shfaqje të dëmshme ekstremizmi në lidhje me luftën kundër kulakëve të identifikuar. Këto shfaqje konsistojnë në masat policore kundër kulakëve në masë, të cilat të çojnë në ofensivën frontale kundër kulakëve, në likuidimin e tyre. Këto shfaqje janë dukur sidomos në rrethin e Korçës në tetorin e kaluar. Duhet të kuptohet prej të gjithëve se tani nuk jemi në fazën e likuidimit të kulakëve, po jemi në fazën e kufizimit ekonomik e të izolimit politik të kulakëve. Lufta kundër kulakëve ka sukses vetëm atëherë kur Partia mobilizon në këtë luftë masat e fshatarësisë së varfër dhe të mesme.

Detyrat tona në lidhje me luftën e klasave në fshat

Duke marrë parasysh se në fazën e kalimit nga kapitalizmi në socializëm lufta e klasave ashpërsohet, duke marrë parasysh atë që ka thënë i madhi Lenin se

«Edhe pas disfatës së parë serioze, shfrytëzuesit e përmbysur, të cilët nuk e prisnin përmbysjen e tyre, nuk e besonin një gjë të tillë, dhe as që u shkonte ndërmend për të, hidhen në luftë me energji të dhjetëfishuar, me pasion të tërbuar, me urrejtje njëqind herë më të madhe për të rifituar «parajsën» e humbur për familjet e tyre, që bënin një jetë kaq të ëmbël dhe të cilat tani «populli i thjeshtë harbut» i dënon me rrënim dhe varfërim (ose me punë «të thjeshtë»...)²,

detyra jonë është të zhvillojmë drejt luftën e klasave në fshat, duke kufizuar ekonomikisht dhe duke izoluar politikisht kulakët

¹ Stallën e lopëve dhe koçekët e misrit.

² V. I. Lenin. Veprat, vëll. 28, f. 285.

dhe duke tërhequr në këtë luftë masat e fshatarësisë së varfër dhe të mesme. Për këtë na dalin këto detyra konkrete:

1. — Brenda tre muajve të ardhshëm të identifikojmë të gjithë kulakët që janë në vendin tonë, sipas direktivave të letrës të Komitetit Qendror drejtuar komiteteve të rretheve më 1 tetor 1950. Të mbahet parasysh kurdoherë se ekonomia individuale fshatare lind vazhdimisht elementë kapitalistë, d.m.th. kulakë të rinj.

2. — Të forcojmë punën e Partisë në fshat për të bërë që në luftën për kufizimin e kulakut të tërhiqen masat e gjera të fshatarësisë së varfër dhe të mesme. Për të hedhur fshatarët e varfër në luftë kundër kulakëve, 25 për qind nga pasuria që shteti u konfiskon atyre kulakëve të cilët u rezistojnë ligjeve të shtetit dhe kryejnë akte armiqësore, t'u shpërndahet gratis fshatarëve të varfër.

3. — Të forcohet puna e Partisë në fshat për të zbuluar e për të demaskuar të gjitha metodat dhe format e punës së kulakut kundër pushtetit popullor.

4. — Të ndihmohen më tepër komitetet e Partisë në rrethe nga Komiteti Qendror në mënyrë që të mos vërtetohen shmangje nga vija e Partisë në luftën e klasave në fshat. Në këtë drejtim duhet të preokupohet jo vetëm Drejtoria e bujqësisë, por edhe drejtoritë e tjera të Komitetit Qendror dhe Sekretariati e Byroja Politike ta ndjekin çështjen në mënyrë të veçantë.

5. — T'u hiqen menjëherë kulakëve të gjitha lehtësitë që rrjedhin nga moszbatimi i drejtë i vijës së Partisë. (Kulaku nuk duhet të marrë farën e pambukut me të njëjtat kondita si të gjithë fshatarët e tjerë, kulaku duhet të paguajë më tepër për ujin që i jep atij shteti për të ujitur bimët industriale, ai duhet të paguajë më tepër se fshatarët e tjerë për punën e SMT-ve dhe SMT-ja të mos punojë veçse në tokat që ai do të mbjellë me bimë industriale). Për këtë, qeveria të nxjerrë dispozita të posaçme për kufizimin ekonomik të kulakëve.

IV

MBI FORCIMIN E KOOPERATIVAVE BUJQËSORE TË PRODHIMIT

1. — Kooperativat bujqësore ekzistuese janë formuar në baza të drejta, në bazë të principit të vullnetarizmit. Ato kanë arritur rendimente më të larta se fshatarët individualë. Të ardhurat

e fshatarëve kooperativistë janë relativisht më të larta se të ardhurat e fshatarëve individualë. Ato kanë përmirësuar metodat e punimit të tokës, kanë bërë përparime të dukshme në pikëpamje organizative.

2. — Por kooperativat tona bujqësore, në pjesën më të madhe të tyre, nuk kanë veçse dy-tre vjet që janë formuar dhe 1/3 e tyre janë formuar nga fundi i vitit 1950. Prandaj është akoma shumë shpejt që fshatarësia individuale të shohë shembullin e madh të organizimit, të prodhimit dhe të fitimit në kooperativat bujqësore ekzistuese. Me gjithë përparimet që kanë bërë kooperativat ekzistuese, prapëseprapë ato kanë shumë të meta të mëdha dhe akoma nuk është arritur që të ketë një diferencë shumë të madhe dhe shumë të dukshme midis prodhimit të kooperativave dhe prodhimit individual. Ekzistojnë ndryshime të mëdha midis kooperativave të një rrethi me ato të një rrethi tjetër, ka një disproporcion të dukshëm në shtrirjen e kooperativave bujqësore midis një rrethi dhe një rrethi tjetër, ka ndryshime të mëdha edhe midis kooperativave të një rrethi. Të metat e shumta dhe të mëdha organizative që rrjedhin nga moseksperienca e fshatarëve në çështjet e organizimit dhe të administrimit në kooperativat, niveli tepër i ulët i kuadrove drejtues të kooperativave dhe mjetet e tyre të punës relativisht të dobëta janë të metat kryesore të kooperativave bujqësore.

3. — Puna e Partisë në drejtim të kooperativave bujqësore është mjaft e dobët. Komitetet e Partisë në rrethe nuk kanë punuar në mënyrë të kënaqshme për të edukuar politikisht fshatarët kooperativistë, për të luftuar mentalitetin e vjetër të fshatarit që ka lindur nga marrëdhënjet e vjetra shekullore në prodhim, nuk janë kujdesur sa duhet për drejtimin praktik të punëve të kooperativave. Ndiurma agroteknike për kooperativat nga ana e Ministrisë së Bujqësisë nuk ka qenë në lartësinë e duhur.

4. — Perspektiva e bujqësisë sonë është pa dyshim kolektivizimi, sepse vetëm me anën e kolektivizimit mund të ndërtohet socializmi në fshat. Por në lidhje me kolektivizimin në fshat ne nuk duhet të shpejtohem në asnjë mënyrë, por të ecim me kujdes të madh dhe me hapa të sigurtë, në bazë të vendimeve të Konferencës II Nacionale të Partisë që «në kolektivizimin e bujqësisë as të mos shpejtojmë dhe as të ndalemi në vend». Prandaj si detyrë imediate dhe urgjente na vihet jo rritja e numrit të kooperativave bujqësore të prodhimit, por forcimi i gjithanshëm i kooperativave ekzistuese, në mënyrë që këto të bëhen shembull i shkëlqyer për fshatarët e varfër dhe të mesëm, për t'i tërhequr këta në rrugën e kolektivizimit pa asnjë presion, por vullnetarisht dhe në bazë të shembullit praktik të kooperativave ekzistuese. Çfarëdo shpej-

timi i pamatur në kolektivizimin e bujqësisë në konditat e sotme do të çonte në gabime të rënda që do ta dëmtonin rëndë vetë çështjen e kolektivizimit të bujqësisë.

Detyrat tona konkrete në lidhje me forcimin e kooperativave bujqësore të prodhimit

1. — Ministria e Bujqësisë të marrë të gjitha masat për t'u ardhur në ndihmë më efektivisht se sa deri sot kooperativave bujqësore, duke i ndihmuar ato me kuadro, me SMT, farëra, kafshë dhe kafshë pune, fidane, plehra kimike, kredit bankar, ndihmë agroteknike etj. Të forcohet kursi i kuadrove të kooperativave dhe në këto kurse të futen fshatarë të ndershëm e punëtorë, me qëllim që të ndihmohen kooperativat me kuadrot e nevojshëm. Të merren masa praktike që brenda vitit të gjitha kooperativat ekzistuese të sistemojnë më mirë mbajtjen e llogarive dhe planifikimin e punës.

2. — Komitetet e Partisë në rrethe dhe Drejtoria e bujqësisë pranë Komitetit Qendror duhet të tregojnë kujdes të veçantë dhe të pandërprerë për edukimin politik dhe ideologjik të komunistëve kooperativistë dhe të kooperativistëve pa parti. Ministria e Bujqësisë duhet të forcojë sa më parë seksionet e bujqësisë në rrethet ku janë ngritur kooperativat bujqësore dhe të tregojë një kujdes të veçantë për të ndihmuar teknikisht kooperativat bujqësore në mënyrë që ato të përmirësojnë metodat e punimit të tokës, planifikimin dhe mbajtjen e llogarive e drejtimin administrativ.

3. — Propaganda e Partisë në favor të kolektivizimit duhet të bëhet në bazë të shembullit konkret të sukseseve që arrihen në kooperativat ekzistuese. Duhet mbajtur parasysh kurdoherë parimi leninist-stalinian sipas të cilit bashkimi i ekonomive fshatare duhet bërë vetëm në bazë të dëshirës dhe vullnetit të lirë të fshatarit për t'u futur në rrugën e kolektivizimit. Përhapja e formave fillestare të kolektivizimit të bujqësisë duhet të bëhet duke u bazuar po në parimin themelor të vullnetarizmit, nuk duhet shpejtuar dhe duhet ecur me kujdes për të mos rënë në gabime. Meqenëse si detyrë kryesore për Partinë del forcimi i kooperativave ekzistuese, fare lehtë mund të paraqitet rreziku që të formohen kolektiva bujqësore pa u pjekur konditat ose nën maskën e kolektivave bujqësore të prodhimit, gjë e cila do të ishte e dëmshme. Prandaj t'u tërhiqet vëmendja të gjitha organeve të Partisë dhe të pushtetit që në praktikën e tyre të mos përziejnë formën e kolektivave bujqësore me kooperativat bujqësore ekzistuese. Kooperativa bujqësore të prodhimit mund të formohen vetëm me aprovimin e Ministrisë së Bujqësisë.

MBI PUNËN E PARTISË NË FSHAT

1. — Puna organizative në fshat është shumë e dobët. Komitetet e Partisë të rretheve kanë të meta dhe lidhjet e tyre me organizatat bazë të fshatit janë të dobëta. Në këtë mënyrë direktivat e Partisë nuk mbërrijnë të plota në fshat, komitetet e rretheve nuk ushtrojnë kontrollin e duhur dhe nuk japin ndihmën e nevojshme në drejtim të organizatave bazë të fshatit.

2. — Puna politike dhe ideologjike në fshat nuk është e kënaqshme. Komitetet e rretheve nuk kanë bërë përpjekjet e duhura për ngritjen politike dhe ideologjike të komunistëve në fshat, aq më pak për ngritjen politike dhe kulture të fshatarëve pa parti.

3. — Nga mungesat kryesore të mësipërme, organizatat e Partisë në fshat nuk kanë mundur që të formojnë aktive të forta të fshatarëve pa parti rreth tyre:

«Partia rritet dhe forcohet — ka thënë shoku Stalin — në goftë se rritet dhe forcohet rreth partisë shtresa e gjërë e aktivitetit pa parti. Partia dobësohet dhe vyshket, në goftë se një aktiv i tillë mungon»¹.

Aktivet e fshatarëve pa parti te ne janë mjaft të dobëta. Shumë herë punën e bëjnë vetë komunistët, pa u përpjekur që të aktivizojnë edhe fshatarët pa parti.

4. — Komunistëve të fshatit në përgjithësi, si edhe shumë funksionarëve të shtetit, u mungon takti i duhur për afrimin me masat e fshatarësisë, për forcimin e lidhjeve me masat fshatare. Kjo gjë e dëmton punën e Partisë në fshat, i dëmton lidhjet e Partisë me masat e fshatarësisë.

Këto janë të metat kryesore të punës së Partisë në fshat. Nga ana tjetër edhe sukseset e punës së Partisë në fshat janë të mëdha. Këto suksese që janë rezultati i punës së komunistëve në fshat duken në patriotizmin e flaktë të fshatarësisë sonë, e cila si dje në kohën e luftës, që, me kushtimin e parë të Partisë për luftën çlirimtare, rroku armët dhe luftoi trimërisht, ashtu edhe sot është e lidhur në mënyrë të pazgjydhshme me Partinë dhe me pushtetin. Puna e palodhur që bën fshatarësia për shtimin e prodhimit dhe shlyerjen e detyrimeve kundrejt shtetit, pjesëmarrja aktive dhe shumë e kënaqshme në votimet e 28 majit të vitit të

¹ J. V. Stalin. Veprat, vëll. 6, f. 316.

kaluar dhe të shkurtit të këtij viti, pjesëmarrja në huan e shtetit, vigjilenca e masave të fshatarësisë kundër armiqve të brendshëm, urrejtja e pakufi kundër armiqve të brendshëm dhe të jashtëm, gatishmëria e saj për të mbrojtur atdheun nga çdo armik, dashuria e madhe për Partinë tonë, dhe për Bashkimin Sovjetik, dashuria për paqen, të gjitha këto janë suksese të punës së Partisë në fshat.

Detyrat tona në lidhje me forcimin e punës së Partisë në fshat

Duke qenë se Partia është repart pararojë i klasës punëtore dhe se pa një Parti të fortë në fshat nuk mund të zgjidhet asnjë problem i rëndësishëm i fshatarësisë, se forcimi i Partisë në fshat është vendimtar për suksesin në kryerjen e të gjitha detyrave që vihen para nesh dhe duke pasur kurdoherë parasysh porositë e shokut Enver për forcimin e Partisë në fshat, detyra jonë kryesore është: të forcojmë organizativisht, politikisht dhe ideologjikisht Partinë në fshat. Për këtë na dalin këto detyra konkrete:

1. — Të forcohen komitetet e Partisë në rrethe duke shtuar numrin e instruktorëve të tyre si edhe numrin e organizatorëve të Partisë në rrethe në mënyrë që komitetet e rretheve të mund të forcojnë lidhjet, kontrollin dhe ndihmën në drejtim të organizatave bazë të Partisë në fshat.

2. — Të merren masa për përmirësimin e përbërjes shoqërore të byrove të organizatave bazë në fshat, të këshillave popullore, të forumeve të rinisë, të gruas e të Frontit. Të ngrihen me guxim në këto poste fshatarë të varfër, të ndershëm dhe të devotshëm për Partinë dhe të spastrohen ato nga elementët e dobët.

3. — Byroja Politike të studjojë sa më parë masat konkrete që duhen marrë për forcimin e punës politike dhe ideologjike në fshat.

4. — Ti kushtohet kujdes i veçantë ngritjes dhe zhvillimit të mëtejshëm kultural dhe arësimor të masave fshatare.

5. — Organizata e BGSH të forcojë punën e saj edukative për të zgjeruar pjesëmarrjen e gruas në prodhim, për forcimin e rolit të gruas në fushën politike, ekonomike dhe kulturele të vendit. Një kujdes i veçantë duhet të tregohet për pjesëmarrjen e gruas në punët bujqësore.

6. — Të merren masa nga ana e shtetit dhe e Partisë për të forcuar këshillat popullore të fshatit, komitetet ekzekutive të lokaliteteve si dhe komitetet ekzekutive të rretheve. Këshillat popullore dhe komitetet ekzekutive duhet të spastrohen nga elementët e paaftë dhe nga ata që janë të padëshirueshëm duke i

zëvendësuar këta me elementë të shëndoshë, të zot dhe besnikë të pushtetit dhe të Partisë.

7. — Detyrë e rëndësishme e Partisë në fshat duhet të jetë forcimi i aktiveve të fshatarëve pa parti rreth organizatave të Partisë në fshat. Kjo duhet të bëhet duke aktivizuar në radhë të parë komunistët e fshatit dhe nëpërmjet këtyre të aktivizohen këshillat e fshatarëve, organizata e rinisë, e gruas dhe e Frontit. Pa një aktiv të tillë të fortë, puna e Partisë në fshat do të çalojë kurdoherë.

8. — Një kujdes i veçantë duhet treguar për forcimin e organizatave të rinisë. Organizatat bazë të BRPSH në ato fshatra që nuk ka organizata partie, duhet të mbajnë përgjegjësinë e plotë për zbatimin e direktivave të Partisë. KQ i BRPSH të anullojë menjëherë punën e rinisë në fshat dhe të marrë masa efektive për përmirësimin e saj.

9. — Për të forcuar lidhjet me masën e fshatarësisë punonjëse, të udhëhiqemi nga mësimet e shokut Stalin, sipas të cilave:

«Po për t'u dhënë gjallëri Sovjetëve, është i domosdoshëm, përveç gjithë të tjerave, një kusht. Për këtë është e domosdoshme të ndryshohet nga rrënjët vetë mënyra e trajtimit të fshatarësisë. Po në se qëndron ky ndryshim? Në faktin që komunisti të mësojë të trajtojë njerinë pa parti si të barabartë me të. Në faktin që ai nuk duhet të komandojë, por të dëgjojë me vëmendje zërin e njerëzve pa parti. Në faktin që ai nuk duhet vetëm t'i mësojë njerëzit pa parti, por edhe të mësojë prej tyre. Dhe ne kemi çfarë të mësojmë nga njerëzit pa parti. Çështja e marrëdhënjeve midis anëtarëve të partisë dhe njerëzve pa parti, është çështja më kryesore e praktikës sonë të partisë. Lenini e përcakton këtë marrëdhënie me dy fjalë: besim reciprok. Por besimi i një fshatari pa parti nuk mund të fitohet atje ku ai nuk trajtohet si njeri i barabartë me të tjerët. Në këto raste në vend të besimit krijohet mosbesimi, kështu që shpeshherë puna përfundon në një mënyrë të atillë që në mes të partisë dhe njerëzve pa parti krijohet një hendek i thellë, partia shkëputet nga masat, dhe lidhja e punëtorëve me fshatarët shndërrohet në një përçarje»¹.

Kështu na mëson shoku Stalin. Dhe ne kështu duhet të veprojmë. Këto janë të metat dhe detyrat kryesore në lidhje me punën e Partisë në fshat. Zbatimi i këtyre detyrave është konditë e domos-

¹ J. V. Stalin. Vepra, vëll. 6, f. 318-319.

doshme për zhvillimin e mëtejshëm të bujqësisë, për forcimin e pushtetit, për ndërtimin e socializmit.

Aparati i Komitetit Qendror dhe dikasteret si dhe gjithë institucionet e interesuara, të planifikojnë, brenda muajit prill të këtij viti, masat që do të marrin për zbatimin e detyrave që a ngarkohen nga ky plenum.

Detyrat që shtrohen nga ky plenum janë plotësisht të zbatueshme. Partia jonë, e udhëhequr drejt nga Komiteti i saj Qendror me shokun Enver në krye, ndihma e Bashkimit Sovjetik dhe e popujve të vendeve të demokracisë popullore, janë garanci për realizimin e këtyre detyrave. As shantazhet dhe kërcënimet e armiqve tanë të jashtëm, as përpjekjet e reaksionarëve të brendshëm, nuk mundin dhe nuk do të mundin kurrë të ndalojnë hovin e popullit tonë në punë, për mbrojtjen e paqes dhe të atdheut, për ndërtimin e socializmit.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

*Botohet sipas origjinalit që
gjetet në Arkivin Qendror
të Partisë*

LETËR E KQ TË PPSH MBI KUPTIMIN DHE ZBATIMIN DREJT TË POLITIKËS SË PARTISË NË LIDHJE ME KUFIZIMIN EKONOMIK TË KULAKËVE

21 maj 1951

KOMITETEVE TË PARTISË NË RRETHE

Dihet se metoda e tatimit individual të kulakut është një nga masat kryesore që merr Partia dhe pushteti për kufizimin ekonomik të kulakut në fazën e sotshme të luftës së klasave në fshat. Por shumë organe të Partisë nuk e kanë të qartë se në ç'masë duhet të tathet individualisht kulaku. Për ta bërë të qartë se deri në ç'masë duhet të tathet individualisht ai është e nevojshme të vepohet si më poshtë:

1. — Para se t'i lëshohet fletëdetyrimi kulakut për tatimin në natyrë të detyrueshëm si të gjithë fshatarët e tjerë, duhet të llogaritet sasia që ka mundësi të prodhojë kulaku. Kjo llogari bëhet nga i plotfuqishmi i grumbullimit duke marrë parasysh klasën e tokës së kulakut dhe sipërfaqen efektive që ai do të mbjellë. Mbi këto kritere llogaritet sasia e drithit që do të mund të prodhojë kulaku. Nga kjo sasi hiqet detyrimi i rregullt ndaj shtetit, lihet buka dhe fara e nevojshme për kulakun dhe, nga tepricat reale që i mbeten atij, i merret një pjesë në formë të tatimit individual me qëllim kufizimi. Porse duhet pasur kurdoherë parasysh që llogaritja e tepricave të kulakut duhet të bëhet kurdoherë në bazë të sipërfaqeve reale që mbjell ai dhe jo thjeshtësisht në bazë të kadas-trës, pasi mund të ndodhë që një kulak të ketë edhe sipërfaqe të mbuluara me pyll që nuk i mbjell dhe në rast se do të tathet edhe mbi këtë sipërfaqe në formë individuale, mund të ndodhë, që atij, për të larë tatimin individual t'i duhet të dorëzojë fondin e bukës dhe të farës, në këtë mënyrë masa e kufizimit kalon në masë likuidimi. Përqindja e tatimit individual mbi tepricat e kulakut caktohet nga vlerësimi i të gjithë fuqisë ekonomike të kulakut dhe kjo përqindje shkon nga 10 deri 75 për qind mbi tepricat reale të kulakut. Duhet mbajtur parasysh se qëllimi i këtij tatimi individual

mbi kulakun është për ta kufizuar ekonomisht atë, për të mos i lënë atij teprica të shumta që të pasurohet, por jo për t'ja marrë të gjitha tepricat dhe për ta detyruar qysh sot që të shpërngulet nga fshati nga kufizimi jashtë masës që mund t'i bëhet. Japim këtu një shembull konkret mbi mënyrën se si tatóhet kulaku individualisht.

Kulaku x, ka 10 ha. tokë¹ të klasit të parë. Nga kjo sipërfaqe ai ka një ha. pyll, një gjysmë ha. moçal, një gjysmë ha. e ka mbjellë me perime dhe një ha. e ka mbjellë me jonxhë. Kjo sipërfaqe prej 3 ha., në bazë të ligjit përjashtohet nga tatimi. Pjesa tjetër e sipërfaqes është mbjellë: 3 ha. të lashta dhe 4 ha. janë të destinuar që të mbillen misër. Për këta 7 ha. kulaku tatóhet si të gjithë fshatarët e tjerë, pa marrë parasysh nëse do t'i mbjellë ose jo të 7 ha. Për t'i lëshuar fletëdetyrimin kulakut për misrin, veprohet kështu: për 4 ha. misër tokë të klasit të parë, kulaku i detyrohet shtetit 18,8 kv. (koeficienti i tatimit për tokën e klasit të parë në misër është 4,7 kv. për ha.; $4 \times 4,7 = 18,8$ kv.). Porse të 4 ha. e këtij kulaku prodhojnë më shumë. Të themi se rendimenti i kësaj toke të kulakut është 15 kv. për ha., siç është parashikuar nga shteti. Atëhere nga 4 ha. kulaku prodhon 60 kv. misër. Po t'i heqim atij detyrimin kundrejt shtetit në masën 18,8 kv., i mbeten 41,2 kv. Kësaj teprice, i heqim bukën dhe farën e kulakut. Të themi se kulaku ka 10 persona në shtëpi. Kështu, për bukë atij do t'i duhen 20 kv. (duke llogaritur normën e rregullt prej 2 kv. për frymë në vit) dhe 4 kv. farë (duke llogaritur normën 1 kv. për ha.), d.m.th. gjithsej kulakut i duhen për bukë dhe farë 24 kv. Po ta heqim këtë sasi nga teprica gjejmë se kulaku i mbeten edhe 17,2 kv. misër. Mbi këtë sasi (teprica reale) ushtrohet tatimi individual. Është e logjikshme që këtij kulaku t'i marrim 10 kv. të tjerë përveç tatimit të rregullt. (Kjo masë tatimi, siç u tha, bëhet duke vlerësuar të gjithë fuqinë ekonomike të kulakut). Në këtë mënyrë fletëdetyrimi i lëshohet kulakut për 28,8 kv. misër (18,8 kv. që është tatimi i detyrueshëm dhe 10 kv. që është tatimi individual). Në rast se parashikohet që kulaku mund të prodhojë përmbi 15 kv. për ha., atëhere masa e tatimit individual shtohet dhe në rast se parashikohet të prodhojë më pak, pakësohet. Porse duhet pasur parasysh që sasia e bukës të mos i zbritet dy herë kulakut, të mos i zbritet edhe për misër edhe për grurë, por t'i zbritet vetëm për misrin, ndërsa fara zbritet për të gjitha prodhimet. Ky shembull duhet të vlejë si orientim i përgjithshëm dhe jo të merret në mënyrë mekanike.

¹ Shoku Enver këtë shembull e merr më tepër për lehtësi llogaritjeje, në fakt duhet mbajtur parasysh se sipas ligjit të reformës agrare, si rregull, çdo ekonomie i lejoheshin 5 ha. tokë, kurse vetëm familjeve të mëdha u bëhej një shtesë e vogël për çdo kurorë.

2. — Në ato raste ku llogaria e mësipërme nuk është bërë me kohë dhe tatimi individual nuk është shënuar në fletëdetyrimet që janë lëshuar, kulakut i lëshohet fletëdetyrimi tjetër për tatimin individual. Porse duhet të bëhet rregull që fletëdetyrimi, si për tatimin e rregullt, ashtu edhe për tatimin individual, duhet të bëhet një herë e mirë me anën e një fletëdetyrimi.

3. — Duhet mbajtur parasysh se tatimi individual i imponohet kulakut jo vetëm për misrin dhe grurin, por për të gjitha drithërat që tatóhen dhe jo vetëm për drithërat, por edhe për prodhimet e tjera që tatóhen, si mishi, fasulja, veza, lesi. Tatimi individual në këta artikuj bëhet po me kriterin e mësipërm, duke llogaritur tepricat reale të kulakut. Kulakut i hidhet tatimi individual edhe me rastin e tatimit të ekonomisë bujqësore (tatimi financiar).

Në këtë mënyrë duhet të veprohet për tatimin individual të kulakut. Për çdo paqartësi, komitetet e rretheve duhet të kërkojnë shpjegime në aparatën e Komitetit Qendror.

Për Komitetin Qendror të PPSH

Sekretari i Përgjithshëm

Enver Hoxha

Botohet sipas librit:

Enver Hoxha. «Vepra, vëll. 8»

PLENUMI XI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Tiranë, 21 shtator 1951

KOMUNIKATË

E PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Më 21 shtator të këtij viti u mbledh Plenumi XI i Komitetit Qendror të Partisë të Punës të Shqipërisë, nën kryesinë e Sekretarit të Përgjithshëm të Partisë, shokut Enver Hoxha.

Plenumi dëgjoi, diskutoi dhe aprovoi raportin e Byrosë Politike «Mbi direktivat e planit të parë pesëvjeçar të shtetit (1951-1955)», mbajtur nga Sekretari i Përgjithshëm i Partisë, shoku Enver Hoxha.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Botohet sipas gazetës

«Zëri i Popullit», Nr. 228 (922),

23 shtator 1951

V E N D I M

I KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË RPSH DHE I BYROSË POLITIKE TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH «MBI NDËRTIMIN E CENTRALIT HIDROELEKTRIK MBI LUMIN E MATIT»

7 janar 1952

Të udhëhequr nga vija e drejtë e Partisë së Punës të Shqipërisë mbi ndërtimin e bazave të socializmit në vendin tonë, mbi zhvillimin ekonomik dhe kulturor të popullit tonë, Këshilli i Ministrave i RPSH dhe Byroja Politike e Komitetit Qendror të Partisë, në mbledhjen e përbashkët të datës 7 janar 1952, shqyrtuan mundësitë imediate për zgjerimin e elektrifikimit në vendin tonë.

Këshilli i Ministrave dhe Byroja Politike e Komitetit Qendror të Partisë duke marrë parasysh:

a) Nevojën e krijimit të një sistemi të përbashkët të energjisë elektrike për të gjithë Republikën, në mënyrë që të sigurohet me energji elektrike të mjaftueshme industria si edhe shumë qendra të banuara të vendit tonë;

b) rëndësinë e madhe që ka elektrifikimi i vendit për zhvillimin e mëtejshëm, të shpejtë dhe të gjithanshëm të ekonomisë dhe të kulturës popullore;

c) mundësitë e mëdha që rrjedhin nga ekzistenca e burimeve të rëndësishme hidroelektrike në vendin tonë, si dhe leverdishmërinë e shfrytëzimit të këtyre burimeve;

d) nevojën e zhvillimit ekonomik dhe kulturor të krahinave të Veriut të Republikës sonë, të cilat kanë pasë qenë lënë krejtësisht pasdore nga regjimet antipopullore të satrapit Ahmet Zogu dhe të okupatorëve fashistë;

e) përfitimet e mëdha dhe të afërta, si nga pikëpamja ekonomike ashtu edhe nga ajo kulturele, që do të ridhnin nga ndërtimi i një centrali hidroelektrik të madh për shfrytëzimin e energjisë hidrike të lumit të Matit;

gjithashtu duke u mbështetur:

a) në udhëheqjen e drejtë marksiste-leniniste të Partisë së Punës, organizatores së të gjitha fitoreve të popullit tonë;

b) në patriotizmin e shkëlqyer të popullit tonë, në frymën revolucionare, hovin në punë dhe aftësinë krijuese të klasës sonë punëtore;

c) në fuqinë ekonomike të vendit tonë që rritet dita-ditës;

ç) në ndihmën e madhe dhe bujare të Bashkimit Sovjetik që i është dhënë e po i jepet popullit tonë për ndërtimin e bazave të socializmit;

Këshilli i Ministrave dhe Byroja Politike e Komitetit Qendror të Partisë,

V e n d o s ë n :

1. — Të ndërtohet dhe të vihet në shfrytëzim, brenda vitit 1955, një central hidroelektrik me kapacitet 20 000 kilovat dhe që të mund të prodhojë 100 milion kilovat-orë energji elektrike në vit. Ky central hidroelektrik të ndërtohet mbi lumin e Matit, në afërsitë e katundit Ulëz të rrethit të Burrelit. Fillimi i punimeve për ndërtimin e këtij centrali hidroelektrik të bëhet më 11.I.1952.

2. — Të ndërtohet dhe të vihet në shfrytëzim, brenda vitit 1955, vija elektrike e tensionit të lartë 110 000 voltësh, me një gjatësi të përgjithshme prej rreth 150 kilometrash, dhe që do të kalojë: Ulëz-Tiranë-Elbasan-Cërrik-Qyteti «Stalin», duke u futur në këtë sistem shpërndarjeje të energjisë elektrike Centrali hidroelektrik mbi lumin e Matit, Centrali hidroelektrik «Lenin», Centrali termoelektrik i Kombinatit të tekstileve «Stalin» dhe centrali termoelektrik i uzinës së rafinerisë së naftës që do të ndërtohet. Po brenda kësaj kohe të ndërtohen dhe të vihen në shfrytëzim edhe vija të tjera të tensionit të lartë sekondar prej 35 000, 10 000 dhe 6 000 voltësh, për të rregulluar sistemin e shpërndarjes së energjisë elektrike. Nga ky sistem shpërndarjeje do të ushqehen me energji elektrike: Tirana, Elbasani, uzina e rafinerisë së naftës që do të ndërtohet, Kombinati i naftës «Stalin», Rubiku, Bulqiza, Durrësi, Miniera e Krrabës, Miniera e Selenicës. Me ndërtimin e centralit hidroelektrik mbi lumin e Matit do të krijohen të gjitha mundësitë për të ushqyer me energji elektrike plotësisht edhe Shkodrën, Lezhën, Rrëshenin, Burrelin, Peshkopinë, Shëngjinin, Milotin, Mamurrasin, Krujën, Shijakun, Kavajën, Rrogozhinën, Lushnjën, Fierin, Beratit etj.

3. — Për nevojat e ndërtimit të centralit hidroelektrik mbi

lumin e Matit, brenda vitit 1952 të ndërtohet rruga malore automobilistike e klasit të parë dhe e asfaltuar, e gjatë rreth 25 kilometra: Ura e Milotit—Vablinjë—Kakërdhok dhe vitin që vjen kjo rrugë të lidhet me Burrelin, në mënyrë që të shërbejë për shkurtimin rreth 20 kilometra të rrugës automobilistike ekzistuese Milot-Burrel dhe të lidhë qendrat e banuara të malësisë që ajo do të përshkojë.

4. — Për ndërtimin e centralit hidroelektrik mbi lumin e Matit ngarkohet Ministria e Ndërtimit, e cila duhet:

a) Brenda vitit 1952 të bëjë të gjitha përgatitjet e nevojshme, si ndërtimin e rrugës Ura e Milotit—Kakërdhok, ndërtimin e të gjitha kantierëve të punës, grumbullimin e materialit të nevojshëm, organizimin e gjithanshëm të punës etj.

b) Të përdorë si forcë kryesore për ndërtimin e centralit hidroelektrik mbi lumin e Matit të gjithë kolektivin punonjës, punëtorë dhe specialistë, që kanë marrë pjesë në ndërtimin e Centralit hidroelektrik «Lenin». Drejtor i ndërmarrjes së ndërtimit të centralit hidroelektrik mbi lumin e Matit të jetë shoku Rahman Hanku, në kategorinë e nënministrit.

c) Të interesohet që numrin më të madh të fuqisë punëtore për ndërtimin e centralit hidroelektrik ta sigurojë nga rrethet Burrel, Krujë, Peshkopi, Rrëshen dhe Lezhë. Të interesohet në mënyrë të veçantë për organizimin e kurseve të specializimit teknik për ndërtimin dhe montimin e centralit hidroelektrik sidomos me punëtorët që do të vijnë nga këto rrethe.

5. — Ministria e Industrisë duhet:

a) Të studjojë shpërndarjen e energjisë elektrike në qendrat e banuara dhe në ato industriale sikundër thuhet në pikën 2 të këtij vendimi.

b) Në bashkëpunim me Drejtorinë e industri-komunikacionit të Komitetit Qendror të Partisë, të marrë të gjitha masat e nevojshme për përgatitjen e kuadrit të shfrytëzimit të centralit hidroelektrik, në mënyrë që ky kuadër të jetë plotësisht i përgatitur para mbarimit të ndërtimit të centralit hidroelektrik.

c) Në bashkëpunim me Ministrinë e Tregëtisë së Jashtme, të marrë të gjitha masat për të siguruar me kohë projektet e ndërtimit dhe të montimit, specialistët, mekanizmat, maqineritë dhe materialet e nevojshme, në bazë të grafikut të ndërtimit dhe të montimit që do të aprovohet nga Kryesia e Këshillit të Ministrave.

6. — Ngarkohet Ministria e Bujqësisë, Ministria e Industrisë dhe Ministria e Pyjeve që të marrin të gjitha masat për shfrytëzimin e plotë dhe para kohe të të gjithë materialit pyjor që përfshihet në zonën që do të përmblytet nga liqeni i centralit hidroelektrik.

7. — Brenda këtij muaji të krijohet një komision qeveritar për të vlerësuar pasurinë e fshatarëve të zonës që do të përmbytet nga liqeni i centralit hidroelektrik. Komisioni duhet të ketë parasysh:

a) Të gjithë fshatarëve të zonës që do të përmbytet nga liqeni, shteti duhet t'u sigurojë toka të mira diku gjetkë dhe në sasi të barabarta ose ekuivalente me ato që do të dëmtohen.

b) Të gjithë fshatarëve të zonës që do të përmbytet nga liqeni, shteti do t'u bëjë shtëpi të reja sipas modelit që do të aprovohet nga Kryesia e Këshillit të Ministrave.

c) Të gjithë fshatarët e zonës që do të përmbytet nga liqeni do të shpërblehen me të holla nga shteti për dëmtimet e pemëve, mullinjeve etj.

Komisioni duhet të përfundojë studimet e tij brenda vitit 1952, ndërsa shpërngulja dhe rivendosja e fshatarëve që do të dëmtohen duhet të bëhet brenda vitit 1955.

8. — Ministria e Komunikacionit dhe PTT brenda muajit prill të këtij viti të ndërtojë një vijë telefonike të përhershme Milot-Vablinjë-Ulëz dhe brenda muajit korrik të këtij viti ta çojnë këtë vijë deri në Burrel.

9. — Ministria e Tregëtisë së Brendshme dhe Bashkimi Qendror i Kooperativave të Konsumit duhet të marrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar plotësisht dhe në rregull furnizimin e kantierëve të punës për ngritjen e centralit hidroelektrik. Furnizimi i këtyre kantierëve duhet të ketë precedencë.

10. — Drejtorja e rezervave të punës pranë Këshillit të Ministrave të interesohet në mënyrë të posaçme për të siguruar me kohë kontingjentet e nevojshme në punëtorë dhe specialistë për nevojat e ndërtimit të centralit hidroelektrik. Këto kontingjente duhet të sigurohen kryesisht nga rrethet Burrel, Krujë, Peshkopi, Rrëshen dhe Lezhë.

11. — Ministria e Arësimit ngarkohet që të organizojë kurset e nevojshme kundër analfabetizmit që në fillim të ngritjes së kantierëve të ndërtimit.

12. — Komiteti i arteve dhe i kulturës të marrë të gjitha masat për ngritjen e qendrave kulturele dhe artistike në kantieret e ndërtimit. Në kantierin e Ulzës të ndërtohet një kinema e përhershme.

13. — Ministria e Shëndetësisë të marrë të gjitha masat e nevojshme për sigurimin higjieno-sanitar të kantierëve të punës.

14. — Komitetet e Partisë të rretheve Burrel, Krujë, Peshkopi, Rrëshen dhe Lezhë ta konsiderojnë ndërtimin e centralit hidroelektrik mbi lumin e Matit si detyrën e tyre më kryesore gjatë

planit të parë pesëvjeçar dhe të marrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar realizimin e planit të ndërtimit dhe të montimit me forcat dhe mjetet që ato disponojnë. Ato duhet të bëjnë që masat fshatare të rretheve të tyre të mobilizohen për ndërtimin e centralit hidroelektrik, duke e konsideruar këtë si aksionin ekonomik, politik dhe patriotik më të madh gjatë planit të parë pesëvjeçar.

15. — Për drejtimin e punës së Partisë në kantieret e ndërtimit të centralit hidroelektrik të ngrihet një komitet partie në rangun e komiteteve të Partisë të rretheve. Komiteti i Partisë për ndërtimin e centralit hidroelektrik do të lidhet drejtpërsëdrejti me Komitetin Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë. Drejtoritë përkatëse të Komitetit Qendror të Partisë të marrin të gjitha masat për organizimin dhe drejtimin e Partisë në kantieret e punës, si edhe për edukimin ideo-politik e kultural në këto kantiere.

16. — Këshilli Qendror i Bashkimeve Profesionale të organizojë bashkimet profesionale në kantieret e punës dhe emulacionin socialist për rritjen e rendimentit në punë, forcimin e disiplinës në punë, uljen e kostos së ndërtimit dhe të kujdeset në mënyrë të posaçme për përmirësimin e konditave të jetesës së kolektivit punonjës.

17. — Komiteti Qendror i BRPSH të organizojë rininë në kantieret e punës dhe të kujdeset në mënyrë të posaçme për edukimin e rinisë në këto kantiere, për t'i bërë këto një shkollë të madhe edukative dhe krijuese për rininë. Ai duhet të kujdeset në mënyrë të posaçme që në këto kantiere të shkojnë sa më shumë të rinj dhe të reja, sidomos nga rrethet Burrel, Krujë, Peshkopi, Rrëshen dhe Lezhë, me qëllim që këta të bëhen punëtorë të përhershëm me rrogë dhe prej tyre të dalin kuadro të rinj të ndërtimit.

18. — Organet e shtypit dhe të radios të mobilizohen për të popullarizuar sa më gjerë ndërtimin e centralit hidroelektrik mbi lumin e Matit si vepra më e madhe e planit të parë pesëvjeçar, e cila do të bëjë që industria jonë të përparojë, që jetesa e popullit tonë, veçanërisht ajo e krahinave të Veriut, të përmirësohet.

19. — Ministrat e interesuar, nën drejtimin direkt të nënkryeministrave përkatës, si edhe organet e Partisë dhe të organizatave shoqërore, nën drejtimin e sekretarëve përkatës të Komitetit Qendror të Partisë, të planifikojnë menjëherë punën për të siguruar zbatimin e këtij vendimi.

20. — Për kontrollin shtetëror të zbatimit të këtij vendimi ngarkohet Ministria e Kontrollit të Shtetit, e cila duhet ta njoftojë periodikisht qeverinë me raporte të posaçme mbi zbatimin e këtij

vendimi. Për kontrollin e zbatimit të këtij vendimi, nga ana e Partisë ngarkohet Drejtoria e industri-komunikacionit pranë Komitetit Qendror të Partisë.

**KËSHILLI I MINISTRAVE I RPSH
BYROJA POLITIKE E KQ TË PPSH**

*Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

*Botuar për herë të parë në
gazetën «Zëri i Popullit»,
Nr. 7 (1015), 9 janar 1952*

THIRRJE

**E KOMITETIT QENDROR TË PPSH DHE E QEVERISË SË
RPSH DREJTUAR POPULLIT SHQIPTAR ME RASTIN
E FILLIMIT TË PUNIMEVE TË CENTRALIT
HIDROELEKTRIK MBI LUMIN E MATIT**

7 janar 1952

Popull shqiptar,

Më 11 janar 1952 bëhet inaugurimi i fillimit të punimeve për ngritjen e centralit të madh hidroelektrik mbi lumin e Matit.

Nën drejtimin e Partisë dhe me ndihmën shumë të çmueshme të Bashkimit Sovjetik dhe personalisht të shokut Stalin, populli ynë shkon prej fitoresh në fitore, në rrugën e tij të lavdishme për ndërtimin e bazave të socializmit.

Me shpejtësi të madhe i ndërron faqja vendit tonë. Vazhdimisht rriten pasuritë e vendit tonë, forcohet mbrojtja e tij dhe rritet mirëqenja e popullit, pse çdo gjë ndërtohet për popullin.

Plani pesëvjeçar i shtetit është një program madhështor i zhvillimit ekonomik, kultural dhe shoqëror të vendit tonë. Realizimi dhe tejkalimi i këtij plani do të rritë mirëqenjen e masave punonjëse të vendit, do të forcojë bazat e ndërtimit të socializmit dhe mbrojtjen e vendit tonë. Ai do ta çojë popullin tonë më afër socializmit.

Plani pesëvjeçar i shtetit i jep një rëndësi të madhe zhvillimit të energjisë elektrike, pse pa elektrifikimin nuk mund të ngrihet një industri e përparuar, pse elektrifikimi do të ndihmojë zhvillimin e një bujqësie të përparuar. Ajo është një forcë me leverdi të madhe ekonomike, që mund të zotërohet duke shfrytëzuar lumenjtë e vendit tonë. Ajo është e domosdoshme për industrinë që do të zhvillohet gjatë pesëvjeçarit dhe për industrializimin e mëtejshëm të vendit tonë, për zhvillimin e gjithanshëm ekonomik dhe kultural.

Për këtë arsye centrali hidroelektrik që do të ndërtohet mbi lumin e Matit, përbën veprën më të rëndësishme të planit pesëvjeçar, një pasuri të madhe të popullit tonë, një burim begatie. Kjo veper është një fitore tjetër e miqësisë së popullit tonë me po-

pujt e Bashkimit Sovjetik, e kujdesit dhe e ndihmës vëllazërore të tyre.

Partia i udhëhoqi masat punonjëse të vendit në luftën për çlirim e atdheut dhe të popullit, dhe i bëri zot të fateve të tyre.

Ato kanë dhënë prova të shkëlqyeshme të një atdhedashurie, vrulli revolucionar dhe ndërtimtar të pashembullt në historinë e tyre.

Kjo atdhedashuri dhe ky vrull ndërtimtar, eksperiencia që ato kanë grumbulluar në ndërtimet e mëdha të vendit tonë, si Centrali hidroelektrik «Lenin», Kombinati i tekstileve «Stalin», Fabrika e sheqerit «8 Nëntori» etj. janë një mbështetje e madhe për realizimin me sukses të kësaj veprë madhështore.

Centrali hidroelektrik mbi lumin e Matit ngrihet në Veri të vendit tonë, në krahina që regjimet e vjetra i kishin dënuar, si gjithë vendin tonë, në prapambetjen më të madhe. Asnjë dritë zhvillimi nuk përshkoi kurrë malësitë tona të Veriut. Zogu, si sundimtar i egër i popullit tonë, forcoi në ato krahina aristokracinë bajraktare dhe shtypi me egërsinë me të madhe malësorët dhe fshatarësinë punonjëse. Ai e varfëroi vendin dhe e la në errësirën më të madhe. Ai zhvilloi zakonet më të egra të hakmarrjes dhe të kriminalitetit dhe përdori paditurinë, varfërinë ekonomike, zakonet prapanike si mjete për të shuar rezistencën e popullit dhe për të siguruar sundimin e tij të egër.

Pushteti i bajraktarëve, i feudalëve dhe i borgjezisë u shkatërrua fund e krye dhe pushteti popullor hapi edhe për krahinat e malësitë e Veriut rrugën e përparimit e të kulturës. Rrjeti i gjerë i shkollave, i kurseve kundër analfabetizmit, i institucioneve kulturele e shëndetësore, i shërbimit veterinar dhe agroteknik, shtrihet sot edhe në skajet më të largëta të malësive tona. Në Mat, ku nuk është ndërtuar kurrë gjatë regjimeve të shkuara një vepër në dobi të shoqërisë, pushteti popullor vetëm pas 7 viteve të vendosjes së tij do të ngrejë centralin e ri hidroelektrik, që është një ndër veprat e mëdha të ndërtimit të bazave të socializmit.

Centrali i ri hidroelektrik që do të ngrihet mbi lumin e Matit, do të ketë një fuqi prej 20 000 kw. energji elektrike. Me këtë do të sigurohet sasia e nevojshme e energjisë elektrike për nevojat që krijohen nga zhvillimi i ekonomisë gjatë planit të parë pesëvjeçar dhe do të hidhen bazat e zhvillimit të mëtejshëm të elektrifikimit dhe të industrializimit të vendit. Ky do të jetë një bazë për krijimin e një sistemi të vetëm elektrik, që do të përfshijë zonat kryesore industriale të Republikës Popullore të Shqipërisë. Ky central hidroelektrik do të japë mundësinë që të sigurohet energji elektrike e mjaftueshme dhe në mënyrë të vazhdueshme për Shkodrën, Shëngjinin, Lezhën, Rrëshenin, Burrelin, Krutën, Milotin etj.

Me këtë vepër madhështore, energjia elektrike e vendit tonë

rritet 41,9 herë kundrejt 1938-s, dhe drita elektrike arrin në krahina që regjimi i urryer i Zogut i kishte lënë edhe pa vajguri.

Centrali hidroelektrik mbi lumin e Matit që ndërtohet në zona të lëna pasdore dhe të shkretuara nga regjimi zogollian, do të jetë një shkollë tjetër për masat punonjëse të vendit. Në shembullin e punonjësve heroikë të veprave të mëdha në Bashkimin Sovjetik, në traditat e punonjësve të Centralit hidroelektrik «Lenin», të Kombinatit të tekstileve «Stalin», të Fabrikës së sheqerit «8 Nëntori», punonjësit dhe kuadrot që do të marrin pjesë në ndërtimin e këtij centrali hidroelektrik madhështor, do të shkruajnë faqe të ndritura heroizmi në historinë e ndërtimit paqësor të vendit tonë.

Këto punime do të jenë një aksion tjetër i madh për paqen dhe socializmin, një grusht tjetër për imperialistët amerikano-anglezë dhe shërbëtorët e tyre të Beogradit, të Romës e të Athinës, një shkollë e madhe nga do të dalin me qindra e qindra kuadro të pregatitur nga ana teknike e profesionale, ideologjike dhe kulturele. Në luftë për ndërtimin e kësaj veprë të madhe të Partisë dhe të pushtetit popullor, do të forcohet dhe do të shtohet klasa jonë punëtore.

Vepra si centrali hidroelektrik që do të ndërtohet mbi lumin e Matit do të revolucionarizojë gjendjen. Për krahinat e Veriut dhe për gjithë Shqipërinë ndërtimi i kësaj veprë të madhe do t'i japë një hov të mëtejshëm zhvillimit kulturor, politik, ekonomik dhe shoqëror të masave punonjëse të vendit tonë.

Kjo ndërmarrje e madhe e popullit tonë është një provë tjetër e politikës paqësore të Partisë dhe të qeverisë sonë dhe një betejë për ndërtimin e bazave të socializmit, një dëshmi tjetër e ndihmës së popujve të lavdishëm sovjetikë, e mësimeve dhe e kujdesit të Stalinit të madh për popullin tonë.

Vepra që po ndërmarrim është vepra më e rëndësishme dhe më e madhe e planit pesëvjeçar. Ajo do një mobilizim të gjithanshëm dhe të të gjitha forcave krijuese të vendit tonë.

Le ta fillojmë këtë betejë të re të madhe me besim të paturndur në fitoren e sigurtë, le të mobilizojmë të gjitha forcat për fitoren.

Të gjitha qendrat e prodhimit të vendit tonë, të gjitha ndërmarrjet, të gjitha institucionet shtetërore dhe kulturele, të gjitha organizatat e masave, lidhen me këtë ndërtim të madh.

Komunistët, si kurdoherë, të jenë në ballë të përpjekjeve, shembull vendosmërie dhe qëndrese, frymëzues të emulacionit socialist dhe të heroizmit në punë, organizues dhe mobilizues të masave punonjësve të vendit në ndërtimin e centralit hidroelektrik të dytë.

Ndërtues heroikë të ndërtimeve të mëdha të socializmit, të

Centralit hidroelektrik «Lenin», të Kombinatit të tekstileve «Stalin», të Fabrikës së sheqerit «8 Nëntori», të hidhemi në betejën e re të centralit hidroelektrik të madh. Klasa heroike punëtore dhe rinia e vendit tonë do të tregojnë edhe një herë akoma dashurinë e tyre për popullin, aftësitë e tyre krijuese, vrullin e tyre revolucionar në qendrat e tyre të punës dhe në ndërtimin e kësaj vepre të madhe!

Popullsia e rretheve të Veriut të mobilizohet në shkallë të gjerë në këtë vepër të madhe të socializmit, që do të rritë edhe më tepër mirëqenjen ekonomike të popullit tonë, do të përhapë arësimin dhe kulturën dhe do të çojë dritë në krahinat më të largëta të Republikës.

Gratë e Shqipërisë të mobilizohen në shkallë edhe më të gjerë për të ndërmarrë e për të kryer me sukses këtë vepër madhështore.

Njerëzit e artit, të kulturës, të shkencës e teknikët e vendit tonë të ndihmojnë me të gjitha forcat e tyre punimet e centralit të madh hidroelektrik.

Le të bëhet kjo vepër një çështje e madhe për të gjithë popullin tonë! Le të bëhet ndihma për ndërtimin e kësaj vepre të madhe çështje patriotizmi dhe krenarie!

Le të tregojmë edhe një herë akoma me ndërtimin e kësaj vepre të madhe të socializmit dhe të paqes, se ne dimë të vlerësojmë ndihmën e çmueshme që na japin popujt e lavdishëm sovjetikë dhe personalisht shoku i madh Stalin, dhe popujt e demokracisë popullore, për ndërtimin e bazave të socializmit dhe të jetës së lumtur të popullit tonë!

Rroftë populli heroik shqiptar, që ndërton bazat e socializmit dhe që lufton për paqen!

Të rrojë Partia jonë e Punës dhe Sekretari i saj i Përgjithshëm, shoku Enver Hoxha!

Rroftë pushteti popullor!

Të rrojë miqësia e përjetshme e popullit tonë me popujt e lavdishëm të Bashkimit Sovjetik, që na ndihmojnë për ndërtimin e bazave të socializmit!

Të rrojë Partia e lavdishme Bolshevike dhe udhëheqësi i gjithë njerëzimit, Stalini i madh, që na ndritin rrugën për ndërtimin e jetës së re, për mbrojtjen e paqes dhe të atdheut!

KOMITETI QENDROR I PARTISË SË PUNËS
TË SHQIPËRISË
QEVERIA E REPUBLIKËS POPULLORE
TË SHQIPËRISË

Botohet sipas gazetës

«Zëri i Popullit», Nr. 7 (1015),

9 janar 1952

PLENUMI XII I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Tiranë, 8 janar 1952

K O M U N I K A T E

E PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Plenumi XII i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, i mbledhur më datën 8 janar 1952, në bazë të Statutit, vendosi të thërresë Kongresin II të Partisë më datën 31 mars 1952.

Rendi i ditës i punës së kongresit do të jetë:

1. — Raport «Mbi aktivitetin e Komitetit Qendror» nga Sekretari i Përgjithshëm i Partisë së Punës të Shqipërisë, shoku, Enver Hoxha.
2. — Raport «Mbi zhvillimin ekonomik dhe kulturor të Republikës Popullore të Shqipërisë gjatë pesëvjeçarit 1951—1955» nga shoku Mehmet Shehu.
3. — Raport i Komisionit të Revizionimit.
4. — Zgjedhjet për Komitetin Qendror.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

REZOLUCION

I PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË «MBI VËRTETIMIN E DOKUMENTAVE TË PARTISË»

8 janar 1952

Plenumi XII i Komitetit Qendror të PPSH, në mbledhjen e tij të datës 8 janar 1952, mori në shqyrtim raportin e Byrosë Politike, «Mbi vërtetimin e dokumentave të Partisë» dhe konstatoi:

I

E lindur në zjarrin e luftës kundër okupatorit fashist dhe tradhëtarëve të vendit, e përbërë nga bijtë më të mirë të popullit tonë dhe e mbështetur në bazat e shëndosha të marksizëm-leninizmit, Partia e Punës e Shqipërisë ka kaluar nga suksesi në sukses në rrugën e saj revolucionare dhe heroike.

Partia u rrit, u edukua dhe u çelnikos duke ndjekur me besnikëri mësimet e pavdekshme të Marksit Engelsit, Leninit e Stalinit. Anëtarët e saj i karakterizon dashuria e thellë për popullin, dashuria dhe besnikëria për Partinë e lavdishme Bolsheviqe, për Bashkimin Sovjetik dhe shokun e madh Stalin.

Duke ecur në mësimet e Leninit e të Stalinit, Partia jonë ka shtuar radhët e saja me shokë të rinj, të dalë nga lufta e popullit për liri dhe nga puna e tij vetëmohuese për ndërtimin e jetës së re. Ajo sot numëron nëntë herë më tepër anëtarë e kandidatë se sa në vitin e parë pas çlirimit. Partia është forcuar organizativisht dhe gjendja ideologjike, politike e kulturele e anëtarëve të saj është përmirësuar. Numri i komunistëve që marrin pjesë në format e edukimit marksist-leninist është rritur nga 2 366 më 1949 në 14 000 më 1951.

Është forcuar kritika dhe autokritika, disiplina e ndërgjegjshme dhe është rritur vigjilenca revolucionare e komunistëve.

Këto suksese kanë qenë të mëdha, sidomos pas Kongresit I të PKSH kur Partia e realizoi me sukses kthesën që shënoi ky kongres.

II

Por me gjithë sukseset, në gjirin e Partisë, kanë ekzistuar edhe një sërë dobësish:

1. — Vigjilenca revolucionare e organizatave të Partisë dhe e komunistëve nuk ka qenë në lartësinë e duhur. Kjo ka shkaktuar që, në disa situata të caktuara, të futen në Partinë tonë edhe elementë të papërshtatshëm dhe armiq, që e dëmtuan Partinë.

2. — Kritika dhe autokritika nuk janë përdorur sa duhet për forcimin e frymës luftarake të organizatave, për edukimin e komunistëve dhe për pastrimin e tyre nga një sërë të metash, të trashëguara nga e kaluara, nga vetë origjina e shtresës së tyre ose të fituara gjatë kohës. Kjo ka bërë që mjaft organizata partie të mos jenë sa duhet luftarake në kryerjen e detyrave të Partisë.

3. — Ka munguar edukimi sistematik i komunistëve dhe sidomos i kandidatëve të Partisë dhe i shokëve që hynin rishtas në Parti. Punë edhe më e paktë është bërë me shokët fshatarë. Kjo ka bërë që mjaft shokë, sidomos fshatarë të varfër, duke mos qenë në gjendje të përballojnë detyrat që u shtronte Partia, të përjash-tohen nga radhët e saja.

Niveli i ulët ideologjik, politik e kultural i anëtarëve dhe i kandidatëve të Partisë dhe mungesa e një pune ideologjike të organizuar e këmbëngulëse nga ana e Partisë, është pasqyruar në shfaqjet e huaja për Partinë, në shkarje oportuniste dhe sektare dhe në një sërë dobësish të tjera, të dëmshme për Partinë.

4. — Përbërja e Partisë paraqiste një problem serioz për tërë Partinë. Në të mbizotëronte elementi fshatar, kurse elementi i klasës punëtore numëronte vetëm 10,28 për qind të efektivit si origjinë. Kjo ka bërë që në radhët e Partisë sonë të reflektonin më lehtë lëkundjet mikroborgjeze, hezitimet dhe lëshimet në zbatimin e detyrave si dhe dobësitë në vigjilencën revolucionare.

5. — Kjo gjendje e ka lehtësuar efektin e presionit borgjez mbi Partinë tonë. Armiqtë e Partisë janë munduar të hyjnë në radhët e Partisë për ta minuar nga brenda. Ata kanë mundur të maskojnë deri diku veprimet e tyre dhe duke përfutur edhe nga mungesa e vigjilencës së mjaftueshme revolucionare të organizatave të Partisë, kanë arritur të futen edhe në Parti e ta dëmtojnë atë.

III

Duke i shfrytëzuar këto dobësi që ekzistonin në gjirin e Partisë sonë, duke përfitur nga niveli i ulët ideo-politik i komunistëve dhe nga mungesa e vigjilencës revolucionare në anëtarët e kandidatët e Partisë, klika e Titos me agjenturën e saj të urryer në Partinë tonë, u përpoq që ta shkatërrojë Partinë. Ajo u përpoq të largojë Partinë tonë nga Partia e lavdishme Bolshevike, nga kampi i revolucionit dhe i socializmit me qëllim që ta skllavëronte popullin tonë dhe ta bënte edhe vendin tonë një bazë agresioni të imperializmit kundër Bashkimit Sovjetik dhe vendeve të demokracisë popullore.

Klika trockiste e Titos dhe agjentura e saj i drejtoi shigjetat e saja në radhë të parë kundër Partisë sonë. Për shkak të ndërhyrjes armiqësore të trockistëve të Beogradit e të punës minuese të agjentëve të tyre në Partinë tonë, Koçi Xoxe, Pandi Kristo etj., pranimi në Parti, në disa faza, është bërë në kundërshtim me mësimet e Leninit e të Stalinit.

1. — Pas çlirimit të Shqipërisë, me zgjerimin e radhëve të Partisë, mundën të hyjnë në Parti, përveç elementëve të vendosur e besnikë edhe elementë karrieristë e jo të shëndoshë, bile edhe elementë që kanë marrë pjesë në radhët e «Ballit Kombëtar», të «Legalitetit» e në radhët e okupatorëve. Vetëm gjatë viteve 1947—1948 u pranuan në Parti mbi 60 për qind të efektivit të anëtarëve të Partisë para vërtetimit të dokumentave. Ndër ta, kanë qenë edhe një numër elementësh të papërshtatshëm dhe armiq. Këta në përpjekjet e tyre armiqësore përfituan edhe nga mungesa e Statutit të Partisë.

2. — Nga ana tjetër në çështjet e administrimit të brendshëm të Partisë ekzistonte një kaos i madh. Mungonin të dhëna të plota mbi përbërjen e Partisë dhe mbi biografinë e çdo komunisti. Elementët e papërshtatshëm dhe armiq janë munduar të shfrytëzojnë edhe këtë dobësi.

Duke e parë këtë gjendje, me qëllim që të bolshevizohet Partia dhe të jetë e aftë për të zbatuar vendimet e Kongresit I të PKSH, Komiteti Qendror i PPSH, vendosi të bëjë vërtetimin e dokumentave të anëtarëve e të kandidatëve të Partisë.

IV

Gjatë vërtetimit të dokumentave duhet të arriheshin këto rezultate kryesore:

1. — Të spastroheshin radhët e Partisë nga elementët armiq e të padëshirueshëm, nga elementët që nuk kishin garanci për të qenë në radhët e saja.

2. — Të siguroheshin të dhëna ekzakte për çdo komunist dhe të zbulohesh çdo gjë që mund t'i ishte fshehur Partisë. Të njihej e të përcaktohej mirë përbërja e Partisë.

3. — Të vendosej rregulli bolshevik në çështjet e administrimit të Partisë.

Krahas me këto, vërtetimi i dokumentave duhet të sillte si përfundim forcimin e jetës së brendshme të organizatave të Partisë, luftimin e shfaqjeve të huaja dhe të dëmshme, edukimin e komunistëve dhe rritjen e frymës luftarake të organizatave, kondata këto të domosdoshme për vetë bolshevizimin e Partisë.

V

Komiteti Qendror e orientoi drejt Partinë në zgjidhjen e këtij problemi të rëndësishëm. Që me vendimin e saj të 21 janarit 1950 Byroja Politike e Komitetit Qendror përcaktoi qartë kriteret, procedurën që do të ndiqej dhe rezultatet që duhej të arriheshin. Organizatave ju dhanë udhëzime të hollësishme e konkrete. Me shtojcëvendimin e saj të 27 korrikut 1950 Byroja Politike korrigjoi me kohë të metën parimore të rëndësishme që kishte vendimi i saj i 21 janarit 1950, që vërtetimi bëhej jashtë kontrollit të organizatave bazë të Partisë. Ky shtojcëvendim me rëndësi i Byrosë Politike të Komitetit Qendror ndihmoi që në vërtetimin e dokumentave të merrte pjesë masa e Partisë dhe të arriheshin rezultate pozitive.

Komiteti Qendror u dha një ndihmë të vazhdueshme organizatave të Partisë në terren e ushtri për kryerjen me sukses të këtij aksioni të madh.

VI

Rezultatet e vërtetimit të dokumentave për forcimin e Partisë kanë qenë të mëdha.

1. — *U spastruan radhët e Partisë nga elementët armiq e të padëshirueshëm dhe u përmirësua përbërja shoqërore e Partisë; u forcua më tepër përbërja e saj në përgjithësi.* U përjashtuan nga Partia 3 776 anëtarë e kandidatë partie, d.m.th. rreth 8 për qind e efektivit të Partisë. Ndër ta ka pasur elementë me të kaluar jo të pastër, me qëndrim të dyshimtë si në të kaluarën, ashtu dhe sot, elementë armiq si dhe elementë të pavlefshëm që nuk e mbanin dot barrën e anëtarit të Partisë.

Nga të përjashtuarit, në krahasim me efektivin e tyre në Parti, peshën kryesore e mbajnë shtresat e pasura. Numri i tyre

përfaqëson 15,82 për qind mbi efektivin e tyre në Parti, kurse numri i punëtorëve të përjashtuar në krahasim me efektivin e tyre është 3,89 për qind dhe i fshatarëve të varfër — 7,35 për qind. Kjo gjë forcoi përbërjen shoqërore të Partisë.

2. — *Vërtetimi i dokumentave e ka rritur dhe më tepër vigjilencën revolucionare të organizatave të Partisë, kritikën, autokritikën dhe disiplinën e Partisë.* Një rol me rëndësi ka luajtur në këtë drejtim studimi i dokumentave në organizatat bazë të Partisë. Njëkohësisht, me vërtetimin e dokumentave organizatat e Partisë fituan një eksperiencë të mirë në drejtimin e çështjeve organizative dhe u bënë më luftarake në kryerjen e detyrave të Partisë.

Organizatat e Partisë e kanë çmuar përgjithësisht drejt rëndësinë e këtij problemi serioz për Partinë. Ato i janë përgjegjur thirrjes së Komitetit Qendror të Partisë dhe vazhdimisht e kanë forcuar vigjilencën e tyre revolucionare, për të ruajtur Partinë.

3. — *U përforcua jeta e brendshme e organizatave të Partisë.* U përmirësua funksionimi i organizatave dhe i forumeve të Partisë. U përmirësua puna kolegjiale në Parti dhe u rrit fryma luftarake e organizatave të Partisë. Forcimi i jetës së brendshme solli si rrjedhim spastrimin e elementit të pavlefshëm, që nuk e mbante dot barrën e anëtarit të Partisë. Kështu, gjatë gjithë kohës që vazhdoi vërtetimi i dokumentave, organizatat e Partisë, në jetën e tyre normale përjashtuan nga radhët e tyre 2 220 anëtarë e kandidatë partie. Kjo forcoi edhe më tepër përbërjen e Partisë.

Gjithashtu gjatë vërtetimit të dokumentave, organizatat e Partisë kritikuan dhe goditën dobësitë e gabimet që konstatoheshin në lidhje me qëndrimin dhe aktivitetin e komunistëve. Për këto të meta e dobësi, duke qenë të korigjueshme, organizatat e Partisë kanë marrë masa ndëshkimore të ndryshme, për anëtarë e kandidatë partie.

4. — *Vërtetimi i dokumentave ka siguruar të dhëna më të plota për çdo komunist.* U zbuluan çështjet që i ishin fshehur Partisë dhe u pajisën të gjithë komunistët me dosje personale, me të dhëna më të plota dhe të vërtetuara.

U krijuan konditat për vendosjen e rregullit bolshevik në administrimin e brendshëm të Partisë. Në këtë mënyrë vërtetimi i dokumentave ndihmoi shumë në bolshevizimin e Partisë.

Gjatë vërtetimit të dokumentave u konstatuan edhe dobësi të cilat kanë konsistuar në këto drejtime:

1. — *Vigjilenca revolucionare për të ruajtur pastërtinë e radhëve të Partisë nuk ka qenë gjithnjë në lartësinë e duhur.* Në mjaft raste nuk janë bërë të gjitha përpjekjet për të njohur mirë komunistët. Disa komitete partie të rretheve nuk i kanë parë thellë problemet më të rëndësishme të organizatës së tyre, nuk i kanë analizuar këto dhe nuk kanë nxjerrë kurdoherë konkluzione të drejta për forcimin e organizatave. Mungesë të theksuar vigjilence kanë treguar komitetet e Partisë të rretheve Pukë, Burrel e Berat.

2. — *Nuk është lidhur sa duhet vërtetimi i dokumentave me forcimin e jetës së brendshme të Partisë.* Byrotë e komiteteve të Partisë nuk e kanë ndjekur që në fillim e rregullisht këtë problem dhe nuk kanë ushtruar kontrollin e duhur. Nuk janë kritikuar drejt në të gjitha rastet dobësitë në punën dhe aktivitetin e komunistëve; si rrjedhim, edhe pas vërtetimit të dokumentave, konstatohen akoma mjaft dobësi në jetën e brendshme të organizatave bazë, si mungesë disipline, dobësi në kritikën dhe autokritikën, si domos në kritikën nga poshtë, lëshime në kryerjen e detyrave etj. Këto janë më të theksuara në disa rrethe si në atë të Lushnjës, Vlorës, Pukës etj. Disa komitete partie të rretheve si i Korçës e i Pogradecit nuk i ndoqën deri në fund e nuk i luftuan në mënyrë sistematike dobësitë dhe të metat që zbuloi vërtetimi i dokumentave.

Në një numër rrethesh, vërtetimi i dokumentave, nuk ka shërbyer sa duhet për të forcuar rolin e organizatave e të çdo komunisti në kryerjen me sukses të detyrave që u ngarkon Partia qoftë në sektorin e prodhimit, qoftë në çdo sektor tjetër. Fakti është se në këtë drejtim në shumë organizata e komunistë ka akoma mjaft dobësi; kjo gjendje është më e theksuar në organizatat e fshatit. Nuk janë të pakta rastet që anëtarët e tyre neglizhojnë kryerjen e detyrave të tyre. Në punën e tyre ka qëndrime burokratike, tendenca liberalizmi e sektarizmi që prekin direkt lidhjet e Partisë me masat e popullit.

3. — *Vërtetimi i dokumentave tregon edhe një herë se niveli ideologjik, politik e kultural i anëtarëve të Partisë sonë është i ulët dhe problemi i edukimit të tyre përbën një nga detyrat kryesore për Partinë dhe për vetë komunistët.* Ky problem paraqitet edhe më serioz për komunistët e fshatit. Gjatë vërtetimit të do-

kumentave u përjashtuan nga radhët e Partisë 2 102 anëtarë e kandidatë me origjinë fshatare të varfër. Kjo shifër është baras me 55,66 për qind e numrit të të përjashtuarve gjatë vërtetimit. Një pjesë e tyre do t'i kishin shpëtuar përjashtimit po të ishte bërë një punë e shëndoshë dhe sistematike për edukimin e tyre.

4. — *Në marrjen e masave ndëshkimore nuk është ndjekur kurdoherë kriteri i drejtë.* Në këtë drejtim ka pasur qëndrime oportuniste dhe sektare. Por më të theksuara kanë qenë qëndrimet oportuniste. Nga shqyrtimi i shumë dokumentave ka rezultuar që në disa raste, organizatat e Partisë të rretheve Fier, Berat, Kolonjë, Burrel, Përmet, Vlorë, Pogradec, Elbasan e Shkodër u kanë dhënë dokumentin e Partisë elementëve që kanë qenë në radhët e armikut e kanë zhvilluar aktivitet kundër Partisë. Shfaqje oportuniste të theksuara ka pasur në disa organizata bazë të Pogradecit, të Fierit, të Vlorës etj. Qëndrime oportuniste janë mbajtur edhe nga organizatat e Partisë në ushtri, ku ka pasur mjaft raste që nuk është analizuar thellë e kaluara e komunistëve.

Qëndrime sektare ka pasur sidomos në fillim. Këto kanë konsistuar veçanërisht në drejtim të masave edukative.

Në përgjithësi shumë nga këto të meta janë ndrequr pastaj me ndihmën e ndërhyrjen e Komitetit Qendror.

5. — *Gjatë vërtetimit të dokumentave nuk është pasur sa duhet parasysh puna e armikut.* Me gjithë paralajmërimet e Komitetit Qendror se elementi armik nuk do të rrinte duarlidhur para kësaj mase të rëndësishme që mori Partia, mjaft komitete partie të rretheve edhe organizata bazë nuk u treguan që në fillim në lartësinë e duhur për të kapur dhe për të analizuar me kohë çdo përpjekje që elementi armik bëri për t'i shpëtuar kësaj mase të Partisë. Të ngarkuarit me vërtetimin e dokumentave ashtu dhe byrotë e komiteteve të Partisë përgjithësisht nuk kanë nxjerrë përfundime mbi punën e armikut në këtë rast, të cilat do t'u vlenin organizatave bazë për të ardhshmen, për të forcuar edhe më shumë vigjilencën revolucionare të komunistëve.

Mungesë vigjilence ka pasur sidomos në organizatat e rretheve të Pukës, Burrelit, Sarandës, Beratit, Fierit, Lushnjës e të Vlorës. Kanë treguar më tepër preokupim për këtë problem organizatat e Partisë të rretheve Tiranë, Korçë, Kukës e Peshkopi.

6. — *Të meta ka pasur dhe në punën e aparatit të Komitetit Qendror për këtë problem.*

a) Nuk është marrë pjesë sa duhet në mbledhjet e organizatave bazë. Instruktorët, sidomos në fillim, janë kufizuar në përgjithësi në kontrollin e dokumentave të vërtetuara, duke mos pasur

parasysh sa duhet të ndiqnin vazhdimisht, gjatë vërtetimit të dokumentave, punën e komiteteve të Partisë, për forcimin e jetës së brendshme të Partisë dhe për rritjen e shpirtit luftarak të organizatave bazë.

b) Disa ekupe të Komitetit Qendror, në fillim kanë bërë një punë të përciptë në disa rrethe si në Kolonjë, Peshkopi, Burrel e Sarandë.

c) Çështja e njohjes së kuadrit nuk u pat sa duhet parasysh gjatë vërtetimit të dokumentave. Gjatë kësaj kohe pak shokë të rinj janë ngritur në përgjegjësi në aparatet e Partisë, në ato shtetërore e të organizatave të masave.

ç) Ndihmë e paktë u është dhënë organizatave të Partisë me anën e shtypit.

VIII

Rezultatet e vërtetimit të dokumentave provuan në mënyrë ekzakte konstatimet e Byrosë Politike të Komitetit Qendror. Ato e bënë Partinë tonë më të fortë e më luftarake. Analiza e këtyre rezultateve nxjerr për tërë Partinë një sërë mësimesh të rëndësishme dhe detyra për forcimin e shpirtit të saj luftarak.

Për t'ja arritur sa më mirë këtij qëllimi, Plenumi XII i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë,

Vendosi:

1. — *Të përmirësohet përbërja shoqërore e Partisë dhe të forcohet përbërja e saj në përgjithësi.*

a) Të forcohet akoma më tepër vigjilencia revolucionare e organizatave të Partisë, për të ruajtur si sytë e ballit Partinë nga përpjekjet e vazhdueshme të elementëve armiq të cilët mundohen të hyjnë në radhët e Partisë për ta minuar nga brenda. Në të ardhshmen duhet që rregullisht e në mënyrë sistematike të zhduken dobësitë që ekzistojnë akoma në Parti. Të luftohen më me forcë shfaqjet e huaja për Partinë dhe të zbulohen e të spastrohen radhët e saja nga elementët armiq që mund t'i kenë shpëtuar syrit të organizatave gjatë vërtetimit të dokumentave. Një punë e tillë duhet të bëhet që me ndërrimin e dokumentave. *Çështja e mbrojtjes së Partisë duhet të jetë preokupacioni kryesor dhe i përditshëm i çdo komunisti dhe i çdo organizate.*

b) Organizatat e Partisë të tregojnë një kujdes të veçantë për pranimet e reja në Parti. Në radhë të parë të pranohen në Parti

kandidatët ekzistues të Partisë që i plotësojnë konditat dhe të mos lejohet më që kandidati të plakët si i tillë. Të tregohet një kujdes më i madh për aktivizimin dhe edukimin e kandidatëve të Partisë. Të zhduket përpjesëtimi i zhdrejtë që ekziston në disa rrethe midis numrit të anëtarëve dhe numrit të kandidatëve të Partisë. Të forcohet përbërja shoqërore e Partisë me elementë të rinj, sidomos ata që vijnë nga radhët e klasës punëtore. Të analizohet mirë elementi i ri që do të pranohet në Parti, si nga e kaluara e tij, ashtu dhe nga puna e tij e tanishme. Të gjykohen njerëzit nga besnikëria e tyre ndaj Partisë dhe popullit, ndaj Partisë Bolshevike, Bashkimit Sovjetik dhe shokut të madh Stalin. Të gjykohen nga puna e tyre e palodhur për të kryer me nder detyrat që u ngarkon Partia. Vëmendje të posaçme duhet të tregojnë në këtë drejtim organizatat e Partisë në ushtri dhe ato në aksionet e mëdha kombëtare, ku venë shumë punëtorë të përkohshëm.

c) Të forcohet udhëheqja dhe kontrolli i Partisë mbi rininë, të përmirësohet puna e organizatave bazë me aktivin pa parti dhe të bëhet më e shëndoshë lidhja e organizatave të Partisë dhe e çdo komunisti me masat punonjëse. Të mbahen pranë e të tregohet më tepër kujdes për njerëzit pa parti që janë shumë afër organizatës së Partisë.

c) Të aktivizohen sa më shumë gratë në jetën ekonomike, politike dhe shoqërore të vendit. Të bëhet një punë më e madhe me gratë aktiviste, në mënyrë që të vijnë në radhët e Partisë edhe shoqe të devotshme e besnike për kauzën e Partisë.

2. — Të respektohet me rigorozitetin më të madh Statuti i Partisë si konditë e domosdoshme për bolshevizimin e Partisë.

a) Të forcohet disiplina dhe demokracia e brendshme në komitetet dhe organizatat bazë të Partisë. Në mënyrë të posaçme të inkurajohet kritika nga poshtë dhe kritika e masave mbi organet e Partisë e të shtetit.

b) Drejtorja e organeve të Partisë pranë KQ të PPSH të marrë masa që të njihet më mirë Statuti nga çdo anëtar e kandidat partie, në mënyrë që çdo anëtar e kandidat partie të jetë në gjendje jo vetëm ta zbatojë atë, po edhe ta mbrojë me fanatizëm në çdo moment e kundërshtojë që do të tentojë ta shkelë.

3. — Të bëhen edhe më luftarake organizatat bazë të Partisë. Ato të bëhen qendra të vërteta të edukimit bolshevik të komunistëve.

a) Të tregohet një kujdes i veçantë për edukimin e sekretarëve të organizatave bazë dhe të instruktorëve të komiteteve të Partisë.

b) Aparatet e komiteteve të Partisë në rrethe dhe aparati i Komitetit Qendror të ndihmojnë më shumë organizatat bazë në mënyrë që ato të kryejnë më mirë funksionet dhe detyrat e tyre. Të luftohen vazhdimisht dhe me forcë qëndrimet burokratike të komunistëve që i shkëputin ata nga masat e popullit dhe dëmtojnë Partinë.

Organizatave bazë të Partisë duhet të bëhen më luftarake në kryerjen me përgjegjësi të detyrave të tyre. Nëpërmjet një jete më të gjallë ato të edukojnë çdo komunist me ndjenjën e thellë të përgjegjësisë për kryerjen e detyrave që i ngarkon Partia. Të mos lejohet organizatat që elementë të papërshtatshëm të fshehin inaktivitetin ose dobësitë e tyre të tjera prapa tesarës së Partisë. Anëtarët e Partisë duhet të jetë shembull vetëmohimi e sakrificës në punë e kudo që e ka caktuar Partia. T'u kushtohet më tepër kujdes mbledhjeve të hapëta të organizatave bazë për pranimet në Parti dhe për çështjet ekonomike.

c) Organizatat e Partisë të jenë në ballë të luftës për problemet ekonomike e politike të Partisë. Ato të jenë shembull në kryerjen e detyrës për realizimin e planit pesëvjeçar. Çdo komunist në prodhim të luftojë që të bëhet sulmues dhe novator. Asnjë komunist të mos mbetet jashtë përpjekjeve për kualifikimin e tij teknik. Të analizohet me kujdes e të merren masa për përmirësimin e shpërndarjes së komunistëve në prodhim.

4. — Të punohet me këmbëngulje për edukimin ideo-politik e kultural të komunistëve. Të vihet në radhë të parë çështja e ngritjes ideologjike të anëtarëve dhe kandidatëve të Partisë.

a) Të zhduket brenda vitit shkollor 1951—1952 analfabetizmi në Parti. Të mos pranohen më në Parti njerëz analfabetë. Të tregohet një kujdes më i madh për shokët gjysmanalfabetë, që të ngrenë nivelin e tyre arësitor.

b) Të zbatohen me kujdes porositë e Byrosë Politike të Komitetit Qendror në lidhje me edukimin ideo-politik, kultural e ngritjen profesionale të komunistëve. Të ndiqet më me forcë zhvillimi i formave të arësimit marksist-leninist dhe të bëhen herë pas here mbledhje të organizatave bazë me karakter edukativ, ku të zhvillohen, me një program të caktuar, mësimet me karakter organizativ, kultural, politik etj

5. — Një vëmendje e veçantë duhet të tregohet nga aparati i Komitetit Qendror të Partisë dhe komitetet e Partisë në rrethe, për edukimin ideologjik, politik dhe kultural të komunistëve të fshatit dhe për forcimin e frymës luftarake të organizatave të Par-

tisë në fshat. Duke pasur parasysh dobësitë që ekzistojnë në këto organizata dhe gabimet në këtë drejtim, të analizohet posaçërisht gjendja e këtyre organizatave dhe të merren masa efikase edukative dhe organizative për përmirësimin e gjendjes së tyre sa më shpejt. Të ndihmohen më konkretisht organizatat e fshatit me kuadro nga qyteti e qendrat e punës. Aparati i Komitetit Qendror dhe çdo komitet partie rrethi të përpilojë brenda tremujorit të parë të këtij viti një plan të veçantë për forcimin e organizatave të Partisë në fshat.

6. — Të merren masa për formimin komunist të elementëve me dobësi në Parti. Të zhvillohet me këta një punë e gjerë edukative dhe të hidhen në aksione të hapëta politike në mënyrë që të meritojnë plotësisht titullin e anëtarit të Partisë. Një kujdes i veçantë të tregohet sidomos me ata me origjinë fshatare të varfër, në mënyrë që të bëhen sa më luftarakë në kryerjen e detyrave të Partisë.

Të luftohen vazhdimisht qëndrimet e shfaqjet oportuniste në radhët e Partisë, ashtu edhe tendencat sektare. Të ndiqet aktiviteti në punë i shokëve që kanë dobësi dhe të arrihet që pikërisht me punën e tyre ata t'i zhdukin këto dobësi e të bëhen sa më të aftë për detyrat e Partisë.

7. — Të ndiqet me vëmendje puna e elementëve të përjashtuar nga Partia. Të mbahen afër e të tregohet kujdes për elementët e përjashtuar si të pavlefshëm; në asnjë mënyrë të mos lejohet që këta të bëhen rezervë e armikut. Këta të aktivizohen sa më shumë në rrugën e Partisë. Organizatat të jenë më vigjilente ndaj elementëve të përjashtuar si bashkëpunëtorë të armikut në të kaluarën ose sot dhe të mos lejojnë që elementët trockistë t'i përdorin për interesat e tyre kundër Partisë.

8. — Të respektohet me rigozitet rregulli i vendosur në administrimin e brendshëm të Partisë dhe të tregohet një kujdes i posaçëm për shpërndarjen dhe ruajtjen e dokumentave të reja të Partisë.

9. — Drejtoritë e Komitetit Qendror dhe çdo komitet partie rrethi brenda datës 29 shkurt 1952 të hartojnë një plan konkret për zbatimin e këtyre detyrave.

10. — Ky rezolucion të punohet në plenumet e komiteteve të Partisë, të cilat duhet të bëjnë analizën e punës së tyre lidhur me këtë aksion të madh. Çështjet më të rëndësishme të këtij rezolu-

cioni dhe konkluzionet më të rëndësishme të plenumeve të komiteteve të Partisë të shtrohen në organizatat bazë të Partisë, që t'i shërbejnë forcimit të mëtejshëm të tyre.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë

VENDIM

I PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH MBI THIRRJEN E KONGRESIT II TË PARTISË

8 janar 1952

Plenumi XII i Komitetit Qendror të PPSH në mbledhjen e tij të datës 8 janar 1952, duke u mbështetur në Statutin e Partisë, i cili thotë se të paktën në çdo tre vjet mblidhet kongresi i Partisë dhe në bazë të propozimit të Byrosë Politike të Komitetit Qendror

Vendosi:

- I. — Të thirret Kongresi II i PPSH më 26 mars 1952.
- II. — Kongresi të zhvillojë punimet me këtë rend dite:
 1. — Raport «Mbi aktivitetin e Komitetit Qendror të PPSH», nga shoku Enver Hoxha.
 2. — Raport «Mbi zhvillimin perspektiv ekonomik e kultural të Republikës Popullore të Shqipërisë gjatë pesëvjeçarit 1951-1955», nga shoku Mehmet Shehu.
 3. — Raport i Komisionit të Revizionimit.
 4. — Zgjedhjet për Komitetin Qendror.
 5. — Zgjedhjet për Komisionin e Revizionimit.
- III. — Norma e përfaqësimit të organizatave të Partisë për kongresin të jetë:
 - Delegatë me votë deliberative 1 për çdo 50 anëtarë partie.
 - Delegatë me votë konsultative 1 për çdo 100 kandidatë partie.
- IV. — Të zhvillohen konferenca të Partisë në rrethe për zgjedhjen e delegatëve për në kongres brenda muajit shkurt 1952 me këtë rend dite:
 - a) Raport pune i komitetit të Partisë;
 - b) Punimi i tezave të raporteve të kongresit;
 - c) Zgjedhja e delegatëve për në kongres.

V. — Të shpallet rendi i ditës i kongresit jo më vonë se më 15 janar 1952.

VI. — Ngarkohet Byroja Politike e Komitetit Qendror që të marrë të gjitha masat e nevojshme për përparatjen dhe zhvillimin e zgjedhjeve për Kongresin II të Partisë.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë

**LETËR E BYROSË POLITIKE TË KQ TË PPSH
MBI ZBATIMIN DREJT TË POLITIKËS SË PARTISË
NË CILËSIMIN E KULAKËVE NË FSHAT**

21 janar 1952

LETËR DËRGUAR KOMITETIT TË PARTISË TË RRETHIT

DURRËS

**DHE GJITHË KOMITETEVE TË PARTISË NË RRETHE
DREJTORISË POLITIKE TË USHTRISË POPULLORE
DEGËS POLITIKE TË MP TË BRENDSHME**

Në lidhje me luftën e klasave në fshat, konstatojmë se ju nuk i vini rëndësinë e duhur këtij problemi ashtu si ju ka udhëzuar Komiteti Qendror. Konstatojmë se në këtë drejtim, ju bëni gabime qoftë nga e djathta, qoftë nga e majta dhe këtë problem kaq të rëndësishëm nuk e keni studjuar dhe vazhdoni të mos e studjoni me seriozitetin e duhur. Nga kjo rrjedhin shumë padrejtësi dhe vija e Partisë në përcaktimin e kulakut dhe në kufizimin e tij ekonomik nuk zbatohet si duhet.

Ju e dini se komiteti i Partisë i rrethit është instanca e fundit që vendos për përcaktimin e kulakëve në bazë të të dhënave dhe të propozimeve të organizatave bazë të Partisë të fshatit. Një e drejtë e tillë sjell me vete edhe përgjegjësi të mëdha mbi ju dhe kjo lë të kuptohet që jeni përgjegjës për zbatimin e drejtë të vijës së Partisë. Që vija e drejtë e Partisë të zbatohet dhe të kontrollohet nëse zbatohet drejt, nuk mjafton që komiteti i Partisë i rrethit të aprovojë në mënyrë burokratike dhe pa i studjuar thellë propozimet që i vijnë nga poshtë. Faktet tregojnë se komiteti i rrethit tuaj, në përgjithësi kështu vepron, nuk bën gjë tjetër veç aprovon pa studim dhe pa diskutim propozimet që i vijnë nga poshtë. Këtë gjë e faktojnë gabimet që po vërtetojmë në caktimin dhe kufizimin e kulakut ku ka oportunitet të theksuar, dobësim të luftës së klasave, që do të thotë se shumë kulakë të vër-

tetë nuk janë zbuluar dhe nuk luftohen, por vazhdohet të konsiderohen si katundarë të mesëm dhe nga ana tjetër, katundarë të mesëm janë cilësuar kulakë, janë dënuar si të tillë dhe ndaj tyre zbatohet politika që ka caktuar Partia vetëm për kulakët.

Por, veç kësaj, nuk merrni të paktën mundimin që të rishqyrtoni lutjet e kërkesat që vijnë nga katundarët e cilësuar si kulakë për t'i verifikuar të thënat e tyre dhe kjo t'ju shërbejë sado pak për verifikimin e vendimeve që ju keni marrë në lidhje me përcaktimin e kulakëve. Lutjet e njerëzve për ju kanë pak rëndësi, pse shkoni nga parimi i gabuar që çdo gjë, që keni vendosur, është e pagabueshme dhe përjashtoni bërjen e gabimeve, megjithëse në organizatat e Partisë në fshatrat e rrethit tuaj, nga pakujdesia juaj, nga mungesa e një pune organizative dhe edukative të shëndoshë në bazë të direktivave të Partisë, ekzistojnë shumë dobësi. Këto dobësi duhet që t'ju bëjnë më realistë për të ndihmuar dhe për të kontrolluar organizatat bazë në fshat dhe veçanërisht përsa i përket problemit të luftës së klasave. Është një gabim shumë i rëndë të lejoni dobësimin e ashpërsimit të luftës së klasave në fshat, por është një gabim tjetër, po aq i madh, të cilësoni si kulakë, katundarë të mesëm, të cilët duhet të jenë aleatët e fshatarëve të varfër në luftën kundër kulakëve.

Shumë fakte vërtetojnë sa thamë më lart, veçanërisht ngjarja e Ishmit, e cila ishte bërë e rrezikshme dhe komiteti juaj nuk kishte mundur, jo vetëm ta shëronte këtë plagë, por as ta diktonte.

Një fakt tjetër, në mes të shumë të tjerave që ekzistojnë, është çështja e fshatit Luz të Kavajës, nga ku ju keni mjaft letra katundarësh, qofshin këto me përmbajtje të drejtë ose jo, me të cilat qahen për padrejtësitë që u janë bërë, në lidhje me cilësimin e tyre si kulakë. Një nga këta katundarë, i quajtur H.B., duke mos marrë asnjë përgjegje nga komiteti i Partisë i ka drejtuar një lutje drejtpërdrejt Sekretarit të Përgjithshëm të Partisë, ku i shpjegon se është cilësuar padrejtësisht si kulak nga organizata bazë e Partisë e fshatit Luz dhe nga Komiteti i Partisë i rrethit të Durrësit. Duhet të dini se Komiteti Qendror i Partisë i studjon me kujdes lutjet dhe propozimet e popullit, pse kështu na mëson Partia. Vetëm kështu Partia do të lidhet me masat dhe do të mësojë nga masat. Lutja e këtij katundari u verifikua nëpërmjet instruktorit të Drejtorisë së bujqësisë të Komitetit Qendror në organizatën bazë të fshatit Luz të Kavajës dhe pretendimet e tij ishin plotësisht të drejta. Ai është cilësuar padrejtësisht si kulak, pse në fakt ai është një katundar i mesëm. Nga mbledhja e kësaj organizate bazë u vërtetua gjithashtu se atje po bëheshin gjëra të turpshme dhe padrejtësi flagrante, të cilat i kishin shpëtuar vigjilencës së organizatës bazë të fshatit dhe Komitetit të Partisë të rrethit të Durrësit. Jo vetëm kaq, por shokë të Komitetit të

Partisë e kishin inkurajuar fajtorin. Në organizatën bazë të fshatit Luz ekziston një farë Q.Ç. kandidat partie, që në realitet ja ka hipur në qafë organizatës bazë dhe bën ligjin atje. Në pozitat e këtij kanë qenë edhe sekretari i organizatës bazë dhe disa shokë të tjerë. Ky person, që ka qenë trim beu, me të kaluar të dyshimtë, imoral, i dënuar nga gjyqet, arrogant dhe që ka rrahur katundarë, dallaveraxhi dhe çfarë të duash ka influencuar që katundari H.B. të cilësohet kulak për arësye se nuk i ka dhënë çupën e tij 14-vjeçare për grua këtij bukuroshi 45-vjeçar. Sigurisht ju keni një përgjegjësi të rëndë për një situatë të tillë, pse merret me mend që padrejtësia që i është bërë katundarit H.B. nuk duhet të jetë e vetmja. Duhet të ketë edhe katundarë të tjerë në këtë fshat në pozitat e H.B. dhe kulakë të tjerë në fshat, të cilët jo vetëm nuk luftohen, por edhe mbrohen. Natyrisht, pas këtij verifikimi, organizata bazë e Partisë e fshatit Luz e inkurajuar në rrugën e drejtë nga ndërhyrja e organeve të Komitetit Qendror të Partisë, u bë më luftarake për mbrojtjen e vijës së Partisë. Ajo zbuloi kalbësirën që ekzistonte në gjirin e saj, spastroi nga radhët e saja Q.Ç. dhe mori masa ndëshkimore ndaj sekretarit të organizatës bazë dhe disa shokëve të tjerë.

Nga një çështje e tillë juve dalin detyra të rëndësishme:

1. — Të rishikoni sa më parë dhe drejt zbatimin e politikës së Partisë në lidhje me luftën e klasave në fshat. Të vini në vend padrejtësitë ndaj katundarëve të mesëm dhe të ashpërsoni luftën kundër kulakëve të vërtetë. Udhëhiquni vazhdimisht në këtë çështje të rëndësishme nga mësimet e Leninit dhe të Stalinit, që na i kanë bërë të qarta këto probleme si dhe nga direktivat e Komitetit Qendror, të cilat bazohen plotësisht në mësimet e marksizëm-leninizmit, të zbatuara në rrethanat e katundit tonë. Ky rishikim t'ju shërbejë jo vetëm juve, por të gjitha organizatave të Partisë të rrethit tuaj, duke pasur kurdoherë parasysh që ky problem të ngrihet drejt, d.m.th. të mos shikohen vetëm padrejtësitë dhe mbasandaj, duke u ruajtur nga sektarizmi, të kalohet në oportunitet duke lënë kulakët të qetë ose të mbrohen nën pretekstin se «mos gabojmë». Rishikimi i vijës së Partisë në këtë drejtim nuk duhet të bëhet vetëm duke rishqyrtuar lutjet e katundarëve të cilësuar si kulakë, të cilat flenë në raftet tuaja, por duhet të kuptohet më gjerë, duke u lidhur mirë udhëheqja me bazën, duke e ndihmuar bazën për këtë problem dhe duke e kontrolluar.

2. — Mjaft gjëra ju shpëtojnë juve në këtë drejtim, të cilat sjellin konsekuenca të rënda, prandaj duhet të luftoni burokracinë që ekziston te ju dhe në aparatet e komitetit të Partisë, të forconi punën kolegjiale në udhëheqje dhe t'u vini rëndësi të jashtëzakonshme mbledhjeve të organizatave bazë të Partisë, të aktiveve, të komitetit të Partisë të rrethit dhe të byrosë. Problemet

që i shtrohen Partisë dhe forumeve, të jenë të studjuara dhe të përgatitura mirë. Të luftohet ashpër formalizmi në punë dhe mungesa e përgjegjësisë. Të zhvillohet kritika dhe autokritika bolshevike kudo dhe sidomos nga poshtë-lart. T'i vini rëndësi të madhe zërit të popullit dhe bazës së Partisë. Të mos neglizhoni as gjënë më të vogël, pse kjo ju bën ju që të harroni edhe gjërat e mëdha. Shihni se si shoku Stalin interesohet edhe për gjëra familjare që i kërkoi populli. Në një kolkoz të vogël të Ukrainës, nipi i një kolkoziani plak ishte shumë i sëmurë. Doktor i që e mjekonte i kishte humbur shpresat dhe i thotë kolkozianit plak se nuk ka shpëtim. Kolkozianit plak mendon dhe thotë: «Nipi i im i vetëm do të vdesë. Kush mund të ma shpëtojë atë»? Atëhere ai i drejtoi një telegram shokut Stalin ku i thotë: «Nipi im i vetëm po vdes, shpëtoja». Pas tri orëve kolkozianit plak mori një telegram nga Stalini me këtë përgjegje: «U nis për atje aeroplani me doktorë specialistë». Dhe nipi i kolkozianit plak shpëtoi. Shihni sa kujdeset shoku Stalin për çështje të popullit. Pra, nuk duhet në asnjë mënyrë të veprohet ashtu si konstatohet te ju dhe në shumë rrethet të tjera goftë nga Partia, goftë nga organet e pushtetit. Të luftohen ashpër neglizhencat e theksuara në shqyrtimin e kërkesave të popullit, në pritjen e popullit, në zgjidhjen e problemeve të tij, në zgjidhjen e problemeve shtetërore dhe të Partisë, qofshin ato shumë të mëdha, qofshin edhe fare të vogla.

3. — Përsa i përket çështjes së katundarit H.B., ai duhet të thërritet nga ju, t'i thuhet se u shqyrtua çështja e tij dhe se rezultoi që kishte të drejtë. T'i thuhet se komiteti i Partisë i rrethit dhe organizata bazë e fshatit të tij, kanë gabuar. T'i hiqet menjëherë cilësimi i tij si kulak dhe t'i tregohen masat që janë marrë ndaj Q.Ç. Në të njëjtën mënyrë duhet të veprohet edhe për rastet e tjera.

4. — Rishikimi i çështjes së luftës së klasave në fshat, i gabimeve që do të vërtetohen pas këtij rishikimi, duhet të bëjë thelbin e një mbledhjeje të plenumit të komitetit të Partisë të rrethit, ku të analizohet mirë kjo çështje dhe të mësohet Partia nga gabimet që janë vërtetuar për të zhdukur oportunizmin ndaj kulakëve dhe sektarizmin ndaj elementit katundar të mesëm.

Me autorizim të Byrosë Politike të KQ
të PPSH

Sekretari i Përgjithshëm

Enver Hoxha

Botohet sipas librit:
Enver Hoxha. «Vepra, vëll. 9»

KONGRESI II I PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË

Tiranë, 31 mars — 6 prill 1952

Nga 31 marsi deri më 6 prill 1952 zhvilloi punimet e tij Kongresi II i PPSH.

Në Kongres morën pjesë 592 delegatë me votë deliberative dhe 142 delegatë me votë konsultative që përfaqësonin 44 418 anëtarë dhe kandidata të partie.

Kongresi II punoi me këtë rend dite:

1. — Raport «Mbi aktivitetin e Komitetit Qendror të PPSH», mbajtur nga shoku Enver Hoxha.

2. — Raport «Mbi zhvillimin perspektiv ekonomik e kultural të Republikës Popullore të Shqipërisë gjatë pesëvjeçarit 1951-1955», mbajtur nga shoku Mehmet Shehu.

3. — Raport i Komisionit të Revizionimit.

4. — Zgjedhjet për Komitetin Qendror.

5. — Zgjedhjet për Komisionin e Revizionimit.

Kongresi II i PPSH ishte një ngjarje e shënuar në jetën e Partisë dhe të popullit tonë. Ai shqyrtoi, diskutoi dhe aprovoi çështje me rëndësi të madhe historike të zhvillimit të Partisë dhe të vendit tonë, në rrugën drejt socializmit. Kongresi konstatoi se kthesa historike e Partisë e filluar në Kongresin I të PKSH ishte realizuar në të gjitha drejtimet dhe se Komiteti Qendror i Partisë me në krye Sekretarin e Përgjithshëm të Partisë, shokun Enver Hoxha, e kishte udhëhequr me urtësi Partinë dhe popullin tonë në luftën për sigurimin e pavarësisë dhe ndërtimin e bazave të socializmit. Kongresi II përpunoi direktivat e planit të parë pesëvjeçar 1951-1955.

Kongresi zgjodhi organet udhëheqëse të Partisë: Komitetin Qendror me 27 anëtarë dhe 12 kandidatë dhe Komisionin e Revizionimit me 3 anëtarë. Komiteti Qendror zgjodhi Byronë Politike me 7 anëtarë dhe 3 kandidatë dhe Sekretariatit të përbërë nga 5 sekretarë.

Sekretar i Përgjithshëm i Partisë u zgjodh përsëri shoku Enver Hoxha.

REZOLUCION

I KONGRESIT II TË PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË

Për raportin «Mbi aktivitetin e Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë»

6 prill 1952

Kongresi II i Partisë së Punës të Shqipërisë aprovoi njëzëri raportin «Mbi aktivitetin e Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë», paraqitur nga Sekretari i Përgjithshëm i Partisë, shoku Enver Hoxha. Kongresi konstatoi se kthesa historike e Partisë, e vendosur në Kongresin I të PKSH, është realizuar në të gjitha drejtimet dhe se Komiteti Qendror i Partisë e ka udhëhequr me sukses Partinë dhe popullin tonë në luftë për mbrojtjen e paqes, sigurimin e pavarësisë kombëtare dhe ndërtimin e themeleve të socializmit. Kongresi përcaktoi vijën e Partisë për periudhën e ardhshme.

I

MBI GJENDJEN POLITIKE NDËRKOMBËTARE DHE TË BRENDSHME

1. — Kongresi konstatoi se gjendja ndërkombëtare, prej Kongresit I e deri sot, është karakterizuar, në njërin anë, nga përgatitjet e ethëshme të imperializmit me Shtetet e Bashkuara të Amerikës në krye, për shpërthimin e një lufte të re botërore kundër Bashkimit Sovjetik dhe vendeve të demokracisë popullore dhe nga kalimi i tij në agresion të hapët në Kore; në anën tjetër, nga forcimi i mëtejshëm i kampit të socializmit, të paqes dhe të demo-

kracisë, që udhëhiqet nga Bashkimi i lavdishëm Sovjetik dhe Stalini i madh.

Në planet e tyre kriminale për sundimin e botës, imperia- listët amerikanë, kanë krijuar Paktin agresiv të Atlantikut Verior¹, kanë ndërtuar dhe po ndërtojnë baza ushtarake agresi- ve rreth Bashkimit Sovjetik dhe vendeve të demokracisë popu- llore dhe bashkë me shërbëtorët e tyre janë hedhur në një garë të çmendur armatimesh. Në të njëjtën kohë imperialistët ame- rikano-anglezë dhe shërbëtorët e tyre zhvillojnë një propagandë histerike për të ngjallur psikozën e luftës. Ata mundohen të fshe- hin kontradiktat dhe qëllimet e tyre prapa teorive false sikur lufta është gjoja e paevitueshme dhe e nevojshme, sikur sistemi kapita- list është i qëndrueshëm dhe mund të zhdukë kontradiktat e tija. Lufta është pjellë e imperializmit, por historia ka provuar se luf- tërat jo vetëm që nuk i zhdukin kontradiktat e imperializmit, por i thellojnë ato akoma më shumë, nuk e forcojnë imperializmin, por e çojnë atë më tutje drejt greminës. Lufta e parë botërore përfundoi me fitoren e Revolucionit të madh të Tetorit dhe në këputjen e zinxhirit imperialist në një të gjashtën e botës. Lufta e dytë botërore përfundoi me shkëputjen nga sistemi kapitalist botëror të një vargu vendesh të tjera të Evropës Lindore, Jug- lindore dhe të Azisë. Një luftë e re botërore do të sjellë me siguri vdekjen e imperializmit.

2. — Ndërsa imperializmi është dobësuar dhe po shkon në greminë, forcat e kampit të paqes, të demokracisë e të socializmit janë rritur dhe forcuar çdo ditë e më tepër. Popujt nuk e duan luf- tën; ata janë bashkuar në një front të organizuar për mbrojtjen e paqes, të udhëhequr nga Bashkimi Sovjetik dhe Stalini i madh. Kurrë nuk ka ekzistuar një lëvizje e tillë që përfshin qindra mi- liona njerëz në të gjithë botën. Për të mbrojtur paqen luftojnë sot popujt e lavdishëm të Bashkimit Sovjetik, popujt e vendeve të demokracisë popullore, populli i madh kinez, populli heroik ko- rean. Për paqen dhe pavarësinë kombëtare luftojnë popujt e ro- bëruar të kolonive. Për paqen dhe kundër skllavëruesve ameri-

¹ Pakti i Atlantikut Verior (NATO) u nënshkrua më 4 prill 1949 në Uashington nga përfaqësuesit e SHBA-së, Britanisë së Madhe, Francës, Bel- gjikës, Hollandës, Luksemburgut, Kanadasë, Italisë, Portugalisë, Norvegjisë, Danimarkës, Islandës. Në shtator të vitit 1951 këshilli i vendeve që formojnë këtë blok agresiv vendosi të pranojë në radhët e tija Greqinë dhe Turqinë, të cilat hynë zyrtarisht në këtë blok më 18 shkurt 1952. Ky pakt drejtohej kundër Bashkimit Sovjetik, vendeve të demokracisë popullore, kundër lë- vizjes nacional-çlirimtare në vendet koloniale dhe të varura dhe kundër lëvizjes demokratike në vendet kapitaliste.

kanë luftojnë masat punonjëse të vendeve kapitaliste të udhëhe- qura nga partitë e tyre komuniste...

Politika paqësore leniniste-staliniane e Bashkimit Sovjetik është drita që ndriçon rrugën e qindra miliona njerëzve në të gjitha kontinentet dhe që i udhëheq ata në aksione të guximshme për të mbrojtur paqen. Përpjekjet e vendit të Sovjetëve kanë qenë dhe janë të mëdha për t'i dhënë fund agresionit dhe për të ven- dosur paqen në Kore, për pakësimin e armatimeve, për ndalimin e menjëhershëm të armës atomike dhe të armëve të tjera të shfa- rosjes në masë, për demaskimin e Paktit agresiv të Atlantikut Verior dhe të traktateve anekse të hapëta ose të fshehta të tij, për nënshkrimin e një pakti të paqes në mes të pesë fuqive të mëdha. Politika paqësore e Bashkimit Sovjetik gjen shprehjen e saj të plotë në veprat e mëdha të ndërtimit të komunizmit. Bash- kimi Sovjetik realizoi dhe tejkaloi planin e parë pesëvjeçar të pasluftës dhe ecën drejt komunizmit. Kjo tregon fuqinë e pashter- shme dhe epërsinë e pakrahasueshme të sistemit socialist mbi atë kapitalist.

Të ndihmuar në mënyrë vëllazërore dhe të gjithanshme nga çlirimtari i tyre, Bashkimi Sovjetik, vendet e demokracisë popu- llore kanë korrur një varg suksesesh të rëndësishme në të gjitha fushat dhe ecin sot të sigurtë drejt socializmit.

3. — Kongresi konstatoi se në saje të politikës së drejtë të Partisë së Punës të Shqipërisë, të udhëhequr nga Komiteti Qe- ndror me shokun Enver Hoxha në krye, populli shqiptar është rad- hitur me vendosmëri në kampin e socializmit e të paqes dhe i ka vënë të gjitha forcat në shërbim të mbrojtjes së paqes.

Me ndihmën e çmueshme të Bashkimit Sovjetik në radhë të parë dhe personalisht të shokut të madh Stalin dhe me ndihmën e vendeve të demokracisë popullore, vendi ynë ka arritur suksese të mëdha në ndërtimin e themeleve të socializmit. U ndërtuan ve- pra të mëdha të socializmit, si Kombinati i tekstileve «Stalin», Centrali hidroelektrik «Lenin», Fabrika e sheqerit «8 Nëntori», u hapën institutet e para të larta në vendin tonë etj.

Kongresi e gjeti klasën tonë punëtore dhe të gjitha masat e tjera punonjëse në një mobilizim të plotë për ndërtimin e vepra- ve të mëdha të planit të parë pesëvjeçar të shtetit. Të gjitha këto janë një dëshmi e gjallë e politikës paqedashëse të Partisë sonë dhe e luftës së popullit tonë për paqen, janë fruti i punës heroik- ke të klasës sonë punëtore dhe i të gjitha masave punonjëse, të udhëhequra nga Partia e Punës, fruti i miqësisë së popullit tonë me popujt e Bashkimit Sovjetik si dhe me popujt e vendeve të de- mokracisë popullore.

4. — Kongresi konstatoi se miqësia e popullit tonë me popujt heroikë të Bashkimit Sovjetik është forcuar dhe çelnikësor për- ditë e më shumë...

Kongresi konstatoi gjithashtu, se edhe lidhjet e marrëdhënjet miqësore të popullit tonë me popujt e vendeve të demokracisë popullore janë zgjeruar e forcuar.

5. — Imperialistët amerikano-anglezë dhe këlyshët e tyre të Beogradit, të Athinës dhe të Romës e kanë halë në sy vendin tonë që ndërton themelet e socializmit dhe që është një vatër paqejë. Ata kurdin dhe vënë në veprim plane të poshtra kundër pavarësisë së atdheut tonë, shpifin kundër tij, organizojnë kriminelët e luftës të arratisur dhe i dërgojnë në Shqipëri për të kryer akte diversioni, terrori e sabotazhi. Por planet e tyre kanë dështuar dhe do të dështojnë kurdoherë në saje të vigjilencës dhe të patriotizmit të popullit tonë, në saje të ushtrisë sonë heroike, të Armës besnike të Sigurimit dhe të rojeve trime të kufirit, në saje të frontit ndërkombëtar të paqes që frymëzohet nga politika paqësore staliniane. Republika jonë Popullore ka forcuar prestigjin dhe pozitën e saj në fushën ndërkombëtare.

6. — Klika e Titos është armike e Bashkimit Sovjetik dhe e kampit të socializmit. Ajo është armike e Partisë sonë dhe e popullit shqiptar, ajo provokon çdo ditë kundër vendit tonë dhe është një rrezik për pavarësinë e atdheut tonë. Kriminelët e Beogradit, krahas terrorit që bëjnë kundër gjithë popujve të Jugosllavisë, po shfarosin me metodat më barbare popullsinë shqiptare të Kosovës, të Metohisë, të Malit të Zi dhe të Maqedonisë. Kongresi konstatoi se në saje të politikës së vendosur të Komitetit Qendror me shokun Enver Hoxha në krye, Republika jonë Popullore ka dërmuar dhe do të dërmojë të gjitha veprimet armiqësore të klikës Tito-Rankoviç.

7. — Populli ynë, i udhëhequr nga Partia, është bashkuar më tepër se kurrë në Frontin Demokratik; aleanca midis fshatarësisë dhe klasës punëtore, nën udhëheqjen e kësaj të fundit, shkon gjithnjë duke u forcuar. Është rritur dhe forcuar klasa jonë punëtore, ndërgjegjja e saj politike dhe eksperiencia e saj në punë. Regjimi i demokracisë popullore, ku klasa punëtore, nën udhëheqjen e Partisë, ka vendin drejtues, është bërë garancia e shëndoshë për pavarësinë dhe lirinë e atdheut. Republika Popullore e Shqipërisë qëndron sot si një kështjellë e pamposhtur e demokracisë dhe e paqes.

Në lidhje me këtë gjendje të brendshme dhe ndërkombëtare, kongresi shtron detyrat që vijojnë:

1. — Të gjitha organizatat e Partisë të rritin dhe të forcojnë luftën e popullit tonë për paqen. Të forcohen dhe të aktivizohen kudo komitetet për mbrojtjen e paqes dhe të tërhiqen gjithmonë e më shumë masat punonjëse të qytetit dhe të fshatit në veprimtari praktike dhe aksione konkrete e revolucionare për paqen.

Të demaskohen sistematikisht planet e nxitësve të luftës. T'u kujtohen gjithnjë masave tmerret e luftës, barbarizmat e amerikaneve në Kore dhe çfarë tmerresh të reja i përgatitin ata në rrezimit. T'u flitet atyre për varfërinë dhe vuajtjet e masave punonjëse të vendeve kapitaliste, mbi të cilat rëndojnë shpenzimet për përgatitjen e luftës. Të forcohet pa pushim urrejtja e popullit kundrejt imperializmit.

Të forcohet solidariteti ndërkombëtar i klasës punëtore dhe i masave punonjëse të vendit tonë me klasën punëtore dhe masat punonjëse të kampit të fuqishëm të socializmit, demokracisë dhe paqes, të udhëhequra nga Bashkimi Sovjetik dhe Stalini i madh.

Të bëhet një propagandë e gjallë për të sqaruar akoma më shumë masat se lufta nuk është e paevitueshme. Fjalët e shokut Stalin se

«Paqja do të ruhet dhe do të forcohet, në qoftë se popujt do ta marrin në duart e veta çështjen e ruajtjes së paqes dhe do ta mbrojnë atë deri në fund»¹,

duhet të jenë flamuri i luftës së popullit tonë për mbrojtjen e paqes.

2. Kongresi e quan si detyrë kryesore për Komitetin Qendror dhe gjithë organizatat e Partisë çelnikosjen e mëtejshme të miqësisë, dashurisë dhe besnikërisë ndaj Bashkimit Sovjetik, Partisë Bolshevike dhe shokut Stalin, mikut më të madh e më të shtrenjtë të popullit tonë.

Organizatat e Partisë, të gjitha levat e saja dhe Shoqëria e miqësisë Shqipëri-BRSS, të organizojnë dhe të bëjnë një punë të gjithanshme, të vazhdueshme dhe konkrete për njohjen e jetës së vendit të madh të socializmit, për popullarizimin e të gjitha sukseseve të popujve sovjetikë.

Kongresi e konsideroi si një çështje të rëndësishme për Partinë, për organet shtetërore dhe organizatat e masave, përvetësimin e mëtejshëm dhe vënjen në jetë të eksperiencës së Partisë së madhe Bolshevike dhe të të gjithë punonjësve sovjetikë në të tëra fushat e ndërtimit ekonomik e kultural të vendit tonë.

3. — Të forcohet edhe më tej miqësia dhe bashkëpunimi vëllazëror i popullit tonë me popujt e vendeve të demokracisë popullore dhe të bëhet një punë akoma më e organizuar për njohjen e këtyre vendeve që ecin në rrugën e socializmit.

4. — Kongresi e quan jetike forcimin e mbrojtjes së pavarësisë dhe të lirisë së atdheut tonë.

1 J. V. Stalin. Bisedë me korrespondentin e gazetës «Pravda». «Pravda», Nr. 48 (11885), 17 shkurt 1951.

Prandaj të shtohet përherë e më shumë patriotizmi popullor i masave tona punonjëse i lidhur ngushtë me punën e tyre të përditshme për ndërtimin socialist të vendit dhe me traditat e shkëlqyera të popullit tonë.

Të rritet edhe më shumë vigjilenca revolucionare e Partisë, e klasës punëtore dhe e të gjitha masave punonjëse në veprimtarinë e tyre praktike.

Të demaskohet e të luftohet pa pushim veprimtaria armiqësore e imperialistëve amerikano-anglezë dhe e këlyshëve të tyre të Beogradit, të Athinës e të Romës, kundër Republikës Popullore të Shqipërisë. Të luftohet pa mëshirë klika trockiste e Titos dhe agjentët e saj si armiq të Partisë dhe të popullit tonë.

Të rritet edhe më tej fuqia dhe aftësia mbrojtëse e atdheut tonë; të forcohet dhe të modernizohet më tej Ushtria jonë Popullore, garancia e fitoreve të revolucionit tonë popullor; të forcohet vazhdimisht Arma e Sigurimit të Shtetit dhe lidhjet e saja me popullin.

II

MBI UDHËHEQJEN E PARTISË NË EKONOMI

1. — Kongresi konstatoi se ekonomia jonë është zhvilluar në mënyrë të planifikuar socialiste, dhe kjo u bë e mundur në sajë të hovit revolucionar të masave, në sajë të udhëheqjes së drejtë të Partisë, në sajë të ndihmës së Bashkimit Sovjetik dhe sepse u likuidua sabotimi titist. Suksese të mëdha janë arritur në të gjitha fushat e ekonomisë kombëtare dhe sidomos në lëmin e industrisë që është themeli i ndërtimit të socializmit. Prodhimi industrial e ka kaluar shumë herë nivelin e paraluftës. Bujqësia është vënë në rrugën e përparimit, është shtuar sipërfaqja e tokave të mbjella dhe janë rritur rendimentet e kulturave bujqësore. Kooperativat bujqësore janë shtuar dhe forcuar. Është përmirësuar gjendja materiale e masave dhe është ngritur niveli kulturor i tyre.

Këto suksese i detyrohen udhëheqjes së drejtë të Partisë, punës së palodhur të klasës punëtore dhe të të gjitha masave punonjëse, ndihmës së gjithanshme dhe vëllazërore të Bashkimit Sovjetik, personalisht të shokut të madh Stalin si dhe të vendeve të demokracisë popullore.

Në punë për ndërtimin e themeleve të socializmit është rritur dhe forcuar klasa punëtore, është ngritur ndërgjegjja e saj po-

litike dhe kualifikimi i saj në punë. Është zgjeruar lëvizja e sulmuesve dhe janë vënë në zbatim një varg metodash të përparuara të stakanovistëve sovjetikë.

2. — Kongresi konstatoi se plani i parë pesëvjeçar është një program madhështor i ndërtimit të themeleve të socializmit. Ai parashikon një zhvillim të madh të ekonomisë dhe të kulturës së vendit tonë. Një hov i madh pune dhe emulacioni ka përfshirë të gjitha masat punonjëse për ndërtimin e veprave të mëdha të socializmit, si centrali hidroelektrik mbi lumin e Matit, rafineria e naftës në Cërrik, fabrika e çimentos në Vlorë etj.

3. — Kongresi konstatoi gjithashtu se gjatë kësaj periudhe në drejtimin e ekonomisë ka pasur mjaft të meta, ka munguar një disiplinë e kontroll i fortë në punë, përgjegjësia kolektive dhe personale ka qenë e dobët, ka pasur burokratizëm dhe mungesë vigjilence kundër armikut të klasës.

4. — Detyra të rëndësishme dalin përpara Partisë dhe të gjitha masave punonjëse për plotësimin e planit të parë pesëvjeçar.

«Detyra politike kryesore e planit të parë pesëvjeçar konsiston:

NË FORCIMIN E ALEANCËS MIDIS KLASËS PUNËTORE DHE FSHATARRËSISË PUNONJËSE DHE NË FORCIMIN E ROLIT DREJTUES TË KLASËS PUNËTORE NË KËTË ALEANCË; NË KUFIZIMIN E ELEMENTËVE KAPITALISTË DHE SPEKULATORË TË QYTETIT DHE TË FSHATIT; NË RRITJEN E NIVELIT KULTURAL TË MASAVE PUNONJËSE; NË FORCIMIN E NDËRGJEGJES SOCIALISTE TË KLASËS PUNËTORE DHE NË FORCIMIN E VIGJILENCËS REVOLUCIONARE E TË PATRIOTIZMIT TË TË GJITHA MASAVE PUNONJËSE.

Detyra ekonomike kryesore e planit të parë pesëvjeçar konsiston:

NË VAZHDIMIN ME NJË RITËM MË TË SHPEJTË TË PUNËS PËR NDËRTIMIN E BAZËS EKONOMIKE TË SOCIALIZMIT, PËR TË BËRË QË NË FUND TË PESËVJEÇARIT VENDI YNË TË JETË TRANSFORMUAR NGA NJË VEND AGRAR I PRAPAMBETUR NË NJË VEND AGRARO-INDUSTRIAL»¹.

5. — Kushtet kryesore të domosdoshme për plotësimin e planit të parë pesëvjeçar janë:

Të përmirësohet dhe të forcohet drejtimi i Partisë në ekonomi. Të forcohet dhe të përmirësohet puna për lidhjen e ngushtë të problemeve ekonomike me punën politike. Të ushtrohet kontroll i vazhdueshëm, sistematik e rigoroz mbi zbatimin e vendimeve dhe të detyrave të Partisë e të shtetit. Të luftohet për një

¹ Enver Hoxha. Vepra, vëll. 9, f. 170—171.

punë të organizuar mirë dhe për zhdukjen e burokratizmit në punë.

Komunistët dhe gjithë punonjësit të luftojnë për uljen e kos-
tos, për përmirësimin e cilësisë së prodhimit, për rritjen e rendi-
menteve në punë duke organizuar gjerësisht emulacionin socia-
list, duke përhapur metodat sovjetike dhe të punëtorëve tanë më
të përparuar dhe duke vendosur një regjim të rreptë kursimi.

Për plotësimin e detyrave që na vë përpara plani pesëvjeçar,
duhet të forcohet më shumë vigjilenca revolucionare, duke edu-
kuar masat me anë shembujsh të marrur nga lufta kundër armiq-
ve, spiunëve, diversantëve e vjedhësve; të rritet ndërgjegjja në
punë e gjithë punonjësve dhe të bëhet një luftë e ashpër kundër
të metave dhe lëshimeve, kundër vjedhjeve, dëmtimeve e sabo-
timeve të pasurisë shtetërore e kooperativiste, të cilat janë manifes-
time të ashpërsimit të luftës së klasave. Komunistët të jenë kurdo-
herë në pararojë të masave punonjëse.

T'i kushtohet kujdes i posaçëm përgatitjes së kuadrove të
rinj nga radhët e klasës punëtore dhe ngritjes profesionale të pu-
nëtorëve. Komunistët, në radhë të parë, duhet të përvetësojnë
teknikën e re.

Nën udhëheqjen e Partisë, organizatat profesionale e të rinisë,
organizata e gruas, e Frontit Demokratik, të mobilizojnë masat
punonjëse për realizimin e planit pesëvjeçar. Në mënyrë të ve-
çantë, organizatat profesionale u takon të luajnë një rol shumë
të rëndësishëm, ato duhet të bëhen shkolla të komunizmit, të për-
krahin metodat e reja në punë, racionalizimet e novacionet, të
zhvillojnë emulacionin socialist dhe lëvizjen sulmuese. Edukimi i
klasës punëtore, që po rritet e po forcohet dhe përmirësimi i jete-
sës së saj dhe i të gjithë punonjësve janë detyra kryesore të Partisë
dhe të Bashkimeve Profesionale të Shqipërisë.

III

MBI FORCIMIN E MËTEJSHËM TË PARTISË

1. — Kongresi konstatoi se pas Kongresit I në vendin tonë
janë arritur suksese të rëndësishme, që tregojnë se Partia i ka
kryer me nder detyrat e saja historike.

Partia jonë nxori mësimë të rëndësishme nga letrat histori-
ke të PK (b) të BRSS drejtuar ish-PKJ dhe Rezolucioni i Byrosë
Informative «Mbi gjendjen në PKJ». Ajo i dërhoi agjentët titistë
në Partinë tonë, Koçi Xoxen me shokë, dhe kreu me sukses kthe-

sën historike që e vuri plotësisht Partinë në rrugën e drejtë mark-
siste-leniniste.

Partia ka luftuar me sukses për ruajtjen e vijës së saj dhe të
parimeve marksiste-leniniste. Lufta e saj kundër armiqve të jash-
tëm dhe të brendshëm, lufta e ashpër kundër titistëve dhe agjen-
tëve të tyre, lufta kundër deviatorëve në Parti pas Kongresit I,
kundër presionit të borgjezisë, lufta e përditshme kundër vësh-
tirësive e ka çelënikosur Partinë tonë dhe e ka forcuar unitetin
e saj.

2. — Partia ka synuar që të hynin në radhët e saja njerëz
të sprovuar dhe besnikë të Partisë e të popullit. Efektivit i Partisë
paraqitet sot pak më i vogël se 3 vjet më parë dhe kjo për arsye
të vërtetimit të dokumentave dhe sepse është luftuar më shumë
për përmirësimin e cilësisë se sa për shtimin e numrit.

Përbërja shoqërore e Partisë në përgjithësi është e mirë e
krahasim me shtresat shoqërore të vendit tonë, por megjithatë
numri i anëtarëve dhe i kandidatëve punëtorë është akoma i vo-
gël. Gjithashtu kandidatët e Partisë përfaqësojnë në efektivin e
Partisë akoma një përqindje të madhe. Nuk është bërë sa duhet
për edukimin e komunistëve të rinj.

Një masë e domosdoshme e shumë e rëndësishme ka qenë
vërtetimi i dokumentave, i cili spastroi Partinë nga elementi arm-
mik dhe i pavlefshëm, goditi dobësitë dhe të metat në lidhje me
qëndrimin dhe aktivitetin e sotëm të komunistëve, influenoi
shumë në forcimin e jetës së brendshme të organizatave të Partisë,
forcoi vigjilencën, shpirtin e tyre luftarak, kritikën dhe au-
tokritikën.

Përmirësimi i shtrirjes së Partisë i afroi organet drejtuese
me organizatat bazë dhe kjo ndihmoi në përmirësimin e tyre. Or-
ganizatat bazë u ndërtuan në bazë prodhimi, u shtua numri i tyre
dhe u forcuan lidhjet e Partisë me masat.

3. — Në Parti u spastruan metodat trockiste-titiste që dëm-
tonin rëndë vijën politike dhe organizative të saj. Është forcuar
centralizmi demokratik, janë përmirësuar jeta e brendshme e Partisë,
kritika e autokritika dhe disiplina në Parti.

Të gjitha këto e kanë forcuar Partinë, rolin udhëheqës të
saj, kanë rritur aftësitë dhe ndjenjën e përgjegjësisë së komunis-
tëve kundrejt detyrave.

Por me gjithë këto përparime, në jetën e brendshme të Partisë
ka mjaft dobësi. Mbledhjet e plenumeve të komiteteve të Partisë
dhe të aktiveve të Partisë nuk janë zhvilluar kudo dhe në
rregull. Ato nuk janë përgatitur si duhet dhe shumë herë janë
bërë formale. Komitetet e Partisë nuk i përdorin aktivet plotësisht
në rrugën e drejtë të caktuar prej Statutit, nuk i konsiderojnë
ato si ndihmëse të dorës së parë, si një shkollë të vërtetë kua-
drosh, si organe që drejtojnë dhe orientojnë gjithë punën e Par-

tisë dhe të udhëheqjes së saj. Ky nënvleftësim ka shkaktuar që organet drejtuese të Partisë në rrethe të mos mbështeten dhe të mos dëgjojnë sa duhet zërin e bazës. Nga ky nënvleftësim organet drejtuese në rrethe nuk kanë mundur t'i bëjnë aq sa duhet vendimet e tyre probleme të organizatave bazë të Partisë. Komiteti Qendror ka përgjegjësi në këtë drejtim, por përgjegjësi për këtë kanë dhe shokët e byrove të komiteteve të Partisë të rretheve, të cilët i janë shmangur dhënjes llogari përpara plenumit dhe masës së Partisë duke dobësuar kështu rolin e udhëheqjes kolegjiale të plenumeve.

Metoda e punës në organet udhëheqëse të Partisë në rrethe dhe në aparatet e Komitetit Qendror është akoma e dobët, me të meta serioze: aty ka javashllëk, burokratizëm të madh, praktikizëm, çështjet nuk shikohen thellë dhe nuk studjohen gjithmonë në mënyrë kolegjiale, prandaj merren vendime të përcipta, të shpejta e jo të plota, kurse puna organizative dhe kontrolli për zbatimin e vendimeve janë të dobëta. Një pjesë e shokëve të organeve udhëheqëse nuk interesohen gjallërisht për të gjitha problemet, por merren vetëm me sektorin e punës së tyre, duke harruar rolin si anëtarë të një organi udhëheqës partie. Si rrjedhim ka pasur dobësi në kritikën e autokritikën. Kritika nga poshtë nuk ka qenë e fortë dhe shpeshherë ka pasur mbytje të kritikës. Kjo ka çuar pastaj në lëshime në drejtim të zbatimit të vendimeve të udhëheqjes.

Në lidhjet e organeve udhëheqëse me bazën ka akoma mjaft dobësi, puna e instruktorëve të Partisë ka qenë e dobët, nuk është kontrolluar mirë dhe nuk është treguar kujdesi i nevojshëm për edukimin e tyre.

4. — Në saje të mësimave të Stalinit të madh Partia jonë, e udhëhequr nga Komiteti Qendror me shokun Enver në krye, i dërmoi përpjekjet e klikës së Beogradit dhe të agjentëve të saj në Partinë tonë Koçi Xoxes, Pandi Kristos etj.

Titizmi, si agjunkturë e rrezikshme, është përpjekur dhe përpjetet të godasë njerëzit e shëndoshë të Partisë, unitetin e saj bolshevik, parimet dhe rregullat organizative të saja, vijën politike dhe ideologjike. Përpjekjet e tija kanë dështuar e do të dështojnë, pse Partia dhe populli ynë kanë qëndruar e qëndrojnë vazhdimisht vigjilentë.

5. — Kongresi konstatoi se devijimet dhe gabimet e shfaqura në Partinë tonë tregojnë se rreziku i djathtë, rreziku i oportunitizmit, është më i madh për Partinë tonë. Rreziku i djathtë u shfaq në grupin antiparti dhe antisovjetik të Abedin Shehut me shokë. të cilin Partia jonë e dërmoi menjëherë. Manifestime oportuniste dhe qëndrime të padënja u shfaqën edhe pas dërmimit të këtij grupi, si gabimet e rënda oportuniste të shokut Tuk Jakova,

kapitullimi dhe dezertimi nga lufta e Partisë i shokëve Manol Konomi dhe Theodor Heba, qëndrimet e gabuara të shokëve Nexhip Vinçani e Gjin Marku, puna e sëmure e grupit të Hasan Gjinës në Lushnjë, ajo e Pajo Islamit në Komitetin e Partisë të Kombinativit të naftës dhe dredhia e kurdisur kundër organizatës së Partisë dhe udhëheqjes së Komitetit të Partisë të Pukës nga ish-sekretari i dytë i këtij komiteti Z.G.

Në saje të vigjilencës revolucionare, këto devijime dhe gabime Partia jonë i ka zbuluar e kritikuar ashpër dhe i ka goditur. Kështu është çeltnikësuar edhe më tepër Partia jonë.

Por nuk mund ta flemë mendjen dhe të themi se u zhdukën armiqtë e Partisë, të hapët dhe të fshehtë. Rreziku qëndron kurdoherë i madh, derisa qëndron rrethimi kapitalist, derisa vendi ynë është i rrethuar gjeografikisht nga armiq, derisa në vendin tonë ashpërsohet çdo ditë e më tepër lufta e klasave.

6. — Në edukimin marksist-leninist të anëtarëve dhe të kandidatëve të Partisë janë arritur suksese. Është organizuar rrjeti arësimor i Partisë që punon me programe të rregullta, në mbështetje të eksperiencës së Partisë Bolshevike. Pjesëmarrja e komunistëve në këto forma ka ardhur duke u rritur nga viti në vit dhe janë botuar një numër i mirë librash me karakter ideologjik. Një punë e organizuar ka filluar të bëhet edhe në klasën punëtore, në rini dhe në masën e intelektualëve për edukimin e tyre me teorinë marksiste-leniniste.

Por, në punën e propagandës ka dobësi të mëdha. Ngritja ideopolitike e Partisë nuk është udhëhequr si duhet nga lart dhe nga komitetet e Partisë; ajo nuk është konsideruar si një nga problemet themelore të Partisë. Cilësia e punës së propagandës është e dobët, ka formalizëm dhe një ndarje të teorisë nga praktika. Puna për edukimin e masave punonjëse ka qenë e pamjaftueshme. Shtypi e ka ndihmuar pak propagandën dhe ka të meta në shpërndarjen dhe shfrytëzimin e tij. Gjendja arësimore-kulturale e Partisë është akoma e ulët.

7. — Në punën me kuadrin Partia është udhëhequr nga parimet staliniane të zgjedhjes, ngritjes dhe edukimit të kuadrit. U zbatua parimi kolegjial në vendosjen e kuadrit, ju dhanë fund rreziqeve që sillte vendosja personale e kuadrit. U vendos nomenklatura e kuadrit dhe u bë një shpërndarje më e drejtë e kuadrove duke forcuar në radhë të parë komitetet e Partisë të rretheve.

Por në politikën e kuadrit, ekzistojnë akoma shfaqje sektare në ngritjen e kuadrove të rinj, bile ka pasur edhe shfaqje të dëmshme, siç është mosbesimi ndaj kuadrit punëtor. Ka pasur gjithashtu mungesë vigjilence dhe oportunitizëm në zgjedhjen e kuadrit sidomos në sektorin ekonomik ku kanë hyrë edhe elementë armiq. Aparatet e Partisë nuk e kanë bërë akoma çështjen e kua-

drit problem të tyre kryesor dhe nuk ndjekin sistematikisht zhvillimin e përparimin e kuadrove. Zgjedhja e kuadrit për në shkolla e kurse shpesh bëhet e rastit e pa perspektivë. Nuk tregohet kujdesi i duhur për edukimin dhe aktivizimin e rezervës së kuadrit.

Në lidhje me këto konstatime dhe për forcimin e mëtejshëm të Partisë, kongresi shtron këto detyra:

1. — Të njihet dhe të zbatohet plotësisht Statuti i PPSH nga të gjithë anëtarët e kandidatët e Partisë.

2. — Të përmirësohet përbërja shoqërore e Partisë. Organizatat e Partisë të tregojnë një kujdes të veçantë për pranimet e reja në Parti. Të tregohet një kujdes më i madh për aktivizimin dhe edukimin e kandidatëve të Partisë. Të forcohet përbërja shoqërore e Partisë me elementë të rinj, sidomos nga radhët e klasës punëtore. Të shqyrtohet mirë elementi i ri që do të pranohet në Parti, si nga e kaluara ashtu dhe nga puna e tij e tashme. Të gjykohen njerëzit nga besnikëria e tyre ndaj Partisë dhe popullit. Të gjykohen nga puna e tyre e palodhur për të kryer me nder detyrat që u ngarkon Partia. Të ruhet si sytë e ballit Partia nga përpjekjet që bën armiku për të hyrë në radhët e saja dhe të forcohet vigjilenca revolucionare.

3. — Të forcohen vazhdimisht organizatat bazë dhe të bëhen shkolla të vërteta të edukimit bolshevik të komunistëve. Ato të jenë në ballë të luftës për zbatimin e vijës së Partisë.

4. — Organet udhëheqëse të marrin masat për përmirësimin e metodës së punës së tyre.

T'u vihet rëndësi e madhe mbledhjeve të plenumeve të komiteteve të Partisë, konferencave e aktiveve të Partisë dhe seminareve. Të përmirësohet puna në to, dhe të ushtrohet kontrolli i përpiktë mbi zbatimin e vendimeve. Të forcohet udhëheqja kolegjiale në Parti, si metodë e vetme e udhëheqjes së Partisë dhe të rritet ndjenja e përgjegjësisë personale dhe kolektive.

Të forcohet kritika e autokritika bolshevike dhe sidomos kritika nga poshtë, pa marrë parasysh personin dhe të luftohet kundër të gjitha shfaqjeve të mbytjes së kritikës. Një rol me rëndësi i takon «Zërit të Popullit» dhe gjithë shtypit tonë për forcimin e kritikës dhe të autokritikës bolshevike. Të forcohet disiplina dhe vigjilenca revolucionare.

Të ngrihet niveli i udhëheqjes së Partisë duke zhdukur metodat e punës deklarative dhe konferenciale dhe të luftohet për një operativitet bolshevik në punë. Në të gjitha aparatet e Partisë dhe të shtetit të luftohet burokratizmi. Në këtë drejtim të udhëhiqemi nga mësimet e shokut Stalin:

«Në luftën kundër burokratizmit puna e partisë bëhet në katër drejtime: duke zhvilluar autokritikën, duke orga-

nizuar kontrollin e zbatimit, duke spastruar aparatën dhe, më në fund, duke ngritur në aparat njerëz besnikë të dalë nga radhët e klasës punëtore»¹.

Të forcohen vazhdimisht lidhjet e organeve udhëheqëse me bazën.

Në radhë të parë në punën e çdo organi drejtues e të çdo udhëheqësi të vihet kontrolli i përpiktë i zbatimit të vendimeve.

Udhëheqja e Partisë të kujdeset veçanërisht për ngritjen e nivelit teorik dhe politik të funksionarëve të aparateve qendrore dhe të komiteteve, të instruktorëve, të organizatorëve dhe të sekretarëve të organizatave bazë.

5. — Të shtohet vigjilenca e Partisë kundër titistëve dhe agjentëve të tyre.

Të konsiderohet deviacion i djathtë oportunizmi si rreziku më i madh i Partisë sonë, i cili shfaqet dhe bëhet i rrezikshëm në çastet e qetësisë dhe të stabilitetit, pa harruar aspak rrezikun e deviacionit të majtë. Prandaj hovi revolucionar i Partisë duhet të ecë vazhdimisht përpara, vigjilenca revolucionare e Partisë të shtohet çdo ditë, lufta kundër oportunizmit të jetë e ashpër dhe pa kompromis.

Presioni i borgjezisë mbi Partinë tonë duhet të konsiderohet si një rrezik shumë serioz dhe duhet të luftohet vazhdimisht me forcën më të madhe.

Të forcohet çdo ditë e më tepër uniteti ideologjik dhe organizativ i Partisë sonë.

6. — Të forcohen pa pushim lidhjet e Partisë me klasën punëtore dhe masat e gjera punonjëse. Komunistët kudo që punojnë, të kenë kontakte të përditshme me masat, të bisedojnë me to mbi ngjarjet e brendshme e ndërkombëtare, t'i sqarojnë drejt e me durim mbi të gjitha çështjet që u interesojnë, të dëgjojnë zërin e tyre duke zgjidhur ankesat, propozimet dhe kërkesat e tyre, duke i mobilizuar në zbatimin e politikës së Partisë e të qeverisë.

7. — Të konsiderohet puna për edukimin ideo-politik dhe kultural të komunistëve si një nga problemet themelore të Partisë. Çdo komunist duhet ta konsiderojë punën për ngritjen e nivelit ideo-politik dhe kultural, si një detyrë të parë dhe urgjente të tij. Organizatat bazë të Partisë ta drejtojnë më mirë këtë punë.

Porositet Komiteti Qendror të ketë parasysh që zgjerimi i rrjetit arësor të Partisë të mos çënojë cilësinë e punës së propagandës. Të merren masa për përgatitje propagandistësh të kualifikuar dhe të organizohet një ndihmë e vazhdueshme për ngritjen e nivelit të tyre ideo-politik e të aftësive metodike. Zhvilli-

¹ J. V. Stalin. Veprat, vëll. 12, f. 319.

mi i mësimëve të marksizëm-leninizmit të lidhet ngushtë me jetën dhe detyrat praktike dhe aktuale të Partisë. Studimi individual të konsiderohet si një nga metodat kryesore të edukimit marksist-leninist për kuadrot e ngritur.

Të forcohet drejtimi i komiteteve të Partisë në fushën e arësimit, të artit e të kulturës.

Komitetet e Partisë të drejtojnë nga afër seminarët e agjitorëve dhe të përmirësojnë punën në to.

Të forcohet puna për edukimin marksist-leninist të masave punonjëse, të klasës punëtore, rinisë dhe intelektualëve. Shtypi i Partisë duhet të luajë një rol me rëndësi në punën e propagandës së Partisë, për të ndihmuar Partinë dhe masat punonjëse në studimin e marksizëm-leninizmit. Leximi me kujdes i shtypit dhe i librit duhet të jetë një detyrë e përditshme e çdo komunisti.

8. — Komitetet e Partisë ta bëjnë problemin e kuadrit, problemin e tyre kryesor. Të luftohet kundër sektarizmit në ngritjen e kuadrove të rinj e të kuadrove punëtorë. Të tregohet kujdesi dhe vigjilenca e duhur në zgjedhjen e kuadrit dhe në mënyrë të veçantë të studjohet kuadri që dërgohet në shkollë e kurse partie, duke zgjedhur kuadro të shëndoshë e me perspektivë. Komitetet e Partisë të kujdesen më shumë për edukimin dhe aktivizimin e rezervës së kuadrit.

IV

MBI PUNËN E PARTISË NË FSHAT

Kongresi konstatoi se në fshat janë bërë mjaft përparime. Aty është përmirësuar jeta dhe ekonomia, është zgjeruar arësimi fillor dhe 7-vjeçar, janë arritur rezultate në zhdukjen e analfabetizmit, janë vënë në zbatim metodat e reja në punë. Kooperativat bujqësore janë forcuar nga ana ekonomike dhe organizative. Është zhvilluar e ashpër lufta e klasave, është ngritur niveli politik i masave dhe janë kryer me sukses aksione të rëndësishme politike.

Por në fshat ka mungesa të ndijshme; lufta për shtimin e vazhdueshëm të prodhimeve bujqësore e blegtorale, për rritjen e rendimenteve është akoma e dobët. Puna politike dhe organizative e Partisë në fshat nuk është e mjaftueshme. Organet qendrore dhe komitetet e Partisë të rretheve tregojnë shumë pak kujdes për fshatin, duke u kufizuar më shumë në kërkesat për zbatimin e detyrimeve nga ana e fshatarëve, por edhe këto kërkesa nuk sho-

qërohen me një punë të shëndoshë politike, ideologjike dhe kulturale. Direktivat e Partisë në fshat punohen në mënyrë të përciptë dhe formale, pa i lidhur këto si duhet me një punë politike dhe me gjendjen konkrete të fshatit. Puna e organizatave të Partisë për të udhëhequr drejt dhe për të forcuar levat e Partisë në fshat, për të aktivizuar njerëzit pa parti, nuk është e mjaftueshme. Puna për forcimin e këshillave popullore të fshatit, për edukimin dhe aktivizimin e plotë të rinisë, të gruas, e sidomos të organizatës së Frontit Demokratik është e dobët. Ka tendenca që komunistët të monopolizojnë punën, në vend që të kenë besim të plotë të njerëzit e thjeshtë të popullit dhe t'i aktivizojnë ata, t'i mësojnë dhe të mësojnë prej tyre.

Është treguar pak kujdes për forcimin ekonomik e organizativ të kooperativave bujqësore. Ka pasur ndonjë rast që në kooperativat tona të shfaqen tendenca të huaja, të mos zbatohet plotësisht Statuti, të mos realizohen rendimentet e parashikuara në të gjitha kulturat bujqësore. Partia nuk ka bërë një punë sistematike edukative për rritjen e ndërgjegjes kooperativiste të anëtarëve, për ruajtjen e pasurisë së përbashkët, për përhapjen sa duhet të eksperiencës së kolkozeve sovjetike etj.

Edhe në luftën e klasave në fshat janë vërtetuar raste të shfaqjeve oportuniste, sektare dhe ekstremiste që kanë dëmtuar vijën e Partisë.

Për përmirësimin e gjendjes në fshat Partisë i dalin këto detyra:

1. — Të forcohet çdo ditë e më shumë aleanca midis klasës punëtore dhe fshatarësisë punonjëse, nën udhëheqjen e klasës punëtore, konditë kjo e domosdoshme për ndërtimin e socializmit.

2. — Të përmirësohet puna politike dhe organizative e Partisë në fshat. Direktivat e Partisë të shkojnë drejt dhe me kohë në fshat. Instruktorët që merren me çështjen e Partisë në fshat të mësojnë dhe të njohin mirë problemet bujqësore.

Udhëheqja e Partisë të heqë dorë nga metodat e administrimit e të komandimit. Me fshatarësinë duhet sqarim, edukim, interesim i gjallë për nevojat dhe problemet e saj.

3. — Udhëheqja e Partisë në rreth dhe organizatat e Partisë në fshat t'i vënë rëndësinë më të madhe forcimit dhe aktivizimit të levave të Partisë dhe aktivitetit pa parti. Këshillave popullore të fshatit t'u jepen të gjitha kompetencat dhe të drejtat e drejtimit të pushtetit në fshat, të forcohet përbërja e këshillave të fshatrave. Organet e pushtetit të tregojnë më tepër kujdes për dëgjimin e zërit të masave e për zgjidhjen e problemeve të tyre.

a) Fronti Demokratik, i udhëhequr nga Partia, duhet të gjallërohet, të bëhet i fuqishëm, siç ka qenë në kohën e Luftës nacional-çlirimtare, të mobilizojë dhe të edukojë masat në frymën

e patriotizmit të flaktë, t'u sqarojë atyre çdo problem dhe të ngjallë në to entuziazmin dhe besimin në forcën e Republikës sonë Popullore. Të luftohet sektarizmi që shfaqet në Front.

b) Partia duhet t'i kushtojë kujdesin më të madh organizatës së rinisë në fshat. Udhëheqja e rinisë duhet të përmirësojë punën e saj organizative dhe politiko-kulturale, të shkundet nga burokratizmi dhe sektarizmi i theksuar. Partia duhet t'i vërë kujdesin më të madh edukimit të brezit të ri, si në qytet dhe në fshat dhe t'i përmbushë nevojat e tij. Organizata e rinisë të shtrihet në të gjitha fshatrat, të krijojë një aktiv të gjerë rreth vetes dhe të bëhet, si na mëson shoku Stalin, «... përçues i politikës proletare në fshat»¹. Komitetet e Partisë në rreth duhet të kujdesen veçanërisht për organizatat e rinisë në ato fshatra ku nuk ka organizata partie.

c) Gjithashtu, Partia të kujdeset dhe të ndihmojë organizatën e gruas në fshat, që kjo të forcojë punën për edukimin e gjithanshëm të grave, për hedhjen e plotë të tyre në punë bujqësore.

4. — Çështja e edukimit politik dhe kultural të komunistëve në fshat dhe të fshatarësisë në përgjithësi të jetë një nga detyrat kryesore të Partisë. Të luftohet me këmbëngulje për zhdukjen e analfabetizmit. Të zbatohet plotësisht detyrimi i arësimit fillor dhe të tregohet kujdes që fëmijët e fshatarëve të vazhdojnë shkollën më të lartë.

T'i kushtohet kujdesi i posaçëm shpërndarjes dhe leximit të shtypit dhe të librit në fshat, zhvillimit të konferencave edukative e teknike për problemet e fshatit. Qyteti duhet të ndihmojë vazhdimisht fshatin në këtë drejtim. Një barrë të rëndësishme për këtë ka inteligjencia jonë, që duhet të shkojë në fshat, t'i mësojë dhe t'i edukojë fshatarët, ta lidhë punën shkencore me praktikën. Prapambetja, fanatizmi, pikëpamjet mikroborgjeze të fshatarit të luftohen me një punë edukative politike dhe ideologjike të shëndoshë dhe kurdoherë bindëse.

5. — Një nga detyrat më të rëndësishme për Partinë është zbatimi me përpikmëri i direktivës së dhënë nga Partia në lidhje me kooperativat bujqësore. Kooperativat bujqësore janë e vetmja rrugë e shpëtimit nga prapambetja dhe e ndërtimit të socializmit në fshat. Por në këtë çështje kaq të rëndësishme dhe delikate duhet ecur me hapa të matur, nuk duhet të shpejtohem dhe as të qëndrojmë në vend, por të luftojmë për krijimin e konditave të nevojshme për zhvillimin e kolektivizimit. Forcimi i kooperativave ekzistuese dhe forcimi i propagandës për dobritë e kolektivizimit është sot detyra kryesore në çështjen e kooperativave bujqësore. Partia duhet të punojë për forcimin ekonomik e organizativ të

¹ J. V. Stalin. Veprat, vëll. 7, f. 78.

kooperativave bujqësore të sotme, që të bëhen shembull për gjithë fshatarësinë individuale. Të zbatohet plotësisht Statuti, puna me norma, të forcohet sektori i llogarisë, të shtohet emulacioni socialist dhe pjesëmarrja e gjerë e gruas në prodhim.

6. — ...Detyra e Partisë është që të kuptohet mirë se problemi i luftës së klasave përmban në vetëvete luftën ekonomike, politike dhe ideologjike. Të mbahet parasysh që nuk jemi në fazën e likuidimit të kulakëve, por në fazën e kufizimit ekonomik e të izolimit politik të tyre dhe kjo duhet të bëhet në mbështetje me fshatarët e varfër e në aleancë me fshatarët e mesëm. Të zhduken të gjitha gabimet lidhur me zbatimin e direktivave të Partisë, duke mos kaluar në likuidimin e kulakëve, duke evituar me çdo kusht cilësimin e fshatarëve të mesëm si kulakë. Lufta e klasave duhet të zhvillohet drejt, e gjithanshme, në fshat e qytet, kundër kulakëve, kundër spekulatorëve, kusarëve, sabotatorëve, kundër pikëpamjeve mikroborgjeze që ekzistojnë në njerëzit e në komunistët vetë, kundër presionit të borgjezisë, burokratizmit, kundër korrenteve ideologjike të huaja për ne, kundër korrenteve idealiste mistike, fetare, kundër injorancës, sektarizmit, oportunitizmit, egoizmit.

V

MBI PUSHTETIN POPULLOR

Kongresi konstatoi se pushteti popullor në vendin tonë është forcuar. Ndarja e re administrative në rrethe, lokalitete dhe këshilla fshatrash, ka qenë një masë e rëndësishme për forcimin e pushtetit, për afrimin dhe lidhjet e tija sa më të ngushta me masat e gjera punonjëse. Partia jonë ka ndjekur me kujdes eksperiencën sovjetike, mësimet e Leninit dhe të Stalinit në lidhje me pushtetin.

Por gjendja e pushtetit nuk është akoma në lartësinë e duhur. Partia duhet të tregojë kujdes për forcimin dhe demokratizimin e mëtejshëm të pushtetit, duke luftuar me ashpërsinë më të madhe burokratizmin dhe shfaqjet e tjera të dëmshme që e largojnë pushtetin nga masat. Ka akoma organizata dhe komitete partie që nënvlehtësojnë rolin e pushtetit dhe hyjnë në kompetencat e tija, ka raste që shkelen parimet e ndërtimit të pushtetit. Të zgjedhurit nuk mbajnë lidhje të ngushta me zgjedhësit.

Për forcimin e mëtejshëm të pushtetit popullor, kongresi shtron këto detyra:

1. — Partia t'i vërë një rëndësi të madhe forcimit të pushtetit. Këshillat duhet të aktivizohen dhe të marrin të gjitha kompetencat e tyre në bazë të ligjeve të shtetit. Komunistët në radhë të parë duhet të luftojnë me këmbëngulje për aktivizimin dhe fuqizimin e organeve të pushtetit lokal, për mbrojtjen e ligjeve dhe të të drejtave të këshillave e të këshilltarëve kundër çdo shkelësi e abuzuesi.

2. — Organizatat bazë të Partisë duhet ta përqëndrojnë punën e tyre në përmirësimin e veprimtarisë së aparatit të pushtetit, që aparati të punojë mirë, në mënyrë të organizuar, të përpiktë, operativisht dhe pa burokratizëm.

3. — Organizatat e Partisë në aparatit shtetëror dhe ato të ndërmarrjeve duhet t'i edukojnë punonjësit me frymën e përgjegjësisë, të patriotizmit, të zbatimit të përpiktë të ligjeve, të disiplinës shtetërore. Organizatat bazë duhet të zhvillojnë kritikën e autokritikën, për të ndrequr të metat e aparatit. Vetëm në këtë mënyrë aparati i shtetit do të forcohet, do të rritet influenca e komunistëve dhe do të plotësohet me sukses plani i parë pesëvjeçar.

4. — Organet e pushtetit dhe deputetët e popullit të respektojnë me përpikmëri detyrat që kanë ndaj zgjedhësve, të japin llogari para tyre herë pas here, të dëgjojnë zërin e masës dhe t'u zgjidhin kërkesat. Të forcohet kritika dhe kontrolli i masave ndaj organeve të pushtetit.

5. — Organizatat e masave, nën udhëheqjen e Partisë, të mobilizohen e të ndihmojnë në forcimin dhe demokratizimin e pushtetit dhe në plotësimin e detyrave që u shtrohen.

Botohet sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 88 (1096), 10 prill 1952

REZOLUCION

I KONGRESIT II TË PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË

Për raportin «Mbi planin e parë pesëvjeçar të zhvillimit të ekonomisë popullore të Republikës Popullore të Shqipërisë»

6 prill 1952

I

REZULTATET E ARRITURA NË LËMIN EKONOMIK E KULTURAL DHE DETYRAT KRYESORE TË PLANIT TË PARË PESËVJEÇAR

1. — Periudha që nga Kongresi I i Partisë dhe deri sot karakterizohet nga përpjekjet e mëdha të Partisë dhe të masave punonjëse për realizimin e planit dyvjeçar dhe tani për realizimin e planit ekonomik të shtetit. Kjo periudhë karakterizohet nga sukseset tona të mëdha në ndërtimin ekonomik, në zhvillimin kultural dhe në përmirësimin e gjendjes ekonomike të masave punonjëse, karakterizohet nga rritja e klasës punëtore dhe nga forcimi i saj organizativ e politik, nga forcimi i sektorit socialist të ekonomisë dhe nga disiplinimi e kufizimi i elementëve kapitalistë privatë, nga rritja e të ardhurave popullore dhe nga shpërndarja e tyre në interes të masave punonjëse.

Që nga vendosja e pushtetit popullor dhe deri sot janë bërë ndryshime të mëdha në jetën ekonomike dhe shoqërore të vendit tonë. Me përmbysjen e strukturës së vjetër ekonomike, është krijuar struktura e re ekonomike, që përbëhet nga ekonomia socialiste, nga ekonomia e prodhimit të vogël individual dhe nga ekonomia kapitaliste private. Ekonomia socialiste zotëron sot të gjitha lartësitë komanduese në kuadrin e ekonomisë popullore. Mbi 95 për qind të prodhimit industrial dhe rreth 6 për qind të prodhimit bujqësor në vitin 1950 ishte prodhim socialist. Ekonomia e prodhimit të vogël individual është në fazën kalimtare të zhvi-

llimit të saj. Ajo do të tërhiqet gradualisht për në socializëm, për t'u inkuadruar në ekonominë socialiste. Inkuadrimi i kësaj kategorie ekonomike në socializëm nuk do të bëhet në mënyrë spon-tane, por do të bëhet nën udhëheqjen e Partisë në aleancë të ngushtë me ekonominë socialiste, duke u ndihmuar nga kjo ekonomi dhe në luftë me ekonominë kapitaliste private. Sado që kjo kategori ekonomike nuk shfrytëzon forcën e krahut të të tje-rëve, ajo mund të lindë kapitalizmin, duke qenë se bazohet në pro-nën private mbi mjetet e prodhimit. Ekonomia kapitaliste priva-te kufizohet në zhvillimin e saj, dhe në të ardhshmen ajo do t'i lërë vendin ekonomisë socialiste, e cila me ndërtimin e socializmit, do të bëhet e vetmja kategori ekonomike në vendin tonë.

2. — Nga të gjithë sektorët e ekonomisë popullore, sektori i prodhimit industrial, d.m.th. industria nazionale dhe ajo lokale, minierat dhe kooperativat e prodhimit, është rritur më shpejt se të tjerët. Në vitin 1950, viti i fundit i planit dyvjeçar, prodhimi global i industrisë, duke përfshirë edhe prodhimin e artizanatit, arriti vlerën 3 266 000 000 lekë (me çmimet e vitit 1950), d.m.th. 395 për qind në krahasim me vitin 1938. Regjimi zogollian impor-tonte nga jashtë të gjitha prodhimet industriale. Sot, në saje të kujdesit të pushtetit popullor e të Partisë për industrializimin e vendit, një pjesë e konsiderueshme e artikujve industrialë fabri-kohet në vend dhe importimi i këtyre artikujve po shkurtohet çdo vit, njëkohësisht ka ardhur duke u shtuar edhe furnizimi i popull-sisë me prodhime industriale të konsumit të gjerë.

Gjatë dyvjeçarit 1949-1950, prodhimi industrial është rritur me një ritëm mesatar çdo vit prej 10,5 për qind. Ky ritëm për konditat tona gjatë dyvjeçarit është i kënaqshëm. Në krahasim me vitin 1938, në vitin 1950 prodhimi i industrisë së naftës ka arritur në 312 për qind, prodhimi i industrisë minerare (krom, ba-kër, qymyr, bitum) arriti 464 për qind, energjia elektrike arriti në 513 për qind, industria e materialeve të ndërtimit në 851 për qind, industria e veshmbathjes në 547 për qind dhe industria e ushqimit në 175 për qind.

Plani i prodhimit industrial gjatë dyvjeçarit 1949-1950 nuk u realizua plotësisht, u realizua vetëm rreth 91 për qind. Shkaqet që nuk u realizua plotësisht plani dyvjeçar i prodhimit industrial kanë qenë këto: Së pari, sabotimi i «specialistëve» jugosllavë të cilët, para se të shporreshin nga vendi ynë në vitin 1948, degazi-fikuan fushat tona vajguore; së dyti, veprimtaria armiqësore e grupit antiparti të Abedin Shehut, që u mundua të mbillte fry-mën e demobilizimit e të mosbesimit në realizimin e planit të shtetit midis punonjësve të industrisë; së treti, mungesat tona të mëdha, si dobësia në drejtimin e prodhimit, mungesa e kontro-llit të zbatimit të vendimeve e të tjera. Nga një sërë masash të

rëndësishme që mori Partia dhe qeveria gjatë dyvjeçarit, u arrit që plani i prodhimit industrial në vitin 1950 të realizohej si vlerë e përgjithshme mbi 105 për qind ose 131 për qind në krahasim me vitin 1949.

3. — Bujqësia jonë po zhvillohet, po ecën përpara, por ritmi i zhvillimit të saj nuk është aspak i kënaqshëm. Rritja e shpejtë e industrisë, gjë e cila është konditë e domosdoshme për ndërtimin e socializmit, kërkon që bujqësia të zhvillohet me një ritëm më të shpejtë nga ai i deritanishmi, në mënyrë që ajo të mund të përballojë nevojat e industrisë për lëndë të para, si edhe nevojat e shtetit e të popullit për prodhime bujqësore. Në vitin 1950, vël-limi i përgjithshëm i prodhimit bujqësor ka qenë 130 për qind kundrejt nivelit të paraluftës. Sipërfaqet e mbjella e kanë tejka-luar nivelin e paraluftës qysh në vitin 1946: Nga 221 500 ha. që ishte në vitin 1938, arriti në 263 000 ha. në vitin 1946. Pastaj rritja vazhdon me një ritëm çdo vit më të vogël: në vitin 1947 rritja ishte në masën 16 për qind, në vitin 1948 — 4 për qind, në vitin 1949 — 2 për qind dhe në vitin 1950 — 2,2 për qind. Copëtimi i madh i tokës, (ne kemi mbi 145 000 ekonomi individuale bujqë-sore), prapambetja shekullore e metodave dhe e mjeteve të pro-dhimit të fshatarit tonë, mungesa e ndihmës në masën e duhur nga ana e shtetit për ta zhvilluar ekonominë individuale të fsha-tarit — të gjitha këto përcaktojnë atë që ndodh te ne: uljen gra-duale të ritmit të rritjes së prodhimit bujqësor. Kjo ulje e ritmit të zhvillimit të bujqësisë është boshllëku më i madh në ekonominë tonë, është problemi më i madh që duhet zgjidhur medoemos, ndryshe komprometohet industrializimi i vendit, ndërtimi i ba-zës ekonomike të socializmit.

Rruga e daljes për të shpejtuar zhvillimin e bujqësisë është rruga e forcimit të kooperativave bujqësore ekzistuese, rruga e forcimit dhe e zgjerimit të ndërmarrjeve bujqësore dhe blegtorale të shtetit, e forcimit dhe e zgjerimit të SMT-ve, e mekanizimit të buj-qësisë dhe e pajisjes së saj me mjete teknike të reja për të zëven-dësuar mjetet primitive të prodhimit, e zgjerimit të ndihmës së shtetit ndaj fshatarësisë punonjëse. Në këtë mënyrë do të përmirë-sohet dhe do të zhvillohet ekonomia private e fshatarësisë së var-fër dhe të mesme, do të rriten rendimentet e prodhimit bujqësor, do të përgatiten konditat e nevojshme për të kaluar në zgjerimin e kolektivizimit të fshatit.

Një karakteristikë pozitive në zhvillimin e bujqësisë sonë është zgjerimi i kulturave industriale. Në vitin 1950, sipërfaqja e mbjellë me pambuk, në krahasim me paraluftën, është rritur 52 herë, ajo e mbjellë me duhan është rritur 77 për qind dhe sipër-faqja e mbjellë me kërp dhe li është rritur 24 herë. Prodhimi i drithërave të bukës në vitin 1950, që ishte një vit jo i mbarë për

bujqësinë, ka qenë 110 për qind në krahasim me vitin 1938. Ne i kemi të gjitha mundësitë që në të ardhshmen ta prodhojmë vetë gjithë bukën në vend, pa pasur nevojë që të importojmë.

Zhvillimi i blegtorisë nuk është aspak i kënaqshëm. Së pari, në rritjen e kuajve, të qeve dhe të buajve ne jemi shumë prapa, nuk kemi arritur as nivelin e paraluftës; së dyti, përveç derrave që po rriten disi mirë në numër, të gjitha kafshët e tjera janë duke rënë. Kjo gjendje e blegtorisë është serioze dhe duhen marrë masa të shpejta dhe efektive për ta ndryshuar, për ta ndaluar rënjen dhe për të bërë të mundur rritjen e vazhdueshme të blegtorisë.

Në kuadrin e përgjithshëm të prodhimit bujqësor, në vitin 1950 sektori socialist i bujqësisë arrinte rreth 6 për qind (sektori shtetëror rreth 3,5 për qind dhe sektori kooperativist rreth 2,5 për qind), kurse sektori privat kishte 94 për qind të prodhimit të përgjithshëm.

Plani i pyllëzimeve realizohet dhe tejkalohet në mënyrë të kënaqshme, sepse çështja e pyllëzimit është bërë çështje e masave punonjëse. Në vitin 1950 janë mbjellë dy herë më shumë fidane pyjore se sa në vitin 1948.

Fshati ynë ndodhet në procesin e diferencimit ekonomik. Karakteristika kryesore e këtij diferencimi qëndron në faktin se fshatarësia e mesme nuk varfërohet ekonomikisht, sikurse ndodh në regjimin kapitalist, por ajo forcohet ekonomikisht dhe si numër; në faktin që shtresa e kulakëve, në vend që të forcohet sikurse ndodh në regjimin kapitalist, ajo kufizohet ekonomikisht në etapën e sotme; në faktin që fshatarësia e varfër, në vend që të shkojë drejt mizerjes dhe papunësisë siç ndodh në regjimin kapitalist, pjesa më e madhe e saj përmirëson vazhdimisht ekonominë dhe shkon drejt fshatarësisë së mesme, ndërsa një pjesë e vogël, ajo që është e pafuqishme ekonomikisht dhe nuk mund të përballojë jetesën në fshat me mjetet që ka, zbret në qendrat e punës, ku gjen punë sezonale ose të përhershme dhe kështu e zgjidh problemin e jetesës.

4. — Në vitin 1950 transporti automobilistik realizoi një vëllim pune prej katër herë më shumë se në vitin 1938 dhe transportoi pasagjerë 13 herë më shumë se në vitin 1938. Transporti detar në vitin 1950 realizoi një vëllim pune 11 herë më shumë se në vitin 1938, kurse transporti hekurudhor gati dyfish kundrejt vitit 1948. Është zgjeruar rrjeti i tregëtisë socialiste. Në vitin 1950 sektori socialist i tregëtisë realizoi mbi 77 për qind të të gjithë qarkullimit të mallrave të tregëtisë. Importi dhe eksporti janë rritur vazhdimisht, por plani i eksportit nuk është realizuar, ndërsa plani i importit është realizuar rregullisht.

5. — Me rritjen e vëllimit të përgjithshëm të të ardhurave

të popullsisë rritet dhe standardi i jetesës së masave punonjëse. Në bazë të të dhënave orientuese, në vitin 1950 vëllimi i përgjithshëm i të ardhurave të popullsisë arriti mbi 9 miliard lekë (me çmimet e vitit 1947), që është 16,8 për qind më tepër se në vitin 1948.

Qarkullimi i mallrave të tregëtisë në vitin 1950 ka qenë 59 për qind më tepër se sa në vitin 1947. Nga rritja e prodhimit janë ulur çmimet në tregun e lirë. Nga zbritja e çmimeve që bëri qeveria në vitin 1950, popullsia pati një përfitim prej 300 milion lekësh dhe nga zbritja e dytë e çmimeve që u bë vitin e kaluar popullsia përfitoi dhe rreth 148 milion lekë të tjera. Fondi i arkave të kursimit në vitin e kaluar ka qenë 67 për qind më shumë se në vitin 1948, dhe në të njëjtën periudhë fondi i sigurimeve shoqërore është rritur më tepër se tri herë e gjysmë. Zbatimi i vendimit të qeverisë për shpërblimin e nënave me shumë fëmijë ka bërë që vitin e kaluar shteti të harxhonte 260 milion lekë. Në këtë mënyrë është përmirësuar gjendja ekonomike e masave punonjëse.

Numri i përgjithshëm i punëtorëve dhe i nëpunësve është rritur 28 për qind në vitin 1950 në krahasim me vitin 1947, ndërsa në të njëjtën periudhë fondi i pagave për gjithë punonjësit është rritur rreth 50 për qind. Pjesëmarrja e gruas në punë në vitin 1950 ka qenë 18 për qind mbi numrin e përgjithshëm të punonjësve. Në vitin 1951 u janë dhënë mbi 3 600 urdhëra dhe medalje pune punonjësve të dalluar.

Ndërsa në vitin 1938 kishte vetëm 643 shkolla fillore me 52 000 nxënës, në vitin 1950 kemi pasur mbi 2 000 shkolla fillore me 150 000 nxënës. Në vitin 1938 kishte 11 shkolla të mesme dhe unike, me rreth 6 300 nxënës, në vitin 1950 kemi 193 shkolla unike me rreth 18 000 nxënës, dhe 23 shkolla të mesme me më shumë se 5 000 nxënës, si dhe Institutin pedagogjik 2-vjeçar me 130 nxënës, përveç rreth 900 studentëve në Bashkimin Sovjetik dhe në vendet e demokracisë popullore. Numri i mësuesve dhe i profesorëve u rrit nga 1 620 në vitin 1938, në 5 100 në vitin 1950. Numri i analfabetëve ka zbritur nga 679 000 që ishte në vitin 1945, në 375 000 në vitin 1950. Siç dihet, vitin e kaluar u çelën për herë të parë në vendin tonë tri institute të larta: Instituti pedagogjik, Instituti bujqësor dhe Instituti politeknik. Sot ne kemi Institutin e shkencave, që më parë nuk ekzistonte. Muzika, teatri, sporti janë duke u zhvilluar me hov të madh. Pushteti popullor u ka krijuar atyre mundësitë që të zhvillohen pa kufi. Inteligjencia e re, inteligjencia progresive dhe socialiste është duke u rritur me të shpejtë, si në numër ashtu dhe në cilësi.

Shëndeti i popullit është përmirësuar mjaft. Në vitin 1938 popullsia jonë u rrit në numër 1,6 për qind, kurse në vitin 1950 ajo u rrit 2,4 për qind. Në vitin 1950 lindjet ishin 3,8 për qind mbi

numrin e përgjithshëm të popullsisë, kurse në vitin 1938 ato ishin 3,4 për qind. Në të njëjtën periudhë, përqindja e vdekjeve është ulur nga 1,8 për qind mbi numrin e përgjithshëm të popullsisë, që ka qenë në vitin 1938, në 1,4 për qind në vitin 1950. Ndërsa në vitin 1938 kishim 8 spitale me 820 shtretër, në vitin 1950 kemi 42 spitale të mëdha me 3 120 shtretër, si dhe 328 ambulanca, në të cilat u vizituan 3 herë më shumë persona se në vitin 1938.

Këto janë suksese të mëdha, janë një fitore e madhe e Partisë dhe e popullit tonë. Ato ne i kemi arritur me punë, me përpjekje të mëdha, me sakrifica. Këto suksese tregojnë se Partia jonë është e aftë të drejtojë me sukses, në rrugën marksiste-leniniste, klasën punëtore, masat punonjëse, shtetin. Ajo i drejton këto me sukses në luftën për ndërtimin e socializmit, ashtu sikurse dje ajo udhëhoqi popullin në luftën e armatosur për çlirimin e vendit nga zgjedha e huaj. Këto janë sukseset e klasës sonë punëtore, të fshatarësisë punonjëse, të rinisë heroike, të gruas, të popullit tonë. Komunistët kanë qenë kurdoherë në ballë të luftës për ndërtimin ekonomik, ata kanë qenë zemra dhe shpirti i popullit, krenaria dhe mburrja e klasës punëtore. Këto janë suksese të ushtrisë sonë heroike, të rojeve trime të kufirit, të Sigurimit të Shtetit dhe të Policisë Popullore, që kanë ditur të vigjilojnë, të ruajnë si jetën e tyre punën paqësore të popullit tonë nga armiqtë e jashtëm dhe të brendshëm. Këto janë sukseset e vijës së drejtë të Partisë, të udhëheqjes marksiste-leniniste, të shokut Enver, themeluesi i Partisë sonë dhe i pushtetit popullor, që na udhëheqin në rrugën e ndërtimit të socializmit. Këto suksese janë arritur në sajë të ndihmës bujare të Bashkimit Sovjetik dhe të vendeve të demokracisë popullore. Këto suksese janë arritur nëpërmjet ashpërsimit të vazhdueshëm të luftës së klasave, e cila ka pasur si rezultat forcimin e aleancës midis klasës punëtore dhe fshatarësisë punonjëse, rritjen e rolit të elementëve socialistë, në dëm të elementëve kapitalistë, kufizimin ekonomik dhe izolimin politik të elementëve kapitalistë të qytetit dhe të fshatit. Këto suksese kanë bërë të mundur që ne të forcojmë dhe të zgjerojmë sistemin e planifikimit të ekonomisë, duke kaluar nga plani dyvjeçar në planin e parë pesëvjeçar të zhvillimit të ekonomisë popullore.

6. — Plani i parë pesëvjeçar i zhvillimit të ekonomisë popullore filloi në vitin 1951 dhe mbaron në fund të vitit 1955. Kalimi nga plani dyvjeçar në planin pesëvjeçar shënon një etapë të re në jetën tonë, etapën e ritmeve të shpejta të ndërtimit ekonomik, etapën e luftës vendimtare në fushën e ndërtimit të bazës ekonomike të socializmit.

«Detyra politike kryesore e planit të parë pesëvjeçar konsiston: **NË FORCIMIN E ALEANCËS MIDIS KLASËS PUNËTORE DHE FSHATARËSISË PUNONJËSE DHE NË FORCIMIN E ROLIT DREJTUES TË**

KLASËS PUNËTORE NË KËTË ALEANCË; NË KUFIZIMIN E ELEMEN-TËVE KAPITALISTË DHE SPEKULATORË TË QYTETIT DHE TË FSHATIT; NË RRRITJEN E NIVELIT KULTURAL TË MASAVE PUNONJËSE; NË FORCIMIN E NDËRGJEGJES SOCIALISTE TË KLASËS PUNËTORE DHE NË FORCIMIN E VIGJILENCËS REVOLUCIONARE E TË PATRIOTIZMIT TË TË GJITHA MASAVE PUNONJËSE.

Detyra ekonomike kryesore e planit të parë pesëvjeçar konsiston:

NË VAZHDIMIN ME NJË RITËM MË TË SHPEJTË TË PUNËS PËR NDËRTIMIN E BAZËS EKONOMIKE TË SOCIALIZMIT, PËR TË BËRË QË NË FUND TË PESËVJEÇARIT VENDI YNË TË JETË TRANSFORMUAR NGA NJË VEND AGRAR I PRAPAMBETUR NË NJË VEND AGRARO-INDUSTRIAL»¹.

Në caktimin e këtyre detyrave kryesore të planit pesëvjeçar, janë mbajtur parasysh këto rrethana dhe teza kryesore:

a) Nevoja për të dalë nga prapambetja e madhe teknike dhe ekonomike, në të cilën ka qenë hedhur vendi ynë nga regjimi reaksionar që ne përmbysëm; nevoja për të krijuar një industri relativisht të fortë për vendin tonë dhe nevoja për të pajisur bujqësinë me një bazë teknike, për të bërë që të dalë nga prapambetja shekullore në të cilën ndodhet akoma, të përmirësojë metodat e prodhimit, të përgatitë konditat e nevojshme për kalimin gradual e vullnetar të fshatarësisë individuale në prodhimin kolektiv, socialist.

b) Nevoja për t'u çliruar nga importimet e shumta në artikuj industrialë të konsumit të gjerë, si vegla të thjeshta për punë, drithëra të bukës, duke krijuar bazën teknike dhe ekonomike për prodhimin e tyre në vend, në mënyrë që gjatë këtij pesëvjeçari të shkurtojmë sa më shumë importimin e tyre.

c) Nevoja për të shpejtuar revolucionin kultural që të dalim definitivisht nga prapambetja kulturele, të zhdukim përgjithmonë analfabetizmin, të përvetësojmë teknikën e re dhe të bëhemi zotër të saj, të përgatitim kuadrot e nevojshëm, të luftojmë me sukses influencën borgjeze në ndërgjegjen e njerëzve me anën e edukimit, për të formuar njeriun e ri, njeriun socialist.

ç) Fakti që vendi ynë ndodhet gjeografikisht i rrethuar nga armiq të betuar të socializmit e të popujve, fakti që ne detyrohem të ndërtojmë socializmin duke mbajtur «në njërën dorë kazmën dhe në dorën tjetër pushkën», siç ka thënë shoku Enver, këto rrethana kërkojnë forcimin e mbrojtjes së vendit, forcimin e ga-

¹ Enver Hoxha. Vepra, vëll. 9, f. 170—171.

tishmërisë luftarake të vendit, forcimin e vigjilencës revolucionare.

d) Mundësitë tona materiale, aftësitë tona drejtuese dhe ndihma bujare e Bashkimit Sovjetik dhe e vendeve të demokracisë popullore.

II

PLANI I RRRITJES SË PRODHIMIT NË PESËVJEÇARIN E PARË

1. — Në vitin 1955, vëllimi i përgjithshëm i prodhimit industrial (industri, miniera, artizanat) do të arrijë në 11 miliard e 100 milion lekë (me çmimet e vitit 1950), kundrejt 3 miliard e 266 milion lekë që ka qenë vlera e prodhimit industrial në vitin 1950. Në këtë mënyrë prodhimi industrial në fund të pesëvjeçarit do të arrijë nivelin 339 për qind në krahasim me vitin 1950, ose do të jetë gati 12 herë më i madh se prodhimi i paraluftës.

Ritmi i rritjes së prodhimit industrial gjatë planit të parë pesëvjeçar do të jetë mesatarisht 27,7 për qind në çdo vit, kundrejt 10,5 për qind që ka qenë ritmi mesatar i rritjes vjetore në planin dyvjeçar 1948—1950. Prodhimi i mjeteve të prodhimit gjatë pesëvjeçarit do të rritet me një ritëm mesatar vjetor prej 31 për qind, ndërsa prodhimi i mallrave të konsumit do të rritet me një ritëm mesatar vjetor prej 26,5 për qind.

Kongresi II i PPSH caktoi rritjen e prodhimit industrial në vitin 1955 si më poshtë:

Klasifikimi i prodhimit	Prodhimi		1955 kundrejt 1950 në %
	1950	1955	

PRODHIMI I PËRGJITHSHËM I INDUSTRISË

(në milion lekë me çmimet e vitit 1950) 3 266 11 160 339

Nga i cili:

Grupi «A» — Mjete prodhimi (mil. lekë) 761 2 941 386

Klasifikimi i prodhimit	Prodhimi		1955 kundrejt 1950 në %
	1950	1955	
Nga i cili:			
1) Prodhimi i minierave (mil. lekë)	452	1 382	306
Nga i cili:			
— Naftë brut (ton)	131 800	263 000	200
— Bitum i pastruar (ton)	26 300	80 000	303
— Krom mineral (ton)	52 000	120 000	230
— Bakër blistër (ton)	900	2 500	267
— Qymyr guri (m ³)	42 000	250 000	588
2) Industria mekanike (mil. lekë)	54	181	335
3) Energji elektrike (mil. kwh.)	21	121	572
4) Material ndërtimi (mil. lekë)	179	682	383
Nga i cili:			
— Çimento (ton)	15 000	58 000	365
— Lëndë druri të sharruar (m ³)	51 000	82 000	161
— Lëndë druri të staxhionuar (m ³)	—	30 000	—
— Lëndë druri të imprenjuar (m ³)	—	15 000	—
— Kompensatë (m ³)	—	5 000	—
— Qelqurina (ton)	—	2 000	—
— Xhama (m ²)	—	200 000	—
5) Të tjera (mil. lekë)	—	696	—
Grupi «B» — Mjete konsumi (mil. lekë)	2 505	8 131	324
Nga i cili:			
1) Industria ushqimore (mil. lekë)	339	2 048	604
Nga e cila:			
— Sheqer (ton)	610	11 000	1 803
— Makarona (ton)	4 700	9 800	208
— Vaj ulliri (ton)	1 300	5 150	384
— Sapun rrobash (ton)	950	3 700	386
— Birrë (hl)	21 000	30 000	143
— Cigare (ton)	700	850	116
2) Industria e veshmbathjes (mil. lekë)	198	1 936	977
Nga e cila:			
— Tekstile të pambukta (mij. ml)	1 100	21 500	1 886
— Tekstile të leshta (mij. ml)	—	852	—
— Këpucë (palë)	272 000	598 000	220

Klasifikimi i prodhimit	Prodhimi		1955
	1950	1955	kundrejt 1950 në %
3) Ministria e Tregëtisë dhe Ministria e Grumbullimeve (mil. lekë)	243	800	288
4) Industria lokale (mil. lekë)	95	413	434
5) Koop. e konsumit (mil. lekë)	1 017	1 279	125
6) Koop. e artizanatit (mil. lekë)	353	1 511	428
7) Të tjera (mil. lekë)	—	144	—

Kongresi II i PPSH, u cakton këto detyra degëve të ndryshme të prodhimit industrial për pesëvjeçarin.

a) *Industria e naftës*: Të marrë masa organizative të shpejta dhe të gjithanshme për të dalë nga gjendja e sotme një herë e mirë. Plani i prodhimit nuk mund të realizohet në rast se nuk rritet me të shpejtë ritmi i shfrytëzimit të puseve ekzistuese dhe njëkohësisht të çelen në numrin e nevojshëm edhe puse të reja të prodhimit. Të sigurohet energjia elektrike e nevojshme dhe vazhdimësia e prodhimit, të zhduken uljet dhe ngritjet spontane të grafikut të prodhimit e të bëhet që ky grafik të shkojë gjithnjë duke u ngritur. Të zgjerohen kërkimet gjeologjike për të zbuluar fusha të reja vajguore, ose për të zgjeruar fushat vajguore që janë në shfrytëzim dhe njëkohësisht të punohet me perspektivë për krijimin e kuadrove teknikë të aftë dhe të shumtë në numër, që të sigurojnë prodhimin plotësisht. Në vitin 1955 rendimenti i punës të rritet 41 për qind dhe kostoja e prodhimit të ulet 43 për qind kundrejt vitit 1950.

b) *Industria minerare*: Të drejtojnë vëmendjen kryesore në drejtim të elektrifikimit dhe të mekanizimit të minierave sidomos për minierat e qymyrit dhe të kromit; në drejtim të sigurimit të bazës materiale për jetesën e punonjësve, për të krijuar fuqinë punëtore të përhershme dhe për t'i dhënë fund fluktuacionit të kohëpaskohshëm të fuqisë punëtore; në drejtim të zgjerimit të kërkimeve gjeologjike për të zbuluar rezerva të reja për minierat ekzistuese dhe për të krijuar edhe fusha të reja të shfrytëzimit të pasurisë së nëntokës, si hekuri, nikeli etj. Në vitin 1955, kundrejt vitit 1950, rendimenti i punës të rritet në këtë masë: në minierën e bitumit natyral 87 për qind, në minierën e bakrit 120 për qind, në minierat e kromit 42 për qind, në minierat e qymyrit

157 për qind. Gjithashtu kostoja e prodhimit të ulet në këtë masë: në minierën e bitumit natyral 39 për qind, në minierën e bakrit 43 për qind, në minierat e kromit 11 për qind, në minierat e qymyrit 27 për qind.

c) *Industria mekanike*: Të zgjerojë bazën e saj teknike, duke zgjeruar në radhë të parë fonderinë për shkrirjen e gizes, të hekurit dhe të çelikut. Zgjerimi i shpejtë i industrisë kërkon që dega mekanike e prodhimit të forcohet shumë, duke shfrytëzuar racionalisht maqineritë ekzistuese dhe duke u pajisur me maqineri të reja. Ajo duhet të sigurojë veglat e shkëmbimit për industrinë, bujqësinë dhe transportin, të prodhojë vegla dhe mjete pune për fshatarësinë dhe të zgjerojë asortimentet e prodhimit, d.m.th. të prodhojë sa më shumë mallra të konsumit, vegla pune etj., për të cilat vendi ka shumë nevojë. Gjatë pesëvjeçarit të rritë rendimentin e punës 84 për qind dhe të ulë koston e prodhimit 15 për qind.

c) *Industria elektrike*: Të pajiset me stacione termoelektrike dhe hidroelektrike të fuqishme, për të krijuar bazën e energjisë elektrike të ekonomisë sonë dhe për të shfrytëzuar këtë energji me anën e një sistemi unik të shpërndarjes. Me krijimin e sistemit unik të shfrytëzimit të energjisë elektrike, stacionet e vogla elektrike që kemi sot duhet të rishpërndahen dhe të riinstalohen në qendrat e banuara dhe në qendrat e punës të periferisë ku nuk do të arrijë vija e tensionit të lartë, për t'i siguruar këto qendra me energji elektrike. Të vendoset një regjim i rreptë në shfrytëzimin racional të energjisë elektrike. Të inkurajohet inisiativa e masave të fshatarësisë për krijimin e stacioneve të vogla hidroelektrike për elektrifikimin e fshatit. Në vitin 1955 rendimenti i punës në këtë degë të rritet 88 për qind dhe kostoja e prodhimit të ulet 28 për qind.

d) *Industria e materialeve të ndërtimit*: Vëllimi i madh i ndërtimeve gjatë pesëvjeçarit të parë kërkon që industria e prodhimit të lëndëve të ndërtimit të zgjerohet për së tepërmi, duke u pajisur me stabilimente të reja moderne. Për këtë duhet të pregatiten me kohë quadro të nevojshëm. Por prodhimi i lëndëve të ndërtimit nuk është një detyrë vetëm e Ministrisë së Industrisë. Të gjitha entet dhe administratat, sidomos industria lokale dhe kooperativat e prodhimit, duhet të prodhojnë sa më shumë materiale ndërtimi dhe të kursejnë sa më shumë harxhimin e këtyre materialeve. Prodhimi i gëlqeres, i tullave, përdorimi i gurit etj. duhet të preokupojnë të gjitha entet që merren me ndërtimin. Projektet e ndërtimeve tona të orientohen nga konstruksionet e

thjeshta por të forta, për të kursyer materialet e ndërtimit e për të shkurtuar importin e këtyre materialeve, të orientohen nga përdorimi në një shkallë sa më të gjerë i materialeve që gjenden në vend. Të zgjerohet mekanizimi i punimeve në furrat e tullave.

Të merren masa të shpejta për t'i dhënë fund gjendjes jo të kënaqshme në sharrat. Të krijohet një drejtim unik i centralizuar për të gjithë stabilimentet e kësaj industrie. Gjatë pesëvjeçarit rendimenti i punës të rritet 115 për qind dhe kostoja e prodhimit të ulet 20 për qind.

dh) *Prodhimi i mallrave të konsumit*: Të merren masa serioze për përgatitjen e kuadrove të nevojshëm për shfrytëzimin e plotë dhe racional të kombinatave dhe të fabrikave të reja, si dhe për sigurimin e sasisë të pambukut, të panxharit të sheqerit, të duhanit etj. Organet qendrore të tregojnë më tepër kujdes për zhvillimin e industrisë lokale që të bëhet kjo një ndihmëse e fortë e industrisë nacionale. Të merren masa të shpejta për të përmirësuar cilësinë e prodhimit. Rëndësi të posaçme ka për këtë sektor futja e gruas në punë, sidomos në industrinë e tekstilit. Gjatë pesëvjeçarit rendimenti i punës duhet të rritet në këtë masë: në industrinë ushqimore 86 për qind, në industrinë e veshmbathjes 154 për qind, në industrinë lokale 77 për qind, ndërsa kostoja e prodhimit duhet të ulet: në industrinë ushqimore 24 për qind, në industrinë e veshmbathjes 41 për qind dhe në industrinë lokale 25 për qind.

e) *Prodhimi kooperativist*: Kooperativat e prodhimit duhet të orientohen nga shfrytëzimi në maksimum i mbeturinave të materialit nga procesi i prodhimit të industrisë dhe nga shfrytëzimi i lëndëve të para që gjenden në vend. Kooperativat e artizanatit duhet të prodhojnë sa më shumë vegla pune për bujqësinë dhe t'i afrohen më tepër fshatit. Të bëhet riorganizimi i drejtimit të prodhimit të kooperativave të konsumit dhe të shitblerjes, për t'i bërë këto më të lira që të kryejnë funksionin e tyre kryesor, që është furnizimi i popullit dhe i qendrave të punës. Prodhimi kooperativist të orientohet nga zgjerimi i llojeve të ndryshme të prodhimit. Gjatë pesëvjeçarit rendimenti i punës në të gjitha kooperativat e prodhimit duhet të rritet 165 për qind dhe kostoja e prodhimit të ulet 40 për qind.

2. — Në vitin 1955, prodhimi i përgjithshëm i të gjitha degëve të prodhimit bujqësor do të arrijë vlerën 8 153 milion lekë (me çmimet e vitit 1950), kundrejt 4 730 milion lekë që ka qenë prodhimi i vitit 1950. Në këtë mënyrë, në fund të pesëvjeçarit prodhimi bujqësor të arrijë 171 për qind në krahasim me vitin 1950, ose 221 për qind në krahasim me 1938-n.

Ritmi mesatar i rritjes së prodhimit bujqësor çdo vit gjatë pesëvjeçarit të jetë 11 për qind.

Prodhimi i drithërave të bukës në vitin 1955 të arrijë në 2 840 000 kv., d.m.th. 147 për qind në krahasim me vitin 1950. Rendimenti mesatar për çdo hektar për gjithë Republikën, për grurin të arrijë 11,8 kv., misrin — 12,5 kv., thekrën — 9 kv., orizin — 25 kv., elbin — 10,5 kv. Prodhimi i pambukut në vitin 1955 të arrijë 240 000 kv., ose gati dy herë e gjysmë më shumë se në vitin 1950, me një rendiment mesatar prej 8 kv. për ha. Vëllimi i prodhimit të panxhar sheqerit duhet të arrijë në 1 000 000 kv., ose 16 herë më shumë se në vitin 1950, me një rendiment mesatar prej 200 kv. për ha. Prodhimi i duhanit të arrijë në 52 000 kv., ose 318 për qind në krahasim me vitin 1950, me një rendiment mesatar prej 7 kv. për ha. Perimet të arrijnë në masën 189 për qind dhe ushqimi i kafshëve në masën 208 për qind në vitin 1955, në krahasim me vitin 1950.

Për të arritur prodhimin e mësipërm, Kongresi II i PPSH cakton këto detyra:

a) Të zgjerohet baza e mekanizimit të bujqësisë, duke importuar traktorë dhe maçina bujqësore. Numri i traktorëve të arrijë në 700 copë në vitin 1955. SMT-të të pajisen me ofiqina mekanike, për të siguruar plotësisht riparimet e traktorëve dhe të maçinave bujqësore.

Të përmirësohet gjendja e organizimit dhe e drejtimit të SMT-ve, dhe këto të shtrijnë punën e tyre në të gjitha proceset e kultivimit të bimëve bujqësore, duke u dhënë precedencë bimëve industriale. Shteti të subvencionojë SMT-të dhe në punën e tyre ato të favorizojnë fshatarët e varfër dhe të mesëm. Për të zhvilluar ekonominë individuale të fshatarëve të zgjerohet ndihma e shtetit me anën e kreditit agrar, me vegla pune, kafshë pune, kafshë race etj. Gjatë këtij pesëvjeçari të përhapet kudo plugu i hekurt, për të zëvendësuar në pjesën më të madhe parmendën e drurit.

b) Të zgjidhet problemi i farës së seleksionuar. Brenda këtij pesëvjeçari, fara e grurit, e misrit, e orizit etj., që nuk janë të përshtatshme dhe nuk japin rendimentin e nevojshëm, të zëvendësohen me farëra të seleksionuara të rendimentit të lartë.

c) Të zgjerohen veprat e bonifikimit në shkallë të gjerë, për të kulluar tokat e lagura dhe për të vënë nën ujë tokat e thata në zonat më kryesore të bujqësisë, duke i dhënë precedencë hapjes së kanaleve ujitëse. Të mirëmbahen dhe të administrohen mirë kanalet kulluese dhe kanalet ujitëse ekzistuese dhe, në ujtitjen e tokave, të vendoset një regjim i fortë për shfrytëzimin sa më të mirë të ujit për ujtitje, duke u dhënë precedencë bimëve industriale.

c) Të sigurohet një sasi e konsiderueshme plehu kimik për bimët industriale e perimet dhe njëkohësisht të merren masa organizative dhe teknike për të shfrytëzuar më mirë plehun natyral dhe për ta shtuar atë.

d) Për të siguruar shfrytëzimin sa më të mirë të traktorëve dhe të makinave bujqësore, është e nevojshme që me anën e agjitacionit dhe të propagandës ta bindim fshatarin individual të fushës që të zhdukë gjerdhet dhe ledhet penguese për maqinerinë dhe njëkohësisht të fillojmë sistemimin agrar të fushave, qofshin këto edhe prona individuale.

dh) Të stimulohet në masën e nevojshme prodhimi i bimëve industriale nga shteti, të forcohet ndihma teknike dhe krediti agrar në drejtim të fshatarësisë. Të përhapet eksperiencia sovjetike në të gjitha degët e prodhimit bujqësor, të popullarizohen rezultatet më të mira në prodhim, të shpërblehen dhe të dekorohen bujqit më të dalluar.

Duke marrë parasysh konditat klimaterike shumë të favorshme të vendit tonë për rritjen e ullirit dhe të agrumeve, plani pesëvjeçar përcakton që prodhimi i ullinjve të arrijë 520 për qind dhe ai i agrumeve — 360 për qind në vitin 1955 kundrejt vitit 1950.

Rëndësi e posaçme duhet t'i jepet prodhimit të perimeve, sidomos pranë qyteteve dhe qendrave të punës, për të furnizuar rregullisht popullsinë e qyteteve dhe qendrat e punës me zarzavate dhe barishte. Ekonomitë ndihmëse të qendrave të punës duhet të forcohen dhe të zgjerohen.

Kongresi II i PPSH e përcakton rritjen e gjësë së gjallë gjatë pesëvjeçarit, në krahasim me vitin 1950, në këtë masë: kafshët njëthundrake (kuaj, mushka, gomarë) 5 për qind, qetë dhe lopët 7 për qind, buajt dhe buallcat 9 për qind, dhentë 8 për qind, dhitë 2 për qind, derrat 171 për qind, bletët 100 për qind dhe shpendët 160 për qind. Rritja e krimbit të mëndafshit duhet të zgjerohet. Për të siguruar realizimin e rritjes së blektorisë në masën e mësipërme, duhet të zgjidhen këto detyra:

a) Të përmirësohet dhe të zgjerohet baza ushqimore e kafshëve, duke stimuluar rritjen e jonxhës dhe përmirësimin e kullotave, gjithashtu, të fillohet përpunimi industrial i koncentreve ushqimore për kafshët me melasin e sheqerit e lëndë të tjera.

b) Të merren masa serioze për përmirësimin e racës së kafshëve, duke seleksionuar racat ekzistuese, duke zgjeruar numrin e stacioneve të ndërzimit, duke prodhuar sidomos në fermat e shtetit kafshë race në shkallë të gjerë, gjithashtu, duke importuar nga jashtë kafshë race të përshtatshme për konditat tona.

c) Të ndalohet rreptësisht dhe me ligj therja e gjësë së gjallë për riprodhim dhe të zgjerohet gjuetia e peshkut, për të mundur që gjatë këtij pesëvjeçari të paktën 1/3 e konsumit të mishit të

zëvendësohet me peshk. Të fillojmë rritjen e shpendëve dhe të derrave në shkallë të gjerë.

c) Të stimulohet në masën e nevojshme nga ana e shtetit rritja e kuajve, e qeve, e lopëve dhe ajo e deleve rudë.

Gjatë pesëvjeçarit duhet të mbillen mbi 67 milion fidane për pyllëzime të reja dhe të përmirësohen dhjetëra mijëra hektarë pyje ekzistuese. Gjatë këtij pesëvjeçari duhet të fillojë puna për projektimin e sistemimit të brezave pyjorë për zonat fushore. Duhet të tregohet kujdes i veçantë për të mbrojtur tokat buzë lumenjve dhe përrunjve të rrëmbyeshëm me anën e brezave pyjorë prej shelgu, rrapit e të tjera pemë si këto. Për të bërë këtë është e nevojshme që të mbahet gjallë flaka e entuziazmit të masave punonjëse në çështjen e pyllëzimeve dhe njëkohësisht të merren masa serioze për ruajtjen e pasurisë pyjore, duke shfrytëzuar racionalisht lëndën e drurit, duke kufizuar harxhimin e panevojshëm të drurit të zjarrit dhe duke e zëvendësuar këtë me qymyrguri atje ku ka mundësi.

Kongresi II i Partisë së Punës të Shqipërisë kërkon forcimin e gjithanshëm dhe zgjerimin e sektorit shtetëror të bujqësisë. Përsa i përket kolektivizimit të fshatit, Kongresi II i PPSH konsideron se detyra kryesore e sotme në këtë drejtim është forcimi i gjithanshëm i kooperativave ekzistuese, të mos shpejtojmë në çështjen e kolektivizimit, të përgatitim të gjitha konditat e nevojshme për të bërë të mundur më vonë zgjerimin e kolektivizimit të bujqësisë gradualisht dhe në baza vullnetare, pa asnjë presion mbi fshatarësinë.

3. — Në vitin 1955, transporti automobilistik do të bëjë një vëllim pune mbi 110 milion ton/km, që është më se 3 herë më i madh se ai i vitit 1950. Vëllimi i transportit hekurudhor do të arrijë mbi 42 milion ton/km., d.m.th. mbi 5 herë në krahasim me vitin 1950. Vëllimi i transportit detar do të arrijë në 23 milion ton/milje d.m.th. do të rritet më se 2 herë në krahasim me vitin 1950.

Për të zgjidhur detyrat e mësipërme, është e nevojshme që transporti të pajiset me mjete të reja, të shfrytëzojë racionalisht mjetet ekzistuese dhe të përgatitë kuadrot e nevojshëm. Gjatë pesëvjeçarit të tri llojet e transportit duhet ta ulin koston e shërbimit 40 për qind dhe ta rritin koeficientin e shfrytëzimit 6 për qind.

Duhet që të zhvillohet transporti lokal, si dhe përdorimi në shkallë të gjerë i transportit primitiv.

Gjatë pesëvjeçarit duhet të forcohet dhe të zgjerohet rrjeti postë-telegrafonik, për të siguruar ndërlidhjen e pandërprerë të qendrave të punës dhe të periferisë me qendrën.

4. — Rritja e madhe e prodhimit industrial, që do të sjellë rrit-

jen paralele të qarkullimit të mallrave të tregëtisë, kërkon forcimin dhe zgjerimin e rrjetit të tregëtisë. Gjatë pesëvjeçarit numri i magazinave të tregëtisë shtetërore do të rritet 200 për qind dhe numri i magazinave të rrjetit të tregëtisë kooperativiste do të rritet 160 për qind në krahasim me vitin 1950. Zgjerimi i rrjetit të tregëtisë dhe forcimi i gjithanshëm i tij janë konditë e domosdoshme për të siguruar forcimin e lidhjes midis qytetit dhe fshatit. Prandaj, gjatë pesëvjeçarit, rrjeti i tregëtisë kooperativiste duhet të përfshijë të gjitha masat e fshatarësisë punonjëse; organizatat e tregëtisë kooperativiste duhet të demokratizohen, për t'u bërë me të vërtetë organizata masash dhe t'i aktivizojnë këto masa. Kooperativat e shitblerjes janë duke u marrë më tepër se sa duhet me çështjen e prodhimit, duke neglizhuar nga ana tjetër detyrën e tyre kryesore, që është tregëtia me fshatarësinë. Kjo e metë duhet të ndreqet sa më parë.

III

PLANI I NDËRTIMEVE DHE I PAJISJEVE TË REJA

1. — Për të arritur vëllimin e prodhimit në shkallën që u tha më lart, Kongresi II i PPSH e përcakton vëllimin e investimeve për ndërtime dhe pajisje të reja gjatë pesëvjeçarit 1951-1955 në masën 21 miliard lekë (me çmimet e vitit 1950), kundrejt 6 miliard e 824 milion lekë që kanë qenë investimet në periudhën pesëvjeçare 1946-1950, nga të cilat:

a) *Në industri dhe miniera:* Të investohen 8 miliard e 943 milion lekë, kundrejt 2 miliard e 136 milion lekë që kanë qenë investuar në periudhën pesëvjeçare 1946-1950, d.m.th. 318 për qind më tepër ose 42,7 për qind mbi vëllimin e përgjithshëm të investimeve gjatë pesëvjeçarit të parë 1951-1955.

b) *Në komunikacion:* Të investohen 3 miliard e 2 milion lekë, kundrejt 2 miliard e 410 milion lekë në periudhën 1946-1950, d.m.th. 24 për qind më tepër ose 14,3 për qind mbi vëllimin e përgjithshëm të investimeve të pesëvjeçarit të parë.

c) *Në bujqësi:* Të investohen 2 miliard e 821 milion lekë kundrejt 961 milion lekë në periudhën 1946-1950, d.m.th. 193 për qind më tepër ose 13,5 për qind mbi vëllimin e përgjithshëm të investimeve të pesëvjeçarit të parë.

c) *Në sektorin kulturalo-social:* Për arësim, shëndetësi, kulturë, ndërtesa banimi e të tjera, të investohen 3 miliard e 460 milion lekë, kundrejt 780 milion lekë në periudhën 1946-1950, d.m.th. 343 për qind më tepër, ose 16,5 për qind mbi vëllimin e përgjithshëm të investimeve të pesëvjeçarit të parë.

d) *Në sektorët e tjerë:* Të investohen 2 miliard e 717 milion lekë kundrejt 537 milion lekë në periudhën 1946-1950, d.m.th. 407 për qind më tepër ose 13 për qind mbi vëllimin e përgjithshëm të investimeve në pesëvjeçarin e parë.

Kongresi e konsideron të nevojshme që gjatë këtij pesëvjeçari të përqëndrohem kryesisht në ndërtimet dhe pajisjet e reja më kryesore, si më poshtë:

a) Për të zgjidhur plotësisht të gjitha nevojat e vendit në të gjitha llojet e karburanteve dhe për të shtuar eksportimet, të ndërtohet rafineria e re e naftës me kapacitet 150 000 ton në vit me të gjitha anekset përkatëse, si fabrika e fuçive, që do të prodhojë 300 000 fuçi për bitum në vit, stacioni termoelektrik, me kapacitet 7 500 kw., dhe qyteti për banimin e punëtorëve, me kapacitet strehimi për 3 500 banorë. Për të zgjeruar bazën teknike të spastrimit të bitumit natyral, të ndërtohet impianti i pastrimit në Minierën e bitumit të Selenicës me kapacitet 80 000 ton në vit. Gjithashtu, të ndërtohet impianti i pastrimit të mineralit të bakrit me kapacitet 90 000 ton në vit, si edhe fabrika e briketit të qymyrgurit me kapacitet 40 000 ton në vit.

b) *Në sektorin e industrisë:* Plani parashikon mbarimin e ndërtimit dhe vënjen në prodhim të fabrikës së sheqerit, me kapacitet 10 000 ton në vit, për të plotësuar nevojat e vendit dhe për të pakësuar importin e sheqerit, Fabrikën e konservimit të peshkut në Vlorë, me kapacitet 2 000 ton në vit; 3 fabrika të vogla për konservimin e perimeve, me kapacitet kompleksiv 1 000 ton në vit, Fabrikën e pjekjes së bukës në Tiranë dhe Fabrikën e fermentimit të duhanit në Shkodër me kapacitet 1 500 ton. Për të zgjeruar prodhimin e veshmbathjes, të ndërtohen këto objekte: Kombinati i tekstileve «Stalin», me kapacitet 20 000 000 met. linear në vit, i cili brenda pesëvjeçarit do të plotësojë të gjitha nevojat e vendit me tekstile të pambukta, fabrika e zhveshjes së pambukut në Fier dhe fabrika e zhveshjes së pambukut në Rrogozhinë, me kapacitet secila 10 560 ton në vit, me të cilat do të sigurohet zhveshja e të gjithë pambukut që do të prodhohet gjatë pesëvjeçarit, fabrika e tekstileve të leshta në Tiranë, me kapacitet 900 000 metra linear në vit, fabrika e fijeve të pambukut, me kapacitet 600 ton në vit, dhe fabrika e ekstrakt-taninit, që do të prodhojë 1 000 ton ekstrakt-tanin në vit për industrinë e lëkurëve. Për të shtuar prodhimin e lëndëve të ndërtimit, të ndërtohen kë-

to objekte të reja: kombinati i drurit në Elbasan, me kapacitet 36 000 m³ në vit, fabrika e staxhionimit të drurit në Pukë dhe fabrika e staxhionimit të drurit në Korçë, me kapacitet të përgjithshëm 15 000 m³ në vit, fabrika e qelqit në Tiranë, me kapacitet 2 000 ton në vit, fabrika e çimentos në Vlorë, me kapacitet 40 000 ton në vit. Për të krijuar bazën e energjisë elektrike për të gjithë industrinë dhe një sistem unik të shpërndarjes së energjisë elektrike, të ndërtohet centrali hidroelektrik «Lenin», me kapacitet 5 000 kw. për t'i dhënë ujë e dritë Tiranës dhe energji Durrësit e Shijakut, centrali hidroelektrik mbi lumin e Matit, me kapacitet 20 000 kw., si dhe vija e tensionit të lartë prej këtij centrali deri në Selenicë, 270 km. e gjatë. Për industrinë mekanike të ndërtohet fabrika e shkrirjes së hekurit dhe çelikut¹ me kapacitet 3 000 ton në vit, duke shfrytëzuar si lëndë të parë hekurishtet që gjenden në vend. Gjithashtu të zgjerohen me pajisje të reja ofiçinat mekanike ekzistuese.

c) *Për bujqësinë*: Të mbarojë bonifikimi i kompleksit të Maliqit, duke siguruar 4 500 ha. tokë nga më pjelloret dhe duke kulluar 3 700 ha. të tjera dhe të bëhet sistemimi i lumit të Devollit dhe Dunavecit. Të fillojë bonifikimi i Myzeqesë së madhe, midis lumit Seman dhe lumit Shkumbin, mbi një sipërfaqe të përgjithshme prej 40 000 ha., për tharjen e kënetës së Tërbufit, duke siguruar rreth 7 000 ha. tokë të re, duke vënë nën ujë pjesën më të madhe të tokës midis lumenjve. Të bonifikohet fusha e Vurgut të Delvinës, për ta shpëtuar atë nga inondata e lumit Bistrica dhe për ta bërë atë zonë bazën kryesore të rritjes së orizit, duke siguruar rreth 1 000 ha. tokë të re. Të çelen kanale të reja ujitëse, në mënyrë që në vitin 1955 sipërfaqja nën ujë të arrijë në 83 000 ha. kundrejt 39 000 ha. që ka qenë në vitin 1950: kanali Peqin-Kavajë 43 km. i gjatë, që do të ujitë të gjithë fushën e Kavajës, rreth 7 000 ha. tokë, midis Shkumbinit dhe Bregdetit; kanali Vjosë-Levan-Fier, i gjatë mbi 50 km. që do të ujitë rreth 10 000 ha. tokë; do të shtohet kapaciteti i kanalit të Myzeqesë; të çelet kanali i fushës së Krujës, që do të ujitë mbi 1 500 ha. tokë; kanali i fushës së Korçës, që do të ujitë mbi 2 000 ha. tokë; kanali i fushës së Zadrimës, rreth 18 km. i gjatë, që do të ujitë mbi 2 500 ha. tokë; të ndërtohet rezervuari mbi lumin e Tërkuzës, afër Tiranës që do të ujitë mbi 2 500 ha.

Gjithashu, për të zgjeruar mekanizimin e bujqësisë, gjatë pesëvjeçarit të importohen 675 traktorë, 670 plugje traktorësh, shumë maqina shirëse, 38 kombajna, 342 maqina korrëse, qindra mijëra kv. plehra kimike etj. Të ngrihen 7 ferma të reja shtetë-

1 Këto objekte u hoqën nga plani i parë pesëvjeçar dhe fondet e planifikuara për to u investuan në sektorin e bujqësisë.

rore, të shtohet numri i SMT-ve, të ngrihen 130 stacione të reja ndërzimi, të importohen kafshë race, farëra të cilësisë së lartë, të ngrihet një aneks pranë fabrikës së sheqerit për të industrializuar përpunimin e koncentrateve ushqimore për kafshët.

c) *Për komunikacionin*: Të ndërtohet rruga e hekurt Vlorë-Memaliaj¹, 90 km. e gjatë, për të transportuar çdo vit 100 000 ton qymyrguri nga Miniera e Memaliajt në Portin e Vlorës. Të ndërtohen rrugët automobilistike Shëmri-Kolgecaj dhe rrugët Gramsh-Lozhan e Qyteti «Stalin» — Elbasan të transformohen në rrugë nacionale. Të ndërtohet ofiçina e riparimit të lokomotivave dhe të vagonave në Durrës, ofiçina automobilistike në Elbasan, ofiçina automobilistike në Tiranë. Të sistemohet Porti i Durrësit dhe ai i Shëngjinit, të ndërtohet stacioni i madh i radio Tiranës etj.

d) *Për sektorët e tjerë*: Për të siguruar zhvishjen e orizit, të ngrihet fabrika e orizit në Vlorë me kapacitet 3 000 ton në vit. Për të përmirësuar shëndetin e popullit, të ngrihet një spital i madh në Berat si dhe stacioni termal i Selenicës. Të ngrihen kinoteatri i Gjirokastrës, i Lushnjës dhe i Fierit. Për qytetin e Tiranës, përveç objekteve që do të ndërtohen, sikurse u tha më lart, do të ndërtohen edhe këto objekte: Një frigorifer i madh, politeknikumi «7 Nëntori», teknikumi ekonomik, të adaptohen ndërtesat për institutet e larta, të ndërtohet politeknikumi mjekësor, instituti i pediatriisë², laborator i bakteriologjik, laborator farmaceutik, kinostudioja, teatri i madh popullor³, gjithashtu të rregullohet sistemi i transportit urban dhe të ndërtohen 170 000 m² ndërtesa banimi me 2 100 apartamente të ndryshme.

Për të ndërtuar objektet e mësipërme, si dhe objektet e tjera të shumta që nuk u përmendën, kongresi vë këto detyra përpara punonjësve të ndërtimit:

— Të zgjerohet mekanizimi i punimeve të ndërtimit. Kjo duhet të bëhet në radhë të parë duke shfrytëzuar sa më mirë maqineritë ekzistuese si dhe duke importuar maqineri e pajisje të reja. Për përdorimin e maqinerisë duhet të pregatiten kuadrot e nevojshëm.

— Të kursethet sa më shumë materiali i ndërtimeve, duke shfrytëzuar në maksimum materialet e ndërtimit që prodhohen në vend, për të shkurtuar importimet e kota.

— Të pregatiten me kohë projektet e ndërtimit. Realizimi i planit duhet të matet jo vetëm me vlerën e punimeve, por edhe me vëllimin fizik të objektit.

— Të organizohet mirë emulacioni socialist, puna me norma të shtrihet në të gjitha llojet e punës së ndërtimit. Të tregohet kujdes i veçantë për përmirësimin e konditave të jetesës së puno-

1, 2, 3 Shih në këtë vëllim shënimin f. 300.

njësve të ndërtimit, duke u siguruar atyre plotësisht ushqimin e rregullt dhe të bollshëm, fjetjen e rehatshme, argëtimin, edukimin, veshmbathjen e nevojshme dhe të gjitha shërbimet e tjera.

— Të sigurohet fuqia punëtore në kohën e duhur dhe të kufizohet sa më shumë fluksi dhe riflaksi i fuqisë punëtore. Të përgatiten kuadrot e nevojshëm.

— Të përqëndrohen forcat kryesore të ndërtimit në objektet më kryesore, e në radhë të parë në ndërtimin e centralit hidroelektrik mbi lumin e Matit, në rafinerinë e naftës, në fabrikën e çimentos dhe në hekurudhën Vlorë-Memaliaj.

IV

PLANI I NGRITJES SË MËTEJSHME TË NIVELIT TË JETESËS DHE TË NIVELIT KULTURAL TË POPULLIT

Kongresi II i PPSH e konsideron të nevojshme që gjatë pesëvjeçarit të parë të përmirësohet mjaft gjendja ekonomike e masave punonjëse, duke shtuar prodhimin e konsumit të gjerë, qarkullimin e mallrave të tregëtisë dhe duke ulur çmimet në përgjithësi e veçanërisht çmimet e prodhimeve industriale.

Kongresi e konsideron të nevojshme që gjatë këtij pesëvjeçari numri i punëtorëve dhe i nëpunësve të rritet 79 për qind më tepër se në vitin 1950. Në të njëjtën kohë fondi i pagave të punëtorëve dhe të nëpunësve të arrijë 215 për qind.

Për të përmirësuar shëndetin e popullit, për të zhvilluar arësimin, kulturën dhe sportin, për të përmirësuar gjendjen e banesave të punonjësve, shteti duhet të harxhojë 343 për qind më tepër se në periudhën 1946-1950. Në krahasim me vitin 1950, qarkullimi i mallrave të tregëtisë socialiste do të arrijë në 11 miliard e 328 milion lekë, ose 200 për qind në krahasim me vitin 1950. Vëllimi i të ardhurave të popullsisë do të rritet më tepër se dy herë në krahasim me vitin 1950.

Në krahasim me vitin 1950, në vitin 1955 numri i shkollave fillore do të arrijë 106 për qind, numri i shkollave unike dhe të mesme-180 për qind, numri i shtretërve në spitale-124 për qind, numri i shtëpive të kulturës-227 për qind. Do të zgjerohet rrjeti i teatrove dhe i kinemave. Do të çelen institute të larta për ekonominë, për mjekësinë etj., për të përgatitur kuadro të lartë në vend. Gjatë pesëvjeçarit do të ndërtohen gjithsej 586 000 m² ndërtesa për banim dhe do të organizohet lufta në stil të gjerë kundër malarjes dhe sëmundjeve infektive. Numri i përgjithshëm

i nxënësve në vitin 1955 do të arrijë 215 800, d.m.th. 370 për qind më tepër se në vitin 1938, numri i mësuesve të shkollave fillore do të arrijë në 321 për qind, numri i mësuesve dhe i profesorëve të shkollave të mesme dhe unike në 878 për qind, numri i agronomëve në 506 për qind, numri i punonjësve të shëndetësisë në 377 për qind dhe numri i inxhinierëve të çdo specialiteti do të rritet 18 herë.

Kongresi konsideron të domosdoshme që gjatë këtij pesëvjeçari të zhduket analfabetizmi plotësisht, të zgjerohet rrjeti i shkollave industriale, të forcohen dhe të zgjerohen shkollat e rezervave të punës dhe të tregohet kujdes i veçantë për ngritjen kulturele dhe përmirësimin e shëndetit të krahinave më të prapambetura, si Kukësi, Tropoja, Mirdita, Puka etj. Centrali hidroelektrik mbi lumin e Matit të bëhet një qendër e madhe edukative për përgatitjen e kuadrove të rinj teknikë dhe për ngritjen e nivelit kultural të krahinave të Veriut. Gjatë pesëvjeçarit të përgatiten mbi 8 500 teknikë të mesëm dhe rreth 54 000 punëtorë të kualifikuar. Të tregohet kujdes i veçantë për futjen e gruas në punë.

Për të realizuar detyrat e mësipërme, Kongresi II i PPSH kërkon që:

a) Ministria e Tregëtisë, Bashkimi Qendror i Kooperativave të Konsumit dhe Ministria e Shëndetësisë të tregojnë më tepër kujdes për t'i shërbyer popullit si duhet, të zhdukin çrregullimet që ekzistojnë në sektorët e tyre, t'i gjallërojnë dhe t'i aktivizojnë organet vartëse, t'i edukojnë ato për t'i shërbyer sa më mirë popullit. Ato duhet të interesohen që të futet sa më shumë gruaja në shërbimet e tyre.

b) Ministria e Arësimit të tregojë kujdes të veçantë për edukimin e brezit të ri dhe për riedukimin e personelit arësimor të vjetër, të tregojë sidomos kujdes të veçantë për perfeksionimin dhe përgatitjen e mësuesve të fshatit. Të kujdeset më tepër për pajisjet e shkollave me tekstet e nevojshme dhe për përmirësimin e konditave të jetesës së nxënësve konviktore. Të luftohet fryma e shkollës së vjetër dhe arësimi ynë të bazohet në sistemin e përpunuar pedagogjik të Bashkimit Sovjetik.

c) Komiteti i arteve dhe i kulturës, Lidhja e Shkrimtarëve, Komiteti i fiskulturës e i sporteve të përpigën që artin, kulturën, letërsinë, sportin ta bëjnë të masave, ta vënë në shërbim të masave dhe të luftojnë për forcimin dhe edukimin e brezit të ri, për edukimin e të gjitha masave punonjëse në frymën e patriotizmit dhe të vetëmohimit, duke ecur në rrugën e eksperiencës sovjetike.

ç) Instituti i shkencave të përpigjet që ta vërë diturinë e vet në shërbim të prodhimit dhe të ndërtimit, të afrohet më tepër

me qendrat e punës dhe të thellohet më tepër në problemet aktuale, që kanë të bëjnë me ndërtimin e bazave të socializmit.

d) Organet financiare duhet ta përqëndrojnë vëmendjen e tyre në forcimin e disiplinës financiare, në forcimin e kontrollit për përdorimin e drejtë të mjeteve buxhetore, për kursime sa më të mëdha. Ato duhet të bëjnë një luftë të madhe kundër çdo lloj abuzimesh dhe shpërdorimesh të mjeteve shtetërore prej elementëve të pandërgjegjshëm ose armiq. Ato duhet të përpiqen për zbatimin rigoroz të ligjeve financiare të shtetit dhe për qarkullimin sa më të shpejtë të monedhës.

dh) Komitetet ekzekutive të rretheve duhet të shkunden, të luftojnë për zhdukjen e të metave të tyre dhe të përmirësojnë metodën e tyre të drejtimit dhe të punës. Ato duhet të kujdesen më tepër për zhvillimin e industrisë lokale, për rregullimin e transportit lokal, për zgjerimin e banesave të strehimit, për rregullimin urbanistik dhe të të gjithë rrethit. Ato nuk duhet të qëndrojnë indiferentë kundrejt ndërtimit të industrisë nacionale në rrethet e tyre. Rrethi i Elbasanit, ku po ndërtohen fabrika dhe kombinat, në radhë të parë rrethi i Tiranës, si edhe shumë rrethe të tjera, duhet të mendojnë dhe të punojnë seriozisht për ngritjen e banesave, të klubeve dhe të shtëpive popullore të leximit, për gjithshka është e nevojshme dhe që lind nga zgjerimi i industrisë. Komitetet ekzekutive të rretheve duhet të drejtojnë të gjithë punën dhe jo të merren vetëm me një çështje, siç bëjnë disa komitete, që merren vetëm me grumbullimin, por duhet të merren edhe me industrinë edhe me bujqësinë edhe me transportin edhe me arësimin e kulturën, pra, me të gjitha. Ato janë organe të zgjedhura nga populli, prandaj duhet t'i shërbejnë mirë popullit.

V

LUFTA ME VËSHTIRËSITË DHE TË METAT — KONDITË E DOMOSDOSHME PËR REALIZIMIN E PLANIT PESEVJEÇAR

1. — Kongresi konsideron se realizimi i planit të parë pesëvjeçar është objektivi më i rëndësishëm dhe më imediat i Partisë, i pushtetit dhe i popullit. Duke u mbështetur në parimin stalinian, sipas të cilit,

«Fitorja nuk vjen kurrë vetë, — ajo zakonisht merret me luftë»¹,

kongresi e konsideron të domosdoshme që të mobilizohet e gjithë Partia, të gjitha organet shtetërore, të gjitha organizatat shoqërore, i gjithë populli punonjës, për të luftuar me këmbëngulje kundër të gjitha vështirësive dhe të metave në punë. Për këtë, kongresi shtron këto detyra të rëndësishme, plotësimi i të cilave është konditë e domosdoshme për suksese në realizimin e planit të parë pesëvjeçar:

a) Të luftohet për organizimin më të mirë të punës dhe të drejtimit. Kjo do të bëhet duke luftuar pa mëshirë burokratizmin, tendencën e përgjithshme për të zgjidhur çështjet me anën e shkresave dhe pa e kontrolluar çështjen në vend. Kjo duhet të bëhet duke luftuar pa mëshirë javashllëkun në punë, ndryshkjen e njerëzve, e cila pengon ritmin e shpejtë të punës. Kjo duhet të bëhet, para së gjithash, duke vlerësuar drejt kuadrot, në bazë të qëndrimit të tyre politik, të aftësive të tyre konkrete për të drejtuar dhe për të punuar, të perspektivës që ata kanë për t'u zhvilluar. Kjo duhet të bëhet duke organizuar kontrollin e realizimit të planit, kontrollin e zbatimit të vendimeve, një kontroll preventiv, të pandërprerë, të saktë, të rreptë dhe edukativ.

b) Të luftohet për përdorimin e drejtë të akumulimit shtetëror, për vendosjen e një regjimi të rreptë kursimi, duke u nisur nga parimi: asnjë lek të mos harxhohet pa vend, por të harxhohet në interes të popullit, në interes të industrializimit të vendit dhe të zhvillimit të bujqësisë. Kjo duhet të bëhet duke u përpjekur për plane reale, për të mos bërë plane të fryra. Kjo duhet të bëhet duke forcuar dhe duke thjeshtësuar aparatën e shtetit, duke shkurtuar shpenzimet e kota dhe duke ruajtur pasurinë shtetërore si gjë të shenjtë. Kundrejt shpërdoruesve të pasurisë shtetërore duhet të jemi të rreptë, të pamëshirshëm. Kjo duhet të bëhet duke mos humbur kohën gjatë orarit të punës, duke shfrytëzuar racionalisht maqinerinë. Kjo duhet të bëhet duke luftuar me të tëra forcat për uljen e kostos së prodhimit, duke ulur në minimum shpenzimet administrative, duke i bërë maqinerisë shërbimet teknike të domosdoshme, duke shkurtuar në minimum mbeturinat e materialit nga procesi i prodhimit, duke i bërë punonjësit të ndërgjegjshëm për rëndësinë e uljes së kostos së prodhimit.

¹ J. V. Stalin. Veprat, vëll. 13, f. 352.

c) Të luftohet për rritjen e rendimentit të punës, duke u konsideruar rritja e tij si

«. . . gjëja më e rëndësishme, gjëja kryesore për fitoren e rendit të ri shoqëror»¹.

Kjo duhet të bëhet duke forcuar autokritikën dhe kritikën nga poshtë, për të luftuar burokratizmin, duke organizuar mirë emulacionin socialist. Për të organizuar si duhet emulacionin socialist duhet të nisemi nga parimi që nuk duhet të mbetet asnjë punëtor i thjeshtë, asnjë drejtues që të mos e njohë planin e tij të prodhimit të përditshëm dhe për çdo orë, nga parimi që punëtori duhet të njohë sa ka prodhuar dhe sa ka për të prodhuar dhe rezultatet të publikohen, për t'u njohur nga të gjithë, për të mundur që secili të krahasojë punën e tij me punën e të tjerëve. Kjo duhet të bëhet duke luftuar me këmbëngulje për përmirësimin e cilësisë së prodhimit. Plani duhet të realizohet jo vetëm si sasi, por edhe si cilësi, edhe si asortiment. Duhet të zgjerohet mekanizimi i proceseve të prodhimit, racionalizimi i prodhimit, të mirëmbahet maqinaria dhe të inkurajohet çdo inisiativë nga poshtë për shpikje të reja, racionalizime dhe novatorizëm, që synojnë në rritjen e rendimentit të punës dhe në uljen e kostos së prodhimit.

ç) Të luftohet për zotërimin e teknikës, të tregohet vëmendje kryesore për përgatitjen e kuadrit. Kjo duhet të konsiderohet si një nga detyrat më të rëndësishme, si detyra më imediate, sepse duhet të zhduket disproporcioni që ekziston midis nivelit shumë të ulët të kuadrove tanë dhe teknikës moderne, me të cilën po pajiset me të shpejtë industria jonë. . . Komunistët duhet të jenë të parët që të japin shembullin në luftën për zotërimin e teknikës, ata duhet të jenë në ballë të luftës për t'u bërë zotër të maqinës, të shkencës, të teknikës.

d) Të përvetësojmë dhe të përhapim eksperiencën sovjetike, duke e konsideruar atë si modelin më të mirë dhe më të perfeksionuar të punës për ndërtimin e socializmit. Kjo çështje duhet të bëhet një preokupacion kryesor për të gjitha organet e Partisë, për të gjitha ministrinë dhe kolegjiemet e tyre, për të gjitha organizatat e masave, për të gjitha ndërmarrjet ekonomike, për ta organizuar drejt dhe për ta udhëhequr zbatimin e metodave sovjetike. Metododat sovjetike në punë duhet të shtrihen në të gjitha degët e prodhimit. . . dhe duhet të bëhen bazë për emulacionin socialist.

dh) Të forcojmë vigjilencën revolucionare. Duke marrë parasysh se vendi ynë është gjeografikisht i rrethuar nga armiq të betuar të socializmit e të popujve dhe se në fazën e kalimit për

1 V. I. Lenin. Veprat, vëll. 29, f. 474.

në socializëm, në të cilën ndodhet vendi ynë, lufta e klasave nuk zbutet, se armiqtë e brendshëm dhe të jashtëm nuk do ta zbutin luftën e tyre kundër pushtetit popullor dhe popullit tonë, por do t'i shumëfishojnë përpjekjet e tyre për të sabotuar ndërtimin e socializmit në vendin tonë; prandaj kongresi e quan të domosdoshme që vigjilenca revolucionare të forcohet dhe të bëhet çështje e të gjitha masave punonjëse.

e) Të forcojmë drejtimin e ekonomisë nga Partia. Duke u nisur nga parimi stalinian, sipas të cilit

«. . . sukseset ekonomike, qëndrueshmëria dhe jeta e tyre varen tërësisht dhe plotësisht nga sukseset e punës organizative dhe të punës politike të partisë, se pa këtë kusht sukseset ekonomike mund të jenë si të ndërtuara mbi rërë»¹,

kongresi konsideron të nevojshme marrjen e masave për të zhdukur të metat që ekzistojnë në drejtimin e ekonomisë nga Partia, në punën organizative dhe politike të Partisë. Organet e Partisë duhet ta lidhin punën e tyre të përditshme me drejtimin e ekonomisë, pa e zëvendësuar pushtetin në funksionet e tij. Ato duhet që, në radhë të parë, t'i bëjnë komunistët të ndërgjegjshëm për rolin e tyre pararojë në frontin e luftës për realizimin e planit. Ato duhet të mobilizojnë të gjitha levat e Partisë, bashkimet profesionale, organizatën e rinisë, organizatën e gruas, organizatën e Frontit, organet e pushtetit për realizimin e planit pesëvjeçar. Ato duhet të krijojnë rreth vetes aktivet e njerëzve pa parti, si në qytet ashtu edhe në fshat. Komunistët që janë në prodhim duhet të bëhen të gjithë sulmues, të jenë më të dalluarit në të gjitha drejtimet.

ë) Të gjitha organet ekzekutive dhe ato të Partisë të tregojnë kujdes të veçantë për përmirësimin e konditave të jetesës së punëtorëve në qendrat e prodhimit. Të krijohen bazat materiale të nevojshme për fuqinë punëtore permanente pranë qendrave të punës.

2. — Kongresi II i PPSH konsideron se realizimi i detyrave që ai përcakton për planin pesëvjeçar do të sigurojë:

a) Zhvillimin e industrisë me një ritëm më të shpejtë nga ai i deritanishmi, rritjen e prodhimit industrial, për të bërë të mundur: shkurtimin e importit të veglave dhe të maqinerive të thjeshta dhe të pjesës më të madhe të mallrave të konsumit të

1 J. V. Stalin. Veprat, vëll. 14, f. 107.

gjerë, furnizimin e rregullt të popullsisë me prodhime industriale, furnizimin e fshatarësisë jo vetëm me prodhime industriale për nevojat personale të fshatarit, por edhe me mjete e vegla pune, për të përmirësuar metodat e prodhimit bujqësor, zvogëlimin e disproporcionit midis çmimeve të prodhimeve industriale dhe çmimeve të prodhimeve bujqësore, rritjen e eksportit të prodhimeve minerale.

b) Zhvillimin e bujqësisë me një ritëm më të shpejtë nga ai i deritanishmi, për të bërë të mundur: prodhimin e vëllimit të nevojshëm të lëndëve të para për industrinë (pambuk, panxhar, duhan, etj.), gjallërimin e tregut fshatar me prodhime bujqësore, prodhimin e gati të gjithë sasisë së nevojshme të drithërave për bukën e popullit, duke ulur kështu në minimum importin e bukës, kthesën e domosdoshme të blegtorisë, duke ndaluar rënjen e numrit të blegtorisë dhe duke bërë që kjo të rritet vazhdimisht në numër dhe të përmirësohet si cilësi; zgjerimin e mekanizimit të bujqësisë, duke i pajisur stacionet e maqinave dhe të traktorëve me traktorë dhe maqina bujqësore, duke pajisur fshatarësinë kooperativiste dhe individuale me mjete teknike dhe vegla bujqësore; forcimin dhe zgjerimin e fermave të shtetit, forcimin e gjithanshëm të kooperativave bujqësore të prodhimit, zgjerimin e ndihmës së shtetit për të fuqizuar ekonominë individuale të fshatarësisë dhe rritjen e rendimenteve të prodhimit; kufizimin e ekonomisë së kulakëve, rritjen e eksportit të prodhimeve bujqësore.

c) Rritjen e fuqisë së transportit për të bërë që të zhduket plotësisht disproporcioni midis nevojave të ekonomisë popullore në transport dhe kapacitetit të transportit; zgjerimin e rrjetit telegrafonik; forcimin dhe zgjerimin e tregëtisë shtetërore dhe asaj kooperativiste, përmirësimin e tregut fshatar dhe kufizimin e tregëtisë private spekuluese.

c) Një përmirësim të konsiderueshëm të gjendjes ekonomike, ngritjen e mëtejshme të nivelit kultural dhe përmirësimin e shëndetit të të gjitha masave punonjëse; rritjen e pagave reale, duke forcuar fuqinë blerëse të lekut; furnizimin më të mirë të popullsisë me artikuj të konsumit të gjerë dhe heqjen e pjeshme të sistemit të triskëtimit aty nga fundi i pesëvjeçarit; krijimin e konditave normale të jetesës së punëtorëve pranë qendrave të punës; zhdukjen e plotë të analfabetizmit, realizimin e plotë të arësimit të detyrueshëm në shkollat fillore, zgjerimin e arësimit të mesëm, krijimin e arësimit të lartë, perfeksionimin e kuadrove ekzistues dhe krijimin e kuadrove të rinj për të përballuar nevojat që lindin nga plani pesëvjeçar, forcimin dhe zgjerimin e artit, të kulturës, të sportit, të kinematografisë; zgjerimin dhe përmirësimin e shërbimit sanitar.

d) Zhvillimin ekonomik e kultural të rretheve të prapambe-

tura të Republikës, duke i vënë ato në rrugën e daljes së shpejtë nga prapambetja ekonomike dhe kulturele.

dh) Krijimin e rezervave të nevojshme për shtetin, për të mundur që të përballojmë nevojat e ngutshme që lindin gjatë pesëvjeçarit, për të mundur që të manevrojmë si në tregun e brendshëm, ashtu dhe në atë të jashtëm.

e) Forcimin e pozitive ekonomike dhe politike të pushtetit popullor në luftën e tij me armiqtë e brendshëm të klasës dhe me armiqtë e jashtëm, trockistë, fashistë dhe imperialistë.

ë) Forcimin e fuqisë mbrojtëse të vendit, të vigjilencës revolucionare dhe të patriotizmit të masave punonjëse.

f) Forcimin e besimit të masave punonjëse ndaj Partisë së Punës të Shqipërisë, forcës drejtuese të fateve të popullit tonë.

g) Forcimin sasior dhe cilësor të klasës punëtore, udhëheqëse e masave punonjëse të vendit tonë.

gj) Forcimin e miqësisë së popullit tonë me popujt e Bashkimit Sovjetik, forcimin e dashurisë dhe të besimit të patundur të popullit tonë ndaj mikut të tij më të dashur, ndaj shokut Stalin.

h) Forcimin e miqësisë së popullit tonë me popujt e vendeve të demokracisë popullore.

i) Forcimin e luftës sonë për mbrojtjen e paqes.

3. — Kongresi konsideron se faktorët kryesorë që kanë përcaktuar sukseset tona të deritanishme, që sigurojnë realizimin me sukses të planit të parë pesëvjeçar, që sigurojnë ndërtimin e socializmit në vendin tonë, janë:

a) *Ekzistenca e Partisë së Punës të Shqipërisë*, e cila është forca drejtuese, organizuese dhe mobilizuese e masave punonjëse. Ajo është themeluar në zjarrin e Luftës nacional-çlirimtare të popullit tonë, mbi bazat e marksizëm-leninizmit. Ajo është reparti pararojë i klasës punëtore dhe arma e saj e fortë për konsolidimin dhe forcimin e pushtetit popullor, që kryen funksionet e diktaturës së proletariatit. Ajo është një nga faktorët kryesorë të brendshëm që garanton pavarësinë dhe ndërtimin e socializmit.

b) *Ekzistenca e pushtetit popullor*, që është baza politike për ndërtimin e socializmit, që është pushteti i masave punonjëse të qytetit dhe të fshatit me klasën punëtore në krye. Ai ushtron funksionet e diktaturës së proletariatit, sepse siguron plotësisht sundimin e vet, me anën e vigjilencës revolucionare të organizuar të masave punonjëse me klasën punëtore në krye, kundër feudoborgjezisë së mundur, siguron thyerjen e çdo rezistence të kësaj të fundit; siguron plotësisht udhëheqjen e klasës punëtore ndaj fshatarësisë punonjëse, sepse ai mbështetet në aleancën midis klasës punëtore dhe fshatarësisë punonjëse dhe në këtë aleancë

klasa punëtore ushtron rolin udhëheqës; siguron plotësisht ndërtimin e bazës ekonomike të socializmit, sepse ai ka bërë të mundur shpronësimin e çifligarëve dhe të kapitalistëve, reformat e mëdha ekonomike, përmbysjen e raporteve të vjetra në prodhim dhe vendosjen e raporteve të reja, ka krijuar të gjitha mundësitë praktike për ndërtimin e bazës ekonomike të socializmit në bazë të një plani shtetëror.

c) *Baza jonë ekonomike.* Në bazën ekonomike ekzistuese rolin drejtues e luan ekonomia socialiste, e cila ka pozita komanduese në kuadrin e ekonomisë popullore. Ajo është duke u forcuar vazhdimisht dhe ka perspektiva të mëdha përpara, po të marrim parasysh pasuritë e mëdha të nëntokës, si naftën, kromin, qymyrin, bitumin, bakrin, hekurin etj., duke marrë parasysh prodhimtarinë e tokës sonë, klimën shumë të mirë për bujqësinë dhe burimet e mëdha të vendit me energji hidroelektrike.

c) *Vrulli revolucionar dhe patriotizmi i masave punonjëse.* Masat tona punonjëse karakterizohen nga vrulli i tyre revolucionar dhe nga patriotizmi i tyre i shkëlqyer. Ky e ka burimin në qëndresën e armatosur, në luftën që ka bërë populli ynë gjatë shekujve kundër pushtuesve të huaj, ky e ka burimin në besimin e patundur të masave punonjëse ndaj Partisë së Punës, ndaj së ardhshmes së lumtur të vendit tonë, ndaj Bashkimit Sovjetik dhe shokut Stalin; ai është shprehja më e gjallë e lidhjeve të ngushta midis Partisë dhe masave.

d) *Bashkimi Sovjetik...* Çlirimi i vendit nga zgjedha e huaj, vendosja e pushtetit popullor, ndërtimi i bazave të socializmit, si në vendin tonë ashtu dhe në të gjitha vendet e demokracisë popullore, e kanë burimin në triumfin e Revolucionit të madh socialist të Tetorit, e kanë burimin në fitoren e Bashkimit Sovjetik mbi ushtritë nazi-fashiste në Luftën e dytë botërore, në ekzistencën dhe aktivitetin internacionalist të Bashkimit Sovjetik, në ndihmën e tij bujare që u jep vendeve të demokracisë popullore, që na jep neve. Është pesha specifike e Bashkimit Sovjetik në gjendjen ndërkombëtare, është ndihma pa interes që ai i jep popullit tonë, që na ndihmon në të jemi të lirë, të ndërtojmë kombinatet e fabrika, të ndërtojmë bazat e socializmit... Bashkimi Sovjetik, si koka drejtuese e kampit socialist, si mbrojtës i fuqishëm dhe besnik i interesave të popullit tonë, është faktori i jashtëm vendimtar për ndërtimin e bazave të socializmit te ne, sikurse kudo gjatë në vendet e demokracisë popullore.

Kongresi i bën thirrje të gjithë Partisë, gjithë klasës punëtore, rinisë, gruas, të gjithë popullit, që të mobilizohen plotësisht për realizimin me sukses të planit të parë pesëvjeçar, duke luftuar me vështirësi të përditshme dhe me të metat në punë, duke punuar pa u lodhur, duke mbajtur lart flamurin e Partisë, për ndërtimin e bazave të socializmit, për mbrojtjen e pavarësisë, për mbrojtjen e paqes.

*Botohet sipas origjinalit që
gjenet në Arkivin Qendror
të Partisë*

*Botuar për herë të parë në
gazetën «Zëri i Popullit»,
Nr. 89 (1097), 11 prill 1952*

THIRRJE

E KONGRESIT II TË PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË DREJTUAR GJITHË PUNONJËSVE TË SHQIPËRISË

6 prill 1952

PUNONJËS TË SHQIPËRISË!

Duke ndjekur rrugën tonë historike drejt ndërtimit të themeleve të socializmit, duke plotësuar vullnetin e klasës punëtore dhe të të gjithë popullit tonë, Kongresi II i Partisë së Punës të Shqipërisë aprovoi planin e parë pesëvjeçar të zhvillimit të ekonomisë popullore të Republikës Popullore të Shqipërisë. Ky plan, i mbështetur në bazën ekonomike të krijuar deri sot dhe në ndihmën e çmueshme të Bashkimit Sovjetik dhe të shokut Stalin në radhë të parë si dhe të vendeve të demokracisë popullore motra, është për Partinë dhe për gjithë punonjësit e vendit tonë një program i gjerë lufte për paqen dhe lumturinë.

«Detyra politike kryesore e planit të parë pesëvjeçar konsiston: **NË FORCIMIN E ALEANCËS MIDIS KLASËS PUNËTORE E FSHATARËSISË PUNONJËSE DHE NË FORCIMIN E ROLIT DREJTUES TË KLASËS PUNËTORE NË KËTË ALEANCË; NË KUFIZIMIN E ELEMENTËVE KAPITALISTË DHE SPEKULATORË TË QYTETIT DHE TË FSHATIT; NË RRITJEN E NIVELIT KULTURAL TË MASAVE PUNONJËSE; NË FORCIMIN E NDËRGJEGJES SOCIALISTE TË KLASËS PUNËTORE DHE NË FORCIMIN E VIGJILENCËS REVOLUCIONARE E TË PATRIOTIZMIT TË TË GJITHA MASAVE PUNONJËSE.**

Detyra ekonomike kryesore e planit të parë pesëvjeçar konsiston: **NË VAZHDIMIN ME NJË RITËM MË TË SHPEJTË TË PUNËS PËR NDËRTIMIN E BAZËS EKONOMIKE TË SOCIALIZMIT, PËR TË BËRË QË NË FUND TË PESËVJEÇARIT VENDI YNË TË JETË TRANSFORMUAR NGA NJË VEND AGRAR I PRAPAMBETUR NË NJË VEND AGRARO-INDUSTRIAL»¹.**

¹ Enver Hoxha. Vepra, vëll. 9, f. 170-171.

Plani i parë pesëvjeçar parashikon një vëllim të madh pune. Investimet në lëmin ekonomik e kultural do të arrijnë në 21 miliard lekë, kundrejt 6 miliard e 824 milion lekë që kanë qenë në periudhën 1946-1950. Në vitin 1955 vëllimi i përgjithshëm i prodhimit industrial do të jetë 339 për qind në krahasim me vitin 1950, ose 12 herë më i madh se prodhimi i paraluftës. Vëllimi i përgjithshëm i prodhimit të të gjitha degëve të bujqësisë do të jetë 171 për qind në krahasim me vitin 1950, ose 221 për qind në krahasim me prodhimin bujqësor të paraluftës.

Do të ndërtohen vepra madhështore, si centrali hidroelektrik mbi lumin e Matit, rafineria e naftës në Cërrik dhe një sërë fabrikash, si ajo e fermentimit të duhanit në Shkodër, fabrika e çimentos në Vlorë, fabrika e shkrirjes së hekurit, fabrikat e staxhionimit në Pukë e në Korçë, fabrika e qelqit, fabrika për fijet e pambukut, fabrika e tekstileve të leshta në Tiranë, fabrika e letrës e të tjera.

Bonifikimet do të marrin përpjesëtime të gjera. Do të fillojë bonifikimi i Myzeqesë së madhe me një sipërfaqe të përgjithshme prej 40 000 ha., do të bonifikohet fusha e Vurgut të Delvinës, do të çelen kanale të reja ujitëse në mënyrë që më 1955 sipërfaqja nën ujë të arrijë në 83 000 ha. kundrejt 39 000 ha. që ka qenë në vitin 1950.

Do të ndërtohen qendra të rëndësishme kulturele, shëndetësore e shtëpi banimi, si kinostudioja, teatri i madh popullor, një spital i madh në Berat, stacioni termal i Selenicës e të tjera. Do të zhduket plotësisht analfabetizmi.

Plani i parë pesëvjeçar është një grusht i fortë kundër armiqve të pushtetit tonë popullor, kundër armiqve të socializmit. Prandaj këta armiq dhe veçanërisht kulakët e spekulatorët do të përpiqen të pengojnë me çdo mënyrë plotësimin me sukses të planit të parë pesëvjeçar. Ata do të bëjnë çmos për të sabotuar punën tonë ndërtimore dhe paqësore. Ata ndihmohen në veprimtarinë e tyre nga njerëzit e pandërgjegjshëm në punë, vjedhësit, shpërdoruesit, egoistët, dembelët dhe burokratët. Por mbi të gjitha armiqtë e brendshëm do të nxiten dhe do të përkrahen nga padronët e tyre të jashtëm, nga imperialistët amerikano-anglezë dhe veglat e tyre të Beogradit, të Athinës dhe të Romës.

Në rrugën tonë, deri sot, ne kemi hasur në shumë vështirësi dhe pengesa. Nën udhëheqjen e shëndoshë të Partisë me shokun Enver Hoxha në krye dhe në saje të ndihmës së pareshtur të Bashkimit Sovjetik e të shokut Stalin, të gjitha këto vështirësi i kemi kapërcyer me sukses. Ne parashikojmë që edhe në të ardhshmen, në punën tonë për plotësimin e planit të parë pesëvjeçar, do të ndeshim, me siguri, në vështirësi dhe pengesa të reja. Kjo shpjegohet nga fakti që ne po shkojmë më përpara, po zgjerojmë

frontet tona të punës, po hapim fronte të reja. Por jeta na ka provuar se asgjë nuk mund t'i qëndrojë vrullit revolucionar dhe iniciativës krijuese të masave. Qysh në ditët e para pas çlirimit të Shqipërisë, në kushte jashtëzakonisht të vështira, punëtorët e Kombinatit të naftës në qytetin «Stalin» i vunë shpatullat punës, dhe për dy muaj rresht, me heroizëm e vetëmohim, bënë gati për shfrytëzim kantierin vajguror të shkatërruar prej zaptuesve fashistë. Gjatë viteve 1945-1946 dhe 1947, me ndihmën shumë të çmueshme të Bashkimit Sovjetik, u ndërtuan me punë të vrullshme shumë ura, rrugë, shtëpi e kanale. Që më 1946 nga gjiri i masave tona punonjëse lindi për herë të parë lëvizja sulmuese. Kjo la mënjanë mënyrën e vjetër të punës dhe e zëvendësoi atë me një hov të ri revolucionar. E frymëzuar nga ky hov revolucionar, rinia jonë ndërtoi me heroizëm dhe në një kohë rekord hekurudhat e para të vendit tonë. Në saje të emulacionit socialist të viteve 1949-1950, shumë ndërmarrje ekonomike plotësuan dhe tejkaluan planin dyvjeçar të shtetit.

PUNONJËS TË SHQIPËRISË!

Plani i parë pesëvjeçar për zhvillimin e ekonomisë dhe të kulturës së vendit tonë do të plotësohet duke zgjeruar e duke forcuar pa pushim lëvizjen e emulacionit dhe të garave socialiste. Kongresi II i Partisë ju bën thirrje që, kudo ku punoni, nën shembullin e ndritur të punonjësve të Bashkimit Sovjetik, të viheni në garë socialiste për të përmbushur me sukses detyrat e këtij plani. Kjo është një çështje e lartë patriotike, që duhet të kryhet me nder nga të gjithë. Kolektiv me kolektiv, repart me repart, brigadë me brigadë, fshat me fshat, njëri me tjetrin, hyni në gara socialiste për rritjen e prodhimtarisë në punë, për uljen e kostos dhe të shpenzimeve të kota, për ngritjen e cilësisë së prodhimit, për forcimin e disiplinës në punë, për zgjerimin e sipërfaqeve të tokave të mbjella, për shtimin e drithit, për forcimin e kooperativave bujqësore, të fermave shtetërore, të ndërmarrjeve blegtorale dhe të SMT-ve, për thjeshtësimin e aparateve shtetërore dhe për forcimin e lidhjeve të tyre me masat, për përmirësimin e punës në shkollat, spitalet dhe në të gjitha institucionet e tjera kulturore e sociale. Çdo kolektiv punonjës, çdo repart ose brigadë, çdo fshat dhe çdo punonjës duhet të njohë planin e tij pesëvjeçar dhe të luftojë për plotësimin e tij me sukses. Plani i parë pesëvjeçar në tërësi do të kryhet në qoftë se kryhet plani i çdo ndërmarrjeje, i çdo reparti, i çdo brigade, i çdo fshati, i çdo punonjësi në veçanti. Plani pesëvjeçar do të plotësohet në qoftë se plotësohet plani i çdo dite, i çdo dhjetëditori, i çdo muaji, i çdo tremujori dhe i çdo viti.

Asnjë punonjës i vendit tonë nuk duhet të mbetet jashtë emulacionit dhe garave socialiste për plotësimin e planit të parë pesëvjeçar. Nuk mjafton që në emulacionin socialist të kemi vetëm një numër të kufizuar punonjësish, qofshin këta edhe shumë të shquar. Duhet hedhur në gara e gjithë masa, i gjithë kolektivi, i gjithë fshati, sepse këto sigurojnë plotësimin e planit në kohë, në sasi e në cilësi. Zhvillimi i emulacionit dhe i garave socialiste duhet të bëhet një mjet i fuqishëm për t'i hapur rrugë të reja iniciativës krijuese të masave, për të zgjeruar radhët e punonjësve të përparuar dhe për të sjellë në rrugë të mirë të prapambeturit në punë.

Për të arritur përfundime sa më të mira në plotësimin e planit pesëvjeçar, nuk mjafton shpallja e emulacionit dhe e garave socialiste, duhet organizim dhe drejtim i mirë i këtyre garave.

Garat socialiste për plotësimin e planit të parë pesëvjeçar do të kurorëzohen me sukses, duke zbatuar shkencën dhe teknikën sovjetike. Çdo punonjës i vendit tonë të ndjekë kurdoherë shembullin e punonjësve sovjetikë, të përvetësojë dhe të zbatojë metodat e tyre në punë. Zbatimi i tyre jep suksese të jashtëzakonshme dhe bën që të thyhen normat, të arrihen rendimentet të larta dhe të plotësohen planet para afatit. Zbatimi i metodave sovjetike i edukon punonjësit, i pajis me teknikë të përparuar, i zhvillon dhe i bën me kulturë. Prandaj organizatat profesionale, organet ekonomike dhe shtypi t'i përhapin këto metoda në masat e gjera punonjëse dhe të bëjnë që radhët e sulmuesve, novatorëve, racionalizatorëve dhe të dalluarve në punë, të numërohen me mijëra dhe dhjetëra mijëra. Të organizohen herë pas here mbledhje nacionale e lokale me punonjësit e përparuar, sepse këto luajnë një rol me rëndësi në përhapjen e eksperiencës së më të mirëve.

Organizatrat profesionale, organet ekonomike dhe shtypi të përdorin një sistem sa më të mirë për të nxitur zhvillimin e emulacionit dhe të garave socialiste. Në çdo ndërmarrje, fshat, zyrë, shkollë, qendër kulturore dhe spital të bëhet një popullarizim i vazhdueshëm i sulmuesve, i novatorëve, i racionalizatorëve, i të dalluarve në punë, i fituesve të emulacionit dhe të garave socialiste. Emrat e tyre të botohen në gazetatat e murit, në gazetatat e revistat e vendit, të jepen në radio, të afishohen në tabela nderi dhe të popullarizohen në çdo mënyrë tjetër të përshtatshme.

Përfundimet e emulacionit dhe të garave socialiste të bisedohen gjallërisht në frymën e kritikës dhe të autokritikës bolshevike në mbledhjet e punëtorëve, të fshatarëve dhe të punonjësve të tjerë.

PUNONJËS TË SHQIPËRISË!

Plani i parë pesëvjeçar i zhvillimit të ekonomisë së vendit tonë është plotësisht i realizueshëm. Ai mbështetet në fuqinë e Partisë dhe të pushtetit tonë popullor, në bazën ekonomike të krijuar deri sot, në hovin revolucionar dhe atdhedashurinë e masave punonjëse dhe në ndihmën e çmueshme të Bashkimit Sovjetik në radhë të parë dhe të vendeve të demokracisë popullore.

... Plani i parë pesëvjeçar i vendit tonë është një vepër e madhe paqeje. Plotësimi i këtij plani do të jetë një kontribut i rëndësishëm për forcimin e paqes dhe të miqësisë ndërmjet popujve.

Rroftë klasa punëtore dhe gjithë populli shqiptar, që luftojnë me vendosmëri për mbrojtjen e paqes dhe ndërtimin e socializmit!

Rroftë Bashkimi i lavdishëm Sovjetik dhe shoku i madh Stalin!

Rroftë kampi i paqes me Bashkimin Sovjetik në krye!

Me flamurin e marksizëm-leninizmit nën udhëheqjen e PPSH, përpara për plotësimin e planit të parë pesëvjeçar!

KONGRESI II I PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË

*Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

*Botuar për herë të parë në
gazetën «Zëri i Popullit»,
Nr. 87 (1095), 9 prill 1952*

PLENUMI II I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Tiranë, 27 qershor 1952

KOMUNIKATË

E PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Plenumi II i Komitetit Qendror të PPSH, i mbledhur më 27 qershor 1952, pasi shqyrtoi raportin «Mbi punimin e rezolucioneve të Kongresit II të PPSH në aktivet dhe në organizatat bazë të Partisë», konstatoi se të gjitha organizatat e Partisë aprovuan me unanimitet rezolucionet e Kongresit II të PPSH. Anëtarët dhe kandidatët e Partisë shprehën gatishmërinë e tyre për realizimin me sukses të planit pesëvjeçar dhe treguan edhe një herë vullnetin dhe vendosmërinë që i karakterizon për të kryer me nder detyrat që u ngarkon Kongresi II i Partisë dhe Komiteti Qendror i PPSH me shokun Enver Hoxha në krye.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

REZOLUCION

I PLENUMIT TË KQ TË PPSH MBI PUNIMIN DHE ZBATIMIN NË JETË TË DOKUMENTAVE TË KONGRESIT II TË PARTISË

27 qershor 1952

Më datën 27 qershor 1952, u mbledh Plenumi II i Komitetit Qendror të PPSH, i cili pasi mori në shqyrtim raportin «Mbi punimin e rezolucioneve të Kongresit II të PPSH në aktivet dhe në organizatat bazë të Partisë», konstatoi:

1. — Të gjitha organizatat e Partisë aprovuan me unanimi-

tet rezolucionet e Kongresit II të PPSH. Anëtarët dhe kandidatët e Partisë shprehën gatishmërinë e tyre për realizimin dhe tejkalimin e planit pesëvjeçar dhe treguan edhe një herë vullnetin dhe vendosmërinë që i karakterizon për të kryer me nder detyrat që u ngarkon Kongresi II i Partisë dhe Komiteti Qendror i PPSH me shokun Enver në krye.

2. — Duke analizuar punën e tyre në dritën e rezolucioneve të Kongresit II të PPSH dhe në frymën e kritikës dhe të autokritikës, organizatat e Partisë zbuluan dhe goditën mjaft të meta në punën drejtuese të Partisë dhe të organeve ekonomike, në punën e pushtetit dhe të organizatave të masave, në çështjet organizative dhe në ato të agjitacionit e të propagandës së Partisë, si dhe në sektorët ekonomikë e sidomos në ata të tregëtisë, të grumbullimit e të bujqësisë.

Duke marrë parasysh sa më lart, Plenumi II i Komitetit Qendror të PPSH,

Vendosi:

1. — Gjithë organizatat e Partisë në qendër e në rrethe, dikasteret dhe organet e pushtetit, organizatat e masave dhe institucionet e ndryshme kulturele dhe shoqërore të hartojnë plane konkrete të punës dhe të marrin masa për t'i vënë në jetë vendimet e Kongresit II të PPSH. Këto vendime të bëhen program pune në të gjithë sektorët, të bëhen të njohura nga të gjithë komunistët dhe masat dhe të kërkohet me këmbëngulje zbatimi i tyre.

2. — Të dy raportet dhe rezolucionet e Kongresit II të PPSH të konsiderohen material zyrtar shtetëror dhe të punohen si lëndë e detyrueshme në të gjitha shkollat e mesme dhe në institutet e larta...

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

*Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

LETËR E KQ TË PPSH DËRGUAR REDAKSISË SË GAZETËS «ZËRI I POPULLIT» ME RASTIN E 10-VJETORIT TË THEMELIMIT TË KËTIJ ORGANI

24 gusht 1952

REDAKSISË SË GAZETËS «ZËRI I POPULLIT»

Komiteti Qendror i Partisë përshëndet dhe përgëzon gazetën «Zëri i Popullit», organin luftarak të Partisë sonë, me rastin e 10-vjetorit të themelimit të saj.

Rruga e kaluar nga «Zëri i Popullit» është rrugë e lavdishme, sepse e tillë është historia e Partisë sonë që e krijoi dhe e udhëheq atë. Në çastet më të vështira të jetës së popullit tonë, kur pushtuesit fashistë dhe tradhëtarët e vendit donin ta kthenin Shqipërinë në një koloni të imperializmit, Partia jonë, nëpërmjet gazetës «Zëri i Popullit», lëshoi kushtrimin e luftës për liri. Gazeta u bë një mjet i fuqishëm në duart e Partisë dhe të popullit tonë, në luftën e shenjtë për një Shqipëri të lirë, demokratike, popullore, në dërmimin e gjithë armiqve të Partisë dhe të popullit dhe në triumfin e plotë të vijës leniniste-staliniane të Partisë sonë.

Gazeta «Zëri i Popullit» edhe sot po i kryen me nder detyrat e saja në luftën për mbrojtjen e paqes dhe ndërtimin e themeleve të socializmit. Ajo e edukon popullin me frymën e patriotizmit dhe të vigjilencës revolucionare, me frymën e dashurisë e të besnikërisë së pakufishme ndaj atdheut të madh të socializmit dhe të Partisë së Lenin-Stalinit, me idetë e internacionalizmit proletar. Gazeta lufton për interesat e klasës punëtore, të fshatarësisë punonjëse dhe të inteligjencies popullore, i mobilizon këto në luftë për realizimin e planit, pasqyron punën e tyre krijuese dhe është bërë një faktor me rëndësi për zhvillimin e emulacionit dhe të garave socialiste.

Por përballë detyrave të mëdha e të rëndësishme që ka populli ynë në realizimin e planit të parë pesëvjeçar, roli dhe përgjegjësitë e gazetës rriten dita-ditës më shumë. Gazeta duhet të bëhet gjithmonë një agjikator më i fuqishëm, një propagandist

më i flaktë dhe një organizator kolektiv më i mirë i masave tona punonjëse.

«Zëri i Popullit» duhet të forcojë më tepër propagandën për mbrojtjen e paqes, për forcimin e miqësisë dhe të dashurisë së popullit tonë për Bashkimin Sovjetik dhe Stalinin e madh dhe për demaskimin e imperializmit amerikano-anglez dhe të shërbëtorëve të tij.

Organi i Komitetit Qendror të Partisë duhet të bëjë një propagandë më të gjerë dhe me një cilësi më të lartë për përhapjen e ideve të marksizëm-leninizmit e për të ndihmuar anëtarët e Partisë dhe masat punonjëse në përvetësimin e kësaj teorie.

Gazeta duhet të organizojë në një shkallë më të gjerë përhapjen e eksperiencës së më të mirëve, të nxitë më tepër zhvillimin e emulacionit socialist dhe të lëvizjes sulmuese në vendin tonë, të trajtojë më shumë dhe më mirë problemet e fshatit. Gazeta duhet të forcojë kritikën parimore dhe instruktive kundrejt të metave, lëshimeve, gabimeve dhe shtrembërimeve në zbatimin e vijës së Partisë.

Komiteti Qendror i Partisë i tërheq vëmendjen redaksisë për punën e pamjaftueshme që është bërë me korrespondentët punëtorë e fshatarë dhe porosit që në bazë të vendimeve të Partisë sonë të merren masa urgjente për zhdukjen e kësaj të mete. Lidhja sa më e ngushtë me masat, puna e vazhdueshme dhe sistematike për zgjerimin e forcimin e rrjetit të korrespondentëve punëtorë e fshatarë duhet të jetë një nga detyrat më të rëndësishme të të gjitha redaksive.

Komiteti Qendror i Partisë porosit gjithë punonjësit e gazetës që të shtojnë përpjekjet për ngritjen e tyre politike, ideologjike e profesionale dhe për përvetësimin e vazhdueshëm të eksperiencës së lavdishme të shtypit bolshevik.

Komiteti Qendror i uron redaksisë suksese të reja në punën e mëtejshme të gazetës dhe ka besim se në të ardhshmen gazeta «Zëri i Popullit» do t'i kryejë akoma më mirë detyrat e ngarkuara nga Komiteti Qendror i Partisë.

Për Komitetin Qendror të PPSH

Sekretari i përgjithshëm

Enver Hoxha

Botohet sipas librit:
Enver Hoxha. «Vepra,
vëll. 9»

UDHËZIME TË KQ TË PPSH MBI PUNËN E ORGANIZATAVE BAZË TË BRPSH NË ATO FSHATRA KU NUK KA ORGANIZATA BAZË PARTIE

18 shtator 1952

GJITHË KOMITETEVE TË PARTISË

Sipas Statutit të PPSH Partia ka në drejtimin e saj organizatën e BRPSH. Në tërë aktivitetin ajo duhet të ndihmojë Partinë për zbatimin e vijës së saj. Plenumi X i Komitetit Qendror të PPSH vendosi: «Organizatave bazë të BRPSH në ato fshatra që nuk ka organizata partie, duhet të mbajnë përgjegjësinë e plotë për zbatimin e direktivave të Partisë»¹. Për zbatimin e këtij vendimi po japim këto udhëzime:

1. — Detyrat e këtyre organizatave

Organizatave bazë të BRPSH në ato fshatra ku nuk ka organizata bazë të Partisë, sikurse gjithë organizatat e tjera të BRPSH duhet të shpien në fshat vijën e Partisë dhe të punojnë në mënyrë aktive për zbatimin e direktivave të saja. Në vendimin Nr. 97 të Byrosë Politike të Komitetit Qendror të PPSH thuhet: «Rinia duhet të bëhet përcuese e politikës së Partisë në fshat». Dhe më poshtë: «... Rinia, veçanërisht njerëzit më aktivë të saj, të sqarojnë e të bindin fshatarët mbi drejtësinë e politikës së Partisë dhe të bëhet ajo roja e ligjshmërisë revolucionare». Organizatat e rinisë në këto fshatra duhet të shtrojnë në mbledhjet e tyre të gjitha problemet ekonomike, politike dhe shoqërore që ka Partia. Ato duhet t'i shqyrtojnë këto probleme nga të gjitha anët, të marrin vendime dhe të kujdesen për zbatimin e plotë të këtyre vendimeve. Ato duhet t'u kushtojnë kujdes të veçantë në fshat probleme-

¹ Shih në këtë vëllim f. 229.

ve të bujqësisë, të grumbullimeve, të shkollës, luftës kundër prapambetjes etj. Këtë punë duhet ta bëjnë të gjitha organizatat bazë të BRPSH, por kjo duhet konsideruar si detyrë e domosdoshme për ato organizata ku nuk ka organizata bazë të Partisë. Këto nuk fundit ndryshojnë nga organizatat e tjera të rinisë, sepse nuk kujdesen vetëm për punën dhe aktivitetin e të rinjve të fshatit, por kanë detyrë të kujdesen përgjithësisht për punën e fshatit. Kështu p.sh. në qoftë se ato do të marrin në studim çështjen e grumbullimeve, nuk do të kufizohen vetëm në detyrat e të rinjve për grumbullimin, por duhet të këshillohen për këtë me këshillin e fshatit, me përgjegjësit e organizatave të Frontit e të gruas, me fshatarë të ndryshëm etj. Në këtë mënyrë ata diskutojnë jo vetëm për të metat e organizatës së rinisë, por ngrenë edhe të metat e këshillit të fshatit e të organizatave të tjera të masave në fshat dhe u sugjerojnë atyre masat që duhet të marrin. Por ata duhet të kujdesen që për vete të marrin përsipër detyrat më të vështira, që çdo të ri e të re ta ngarkojnë me detyra të caktuara, që shembullit personal të të rinjve t'i kushtojnë një kujdes të veçantë.

Partia u jep një besim të madh këtyre organizatave duke u ngarkuar përgjegjësi të plotë për zbatimin e detyrave të Partisë në fshatrat ku nuk ka organizata partie. Për ta zbatuar më mirë këtë detyrë që u ngarkon Partia duhet të kenë parasysh:

a) Të dëgjojnë informacione në mbledhje të organizatës nga kryetari i këshillit të fshatit për çështje të caktuara ekonomike. Në këto mbledhje kryetari i këshillit shtron përpara të rinjve detyrat që dalin për këto probleme dhe çfarë duhet të bëjë rinia. Organizata e rinisë nuk mund t'i kërkojë llogari kryetarit të këshillit, as që mund ta detyrojë atë që të vijë edhe për informacion në organizatën e rinisë. Kjo punë duhet bërë në marrëveshje të plotë me këshillin, i cili është pushteti në fshat.

b) Të shtrojnë përpara këshillit të fshatit dhe organizatave të masave probleme të ndryshme të fshatit dhe t'u sugjerojnë atyre masat që duhen marrë.

c) Të shtrojnë përpara organizatave bazë të Partisë e komiteve të Partisë në rrethe (kur është nevoja) gjendjen e fshatit për probleme të ndryshme, të bëjnë para tyre propozime dhe kërkesa për zgjidhjen e këtyre problemeve dhe për nevojat e ndryshme të fshatit.

Siç shihet këto organizata kanë inisiativë të gjerë në shqyrtimin dhe shtruarjen para organizatave përkatëse të Partisë të të gjitha problemeve të fshatit, me qëllim që të eliminohen të metat në punë. Kështu këto do të bëhen ndihmëse aktive të Partisë në tërë ndërtimin shtetëror dhe ekonomik e do të bëhen mbështetje e saj për realizimin e planit të parë pesëvjeçar në fshat.

2. — Mbi punën e komiteve të rinisë me këto organizata

Kryerja e detyrave të sipërme nga ana e organizatave të rinisë, kërkon që komitetet e BRPSH të rretheve, të ndihmojnë e të kontrollojnë më shumë punën e këtyre. Komitetet e Partisë duhet t'u kërkojnë llogari atyre për punën që bëjnë me këto organizata dhe të kenë parasysh se përgjegjësinë kryesore për ato e kanë komitetet e rinisë. Në asnjë mënyrë komitetet e rinisë nuk duhet të shkarkojnë përgjegjësinë që kanë për këto organizata pavarësisht nga puna që do të bëjnë organizatat bazë dhe komitetet e Partisë në rrethe. Komitetet e rinisë duhet të kujdesen në mënyrë të veçantë t'u japin një ndihmë më të madhe e më të afërt organizatave bazë të rinisë në fshatrat ku nuk ka organizata bazë të Partisë.

3. — Mbi ndihmën dhe kontrollin nga ana e organizatave bazë dhe komiteve të Partisë

Komitetet e Partisë dhe organizatat bazë duhet të tregojnë një kujdes të veçantë për punën e këtyre organizatave të rinisë. Ndryshe ato nuk mund t'i kryejnë detyrat që u ngarkon Partia. Praktikisht duhet vepruar në këtë mënyrë:

a) Organizatat bazë të Partisë duhet t'i thërrasin më shpesh në raport këto organizata rinie për probleme të caktuara të punës në fshat. Mundet që këto mbledhje të bëhen të hapura, sepse kështu do të shërbejnë edhe për të rritur autoritetin e organizatave të rinisë në masat. Sekretarët e organizatave të rinisë, kur këta nuk janë komunistë, duhet të ftohen në të gjitha mbledhjet e organizatave të Partisë, përveç kur shtrohen probleme të brendshme të Partisë.

Në mbledhjet e këtyre organizatave të rinisë duhet të marrin pjesë sekretarët e organizatave bazë të Partisë ose komunisti që është në atë fshat, të cilët do t'i ndihmojnë të rinjtë për t'i shqyrtuar mirë problemet. Në këtë punë duhet pasur parasysh që të mos zbatohen mekanikisht eksperiencia dhe format e punës së Partisë, por të mbahen parasysh konditat e veçanta të punës me rininë.

Organizatat bazë të Partisë duhet të kenë të qartë se në fshatrat ku ka një ose më shumë komunistë, këta mbajnë përgjegjësi të plotë para Partisë për gjendjen e fshatit dhe aktivitetin e këtyre organizatave të rinisë.

b) Kujdesi i komiteve të Partisë duhet të përqëndrohet në radhë të parë në edukimin e sekretarëve që drejtojnë këto organizata. Ata duhet të ndjekin frekuentimin dhe përparimin e tyre në shkollat politike të Partisë, të organizojnë kalimin e atyre që janë

komunistë në kurset e Partisë dhe ata që nuk janë komunistë të dërgohen të parët në kurset e rinisë, të ndjekin punën që bëhet dhe sa përfitojnë ata nga seminarët e Partisë e të rinisë, t'i ndihmojnë ata në përpjekjet që bëjnë për edukimin politik e kultural të tyre.

Është mirë që në fshatrat ku ka komunistë, të cilët i kanë kon-ditat, të rekomandohen për t'u zgjedhur sekretarë të këtyre organizatave.

Sekretarët e organizatave bazë të BRPSH, për këto fshatra, duhet të thirren në seminarët që organizon komiteti i Partisë me sekretarët e organizatave bazë, me përjashtim të rasteve kur në këto seminare shtrohen çështje të brendshme të Partisë.

Mundet që komiteti i Partisë t'i thërrasë në raport këto organizata, por duhet pasur parasysh që nuk mund të pretendohet nga këto sikurse nga organizatat bazë të Partisë. Zakonisht ato duhen thirrur në raport lidhur me sukseset e punës së tyre, me qëllim që të inkurajohen për rezultate më të mëdha dhe të shpërndajnë eksperiencën e tyre në organizatat e tjera.

Këto organizata bazë rinie të ndihmohen më tepër në vend. Të dërgohen për këtë jo vetëm shokë nga komiteti i rinisë, por edhe instruktorë të komitetit të Partisë dhe herë pas here të shkojnë vetë anëtarët e byrosë dhe sekretarët e komitetit të Partisë për ta parë punën në vend e për t'i ndihmuar.

Vetë eksperiencia në të ardhshmen do të tregojë edhe më mirë se si duhet punuar e si duhen ndihmuar këto organizata. Por komitetet e Partisë duhet të kenë parasysh që të mos i nënvleftësojnë e as t'i mbivlerësojnë këto organizata. Atje ku nuk ka organizata partie këto mund të kryejnë një punë të madhe në ndihmë të Partisë, por ato nuk mund ta bëjnë këtë vetë, po të jetë se nuk kontrollohen e nuk ndihmohen direkt nga organizatat bazë e nga komitetet e Partisë.

4. — Gjatë punës në lidhje me këto organizata duhen mbajtur mirë parasysh:

a) Këto detyra dhe të drejta që u jepen këtyre organizatave nuk duhet t'i bëjnë ato që ta konsiderojnë veten mbi pushtetin dhe organizatat e tjera të masave në fshat. Shfaqje të tilla janë dukur aty-këtu, p.sh. në Kolonjë, në Tepelenë etj. Organizatat e rinisë kanë për detyrë të ngrenë të metat që konstatojnë në punën e pushtetit e të organizatave të masave, qoftë te vetë ato, qoftë në organizatat bazë dhe në komitetet e Partisë. Ato kanë për detyrë gjithashtu të sugjerojnë masat që duhen marrë e të paraqitin kërkesa e propozime për mbarëvajtjen e punës. Por ato janë gjithnjë organizata rinie dhe si të tilla nuk kanë të drejtë të kërkojnë

llogari, t'i thërrasin në raport e t'u diktojnë atyre detyra të ndryshme. Funksione të tilla ka vetëm organizata bazë e Partisë. Lidhjet e këtyre organizatave të rinisë, me organet e pushtetit në fshat dhe me organizatat e tjera të masave, duhet të bëhen në bazë të marrëveshjes së plotë. Mund të ndodhë që vërejtjeve dhe sugjerimeve të drejta nga ana e këtyre organizatave të mos u kushtohet kujdes i duhur nga këshilli i fshatit etj. Në raste të tilla ato duhet të vënë në dijeni organizatën bazë e po qe nevoja komitetin e Partisë, të cilat duhet t'i studjojnë këto çështje e të marrin masa. Komitetet e Partisë duhet të vënë në dijeni organet e pushtetit dhe organizatat e masave në fshat për këto detyra që kanë organizatat e rinisë në fshatrat ku nuk ka organizata bazë partie.

b) Fakti që komitetet e Partisë do të tregojnë në të ardhshmen një kujdes më të madh për këto organizata të rinisë nuk duhet t'i bëjë organizatat bazë të Partisë që të kujdesen më pak për to. Gjithashtu kjo nuk duhet të shkaktojë që këto organizata bazë të rinisë të mos kujdesen sa duhet për të siguruar kontrollin dhe ndihmën e organizatave bazë të Partisë si dhe të komiteteve të rinisë.

Këto udhëzime të shtrohen nga ana e sekretarëve të komiteteve të Partisë në seminarët më të afërta që do të bëhen me aparatit e komiteteve të Partisë dhe me sekretarët e organizatave bazë të Partisë ku do të marrin pjesë edhe sekretarët e organizatave bazë të rinisë të atyre fshatrave në të cilat nuk ka organizata partie.

Për Komitetin Qendror të PPSH

Sekretari i Përgjithshëm

Enver Hoxha

Botohet sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë